REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I LETËRSISË SHQIPE

DISERTACION

RECEPTIMI I POEZISË SË LASGUSH PORADECIT

Punoi
Msc. ILIR SHYTA

Udhëheqës shkencor
Prof.dr. DHURATA SHEHRI

TIRANË, 2015

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I LETËRSISË SHQIPE

DISERTACION
Përgatitur nga: ILIR SHYTA
Për marrjen e gradës shkencore: "DOKTOR"

RECEPTIMI I POEZISË SË LASGUSH PORADECIT

Udhëheqës shkencor: Prof.dr. DHURATA SHEHRI

Mbrohet në dt. ___. ___. 2015 përpara jurisë së përbërë nga:

1. _____ _____ Kryetar
2. _____ _____ Anëtar
3. _____ _____ Anëtar (oponent)
4. _____ _____ Anëtar (oponent)
5. _____ _____ Anëtar

TIRANË, 2015

* “Të gjithë marrin jetë prej FLAKËS që ndrin, asnjë s’kujton ZJARRIN që pat djegur. Sepse POETI nuk rron jetën e vdekur të vet, po jetën e pavdekur të Kombit të vet.
Përpara së gjithash është POEZIJA. Ajo formon shpirtin e kombit. Një libër me një roman është një libër bashkëbisedimi, ndërsa një libër me poezi është një libër formimi...
Prandaj duhet të shkruajmë poezi jo të mirë, po shumë të mirë, jo të lartë po shumë të lartë, shumë të thellë, shumë të gjerë, që t’i vemë shpirtit të kombit themele... të shëndosha” *Lasgush Poradeci*

* “I famshëm do të thotë i njohur, i çmuar, i lexuar” *Ismail Kadare*

* “Vepra letrare është si një partiturë, e krijuar për një rezonancë përherë të re, të lexuesit” *Robert Haus Jauss*

* “Thelbi i kritikës është të dish të lexosh dhe t’i mësosh të tjerët të lexojnë”
Charles Augustin Saint-Beuve

* “Shkruaj, sepse më pëlqen të më lexojnë. Shkruaj, sepse besoj si një fëmijë në pavdekësinë e bibliotekave dhe në vendin që do zenë aty librat e mi”
Orhan Pamuk

Tabela e përmbajtjes

Tabela e përmbajtjes 4
I. HYRJE 6
II. KAPITULLI I PARË. PRERJE TEORIKE 10
(Çelsa në teoritë bashkëkohore të leximit) 10
II.1. Metodologjia e përdorur në punim 19
II.2. Objektivat e punimit 19
II.3. Recensionimi i shkrimeve dhe zgjedhja e kuadrit të referencës 20
II.4. Kërkimi në punim. Formulimi i çështjeve 20
II.5. Hipoteza 21
II.6. Përpilimi i një plani logjik (devizës) për punimin kërkimor 21
II.7. Zgjedhja e metodës të analizës së të dhënave, analiza cilësore dhe ajo statistike 21
II.7.1. Zgjedhja e kampionit 21
II.8. Zgjedhja e instrumentave për mbledhjen e informacionit në terren 21
III. KAPITULLI I DYTË. RECEPTIM NË VITE 23
III.1 Leximi i Lasgush Poradecit gjatë viteve 1928-1939. Hermeneutika si përvojë leximi 23
III.2. Leximi i veprës së L. Poradecit gjatë viteve ’40-‘44 29
III.3. L. Poradeci në periudhën kohore ‘45-‘90. Kritika utilitare, kritikë angazhuese. Pleqënim(e) më vete 32
III.4. Receptimi i poezisë së Lasgush Poradecit, pas viteve 1990. 43
IV. KAPITULLI I TRETË. FILLESAT E KRIJIMIT POETIK 67
IV.1. Botimi i librit, tirazhi, lexuesit e parë. Poezitë e muzikuara 67
V. KAPITULLI I KATËRT. BOTIME TË TJERA 83
V.1. Publikime në Rumani, Shqipëri dhe Kosovë 83
V.2. Amaneti i Çabejit: Lasgushi i përkthyer 94
VI. KAPITULLI I PESTË. KRITIKA SOCREALISTE 100
VI.1. Tematizmi i kritikës rreth veprës së Poradecit 100
VI.2. Padakortësi në çështje të realizmit socialist 101
VII. KAPITULLI I GJASHTË. POETIKA 104
VII.1. Poezia e Lasgushit: Vlerësime përgjithësuese receptivo-strukturale 104
VII.2. Vdekja dhe testamenti i përjetshëm. Ideja e dhënë përmes strukturës artistike në varg 105
VII.3. Tendencë meditatovo-kuptimore 109
VII.4. Vargjet me sens kritik, që mbartin lëndë jetësore 115
VII.5. Vargje poetike pjesërisht të angazhuar 120
VII.6. Pesimizmi në krijimtarinë e Poradecit 123
VII.7. Lirika intime, erosi lasgushian. Krijimet për dashurinë! 126
VII.8. Filozofia e jetës dhe tragjizmi përmes dhimbjes poetike 132
VII.9. Copëza shpirti e jete si modele poetike. Poeti piktor dhe piktori poet. 134
VIII. KAPITULLI I SHTATË. FAQE DITARËSH DHE SHKRIME TË TJERA 140
VIII.1. Karakteristika të zhanrit ditar te Lasgush Poradeci. Ditari për dashurinë. Proza poetike e Lasgushit dhe struktura narrative e saj 140
VIII.2. Ditari personal i përditshmërisë së poetit, problematika e tij. 142
VIII.3. Ditari personal dhe korrespondenca intime e poetit, fragmente nga jeta, mjedisi dhe hapësira kulturore e kohës 143
VIII.4. Shënime për ngjarje reale historike të prekshme për realitetin shqiptar. 144
IX. KAPITULLI I TETË. VARIANTËT, TEKSTI I PARË 147

IX.1. Variantet poetike lasgushiane dhe receptimi filologjik 147
X. KAPITULLI I NËNTË. KUTELI, INTERTEKSTUALITETI I POETIT, LËQERI I KRISTOFORIDHIT 154
X.1. Dy qëndrimet e Kutelit për poezinë lasgushiane dhe intertekstualiteti i poetit 154
X.2. Interpretim filologjik mbi disa fjalë mbizotëruese në poezinë e L. Poradecit .. 157
XI. KAPITULLI I DHJETË. LASGUSHI DHE LEXUESI I "DETYRUAR" 159
XI.1. Poezia e Lasgush Poradecit në sistemin parauniversitar, atë universitar shqiptar dhe çështje të tjera sqaruese 159
Kronologji bibliografike e jetës dhe veprës së Lasgush Poradecit në tekstet parauniversitare dhe ato univesristare 165
XII. KAPITULLI I NJËMBËDHJETË. NJË RECEPTIM NDRYSHE 171
XII.1. Receptime poezish që veçohen nga të tjerat 171
XIII. KAPITULLI I DYMBËDHJETË. RECEPTIM PËRMES LEXIMIT ELEKTRONIK 177
XIII.1. Leximi on-line i poezisë së Lasgush Poradecit 177
XIV.KAPITULLI I TREMBËDHJETË. PYETËSORI 180
XIV.1. Receptim përmes një pyetësori 180
XV. BIBLIOGRAFIA *:* 208
Referenca: 208
Litereturë teorike: 209
Tregues i autorëve të shqipëruar dhe redaktuar nga Lasgush Poradeci: 209
Literaturë kritike: 211
-Poezi, artikuj, prozë poetike, ese të Lasgush Poradecit në perodikun shqiptar, rumun, antologji, gazeta, revista etj... 233
XVI. INDEKS 248
Tregues i autorëve të shqipëruar dhe redaktuar nga Lasgush Poradeci. 248
Treguesi i autorëve të librave dhe shkrimeve mbi Lasgush Poradecin. 249
Tregues i titujve të krijimeve të Lasgush Poradecit, shkrimeve dhe intervistave të tij në periodikë të ndryshëm. 254
Tregues kronologjik i autorëve të shqipëruar në vite nga Lasgush Poradeci. 259
Tregues kronologjik për çdo dhjetëvjeçarë i autorëve të shkrimeve, librave dhe krijimeve poetike për Lasgushin 260
Lista e organeve të periodikut, në të cilin është botuar vepra letrare dhe intervistat e Lasgush Poradecit (1922-2010). 262
XVII.APENDIKS 262
PYETËSOR 262

I. HYRJE

Jetojmë në një kohë kur informacioni zë hapësirën më të rëndësishme në komunikimin ndërmjet njerëzve. Dukuria në fjalë tashmë është i përhapur, që nga faqet e medias së shkruar, mediave vizive satelitore, tokësore, radiofonike dhe sidomos nëpërmjet teknologjive më të përhapura të internetit dhe rrjeteve elektronike të komunikimit celular, nga qendrat e mëdha qytetare, gjer në lokalitetet më të thella, duke përvijuar idenë gjithmonë e më të afërt drejt realitetit të globalizmit. Shqipëria është pjesë e së tërës dhe bota sa vjen e më tepër, nëpërmjet komunikimit, herë i ngushton dhe herë i afron hapësirat e saj, jo vetëm gjeografike. Në të gjithë këtë trysni të jetës moderne, ku jepet e merret informacion në hapësirë të pamatë, në një në kohë rekord, ne përforcojmë idenë se studimi mbetet banka e vetme ku është depozituar dija.

Jo më kot e filluam këtë parashtrim me një ekspoze të shpejtë se çfarë ndodh aktualisht rreth nesh. Për të vënë në dukje faktin, se përveç dobisë me të vërtetë të madhe të këtyre metodave në përhapjen e informacionit dhe komunikimit, të gjitha njëherazi për këndvështrimin e tyre tërësor mbartin një antikap të përbashkët. Ato kanë trajta tepër fluide si pasojë e shpejtësisë me të cilën lëvizin dhe si rrjedhojë, janë tepër fragmentare për të krijuar një ide solide rreth një hulumtimi të kompletuar, qoftë ky edhe shkencor, që në rastin tonë e kryen më së miri vetëm një vështrim qasës dhe i shteruar për X autor. Metoda është ndërtuar e tillë, që të vërehet drejtpërdrejt përmbajtja e veprave të përfshira në të, por edhe për të theksuar faktin tjetër që ato njihen pak ose aspak në publik. Kjo përshembull për Y autor, në rastin konkret Lasgush Poradecin. Poezia e tij solli një ndjeshmëri në letërsinë shqiptare, solli një kërkim të thellë edhe gjuhësor, e formal dhe një figuracion të paparë artistik. Poezia lasgushiane pati një komunikim jo të zakonshëm me lexuesin dhe kritikun e kohës. Shumë prej tyre e pagëzuan si princ të letërsisë shqipe, ndërsa shumë të tjerë vunë në pikëpyetje vlerat e poezisë së tij, veçanërisht në periudhën pas dy luftrave botërore.

Në të gjitha këto vite, ajo që vërehet është fakti se mungon informacioni i përqendruar në një tekst unik, brenda një libri të destinuar për të qenë burimi i informacionit më të plotë, jo fragmentar për teoritë receptive të një autori, të cilat të përfshijnë të gjitha të dhënat kundrejt objektit të studimit, deri në kufijtë e së shtershmes mes autorit dhe lexuesit. Me të shtershme kuptojmë çdo informacion që ekziston si i veçantë, në lidhje të përhershme me veprën dhe autorin, që ne përpiqemi ta sjellim si tërësi në shërbim të së ardhmes. Burimi i informacionit tashmë duhet të jetë i mbledhur në një pikë të vetme.

Ka ardhur momenti të zhvillohet dija në formë informacioni të gatshëm për komunikim, konkretisht rreth një personaliteti të caktuar të letrave shqipe, kryesisht mbi veprën e tij, kohën e krijimtarisë apo lexuesin eksplicit dhe implicit. Me këtë nuk nënkuptohet vetëm analiza e veprës letrare, por specifikisht e kemi fjalën për arshivimin e saktë të periodikut dhe toponimeve a hidronimeve, që kanë lidhje me publikimet e ndryshme, në vite. Këto janë refleksione të drejtpërdrejta apo të tërthorta, nga autorë në organe të ndryshme, në vende, e pse jo edhe në lëvrime gjuhësh të huaja, që në fakt do t'i jepnin informacionin e duhur për analizë historisë së letërsisë shqipe. Ajo duhet të gjykojë faktorët se përse vepra ka lënë gjurmë në kohë specifike dhe është njëtrajtësuar në këtë hapësirë kulturore. Kështu krijohet ideja solide sa më e plotë rreth personalitetit individual krijues të autorit. Me këtë ide është hedhur njëherazi edhe guri themeltar i etapave të caktuara brenda të cilave hulumton më tej *"Teoria e Letërsisë"*.

Pra, gjithçka që ekziston rreth autorit dhe veprës letrare të tij, e pasqyruar në vite, duhet të përmblidhet në një vështrim të arysetuar, me qëllimin për ta përqendruar informacionin kulturologjik dhe për ta shndërruar atë në komunikim efikas. Për t'i dhënë trajtë më të plotë puzzle-s me fjalë. Duke bërë edhe njëfarë përmbledhje pasqyruese, indirekte të gjuhës së shtypit dhe frazeologjisë ndër vite. Për t'u dhënë liri dhe kursim kohe të gjithëve. Për të kompletuar mënyrën e trajtimit shkencor, letrar të informacionit rreth lexuesit dhe autorit, të cilin studiuesi kërkon ta zotërojë. Hans Robert Jauss-i mbetet themeluesi i kësaj metode.

Ndërmjet të tjerash, ky punim receptiv mbi veprën poetike të Lasgush Poradecit ecën në gjurmët e këtij profili. Vihet re lehtësisht, se jemi në hapat e para të kësaj metode për të cilën uroj të zgjerohet edhe me trajtesa të tjera, për të konsoliduar studimin e letërsisë shqipe. Insistimi ynë për t'u paraqitur me një punim të tillë, ka të bëjë me të gjithë faktorët e sipërpërmendur për t'i ardhur në ndihmë gjithësecilit, në këtë dritëparje të veprës së një autori.

Janë të njohura praktikat e të çuarit deri në profesionalizëm të profesionit të bibliotekarit në botën e civilizuar. Për këtë punë ka specializime përkatëse, për ta kryer profesionalisht këtë detyrë. Nganjëherë aq frytdhënëse janë këto përkujdesje të punonjësve të bibliotekave ndaj librit, sa i kanë ndryshuar kahun edhe vetë letërsisë së përbotshme, si në rastin e Borgesit, bibliotekarit mahnitës.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për funksionin dhe dobinë e këtij lloj punimi, në mbështetje të vetë receptimit (veprës, jetës së autorit dhe lexuesit). Përngjason si lojë fjalësh, por nuk është e tillë. Receptimi mbështet dhe zhvillon rrugën e dijes. Nëpërmjet tekstesh të tjera jemi në gjendje të dekodojmë vetë receptimin, e nëpërmjet tij vetë historinë e kulturës së njerëzimit për të interpretuar a imituar. Kjo është *"loja"* që luhet në rastin e përthithjes së informacionit.

E gjejmë të udhës të theksojmë që në nisje të punimit tonë, se për Lasgush Poradecin ekziston një kritikë e mirëfilltë dedikuar veprës letrare. Disa mendime janë shprehur në fillim, në periodikun e kohës, të cilat mund të konsiderohen si përsiatje fillestare. Më pas është vijuar me një shumësi studimesh letrare. Lista e organeve të periodikut mund t'u hyjë në punë studiuesve dhe të interesuarve të tjerë. Në fund të punimit tonë gjendet bibliografia e përbërë nga treguesit e saj. Ajo përmban të dhëna për autorët që kanë shkruar për veprën letrare të Lasgush Poradecit, për poezitë e publikuara në organe të ndryshme të shtypit dhe listën e plotë të periodikut, ku është botuar krijimtaria e Lasgush Poradecit.

Nis e dëgjohet për ekzistencën letrare të L. Poradecit gjatë periudhës 1928-1939, periudhë e cila shënon edhe botimet e para sporadike të vjershave dhe më pas botimin e dy librave me poezi *"Vallja e yjve"* (1933)[1] dhe *"Ylli i zemrës"* (1937)[2]. Ribotimi i vëllimit të dytë bëhet në vitit 1939.

Konkretisht në vitet 1932-1939 vëllimet poetike të Lasgushit do të botohen në Rumani, për t'u sjellë në Shqipëri, tregtuar e shpërndarë më pas. Kemi edhe një botim tjetër të Poradecit, në Rumani, në vitin 1946. Janë 15 faqe të kseroksuara me titull: "*Misioni i shqiptarëve të Bukureshtit dhe Naim Frashëri"*. (Fjala e Lasgush Poradecit, ish-sekretar i përgjithshëm i Kolonisë së Bukureshtit, mbajtur me rastin e 100-vjetorit të lindjes së poetit tonë kombëtar).

Periudha kohore 1928-1944 do të ketë të ekspozuar në vitrinën e shtypit, pjesë nga poezitë e Lasgushit. Vitet pasçlirimit të vendit, nga 1945-sa deri më '75-sën nuk do të kenë asnjë varg të publikuar. Në këtë periudhë do të botohen pak poezi të poetit të

[1] L. Poradeci, *Vallja e yjve*, Shtypur në Albania, Kostancë, 1933, -119f.
[2] L. Poradeci, *Ylli i zemrës*, Shtypur në Albania, Kostancë, 1937, -184f.

"harruar" që në gjallje të tij. Shteti komunist e boton veprën e L. Poradecit vetëm tri herë, konkretisht në vitet '60, '74 dhe '90.
Duke mbetur në këtë kuadër, pas vitit '97-të është shkruar shumë për Lasgushin. Jemi përpjekur të jemi sa më të saktë në atë që është botuar këtej dhe andej kufirit. Njohja e më pas vazhdimësia e famës së Llazar Gushos përmblidhet në disa periudha duke përfshirë në vetvete dritëhije të shumta. Popullorëzimi i tij ka mbrritur gradualisht në letërsinë shqipe. Këtë e dëshmon kritika letrare. Ndërkaq nuk duhet të harrohet që vazhdohet të shkruhet çdo ditë për jetën dhe veprën letrare të Poradecit.
Për krijimtarinë e Lasgush Poradecit deri tani kanë shkruar kritikët, historianët e letërsisë, eseistët, teoricienët, historianët, gjuhëtarët, pedagogët, shkrimtarët, filozofët, gazetarët, politikanët, krijuesit e rinj të letërsisë e shumë të tjerë. Për krijimtarinë e tij janë botuar shkrime të llojeve dhe trajtimeve të ndryshme, studime, monografi, vështrime, sprova, trajtesa apo romane, tregime, poezi dhe janë realizuar disa filma dokumentarë. Janë shkruar vjersha nga gjithfarë poetësh, të njohur dhe të paafirmuar akoma në letërsinë shqipe. Ismail Kadare shkruan romanin *"Ikja e shtërgut"*[3], për L. Poradecin. Mjafton të shohësh bibliografinë e arsyetuar për Lasgush Poradecin dhe kupton se sa shumë është shkruar dhe botuar për të në vite.[4]
Poradeci vazhdon të mbetet poet i gjithë shqiptarëve, në trevat ku ata jetojnë. Popullorëzimi i poetit, për shkak të ideve, gjuhës poetike të zhdërvjellët dhe filozofisë, nga shumë lexues do vështrohet i shenjtë, ndërsa një pjesë tjetër e mendonin më të hershëm në letërsi sesa periudha letrare së cilës i përkiste. Lasgush Poradeci, adhurohej nga lexues të grupmoshave të ndryshme. Lexuesi në horizonte pritëse ka shfaqur gjithherë dëshirën për ta pasur veprën e Poradecit në dorë. Përgjithësisht ajo ka munguar në intervale kohore për shkak të tirazhit të vogël, së pari të shtypur në Rumani, së dyti, *"injorimit"* që i bëri diktatura enveriane në vitet e saj dhe, së treti prej mos ribotimit të familjarëve të poetit pas viteve '90.
Më 1999, botohen tri veprat letrare, për të vijuar me vitet 2002, 2005, 2009 dhe 2010 në shtëpi të tjera botuese private, një pjesë e tyre edhe si ribotim ose bashkim librash.
Përsa i përket pjesës letrare, mund të themi që vetëm pas vitit '90 ajo meritoi skeptrin mbretëror të princit të talentuar në letërsi. Vitet '90 e këtej dëshmojnë një gjeografi të re të mendimit kritik, përshfaqur në libra dhe periodikë të ndryshëm. Prezantohen lirshëm, analiza dhe vlerësime sintezë, pikërisht në kohën më të përshatshme të mundshme. Kjo situatë është pak a shumë e ngjashme përsa u përket edhe pjesëve të veprës letrare të Lasgushit, të botuara në periodikë shqiptarë në vitet 1922-2009.
Kosova, atëherë krahinë autonome e Jugosllavisë prezantoi botime speciale të veprës së poetit dhe i festoi, plot dinjitet përvjetorin e lindjes. Kosova rrit përmasat e Lasgushit. Nën kujdesin e Sabri Hamitit kemi katër botime të plota, cilësore, të lirikave në vitet '68, '78, '86 dhe '90. Poradeci është poeti i vetëm shqiptar, i "vdekur" nga regjimi diktatorial, që në gjalljen e tij.
Lasgushi, ndërkaq, klasifikohet ndër ata autorë që e ka patur pranë lexuesin dhe receptuesin e veprës së tij poetike, pasi marrëdhëniet e poezisë së tij, nuk kanë qenë asnjëherë të largëta nga Shqipëria. Lasgushi e ka dashur Shqipërinë dhe lexuesin e tij dhe këtë e ka bërë përmes gjuhës, pasi zgjodhi të shkruajë shqip. Nga ana tjetër lexuesi e ka dashur dhe lexuar me kujdes veprën e lirikut, duke e ngritur lart atë nëpër kohëra.
Vlerësimi i kësaj ane artistike të prekshme, në kuptimin letrar si gjendje apo vizion, luan një rol primar për të fokusuar të gjitha planet e përfaqësimit të Lasgush

[3] I. Kadare, *Përballë pasqyrës së një gruaje*, Shtëpia botuese "Onufri", Tiranë, 2001, fq. 113-154.
[4] I. Shyta, *Lasgush Poradeci Bibliografi e arsyetuar*, Shtëpia botuese "D.I.J.A-Poradeci", Pogradec, 2009, -320f.

Poradecit. Poeti bën një jetë modeste deri sa shuhet, është atdhetar në gjallje dhe lartëson poetikisht atdhedashurinë e ngulitur nga të parët e familjes Gusho.

II. KAPITULLI I PARË

PRERJE TEORIKE
(Çelsa në teoritë bashkëkohore të leximit)

Receptimi mes veprës së një shkrimtari dhe lexusit është marrëdhënie e ndërsjelltë që kushtëzon palët. Kjo lidhje e parë konkretisht në veprën e Lasgush Poradecit, funksionon më së miri tek ai dhe receptuesi i tij. Themeluesi i estetikës së receptimit, Jauss-i e thekson këtë bashkëekzistencë: "*Meqenëse raporti dialogues mes letërsisë dhe lexuesit, -i cili mund të kuptohet qoftë si bashkëlidhje mes komunikimit dhe marrësit, qoftë si marrëdhënie mes nxitjes e përgjigjes, -kushtëzon në mënyrë vendimtare veprën letrare, në veçoritë e saj artistike, sikundër në historicizmin e saj, ekziston mundësia për të themeluar mbi të lidhjen e veprave letrare në hapësirën e historisë së letërsisë".*[5]

Një klasifikim të receptimit kritik të poezisë së L. Poradecit bën edhe studiuesi Eldon Gjikaj: *"Shqyrtimi i receptimit kritik të veprës së një autori, veçanërisht kur kemi të bëjmë me një autor që sjell modele të reja e për pasojë provokon sistemin letrar, përbën një çështje me rëndësi të dorës së parë, sepse vendi i një vepre letrare në historinë e letërsisë është i pakonceptueshëm pa pjesëmarrjen aktive të receptuesve që u drejtohet".*[6]

Receptimin e autorit (L. Poradecit) duhet analizuar në nivelin historik, pasi *"mënyra sesi një vepër letrare dhe autori i saj, në momentin historik të shfaqjes, mban, tejkalon, zhgënjen, ose mohon pritjen e publikut të saj të parë, jep qartësisht një krtiter për të përcaktuar vlerën e saj estetike".*[7]

Lasgush Poradeci ka treguar se asnjëherë si kanë munguar lexusit apo adhuruesit e skajshëm të krijimtarisë që mban firmën e tij. Ai ka treguar në këtë ekzistencë se i është përshtatur me artin e tij shijes së lexuesit.

"Nuk ka poezi të madhe ose të vogël, të mirë ose të keqe, por vetëm poezi që i përshtatet plotësisht potencialit jetësor dhe poezi që s'i përshtatet. Poezija që i përshtatet, është POEZIJA, ajo që s'i përshtatet NUK është poezi dhe pra duhet të vdesë, të mos rrojë-sikundër dhe s'rron po humbet".[8] Kjo sentencë e shkruar nga Lasgushi identifikon më së miri fakte të komunikimit, të interpretuara nga Eric Buyssens, Luis Prieto apo Georges Mounin.

Buyssens sqaron se *"...semiologjia duhet të merret me fakte të perceptueshme, të bashkuara me gjendje të vetëdijes, të prodhuara vetëm për t'i bërë të njohura ato, që dëshmitari të mund t'ua njohë destinacionin. Objekti i saj do të kufizohet në faktin që ne do ta quajmë sinjal".*[9] Eric Buyssens, e vë theksin në sinjalet, pra në komunikimin e vërtetë me lexuesin. Librat dhe periodiku shqiptar e ilustrojnë saktësisht këtë ide. Vepra letrare e Lasgush Poradecit bëhet e perceptueshme përmes tij. Lexuesi poet identifikohet përmes kritikës së publikuar në shtypin e kohës, por edhe librave të veçantë. Këtë na e saktëson në punimin tonë kapitulli i dytë: *Receptim në vite*. Kapitulli në fjalë është një statistikë e saktë informative në këtë drejtim.

Receptimi lasgushian ka patur ulje ngritjet e tij në vlerësim final. *"Receptimi kritik i poezisë lasgushiane shfaqet kontrastues, duke përfshirë qëndrime skajshmërisht të*

---

[5] H. R. Jauss, *Perche la storia della letteratura?,* Guida editori, Napoli 2001, f. 34.
[6] E. Gjika, *Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit*. Naim, Tiranë, 2010, fq.42.
[7] H. R. Jauss, *Perche la storia della letteratura?,* Guida editori, Napoli 2001, f.45.
[8] L. Poradeci, *Poezia*,*Vepra 1*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2009, fq. 7.
[9] E. Buyssens, *La communication et l'articulation linguistique*, f. 13-14.

ndryshme. Ai mund të klasifikohet në tre tipe vleriësimesh: vlerësime maksimale, deri në glorifikim; përpjekje për një vlerësim objektiv, me luhatje mes entuziasmit dhe dyshimit; mohimi thuajse i plotë. Tek përfaqësuesit më seriozë të tipit të parë haset një nivel i admirueshëm i kuptimit të tekstit, tek përfaqësuesit e tipit të dytë haset rrekja për kuptimin e tij, ndërsa te përfaqësuesit e tipit të tretë ndeshet keqkuptimi dhe moskuptimi i këtij teksti".[10]

Receptuesi mbetet pjesë e këtij komunikimi sa të gjerë aq dhe të ngushtë njëherazi me veprën letrare. *"Semiologjia mund të përkufizohet si studim i prosedeve të komunikimit, domethënë i mjeteve të përdoruara për të ndikuar tek tjetri dhe të njohura si të tilla nga ai që duam të ndikojmë"*.[11] Eric Buyssens me sinjal nënkupton vetvetiu fenomene të cilat janë prodhuar nga emetuesi për të ndikuar, por që njihen edhe nga receptuesi si të tilla. Për shembull: Jo gjithmonë na ndodh të hasim një vepër letrare plot bukuri arti të arrirë, një ndjesi të përhumbur, a ndoshta një shtysë paraprake të fshehtë dhe ndoshta të pazbërthyeshme, e cila na shpalos vlerat e saj të vërteta artistike, na përthith e magjeps, na detyron ta vështrojmë dhe ta shijojmë pa bërë as më të voglën zhurmë brendapërbrenda origjinalitetit të saj. Ajo na bën të hedhim pas krahëve, madje në mënyrë të pashmangshme dhe krejt të natyrëshme, pa kurrfarë dhimbje apo "mëdyshjeje" të brendshme, të gjitha paragjykimet, kufizimet botëkuptimore, demagogjitë e verbra apo dogmatizmat e ngurta, të fabrikuara palodhshëm e në mënyrë të pandërprerë prej ideologjive sunduese a politikat kalimtare.

Përmes kapitujve tre dhe katër, konkretisht: *Fillesat e krijimit poetik* dhe *Botime të tjera, Rumania, Kosova, bota*..., përcjellim një informacon rreth veprës letrare, që destinacion ka lexuesin në tërësi brenda dhe jashtë Shqipërisë. Soditja e veprës, mbi të gjitha është shijimi artistik, është prangim. Përmes tyre saktësojmë informacion deri për kompozimet muzikore të tekstit të parë poetik, që ndikon te lexuesi për t'u afruar me veprën e autorit.

Lasgush Poradeci ka lexues kombëtarë dhe ndërkombëtarë falë përkthimit në gjuhë të huaj, të veprës letrare. Herë përmes një kodi të zbërthyeshëm dhe herë jo e pëlqejmë artin e tij, duke lënë mënjanë shumë paragjykime.

"Ato jo rrallë arrijnë të përcaktojnë strukturën e jetës sonë, për t'i lënë një hapësirë sa më të gjerë kënaqësisë që nuk ka të dytë, që premton të na dhurojë teksti, mendon Roland Barthes-i".[12] Po sipas tij, libri duhet të rrjedhë, sepse në thelb, pavarësisht shekujsh të tërë intelektualizmi, kritika do që letërsia të jetë gjithmonë një veprimtari e vetvetishme, e dhuntishme, e dhuruar nga një zot, një muzë, dhe nëse muza apo zoti janë disi të tërhequr, të paktën nuk duhet "fshehur puna jote". Një përjetim të tillë, të dhuron natyrshëm vepra poetike e Lasgush Poradecit, një përjetim që për lexuesin do të thotë befasi, ndërsa për vetë prezencën e veprës do të thotë vlerë artistike. Befasia e këndshme që të krijon leximi i poezive lasgushiane nuk qëndron aq tek vargu i tij, sesa te familjariteti, te mundësia që ajo i jep çdo lexuesi për t'u ndier i bashkëpërfshirë me autorin, në të gjitha emocionet që ai fal përmes poezisë. Poetika shpaloset në mënyrë interesante për të gjithë llojet e lexuesve, eksplicitë dhe implicitë. Bartthes-i tek artikulli i tij për teorinë e tekstit, kupton qartë nocionin e intertekstualitetit. Paraqitja që ai iu bën analizave të J. Kristevës, është plotësisht ndriçuese për të gjithë. Kristeva përmes semiotikës së saj lejon të kapet zanafilla e nocionit të intertekstualitetit në mjedisin e tij teorik zanafillor. *"Në qoftë se një*

[10]E. Gjika, *Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit*. Naim, Tiranë, 2010, fq.43-44.

[11] E. Buyssens, *Langages et discours*, f. 11.

[12] R. Barthes, *Writing degree zero*, First published in Tel Quel 47, fall 1971, reprinted in Polylogue, pg. 23-54.

"tekst" shpërfaqet si i tillë vetëm në ato raste kur arrin t'i fshehë vështrimit të parë a lexuesit të parë, ligjësitë e ndërtimit apo rregullat e lojës, leximi fiton një fizionomi më të vetësishme, pra shfaq një "praktikë shenjuese", vetëm në ato raste kur lexuesi arrin të bëhet pjesë e njëmendtë e asaj të fshehte që teksti mbart në vetvete".[13] Ndaj në këtë punim zbulojmë veçantinë e lirikës së Lasgush Poradecit, suksesin poetik mes lexuesve. Në ndihmë të kësaj përgjigjeje na vjen kapitulli Poetika. Përmes tij evidentojmë marrëdheniet e qenësishme që poeti krijon mes fantazisë artistike dhe vizionit të botës që e rrethon. Depërtojmë në ato "kthina" të "kullës" krijuese, ku ekziston një botëkuptim i tërë vetëdijesh, nënvetëdijesh dhe ndërgjegjësimesh shkrimore. *"Përcaktimi i specifikave të teksteve bëhet duke i vënë ato brenda tekstit të përgjithshëm. Ideologema është teksti i ndërthurur funksional, që lexohet si materializim në struktura të ndryshme, të çdo teksti tjetër, i cili përhapet në gjatësinë e trajektores"*.[14]

Në këtë kontekst Jauss-i, shkruan: *"Arti dhe lëtërsia nuk mund të pretendojnë një histori të pavarur, por bëhen historike në atë masë sa marrin pjesë në procesin e përgjithshëm të praksës historike[...] Vepra letrare është si një partiturë, e krijuar për një rezonancë përherë të re të lexuesit"*.[15] Brenda kësaj mëdysheje termi plagjaturë kalon në shumë dimensione diskutimi. Afër dhe larg poezive të Emineskut, liriku pogradecar rikrijon me stil artistik lirika dhe variante të tyre.

Çdo vepër letrare është një raport i rivendosur mes shkrimtarit, tekstit dhe lexuesit. Të gjitha këto "dimensione" të sendërtimit letrar gjenden në vepër, të përfaqësuara pak a shumë dhe të lidhura ndërsjelltasi. Duke parë ndërrimin e metodave dhe të aspekteve të çfarëdollojshme në kritikën letrare dhe perspektivën e saj, vërejmë se brenda njëqind vjetëve të fundit, studimi modern i letërsisë ka kaluar nëpër tri faza të para elementare.

a. Pozitivizmi, i cili merr për objekt kryesor të studimit të letërsisë, krijuesin. / b. Teksti i ndarë, pa futur aty autorin. / c. Interesimi i studiuesve, larg nga receptuesi.

"Interpretimi nga krijuesi është i domosdoshëm për kritikën biografike, psikologjike e deri për atë të sociologjisë. Apologjistët e studimit të tekstit të veçuar vështrojnë kërkimet e pararendësve të tyre si afrim së jashtmi, mjaft të përciptë të veprës letrare. Në sistemin e shenjave gjuhësore e kanë përqendruar vëmendjen së pari, formalistët rusë dhe kritika e re anglo-amerikane, pastaj më tej edhe metoda fenomenologjike, strukturalizmi dhe semiologjia".[16] Në këtë sens punimi merr trajtën pozitiviste të ndërtimit. Ndan tekstin e interpretuar rreth autorit dhe kritika e specializuar udhëheq mendimin e lexuesit të thjeshtë.

Intertekstualiteti lasgushian është një qasje më vete në punimin tonë. Leximi bëhet temë mbisunduese e epikës. Lexuesi bëhet pjesëmarrës aktiv i procesit krijues dhe shkrimtari shpreson gjithnjë e më shumë tek kjo gjë, duke nënkuptuar gjithherë udhëzime për *"lexim të drejtë"*.

Ne jemi dëshmitarë të një serie të tërë realizimesh, në të cilat protagonisti kryesor i tërhequr në qetësinë e dhomës së leximit, ballafaqohet me botën fiktive, e cila shpeshherë shfaqet ndryshe nga e përditshmja jonë. Sipas të gjitha mënyrave ky mijëvjeçar i sapo filluar na afron përsëri me situatën fillestare. Ai që shkruan dhe ai që

---

[13] J. Kristeva, *Desire in language. A semiotic Approach to Literature and Art*, Columbia University Press, 1980, pg. 92.

[14] Po aty, pg.36.

[15] H. Robert Jauss, *Esperienza estetica ed ermeneutica letteraria, volume II*, "Il Mulino", Bologna, 1998, pg. 128.

[16] R. Wellek, A. Woren, *Teoria e Letërsisë*, Shtëpia botuese "Enciklopedike", Tiranë, 1993, fq. 65; 67; 73.

e percepton këtë të shkruar, do të "ndeshen" vetiu, faqe me faqe, sy me sy, në detin e dashurisë që do t'i bashkojë, -siç thoshte Borhesi në një ese kohë më parë : *"Në fund, pas të gjithave, mbeten vetëm lexuesi dhe unë derisa Fjala ime provon të inkarnohet në të, e ai përpiqet të inkarnohet në Fjalën"*.[17]

Teoria e intertekstualitetit e nxjerr jashtë funksioni ndikimin letrar nga shkenca tradicionale pozitiviste apo e thënë më saktë kjo, e ripërkufizon atë. Johan Wolvang Gëte është ndër të parët që shfaqi dyshimet e veta ndaj intertekstualitetit absolut të shkrimatërve. Sikur të mundja të tregoja se çfarë u detyroj pararendësve të mëdhenj: grekëve antikë, Shekspirit, Pokëlenit (Molierit), Volterit, nuk do të më mbetej shumë kohë, -pohonte Gëtë gjatë bisedave të tij me Ekermanin.

Ndërkaq Lasgush Poradeci në letërkëmbimin e tij me Mitrush Kutelin në vitet '30 shkruan: *"Artisti i vërtetë s'pyet, QË Ku e nxjerr lëndën brute të krijimeve të tija; ay pyet: A ka realizuar, prej kësaj lënde brute, një vepër Origjinale, Të re, Të fuqishme, Plot Ekspresivitet vetjak? Imitim -relevojnë eruditët! ; krijim i ri –relevon poeti! Krijimi i ri, prej lëndës së vjetër[...] Asnjë, nga të gjithë veprat artistike me jetë të përbotshme s'është origjinale, trupi i tyre është i huaj, vëtem shpirtin s'ua disputon dot njeri"*.[18] Krijimi i ri prej lëndës së vjetër apo përdorimi i gurëve të vjetër, krahas gurëve të rinj nga mjeshtëri ndërtues në një mur të ndërtuar enkas, kjo është deviza artistike e Lasgush Poradecit, vepra letrare e të cilit mbetet një dialog i përhershëm me artin oral, saktësisht me poezinë e Naimit, Vedat, idete filozofike të Sokratit, me poezinë e Emineskut apo poetëve ballkanas dhe europianë.

Poemat e mëvona të Poradecit si *"Kamadeva"* apo *"Ekskursioni teologjik i Sokratit"*, janë modele të teksteve poetike të krijuara mbi ekzistencën e një lënde te vjetër, një praktikë e njohur kjo për të gjitha veprat artistike me jetëgjatësi të përbotshme. Shekspiri i mori subjektet e tragjedive të tij nga biografitë e Plutarkut, tragjeditë antike etj.

Nuk ka tekst pa intertekst. Intertekstualiteti paraqet komunikimin aktiv së paku të dy teksteve, letrare dhe jo letrare, ndërsa në përgjithësi ai realizon komunikimin e një vepre letrare me një tekst tjetër. Vepra letrare hyn në dialog me vepra të tjera, por edhe me kontekstin me të cilin lexohet dhe vlerësohet ajo në kohëra. Prej vitesh studiuesit Jorgo Bulo dhe Ali Xhiku kanë bërë përpjekje, që fjalën intertekstualitet ta shqipërojnë me ndërtekstualitet apo ndërtekstorësi.

"Ndihet nevoja e lexuesit për të depërtuar në botën e krijimtarisë së poetit dhe për t'u bërë eksplorator në atë botë. Për dallim nga kritika ekspresioniste e cila tekstet letrare i pranon si pretekste për përsiatje dhe për dallim nga kërkesa që lexuesi të futet në shpirtin e shkrimtarit, deri në identifikim me të, teoria e recepcionit përpiqet që rolin e lexonjësit, në procesin letrar, ta peshojë dhe ta justifikojë më së miri. Pikëtakimi tresh i mirënjohur autor - vepër - lexues bën që ky i fundit të mos jetë vetëm vështrues pasiv, vetëm zinxhir reagimesh, porse është edhe personalisht energjia e cila krijon historinë".[19]

Intertekstualitet ka edhe te vepra e Ecos. Në tekstin shpjegues për romanin *"Emri i trëndafilit"* me të cilin ka pajisur ribotimin e romanit Eco thekson se skenën e aktit seksual në kuzhinën e Abacisë e ka ndërtuar me citime nga tekste fetare, duke nisur nga *"Kënga e Këngëve"* e deri te Shën Bernardi e Zhan dë Fekampi. Ai me anë të teksteve të tilla përngjason përndezjen mistike me përndezjen erotike dashurore.

---

[17] H. Robert Jauss, *Esperienza estetica ed ermeneutica letteraria, volume I*, "Il Mulino", Bologna, 1987, pg. 161.

[18] L. Poradeci, *Poezi et coetera..., Vepra 2*, "Onufri", Tiranë 1999, f. 13.

[19] H. Robert Jauss, *Esperienza estetica ed ermeneutica letteraria, volume I*, "Il Mulino", Bologna, 1987, pg. 121.

Vendçelës i studimit të Fishit rimerret në këtë punim. *"Letërsia ndër lexues*: *stilistika efektive"*, motivon këtë koncept për lexuesin. Subjekti i idealizuar duhet patjetër t'i plotësojë disa kritere, e para së gjithash, mbizotërimin e së ashtuquajturës *"dukuri semantike",* që i nevojitet lexuesit *"të përgjegjshëm"*, që ta kuptojë logjikën (bazë të tekstit).

Estetika e recepsionit përpiqet, që proceset receptive t'i përshkruajë duke u nisur nga teksti dhe pikërisht, në atë mënyrë, saqë e analizon "horizontin e pritjeve", i cili është paraqitur falë përvojës së arritur në tekstet e tjera.

Dekada e fundit të shekullit XX ka treguar se është botuar një numër i madh punimesh shkencore, të cilat tematizojnë aktin e leximit. Rryma është bërë dominante në aspektin e teorisë së letërsisë, ndaj tashmë përdoret përherë e më tepër termi *"teoria e leximit"*. Në vitin 1980-1981 janë botuar në Amerikë dy përmbledhje punimesh, perspektiva letrare e të cilave është quajtur *Reader-Response-Criticism*. Teoria e përgjigjes së lexuesit, e reagimit të tij, është një botëkuptim shumë më i ngushtë se vetë teoria e leximit. Studiuesit e këtyre çështjeve shkencore pohojnë se lexuesit flakin përfytyrimin mbi leximin, me tekstin korrekt dhe marrin parasysh liritë më të vogla ose më të mëdha të interpretimit të tekstit. Kjo vërehet në punim në kritikën e shkruar për veprën letrare të L. Poradecit.

Hermeneutika vjen nga greqishtja e vjetër, që do të thotë, të shpjegosh, të interpretosh, të kuptosh. Etimologjinë e kësaj fjale e lidhnin me Hermesin, që ishte ndërmjetës komunikimi mes njerëzve dhe hyjnive. Ai interpretonte dhe shpjegonte tekstin, të cilin ua komunikonte njerëzve në emër të perëndive të Olimpit. Në mitologjinë romake rolin e Hermesit e luante Mërkuri. Hermeneutika zbulon se një vepër artistike nuk mund të jetë absolutisht e barabartë me veten e saj. Ajo ndryshon, sepse hyn në bashkëveprim me lexuesit, që mund të jenë të epokave të ndryshme sikurse vepra e Lasgush Poradecit...

Është e qartë se *Reader-Response-Criticism* nuk është kurrfarë orientimi koherent teorik. Ndërkaq, nëse nisemi nga teza se para leximit ekziston teksti i lexuar në sallë e që vetëm realizimi i tij, në vetëdijen e lexuesit, prodhon efekt artistik, atëherë është e qartë se leximi është së pari, proces mendor i cili endet në kokën e lexuesit, me rastin e ballafaqimit të tij me tekstin. Ne leximit, i afrohemi si akt individual i brendshëm, në dallim nga teoritë e ndryshme, për të cilat leximi i tyre paraqet proces kolektiv dhe fenomen shoqëror. Po ashtu vërejmë që brenda trajtimit retorik dhe hermeneutik nuk arrijmë te përsiatjet kompetente për lirinë e lexuesit. Një tekst i tillë do të jetë përvojë metamorfoze për lexuesin e vet. Lasgush Poradeci e arrin këtë komunikim më së miri me lexuesin e tij koherent.

Roman Ingarden bën një tentativë unike për t'u konstatuar modeli i leximit të teksteve letrare, në të cilat njëkohësisht me shkallën më të lartë të objektivitetit prezanton faktorët individualë e psikologjikë të lexuesve. Për atë lexuesit nuk janë asgjë tjetër përveçse konsumues të thjeshtë, por edhe pjesëmarrës në krijimin e veprës letrare artistike.

"Emri i trëndafilit" i U. Ekos[20], njëra nga veprat më të rëndësishme të postmodernizmit, shfaq, në rolin e protagonistit, jo vetëm lexuesin, por edhe objektin e aktivitetit receptiv. Ai *(shkrimtari)*, do t'i zbulojë lexuesit atë që ky duhet të dojë edhe nëse vetë ky s'e di. Ai do t'i zbulojë lexuesit vetveten. Lasgushi e realizon bashkëbisedimin kritik dhe jo kritik me lexuesit e tij. Kuptimi poetik i veprës letrare funksionon plotësisht i zbërthyer ndër ta.

[20] U. Eko, *Emri i trëndaflit*, Botimet Elena Gjika, Tiranë, 1996, fq. 545-546.

Që prej mesit të viteve gjashtëdhjetë të shekullit XX, Eco në studimin e tij *"Vepra e hapur"*, në kuptimin semiotik, shfaqte interes për statusin e lexuesit brenda procesit të komunikimit letrar. Ndërsa vepra është në ripunim e sipër, bashkëbisedimi me të është i dyfishtë. Është një dialog në mes këtij teksti dhe gjithë teksteve të tjerë të shkruar më parë (se librat bëhen vetëm të bazuar mbi librat e tjerë e rreth librave të tjerë). Është bashkëbisedim mes autorit dhe lexuesit të tij model.

"Në librin "Roli i lexuesit", autori i përmbahet teorisë së komunikimit, si një pikënisje për procesin e leximit. Ai vëren se çdo porosi mbetet e pakuptueshme, nëse ndërmjet dërguesit dhe marrësit nuk ekziston kodi sipas marrëveshjes së arritur më parë. Lexuesi është i definuar rigorozisht me organizimin leksik dhe sintaktik të tekstit: teksti s'është asgjë tjetër, pos produksion semantiko-programatik i model-lexuesit të tij vetjak. Edhe *Manxoni nuk shkruante që t'i pëlqente publikut ashtu siç ishte ky, por që të krijonte një publik të cilit romani i tij nuk kishte si të mos i pëlqente. Dhe i mjeri ai ku të futej sikur të mos e pëlqenin, e shihni dhe vetë me sa hipokrizi e qetësi flet për njëzet e pesë lexuesit e vet. Njëzet e pesë milionë do".*[21] Eco i afrohet konceptit të Rifaterit për arkilexuesin si numër leximesh. Në dualitetin model-lexues *(arkilexues)* gjenden Barti dhe Izeri. Lasgushi tashmë ka krijaur lexuesin e "detyruar", në sistemin parauniversitar dhe universitar. (Kapitulli i dhjetë).

Hstoria e recepimit dhe *Eestetika e receptimit*[22] ekzistojnë në veprën e L. Poradecit dhe jo vetëm. Jauss, në ligjëratën hyrëse mbajtur në Universitetin e Kostancës, e botuar me titullin *"Historia e Letërsisë, sfida e Teorisë së Letërsisë",* kapërcen antagonizmin marksizëm/ strukturalizëm. Ai ngulit në fushën e historisë së letërsisë, konceptet filozofike të Husserl-it, Gadamer-it, W. Benjaminit.

Si pikënisje, e gjitha kjo mori termin receptim. Thelbi i tij i të kuptuarit është një veprimtari, një përpjekje e vetë receptuesit (marrësit), i cili si subjekt pasiv, luan rolin kryesor në vijimësinë e komunikimt. Një teksti i jep kuptim vetëm receptuesi i tij, ai që në një farë mënyre e bën atë të ekzistojë.

Horizonti pritës është koncept thelbësor i teorive receptive. Horizonti i pritjes ndërhyn ndaj një niveli të dyfishtë. I pari është niveli i veprës letrare, që kuptohet si tërësia e tipareve që e bëjnë atë të lexueshme. Këto tipare duhet t'i zbulojë vetë lexuesi. Niveli i dytë është ai i publikut, që duhet kuptuar si tërësi kriteresh pak a shumë normative, të përvetësuara nga lexuesit e që parashihen prej tyre të gjenden në një vepër të re. Është e qartë se dy horizontet pritëse shumë rrallë mund të përputhen. Në këtë moment ndërhyn një nocion i tretë çelës, ai i shkrirjes së horizonteve, i huazuar nga Gadamer-i.

Shtohet pyetja: A është në koherencë ligjërimi poetik i Lasgushit me horizontin pritës?

"Disa nga poezitë e autorit, sidomos ato ku përqëndrohen idetë e konceptet filozofike, jo vetëm për receptuesin masiv, por edhe për një pjesë të kritikës, rezultojnë të parakohëshme. E shpjegueshme kjo po të kemi parasysh se publiku shqiptar deri në atë kohë kishte qenë në kontakt me një letërsi shqipe receptimi i së cilës, më së shumti, nuk kërkonte ndonjë shqisë të hollë estetike. Ka përfaqësues që me gjithë zellin për ta receptuar sa më thellë veprën e Lasgushit, me gjithë vlerësimin maksimal, që i japin atij, nuk mund të shkojnë dot në rrokjen totale të tekstit. Për ta në shumë raste ai mbetet "i errët", "i pakuptueshëm"".[23]

E. Çabej pohon se ligjërimi lasgushian vjen në kohën e duhur. *"Çabej projekton në kohë receptimin e vërtetë të Lasgushit, madje jo vetëm për lexuesin shqiptar, por edhe*

[21] Po aty, fq. 547.
[22] Y. Chevrel, *Letërsia e Krahasuar*, Shtëpia botuese "Albin", 2012, fq. 66-67.
[23] E. Gjika, *Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit.* Naim, Tiranë, 2010, fq.50-51.

për atë europian. Në rastin e letërsisë, jo rrallë projektim i i vlerave në të ardhmen, është vërtetim i vlerave në të tashmen".[24]

Jauss për horizontin pritës sqaron se *"...karakteri artistik i një vepre... në horizontin e shfaqjes së tij të parë në asnjë mënyrë nuk mund të jetë i vëzhgueshëm menjëherë. Distanca mes receptimit të tij të parë real dhe domethënies virtuale, apo me fjalë të tjera, rezistencës që vepra e re i kundërvendos pritjes së publikut të saj të parë, mund të jetë aq e madhe sa ta ketë të domosdoshëm një proces të gjatë receptimi, për të zhdëmtuar atë që ishte e papritur dhe e pashfrytëzueshme në horizontin primitiv".*[25]

Duket qartë se Lasgushi me vetëdije të plotë ka synuar *lëvizjen e horizontit të pritjes*, fenomen që teorikisht i përket krijuesve cilësorë.[26]

"...nën prizmin e estetikës së receptimit poezia e Lasgush Poradecit shfaqet dikotomike: njëra pjesë nuk mëton ndryshimin e horizontit të pritjes, por kënaq pritjen që është e përcaktuar nga shija dominante, ndërsa pjesa tjetër thyen rrënjësisht horizontin e zakonshëm të pritjes letrare; fillimisht ka një publik pothuajse mungesor dhe pak nga pak nis e krijon një publik të vetin".[27]

Estetika e receptimit është e pandashme prej prespektivës fenomenologjike, në të cilën theksohet objekti artisitk dhe aftësitë e tij për të prodhuar kënaqësi estetike. Kritiku duhet të kërkojë se ç'përgjigje përfaqësonte vepra dhe cilës çështje i është përgjigjur ajo. Historia e receptimit fut në punë kohëzgjatjen dhe e vë theksin mbi receptuesit e vendin e tyre në sistemin kulturor, nëpërmjet të cilit ata takojnë veprën. Evidentime të tilla shoqërojnë veprën letrare të L. Poradecit. Marrëdhënia autor-lexues gjithashtu. Madje edhe horizonti pritës nuk mungon brenda saj, ndonjëherë edhe bashkimi i tyre.

Receptimi / ndikimi[28]

Formula "X dhe Y", sipas rastit merr versione të tilla si: autori, Lasgush/ veprat X, *"Vallja e yjve"* dhe *"Ylli i zemrës"* në vendin Y, *(Pogradec)*".

(Studimi i ndikimit), ose "receptuesi X përballë veprës / veprave Y, *"Vallja e yjve"*; "*Ylli i zemrës" (studimi i receptimit)*. Një vend më vete zë mes tyre metodologjia e studimeve të receptimit dhe prespektivat e tyre në ardhmëri. Studimi i receptimit kapet pas të dhënave të sakta të njohjes së veprës së X-it apo Y-ilonit *(artikuj kritikë, libra, revista periodike, përkthime..., për L. Poradecin)*.

Përpjekja për të përcaktuar vendin që zë X autor në parapëlqimet e publikut vendas, studimet e receptimit dhe studimet e ndikimit plotësojnë njëri-tjetrin në këtë fushë. Të dytët kanë nevojë për të parat dhe anasjelltas.

Prespektiva e studimeve të receptimit është padiskutueshme për veprën letrare të Lasgush Poradecit[29] Studimet e këtij lloji, që sot po njohin një zhvillim të madh, i japin rëndësi të dorës së parë nocionit të sistemit letrar. Takimi me veprën letrare na lejon të zbulojmë më mirë vlerat (ndonjëherë të pavetëdijshme, kaq shumë të përthithura) që qëndrojnë në themel të referencave të një shoqërie në një kohë të dhënë. Pasojat duhet të shihen qartë. Ka një prirje që (disa e quajnë të rrezikshme, në mos të dënueshme), e cila na shpie tek një sociologji e letërsisë, e kuptuar si histori e leximeve të veprave, që lë pas dore vetë veprat. Ky rrezik shfaqet në qoftë se mendohet se studimet e receptimit janë e vetmja metodë e mundshme. Në të vërtetë këto studime nuk mund të jenë tjetër, veçse një qasje e pjesshme. Ndërkaq një

[24] Po aty, f. 51.
[25] H. R. Jauss. *Perche la storia della letteratura?,* Guida editori, Napoli 2001, f. 62-63.
[26] Po aty, f. 51.
[27] E. Gjika. *Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit.* Naim, Tiranë, 2010, fq.52.
[28] Y. Chevrel, *Letërsia e Krahasuar,* Shtëpia botuese "Albin", 2012, fq. 67-71.
[29] Po aty, fq. 70-71.

ndërmarrje si ajo e A. Hauser-it *"Historia sociale në art e letërsi"*, që shkon tej çështjeve të receptimit duke njohur rolin e mjedisit kulturor, na ofron vështrime origjinale dhe të dobishme. Gjithashtu duhet vëne re se studimet e receptimit, na lejojnë të rishfaqet një histori e mundshme e personaliteteve krijuese, të cilën, sikurse edhe u theksua në shqyrtimet krahasuaese synonin ta vlerësonin më pak në krahasim me historinë e veprave. Receptimi i Shakespeare-it, Çehovit, Goethes nuk janë thjesht shuma e receptimeve të veprave të autorëve të veçantë, ato janë gjitahshtu edhe reagime ndaj personaliteteve, që vetë veprat letrare ndriçojnë më së miri.
Ndër zhvillimet e mundshme të studimeve të receptimit, duhen dalluar studimet e receptimit të krahasuar. Shqyrtimi i pritjes së të njëjtës vepër në të paktën dy hapësira kulturore të ndryshme (Lasgushi i përbotshëm).
Ky ballafaqim lejon jo vetëm përqasjen e dy sistemeve letrare të ndryshme, por edhe përcaktimin e pikave kontrastuese të sqarimit të tekstit, të cilat u japin vlerë mundësive të leximit, që përmban vetë vepra letrare. Në këtë pikë termi "ndërmjetës", përfshin këtu gjithçka që kushtëzon dukuritë e kalimit nga një sistem kulturor në tjetrin, që ka të bëjë me mbështetjet materiale ose me veprimtarinë e individit.
Volfgang Izeri, në veprën e tij *"Akti i leximit"*, niset nga teza se relacioni tekst-lexues, nuk është njëdrejtimësh porse ndërmjet këtyre dy elementeve të komunikimit letrar, dominon raporti i interaksionit. Botëkuptimi i zërit të *"lexuesit implicit"*, zgjerohet në këtë punim dhe përfaqëson *"strukturën e lexuesit, të shënuar prej tekstit"*.
Psikoanalisti amerikan Norman Holland, teorinë e tij të leximit e ka eksploruar në vija kryesore në studimin *"Dinamika e reagimit letrar"*. Për t'i zbuluar reagimet individuale-psikologjike të lexuesve, ai përvetëson psikoanalizën, pikënisja e së cilës mbarështrohet në pikëpamjet subjektive. Ai konsideron se literatura thith fuqinë nga rrënjët më të thella nga përvoja më individuale, ndërsa kënaqësia që na ofron rrjedh nga dëshirat dhe druajtjet burimore me një domethënie të ndërvarur. Çdo lexues reagon ndaj artit në të njëjtën mënyrë sikurse edhe ndaj secilës përvojë jetësore. Ai veprën letrare e lë të depërtojë nëpër sistemin e tij karakteristik të mbrojtjes duke projektuar në tekst botën personale të fantazisë. Modeli i reagimit letrar që ndërton Hollandi, bazohet në të kuptuarit e tekstit si tërësi fjalësh, të cilit kuptimin jetës dhe domethënien ia jep publiku deri në atë masë, saqë, në fund, "absorbohet" nga ana e tekstit.
Në esencë duke u marrë me tregimin e Po-së *"Letra e vjedhur"*, me nëntitullin *"Leximi si një transaksion personal"*, thuhet teksti nuk është tërësi e pandryshueshme, veçse një proces, në të cilin merr pjesë aktive edhe lexuesi. Te çdo lexim, tekstit të fiksuar në letër lexuesi ia bashkangjit një sërë faktesh ekstratekstuale, joletrare. Me ndihmën e nocioneve psikoanalitike, sikundër janë identiteti, imagjinata ose mbrojtja, jemi në gjendje që, reagimin letrar, ta lidhim me personalitetin e leximit. Teoria transaktive e reagimit, na ndihmon që t'i vëmë në lidhje *"lloj-llojshmërinë e pasur të përvojës letrare me pasurinë e pamatshme të qenieve njerëzore"*. Më vonë Hollandi e zgjeron teorinë e tij të leximit, me konceptin "temat e identitetit", me të cilin nënkuptohet se çdo njeri ka strukturën e caktuar mendore, e cila rregullon të gjitha format e sjelljes së tij, e kështu edhe të kuptuarit dhe të interpretuarit e veprave letrare.
Fantazia nuk ekziston në mënyrë latente, në të ndodhet vetëm materiali, nga i cili, secili lexues do të krijojë vetë trillin e tij, që nuk është e thënë se kondicionon me trillin e shkrimtarit. Veprat nuk kanë fantazi, ato i kanë njerëzit. Fantazitë gjenden te lexuesi, më saktësisht në raportin kreativ mes lexuesit dhe veprës (Kapitulli i njëmbëdhjetë i punimit tonë-Një receptim ndryshe i poezive).

Në librin e Hollandit *"Leximi i pesë lexuesve"*, thuhet: Psikika e lexuesit shfrytëzon, përshtat dhe rregullon çdo gjë, që e merr nga tregimi, e që asaj mund t'i sjellë kënaqësi", pra, çdo akt leximi është konstruktiv.
Blliç është protagonisti kryesor i pozicionit subjektiv radikal. Në studimin me titull *"Kritika subjektive"* Blliçi parashtron teorinë e tij, sipas së cilës, vepra letrare është prirur gjithmonë nga vështruesi i saj dhe se ajo, gjatë aktit perceptiv bëhet refleks i vetë lexuesit.
Duke shtjelluar parimin e subjektivizmit në teorinë e leximit Blliç sqaron edhe qëndrimet e Rozeblatit, Hollandit dhe të Fishit, me të cilat është kryesisht në të njëjtat gjatësi valësh. Për Blliçin çdo lexim i tekstit është vepër tjetër. Vepra, shprehet ai madje nuk ekziston, nëse nuk lexohet nga askush. Si kundërpeshë e këtij qëndrimi marrim pikëpamjen e fenomenologëve, se vepra letrare ekziston pavarësisht nga shfaqja e saj fizike, e kështu edhe nga perceptimi i saj. Për çdo rast Blliç personifikon pikën e fundit, deri tek e cila është arritur gjatë zhvendosjes së pozicionit nga pika objektive përkrah subjektives. Rruga mesatare ndërmjet shtrëngesës dhe anarkisë, gjendet me pranimin e lexuesit ideal, kompetent. Ky do të ishte ai lexues që ka mjaft përvojë jetësore dhe letrare dhe nga i cili pritet ta demonstrojë ndjeshmërinë e zhvilluar sa duhet ose shijen.
Është një pajtueshmëri e përgjithshme në qëndrimin mbi nevojën e marrjes në konsideratë e lexuesit, si një faktor të barabartë dhe vendimtar në jetën e veprës letrare. Mendimet e tilla i gjejmë edhe në hulumtime të tjera që shtjellojnë çështjen e lirisë së leximit te Teri Igllton *"Kryengritja e lexuesit";* Mishel Sharl *"Retorika e leximit*" dhe Pol Riker *"Koha e tregimit"*.
Është interesant edhe mendimi që shpreh Hillias Milleri në studimin *"Etika e leximit"*, duke u përpjekur të vërë në pah domosdoshmërinë e ekzistencës të momentit etik dhe të përgjegjësisë në aktin e leximit.
Teoricienët kërkojnë që lexuesi të kapë në një tekst logjikën, të cilën e ka sjellë në vepër shkrimtari. Lexuesi ka liri, që ta gjejë kuptimin e saj në një tekst. Liria e lexuesit varet nga mënyra e të rrëfyerit që ka zgjedhur shkrimtari në veprën e tij letrare. Kështu, bie fjala, për Sartrin publiku, nënkuptohet me shkrimtarin dhe vepra rrjedh në mënyrë logjike nga përzgjedhja e materialit dhe e formulimeve stilistike të saj.
Postmodernizmi është era e preokupimit epistemiologjik, saktësisht funksionimi i tij si teori dhe metodë, për kërkime të mëtejshmë shkencore. Gnoseologjizmi e përball lexuesin me të vërtetën estetike.
"Nëse nuk kam objekt në dashuri nuk ekzistoj".[30] *"Narcisizi është Tjetri. Për Frojdin, narcisizi, është Gruaja"*.[31] Kjo lloj dashurie erotike gjendet te lirika e L. Poradecit dhe perjetohet si ekzistencë e fshehur. *"Në dashurinë e parë objekti gjithmonë e fsheh veten e tij, duke dalë jashtë krijimit dhe duke mbetur anonim"*.[32] Lexuesi modern është më i lirë në interpretim se sa u dukej strukturalistëve, në mes tjerash edhe për shkak të evolucionit të shkrimit artistik që ka ndodhur në vepër.
Tek *"Emri i trëndafilit"* të Ecos, rolin e objektit vdekjeprurës të gjykimit e merr libri.
Thuhet se qasja më e mirë e veprës është ajo që do t'i bashkonte të gjitha metodat e njohura. Në praktikën e interpretimeve, mbase është punë më e thjeshtë t'ju shmangemi anshmërive të metodave të sprovuara dhe ta kërkojmë rrugën personale tek suksesi gjatë gjithë jetës, si filozofi e të nxënit. Kjo qasje metodash të njohura

[30] *The Kristeva reader*, Blackwell Publishers, "Oxford", UK, 2002, p. 154.
[31] Po aty, p. 240.
[32] Po aty, p. 153.

është realizuar në punimin tonë përmes trembëdhjetë kapitujve të parashtruar rreth veprës letrare të Lasgush Poradecit.

II.1. Metodologjia e përdorur në punim

Për realizimin e disertacionit, vend të veçantë ka patur metodologjia e përdorur si bazament i sigurtë dhe orientim i qartë në fazat e konceptualizimit dhe punës empirike të çështjeve të mirëtrajtuara. Zgjedhja e temës u realizua duke marrë në konsideratë premisat e procesit për vlerësimin e veprës së Lasgush Poradecit dhe shqyrtimin e gjykimit kritik rreth saj.

Të gjithë e dinë tashmë që Lasgushi nuk e pranoi tendencën e hapur, por pranoi atë implicite. Poradeci nuk shkroi sipas recetave e formulave klishe, të programuara e angazhuara, por ai krijoi me një intuitë, ndaj edhe sot e kësaj dite vepra letrare e tij gëzon një receptim të gjerë. Poeti krijoi me të njëjtën mjeshtëri artistike poezinë me motiv patriotik, poezinë inividualiste dhe atë subjektive. Nga krijimtaria e tij poetike burojnë idetë, pikëpamjet, psikologjia, filozofia, botëkuptimi për njeriun, vdekjen, dashurinë, erotizmin, dukuri të cilat ai nuk i trajton në mënyrë të cekët, por me një poetikë të thellë, saqë strukturimi i tyre artistik të zgjon asosacione të ndryshme filozofike. Gjithashtu zgjedhja u orientua nga receptimi kritik i cili deri më sot ka hetuar probleme apo çështje të ndryshme të veprës së Lasgush Poradecit.

Ky eksplicisëm sikurse do shihet në kapitujt përkatës të punimit ka bërë interpretime gnoseologjike dhe qasje estetike. Ato kanë qenë afri të jashtme dhe të brendshme. Në këtë kuadër, vëmendja u përqëndrua tek lexuesi eksplicit dhe ai implicit i veprës letrare lasgushiane.

Në argumentimin tonë se kjo është një zgjedhje e përshtatshme, e justifikueshme dhe e mirë, morëm në konsoderatë interesin publik, atë arsimor dhe integrues, me të cilin lidhet tema e punimit, ekzistencën e punimeve të mëparshme, nga studiues e kërkues të fushës, monografi, artikuj e shkrime.

Punimet e pakta mbi këtë temë apo aspekte të veçanta të saj, kishin vlerën dhe rëndësinë e tyre si burime reference. Në to konstatohet se si studiuesit e tjerë e kishin bërë objekt studimi krijimtarinë lasgushiane, si kishin proceduar ata metodologjikisht për të përpunuar konceptet, variablat, qofshin të pavarur, të varur, ndërmjetës etj.

Në këtë punim u përftuan disa nga burimet e informacionit të përdorur si dhe mënyra e analizës cilësore. Në të njëjtën kohë ato na krijuan mundësinë e konstatimit të *"zonave gri"*, që kishin nevojë për shpjegim apo intrepretim të mëtejshëm të veprës letrare . Në këtë perspektivë u çel një zonë e mirë kërkimi për shkak të veçorive të problematikës receptive në kapituj të ndryshëm.

Ekzistenca e burimeve të mundshme të informacionit është vjelë në terrenin shqiptar dhe atë të huaj. Në aspektin e brendshëm kemi mjaft informacion cilësor e statistik për të studiuar më pas çështjen e receptimit në botë. Studimi i fenomenit receptiv në terren duke përdorur pyetësorin, zgjeron burimet e informacionit tonë në këtë qasje.

II.2. Objektivat e punimit

Duke pasur parasysh karakterin e punimit, vëmendja jonë u përqëndrua në realizimin e këtyre objektivave:

-"Receptimit" dhe formulimi i një kuadri referencial, i cili shërben si kuadër konceptual dhe në të njëjtën kohë edhe si kuadër teorik për të bazuar punën e analizës.

-Kryerjen e një analize të dhënash bazuar tek informacioni cilësor dhe statistik duke kombinuar metodat e analizës statistike dhe asaj cilësore në vite.

-Paraqitjen e një sërë përfundimesh në punim duke dhënë shpjegime përsa i takon çështjeve të bëra objekt studimi.
-Kryerjen e një pyetësori në terren, në mjediset e hapësirës universitare dhe jo vetëm, në vend për të evidentuar perceptimet, mentalitetet apo steriotipet për shijet e lexuesit.

II.3. Recensionimi i shkrimeve dhe zgjedhja e kuadrit të referencës

Për konceptualizimin e këtij punimi doktoral u shfrytëzuan një sërë shkrimesh nga fusha e kërkimit. Në këtë proces janë klasifikuar të gjitha ato shkrime që ekzistojnë dhe në të njëjtën kohë është bërë një inventarizim i tyre. Recensionimi i shkrimeve shërben dhe si bilanc i asaj se çfarë është shkruar ndër vite për Lasgush Poradecin. Bazuar tek ky recension dhe në të njëjtën kohë tek njohjet që ofronin ato mbi fushën tonë të kërkimit, u parashtruan dhe u formuluan një sërë çështjesh për studimin e këtij fenomeni. Recensionimi na ndihmoi edhe në konturimin e përmbajtjes, të mjaft koncepteve të nevojshme që morën pjesë në punim sikurse denotacioni dhe konotacioni si pjesë përbërse për veshjen që i bëhet fjalës.
Qëllimi tek recensionimi i shkrimeve të mëparshme është përcaktimi i mirë i fushës së kërkimit, gjenerimi i pyetjeve kërkimore, evidentimi i asaj çfarë është arritur dhe çfarë mbetet për t`u arritur nëpërmjet thellimit të njohjes. Shtrirja e recensionit tonë është mbi një numër relativisht të konsiderueshëm autorësh, duke marrë në konsideratë natyrën komplekse të problematikës të fokusuar në trajtimin e tyre. Ky punim është një vrojtim i ri i fakteve letrare, një krahasim i të kuptuarit të tanishëm dhe të dikurshëm të veprës letare të Lasgushi Poradecit. Vepra letrare është shumësi metodologjike e cila bashkon estetikën gnoseologjike dhe integron në brendësi të saj historinë, gjenezën, tekstin, kontekstin, vetë krijimin.

II.4. Kërkimi në punim. Formulimi i çështjeve

Zhvillimet e vendit tonë, veçanërisht pas viteve 1990, sollën një dinamikë të re në jetën e shqiptarëve, sollën transformime të vrullshme politike, ekonomike e sociale, kërkime e standarde të reja që lidheshin me prirjen e integrimit në familjen e vendeve europiane. Ky vizion synonte lidhjen e mëtejshme të universitetit më shoqërinë dhe njëkohësisht rritjen e rolit të tij përballë kërkesave dhe nevojave të shoqërisë.
Gjatë fazës së konceptualizimit të punimit u përcaktuan edhe një grup çështjesh dhe nënçështjesh, si pyetje që orientuan kërkimin drejt gjetjes së përgjigjeve të nevojshme të kësaj përpjekjeje. Ato u formuluan në kohezion dhe mbi bazën e një logjike që kërkonte shpjegimi i fenomenit *"të receptimit"* të marrë në studim. Pjesa e analizës së të dhënave është strukturuar mbi këtë logjikë çështjesh:
Ç`duhet kuptuar me nocionin receptim i veprës letrare? Shtrimi i kësaj pyetjeje synonte qartësimin e përmbajtjes së konceptit, si dhe të një sërë nënkoncepteve të lidhura me të. Kjo çështje synon të rendisë argumentat që justifikojnë dhe bëjnë të domosdoshëm këtë lloj formimi.
Nga njëra anë shumë faktorë diktojnë nevojën e receptimit të veprës letrare, krahas formimit iniciues e të integruar dhe nga ana tjetër ka ende mjaft mangësi dhe kufizime lidhur me këto teori.[33]

[33] Gj. Pendavinji, *Metodat e kërkimit,* Shtëpia botuese "Koti", Korçë, 2010, -243f.

II.5. Hipoteza

Gjithë punimi dhe çështjet e kërkimit orientohen e burojnë nga hipoteza jonë, si një përgjigje e supozuar dhe paraprake e receptimit të veprës së Lasgush Poradecit. Receptimi i Lasgush Poradecit, si një receptim i gjerë kritik nga bashkëkohesit e tij dhe jo vetëm ata. Receptimi sintezë që mundëson raportin mes autorit në fjalë dhe publikut, që tregon se vepra e L. Poradecit është në koherencë të plotë me sistemin letrar shqiptar. Kjo hipotezë është shtylla qendrore rreth të cilit është organizuar punimi. Ajo përmban së paku dy koncepte si referentë shumë të gjerë deduksioni dhe induksionin e veprës letrare. Në të njëjtën kohë kjo hipotezë formulon edhe relacionin midis këtyre koncepteve që në thelb është një relacion modaliteti e që shpreh nevojshmërinë e çështjes së receptimit të veprës letrare.
Relacioni i hipotezës është linear dhe orienton punën kërkimore në etapat e mëtejshme të tij. Gjithashtu hipoteza na ofron dhe një kapacitet përpunues për të zgjeruar fushën e argumentimit dhe të verifikimit.

II.6. Përpilimi i një plani logjik (devizës) për punimin kërkimor

Për të shtjelluar më tej detyrat e njëpasnjëshme dhe për të përpunuar më tej platformën metodologjike të punimit u përpilua një plan logjik në të cilin vëmendja u përqëndrua në kontrollin e studimit duke evituar burimet e mundshme të gabimit. U bënë zgjedhja e kampionit, zgjedhja e metodës së mbledhjes së informacionit në terren dhe pyetësori.

II.7. Zgjedhja e metodës të analizës së të dhënave, analiza cilësore dhe ajo statistike

II.7.1. Zgjedhja e kampionit

Për organizimin e mbledhjes së informacionit nëpërmjet terrenit u realizua një pyetësor i strukturuar, i cili synonte evidentimin e perceptimeve dhe mentaliteteve të grupmoshave të ndryshme. Në rastin tonë popullsia e marrë në studim përbënte: shtresën e studentëve në universitet të përbërë prej 200 vetësh dhe një pjesë grupmoshash dhe profesionesh të ndryshme. Në pikpamjen e studimit tonë kjo shtesë konsiderohet si homogjene pavarësisht nga diferencat moshore, gjinore, përvojës, rolit në drejtim, etj. Në mënyrë krejt rastësore u përcaktua kjo shpërndarje:
Kërkesat e dërguara: 200
Kërkesat e mbledhura: 200
Totali i përgjigjeve të marra me shkrim po 200.

II.8. Zgjedhja e instrumentave për mbledhjen e informacionit në terren

Për mbledhjen e informacionit u përdorën një sërë teknikash e metodash. Veç studimit dokumentar, përzgjodhëm edhe sondazhin e strukturuar të pyetësorit të përbërë nga 22 pyetje. Një grup pyetjesh ishin ndërtuar për të bërë të matshëm një sërë konceptesh sipas shkallëve të masës të përmendura më sipër. Matjet janë kryer kryesisht mbi bazën e përqindjes së preferencës së subjekteve të kampionit të paraqitur në përgjigjet e pytësorit sistematik.[34]
Nisur nga fusha e kërkimit, nga shkalla e njohjes së fenomenit të marrë në studim, nga natyra dhe karakteri i të dhënave të mbledhura, analiza jonë u bazua tek kombinimi i metodës cilësore me atë sasiore. Analiza cilësore e fenomenit të "receptimit"

[34] Gj.Pendavinji, *Nga mbledhja tek analizat statistike e të dhënave*, Shtëpia botuese "Plejad", Tiranë, 2008, -166f.

kushtëzohej nga informacioni i bollshëm cilësor i siguruar nëpërmjet vëzhgimit dokumentar, recensionit të punimeve dhe kuadrit të referencës. Ky informacion lejoi realizimin e analizës fenomenologjike të çështjeve të receptimit. Këto të dhëna ofronin një kapacitet argumentues e shpjegues të dukurisë së ndërmarrë në studimin tonë duke qartësuar mjaft elemente ende të paevidentuara për poetin e liqerit.
Analiza jonë cilësore lidhet natyrshëm dhe shton pjesët argumentuese nëpërmjet analizës statistike. Analiza statistike që u përdor në pyetësor ishte një tjetër arritje e cila e thelloi më tej argumentimin në studimin e fenomenit në fjalë. Kjo analizë u mundësua nga karakteri i të dhënave të siguruara me anën e pyetësorit të strukturuar dhe të organizuar sipas pespektivës së një analize statistike. Rezultatet e sondazhit u paraqitën në trajtë statistikore nëpërmjet përqindjeve si dhe të përpunuara vizualisht në grafikë e skema metrike për të qartësuar analogjitë, krahasimet, korrelacionet e relacionet e faktorëve implikues në fenomenin e studiuar (Kapitulli i trembëdhjetë).
Ky punim do të jetë një histori receptimi që i shmanget njëanshmërisë metodologjike. Ai merr në shqyrtim veprën e Lasgush Poradecit me të gjitha karakteristikat e saj ideore, etike, filozofike dhe strukturale, si dhe mënyrën se si është përtypur në rrethet e lexuesve. Gjithashtu duke kërkuar në veçoritë e poetikës dhe të strukturës shpjegojmë shkaqet e ndikimit të fuqishëm që ushtron dhe vijon të ushtrojë ajo në botën e receptuesve, lexuesve, kritikëve dhe shkrimtarëve.
(Formati i pyetësorit i bashkangjitet punimit në rubrikën "Apendiks")

III. KAPITULLI I DYTË

RECEPTIM NË VITE

III.1 Leximi i Lasgush Poradecit gjatë viteve 1928-1939. Hermeneutika si përvojë leximi

Suksesi i librit, mbijetesa, fama e mëvonshme e tij, si edhe reputacioni janë kryesisht dukuri shoqërore. Vetëkuptohet se, pjesërisht, kjo dukuri i përket historisë së letërsisë, meqë fama dhe reputacioni i një shkrimtari maten me ndikimin e tij te shkrimtarët e tjerë, me aftësinë e tij për të ndryshuar traditën letrare. Pjesërisht, reputacioni është çështje e kritikës letrare. Deri tani kjo çështje është hetuar mbi bazën e opinioneve pak a shumë zyrtare, të nënkuptuara sikur përfaqësojnë qëndrimin e lexuesit të zakonshëm. Prandaj në qoftë se karuseli i shijeve është çështje shoqërore, ai duhet argunentuar mbi bazë sociologjike më të gjerë. *"Me një studim të imët mund të zbulohet sekreti i suksesit të një vepre në një kategori të caktuar lexuesish. Për këtë mund të ndihmojë grumbullimi i dëshmive për numrin e botimeve dhe kopjeve të shitura të librit"*.[35]
Në këtë drejtim le të shohim mendimin kritik të lexuesit eksplicit, por edhe opinionin e publikut të kohës, lexuesit implicit.
Lasgush Poradeci edhe pas botimeve të dy veprave poetike ka pasur horizontin e tij pritës. Lexuesi implicit e vërteton më së miri strukturimin e veprës letrare. Horizonti shoqëror i pritjes ishte në vetvete horizonti social i kohës. Gjithmonë njerëzimi ka qenë i prirur për të prekur diçka të re. E vështruar kjo në aspektin historiko-shoqëror, duhet thënë se edhe opinioni i lexuesve kishte horizontin e pritjes. Rrjedhimisht, përvoja estetike e publikut lexues ishte e gatshme të pranonte poezinë e Lasgush Poradecit. Kjo risi progresive e horizontit letrar u pranua si shije estetike.
Shkrimet e para kritike rreth veprës së Lasgushit janë artikuj sporadikë, shënime redaksionale apo individuale nga Mitrush Kuteli a nga ndonjë shok ose lexues adhurues i poezisë së tij. Këto shkrime përshëndesin ardhjen e poetit në botën e lexuesve dhe duhen marrë në konsideratë.
Krijimtaria e Lasgushit evokonte horizontin e traditës letrare të Naimit, Çajupit, Asdrenit, Emineskut... në prizmin konvencional stilistik, ndërsa bëri më tej edhe kapërcimin e traditës. Këtu vlen të përmendet një mendim i kundërt që vjen për poetin nga Stefan Shundi më 1933. Ai flet për popullaritetin e poetit, thotë se nuk është poet popullor, po antipopullor. Qëndron më afër De Radës se Naimit, më afër Eminescut se Mussetsë, ndërsa citon vargun *"Futet zemra djaloshare..."*[36]
Këtë varg ai e merr si të pakuptimtë. Thotë se zemra a shpirti nuk hynë në zemër. Si duket nuk e kuptonte nivelin poetik të gjuhës së Lasgushit, të poezisë. E këshillon poetin të shkruajë vjersha më të thjeshta, të lehta, se shqiptari nuk është i përgatitur për vjersha si të Lasgushit. Konstaton se gjëra të tilla poetin e bëjnë nervoz. E quan romantik, e impresionist. Ka harmoni të fjalëve e të tingujve, por pa mendim-ka mendim të zbrazët. Lasgushi është enigmë, i tejkaluar në krahasim me poezinë e huaj.
Gjuha e Poradecit i duket gjuhë e vrazhdë-pa muzikalitet dhe elegancë. Ai nuk e pranon tezën se është poet kombëtar, meqë simbas tij nuk është shqiptar, në bazë të pamjes, fizionomisë së tij struktura e tij fizike si thotë ai -i përngjan një rusi etj. Poeti

[35] R. Uellek, A. Uoren, *Teoria e Letërsisë*, Shtëpia botuese "Enciklopedike", Tiranë, 1993, fq. 91.
[36] S. Shundi, *Lasgush Poradeci*, në: "Minerva", -Nr. 7, 1933, f. 6-7.

është jashtë realitetit shqiptar, morboz në dashuri. I shquan vargjet për natyrën. Vargjet e Lasgush Poradecit, thotë Shundi, *"duken si jehona në tempullin e zbrazët, të duket sikur bashkohen me Heshtjen, me Zotin e Madh"*.[37]

Lasgushi thyen këto horizonte duke servirur diçka të re. Fjalori tipik lasgushian i krijimit të leksikut të ri, metrika dhe mënyra e vargëzimit bëhen pjesë e këtij tejkalimi tradicional. Kjo ngjizje brumoset gjatë qëndrimit të Lasgushit në Manastir ku sytë dhe duart e tij prekën literaturë të huaj.

Në krijimtarinë letrare të Lasgushit ka ndikuar edhe horizonti i rrethanave. Vlen të theksohen këtu artikujt e viteve '30 që sollën shkrime programatikë në frymën e letërsisë së kohës. Petrota, Shundi, Logoreci, Kokoshi, Cipo, Toto, Luarasi, Merxhani, Kruja, Bulku, Maloki etj.

Lasgush Poradeci nuk e banalizoi artin e tij dhe mbeti besnk i vlerave të vërteta artistike, nisur edhe nga tematika dhe motivet që trajtoi në poezi. Për të gjitha këto vlera të dukshme estetike, lasgushi dhe poezia e tij u pranuan nga shtresa të ndryshme lexuesish. Shkrimi më i rëndësishëm kritik i kësaj periudhe mbi veprën e Lasgush Poradecit është padyshim vështrimi i Kutelit, në fjalën e editorit. Përmes tij autori bën një paraqitje të mirfilltë kritike dhe ia arrin këtij qëllimi. Në këtë studim, Kuteli tregon peripecitë e botimit të vëllimit poetik *"Vallja e yjve"*, tregon historinë e gjatë dhe të brengosur të librit, mënyrën se si u prit ky botim nga shtypi i brendshëm. Më pas Kuteli jep një shënim të plotë bibliografik të vëllimit *"Vallja e yjve"*.

Ndërkaq, "*Ylli i zemrës"* sjell vargje të pabotuara të shkruara prej vitesh në Pogradec, Athinë dhe Bukuresht, por dhe një pjesë poezish të botuara tek *"Vallja e yjve"*. Ato janë: *"Kënga pleqërishte"; "Poradeci"; "Kroi i fshatit tonë"; "Baladë"; "Vallja e luleve"; "Ah, me atë mall që më ke ti"; "Ku shtrohet vala"; "Eja, motër"; "Vdekja jonë"; "Rri me shëndet"; "Të rritë e viteve të mi"; "Kur të më jesh e zemëruar"; "Malli"; "Që larg"; "Vallja e yjve"; "Njeriu dhe Zoti"; "Gjeniu i anijes"; "Lundra dhe flamuri", "Vdekja e Nositit"*.[38]

Përmes një padije letrare, Kuteli thotë se asnjë prej komenteve të deriatëhershme që i janë bërë veprës së Lasgushit, nuk mund të quhet kritikë shkencore. Kuteli bën analizën konkrete të poezisë, strukturës dhe vë në dukje veçoritë stilistike, ritmike dhe figurative të krijimeve të Poradecit.

Siç mund të vërejmë, autori i këtij vështrimi, përveç konstatimeve konkrete të mbështetura në vrojtimin e strukturës së vargjeve, jep edhe përfundime sintezë, të përgjithësuara për poetikën e krijimtarisë së Lasgush Poradecit.

Po aty Kuteli debaton me profesor Gaetano Petrottën rreth qëndrimit të tij mbi poezinë e Poradecit. Petrotta thotë më 1931, se në kaptinën që merret me Lasush Poradecin, ky i fundit shkel duke rënë nga një gabim në tjerin. Lasgushi sipas tij i bën vjershat me një lehtësi të jashtëzakonëshme dhe i prodhon me një nxitim të madh, gjë që e dëmton artin. Po sipas tij, Lasgushi njeh mirë gjuhën shqipe, dalëngadalë ai bën përparime në metrikën e vjershave, ka një kulturë të mirë dhe nuk i mungon talenti. *"Poezia e Lasgush Poradecit nuk lipset të gjykohet si ajo e disa poetëve të tjerë, që kanë prekur kulmin e artit të tyre, se ky ka kohë t'u qaset këtyre"*.[39]

Në vëzhgimin e vepërs poetike të Lasgushit, Kuteli kritikën e fillon me formën duke përmbledhur aty fjalorin, përfytyrimet, rimën, ritmin, fonologjinë dhe stilin. Epiteti për Lasgushin si *poet i dashurisë*, për Kutelin është i vërtetë.[40]

---

[37] Po aty, f. 6-7.

[38] M. Kuteli, *Fjala e editorit*, Në librin: *Ylli i zemrës*, Bukuresht, 1937, fq. 139-180.

[39] G. Petrotta, *Popolo, Lingua e letteratura Albanese*, Palermo, Tipogr. "Pontifica", 1931, f. 395-397.

[40] Po aty, f. 395-397.

Kuteli përhap pozitivizëm në shijen e lexuesit përsa i përket poetikës lasgushiane. Pas botimit, poezitë e Poradecit u përhapën dorë më dorë, ato zgjuan interes te lexuesit e kohës dhe patën një perceptim më të gjerë ndër ta. Poezitë e tij, edhe kur nuk gjendej vepra letrare, u daktilografuan apo kopjuan me dorë veçmas ndër të rinj. Ky admirim për poetin e ri erdhi edhe nga tematika dashuroro-erotike që trajtoi.

Duke mbetur në këtë vështrim Kuteli nënvizon erotizmin që zotëron pjesën më të madhe të veprës së L. Poradecit. Kjo gjë provohet statistikisht edhe me lexim të lirë, sepse në 23 nga 45 vjersha te *"Vallja e yjve"* dhe 45 nga 67 vjersha te *"Ylli i zemrës"* janë dashuroro-erotike. Emri i librit të parë nuk është veçse emri i poemës erotike e kozmogonike *"Vallja e yjve"*.

Përmbledhja e poezive të volumit të dytë mbante gjer në vjeshtën e vitit 1936, titullin *"Vasha e trimi"*, dy protagonistët e dashurisë në etikën shqiptare. Kuteli i bën këto shënime me cilësinë e editorit të kësaj vepre.

Kjo madje duket edhe në një bisedë e bërë në një librari të Tiranës mes Lasgushit dhe At Fulvio Cordignanos. Atë ditë Lasgushi zë në befasi Cordignanon, i cili kishte mohuar *"Historinë e Skënderbeut"* të Naimit, duke e quajtur banale meqë Skëndërbeu bie në dashuri. Poradeci e përkufizon dashurinë si pjesë të jetës dhe i kujton atij thënien e Krishtit: *"Shumëzohuni! Lasgushi gjithashtu i hedh poshtë atij, tezën që Naimi, te Skëndërbeu përdori tetërrokëshin dhe jo shtatërrokëshin"*.[41]

Jehona e shkrimeve të Mitrush Kutelit vazhdon edhe në Bukuresht kur ai shkruan për stilin, se nuk është përveçse mënyrë e radhosjes së fjalëve në vargje. Ky përkufizim i stilit ndoshta mund të jetë edhe moto e cila është ndjekur në vështrimin e tij kritik për L. Poradecin. Shkrimi përqëndrohet në paradigmën poetike të Lasgushit dhe ndonjëherë në sintagmën e tij...[42]

Gjergj Kuka do të shpallte në mendimin e tij kritik vlerësim për lëndën poetike lasgushiane dhe do të mbetej i një linje mendimit të Çabejit. Ai kundërshton bindshëm Shundin dhe Kokoshin të cilët shikonin mangësi në nivelin kuptimor të poezisë së Lasgush Poradecit. Këto mendime Kuka i përshfaq në artikujt që mbanin autorësinë e tij dhe të botuar në disa numra të gazetës *"Arbënia"* në vitin 1936. *"Lasgushi la çelun një botë të re në vjershën t'onë, me fjalë të tjera ka sjellun vjershën. Aj na paraqitet tepër sensibël; porsi nji arpë qi dridhet në telat e veta përpara ç'do flladi të lehtë, aj mbledh armonitë ma të holla, dhe arrin me i ngrijtun ma së miri nji hymn. "Lajmësit qielluar" me këndue qetësinë e natyrës, kullimin e lumtunisë qi na mbush shpirtin kur gjindemi para saj"*.[43]

Një vlerë më vete lasgushiane është se poeti nuk humbi në ngushticën sociale të atyre viteve dhe nuk u përhumb në hermetizëm sikundër thotë Nonda Bulka që, parabolikisht, kërkon të hetojë momentin e atëhershëm të krijuesve të rinj, duke u përpjekur ta lidhë këtë me momentin shoqëror të vendit dhe të kohës. Për Lasgushin shkruan: *"nuk ka hedhur sytë rrotull tij për të parë njeriun që rrjep njeriun, vëllanë që vret vëllanë. A nuk ka parë se si virtyti zhduket dhe thëthitet prej interesit? S'ka kuptuar që ati e do të birin për interes, se qëndra e gravitacionit të çdo veprimi njerëzor është interesi?[...] Qan, lëngonë dhe shfryn poeti një dashuri të demoduar dhe anakronike. I lutet një Perëndije pa ditur mirë ku e ka banesën kjo Përëndi. Përpëlitet zall më zall dhe pastaj..."*[44]

---

[41] K. Kokoshi, *Një bisedim midis L. Poardecit dhe At Fulvio Cordignano*, në: "Arbënia". -Nr. 386, 11 tetor, 1936, f. 4-5.

[42] D. P. Pascu, *Catevaobservatiuni asupra scririi*, "Albanica", a d-lui Dr. Anton Balota, Bucuresti, 1937, f. 40.

[43] Gj. Kuka, *Vallja e Yjve*, në: "Arbënia", nr. 344, 1936.

[44] N. Bulka, *Horizonte të reja të letërsisë kombëtare*, në: "Minerva", Nr. 4-5, Tiranë, 1932.

Një pjesë e madhe e krijimeve të Lasgush Poradecit kanë fituar pavdekësinë duke u mësuar përmendësh nga lexuesi i grupmoshave të ndryshme. L. Poradeci është një figurë mitike përsa i përket letërsisë shqipe në tërësi dhe poezisë në veçanti. Ai është njëri nga lëvruesit më të epërm të shqipes. Këtë e ndihmon edhe fati i të qenit njëkohësisht poet me kuptimin më të gjerë të fjalës. Shpesh karakteri i librave dhe shkrimeve për Lasgushin ka gjithashtu karakter mitik. Ndoshta këtë lloj klime e kushtëzon supremacia prej gjeniu e Poradecit. Bëhet fjalë për ndodhi me "ishte seç na ishte", me rrëfenja të cilat nuk mund t'i trajtojmë si objekte shkencore në raport me veprën letrare, por që na ngelen thjesht t'i dëgjojmë për kërshëri.

Mënyra e ekzistencës së veprës së Lasgushit flet edhe për mënyrën e ekzistencës së qenies së saj. Hans Robert Jauss-i thotë së forma e re estetike njëherazi mund të ketë edhe qëllime morale. Një ndër to është edhe mishërimi i lexuesve të kohës me qëllimet dhe artin që mbartte vepra e Lasgushit. Ky rimishërim arrin deri aty sa një lexues implicit një shkrimit të tij i vë titullin metonimik: *"Unë, duke lexuar Lasgushin"*.

Megjithatë, këta kritikë shprehën mendime origjinale, përshtypjen e tyre për elementët e rinj në srukturën e veprës së Lasgush Poradecit. Në shkrimet e tyre të shkurtra dhe të varfëra, përsa i përket bazës teorike dhe estetike apo parimeve kritike, është shfaqur spontanisht një mendim i saktë për tematikën, artin dhe funksionin e krijimtarisë së Poradecit. Me një fjalë, pasqyrohen principe të përgjithshme humaniste se sa kritere të rëndësishme kritike. Pa frikë kjo mund të quhet kritikë spontane, pa një orientim të caktuar.

Gëzimi për ardhjen e poetit të ri, mallëngjimi për sëmundjen e tij apo përkeqësimi i saj ua zë frymën shkrimeve konkrete të kohës. Jo vetëm titujt e artikujve, por edhe përmbajtja e tyre flasin për një emfazë apo sentimentalizëm të tepëruar. Ja disa prej tyre:

Në gazetën *"Shqipëria e Re"* në Kostancë, më 28 nëntor 1928 njoftohet për ardhjen e një poeti shqiptar, të ri dhe të sukseshëm, Lasgush Poradecin. Poezitë e tij thuhet në shkrim, janë premtuese, ndërsa figuracioni popullor i vendlindjes mbetet mbizotërues në vargjet e shkruarara nga autori. Shkrimi shoqërohet me vjershat e Lasgushit "*Njëzetet nëntor"; "Trioleta"* dhe *"Excelsior"*. Kërkohen ndihma për shërimin e Lasgushit, sepse gjendej i shtrirë në spital në Graz.[45]dhe më tej në një tjetër mbulesë anonimati flitet se poeti me përmbledhjen e tij nuk u prit mirë. Anonimati e pranon si poet, por thotë se përsëritet mendimi poetik. Shkrimi më tepër flet për jetën letrare të L. Poradecit. Shkrimi është shkruar nga Gjergj Kuka dhe është botuar pa emrin e autorit.[46] Ky horizont i ri pritës do të fabrikonte dalëngadalë edhe receptimin e ri.

Lidhur me receptimin gradual të veprës, bazuar në një gjykim vlerësues flet edhe shkrimi i Eqrem Çabejt, plot konstatime për virtuaitetin e veprës, vlerën e saj në të ardhmen. Ai thotë se lirika lasgushiane një ditë do t'i flasë botës. Për Lasgush Poradecin dhe veprën e tij poetike, Çabej vijon: *"Lasgush Poradeci na hap portën e një jete të re në poezinë shqiptare, një "frisson neuf", siç pat thënë V. Hygoi për vjershat e Baudelairit, lind e rritet në lëmën e këngës shqiptare një stil i ri, të cilin do ta kërkosh më kot ndër poetët e tjerë shqiptarë, po më kot edhe ndër shkrimtarët e huaj nga shkaku i origjinalitetit që shquan këtë poet djalosh. Ç'e ndryshon nga të parët është thellësia, është vjershëtori më i thellë që ka shkruar në shqipet, në qoftë se kjo nuk është vënë re gjer tani, shkaku është se më të shumtët nuk e kuptojnë poezinë e tij , e cila me fjalë dhe mënyra foljesh, fare të thjeshta, e shumë herë popullore, arrin*

[45] Anonim, *Dy fjalë mbi vjershëtorin Lasgush Poradeci*, në "Shqipëria e Re". -Nr. 347, Kostancë, 28 nëntor 1928, f. 3.

[46] Anonim, *Vallja e yjve e Lasgush Poradecit*, në: "Arbënia", -Nr. 340, Tiranë, 1936, 16 gusht, f. 3.

të koncentrohet aq sa mundet të nxjerrë në dritë mendimet më të thella, ndjenjat më labirintike, idetë më të larta. Dhe po të këndohet Lasgushi me dashurinë, do të vërtetohet thellësia e tij e pashoqe, në mos sot, nga brezat që do të vijnë. Po moskuptimi i lehtë, errësira e disa vjershave të tija, nuk është një e metë përkundrazi, një elememnt i gjithë shkrimeve të thella në botë, që prej poemave indiane e, nëpër Kuranin, gjer më sot. Fundi i fundit, çdo thellësi është e errët. Dhe faji s'është aq i gjeniut sa i publikut mendje shkurtë".[47] Një ditë Shqipëria do t'ja falë njëherë botës këtë talent të madh letrar, nënvizon në këtë shkrim Çabej.

Duke mbetur në këtë truall studimi, Selahydin Toto saktëson se Lasgushi ngrihet kundër artit për art. Arti i tij nuk njeh shoqëri. Si shembuj merr Schlegelin, Noavalisin dhe Goethen. Në tërësi arti është një zhvillim relativ jo absolut. Në fakt arti është vetëm një pjesë e përpjekjes shoqërore dhe sikur ta quajmë art për hir t'artit konkludon Toto duke nënvizuar që në titull se arti i Poradecit është arti dhe letërsia që na duhen.[48]

I këtij mendimi është edhe Skënder Luarasi kur citon se vargjet lasgushiane të përsosura nuk pranojnë kurrfarë vërejtjesh sa i përket formës. Poezitë e tij erotike zënë vend të katërt në ciklin e tij. *"Në mesin e kaq motiveve nga të cilët dridhen telat e lirës së tij, të përmendim nostalgjinë e shkuarjes në vjershën " Partir, c'est mourir un peu", të cilën poeti ynë e ka ndier më shumë se kushdo tjetër"*.[49]

Shpend Bardhi alias Mustafa Kruja nënvizon në vështrimin e tij kritik të atyre viteve leksikun e Lasgushit. "*Fjalët janë të lehta si vargu i lehtë dhe i dashur për lëçitësin"*.[50]

Krist Maloki ngre pyetjen: a është poet Lasgush Poradeci? Kjo e parë në këndvështrimin e plagjaturës së kohës. Maloki veçon, se një studim i hollë psikologjik dhe kulturoro-historik mund të na i zbulonte rrënjët e koloritit lasgushian, por pa ja lënë atë detyrë kohës së ardhëshme dhe ndonjë ditari më kompetent. *"Ne po mjaftohemi këtu me hamendjen tonë që poezija e Lasgushit ashtë e përshkueme dhe e inervueme tepër fort nga spirita poetike sllave, vllahçe dhe romano-franceze"*.[51]

Për të vijuar një vit më vonë me të tjera hamendësi dhe bindje, saktësisht më 1939, duke kujtuar se në pjesën e parë të punimit me karakter teorik i është përgjegjur pyetjes se a është Lasgush Poradeci Dichter, edhe thotë se nuk mund të konsiderohet Dichter, po Poet në kuptimin më të gjerë, me lementin incciona *(të përgjithshëm)* të gjuhës, të tematikës dhe të problematikës si dhe të kombëtares. Pajtohet se poezia e Lasgushit ka karakter të përgjthshëm, po "*nuk ashtë si Goethe apo Schilleri as Stefan George e kundërshton Branko Merxhanin, po si Duccento italjane, ma afër poezisë gjermane të një Holderlini, Hajneje, Lenau, Rilkeje"*.[52]

Një tjetër vlerësim me rezerva për kohën është edhe shkrimi i zotit Kokoshi. Ai ndalet te harmonia e fjalës, varfëria e inspiracionit të poetit. E quan artist të mbaruar të përshkrimeve, veçon vjershën *"Poradeci"*. Thotë se është talent poetik. *"Poezia e Lasgushit është si një molodhi magjike, që në heshtjen e një nate prilli ngrihet ngadalë, përkëdhel veshin, por nuk ngjeth zemrën; është si një flakë e ndritshme që zbukuron qiellin e ërrët, por ka jetën e një metere; është si një psherëtim' e lehtë dhe*

---

[47] E. Çabej, *Mbi poezinë e Lasgush Poradecit*, në: "Gazeta e Re". -Nr. 94, Tiranë, 22 shkurt, 1929, f. 3.
[48] S. Toto, *Arti dhe letërsia që na duhen*, në: "Minerva". -Nr. 30, 1935, f. 13-14.
[49] S. Luarasi, *Moderna knjizevnostu Albaniji in Knjiga o Balkanu*. I/ 1936, f. 347.
[50] Sh. Bardhi, (Mustafa Kruja), *Rreth fjalëve lasgushjane*, në: "Përpjekja shqiptare", -Nr. 18-24, Tiranë, II/ 1938, dhjetor, f. 405-406.
[51] K. Maloki, *Kritikë letrare: A asht poet Lasgush Poradeci?*, në: "Përpjekja shqiptare". -Nr. 13-24, II/ 1938, f. 333-350.
[52] Po aty, -Nr. 25-27, III/ 1939, f.10-31.

e harmonishme që shpejt shuhet pa ushëtuar në zemër! Lasgushi krijon "delusionim". "Shumë herë është e herët, kaotike, poezia e Lasgushit, dhe jo për mendime të thella, por vetëm pse në rrëmbimin e inspiracionit mungoj xhenija që plazmon lëndën; nganjëher' është pedante dhe e mërzitshme, pse pa ispiracion, me pahir zbëhet poezia. Poeta nascutur" dhe Lasgushi ka lindur në gjithë kuptimin e lartë të kësaj fjale. Po duhet që përfytyrimi dhe idetë dhe melodhitë dhe dashuritë të kenë koordinacion harmonik për të krijuar poezin' e vërtetë".[53] Kokoshi e këshillon që në të ardhmen t'i lërë *"reminiscencat"* e lirikëve europianë të shek. XIX. Shkrimi është në formë recensioni, beson në talentin e poetit dhe i bën vërejtje të shumta. *Predikon*.
Përkundër këtij tabloidi "sulmues" në të gjitha shkrimet e tjera kemi një ekzaltim dhe hiperbolizim për poetin. Jo vetëm përmbajtja, por edhe vetë titujt e tyre flasin për një emfazë dhe melankoli të tepëruar për Lasgush Poradecin.
Ja disa tituj të tillë: *"Poet kombëtar"*; *"Këngëtor i pavdekshëm"*; *"Perëndi e poezisë shqiptare"* etj. Vetë titujt, por edhe shtjellimi i brendësisë flasin për qëllimin e tyre ekzaltues. Me fjalë të tjera, po të shprehemi me nocionet e sotme të metagjuhës, konstatojmë se Lasgushi me poezitë e tij përbënte një kthesë interesante në vitrinën letrare të kohës dhe konstituonte një format të ri letrar me elemente modernë, novatorët që do formësonin një horizont tjetër të pritjes. Ky horizont i ri pritës natyrisht do të përfitonte ngadalshëm edhe receptimin e ri. Krijimtaria e Lasgushit është më e gjerë seç mund të mendohej. Këtë e dëshmon ribotimi i vëllimit poetik *"Ylli i zemrës"* më 1939 dhe më pas disa shkrime rreth strukturës së tij.

Përfundime:

Deri më tani është konstatuar se bibliografia e veprës së Lasgushit fillon me shkrimin e Çabejt, më 1929, ndërsa ekziston edhe një botim më i hershëm anonim, në vitin 1928.[54] Ai do të pasohet nga shkrime të tjerë sporadikë, për veprën letrare të poetit. Kësaj periudhe i takon shkrimi brilant i Mitrush Kutelit, *"Fjala e editorit"*. Aty, Kuteli do të përfundonte me dëshirën e mirë të atij që shkruan disa radhë, drejt një analize më të imët dhe më të plotë të veprës së Lasgushit. Citoj mendimin kulmor kutelian: "*Lasgushi shfaqet dhe mbetet një kulm vigan , i cili ka për të zotëruar për shumë kohë me hijen e vet literaturën dhe mendimin shqiptar*".[55]
Kjo periudhë përfshin vitet 1928-1939, ndërsa numëron 16 botime në kuadër të veprës poetike të Poradecit. Disa prej emrave interesantë të kohës nuk do të kurseheshin së shkruari për të. Përmedim Eqrem Çabejin, Gaetano Petrotën, Nonda Bulkën, Skënder Luarasin, Branko Merxhanin etj. Lexuesi i kohës do ta lexojë legalisht veprën poetike të Lasgushit dhe do të dashurohet pas përjetimeve ndjesore që ajo përcjell. Poezia do të pëlqehet dhe do të mësohet përmendësh nga bashkëkohësit e zotit Llazar *(sikurse thirrej poeti)*.
Kalendarikisht botimet për L. Poradecin vijnë kështu: në vitin 1929 kemi dy shkrime për poezinë lasgushiane. Më 1930-ën nuk ka asnjë. Vitet 1931 dhe '32 kanë nga një shkrim. Vitet 1933 dhe '34 kanë nga dy të tillë. Më 1935 sërish ka një shkrim të botuar në shtypin e kohës.
Luhatjet vijojnë me 1936-ën kur tre atikuj thyejnë heshtjen e para një viti për krijimtarinë e Poradecit. Kështu, 1937-ta ka vetëm tre shkrime, 1938-ta ka pesë dhe pushtimi italian i vendit sjell një shkrim të vetëm për L. Poradecin. Në këto vite ka pak botime për poetin.

---

[53] K. Kokoshi, *Poezia e Lasgush Poradecit*, në: "Illyria", Nr. 4, 1934, fq. 2.
[54] Anonim, *Dy fjalë mbi vjershëtorin Lasgush Poradeci*, në "Shqipëria e Re". Nr. 347, Kostancë, 28 nëntor, 1928, f. 3.
[55] M. Kuteli, *Fjala e editorit*, në librin: *Ylli i zemrës*, Bukuresht, 1937, fq. 139-180.

Tomas Eliot, thekson: *"Nuk ka shumë peshë fakti, se a ka pasur poeti shumë adhurues në kohën e vet. Unë, madje, do të theksoja se, kur poeti përfton një masë të gjerë adhuruese për një kohë të shkurtër, është rast i dyshimtë që na bën të frikohemi se ai nuk është duke bërë asgjë të re, se vetëm po u ofron njerëzve atë me të cilën janë mësuar nga poetët e brezit të kaluar. Është me rëndësi që poeti të ketë një masë të vogël po të vërtetë adhuruesish në kohën e vet. Kjo masë duhet të jetë një pararojë e vogël njerëzish çmues të poezisë, të cilët janë të pavarur dhe pak a shumë në ballë të kohës së tyre ose që janë të gatshëm të përqafojnë më shpejt të renë"*.[56]
(Shih në fund të punimit tonë treguesin kronologjik për çdo dhjetëvjeçar rreth autorëve të shkrimeve, librave dhe krijimeve poetike për Lasgushin**).**

III.2. Leximi i veprës së L. Poradecit gjatë viteve 1940-1944

Kjo periudhë përkon me vitin 1940, me një shkrim të Pashko Gjeçit për poezinë, *"Poradeci"* të Lasgushit. Ai bën analizën e poezisë Poradeci dhe variantit të saj. Sombolika bodleriane mbetet ushqim bazë inspirimi në këtë poezi gjatë gjithë trajtimit të shkrimit.[57]
Një tjetër shënim ngulit në vëmendjen shoqërore të kohës, poetin lirik të liqenit poradecar. Jani Mili në fillim jepet një vështrim për letërsinë shqiptare dhe Vangjel Koçën si intelektual. Në brendësi Lasgush Poradecin ai e quan poet lirik, poet të harmonisë dhe muzikës, *"adhurues i verbër i formës, harmonisë"*. Në kritikë vlerëson Krist Malokin dhe Mitrush Kutelin *"për kritikë me vlerë sqaronjëse"*.[58]
Në kulmin e luftës, vjen vlerësimi i veprës së Lasgush Poradecit nga Kolë Ashta. Ripërsëritje intelektuale për evidentim vlerash artistike bën në vijim për poetin e liqerit, konkretisht në pjesën: Letërsia e re pas '12-tës, e cila merret me Ernest Koliqin dhe Lasgush Poradecin. Autori sjell një vlerësim të veprës letrare të Koliqit dhe Poardecit.[59]
Notat e vlerësimit kutelian do të jenë sipërisht të denja për poezinë e tij. *"Lasgush Poradeci, m'i të cilin duam të flasim në radhët që vijojnë, është më i riu dhe në gjithë atë kohë më i felli poet shqiptar. Vargu i tij është fond dhe i një perfesksioni ideal si formë - gjë e cila bën që përkthimi në gjuhë të huaj të jetë një fytyrë fort e zbehtë e origjinalit"*.[60] Do të jetë Vangjel Koça, personi që do shkundë pluhurin e harrimit dhe do të bëjë tejvlerësim të veprës së poetit. Në këtë këndvështrim Lasgushi do të jetë i respektuar. Në shkrim thuhet se kritika shqiptare si term abstarkt ka histori të vogël, fillon me Konicën, i cili prej kritikut u shndërrua në polemist politik. Ai bën ekstremizma kritike, tejvlerësime nga Naimi e deri te Fishta, e Poradeci.[61]
Lasgush Poradeci herë pas here në rini ka udhëheqës emblemën e tij identifikuese, Naim Frashërin, poetin e madh të Rilindjes Kombëtare. Në krijimin e famshëm *"Naim Frashërit"*, të vitit 1925, Lasgushi përmes figurës së poetit kombëtar endet nëpër terrin e kulturës dhe artit shqiptar, veçanërisht në gjirin e shoqërisë shqiptare, duke sendërtuar identitetin poetik dhe kombëtar, përballë historisë, gjuhës dhe traditës. *"Me fjalën e perëndishme të Naimit do të fillonte ndryshimi i motit dhe do të ngallej së vdekuri polemi i vet që s'kish ditur ç'shëtë fjal' e shkruar, pa të bukuri e*

[56] T. Eliot, *Letërsia botërore*, "Shblsh", Tiranë 2000, fq; . 153.
[57] P. Gjeci, *Poradeci i Lasgushit*, në: "Shkëndija". -Nr. 1, V. 1, korrik, 1940, f. 40-43.
[58] J. Mili, *Kritiku dhe sociologu, Vangjel Koça*, në: "Shkëndija". -Nr. 3, 1940, f. 37-40.
[59] K. Ashta, *Vaji i bylbilit i Ndre Mjedës*, në: "Shkëndija". -Nr. 7-8, 1942.
[60] Dh. Pasko, *Poeti Lasgush Poradeci*, në: "Tomori i vogël." -Nr. 5, 1942, f. 1-2.
[61] V. Koça, *Kuvendime të kohës: Kritika apo diçka tjetër*, në: "Tomori i vogël" .-Nr. 6, 15 mars, 1942, f. 3.

mëmëdhethit do të ngjante e pashijuar. Ky është lajtmotivi i dy vjershave antologjike të Lasgushit kushtuar Naimit; ky është mendimi që përshkon si një fill i kuq prozën shkencore të Lasgushit kushtuar rolit të veprës së Naimit për ringjalljen e kombit dhe të shpirtit të shenjtë të tij, gjuhës shqipe".[62] Ky idhullim rrit padyshim edhe numrin e lexuesve bektashjanë, që Naim Frashërin e shihnin të përjetësuar në vargjet e Lasgushit. *Ti rapsod që pranë shqipes dit' e nat' i lodhe ballët...*[63]

Numri i besimtarëve bektashinj ato kohë në Shqipëri, ka qenë evident dhe ky tregues është pjesë e një audience jo të paktë apo të kufizuar lexuesish. *"Është viti 1930, kur, duke ripohuar statistikat e administratës turke, me vetëm tre opsione të mundshme në mënyrë konvencionale popullsia e asj kohe do të caktohet si 70% myslimane (sunitë dhe bektashinj) dhe 30% kristiane (ortodoksë 20% dhe katolikë 10%), duke krijuar një numër100% besimtarësh"*.[64] Kështu *"nën ndikimin e drejtpërdrejtë të pikëpamjeve intelektuale të Naim Frashërit, zhvillimi i bektashizmit në Shqipëri, tregoi shumë më tepër se çdo sekt tjetër sufi apo degëzim tjetër bektashi, që dija e fshehtë fetare nuk ishte një privilegj i veçantë për një degëzim të caktuar gjenealogjik, por mund të arrihet përmes ngritjes shpirtërore, falë një hiri hyjnor të fituar lirisht e në mënyrë të drejtpërdrejtë, në lidhje të ngushtë me shprehjen e ndjenjave kombëtare shqiptare dhe ngulitjen e atdhedashurisë si virtyti më i lartë. Duke iu referuar këtij ballafaqimi në dukje fetar, por në të vërtetë politik, Naim Frashëri në vazhdën e një tradite të gjatë të letërsisë dhe filozofisë lindore, u përpoq të shprehte dhe propagandonte përpjekjet e tij iluministe dhe humaniste të lirisë"*.[65]

Motivi patriotik vjen si vlerë evokuese në krijimet e Lasgushit *"Naimit"* dhe *"Naim Frashërit"*. Ky motiv ngërthen në një të vetëm edhe motivin filozofik, që poezitë pasqyrojnë. Figura e Naimit, poetit të madh të kombit tonë ngjiz evokim udhëheqësish në vitet '30, kohë kur Shqipëria kishte një mungesë të theksuar idhujsh kombëtarë.[66]

Viti 1944 e bën Mitrush Kutelin lajmëtar të botimeve të tjera për Poradecit. Ky afeksion shkrimtarësh, aspak xheloz në ato vite, na lajmëron botimin e shkrimeve të pabotuar për atë moment. Kuteli përdor pseudonimin tjetër letrar të krijimeve personale për Kosovën. Nuk është çudi, por këtë detaj e përdor për të përhapur edhe më shumë jehonën poetike të Lasgush Poradecit, përtej kufirit shtetëror. Kjo kohë përshfaqi modelin e shkrimve me pseudonime letrare të mjaft autorëve. Njoftohet se Lasgush Poradeci përgatit një vëllim me vjersha të pabotuara dhe një studim për këngët tona popullore. Ka të botura disa poezi të Lasgushit.[67]

Maloki, në 11 numra te *"Shqipnija"* përsëri argumenton mendimin nëse është poet Lasgush Poradeci. Krist Maloki në këto shkrime mendon se Lasgushi nuk është poet.

Në pjesën e parë, Maloki polemizon me Mitrush Kutelin, kryesisht edhe me pikëpamjet e kritikëve të tjerë që Lasgushin e ngrinin lart si poet. E pranon aftësinë analitike të Kutelit, po konstatimet e tij jo. Në këtë vazhdim i zbërthen më shumë këto pikëpamje të tij. Maloki i jep ndryshimet midis koloriteve në arte të ndryshme: pikturë, poezi, skulpturë etj. Koloriti, thotë, duhet të kuptohet si *"frymë, atmosferë, afshië, avullsië, shpirtsië, ngjyrësië",* se poezija e ka koloritin *"nër fjalë ngjyjore, muzikale dhe onomatopeike"*.

---

[62] J. Bulo, *Lasgushi dhe Naim Frashëri,* në librin: *Shpirti i fjalës,* Botimet Toena, Tiranë, 2014, f. 136.
[63] L. Poradeci, *Vepra. Poezia. Volumi 1*. Tiranë, "Onufri", 1999, f. 39.
[64] *Feja dhe statistikat fetare në Shqipëri*. https://ateistet.org/sk1210598e
[65] A. Doja, *Bektashizmi në Shqipëri: Histori politike e një levizje fetare*, Shtëpia Botuse "AiiS", Tiranë, 2008, fq 64-65.
[66] I. Zamputi, *Një motiv i Naim Frashërit në poezi të Lasgush Poradecit,* në: "Shkëndija". -Nr. 11, V. III, shtator, 1943, f. 13-15.
[67] I. J Kutrulia, (M. Kuteli), *Vija të vitit letrar 1943,* në: "Revista letrare". -Nr. 1, 1944, f. 1-7.

Më tej, për Poradecin poet shkruan me ironi, se *"Vepra e Lasgushit ka edhe ajo koloritin e saj dhe jemi gati-dhe mjaft zemërgjanë t'a e quajm at kolorit*: *"lasgushjan! [...] Lasgushi numuron si kapital të vetin një muzikalitet të pashoq dhe të panjoftun deri sot në literaturën shqiptare. [...] Ndo nga mungesa e forcës poetike, ndo nga vartësija materiale-financiare, ndo edhe nga dobsija fyzike..., por sidomos nëpër një frikë animale para çdo sëmundje dhe injekcioni, ka sajue aj njeri shpirt të vet do komplekse inferjoriteti (si mbas Psyhoanalyzës) dhe ashtë ba me kohë hypohondër, mizantrop dhe vetmitar"*.[68]

Pra konstaton se poezisë së Lasgushit i mungon *"polykromija"* (shumëngjyrësia) dhe *"polifonija"* (shumëzërësia) dhe se "vjersha e L. përmbrenda tanësisht asht pothue krej popullore primitive".

Thekson melankolinë, fatalizmin dhe tonin femëror të poezisë së poetit, se ka një meditacion "gjysëm mistik, gjysëm teozotik". Madje edhe në planin e peizazhit nuk e pranon se Lasgushi është vjershëtor i kombit, prijës, profet me frymë shqiptare.

Në planin estetik thotë se është bërë frikacak, se njerëzit e tillë ikin nga vrazhdësija e jetës, ikin çdo detyre të rëndë, shëmtuese dhe e kërkojnë shpëtimin në sfera e atmosfera më të bukura.

Maloki hedh mendimin e plagjaturës. Merxhanit i bën vërjetje se Lasgushi në shumë pika ka pikëtakime me Geirgen. Mbetet te mendimi i vet me theks ironizues: *"Natyrisht nuk jam unë ai që them se L., është një G."*.

Për nga kualiteti vjershat e Lasgushit i ndan në tri klasa. Vjershat e klasës së tretë, të shkruara pas viteve 1929-30 nuk kanë fare vlerë. Përsëri i rikthehet problemit të shqiptarisë, duke përfunduar se Lasgushi nuk është poet kombëtar, sepse nuk sjell probleme shqiptare, por në vjersha trajton unin e tij.

Kryesisht poezinë e poetit e nxjerr *"lirike-idilike"* të mbyllur si *"monadat pa dritare"* të Leibnizit. Nuk ka objekte-subjekte, po është poezi "ezoterike-introverte", se vërehet një impresionizëm *"en plain air"* me subjektivitet të shquar. Maloki këtë e arsyeton me planin metrik. Shkruan se Lasgush Poradeci përdor vargun jambik e trokaik, shquan ritmin te *"Lundra dhe Flamuri", "Vdekja e Nositit", "Këngë pleqërishte"*. Njëherësh vëren se te *"Gjeniu i anijes"* përdor anapestin, tetërrokëshin dhe gjashtërrokëshin. Edhe për nga forma metrike konstaton se poezia e Lasgushit është e thjeshtë e primitive.

N. Bulka mendon se modelet e mëparëshme janë të papërshtatshme për letërsinë shqiptare. Ai është për *"një letërsi kombëtare realiste, ku shkrimtari të vërë gishtin në plagën e të sëmurit, ku poeti të qanjë bujkun që dërsit e psherëtin, që mundohet katër muaj rresht, që rastis më së fundi, nonjë breshër ose nonjë fajdexhi a pronar t'i rrëmbejë ç'ka e ç'nukë ka"*.[69] Po sipas tij *"shkrimtari duhet të përpiqet të majë sytë poshtë; u iku moda përshkrimeve romantike të parajsave të lulëzuara"*.[70]

Ndërkaq, në këtë hark kalendarik Mitrush Kuteli vijon të mbrojë poezinë e poetit Lasgush Poradeci, të sulmuar nga Krist Maloki. Kuteli në një shkrim tjetër merret me disa vjersha të reja të Lasgushit, të cilat i ndan më dysh: një pjesë e shkruar me tonin madhor të poezisë dhe një pjesë tjetër me një inspiratë minore, dekadente.

Në to, sipas Kutelit nuk ka prodhime kulmesh, por si trajtë në to Lasgushi punon bukur baltën e shqipes. Si përmbajtje ai tregon se di të dëgjojë, e di të na bëjë të

---

[68] K. Maloki, *Kritikë letrare: A asht poet Lasgush Poradeci?,* në: "Shqipnija", -Nr. 1, 6 mars, 1944, f. 7; nr. 2, 13 mars, 1944, f. 4; nr. 3, 20 mars, 1944, f. 4; nr. 4, 27 mars, 1944, f. 4; nr. 6, 17 prill, 1944, f.4; nr. 7, 24 prill, 1944, f. 4; nr.8, 1 maj, 1944, f. 4; nr. 9, 8 maj, 1944, f. 4; nr. 10, 15 maj, 1944, f. 4; nr. 11, 22 maj, 1944, f. 4.

[69] Nonda Bulka. Për një letërsi të re, Bota e Re, nr. 3, 1936

[70] Po aty, fq. 40.

ndiejmë dhe ne, së bashku me të , tingëllimat dhe bubullimat e brendshme, të shpirtit. Vjershat e sqaruara në këtë shkrim janë: *"Gremina"; "Engjëjt e parë"; "Durimi"; "Dh'u patmë nisur"; "Vasha me drapër"; "Trashëgimi"; "Tërë ditën në shtëpi"; "Faqet e dashurisë"; "O syt e vashës sime"*;[71]

"Poetë e detraktorë" është një tjetër shkrim polemik i kohës. Kuteli përmes tij reagon kundër kritikës së Krist Malokit që kishte bërë për Lasgushin më 1937, e si duket nxitet më shumë kur këtë shkrim e ribotoi te gazeta *"Shqipnija"* më 1944.

Këtu Kuteli vë në pah dallimin midis koncepteve të tij dhe të Malokit për kriterin kombëtar të vlerësimit të vepërs letrare. Sqaron se Maloki ka një koncept etnografik për karakterin kombëtar të letërsisë, që merret me shpirtin kombëtar. Këtë e argumenton në formë tejet ironike. Pastaj në shkrim reagon edhe kundër Arshi Pipës, që Nolin e quante rikrijues, përkthyes të mirë e jo poet.[72]

Përfundime:

Kjo periudhë, sërisht do të mbetet e vakët, përsa u përket shkrimeve konstatuese apo kritike rreth krijimtarisë lasgushiane. Në harkun kohor të viteve 1940-1944 rezultojnë 13 shkrime për veprën e poetit Pogradecar.

Spikasin në këtë kohë Mitrush Kuteli, Krist Maloki, Mustafa Kruja, Branko Merxhani, Nonda Bulka etj. Këto qasje kritike do të bëhen publike, nën hijen e luftës që kërcënonin tragjikshëm Shqipërinë. Kritikat do të jenë të pakta, aq më shumë ato shkrime kritike që kishin në qendër krijimtarinë e Poradecit.

Konkretisht, viti 1940 prezanton dy botime kritike. Më 1941 nuk ka asnjë interes për veprën letare të Poradecit. Viti 1942 prezanton edhe katër artikuj studimorë që publikohen menjëherë në shtypin e atyre vitesh okupacioni. 1943-shi vijon në radhën kalendarike me një botim të vetëm kritik. Ndërsa viti 1944 krahas erës së çlirimit të vendit që po frynte në horizontin shqiptar, prezanton pesë artikuj letrarë të tjerë.

Mund të themi pa frikë se kjo periudhë 5-vjeçare edhe pse e vogël në dukje, përshfaqi një mikroklimë letrare premtuese, plot rezultate pozitive, me dritëparje nga tradita më e mirë.

Edhe në këtë fazë ndryshimet dhe zhvillimet e ndjeshmërisë kritike, që paraqiten së pari te një pakicë, përpunohen shkallë-shkallë përmes ndikimit te të tjerët dhe nëpërmjet autorëve të popullarizuar sikurse rezulton Lasgush Poradeci. Për më tepër, poetët mbeten në jetë përmes lexuesve të gjallë. Poetët e mëdhenj shpalosin pikëpamje, të cilat nuk dalin në dritë menjëherë. Këtë e ka bërë më së miri kjo periudhë që përfshiu në vetvete Lasgush Poradecin dhe krijimtarinë e tij letrare.

III.3. L. Poradeci në periudhën 1945-1990. Kritika utilitare, kritikë angazhuese. Pleqënim(e) më vete

Pas çlirimit të vendit, vepra e Lasgush Poradecit është vështruar nga prespektiva aktuale dhe jo ajo historike-letrare, pra është vështruar vetëm në aspektin sinkronik dhe jo në atë diakronik të saj. Ç'është e vërteta është abstraguar një pjesë e madhe e veprës, janë reduktuar dimensionet e krijimtarisë letrare dhe është pranuar ajo, e cila i është përgjigjur konvencionit aktual letrar apo parimeve të kritikës. Nuk është përfillur shpesh vepra letrare në tërësi, as madje struktura tërësore e një krijimi të vetëm artistik.

[71] M. Kuteli, *Disa fjalë mbi vjershat e reja të Lasgushit*, në librin: *Mitrush Kuteli. Shënime letrare. Vëllimi i I*. Tiranë, 1944, f . 22-32.

[72] M. Kuteli, *Poetë e detraktorë*, në: "Revista letrare", -Nr. 9, 1944, f. 1-4 .

"Tha i urti:/ Çdonjeni asht nji ngjyrë/ E na hije në të/Prej bardh deri n'zi".[73]
Vepra e Lasgushit në përgjithësi dhe krijimet e veçanta të viteve '45-'90 janë zvetënuar artistikisht dhe janë vështruar nën leverdinë e kritikës utilitare, vulgare sociologjike.
Duke filluar nga fundi i viteve '60 të shekullit të XX e më tej, veprës së Lasgushit, autorë të ndryshëm i qasen me pretendime objektive dhe mbështeten në pikëpamje më të avancuara mbi letërsinë ose në koncepte të reja teoriko-letrare. Ata përpiqen të ndriçojnë aspekte dhe probleme të artit, të metodës artistike, të poetikës dhe të strukturës së krijimeve të poetit.
Për hir të së vërtetës, duhet të themi se në këtë kohë ka autorë që trajtojnë çështje të cilat njëherë janë trajtuar e i ritrajtojnë më dobët, pa shtuar elementë të rinj dukë mbetur të pranguar pas përsëritjes së tyre kokëfortë. Kështu, për shembull, disa trajtojnë heroin lirik të poetit, pa e parë ata të riprezantuar në një kënd të ri vështrues apo domethënie të re. Disa të tjerë trajtojnë çështje të shqyrtuara kohë më parë, sikundër teza nëse është Lasgushi shkrimtar, por këtë herë i *realizmit socialist*.
Ka mendime kritike se çdo krijim letrar lasgushian, duhet vështruar në kontekstin e tërësisë së jetës së tij. Realisht, në të vërtetë kështu veprohet nga ana e një sërë kritikësh, të cilët kur analizojnë ndonjë krijim poetik të veçantë, motivohen nga ajo që të theksojnë tiparet e përgjithshme të krijimtarisë së tij poetike.
Një risi të mevetësishme në këtë aspekt paraqet konstatimi i figurës letrare apo nënteksti i thelluar i poezive. Përmes theksimit të këtyre komponentëve dhe sintezës së veçorive të tjera stilistike, vërehet qëndrimi i autorit ndaj vlerës artistike të krijimtarisë së tij. Vlera letrare e Lasgushit qëndron në aspektin e dimensionit artistik, që përftohet figurshëm në magjinë e liqenit të Ohrit dhe jetës në tërësi.
Në formacionin stilistik të veprës vërehen elemente të romantizmit, simbolizmit, eksperesionizmit, që qëndrojnë të sigurta, mbi epërsinë e elementëve të realizmit socialist.
Çështja që shtrohet rëndom në sisteteme totalitare është të botosh nën diktaturë apo të heshtësh? Regjimi vërente përmes veprës letrare të Lasgushit një mjet për krijimin apo zhdukjen e një zëri të ndryshëm nga rruga e tij. Veçanërisht diktatura ishte aq e "zgjuar" sa të përftonte te vepra e poetit, një aleat të vlefshëm apo një armik të rrezikshëm, aq më tepër që në vitet '70, të shekullit të XX, reputacioni i Poradecit ishte përhapur në popull. Vendi ynë pret që vlerat e atij, i cili i ka dhënë lavdi të vdesë njëherë, pastaj ta nderojë a ta bëjë të pavdekshëm. Deri sa ai është gjallë, mbizotërojnë nënverësimet, përqeshjet, harrimet, duke e zhvlerësuar mundin dhe përpjekjen e tij. Në këtë hark kohor Lasgush Poradeci lartësohet përmes vargjeve të poetëve, në krijimet e tyre.
Ribotohet poezia e Asdrenit (Aleks Stavre Drenova) për L. Poradecin. Në këtë kushtimë ai sjell poetin lirik të shqiptarëve. Poezia titullohet *"Excelsior!"*. Poezia ribotohet në serinë e zgjedhur të veprës poetike të Asdrenit.[74]
Lamja i vogël më 1945 i kushton një poezi Lasgushit. Kjo kushtimë tregon adhurimin e tij për poetin me flokë të bardha si teutonët. Ndërkaq, duhet marrë në konsideratë fakti që herë pas here poetë të ndryshëm do të krijonë vargje për poetin e liqenit, që nën diktaturë heshtoi me gjalljen e tij.[75]

---

[73]M. Camaj, *Pleqënime më vete*, në librin: *Njeriu më vete e me tjerë*, Shtëpia botuese "Onufri", Tiranë, fq. 119.
[74] Asdreni, në librin: *Asdreni. Vepra 2*, Botohet nën kujdesin e Akademisë së Shkencave të RPSSH, Tiranë, 1980, f. 65-67.
[75] S. Malëshova, *Lasgush Poradecit*. Poezia është shkruar në vitin 1981. Vjershë e shkruar në vitin 1928, në librin: Lame Kodra, *Vjersha*, Tiranë, 1945, f. 57-59, Autor: Lame Kodra (pseud.).

Pano Taçi është ndër poetët shqiptarë, që e vuajti regjimin diktatorial burgjeve të tij. Ai krijon vargje për Lasgushin. Poezia titullohet: *"Kamadev, kupid, eros"*.[76]
"Lirikut" titullohet poezia e Dhimitër Pojanakut që do t'i kushtohet bashkëqytetarit të tij.[77] Kjo poezi, pasohet me një tjetër krijim në vargje nga Meri Lalaj kushtuar poetit poradecar, shkruar në vitin 1981.[78] Rinush Idrizi do të shkruajë poezinë e tij *"Poetit"* në vitin 1981.[79] *"Poeti është si deti"* titullohet poezia e shkruar nga studiuesja Klara Kodra në vitin 1984. Libri i saj u shkrua me rastin e 80-vjetorit të lindjes së poetit.[80]
Në këtë botim është hequr përkushtimi: Lasgush Poradecit, sipas dëshmive mëvonshme të studiueses. Poeti Bardhyl Londo vjen me një tjetër kushtimë, më 1988.[81] Jorgo Bllaci gjithashtu vargëzon për poetin.[82] *"Në Pogradec te Lasgushi"* titullohet poezia e shkruar nga Gëzim Hajdari.[83] Kjo poezi pasohet, nga ajo e shkruar nga Petrit Ruka.[84] Poezitë kushtima janë radhitur sipas kësaj paraqitjeje, nisur nga viti i shkrimit, që është vendosur përfund tyre.
Në këtë periudhë kemi edhe një tregim të shkruar nga Ardian Kyçyku për Lasgush Poradecin.[85]
Ismail Kadare shkruan në fillim tregimin dhe më pas romanin me të njejtin titull: *"Ikja e shtërgut"*. Në qendër është L. Poradeci poet, që, pothuajse i harruar dhe i varrosur përsëgjalli gjatë regjimit të E. Hoxhës, arrin ta sfidojë atë, duke përjetuar në pleqëri të thellë, të vetmen gjë që s'mund t'ia ndalonin, një histori platonike dashurie me Ana G.
Kjo periudhë ka edhe mendimin kritik për veprën letrare të Poradecit. Në vitin 1956 Muzafer Xhaxhiu sjell *"Disa shënime rreth jetës dhe veprës poetike të Lasgush Poradecit"*. Ato i përcjell në parathënien e librit duke nxjerrë në pah kontradiksionin e poezive. *"L. Poradeci mbetet një shfaqje e veçantë në letërsisnë tonë. Nuk gjejmë poet tjetër, tek i cili poezia të jetë zhvilluar me ngritje dhe zbritje kaq të çuditshme e në mënyrë kaq kontardiktore sa te Lasgush Poradeci. Këto kontardikta shfaqen jo vetëm nga një vjershë në tjetrën, por nganjëherë edhe brenda një vjershe, bile në mjaft nga ato që kemi mbledhur në këtë vëllim poetik. Që lexuesi të kuptojë të gjitha këto, zbërthyem disa nyja kryesore, duke vënë në pah anët pozitive dhe negative të saj"*.[86] Xhaxhiu këtë e bën edhe në botimin e vitit 1960 nga faqja 3 deri 16 të parathënies së tij.
Në vitin 1960, Nasho Jorgaqi bën shënimet e redaktorit në përmbledhjen poetike të vjershave të zgjedhura të Lasgushit. Aty, ai flet për poezinë në përgjithësi të Lasgush Poradecit. Ndalesë kryesore në shënime mbetet zbërthimi i motiveve që ai trajton në poezitë e tij, ndërsa i mëshon faktit se *"Lasgushi nuk ka hedhur sytë rrotull tij për të*

---

[76] P. Taçi, *Kamadev, kupid, eros.* Poezi, Botuar në kopertinën fundore të librit: *Lasgushi në Poradec* të M. Lalajt, Asdreni, Shkup, 2001.
[77] Dh. Pojanaku, *Lirikut*, Poezi, në librin: *Lasgushi në Pogradec*, Elbasan, 1995, f. 33.
[78] M. Lalaj, *Tingëllimat e dëborës, Poezi*, në librin: *Lasgushi në Pogardec*, Elbasan, 1995, f.105.
[79] R. Idrizi, *Poetit, Poezi*, në librin: *Lasgushi në Pogradec*, Elbasan. 1995, f. 93, 96, 148.
[80] K. Kodra, *Poeti është si deti, Poezi*, në librin Kodra K. *Bisedë me vëllezërit*, Tiranë, 1984.
[81] B. Londo, *Lasgush Poradecit*, në librin: *Si ta qetësoj detin*. Titranë, "Naim Frshëri". 1988, f. 34.
[82] J. Bllaci, *Vreshti i poezisë. Kujtimit të Lasgush Poradecit, Poezi*, në librin: *Epika e trëndafilave.* Tiranë, "Naim Frashëri", 1990, f.26 .
[83] G. Hajdari, *Në Pogradec te Lasgushi*, në librin: *Antologjia e shiut*. Tiranë, "Naim Frashëri", 1990, f. 38-39.
[84] P. Ruka, *Lasgush Poradeci, Poezi,* në librin: *Mirupafshim hënë e vendlindjes,* "Naim Frashëri", Tiranë, 1990, f. 43-44 .
[85] A. Kyçyku, *Përtëritje. Tregim për Lasgush Poradecin*, në librin: *Stina e gonxheve*, "Naim Frashëri", 1990. f. 71-76.
[86] M. Xhaxhiu, *Disa shënime rreth jetës dhe veprës poetike të Lasgush Poradecit,* Parathënia e librit L. Poradeci, *Lirika*, Tiranë, 1956.

parë njeriun që rrjep njerinë, vëllanë që vret vëllanë. A nuk ka parë se si virtyti zhduket dhe thëthitet prej interesit? S'ka kuptuar që ati e do të birin për interes, se qëndra e gravitacionit të çdo veprimi njerëzor është interesi?"[87]

Vehbi Bala më 1965-ën shtron tezën e ndikimit të madh të poetit romantik Mihai Emineskut në poezinë e Lasgush Poradecit. Ndikimet i sheh në temat dhe fjalorin poetik, mirëpo argumentimet nuk janë të mjaftueshme, sepse nuk janë ndjekur sa duhet burimet e formimit dhe të dijes së Lasgushit të cilat nisin në trashëgiminë poetike shqipe në radhë të parë, më së hetueshmi në poezinë e Naim Frashërit. Pastaj hapen në literaturën europiane, të cilën poeti ynë mund ta lexonte në origjinal, e deri në mitologjinë e Vedave Induse, që i njihte mirë që në rininë e hershme të tij.[88]

Akademiku Rexhep Qosja në *"Dialogje me shkrimtarët"* bën një ndarje sistematike të fazave të krijimtarisë së poetit. Sipas tij ato janë tetë: *Poeti dhe letërsia shqipe; Trajta dhe koha; Poetika romantike e frymëzimit; Peizazhi dhe kuptimi i tij simbolik; Domethënia e mallit dhe e harmonisë komike; Mbi botën dhe njohjen e saj; Kreacioni dhe vdekja* dhe *Gjuha, simboli dhe kulti i muzikës*. Ky shkrim më shumë u shtrohet kërkesave të një shkrimi historik-letrar se sa kritik-analitik, prandaj merret me mundësinë e gjetjes së vendit të Lasgushit në historinë e letërsisë shqipe në radhë të parë dhe me gjendjen e poezisë së tij në relacion me poetët bashkëkohës të Europës. *"Lasgush Poradeci ndien si romantik, mendon si klasicist, asht' i vetmuem dhe i hermetizuem shpirtnisht si simbolist dhe i kujdesshëm ndaj formës e vargut si parnasist. Eshtë ekliktik dhe origjinal në çdo pikëpamje"*.[89]

Në tekstin *"Historia e Letërsisë Shqipe për shkolla të mesme"*, botim Prishtinës, Shuteriqi bën jetëshkrimin e poetit duke e zmadhuar famën e tij në territorin kosovar. Aty ndër të tjera thuhet se rrethanat jetësore nëpër të cilat u përshkrua edukimi ideoartistik që L. Poradeci mori nga ambienti dhe shkolla të ndryshme, nga poezia e popullit, nga letërsitë e huaja sidomos ajo rumune dhe gjermane shpjegojnë anët e tij kondradiktore.[90] Më 1969 e ka radhën kritika kosovare të flasë për veprën letare të L. Poradecit. Në këtë aradhë do të veçoja Rexhep Ismailin me këndvështrimin e tij krahasues.

Poezia *"Vdekja e Nositit"* ka simbol zogun e ujit. Ndërkaq Musset dhe Poradeci realizojnë mishërimin simbolist të shpendit të ujërave, i cili del i qartë në konceptim si imazh konkret poetik. Edhe interpretimi i figurës poetike bëhet brenda për brenda sistemit poetik të dy autorëve, sepse lidhjet dhe përngjasimet shtrihen edhe më tej, jo vetëm mes tyre. Emocioni i vargut përcillet rrekshëm dhe bindshëm. Ismaili thekson se Lasgush Poardeci është superior ndaj atyre që mendohet se kanë ndikuar mbi të.[91]

Ibrahim Rugova sjell vështrim kritik mbi vargëzuesin e nositit. Poet që u prarua me bukurinë, cilësohet nga Rugova, Lasgush Poradeci. Shkrimi në fjalë afron një fund tragjik, mishëron idealin e madh të sakrificës dhe vazhdimësisë së jetës, të vetë qenies njerëzore.[92]

---

[87] N. Jorgaqi, *Shënime të redaktorit*, në librin: *Poradeci Lasgush. Vjersha të zgjedhura*, Tiranë, 1960, f. 80-81.

[88] V. Bala, *Lidhjet letrare shqiptaro-rumune*, në: "Buletini Shkencor i Institutit Pedagogjik të Shkodrës", 1965, f. 3-57.

[89] R. Qosja, *Dialogje me shkrimtarët. Lasgush Poradeci (1899)*, Prishtinë, 1968, f. 135-177.

[90] Dh. Shuteriqi, *Lasgush Poradeci (1899)*, në librin: *Shuteriqi Dhimitër. Historia e Letërsisë Shqipe. Për shkolla të mesme*, Prishtinë, 1968, f. 262-264 .

[91] R. Ismaili, *Simbol i njohur i poezisë së qëlluar: Nositi i Alfred de Musset dhe Vdekja e Nositit e Lasgush Poradecit*, në: "Fjala", -Nr. 11, Prishtinë, nëntor, 1969, f. 7.

[92] I. Rugova, *Me zjarr ju flas me zjarr - Me shpirt e mendje te e bukura u prarua me bukurinë - Lasgush Poradeci*, në librin: Rugova Ibrahim. *Prekje lirike.* Prishtinë, 1971. f. 173-182.

Andrea Varfi, në parathënien e librit me poezi të zgjedhura të Lasgushit dhe Razi Brahimi, sërish, në parathëniet e poezive të zgjedhura, të botuara një vit më pas, do përcjellin elementet e tyre të veçantë, të veprës poetike lasgushiane. *"Krijimtaria e L. Poradecit shënon një ngritje artistike të poezisë sonë kombëtare të asaj kohe dhe dallohet në tërësinë e vet si një shprehje origjinale e personalitetit të poetit, që mbetet një prej figurave më të njohura të së kaluarës sonë letare. Vargu letrar mbetet me plot finesë, ëmbëlsi dhe melodi"*.[93] Parathënia flet për Lasgushin poet, ndërsa fokusohet te tema patriotike në poezi, vjershat simbolike dhe ato me motive popullore.

Prirjet e Lasgushit në lirikë janë krijime me frymë popullore, vjershat lirike vijnë me formë më të përcaktuar artistike origjinale dhe me ndikime formaliste. *"Edhe në ndjekjen e folklorit, disa herë është kaluar në manjerizëm"*.[94]

Sabri Hamiti fokusohet me kritikën e tij në ciklin e krijimit dhe kalon më pas në cilkin e zhvillimit (lënda, fryma, ndjenja, njeriu, përjetësia). Përmes një subjektiviteti të theksuar të krijuesit, është shkalla e Shpirt-Zotit, që ndodhet kudo në natyrë, madje edhe në procesin e rikrijimit të materies. *"Jashtësia krijohet përmes shqisave të trupit dhe zemrës që ndien dhe vuan. Kozmogonia mbetet një rrugëtim tokë-qiell dhe njëherazi ideal i fortë i qenësimit nga Krijuesi"*.[95]

Eqrem Çabej do të shkruante: *"Lasgush Poradeci na hap portën e një jete të re në poezinë shqiptare, një "frisson neuf", siç pat thënë V. Hygoi për vjershat e Baudelaireit, lind e rritet në lëmën e këngës shqiptare një stil i ri, të cilin do ta kërkosh më kot ndër poetët e tjerë shqiptarë, po më kot edhe ndër shkrimtarët e huaj nga shkaku i origjinalitetit që shquan këtë poet djalosh. Ç'e ndryshon nga të parët është thellësia, është vjershëtori më i thellë që ka shkruar në shqipet, në qoftë se kjo nuk është vënë re gjer tani, shkaku është se më të shumtët nuk e kuptojnë poezinë e tij , e cila me fjalë dhe mënyra foljesh, fare të thjeshta, e shumë herë popullore, arrin të koncentrohet aq sa mundet të nxjerrë në dritë mendimet më të thella, ndjenjat më labirintike, idetë më të larta*.[96]

Sabri Hamiti vazhdon shkrimet kritike për veprën poetike të poetit të liqerit. Nositi për të është një pelikan i fjetur. Filozofia e vjershës është eksplicite ndaj natyrës që vjen e krijuar simbolikisht. Poezia është shkruar në vetën e parë, si monolog, ku subjektiviteti i poetit është transponuar drejtpërdrejt në materien e vet. Në tekst nuk ka ndërhyrje indirekte përshkruese, ndaj nga një anë ka dramacitet më të lartë dhimbja.[97]

Në këtë botim Hamiti, pjesën e katërt, ia kushton Lasgushit të Pogradecit. Poetit luçid, që në vitet '20 kishte hetuar thellësisht, se të gjithë rilindasit shqiptarë, fjalën poetike e bënin një me idealin kombëtar. *"Po vinte një kohë kur po destruktohej qenia e krijuesit, kur po copëzohej ajo*: *në dëshirën për shkrim dhe në dëshirën për pushtet dhe kur ato po humbnin, poeti po bëhej agresiv, që pret e vret për të treguar virgjinitetin e vet, paprishjen e vet shpirtërore"*.[98]

Më herët Petraq Kolevica shkroi kujtimet e tij me poetin. Petraq Kolevica përmes këtyre fragmenteve jep lajmin për ekzistencën e librit *"Lasgushi më ka thënë..."*, që do të botohej libër më vete në vitin 1992.[99]

---

[93] A. Varfi, *Parathënie*, në librin: *Lasgush Poradeci, Poezi*, Poezia shqipe, Tiranë, 1974, f. 3-4 .

[94] R. Brahimi, *Parathënie*, në librin: *Lasgush Poradeci, Poezi,* Poezia shqipe, Tiranë, 1974, f. 3-4 .

[95] S. Hamiti, *Figura kosmike, Vallja e yjve,* në librin: Variante, Prishtinë, 1974, f. 94-99.

[96] E. Çabej, *Mbi poezinë e Lasgush Poradecit,* në librin: *Studime gjuhësore, V,* Prishtinë, 1975, f. 87-89.

[97] S. Hamiti, *Pelikani i flijuar*, në: Fjala, Prishtinë, -Nr. 20, 15 nëntor, 1976, f. 4; nr. 21, 1 dhjetor, 1976, f. 4; nr. 22, 15 dhjetor, 1976, f. 4, 11.

[98] S. Hamiti, *Lasgushi. Studim mbi poezinë e Lasgush Poradecit* në librin: *Tekst i dramatizuar 2*, Prishtinë, 1978, f. 234-236.

[99] P. Kolevica, *Kujtime me Lasgushin.* Fragmente, në: Nëntori. -Nr. 12, 1977.

Ndërkaq në vitin 1987 përsëri Sabri Hamiti, nën kujdesin personal boton në Kosovë veprën poetike të Lasgushit. Në hyrje sjell një studim për interpretimin e poezive të mjeshtrit pogradecar. Më pas ndalet te vendi, koha dhe gjuha për të vazhduar me probleme të fisit dhe jetës. Miti i gjuhës, pasohet nga këngët e durimit, ligjëratat mbi përjetësinë, vdekjen e ëmbël, artin poetk, sintagmën poetike, variantet dhe sistemin poetik. Fusinota përmban shkrime kritike për veprën e L. Poradecit.[100]

Studiuesi Gjergj Zheji analizon në thellësi metrikën e Lasgushit. Poradeci në krijimtarinë e tij përdor vargun naimian. Vargjet e sistemit silabotonik që janë baza e folklorit shqiptar, hasen edhe te disa poetë të tjerë si Naimi, Mjeda e në mënyrë të veçantë te Noli dhe Poradeci. Te Lasgushi tetërrokëshat janë me rritëm zbritës, mbasi mbisundojnë troketë. Si shembuj Zheji merr poezitë: "*Gjarpërushja"; "Dremit liqeri"; "Gjeniu i anijes"; "Poardeci"*.[101]

Një shkrim anonim analizon disa poezi shkurt, vetëm në nivel strofash për të theksuar disa veçori të përmbajtjes, apo figuarve letare, të marra nga vëllimet e tij poetike *"Vallja e yjve"* dhe *"Ylli i zemrës"*.[102]

Mensur Raifi në librin e tij argumenton se si tre kolosët e letërsisë së viteve '30 ngrejnë piedestalin e tyre falë veprës letrare. Lasgushi mbetet më i preferuari nga kategoritë e lexuesve, përsa i përket poezisë me motiv *dashuroro-erotik*.[103]

Fatos Arapi ndalet te përmbajtja dhe forma e krijimtarisë lasgushiane, që sipas Arapit, ka karakter kontardiktor, duke lënë vetiu shteg për keqkuptime, nga kritika e kohës. Në këto mendime për poezinë sqarohet edhe pozicioni si "i harruar" i poetit.[104]

Më 1988, Ismail Kadare lajmëron hapur simpatinë për shtërgun e fundit. Një simpati që merr në qasje krahasuese, tre korifej të viteve '30. Kadare, vendos në qiejt e parajsës Lasgushn Poradecin, në purgator Mitrush Kutelin dhe në errësirën e ferrit dantesk Migjenin. Lasgush Poradeci kishte kryer ose lënë përgjysmë, një numër shkollash e universitetesh në vende të huaja, për t'u doktoruar më në fund në Universitetin e Grazit të Austrisë, kishte studiuar kështu letërsi, arte, gjuhësi, filozofi, pikturë e misticizëm.[105] Frida Idrizi publikon letërkëmbimimin e Lasgushit me bashkëkohësit. Letra të cilat përshkruhen nga fryma demokratike, patriotizmi i fuqishëm, qëndrimi i drejtë, ndaj problemeve politike të viteve 1920-1930. Zjarri i pasionit dhe madhështia e bukurisë, që iu kundërvu obskurantizmit të kohës fryma e thellë emancipuese, ishin këto disa nga cilësitë e këtij letërkëmbimi me Konon, Asdrenin, Çabejn, Kutelin, Paskalin, Qafzezin, Budën, dhe Gaqo e Tefta Tashkon.[106]

Gjithashtu Frida Idrizi sjell në këtë periudhë edhe përmbledhjen me poezi të Lasgushit me titull "*Vepra letrare"*. Shkruan një prathënie dhe bën një riprezantim kritik të jetës dhe veprës letrare të Lasgush Poradecit. Ajo e sheh poezinë të interpretuar në këndvështrimin atdhetar, filozofik, politik, natyror, dashuror dhe erotik. *"Folku shqiptar, Rilindja Kombëtare, kultura dhe imagjnata janë ushqimi kryesor i poezisë së Poardecit. Fjala në poezinë e Lasgush Poradecit me mënyrën e veçantë të përdorimit*,

---

[100] S. Hamiti, *Vdekja e Nositit. I. Shqiptimi i poezisë. II. Fusinota. Studim.* Shënime, në librin: *Lasgush Poradeci. Vdekja e Nositit,* Prishtinë, 1978, f. 7-46, 221-223.

[101] Gj. Zheji, *Lasgush Poradeci. Studim,* në librin: *Vëzhgime metrike*. Prishtinë, 1981, f. 140-158.

[102] Anonim, *Lasgush Poradeci dhe lirika e tij,* në librin: *Historia e Letërsisë Shqiptare që nga fillimet deri te Lëvizja Antifashiste Nacionalçlirimtare,* Tiranë, 1983, f. 521-530.

[103]M. Raifi, *Lasgushi, Noli, Migjeni.* Prishtinë, 1986, -162f. ; *Sinjalizim i marrë nga bibliografia,* në librin: R. Elsie, *Histori e Letërsië Shqiptare,* Tiranë, Pejë, 1997, f. 629.

[104]F. Arapi, *Fjalë për poezinë,* në librin: *Fjalë për poezinë.* Tiranë, 1987, f. 60-99.

[105]I. Kadare, *Migjeni ose uragani i ndërprerë.* Parathënia e Ismail Kadaresë, në librin: *Migjeni*, Tiranë, Korrik, 1988, f. XXVII, XXX-XXXVI, XXXIX, LII-LVII, LXI.

[106]F. Idrizi, *Dialog i një poeti të madh me brezin e tij: Letërkëmbimi i Lasgush Poradecit,* në: "Nëntori", -Nr. 8, 1988, f. 116-117.

ka peshë të madhe e cilësi të rralla. Në mënyrën e konceptimit poetik, -shkruan Idrizi, *të strukturimit të mendimit dhe të krijimit të figurës ai paraqitet si fenomeni më kompleks i poezisë shqipe, që e ridimensionoi fjalën shqipe dhe figurën artistike, që gjeti në poezinë më të mirë të Rilindjes dhe në atë popullore"*.[107]
Përpjekjet e para, përmes shkrimesh me tendencë utilitare, por edhe elemente të kritikës ideologjike pra, i bën Frida Idrizi, botuar pjesërisht në shtypin partiak të kohës, e më pas në parathënien e veprës poetike të Lasgushit, redaktuar nën kujdesin e saj. Autorja vë në rend të parë rëndësinë ideore dhe jo atë artistike të artit lasgushian. Që në fillim të shkrimit vërehet përpjekja që poeti dhe krijimtaria e tij të vështrohen në lidhje me lëvizjen komuniste të kohës. Autorja tregon ndikimin që kishte pësuar Lasgushi nga letërisa ruse, konkretisht nga ajo socrealiste e Bashkimit Sovjetik të Gorkit dhe Majakovskit. Frida Idrizi vëren disa rrethana kombëtare që ndikuan në orientimin ideor të Lasgushit.
Kështu ajo shkruan sesi Lasgush Poradeci bëhet i vëmendshëm dhe i vetëdijshëm për lëvizjen komuniste në Korçë dhe Tiranë. Madje ka zëra në vitet e sukseseshme të socializmit shqiptar, se Lasgushi në kuadër të kriterit ideologjik, pati ndikime nga Bodleri dhe Remboja, simbolistë të sukseshëm botërorë.
Frida Idrizi në disa momente të shkrimit të saj përqëndrohet në aspektin ideo-tematik duke u marrë më pas edhe me veçoritë e brendshme estetike të veprës poetike të Lasgushit.
Me këto lloj formulimesh u bënë përpjekje që të theksohet leximi së jashtmi i veprës fizike të Lasgushit. Koha kur u shkrua dhe u botua shkrimi në brendësi të vëllimit të poezive të Lasgush Poradecit kërkonte një analizë dhe një vlerësim në një tjetër aspekt, që ishte ai ideologjik e kulturor.
Këto evidentime në vijën krijuese të Lasgushit, vinin kryekëput si pasojë e mosnjohjes të mjaftueshme të poetit më filozofinë marksiste-leniniste. Kritika e pas '90-tës e ka cilësuar këtë, një vështrim të objektit estetik, fund e krye në prizmin ideologjik të kohës.
Ishte ky një ndër predikimet e para didaktike, që përmes koncepteve utilitare kanalizon gjykimin vlerësues, sugjeron mënyrën e vrojtimit e të analizës dhe programon qëndrimin, jo vetëm ndaj Lasgush Poradecit, por edhe ndaj letërsisë shqipe në përgjithësi.
Profesor, Ali Xhiku e trajton Lasgushin si pasromantik. Subjekti i poezive të krijuesit, natyra, dashuria, atdheu, theksat meditativë, janë disa nga karakteristikat e poetit, që trajtohen përmes një kapitulli të vetëm në librin *"Nga romantizmi rrjedhave të realizmit"* Studimi sjell karakteristikat më themelore të poezisë lasgushiane. Profesor Xhiku e quan Lasgushin poet subjektiv, i cili krijon kultin e vetvetes.[108]
Ismail Kadare rimerr Lasgush Poradecin në konsideratë të shkrimeve. Ai i bën një portret hyjnor, poetit lirik gjysëm të gjallë e gjysëm të vdekur. *"Të shkoje tek ai, ishte më shumë se të dilje jashtë shtetit, sepse dilje jashtë sistemit të asaj kohe"*. Kadare hedh dritë për herë të parë për prozën e tij poetike *"Vizitat e zonjushës Ana X. në kullën time"*, ku përshkruhet dashuria e tij e fundit në jetë, si pjesë e një idili platonik.[109]
Aurel Plasari krahason mallin në poezinë shqiptare dhe atë rumune. Plasari gjithashtu flet për vlerën kombëtare dhe universale të veprës së Lasgushit. Malli është një prej

[107]F. Idrizi, *Parathënie*, në librin: *Lasgush Poradeci. Vepra letrare*. Tiranë, 1990, f. 5-38.
[108] A. Xhiku, *Lasgush Poradeci. Një poet romantik,* në librin: *Nga Romantizmi rrjedhave te Realizmit,* Tiranë, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 1989, f. 131-141.
[109] I. Kadare, *Për Lasgush Poradecin*, në librin: Ftesë në studio, Tiranë, "Naim Frashëri, 1990, f. 207-223.

figurave kryesore në veprën e Lasgushit, ndikuar nga poezia popullore rumune dhe veçanërisht ajo e Emineskut. Lasgushi vështrohet i krahasuar në poezinë e tij, në këndvështrimin metafizik edhe me Bodlerin dhe Rilken. Plasari merret edhe me muzikalitetin e poezisë së Poradecit. Aurel Plasari thekson se në letërsinë e krahasuar ekziston *"ligji i qarkullimit"*, i cili nuk pyet për *"kufinj gjuhësorë ose kombëtarë"*. Në poezi ky ligj është veçanërisht i fuqishëm te Lasgush Poradeci.[110]

Profesor Ymer Çiraku ndalet, në zbërthimin e kodeve letrare të poetit. Çiraku shkruan se studimi i Aurel Plasarit *"Princ përballë princërve"* është një studim solid, koncentrat konkluzionesh të argumentuar dhe bindse, ku erudicioni dhe argumenti harmonizohen drejt, pa lakmuar që njëri t'i bëjë hije tjetrit. *"Studime si ky, doemos i hapin shtigje të sigurta studimeve tona komparatiste letrare, që gjer më sot pothuaj kanë munguar fare. Vendosja e Lasgush Poradecit në qendër të monografisë nuk është një zgjedhje e rastit. Ai shikohet me të drejtë si një ekuilibër dhe faktor emancipimi në letërsinë tonë. Studiuesi Plasari, ka meritë në shqyrtimin e asaj pjese të krijimtarisë së poetit, që zhytet në përsiatjet e thella të natyrës filozofike, me zhbirime në labirinthet e psiqikës së njeriut, ku shfaqet hera-herës dhimbja dhe fataliteti përballë pafundësisë së humnershme të vetmisë.* Në fund të shkrimit, analizohet poezia *"Vdekja e Nositit"*.[111]

Vëmendja e diktatorit Hoxha nuk e kursen Poradecin shumëpopullor. *Lasgushin e kam njohur që para lufte, kur isha profesor në gjimnazin e Tiranës. Më kish ftuar dy herë në dhomën e tij të thjeshtë e pa zjarr dhe më një velenxë në krah më kish lexuar disa nga vjershat e tij të bukura të asaj kohe. Ishte ca pesimist në jetë, por jo vjershat e tij. Ai ishte i dëshpëruar nga regjimi i Zogut, prandaj preferonte të rronte i vetmuar. Dikur dilte dhe bashkohej me ne"*.[112] Janë hedhur zëra se shkrimet janë falsifikuar nga e veja e diktatorit Nexhmije Hoxha, pas vdekjes së tij.

Nga mënyra si botohen kujtimet e Enver Hoxhës në veprën seriale, kuptohet që i ka gjithë mekanizmat ndihmës për të shkruar dhe botuar një libër, që do ta kishte zili çdo shkrimtar i atyre viteve. Nexhmije Hoxha është kujdesur shumë për rikrijimin e mitit të diktatorit Enver Hoxha. Deformimin e kujtimeve ajo e bën për çdo rast dhe për çdo personalitet, sidomos kur janë emra të padiskutueshëm në popull. Magjishëm, ajo fut në kah njerëzve të shquar edhe Enverin e saj.

Shembulli më i qartë është deformimi që u ka bërë ajo kujtimeve në lidhje me Lasgush Poradecin. Këto shënime janë botuar në organin lokal partiak të Pogradecit, gazeta *"Driloni"* në vitet '80.[113] Këto fakte të "shtrembëruara" i vendos në shkrimin e saj edhe Frida Idrizi.

Ekziston një letër nga Nexhmije Hoxha me titull: "*Nga kujtimet e shokut Enver për Lasgush Poradecin"*. Shënime ditari, datë 2 gusht, 1981. Aty shkruhej: *"U interesova për Lasgushin pranë shokëve të Partisë dhe më thanë se është mirë me shëndet[...] E kam njohur para lufte, kur isha profesor në gjimnazin e Tiranës. Ai ishte i dëshpëruar nga regjimi i Zogut, prandaj preferonte të jetonte i vetmuar. Dikur dilte dhe bashkohej me ne"*.[114]

---

[110] A. Plasari, *Malli në poezinë shqiptare, rumune. "Princ" përballë "Princërve".* (Nga kombëtarja te universalja) për Lasgush Poradecin, në librin: *Don Kishoti zbret në Shqipëri dhe ese të tjera të Letërsisë së Krahasuar*, Tiranë, "Naim Frashëri", 1990. f. 151-159; 211-260.

[111] Y. Çiraku, *Lasgush Poradeci në një vështrim komparatist (Princ përballë princërve). Vdekja e Nositit,* në librin: *Në zbërthim të kodeve letrare*. Tiranë,1990, f. 63-67; 86-88.

[112] Enver Hoxha, *Shënime ditari*, datë 2 gusht, 1981 në "Driloni", organi Komitetit të Partisë të Rrethit Pogradec, 22 dhjetor, 1988.

[113] Po aty, 22 dhjetor, 1982.

[114] Frida Idrizi, Parathënie, në librin Lasgush Poradeci, vepra letrare, Tiranë, 1990, f. 5-38.

Lasgushi i kishte treguar shpërfillshëm Tomi Matos më 1983 për Enver Hoxhën, dy vjet para vdekjes: *"U njohëm në gjimnazin e Tiranës, në vitin 1937. Unë isha 12 vjet më i madh, isha më i shkolluari, kurse Verua erdhi nga Parisi, ashtu "tabula rasa". Kolegët e tallnin*: *"Tutkun", -i thoshin. Të kanë vajtur këmbët e jo koka në Paris*. *T'i shtrydhën trutë putanat...". Mua më vinte keq*. *E shoqëroja, më kupton, më vinte keq ndaj e shoqëroja se të tjerët i ishin larguar*. *Një ditë se ku i kishte gjetur dy librat e mi "Vallja e yjeve" dhe "Ylli i zemrës". Më tha disa vjersha përmendësh prej tyre dhe m'u lut t'i shkruaja diçka me dorën time në libër dhe ai ta kishte si kujtim nga njeriu që iu gjind, kur të tjerët iu larguan*. *Ia shkrojta*. *Ai më përqafoi dhe më ftoi për darkë në shtëpi*. *Tri herë më ftoi, por nuk i vajta"*.[115]

Në vija të përgjithshme, në këtë periudhë kohore, flitet për përkthimet letrare të Lasgush Poradecit, kohë kur ai punoi si përkthyes me normë në shtëpinë botuese "Naim Frashëri" në Tiranë. Përsa u përket përkthimeve të Lasgushit, duket se ato kanë hyrë në lëkurën e tij. Janë realizuar mjeshtërisht. Meritë e përkthyesve mbetet intuita poetike që ata kanë nëpër shqipërime. Te Lasgushi ajo nuk mungon, ndaj njehsohen edhe përkthyesi, edhe krijuesi. Të gjitha vitet shenjojnë një ose e shumta dy përkthime. Vetëm 1984-tra sjell nëntë autorë të përkthyer. Spikasin poemat e mëdha të Majakovskit, Pushkinit dhe Hajnes.

Kjo është lista kronologjike e përkthimeve në vite e L. Poradecit:

1949

Pushkin, Aleksandër Sergeijev. Poezi.[116]

1952

Hygo, Viktor. Pjesë të zgjedhura.[117]

Vapcarov, Nikolla, Ilinden. Poezi.[118]

1954

Majakovski, Vladimir. Poema.[119]

1956

Pushkin, Aleksandër Sergeijev. Poemë.[120]

1957

Heine, Henrish. Poezi.[121]

Lermontov, Mihail. Lirika të zgjedhura.[122]

1958

Makarockina, Nina. Vjersha.[123]

1959

Heine, Henrish. Poema.[124]

---

[115] T. Mato, *Të vërteta e të pathëna për Lasgushi*,. Tiranë, "55", 2006, fq. 51.

[116] A. Sergeijev Pushkin, *Puscinit (4 maj); I. I. Puscinit*, Poezi, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Lirika*, Tiranë, 1949, f. 21-23.

[117] V. Hygo, *Arti dhe populli*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Pjesë të zgjedhura*, Tiranë, "Naim Frashëri", 1952, f. 29-30.

[118] N. Ilinden Vapcarov, *Poezi*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Vjersha të zgjedhura*, Tiranë, 1952, f. 69-70.

[119] V. Majakovski, *Mirë e bukur. Poema e tetorit (1927)*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Mirë e bukur*, Tiranë, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, 1954, -103 f.

[120] A. Sergeijev Pushkin, *Eugjen Onjegini*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Eugjen Onjegini*, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, 1956, -208 f.

[121] H. Heine, *Poezi. Në tri pjesë*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin*: Në tri pjesë*, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, 1957, -199 f.

[122] M. Lermontov, *Lirika të zgjedhura*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Lirika të zgjedhura*, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, 1957, -71 f.

[123] N. Makarockina, *Trëndafili i kuq. Vjersha*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Trëndafili i kuq*, Tiranë, "Naim Frashëri", 1958, -34 f.

1960
Mickiewicz, Adam. Vjersha dhe poema.[125]
1961
Berns, Robert. Vjersha dhe ballada.[126]
1962
Goethe, Johann Wolfgang von. Poezi.[127]
1973
Breht, Bertold. Poezi.[128]
1975
Hygo, Viktor. Poezi.[129]
1978
Këngë popullore rumune.[130]
1981
Heine, Henrish. Poezi.[131]
1983
Eminescu, Miahi. Poezi.[132]
1984
For, Pol. Poezi.[133]
Hygo, Viktor. Poezi.[134]
Kope, Fransua. Poezi.[135]
Labe, Luizë. Poezi.[136]
Noailles, Anna De. Poezi.[137]
D'obinje, Agripa, Stanca. Poezi.[138]

---

[124] H. Heine, *Atta Troll. Gjermania. (Poema)*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Atta Troll. Gjermania*, Tiranë, "Naim Frashëri", 1958, -34 f.
[125] A. Mickiewicz, *Vjersha dhe poema*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, Emil Plumbi, Qevqep Kambo, në librin: *Vjersha dhe poema*, Tiranë, "Naim Frashëri", 1960, -234 f.
[126] R. Berns, *Vjersha dhe ballada*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Vjersha dhe ballada*, Tiranë, "Naim Frashëri", 1961, -199 f.
[127] J. W. von Goethe, *Poezi*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Poezi*, Tiranë, "Naim Frashëri", 1962, -192 f.
[128] B. Breht, *Poezi*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Poezi*, Tiranë, "Naim Frashëri", 1973, -131f.
[129] V. Hygo, *Ndëshkimet*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci dhe Sotir Caci, në librin: *Ndëshkimet*, Tiranë, "Naim Frashëri", 1975; -264 f.
[130] Këngë popullore rumune, *Mjer si ti, obe, obe!; Syth o sythi vocërak; Toma Alimosh*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin*: Këngë të popujve: Poezi popullore të vendeve të ndryshme*, Tiranë, "Naim Frashëri", 1978; f. 38; 76; 77.
[131] H. Heine, *Poezi*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin*: Poezi*, Prishtinë, Rilindja 1981; -403f.
[132] M. Eminescu, *Një artisteje; Të rinjtë e korruptuar; Dëshira; Vetmi; Jeta; O qëndro,* poezi të shqipëruara nga Lasgush Poradeci , në librin: *Vjersha dhe poema të zgjedhura*, Shtëpia botuse "Naim Frashëri" Tiranë, 1983, f. 15; 17; 49; 72; 76; 81.
[133] P. For, *Duhet të duhemi*, Poezi, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Poezi franceze*, Tiranë, 1984, f. 453.
[134] V. Hygo, *Nënshtrimit pasiv*, Poezi, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Poezi franceze*, Tiranë, 1984, f. 272-274.
[135] F. Kope, *Lotët, Poezi*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: Poezi franceze, Tiranë, 1984, f. 384-385.
[136] L. Labe, *Sonete*, Poezi, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Poezi franceze*, Tiranë, 1984, f. 115-116.
[137] A. De Noailles, *Asnjë ditë s'kam menduar*, Poezi, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Poezi franceze*, Tiranë, 1984, f. 456.
[138] A. Stanca D'obinje, *Poezi*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Poezi franceze*, Tiranë, 1984, f. 117-118.

Sharl Le Kont, De Lil. Poezi.[139]
Veraren, Emil. Poezi.[140]
Vis, Teofil De. Poezi.[141]
1988
Goethe, Johann Wolfgagng von. Poezi.[142]

Përfundime:

Dhjetëvjeçari i Shqipërisë së lirë, nga nazifashistët e huaj, 1945-1955, e bën pothuajse inekzistent mendimin kritik për veprën e Lasgush Poradecit.

Në vitin '56 do të kemi një të tillë, më pas luhatje botimesh deri në vitin '67. Në vitet e egërsimit të dikaturës komuniste në Shqipëri, përsëri zërat e shkrimeve apo librave të ndryshëm për veprën e lirikut, do të jenë të pakëta, dy, tre, katër. Në këtë model, bën një përjashtim vetëm, viti 1979, me 9 zëra bibliografikë.

Në vitet '45- '55 heshtja firmos ekzistencën e Lasgushit edhe pse nuk bëhet fjalë për propogandë armiqësore nga rruga e partisë shtet. Prishet ky pakt, me një botim të vitit 1956. Viti 1960 prezanton dy botime. Heshtja pllakos për vitet 1961 deri 1964-ën në Shqipërinë komuniste. Viti 1965 sjell një shkrim kritik. Vitet 1966-1967 nuk sjellin asnjë gjë të re në këtë fushë. Më 1968 ka vetëm katër shkrime kritike. Viti 1969 sjell dy botime kritike. Viti 1970 sjell një shkrim të vetëm. Katër gjithsej, ekzistojnë për vitet 1971- '72.

Stacionime të tjera janë viti '73 me tre artikuj, viti '74 me katër, viti '75 me dy dhe viti '76 po me dy të tillë, viti '77 me tre artikuj, viti '78 me katër artikuj.

Ajo që duhet theksuar, është se Lasgush Poradeci ato vite mbetet gur që rëndon në vendin e tij. Për të ka edhe tetë artikuj të botuar, konkretisht në vitin 1979-të. Në këtë aradhë viti 1980 sjell një tjetër shkrim kritik të botuar për Poradecin, viti '81 sjell dy, viti '82 nuk sjell asgjë të re, viti '83 sjell tre, viti '84 sjell një, viti '85 sjell katër dhe viti '86 sjell vetëm dy syresh. Vdekja e diktatorit Enver Hoxha mundëson katër artikuj të botuar, në vitin 1987-të. Viti 1988-të shenjon tre të tillë, '89-ta vetëm një dhe viti '90 prezanton nëntë artikuj kritikë, një pjesë prej tyre studime letrare dhe artikuj konferencash shkencore.

Periudha 1945-1991 përmbledh rreth 57 shkrime kritike, artikuj apo studime letrare për Lasgushin. Edhe kjo perudhë ka në qendër të vëmendjes së saj emra të afirmuar dhe premtues për kohën. Muzafer Xhaxhiu, Nonda Bulka, Ali Xhiku, Nasho Jorgaqi, Dhimitër Shuteriqi, Ibrahim Rugova, Rexhep Qosja, Rexhep Ismaili, Riza Brahimi, Petraq Kolevica, Ymer Çiraku, Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Sabri Hamiti, Fatos Arapi, Emin Kabashi, Gjergj Zheji, Anton Berisha, Frida Idrizi, Aurel Plasari etj.

Kujtoj se një vend të rëndësishëm në këtë kohë zënë edhe përkthimet e L. Poradecit, të cilat shtojnë numërin e lexuesve të tij.

---

[139] D. L. Sharl le kont, *M*esditë, Poezi, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Poezi franceze*, Tiranë, 1984, f. 361-362.

[140] E. Veraren, *Mulliri*, Poezi, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Poezi franceze*, Tiranë, 1984, f. 398-399.

[141] T. De Vis Vetëtima, Poezi, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Poezi franceze*, Tiranë, 1984, f. 141.

[142] J. Wolfgagng von Goethe, *Poezi, Kushtim; Nata e parë; Kristja; Atërsia e të dashurit; Mbanë lumit; Mall; Lamtumirë; Së zgjedhurës; Tryezë e shtruar; Me një gjerdan të artë; Si i vdekur; Dhëndërri; Surprizë e fuqishme; I vetëgënjyer; Shoqëri; Gjëja më e mirë; Vanitas; Vanitatum, Vanitas!; Këngë ciganësh; Perëndia dhe Bajadera; Këngë vajtimi e gruas fisnike të Hasan Agait; Perëndesha ime; Vizita; Gota; Praku i Lilit; Prabola; Detyra*, shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Vepra të zgjedhura II*, Tiranë, 1988, f. 25; 33-36; 47-50; 56; 59-62; 78-81; 88-89; 92-95; 137-138; 206-210; 339-342; 363-366; 369-373; 400-405; 450-455.

III.4. Receptimi i poezisë së Poradecit, pas '90-tës.

Fundi i diktaturës komuniste dhe ardhja e demokracisë sollën shënime kritike të tjera për autorin, tashmë brenda dhe jashtë kufirit të ish Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë.

Duhet theksuar se në këtë kohë, interesi i kritikës lasgushiane ka qenë i madh në drejtim të jetës dhe veprës letrare të poetit. Interesant është fakti se në këtë periudhë, vazhdojnë të krijohen vargje për L. Poradecin, në formë dedikimesh për poetin, që sfidoi me heshtje diktaturën pesëdhjetëvjeçare të Shqipërisë.

Gjthçka dëshmon se krijuesit vazhdojnë ta adhurojnë poetin e zemrës. Përsëri ata frymëzohen nga vepra e poetit të liqenit. Petrit Ruka shkruan poezinë *"Lasgush Poradeci"*.[143] Fatmir Alimani publikon *"Dita e poetit"* (kushtuar Lasgush Poradecit);[144] Agim Vinca *"Të shkosh në Pogradec"*;[145] Arben Duka *"Lasgush Poradeci"*;[146] Robert Grabocka *"Lasgush Poradecit"*;[147] Luljeta Mimini shkruan *"Mbi varrin e Lasgush Poradecit"*;[148] Radë Dushku vjen me dy krijime *"Kur qesh ti: Vajtim për Lasgushin"*;[149] Zyhdi Morava shpreh adhurim me tre krijime: *"Muzikë e muzgut"*; *"Poetët flenë ndënë dhe"*; *"Te varri i Lasgushit"*;[150] Ligor Luarasi krijon *"Lasgush Poradecit"*;[151] Basri Çapriqi boton *"Lasgush Poradecit"; "Si mund të vdes"*;[152] Niko Kacalidha sjell dy poezi *"Pashë një ditë detin"; "Mirazh dimëror për Lasgushin";*[153] Pano Taçi vjen me cilklin poetik të titulluar: *"Në ç'qiej humbet pulëbardha ime?"*;[154]dhe Ilir Spata me poezinë *"Vdekja e poetit" (Lasgush Poradecit).*[155]

Në gazetën *"Drita"* Ismail Kadare boton një shkrim për Lasgushin.[156] Ndër të tjera aty thuhet se: *"Në njëqindvjetën e tij, ai i është i nevojshëm si rrallëherë Shqipërisë së sotme. Sepse, sot, kjo Shqipëri e përbaltur, e zhytur në mllef dhe grykësi vulgare, më shumë se kurrë ka nevojë për lartësim shpirtëror, për pastërti dhe qiellësi sublime. U mbushëm njëqind vjet që Shqipërisë i lindi poeti idealist që do ta quante veten zog i qiejve"*.

Madje, romani "*Ikja e shtërgut"* botohet edhe në gjuhën frënge, nga shtëpia e tij botuese në Francë, *"Fayard"*[157]. Flurans Ilia shkruan tregimin: "*Zotëria me kone të bardhë"*.[158] dhe Marie Gusho një tregim autobiografik për të atin, me titull: "*Tregim i jetuar kushtuar poetit Lasgush Poradeci"*.[159]

Në dhjetor të vitit 1992, me rastin e ditëlindjes së Lasgushit, i pari që çeli udhën e gjatë të shrimeve rreth poetit pogradecar, është arkitekti Petraq Kolevica me librin e tij *"Lasgushi më ka thënë..."*.

---

[143] P. Ruka, *Mirupafshim hënë e vendlindjes*. Tiranë, "Naim Frashëri", 1990, f. 43-44 .
[144] F. Alimani, *I dashuri i fundit i Deas*. Tiranë, "Naim Frashëri", 1991, f.80.
[145] Botohet në: Gazeta "Nositi", Pogradec, 6 maj, 1996, f. 6.
[146] A. Duka, *E bardha dhe e zeza*, Poezi të zgjedhura, Tiranë, 1997, f. 11.
[147] Botohet në: Gazeta "Nositi", Nr. 92, Pogradec, 25 tetor, 1997, f. 7.
[148] Po aty, Nr. 183, Pogradec, 23-29 nëntor, 2000, f. 4.
[149] Botohet në: "55", -Nr. 17, 22 janar, 2001, f. 1.
[150] Botohet në: "Drita", 18 mars, 2001, f. 6.
[151] Botohet në: "Nositi", -Nr. 217, Pogradec, 22-28 tetor, 2001, f. 6.
[152] Botohet në: "Drita", 12 tetor, 2003, f. 15.
[153] Botohet në: "Spektër", -Nr. 194, maj, 2004, f. 16.
[154] Botohet në: "55", -Nr. 180, 7 korrik, 2005, f. 18-19.
[155] Botohet në: "Nositi", -Nr. 387, Pogradec, 23-31 mars, 2006, f. 13.
[156] Botohet në: "Drita", 26 dhjetor, 2000, f. 10-11.
[157] I. Kadare, *L' Envol du migrateur,* Trad. de l'alban. Jusuf Vrioni, Tedi Papavrami, Paris, "Fayard", 2003. -157f.
[158] F. Ilia, *Zotëria me kone të bardhë,* në gazetën "Nositi", -Nr, 240, Pogradec 8-4 maj, 2002, f. 7.
[159] M. Gusho, *Poeti…*, në gazeta "Drita", 25 dhjetor, 2005, f. 10-11.

Në fokus janë shënimet nga bisedat e tij me Lasgush Poradecin. Lasgushi lindi kur vdiq, shkruan Petraq Kolevica përmes librit me kujtime për poetin e madh. Prej këtij libri Lasgushi do t'ju flasë edhe atyre që nuk e njohën atëherë. Në qendër të botimit janë bisedat e autorit me Lasgush Poradecin në gjallje të tij. Libri përbëhet nga kapitujt: Lasgushi në kujtimet e veta; Lasgushi për artin dhe poezinë; Pranë poetit; Kamadeva; Lasgushi njeri apo Të tjerët për Lasgushin ; *Edhe drita ndriti nd' errësirët edhe errësira nuk e kuptoj*, thuhet në Ungjillin sipas Johanit, citim që i vishet prej Kolevicës, Lasgush Poradecit. Autori hyjnizon prezencën e poetit, që sfidoi netët e territ të komunizmit shqiptar.[160]

Në "luftën e madhe" që shpërtheu pas viteve '90 rreth vlerave dhe antivlerave në letërsinë shqiptare, spikat edhe mendimi i Dritëro Agollit, i cili thekson se asnjëhere vlerat nuk duhen mohuar. *"Është koha, ajo, që shërben si rregulaltor i tyre dhe i vendos ne vend. Dhjetë apo njëqind individë nuk kanë ç'ti bëjnë, nuk e hedhin dot poshtë. Megjithatë as Naimit, as Samiut, as Lasgushit, këtyre tre rrepërve dhe lisave të letërsisë sonë, nuk iu drodh asnjë fletë edhe nga harresa e Faik Beut, jo pastaj t'i lëkundet ndonjë rrënjkëz letërsisë sonë nga ndonjë vickël e atij që banon mes nesh"*.[161]

Sabri Hamiti në dy shkrime sjell interpertime postdiktatoriale për gjuhën dhe kodin e përdoruar nga poeti përballë së vertetës për të demaskuar një regjim të egër totalitar. Poema dorëshkrim e poetit mbetet shëmbëlltyra më e mirë për të përcjellë mesazhe dhe pika takimi realitetesh. Poema për Sokratin duke u shtruar në trajtën e kërkimit të së vërtetës shoqërore dhe duke synuar një funksionalizim shoqëror të kësaj të vërtete është struktuaruar si trajtesë në vargje: ka pikënisjen, kërkimin, argumentin, provën dhe përfundimin. Nga e gjitha kjo përftohet mesazhi tragjik për popullin e mashtruar nga njëra anë dhe nga ana tjetër për flijimin e heroit të dijes, i cili e shpall haptas këtë mashtrim.[162]

Shkrimi tjetër i Hamitit, i kushtohet Ismail Kadaresë. Interpretimet ndahen në katër çështje. Humbja metarotike; Sokrati i Lasgushit; Besim pa fe; Përkujtim; Lasgushi ishte kritikuar si poet i vetmisë personale, i përmbylljeve personale, i mendimeve ezoterike, i spekulaconeve filozofike, nga ana tjetër Lasgushi i rebeluar, i pezmatuar, që kacafytet me realitetin, është i heshtuar.[163]

Në këtë moment nis saga e bashkëqytetarëve të Pogradecit, lidhur me veprën letrare apo kujtime të ndryshme rreth poetit të madh. Miku i Lasgushit, pogradecari Qani Çollaku mendonte të shkruante një libër të titulluar *"Poeti në shtëpi"*, por nuk dimë çfarë shënimesh ka lënë, pasi jeta e tij u ndërpre prej ferrit komunist. Këtë shteg ndër polemikash e çel Meri Lalaj. Përmes një gazete lokale lajmërohet botimi në fjalë që do i kushtohet, Lasgushit. Meri Lalaj në këtë fragment të botuar, sjell një ditar personal. Aty sqarohet dyzimi i ditëlindjes së Lasgushit, arkitektura e kullës së poetit në Pogradec dhe mënyrën sesi ajo qëndronte më këmbë. Botimi hedh dritë mbi dashuarinë platonike të L. Poradecit në moshën pleqërisë me Ana Jovanin apo zonjushën A., prozë poetike, të cilën poeti i titullon *"Vizitat e Z. Ana në kullën time"*.[164] Një vit më pas botohet libri i plotë ditar i M. Lalajit.[165]

---

[160] P. Kolevica, *Lasgushi më ka thënë...* Tiranë, Shtëpia botuse "8 Nëntori", 1992, -139 f.

[161] D. Agolli, *Etiopianët shqiptarë*, në: Revistën "Spektër", 15-27 mars 1992, f. 58.

[162] S. Hamiti, *Feja e diktaturës: Ekskursioni teologjik i Sokratit* (Poemë dorëshkrim), në: "Rlindja, 2 Shtator, 1993, f. 9.

[163] S. Hamiti, *Lasgushi i fundit. Interpretime*, në: Gazeta "Rilindja Demokratike". 30 nëntor 1994, f. 6.

[164]M. Lalaj, *Lasgushi në Pogradec*. Fragment nga libri që autorja ka në proces botimi, në: "Nositi", -Nr. 15, Pogradec, 17 dhjetor, 1994, f. 5.

[165]M. Lalaj, *Lasgushi në Pogradec. Ditar*, në librin: Lalaj Meri. *Lasgushi në Pogradec*, Elbasan, "Onufri", 1995, -176f. , 16 f.il.

Tomi Mato bën pas vdekjes, vlerësimin e figurës së Lasgushit. Evokimi i figurës së tij në radhë të parë është evokim i vlerës së artit krijues. Dritëhijet mbeten një borxh i madh që duhen t'i lahet patjetër poetit si një amanet i çdo kohe, qoftë edhe nga periudha totaliatre.[166]

Kumtesat për Lasgushin mbeten një vlerë e shtuar, për të lartësuar modele të vërtetë, jo të shtirur dhe të lodhur nga koha.[167]

Petro Prifti sjell një vështrim ndryshe nga librat e botuar për krijimtarinë e L. Poradecit. Përmbajtja konsiston në nëntë cikle. Vallja e qiellit-zemra e qiellit; Vallja e përjetësisë-zemra e përjetësisë; Vallja e vdekjes-zemra e vdekjes; Marrëdhëniet e njeriut me fenë; Vallja e dherit-zemra e dherit; Vallja e yjve-zemra e jetës; dhe Për sistemin poetik;

Prifti nënvizon në këtë libër që përpara se t'ia falim këtë poet botës, më parë t'ia falim atë Shqipërisë.

Ateizmi i Lasgushit, sqarion nocionin *"Zot"*, që është një nga çelësat kryesorë për të mos e keqkuptuar poezinë. Prifti ndërton në këtë libër, grafikun e mbretërisë qiellore në poezinë lasgushiane. P. Prifti komenton poezitë: *"Durimi"; "Rri mbështetem në tryezë"; "Zog' i qiejve"; "Ylli"; "Mall i vjershëtorit"; "Gjumi i shpirtit"; "Gjuha e zjarrtë"; "Lënda dhe jeta"; "Fryma dhe qëllimi"; "Ndjenja dhe njeriu"; "Njeriu dhe Zoti"; "Përjetësia"; "Kush ma njohu dhemshurinë"; "Vesa dhe loti"; "Flaka"; "Gjeniu i anijes"; "Lundra dhe flamuri"; "Vdekja e Nositit"; "Zemra e shokut"; "Vajtim mi trupin e shokut"; "Kur qajnë motrat vëllanë"; "Prej çdo gazi e hidhërimi"; "Përqafimi"; "Vrapojnë zemrat"; "Kënga pleqërishte"; "Poradeci"; "Naimit"; "Naim Frashërit"; "Marsh i djalërisë"; "Dremit liqeri"; "Zemra e liqerit"; "Dritë fshetësije"; "Mëngjes"; "Korrik"; "Mbarim vjeshte"; "Dimër"; "Gjahtori"; "E fundit mërzitje", "Bjenë telat"; "Ç'u mbush mali"; "Dita e njëzetetës"; "Maja e çelur"; "Trioleta"; "Ti po vjen që prej së largu"; "Dora jote ledhatarja"; "Posi burbuqe e trëndafilit"; "Lamtumirë", "Më zu një mall"; "Më zu një mall dhe sot"; "U patmë nisur"; "Po të kundroj duke kaluar"; "Gremina"; "Pendimi"; "Ku vemi shpesh"; "Vasha me drapër"; "Valimi i dashurisë"; "Sytë e varfëruar"; "Mbretëria jonë"; "Ah! Me atë mall që më ke ti"; "Ku shtrohet vala"; "Sytë e tu vetëtimtarët"; "Një yll përjetësie"; "Eja, motër"; "Mbretëria e zemrës"; "Vdekja jonë"; "Rri me shëndet"; "Mërgim"; "Të ritë e viteve të mi"; "Kur të më jesh e zemëruar"; "Resurrectio"; "Që larg";* "*Vogëlushja"; "Mall i largë"; "Ti moj shoqe"; "Syr' i fshehur"; "Vesë dashurie"; "Si nuse e re"; "Vashë dhemshurie"; "Para ndarjes..."; "Erë trëndelinë"; "Dashuria udhëtare"; "Je ulur fort"; "Oh, vanë fletët"; "Ç'dëgjoj me sy të trembur"; "Endërr zilitare"; "Dëshirave"; "Kur në flakë"; "Fluturimi"; "Sot u pamë"; "Zemërimi jonë"; "Trashëgimi"; Poemat: "Ekskursioni teologjik i Sokratit"; "Mbi ta"; "Vallja e yjve"; "Kamadeva"; Baladat: "Reshit Çollaku"; "Muharrem Çollaku"*.[168]

Nis ribotimi i shkrimve të Kutelit për L. Poradecin në Kosovë. Shtypi rifreskon memorjen e lexuesve rreth opinioneve te Kutelit në lidhje me veprën letrare të Lasgushit.

Ribotohet pjesa kur Kuteli merret me vjershat e reja të Lasgushit: "*Gremina"; "Engjëjt e parë"; "Durimi"; "Dh'u patmë nisur"; "Vasha me drapër"; "Tërë ditën në shtëpi"; "Faqet e dashurisë"; "O syte e vashës sime"*. Vjershat e reja të Lasgushit

[166]T. Mato, *T'i paguhen borxhet Lasgushit. Kujtime*, në: "Nositi", -Nr. 43, Pogradec, 22 gusht 1995, f. 5.

[167]A. Gusho, *Maji i Lasgushit apo Lasgushi që sfidoi fushatën*, "Nositi", -Nr. 71 Pogradec, 1 maj 1996, f. 1.

[168]P. Prifti, *Rilindja e Lasgushit*, Tiranë, "Toena", 1997, -213 f.

sipas tij, ndahen më dysh: një pjesë të shkruar me tonin madhor të poezisë dhe pjesa tjetër e një inspirate minore, dekadente.[169] *"Bodleri, babai shpirtëror i simbolizmit, zë në poezinë franceze një vend të ngjashëm me atë të Lasgushit në poezinë shqipe. Elementë si gremina apo skëterra, përsëriten dhe janë të dukshëm në krijimet e dy poetëve. Gremina herë shihet si tërësi e vuajtjeve të shpirtit, si zbarzëti që rëndon mbi të, e herë është krimbi i ndarjes brenda mollës së dashurisë, vetë hija e ndarjes që lind para ndarjes"*, -krahason Laura Smaqi.[170]

Në monografinë e Lasgushit, Emin Kabashi e sjell poetin në të gjitha dimnesionet e jetës letare. Libri ka këtë ndërtim: Poetika e jetës. I. 1. Shenjat e kujtimeve të fëmijërisë; I. 2. Shkollimi në atdheun e robëruar; I. 3. Shkollimi në Greqi në shkollën frënge; I. 4. Shkolla e leximit dhe e krijimit; I. 5. Rumania dhe idetë e mëdha të Rilindjes; I. 6. Pasimi i studimit dhe i shkrimit; Poetika e shkrimit. II. 1. Shkrimet për Koloninë Shqiptare të Rumanisë; II. 2. Monografia për Nikoll Naço-Korçën; Një fatos i veteranerisë shqiptare; II. 3. Struktura e poetikës së shkrimit për Naimin; II. 4. Ndjeshmëria romantike e shkrimit për Fishtën; II. 5. Adhurimi për Asdrenin dhe artet e bukura; II. 6. Poetika e Ditarit; Poetika e Poezisë. III. 1. Simbolika e valles dhe poezia; III. 2. Faktura poetike e Këngës pleqërishte; III. 3. Poetika e idealit romantik; III. 4. Simboli kontekstual i përkatësisë; III. 5. Poetika e harmonisë dhe e vizionit; III. 6. Kozmogonia lasgushiane dhe ideali krijues; III. 7. Vizioni poetik i kthimit; III.8. Ideali poetik i vdekjes dhe i përjetësisë III. 9. Lëvizja poetike dhe stili; III. 10 Poetika e foljeve dhe lëvizja poetike; III. 11. Përjetësia poetike dhe dihotomia e dashurisë; III. 12. Vizioni poetik i qetësisë dhe harmonisë;

Studiuesi Kabashi, në botim thekson se poezia e Lasgush Poradecit e ndien veten mirë edhe në raport më studiuesin, edhe me lexuesin. Koha e poezisë së tij, quhet kohë e poetizuar. Poezia e Lasgushit është më shumë sugjerim substil, atmosferë lirike, qoftë ai edhe fluturim kozmogonik, sesa poezi-rrëfim, ku mund të kapesh pas ndonjë rrëfimi. Ajo është më së paku poezi qëllimi, ndaj kërkon shumë kujdes kur flitet për të. Poezia e Lasgushit të ofron mundësinë e bollshme të qasjes, por kur i afrohesh sikur mbyllet më vete dhe nuk e pranon qasjen me paramendim zhveshjen e saj.

Poetika e jetës përmbledh shënime për fëmijërinë, shkollimin e Lasgushit në Shqipëri, Greqi dhe Rumani. Poetika e shkrimit fokusohet te momentet për Koloninë Shqiptare të Rumanisë dhe ato për Nikolla Naçon, Naim Frashërin, Gjergj Fishtën dhe Aleks Stavre Drenovën (Asdrenin). Poetika e poezisë ka në qendër simbolikën e krijimeve, poetikën dhe kozmogoninë si ideal krijues.[171]

Në shkrimet e pas 90-ës gjendet edhe fjala *fir*, e cila hyn në fjalorin tipik lasgushian, fjalë e cila brenda kontekstit letrar tingëllon poetikisht. Në kontekstin gjuhësor mbart kuptimin sinonimik të tretjes apo humbjes në natyre të një vizioni, krijese, peizazhi apo një emocioni poetik. Kjo fjalë vjen me një ngarkesë të madhe emocionale përsa i përket vlerësimit të saj si një e tërë në vargjet poetikë të L. Poradecit.[172]

"Vdekja e Nositit vijon të lexohet në kohë të ndryshme dhe të ketë lexues të ndryshëm të çdo grupmoshe. Kjo poezi mbetet ndër më të rëndësishmet në krijimin e autorit për shkak të mesazheve dhe simbolikës që mbart. Ajo, për autorin cilësohet si një perlë e artit lasgushian. Pikëllimi që përcjell poezia është me përmasa kozmike. Vjersha i

[169] M. Kuteli, *Disa fjalë mbi vjershat e reja të Lasgushit*, në: "Jeta e re", -Nr. 5, Prishtinë, nr. 5, 1995, f. 633-637.

[170] L. Smaqi, *Lasgushi dhe simbolistët europianë*, në librin: *Letërsia si e tillë*, Tiranë, "Toena", 1996, f. 337-340.

[171] Emin Kabashi, *Lasgush Poradeci. Jeta dhe vepra,* në librin: *Lasgush Poradeci. Jeta dhe vepra,* Instituti Albanologjik Prishtinë, Prishtinë, 1997, -252 f.

[172] E. Lafe, *Fir një fjalë Lasgushiane?* Në librin: *Studime*. Prishtinë. -Nr. 3, 1997, f. 319-324.

ngjan një kumbimi sinfonik të kthjellët e paksa të ngadalshëm si në sinfonitë bethoviane.Vjersha është modeluar në një koncept simbolik sikurse edhe krijime të tjera të Lasgush Poradecit".[173] Vetëflijimi i Nositit bëhet në emër të një altruizmi njerëzor, nënvizon profesor Çiraku

Në letërsinë moderne shqiptare, figura e Lasgushit, zë një kapitull të veçantë, por edhe ndër më të rëndësishmit njëherazi. Në librin e Hamitit realizohet një përmbledhje e detajuar e jetës dhe vdekjes së Lasgush Poradecit. Një vend të rëndësishëm zënë veprat letrare të autorit si dhe aparati pedagogjik për zbërthimin e poezive të ndryshme ose poemave të tij të njohura. Sillen detaje poetike edhe përmes vargjesh të konkretizuara.[174]

Sami Krosi reket të shpjegojë filozofinë e poezisë lasgushiane. Funksioni poetik dhe ai filozofik janë pranë njëri-tjetrit, sepse ëndërrohet absolutja, duke sjellë paralelizma letrarë mes tyre. Poezia filozofike e Lasgushit nuk është poezi në kuptimin didaktik të saj, por atë simbolik. Poezia si hapësirë ndodhet pranë filozofisë, sepse të dyja kanë prezencë shpirtërore.[175]

Teksti poetik lasgushian mbetet i pashterur përherë në mesazhe, prezenca e të cilave i provokon lexuesit të të gjitha kohërave ide, asosacone, kënaqësi estetike meditative për natyrën dhe jo vetëm. Leximi me interes edhe sot bëhet për zbërthimin e kodit poetik të poetit duke rritur vlerën e poezive dhe përmbajtjen e tyre.[176]

Gazeta rajonale *"Nositi"*, në Pogradec, vazhdon publikon shkrimet në fokus të të cilave janë jeta dhe vepra letrare e Lasgushit. Faqet e saj kanë qenë inkurajim i rëndësishëm për kritikën letrare, që i kushtohet poetit në tërësi.

Në kuadër të 100-vjetorit të lindjes së Lasgushit, Sabri Hamiti e sjell poetin njëqindvjeçar, përmes kapitujve të një libri: Bukuri temrrisht e dashur; Fjala kosmike; Narcisizi i menduar /Përjetësia, poezi/; Vdekja e Narcisistit; Testamenti poetik. Trashëgimi, poezi/; Kështu thoshte Lasgushi; Poezi et coetera.../ Rreth artikullit të L. P./; Lasgsushi për Naimin; Zbulimi i Sokaratit /Ekskursioni teologjik i Sokratit, poemë në dorëshkrim/; Arti Poetik i Lasgushit; Lasgsush Poradeci (1899-1987); Zgjimi i Naimit.[177]

Vërtetësia dhe njeriu që gëlon brenda saj mbeten pjesë e nëntekstit estetik të shtresave të poezisë lasgushiane. Ky humanizëm ndjehet tek portreti i vashës e trimit dhe jo vetëm, por edhe te prezenca e nënkuptuar e qytezës, fshatit ku merr jetë e gjallon fisi dhe vetë vërtetësia e vendlindjes.[178]

Poezia e pikturës dhe piktura e poezisë njehsohen. Pikturat së brendshmi, tek Lasgushi na shpalosin mrekullitë fabuleske të vetë liqenit, lëvizjen në shtërngatë, urinë botiçeliane të të dashuruarve, sakrificat biblike të pelikanëve që Lasgushi i mbiquan nositë. Murgu iluminist, shpalos vlerë utilitare dhe estetike në rrafshin

---

[173] Y. Çiraku, *Lasgush Poradeci-princi i poezisë sonë.* (Vdekja e Nositit), në librin: *Në zbërthim të kodeve letrare*, Tiranë, 1998, f. 36-67; f. 86-88.

[174] S. Hamiti, *Lasgush Poradeci (1899 - 1987)*, në librin: *Letërsia Moderne Shqiptare*, Prishtinë, 1998, f. 95-116 .

[175] S. Krosi. *Filozofia e jetës në poezinë e Lasgush Poradecit*, në librin: *Filozofia e jetës në poezinë e Lasgush Poradecit,* Shkup, 1998, 156 f.

[176] Eldon Gjika, *Poezia meditative e L. Poradecit në vështrim krahasues, rrafshi i shkëmbimeve*, në: "Perla". - Nr 4, 1998, f. 96-108.

[177] S. Hamiti, *Lasgush Poradeci. Lasgushi qindvjeçar*, në librin: *Lasgushi qindvjeçar*, Prishtinë, "Faik Konica", 1999, -176f.

[178] D. Shapllo, *Mbi thelbin estetik të poezisë së Lasgush Poradecit. Duke kërkuar të vërtetën dhe humanizmin, Tiranë*, 1999, f. 41-45.

mbivlerësues. Në këtë pikëvështrim vetë Poradeci mbetet një pikturë e realizuar mjeshtërisht nga poeti-piktor, thekson Moikom Zeqo.[179]
Një studim vlerësues, vjen nga Kujtim Shala. Ai e sjell Lasgushin e përjetshëm përmes një studimi kritik duke e parë veprën si një lexim aventurë.
Përmbajtja: KËRCËNIMI I POETIT. I. Identifikime dhe karakterizime; II. Kërcënimi i poetit; III. Poeti i mbyllur; IV. Shtërgu i fundit; V. Kush e kujton poetin; LASGUSHI I PERJETSHEM. I. Magjia e ikjes. (Poezia Mbarim vjeshte); ARTI I POEZISE ; Të gjthë kapitujt e librit sjellin një konceptim për përjetësinë e Lasgushit dhe paradigmën e pavdekësisë mes veprës poetike.[180]
Ndjenja e mallit tek Asdreni, Poradeci, Kuteli është punimi studimor i L. Topçiut. Të tre shkrimtarët kanë kaluar një pjesë të mirë të jetës në Rumani, vend ku kanë shkruar në shqip dhe ku kanë realizuar veprat më të rëndësishme, në kuadrin e krijimtarisë, si letërsi kombëtare, së cilës i përkasin. Autori, Luan Topçiu, është i mendimit se "malli te këta shkrimtarë vështrohet si një ndjenjë e shkaktuar nga migrimi nga njëra anë, nga ana tjetër si produkt i kontaktit me letërsinë rumune, në mënyrë të posaçme me atë poetike, ku *"DORI (malli) gëzon një status të privilegjuar, veçanërisht në letërsinë orale. Malli - fjalë, vizion mbi jetën./ Malli - mungesa, udha./ Mall - vuajtje, sëmundje, përgjim./ Malli tjetërsimi (Në vendim tim jam vetë i huaj)./ Malli - Fillesë, thirrje./ Malli - si lëndë, (zjarr dhe ujë)./ Malli lasgushian dhe poezia rumune"*.[181]
Dashuria në krijimet e fundit të poetit alternohet njëlloj si në rini me bukurinë, fshehtësinë dhe lektisjen. Në to thellësia mbetet e njëjtë dhe vrulli është i përmbajtur, i zhytyr në filozofinë panteiste, së cilës i mungon hapësira. Megjithatë, dashuria lasgushiane përvijohet në fytyrën e Kamadevës, si një zjarr që digjet i qetë.[182]
Petro Prifti një tjetër shkrim, për ilustrim merr shembull poemën *"Ekskursioni teologjik i Sokratit"*. Ndërkaq autori u jep përgjigje Nonda Bulkës dhe Frida Idrizit rreth ateizmit të Lasgushit.[183]
Në këtë periudhë vitesh krahas Sabri Hamitit, Lijana Verdho na sjell perpjekjen e parë serioze në Shqipëri për hartimin e një bibliografie për Lasgush Poradecin. Eshtë e para bibliografi e pjesshme për Lasgushin. Materiali është vjelë nga bibliografia retrospektive e artikujve në periodikun shqip, nga Bibliografia Kombëtare e Librit Shqip, ku janë shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme bibliografike që ndodhen në Bibliotekën Kombëtare, Tiranë. Autorja thekson se bibliografia e saj do të vijojë në numra të tjerë të "*Studime Filologjike"*, por kjo nuk ndodh.[184]
Letërkëmbimi i poetit me shumë personalitete të hershme të viteve '30, mbetet një shkollë më vete komunikimi. Ndërsa zbulojmë madhështinë e poetit, përmes këtij bashkëbidedimi shkrimor, zbulojmë dertet e një njeriu shëndetlig dhe të zgjuar, i cili jo vetëm shkollohet jashtë vendit shkëlqyeshëm, por edhe shqetësohet për hallet e atdheut të drobitur.[185]

---

[179] M. Zeqo, *Poradeci - Murgu iluminist i liqenit, n*ë: "Gazeta shqiptare", 28 dhjetor, 1999, f. 12-13.
[180] Kujtim. Shala, *Lasgushi i përjetshëm: Një lexim aventurë*, Prishtinë, "Faik Konica", 1999, -124f.
[181] L. Topçiu, *Ndjenja e mallit tek Asdreni, Poradeci, Kuteli*. Një botim dy gjuhësh: Rumanisht-Shqip, Bukuresht, 1999, f. 179-182; 205-230.
[182] P. Prifti, *Dashuria e ka Princin e saj, Lasgush Poradecin*, në: "Nositi", -Nr. 108, Pogradec, 17 janar, 1999, f. 9.
[183] P. Prifti, *Ateizmi i Lasgushit dhe simbolika e tij fetare*, në: "Nositi", -Nr. 130; 131; 132, Pogradec, 18 korrik; 25 korrik; 1 gusht; 1999, f. 9.
[184] L. Verdho, *Bibliografi e pjesëshme për jetën dhe veprën e Lasgush Poradecit*, në: "Studime filologjike", -Nr. 3-4, 1999, f. 181-212.
[185] A. Brahaj, *Letrat dhe dertet e Lasgushit... ç'mund të zbulosh në letërkëmbimin lasgushian?*, në: "Spektër", -Nr. 50, 27 nëntor, 1999, f. 3, 31.

Kuteli dhe Çabej mbeten dy shtylla të forta që kanë shfaqur dhe më pas formësuar më së miri konteksin letrar përballë specializantësh në vite. Këto sprova kritike ribotohen vazhdimisht dhe mbartin vlera të rëndësishme jetësore. *"Dhe po të këndohet Lasgushi me dashurinë, do të vërtetohet thellësia e tij e pashoqe, në mos sot, nga brezat që do të vijnë. Po moskuptimi i lehtë, errësira e disa vjershave të tija, nuk është një e metë përkundrazi, një elememnt i gjithë shkrimeve të thella në botë, që prej poemave indiane e, nëpër Kuranin, gjer më sot. Fundi i fundit, çdo thellësi është e errët. Dhe faji s'është aq i gjeniut sa i publikut mendje shkurtë"*. Një ditë Shqipëria do t'ia falë njëherë botës këtë talent të madh letrar, nënvizon në këtë shkrim Çabej.[186]

Profesor Petrotta thotë për Lasgushin se *"ky i bën vjershat me një lehtësi të jashtëzakonshme dhe se poeti ynë prodhon me një nxitim të madh e cila e dëmton artin. Sipas tij poezia e L. Poradecit nuk duhet të gjykohet si ajo e disa poetëve të tjerë, të cilët kanë prekur kulmin e artit të tyre, se ky ka kohë t'u qaset këtyre"*.[187]

Një shkrim lajmëron për daljen në dritë të prozës poetike të Lasgushit me titull *"Vizitat e Zj. Ana në kullën time"*. Ditari intim i poetit në qendër ka dashurinë platonike të Lasgushit me një mësuese në Pogradec me emrin Ana si dhe flet për dashurinë e parë të poetit, piktoren e adhuruar prej tij Androniqi Xengon (Niqka).[188]

Anonimati vijon të përshfaqë pesë tituj shkrimesh në gazetën lokale *"Nositi"* të qytetit të Pogradecit.

Në Prishtinë mbahet simpozium shkencor për L. Poradecin i organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë. Në qendër është poeti lirik dhe vepra e tij poetike.[189]

Studiuesi Kristaq Jorgo, sjell në këto vite një parathënie për shkrimin: "*Lirika e Naim Frashërit, nga Lasgush Poradeci"*. Sipas tij, *"...parafjala e librit përbën të parën qasje tekstologjike mbi veprën e Naim Frashërit. Ajo ka trajtën e një studimi të mirëfilltë që e kapërcen së tepërmi tipin e shënimeve mbi kriteret e botimit të përgatitur. Përsa i përket mosbotimit të veprës, arsyet nuk i dimë, -thotë Jorgo. Ato duhet të kenë lidhje me praktikën kulturore të pasvitit 1946-të"*.[190]

Në Shkup të Maqedonisë kemi shkrimin kritik të radhës. Njeriu dhe vlera e tij humane janë boshti në të cilin lëvrohet poezia e Lasgushit. Kjo epiqendër njehsohet me figurën e vashës dhe trimit, por edhe të personaliteteve letrare dhe historike të kombit tonë. Kjo mënyrë të krijuari e bën Lasgushin të mbetet delikat në vargjet e tij, kur njeriu gjendet në situatat jetike të ekzistencës.[191]

Botimi studimor *"Tekstualizëm dhe stil"* përmban tetë kapituj. Luan Topçiu risjell interpretime të poetikës lasgushiane. Libri ndahet në tetë kapituj. I. Poezia, vlera, interpretimi. II. Karakteri sistemor e strukturor i veprës. (Simbolika e shenjave të sistemit; Sistemi dhe përkatësia tekstuale). III. Poezia filozofike dhe filozofia si poezi. (Vështrim hermeneutik mbi poezinë filozofike). IV. Paradigma e pulsioneve të jetës. (Karakteri onirik i poemës; Heshtja dhe muzika). V. Vizioni poetik i vdekjes. VI. Poeti dhe piktura. (Leksematika piktorale; Pastelet dhe atmosfera). VII. Paradigma e mallit. (Malli – fjalë vizion mbi jetën). VIII. Vlera stilistike e fjalës. (Vlera stilistike e

---

[186] E. Çabej, *Mbi poezinë e Lasgush Poradecit. Studim*, në: "Drita", -Nr. 26, dhjetor, 1999, f. 3.

[187] M. Kuteli, *"Vallja e përjetësisë" dhe "Zemra e Përjetësisë". Lasgush Poradeci "Ylli i zemrës"*, Në: "Drita", 26 dhjetor, 1999, f. 5.

[188] F. Morava, *Kur dashuronte Lasgushi. Del në dritë ditari intim i poetit Lasgush Poradeci*, në: Klan, -Nr. 49, 12 dhjetor, 1999, f. 30-34.

[189] Xh. Hajredini, *Vjershëtor i dashurisë dhe bukurisë. Simpoziumi i 100 vjetorit të Lasgush Poradecit në Prishtinë,* në: "Nositi", -Nr. 148, Pogradec, 28 nëntor - 4dhjetor, 1999, f. 10.

[190] K. Jorgo, *Parathënie për lirikat e Naim Frashërit*, në: "Studime filologjike", -Nr. 1 - 2, 1999, f. 175.

[191] Anonim, *Njeriu - epiqendër në poezinë e Lasgush Poradecit.* Vështrim, në: Flaka, Shkup, 17 qershor, 2000, f. 15.

fjalës; Polivalenca kuptimore; Variantet fonetike dytësore-mjet shprehimsie; Kompozitat). Studimi ka karakter vlerësues.[192]

Rrëfenjat për L. Poradecin shndërrohen në modë. Kjo e dukshme më së shumti tek autorët që vinin nga qyteti i Poradecit. Në rrëfenjat e tij Tomi Mato përpiqet të zbulojë disa kënde të errëta, të panjohura të karakterit, krenarisë dhe vuajtjeve të Lasgushit. Përmes fjalës, dialogut, krijon atmosferën e vendit, kohës dhe romantikën e ambientit. Në to përveçohen figura bashkëqytetarësh që e kanë njohur ose kanë qenë miq të lirikut, por edhe njerëz me pushtet, pjesë e regjimit të atëhershëm komunist. (Tirkë Shqiptari, Dhimitër Pasko, Behar Shtylla, Thoma Angjele, Shefki Sadiku, Sotir Koci (Çiçua), gjermani Gutner) etj.[193]

Hysen Matoshi, reflekton se Lasgushi mund të jetë pjesë e kontekstit të poezisë evropiane. Më së shumti nënvizon atë që kishte paralajmëruar prej kohësh Çabeji i madh. Sipas tij, më parë duhet të ekzistojnë përkthime të arrira, që edhe bota e huaj të shijojnë Lasgush Poradecin. Poezia e Poradecit flet shqip dhe bukurtingëllon, ndaj në këtë kontekst edhe falë një përkthimi të mirë, lirikat e Lasgushit mund t'i shijojë edhe Evropa.[194]

Veprat 2 dhe 3 , botime speciale të shtëpisë botuese *"Onufri"*, sjellin një Lasgush të zhveshur intelektualisht, poetikisht, duke shpalosur edhe botën intime të tij. Publicistika lasgushiane e botuar në shtypin e kohës mbetet brilante dhe mjeshtërore sikurse atëherë edhe tani. Ndërsa ditarët dhe korrespondencat e dashurisë personale, prezantojnë një shpirt të butë, të bukur dhe të talentuar, në artin poetik. Më së shumti botimet treguan që Lasgushi ende pëlqehet në treg nga lexuesit e postkomunizmit.[195]

Në shënimet e tij për librin e Kolevicës, Anton Berisha i ngre madhështi artit të Lasgushit. Ky libër është i sinqertë dhe tepër i thjeshtë në kompozicionin e tij, sepse si edhe thotë Kolevica, shkrova si më tha Lasgushi dhe çfarë thonë të tjerët për Lasgushin. Këto mund t'ju ndihmojnë të ndërtoni në imagjinatën tuaj figurën e Lasgushit dhe një variant të biografisë së tij.[196]

Shkrimet e kësaj periudhe mbeten ndjeshmëri qytetare, nënkupto lexuesish. Njëqindvjetori i poetit festohet në Kosovë. Lasgushi gjithmonë ka shkruar dhe folur për Kosovën. Një ndër postulatet e tij më madhorë që theksohen në shkrim është: *"Jugosllavia nuk mund të jetojë kurrë si shtet, sepse është ashtu me copa. Shtet mozaik: kroatët, sllovenët, malazezët, maqedonasit... Serbi ka qenë dhe do të mbetet armiku i përjetshëm i shqiptarëve"*.[197]

Muzafer Xhaxhiu i qëndron tezës së mos spekulimit me gjenialitetin e poetit të madh shqiptar. Ribotimet e vepërs së tij letrare pas çlirimit të vendit, për Xhaxhiun, mbeten një vlerë për tekstin e parë, si pjesë e analizës filologjike. Vlerat e Lasgushit dihen

---

[192] L. Topçiu, *Tekstualizëm dhe stil. Studim mbi veprën poetike të Lasgush Poradecit,* "Getic", Bukuresht, Rumani, 2000, -223f.

[193] T. Mato, *Të vërteta e të pathëna për Lasgush Poradecin,* Tiranë, Gazeta "55', 2000, -208f.

[194] H. Matoshi, *Poezia e Lasgush Poradecit në kontekstin e poezisë evropiane. (Inst. Albanologjik i Prishtinës),* Prishtinë, 2000. -195 f.

[195] A. Jakllari, *Lasgushi i vetëzbuluar: Lasgush Poradeci.* Veprat 2 dhe 3, në: Universi Shqiptar i Librit, -Nr. 1, 2000, f. 14-15.

[196] A. N. Berisha, *Përligjie e madhështisë së artit dhe personalitetit të Lasgushit: Shënime për librin "Lasgushi më ka thenë" të Petraq Kolevicës,* në: "Albania", -Nr. 96, 26 prill, 2000, f. 10.

[197] B. Asllani, *Lasgush Poradeci për Kosovën:* (Kumtesë e lexuar në simpoziumin shkencor mbajtur më 26-27 dhjetor 1999 në Pogradec në shënimin e 100 vjetorit të lindjes së Lasgush Poradecit), në: "Flaka", -Nr. 6410, 10 janar, 2000, f. 11.

dhe nuk duhen fryrë së tepërmi. Nga mënyra e të kënduarit shqip, vjershat e Lasgushit janë të matura me folkun popullor.[198]
Kujtim M. Shala i kushton vëmendje një vjershe të vetme, asaj me titull *"Mbarim vjeshte"* ndërsa bën përqasjen e gjithë veprës poetike të Poradecit. Poezia ka në qendër të saj një *çoçër* (zog) të vogël. Të gjithë që e lexojnë atë, sipas autorit, e quajnë mrekulli poetike. Zotëriut që i la folezën një vit më parë i troket te porta e shtëpisë. Shkathtësia e tij si zog është e papërfytyrueshme. Kjo poezi në vetvete sjell prezencën e zogut në fluturim.[199]
Një shkrim i hershëm i Kutelit, ribotohet si dëshmi e punës këmbëngulëse për të promovuar një poet. Para se të botohej *"Vallja e yjve"* një pjesë e vjerashave të L. Poradecit ishin të përhapura në fletore të ndryshme të mërgimit, kurse pjesa tjetër dergjej në dorëshkrime pa parë dritën e shtypit. *"Shoqëria e Studentëve Shqiptarë në Rumani"* dhe Miqtë Letrarë të Bukureshtit kuptuan edhe përkrahën këtë iniciativë duke na dhënë mjetet lëndore të nevojshme. Kësisoj mundi të dalë në dritë më 1933, libri *"Vallja e yjve"*. Por sikurse do shihet në kapitullin pasardhës të këtij punimi, botimi i librit ishte financim personal i Kutelit, lexuesit të parë të krijimtarisë së tij poetike.[200] Shkrimi vijon me pjesën e dytë të tij. Vetë njeriu si epiqendër vargjesh, njehsohet me figurën e vashës dhe trimit, por edhe të personaliteteve letarë dhe historikë të kombit tonë. Kjo mënyrë të krijuari e bën Lasgushin të mbetet delikat në vargjet e tij ku njeriu gjendet në situat e ekzistencës.[201]
Dikush tjetër e prezanton poetin poradecar, si një poet të madh nacional. Ky pohim është edhe më i besueshëm përballë artit poetik të Lasgushit. Poezitë e tij janë tepër të ndiera dhe kanë shumë nerv peizazhi ndër vete, thuhet në shkrim. Testamenti poetik i këtij mjeshtri qëndron edhe te motivet që ai trajton në poezinë e tij.[202]
Piktura mbetet poezia e ngrirë e Lasgushit. Mijëra piktorë kanë ilustruar biblën e shenjtë. Një poet është piktor, edhe nëse nuk bën kurrë pikturë. Megjathatë Lasgushi guxon dhe na jep një pikturë të liqerit të tij të dashur në vargje. Poezitë e tij kanë fjalë të pavdekshme që ftillëzojnë imazhe të pabesushme. Pikturat e brendshme te Lasgushi na shpalosin mrekullitë fabuleske të liqenit.[203]
Anila Logu sjell një vështrim mbresëlënës në trajtesën e saj duke u nisur nga përcaktimi simbolik që Kadare i ka bërë Lasgushit. Në kujtim të tij dritësohet një figurë madhështore përmes artit poetik. Zogu i qiejve është përjetësuar definitivisht në republikën e letrave shqipe dhe mbart në vete mjaft sharm bardi të vërtetë. Madhështia e veprës poetike lasgushiane nuk zbehet, por rrit vezullimin e saj.[204]
Studiuesja Dhurata Shehri, përmes një këndvështrimini trajton çështje të strukturës në poezinë e Lasgushit. Poezia, vjen e strukturuar dhe bëhet një krijim delikat që mban firmën Poradeci. Ky moment analizohet për formën e vargut dhe figuracionit në të.

---

[198] M. Xhaxhiu, *Mos spekuloni me gjenialitetin e Lasgushit: Ribotimet e veprës së Lasgush Poradecit në Shqipëri pas Çlirimit,* në: Koha jonë, -Nr. 35, 13 shkurt, 2000, f. 23.
[199] K. M. Shala, *Lasgushi i përjetshëm. Lirika "Mbarim vjeshte",* Në: "Albania", -Nr. 188, 12 gusht, 2000, f. 10.
[200] M. Kuteli, *Kur Kuteli "hiqet mbramesh" për të botuar Lasgush Poradecin. "Lasgushi i vetëmi poet shqiptar që mendon, flet e shkruan vetëm shqip",* në: "Albania", -Nr. 16, 12 janar, 2000, f. 10.
[201] S. Krosi, *Njeriu-epiqendër në poezinë e Lasgush Poradecit*. Vështrim, në: "Flaka", -Nr. 6544, 18 qershor, 2000, f. 15.
[202] I. Costante Fortino, *Lasgush Poradeci, poeta nazionale. In margine ad alcuni giudizi di Mitrush Kuteli*: Nel centenario della nascita, në: "Katundi ynë", -Nr. 1, 2000, f. 18-19.
[203] M. Zeqo, *Lasgushi pas vargjeve nxjerr Liqenin pikturë. Gravurat e Lasgush Poradecit,* në: "Gazeta shqiptare", -Nr. 1517, 17mars, 2000, f. 12-13.
[204] A. Logu, "*Kadare: Poradeci, Zogu i qiejve. In memoriam në 101- vjetorin e lindjes së lirikut të madh shqiptar,* në "Koha jonë", -Nr. 307, 27 dhjetor, 2000, f. 21.

Një kombinim përfekt mes tyre e bën atë të zhdërvjellët, rimuese dhe meditative. Struktura shndërrohet në një thellësi mendimi dhe shpjegon teknikat që shkruhet poezia.[205]

Lasgush Poradeci dhe kultura shqiptare vijnë përmes artikullit të kritikut kosovar Emin Kabashi. Ai apelon se ende nuk është kompletuar as trashëgimia e tij poetike, as ajo shkrimore, as ajo studimore. *"Studimi i mirëfilltë i një krijuesi... kërkon të njihet dhe të vihet në qarkullim shkencor gjithë trashëgimi i tij"*.[206]

Profesor Jani Thomai ndalon gjatë në strukturën semantiko-leksikore të poezisë lasgushiane. Semantika leksikore shndërrohet vetiu në sematikë poetike, -vëren ai. Fjalët e rikrijuara me rrënjë treshe dhe dyshe përvijojnë nocione leksikore të reja. Ligjërimi i poetit vjen i qetë dhe i strukturuar në vargun e tij. Fjalori tipik lasgushian nis me fjalët kyç të ekzistencës së tij, sikurse janë liqeri, Poradeci apo dashurorja e përzemërt *"Komponentja semantike vetjake në strukturën linguistiko-estetike të krijimtarisë poetike të Lasgush Poradecit është shumë më e gjerë dhe shumë më e larmishme se te Naim Frashëri"*.[207]

Risillet në vëmendje të lexuesve punimi i hershëm i Lasgush Poradecit *"Poezia e Naim Frashërit"*. Njohuritë e Lasgushit për tekstin e veprës së Naimit jepen në një nivel mahnitës. Përmes tij L. Poradeci dëshmon se ka njohuri për stilin, për veçoritë dialektore, për sintaksën, për ortografinë, për grafinë e kështu e me radhë..., që zakonisht u mungojnë studimeve tona.[208] Analizohet krijimtaria e Poradecit në krijimet e tij për Naimin. Recensioni poetik ka në qendër njohjen me kushtet historike kur jetoi dhe punoi Naimi. Strofa e parë e poemës në formë perifraze na sjell ndërmend veprën *"Qerbelaja"* të Naimit, vargu i tretë vepërn *"Histori e Skëndërbeut"* dhe dhe vargu i katërt poemën *"Bagëti e bujqësia"*. Estetika e re poetike endet përmes figurash të ndryshme letrare, të cilat i japin një sharm patriotik.[209]

Studiuesi Jorgo Bulo vë përballë dy kolosë të letrave shqipe. Njëherazi marrim informacion rreth ndërlidhjes shpirtërore të poetëve dhe lexuesve bektashinj të poetëve. Madje zbulohet kjo lloj lidhje shpirtërore për të lexuar Lasgushin. Ndërsa Naimi lëvroi fjalën e shkruar dhe krijoi modelin e shqipes moderne, Lasgushi do ta rikthejnë në model krijues vlerën letrare te bilbilit të shqipes. Bulo përjetëson këtë moment në dy krijimet e Lasgushit për figurën e Naim Frashërit. Në këtë përballje vlera patriotike kalon evokimin dhe e adhuron figurën e bilbilit të shqipes. Trashëgimi naimian jeton një jetë të re në poezinë e Lasgushit. *"Naimi dhe Lasgushi janë dy reformatorë të mëdhenj të poezisë shqipe, duke u dhënë, po të shprehemi me fjalët e Lasgushit, dhe privilegjin të mos jetojnë jetën e tyre të vdekur, por jetën e pavdekur të Kombit të vet dhe të shpirtit të tij"*.[210] Lasgushi ishte njohës i mirë i folklorit në përgjithësi dhe në veçanti i atij të zonës përreth Pogradecit. Brenda këtij kodi poetik ai u mbështet dhe rikrijoi fuqishëm një pjesëz të poezive të tij. Modeli poetik popullor mbetet një shembull i drejtpërdrejtë i këtij frymëzimi që josh dhe mrekullon përmes

---

[205] Dh. Shehri, *Çështje të strukturës në poezinë e Lasgush Poradecit*, në: "Aleph", -Nr. 9, 2000, f. 278-282.

[206] E. Kabashi, *Lasgush Poradeci dhe kultura shqiptare*, në: "Studime filologjike", -Nr. 1 - 2, 2000, f. 5-14.

[207] J. Thomai, *Ligjërimi Lasgushian: Semantikë leksikore e semantikë poetike*, në: "Studime filologjike", -Nr. 1 - 2, 2000, f. 71-77.

[208] E. Kabashi, *Një studim i panjohur i Lasgush Poradecit për poezinë e Naim Frashërit. Akribia e poetikës së shkrimit filologjik*, në: "Stil '97", -Nr. 4, dhjetor, 1998, Shkup, f. 97-100.

[209] N. Paleka, *Poema Naim Frashërit; Integrimi i një estetike të re: Reçension për poemën e Lasgush Poradecit*, në: "Drita", 26 dhjetor, 1999, f. 2, 4.

[210] J. Bulo, *Lasgushi dhe Naim Frashëri*, në: "Studime filologjike", -Nr. 1 - 2, 2000, f. 65-69.

vargjesh, duke e bërë poezinë e Lasgushit me më shumë poetikë popullore se ç'mund ajo të ketë. *"...sipas mendimit tim, është i varur nga zgjidhja që do t'i jepet problemit të riperiodizimit të letërsisë shqipe, prej fillimeve deri në fund të shekullit të 20-të, që tani qëndron rreptë si kërkesë para historiografisë letrare shqiptare"*.[211]
Përkujdesi dhe madhështia e Lasgushit për veprën e Naimit ndihet edhe sot nga puna e palodhur e titanike që ka bërë poeti pogradecar në gjallje të tij. Lasgushi e kishte bërë gati botimin e vepërs së Naimit. Edhe termin botim kritik, edhe termin botim kriteri duket se Lasgushi nuk i ndan dot nga njëri-tjetri, sepse poeti është shumë afër tyre.[212]
Një punim interesant vjen nga profesore Floresha Dado, e cila shpalos krijimtarinë e Lasgush Poradecit në planin teorik dhe kritik jo vetëm të poezisë, por edhe të muzikës dhe pikturës. Vlerat e poezisë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ato të teorisë së artit kanë një nyjë të përbashkët në themel, atë të talentit dhe potencialit artistik krijues. *"Personaliteti i tij është mpleksja e vetëdijes me subkoshiencën, e logjikës së thellë me intuitën dhe me ndjenjën e përmbajtur, të cilat ngacmojnë njëra-tjetrën, për të dalë në plan të parë herë njëra në poezi, e herë tjetra në kritikë ose në trajtesë teorike"*.[213]
Me lirizmin e tij Lasgushi krijoi pjesë të fjalorit poetik të shqipes, një shtresë të re stilistike. Pra, ngriti në poezi përditshmërinë dhe fjalët e saj, por edhe u përpoq të krijonte fjalor personal. Puna e Lasgushit nuk është thjesht një gjuhë letrare. Puna e tij është poezi e ndërtuar mjeshtërisht. *"Në lirikën e Lasgushit ndryshohen trajtat morfologjike, shndërrohen fjalët fonetikisht, neologjizmat zgjerohen e shtrihen, ndërtimet sintaksore përngjiten e shkrihen, kuptimet mjegullohen dhe të gjitah bashkë njehsohen për t'ia lënë vendin një mbretëreshe*: *harmonisë. Magjia e ligjërimit të Lasgushit është një magji me gjithë shqipen për ta bërë atë të tingëllojë e ëmbël, e rrjedhshme, delikate, elegante".*[214] Malli rrezikon të mbetet i paplotë në këtë hapësirë aq më tepër kur kemi të bëjmë me një ndjenjë kaq komplekse, ndjenjën e vetmisë plot nostalgji që përfshin kuptime të ndryshme drejt vendesh apo qeniesh të dashura. Kështu thellësia shpirtërore e Lasgushit shndërrohet në lirizëm të thellë.[215]
Komentet e poezive mbeten shembuj interesantë. Përmes një simbioze faktike bëhet komenti i poezive dhe shpjegohet fjalori i tyre. Nositi bën vetëflijimin e tij, për të ushqyer zogjtë e vegjël. Gjatë gjithë kohës flet nositi i personifikuar. Poezia është e mbushur me antiteza ekstremisht te bukura. Nositi flet dhe mbijeton nëpër kohëra në emër të mbijetesës së tij së idealit: të vdesësh për të mbijetuar.[216]
Sabri Hamiti përmes një kapitulli të vetin vëren se poeti cilësohet si pjesë e modernitetit të letërsisë shqipe. Për tetë dekada të jetës ai, Lasgush Poradeci ishte vetëm poet. Ai është shembulli i krijuesit modern shqiptar. Lasgushi krijoi poetikën e tij origjinale që shfaqet me bukurinë llaftare të vetënjohjes për të arritur përsosmërinë

[211] Sh. Sinani, *Lasgush Poradeci dhe kodi poetik popullor*, në: "Studime filologjike", -Nr. 1 - 2, 2000, f. 47-63.
[212] B. Vila, *L. Poradeci në dilemën midis një "botimi kritik" dhe një "botim kriteri" të veprës së Naim Frashërit,* në: "Perla", -Nr. 1-2, 2002, f. 50-53.
[213] F. Dado, *Lasgushi midis poezisë dhe teorisë së artit,* në: "Studime filologjike", -Nr. 1 - 2, 2000, f. 37-46.
[214] Xh. Lloshi, *Lirizmi i lirikut Lasgush*, në: "Studime filologjike", -Nr. 1 - 2, 2000, f. 15-35.
[215] T. Plangarica, *Malli në hapësirën poetike lasgushiane,* në: Buletini shkencor "UNIEL", -Nr. 2, 2000, f. 47-55.
[216] N. Lushaj, *Lasgush Poradeci. Vdekja e Nositit,* në librin: *Komenti midis artit dhe shkencës,* Shtëpia botuese "Alba-ss", Tiranë 2000, f. 186-193.

dhe përjetësinë. Tema themelore e krijimeve të tij është dashuria që ai e ndien dhe e kupton si një fuqi të pashtershme.[217]

"Gjithmonë, sipas Sabri Hamitit ideologjia e censurës së poezisë është gjithnjë dinake. Lasgushi është kritikuar si poet i vetmisë personale, nga ana tjetër Lasgushi vjen i rebeluar, pezmatuar dhe i heshtur. Me figurën morale të Sokratit ai sjell sprovën vetanake të kërkimit të së vërtetës. Poema është një hakmarrje kundër diktaturës, e cila pretendonte se poeti kishte heshtur".[218]

Këndvështrimi hermeneutik i Luan Topçiut nxjerr në pah filozofinë poetike të Lasgushit. Në qendër të vështrimit, qëndron poezia filozofike e poetit. Identifikimi i poezisë me filozofinë të çon tek poezia filozofike dhe identifikimi i filozofisë me poezinë të çon tek filozofia si poezi. Poezia kërkon të përmbushë një funksion filozofik, filozofia një formulë poetike apo, duke mbajtur secila funksionin, i huajnë reciprokisht mjetet. Poezia e Poradecit mbetet një poezi me përmbajtje të thellë filozofike, ndërsa ruan në thelb funksionin lirik. Disa çështje të trajtura në këtë libër janë: Deshifrimi i nyjave: Vallja, zemra - e përjetësisë. Lënda dhe jeta-Një vizion dihotomik. Fryma dhe qëllimi-Hallkë korrelative. Ndjenja dhe njeriu-Homo duplex. Njeriu dhe Zoti, zemra në njohjen e absolutit. Përjetësia (1), Një vizion Panteist. Përjetësia (2), Vizion në kronotop. Zot krijues-Poet krijues. Fjala *Zot* del me më shumë kuptime në këtë vepër, përpos kuptimit religjioz, ajo fiton kuptim polisemantik: herë si objekt referimi, si përqëndrim maksimal i qenies, herë si pushtet, si gjakim drejt absolutes, herë si synimi themelor i njohjes ontologjike. Zoti njehsohet shpesh me gjithësinë, me çdo gjë që shihet, perceptohet apo paramendohet. Zoti, sipas tij, është thelbi i përgjithshëm dhe i përjetshëm i gjithësisë. Zoti lasgushian është paskaj në pikëpamje të hapësirës dhe të kohës. Ai është lënda dhe shpirti i përgjithësuar, një përgjithësim i botës së sendeve dhe ideve.[219]

Shkrimi i Krist Malokit vijon të mbetet dëshmi kritike për poezinë e poetit teuton. Ai e pranon aftësinë analitike të Kutelit, po konstaimet e tij, jo. Maloki veçon: *"Po koloriti nuk përqëndrohet vetëm në karakterizimin e një vepre artistike simbas një vendi gjeografik; jo, edhe situacione të veçanta sociale, personale e shpirtnore karakterizohen me kolorite të veçanta apo-si thotë ditunija-me kolorite "Adequate"*. I jep ndryshimet midis koloriteve në arte të ndryshme: pikturë, poezi, skulpturë etj.[220]

Krijimi "*Ç'u mbush mali"* mbetet një vlerësim historik për një ngjarje po historike, që ka ndodhur në Vlorë, shpallja e mëvetësisë së Shqipërisë. Poezia ka vlerë sa patriotike aq edhe atdhetare. Poezia është një apel mbarëkombëtar për të mbrojtur fort atdheun tonë. Të kuptuarit të saj është më tepër se sa me sfond historik. Poezia mbetet një dëshmi relae e ngjarjes më të rëndësishme për Shqipërinë dhe shqiptarët shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.[221]

Një bilanc arritjesh, në katërmbëdhjetëvjetorin e vdekjes së një poeti, gjigandit të lerave shqipe, është ribotimi i poezisë së Lasgushit. Poradeci vjen më i plotë në vëllimet poetike, letërkëmbimet dhe botime sporadike në shtypi shqiptar. Vargjet për

---

[217] S. Hamiti, *Lasgush Poradeci. Poeti modern i shqipes,* në librin: Letërsia Moderne Shqiptare, Shtëpia botuese "Alb-ass", Tiranë 2000, f. 79-96.

[218] S. Hamiti, *Zbulim i Sokratit,* në librin: *Letërsia Moderne Shqiptare*, Shtëpia botuese "Alb-ass", Tiranë 2000, f. 202-206.

[219] L. Topçiu, *Lasgush Poradeci dhe ligjërimi modern i letërsisë shqiptare. Vështrim hermeneutik mbi "poezinë filozofike" të Lasgush Poradecit,* në librin: *Përmasa moderne në letërsinë shqiptare*, Shkup, "Flaka", 2001, f. 36-46, 46-77.

[220] K. Maloki, *A asht poet Lasgush Poradeci?*, në: "Dita", -Nr. 237, 20 shtator, 2001, f. 19.

[221] D. Hata, *Ç'u mbush mali: Poezia e Lasgush Poradecit,* në: "Krahu i shqiponjës", -Nr. 52, qershor, 2001, f. 15.

dashurinë mbeten të pavdekshme. Forca e madhe e dashurisë e mban Lasgushin gjallë për të dëshmuar, se zemra e dashurisë ende rreh në rrethin vicioz të jetës.[222]
Gazetarja Elsa Demo, rihap edhe njëherë debatin e takimit të poetit, me diktatorin Hoxha. Shumë pyetje dhe hipoteza të ndryshme të shoqërojnë në këtë shkrim. A u takuan ata ndonjëherë pas lirimit të Shqipërisë apo gjithçka u mbyll me përballjen e tyre në gjimnazin e Tiranës, kur të dy jepnin mësim? Ndërkaq flitet edhe rreth letrës që Nexhmija dërgoi atëherë në muzeumin e Pogradecit, se Enver Hoxha e kishte takuar Lasgushin në luftë. Shkrimi hedh dritë mbi këtë fakt.[223]
Poradeci mbetet një personalitet i fortë letrar. Në këndvështrimin e Mark Markut, Lasgushi vjen siç ai nuk është njohur më parë. Një pesonalitet i fuqishëm i vargut dhe rimës, por edhe përvijimit të ideve madhëshore që aspiroheshin në përditshmërinë e asokohshme.[224]
Elemente receptive preken edhe përmes një shkrimi të radhës. Gjithnjë suksesi qëndron te një fakt i tillë, lexuesi të rendë drejt poezisë dhe jo anasjelltas, poezia të shkojë tek lexuesi. Lasgushi bën pjesë te të parët. Kjo duket te etja për të lexuar veprën e tij letrare dhe jo e kundërta. Pastaj krijohet një meditacion vargjesh poetikë që hedh rrënjë mes të dy palëve.[225]
Në kuadrin e përgjithshëm të hartimit të këtij punimi një domethënie merr ky kontekst arsyetimi. Poema e Sokratit është shkruar në trajtën e kërkimit të së vërtetës shoqërore duke synuar funksionalizimin e saj. Sokrati helen mbetet simbol i mendimit dhe fjalës së lirë që përndiqen dhe persekutohen në sisteme totalitare. Poema përdor fjalor tipik lasgushian. Ndërkaq huazimi i antikitetit mbetet një pakt hyjnor për t'i ikur realitetit.[226]
Xhaxhiu i rikthehet dhe i mëshon fort idesë së tij se Lasgushi përmes motiveve të tij të ndryshme dhe veçanërisht atij të dashurisë ngrihet në kulmin e panteonit letar kombëtar. Në 15-vjetorin e vdekjes së lirikut, Xhaxhiu ngroh ngjyrimin e dikurshëm kritik duke i dhënë më tepër vlerësim.[227]
Ngritja e antivlerave në letërsi ka qenë një "ritual" normal. Ata që i shërbenin jetëgjatësisë së tyre bëheshin pjesë e promovimit të kohës. L. Poradeci është poeti që u la në mëshirë të fatit gjatë pleqërisë së tij të gjatë, nga shteti shqiptar. Denigrimi iu bë atij nga mekanizmat e një sistemi që dënonte në mënyrë kolektive dhe mbartte idhuj të remë në piedestal, idhuj që kurrë nuk sollën edhe një emocion të vetëm me vargjet e tyre.[228] Një shkrimtar madhështohet edhe përmes kujtimeve familjare. Rapoti prind-fëmijë, në rastin e një gjeniu merr formë apo përmasë tjetërsimi nga përditshmëria e zakonshme. Nuk është e lehtë të qëndrosh pranë një gjeniu, aq më tepër të qëndrosh pranë Lasgush Poradecit. Eksperincën e saj ndan me lexuesit edhe vajza e poetit, Maria Gusho. Intimitetet lidhet me fëmijërinë e tyre dhe pleqërinë e

[222] E. Bardhyli, *Poeti i dashurisë në 14 vjetorin e vdekjes: Lasgush Poradeci*, në: "55", -Nr. 291, 13 nëntor, 2001, f. 22.
[223] E. Demo, *A është takuar Lasgushi me Enverin*, në: "Korrieri", Nr. 217, 7 dhjetor, 2001, f. 19.
[224] M. Marku, *Lasgushi siç nuk e kam njohur*, në: "Tema", -Nr. 610, 16 - 17 qershor, 2002, f. 13.
[225] L. Turkeshi, *Lasgush Poradeci-poet i synimit që të shkojë lexuesi drejt poezisë dhe jo poezia drejt lexuesit!:* (Përkitazi me librin e Mirlinda Krifcës, Dialog me poezinë e Lasgush Poradecit), në: "Flaka", -Nr. 7258, 16 tetor, 2002, f. 15.
[226] A. Mici, *Sokrati i Antikitetit në poezinë e Lasgush Poradecit*, në: "Illyria", -Nr. 1184, volumi 12, 18-21 tetor, 2002, f. 30.
[227] M. Xhaxhiu, *Lasgushi, poeti i dashurisë sublime: Në 15-vjetorin e vdekjes së Lasgush Poradecit*, në: "Drita", 17 nëntor, 2002, f. 3.
[228] K. Xoxa, *Denigrimi i vjershëtorit më të thellë të shqipes. Me rastin e 15-vjetorit të vdekjes së Lasgush Poradecit*, në: "55", -Nr. 285, 23 nëntor, 2002, f. 21.

vonë të babait të saj. Njeriu i letrave mbi të gjitha vizatohet si një prind i dashur dhe bashkëshort devin në familjen Gusho.[229]

Një shkrim reflektiv për vlerën që mbart dhe mesazhet që përcjell poezia lasgushiane është ai i Moikom Zeqos. Djalëria shqiptare e mëmëdheut duhet të lexojë Lasgushin (veprën e tij letrare) dhe pastaj ta quajë të përfunduar misionin e saj në jetë. Zeqo thekson foljen *vdis*, për ta bërë deklaruese vlerën e poezisë lasgushjane. Në vetvete shkrimi mbetet një thirrje për më shumë kulturë ndër breza.[230]

Vështrimi në thellësi të poezisë së Lasgushit është pjesë e metafizikës, e cila e sjell atë modern dhe më koherent. Ky vështrim në thellësi mbetet primar te poeti, sepse portreti artistik i lirikës sjell aroma të cilat të shpjenë përtej meditimit, të kredhin në botën vetvlerësimit dhe të bëjnë të ëndërrt dhe real pjesërisht, por dhe njëherazi.[231]

Ndërkohë edhe rrëfenjat hedhin dritë rreth antikomformizmit të poetit poradecar. Nipi i doktor Bashos, mjeku Jovan Basho, sjell ndër të tjera edhe tri rrëfenjëza nga jeta e Lasgushit me Dr. Bashon. Mes tyre është biseda e doktorit me Mbretin Zog. Ky i fundit i ishte lutur Dr. Bashos ta bindtte Lasgushin, si bashkëqytetar që e kishte, të shkruante disa vargje ose një shkrim për Mbretërinë Shqiptare. Rrëfimi i dytë përjetëson shoqërinë me Çabejn dhe rrëfimi i tretë flet për momentin e lindjes së vajzës së parë të poetit.[232]

Lasgush Poradeci cilësohet si pjesë e modernitetit të letërsisë shqipe. Për tetë dekada të jetës së tij ai ishte vetëm poet. Ai është shembull i krijuesit modern shqiptar. Lasgushi krijoi poetikën e tij origjinale që shfaqet me bukurinë llaftare të vetënjohjes për të arritur përsosmërinë dhe përjetësinë. Tema themelore e krijimeve të tij është dashuria që e ndien dhe e kupton si një fuqi të pashtershme.[233]

Zhurma piktoreske vijon të shoqërojë mediat shqiptare. Rikthehen shkrimet me bazë pikturën lasgushiane. Një poet është vetvetiu piktor edhe nëse nuk bën kurrë pikturë. Ai regjistrohet në Akademinë e Arteve të Bukura në Rumani dhe vizatoi asokohe portretin e perëndeshës Afërdita. Ai do të vizatojë edhe portretin nudo të një vajze rumune, e cila më vonë do të fitonte konkursin e pikturës. Fakte e kujtime të tilla e lidhin poetin tonë me pikturën.[234]

Të gjitha pikturat listohen dhe një pjesë e tyre përdoren si ilustrim në albumin e botuar me titull: *"Lasgushi dhe engjëjt e pikturës"*. Albumi është botim i Muzeut Kombëtar, nën kujdesin e studiuesit Moikom Zeqo. Albumi ka një parathënie nga zoti, Zeqo, ndërsa ka të botuar një pjesë të pikturave dhe skicave me laps të bëra në vite të ndryshme nga poeti.[235]

Puna prej përkthyesi me normë, harresa dhe hija që diktatura lëshoi mbi shkrimtarët tanë inteligjentë, të kthyer në Shqipëri për t'i shërbyer vendit me jetën dhe veprën e tyre, janë treguesit më të mirë, të emrave më të mëdhenj të Letërsisë së Pavarësisë.

---

[229] E. Bardhyli, *Intimitetet e Lasgushit, nën rrëfimin e së bijës.* Maria, vajza e vogël e poetit, tregon për jetën, në: "Dita", -Nr. 596, 21 nëntor, 2002, f. 17.

[230] M. Zeqo, *Djalëri shqiptare, lexo Lasgush Poradecin dhe pastaj vdis!*, në: "Studime muzeologjike", -Nr. 1, 2002, f. 109 – 114.

[231] B. Suta, *Metafizika e Lasgushit në optikën e modernitetit të poezisë së tij,* në: Buletini shkencor "UNIEL" (matematikë dhe shkenca të natyrës), -Nr. 1, 2002, f. 84 – 98.

[232] J. Basho, *Lasgush Poradeci i ka treguar tim eti...*, në librin: Basho Jovan. *Sa kam shpirt, kam shpresë*. "Ombra GVG", Tiranë 2002, f. 103-104.

[233] S. Hamiti, *Poeti modern i shqipes*. (Shkrimi shoqërohet me fotografi të Lasgushit), në librin: *Letërsia Moderne Shqiptare*, "Albas" 2002, f. 149-169.

[234] M. Hoxhalli, *Zbulohen fakte të reja që e lidhin Lasgushin me pikturën*, në: "Gazeta shqiptare", -Nr. 2401, 8 shkurt, 2003, f. 21.

[235] A. Peçi, *Pikturat e Poradecit mblidhen në një album*, në: "Shekulli", -Nr. 48, 20 shkurt, 2003, f. 18.

Censura dhe frika e saj bëri që një pjesë prej poezive të Lasgushit të mos botoheshin në të gjallë.[236]

Miq e shokë të Lasgushit marrin e japin me njëri-tjetrin letra, të cilat në vetvete janë një protestë e hapur kundër regjimit fashist në Shqipëri. Ndër to përmendim ato me Lame Kodrën. Në to theksohet toni patriotik dhe atdhetar i autorit. Poeti në vetvete vargëzon zemrën e vyrtytshme ndaj një bote ku sundon vesi e marrëzia dhe mbytet liria dhe e vërteta. Mes këtyre letrash gëlon një shpirt rebel që do lirinë e atdheut të tij.[237]

Dorëshkrimet e Lasgush Poradcit mbeten të rëndësishme në çdo moment që dalin në dritë. Gjetja e tyre e dokumentuar përbën vlerë dhe histori në republikën e letrave shqipe. Aq më shumë interesante mbetet gjithçka ka të bëjë me shtetet e huaja ku ai jetoi dhe punoi deri sa u kthye përfundimisht në atdheun e tij. Poema e shkruar në rumanisht në vitin 1921 mban titullin *"Poemë"* dhe përbëhet nga 21 strofa. Emocion dhe lirizëm atdhetar mbetet boshti i poemës në dorëshkrim. Gjetja e saj përbën burimin kryesor të vazhdimësisë letrare të shkruar nga Lasgushi, kur ai jetonte dhe studionte në tokën rumune.[238]

Në faqet e shtypit jepen të dhëna rreth zbulimit të poemës.[239] Ky krijim artsistik është poema e parë shkruar nga Lasgush Poradeci, përkrah vjershave dhe poemave të tjera.[240]

Dy dorëshkrime të panjohura të L. Poradecit *"Antologjia shqiptare e kësikohshme"*, *"Studimi mbi rolin e dr. Norbert Joklit në Albanologji"* përshfaqen në formëm e tyre më interesante. Letërkëmbimi i tij e evidenton këtë miqësi me gjuhëtarin e madh Norbert Jokli. Letrat glorifikojnë rolin e madh të gjuhëtarit dhe saktësisht vlerën e tij të jashtëzakonshme në Albanologjinë shqiptare.[241]

Një shkrim i radhës, sjell një përmbledhje të veprës letrare të Poradecit. Vlerësimi i autorit mbetet i përpiktë përsa i përket madhështisë së Lasgushit. Në të gjithë kohërat ai do të jetojë me krijimtarinë e tij. Dy vëllimet poetike të Porardecit janë emblema e një shenjimi të vërtetë dhe të merituar në panteonin letrar shqiptar dhe jo vetëm.[242]

Forma poetike shpaloset mes gjuhës së pastër shqipe dhe gjuhës poetike duke u bërë normë precioze në poetikën lasgushiane. Duke zotëruar këtë normë poeti këndon me bindje në vargun e tij. Gjuha dhe forma e saj janë ligjërim dhe mit, ndaj Lasgushi krijon me bindje poezinë e tij, që sigurisht ka tis magjie.[243]

Një vend të rëndësishëm Lasgush Poradeci vijon të zërë në programet shkollore apo tekstet ndihmëse mësimore të sistemit parauniversitar shqiptar. Fryma e re që solli poezia e Lasgush Poradecit në vitet '30. Poradeci është në letërsinë shqiptare poeti lirik që solli një ndjeshmëri të veçantë të fjalës, poezisë. Poezia e tij dallohet në tri aspekte kryesore: në poezinë filozofike, patriotike dhe erotike. Ai ushqente pikëpamje

---

[236] P. S. Luarasi, *Si eliminoi Enveri shkrimtarët e viteve '30. Mitrush Kuteli, Lasgush Poradeci, Skënder Luarasi, Petro Marko, Branko Merxhani*, në: "Panorama", -Nr. 171, 29 mars, 2003, f. 12-13.

[237] Sh. Sinani, *Lasgushi antifashist, zbulohen letrat e panjohura*, në: "Flaka", -Nr. 7520, 12 shtator, 2003, f. 9.

[238] Anonim, *Një poemë në dorëshkrim e poetit Poradeci i dhurohet arkivit të Muzeut Kombëtar*, në: "55", -Nr. 136, 24 maj, 2003, f. 21.

[239] Teksti origjinal në rumanisht iu dhurua nga e bija e tij Maria Gusho, Muzeut Historik Kombëtar. Edhe faksimile e origjinalit të poemës.

[240] I. Shabani, *Zbulohet poema e parë e poetit lirik Lasgush Poradeci*, në: "Panorama", -Nr. 301, 28 maj, 2003, f. 12-13.

[241] Sh. Sinani, *Lasgushi, letra të panjohura*, në: "Shekulli", -Nr. 251, 11 shtator, 2003, f. 18-19.

[242] A. Cani, *Lasgush Poradeci : Krijimtaria e tij*, në: "Panorama", -Nr. 439, 21 dhjetor, 2003, f. 21.

[243] A. Zoto, *Një poet shqiptar nga këndvështrimi i letërsisë frënge: Format dhe normat e preciozitetit te Lasgush Poradeci*, në: "Gjurmime albanologjike": seria e shkencave filologjike, -Nr. 30-31, 2003, f. 205-218.

idealiste për artin. Sipas tij, misioni i poetit është i përcaktuar nga "Hyjnia". Veten e krahasonte me zogun e qiejve.[244]

Lasgush Poradeci është i pari poet modern shqiptar dhe një nga lirikët më të mëdhenj shqiptarë të shekullit XX. Poezitë e tij kanë një strukturë të ndërlikuar poetike, prej së cilës varet edhe muzikaliteti dhe ritmi i brendshëm i tyre. Lasgushi i këndon dashurisë jo si emocion, por si fuqi themelore jetësore, si fuqi tokësore e qiellore.[245]

Në vitin 2004, sërish kemi shkrime apo artikuj të botuar për jetën dhe veprën letare të Lasgush Poradecit. Ligjërimi në poetikën e Lasgushit është në parametrat e një norme lehtësisht të dallueshme. Ndërkaq krijimi i tij mbështetet në katër figura themelore: qielli, dheu, uji dhe zjarri të cilat janë edhe temat e përhershme të poezisë. Lidhjet dhe-qiell, e anasjelltas vdekje-perjetësi realizohen nga dashuria që merr kuptimin e energjisë jetësore e shpirtërore.[246]

A. Xhiku me studimin "Letërsia Shqipe si polifoni", sjell historinë e letërsisë kombëtare, të ndërtuar si renditje kohore përmes jetës dhe e veprimtarisë së shkrimtarëve më të shquar të saj. Në këtë fokus autori ndalet edhe krijimtaria e Lasgush Poradecit.[247]

Studiues të ndryshëm vijojnë të shkruajnë në gjuhë të huaj studime mbi veprën letare të Poradecit, madje do të vijojnë të plotësojnë profecinë çabejane për të përkthyer Lasgushin në gjuhë të tjera të huaja. *"The Myth of Lasgush"* ka 306 faqe. Monografia shkencore ka këtë strukturë: Në kërkim të një miti; Kur miti ka lindur; Gjuha që flet miti; Brenda dhe jashtë shtëpisë së yjeve të Lasgushit; Poezi të përkthyera. Në fund të librit janë dhënë disa shënime për përkthyesin dhe janë bërë disa referenca.

Hallkat që përbëjnë zinxhirin e sistemit poetik tek ky libër janë: Nocionet-figura (ylli, liqeni, dashuria, vdekja, dhimbja, fjala, përjetësia, natyra, pluhuri yjor, zalli i brigjeve të liqenit). Secila prej tyre ruan identitetin e vet simbolik në një kërkim të pandërprerë, duke pasur uri përvëluese për dritën e së panjohurës, ato pasurohen më shtresa të reja kuptimore, figurative, më të larta, më të përsosura dhe lëvizin drejt njohurive të reja, duke e çuar sistemin poetik drejt përimtimit gjithnjë e më të përkryer që rritet në formën e një spiraleje. Kryehallka e këtij zinxhiri është ylli.[248]

Sabri Hamiti ndalet në prezencën e figurës së metaforës në vargun Lasgushian. Metafora në varg është kryefigurë. Për të me rëndësi është që poezia të ketë universialitet dhe kontemporaritet (bashkëkohësi), në mënyrë që të komunikojë me të gjitha kohët njësoj, për t'u bërë e pavdekshme. Ndërkaq, shumësia e figurave në poezinë lasgushiane, munden nga ajo e metaforës. [249]

Duke huazuar një prej emrave më të përfolur të dashurisë së Lasgushit, shkrimi hedh dritë për një femër piktore. Androniqi Xengo apo Niqka, e thirrur prej tij me përkëdheli, rrit kërshërinë e lexuesit si një prej emrave që shton misterin lasgushjan përreth botës dashurore të tij. Ajo përveçohet si një emër arti në pikturë. Andoniqi Xengo, vajza që Lasgushi dashuroi në rini, dashuri që merr informacion nga ditari poetik në prozë i Lasgushit. Niqka do të jetë personazhi që do të bashkohet me plot

---

[244] A. Orhanasi (Haveri), *Motivet kryesore të poezisë lasgushiane. Tiparet e lirikës së tij: Lirika e natyrës dhe e dashurisë*. Në librin: *Letërsia për Maturantët*, Erik botime, Tiranë 2003, f. 39-41.

[245] R. Petro (Filipi)., N. Malaj, *Motivet kryesore të poezisë lasgushiane. Tiparet e lirikës së tij: Lirika e natyrës dhe e dashurisë*, në librin: *Çelësi i letërsisë*. "Albas", 2003, Tiranë, f. 37-40.

[246] F. Mustafaj, *Ligjërimi poetik i Lasgushit*, në librin: *Studime kritike në ndihmë të mësuesve dhe nxënësve të shkollave të mesme të profilizuara*, Berat, "Jonalda", 2004, -195f.

[247] A. Xhiku, *Letërsia shqipe si polifoni,* Dituaria, Tiranë, 2004, -311f.

[248] A. Kapurani, *The Myth of Lasgush*, Leicestershire: "Upfront", 2004. -306f. ; Bibliogr. f.305-306.

[249] S. Hamiti, *Metafora e Lasgushit*, në: "55", ("Letra", suplement), -Nr. 58, 11 mars, 2004, f. 9-11, 13.

vajza të tjera të kohës këndej dhe andej kufirit, të cilat ranë në dashuri me poetin që shkruante vargje për dashurinë që robëron.[250]
Fjalët me rrënjë dyshe dhe treshe janë kompozitat më të përhapura në krijimtarinë letrare të Lasgushit. Këto fjalë të përbëra janë fjalor tipik lasgushjan. *Gushë-e-gji-stolisura; Gushë-e-gji-mbollisura, shtat-lëkundura-pallua, lesh-verdhëza-si-ftua; gji-mburuara-si-krua* etj. janë disa syresh që evidentohen fare lehtë në krijimtarinë e tij poetike. Lasgushi shquhet për këtë eksperiment gjuhësor.[251]
Shkrimet rreth figurës së Lasgushit "burojnë" nëpër gazetat dhe revistat e kohës. Apeli këtë herë vjen i vjen i fortë për të mos lejuar prishjen e shtëpisë së tij në Tiranë, por më kot, gjithçka sipas shkrimit ka ndodhur.[252]
Letërkëmbimi është një formë e aplikuar në letrat shqipe që hedh dritë mbi shumë mistere që shoqërojnë jetën e një shkrimtari. Ai këtë herë vjen në eksponatet e një objekti historik. Hapet në Muzeun Historik Kombëtar ekspozita me temë *"Antifashizmi në krijimtari, 1939-1944"*. Shkrimi zbulon letrat e patreguara kurrë më parë të Poradecit me Sejfulla Malëshovën. Letrat e pabotuara më parë kanë karakter antifashist. Antifashizmi është një tjetër detaj i botëkuptimit lasgushian që evidentohet edhe në krijimtarinë e pasçlirimit të vendit nga pushtuesit e huaj.[253]
Cilësimi poet i dashurisë në 105-vjetët e lindjes së Lasgushit mbetet ndër më të tingëlluarit për këdo dhe gjithkund. Ky përcaktim merr një kontekst sa poetik aq dhe jetësor për një person që sfidoi vdekjen dhe mbeti në përjetësi me lëndën e tij poetike. Lirikat lasgushiane mbeten tashmë një tingull dashuror magjik në panteonin e letrave shqipe. [254]
Harmonia kalon të gjitha parashikimet që mund dhe nuk mund të gjenden si pjesë frymëzimit real. Harmonia mbetet refren shoqëronjës në idilizëm, patrotizëm, peizazhizëm dhe figuracinizëm poetik. Bashkimi i së tërës merr një emocion të veçantë allalasgushian dhe dritësohet pa formulë, por thjesht duke dëgjuar ritmin e rrahjeve të zemrës në përgjithësinë e saj. [255]
Shpend Topallaj bën një përsiatje të librit të Lalajit. Libri i saj sjell një përfshirje shpirtërore. Unë e kam parë dhe prekur Lasgushin, thekson ajo në ditarin e saj njerëzor. Saktësi dhe korrektësi vërehen nëpër faqet e këtij libri, ndërsa lartësohet figura e lirikut të madh të shqipes, Poradecit. Stili i rrëfimit është i qetë dhe i rrjedhshëm në të gjitha të vërtetat që dëshmon.
Më 2005 Elsie sjell një format ndryshe të historisë së Letërsisë Shqipe. Në këtë treshe të rrallë dhe madhështore spikat figura e poetit Lasgush Poradeci. Më tej ka një informacin rreth jetës dhe veprës letrare të Poradecit, ndërkaq ky poet solli një frymë të re në krijimtarinë e viteve '30. Prezantoi mendime të thella, ndjenja labirintike dhe ide universale. U largua prej poezive romantike të rilindësve tanë.[256]

---

[250] Z. Hasani, *Historia e njërës nga ato: Lasgush Poradeci; Androniqi Zengo*, në: Klan, -Nr. 362, 19 qershor, 2004, f. 38-40.
[251] N. Dako, *Kompozitat (fjalët e përbëra) në poezinë e Lasgush Poradecit*, në: "Tempulli", -Nr. 9, 2004, f. 85-92.
[252] E. Ypi, *Iste est!: Lasgush Poradeci. Shëmbet shtëpia e tij në Tiranë*, në: "Panorama". -Nr. 673, 14 gusht, 2004, f. 1, 8.
[253] B. Malo, *Zbulohen letrat e panjohura të Lasgushit dhe Lame Kodrës*, në: "Albania", Nr. 276, 25 nëntor, 2004, f. 14.
[254] A. Bardhyli, *Poeti i dashurisë, në 105 - vjetorin e lindjes. Lasgush Poradeci*, në: "55", -Nr. 350, 28 dhjetor, 2004, f. 24.
[255] Sh. Topallaj, *Unë e kam parë Lasgushin*, në: "Fjala", -Nr. 153, 2 - 3 tetor, 2004, f. 6–7.
[256] R. Elsie, *Një histori e shkurtër. 5.4-Lajmëtarë të modernizimit, Migjeni dhe Lasgush Poradeci*, në librin: *Letërsia Shqipe*. Tiranë, "Skanderbeg books", 2005, f. 131-142.

Jokli ose pengu shqiptar i judeofobisë s'mundën ta shpëtojnë studiuesin e shquar hebre që vinte nga Vjena. Letra e disa intelektualëve të kohës mes tyre edhe Lasgush Poradeci, në mbrojtje të albanologut. Letra evidenton madhështinë e Joklit si njeri i punës dhe shkencës në përgjithësi [257]

"Të fshehtat e Lasgushit dhe Kadaresë në arkivat franceze", titullohet shkrimi që trajton letërkëmbimin mes shkrimtarëve. Si i ruajti Kadareja dorëshkrimet e romaneve në arkivat franceze. Nën këtë dualizëm shkrimi sjell të vërtetën tronditëse të censurës komunsite shqiptare për dorëshkrimet e tij roman. Një lojë që shpesh i ngjante paktit me djallin, nënvizon Ismail Kadare.[258]

Poezia lasgushjane trajtohet në një tjetër artikull. Falë pasthirrmave, parashtesave dhe prapashtesave zmadhuese apo zvogëluese i jep veprës së poetit një kolorit tipik poradecar. Elemente të tilla i japin poezisë më tepër nerv dhe personalizim vargut të tij. Këto nuanca muzikore mbeten një lektisje e bukur dhe e papërsëritshme në poetikën lasgushjane.[259]

Vijon edhe pas shumë vjetësh jehona e librit të Kolevicës. Sipas Miranda Haxhisë, Kolevica, mbetet zëri që thirri në shkretëtirë për më tepër vëmendje ndaj Lasgushit, si vlerë kombëtare. Forca e qytetarisë së një shkrimitari e evidenton këtë hapësirë mendimesh dhe vlerësimesh mbarëkombëtare. Libri i Kolevicës *"Lasgushi më ka thënë..."*, mbetet një hap që duhet të hedhë edhe të tjerë[260]

Vazhdon të hidhet ende dritë mbi kujtimet me poetin. Publicisti Dionis Bubani, boton jetëshkrimin e tij që prej fëmijërie me titull: *"Shakatë tragjike të jetës sime"*. Në kujtimet e tij për Poradecin, poeti mbetet njerëzor, tekanjoz dhe i vlerësuar për krijimtarinë poetike. Shkrimtari që shkroi poezi dhe që dashuroi me shpirt poezinë e Mihai Emineskut mbetet i gjallë dhe madhështor në kujtime.[261]

Prononcohet publikisht Brikena, vajza e Eqrem Çabejt. Ndër miqësitë më të mira të tij ka qenë ajo me Lasgushin. Bashkëstudentë në Austri dhe më vonë miq të vjetër në Tiranën e luftës dhe pas luftës së dytë botërore lidhën një miqësi të fortë. Ata flisnin me njëri-tjetrin kundër diktaturës dhe socializmit të vendosur në Shqipëri. *"Bardët"* shqiptarë e vijuan miqësinë e tyre të vërtetë pa asnjë interes apo kompromis.[262]

Leximi mbetet *"shkollë"* me vete. Vajza e poetit hedh dritë për një librat më të dashur të Lasgushit. Sillet eksperienca e një poeti e vendosur në syrin e një lexuesi elitar. Lasgushi lexonte, madje lexonte shumë dhe përzgjidhte. Libri në fjalë i Moikom Zeqos zinte një vëmendje dhe vlerësim të gjithëhershëm për Poradecin. E bija e poetit rrëfen se si bëhej shpesh objekt diskutimi ky botim. Me shumë emocon dhe vërtetësi ajo e shpjegon këtë dashuri të atit të saj.[263]

Studiuesit ndajnë emocionin e tyre përmes intervistash që realizojnë në median e shkruar. Kapurani, përveçon se do ta vijojë punën e tij me studime të tjera. Vendin kryesor do ta zerë treshja N. Frashëri, L. Poradeci dhe I. Kadare. Për studimin e tij

---

[257] Sh. Sinani, *Jokli ose pengu shqiptar*, në: "Panorama", -Nr. 831, 22 Janar, 2005, f. 13.

[258] A. Mema, *Të fshehtat e Lasgushit dhe Kadaresë në arkivat franceze*, në: "Panorama", -Nr. 886, 19 mars, 2005, f. 12 – 13.

[259] H. Matoshi, Pasthirrmat-shprehësia poetike e Lasgushit, në: "Gjurmime albanologjike": seria e shkencave filologjike, -Nr. 32-33, Prishtinë, 02-03, 2005, f. 179-188.

[260] M. Haxhia, *Qytetaria e një shkrimtari: Petraq Kolevica-zëri që thiri në shkretëtirë!*, në: "Drita", 5 qershor, 2005, f. 5.

[261] A. Peçi, *Kujtimet e mia dhe ... Poradeci, Kadare, Marko*, në: "Gazeta shqiptare", -Nr. 3123, 14 qershor, 2005, f. 25.

[262] B. Çabej, *Poradeci, Buda e Luarasi miqtë më të mirë të tim eti*, në: "Tirana observer", -Nr. 120, 10 gusht, 2005, f. 20–21.

[263] M. Gusho, *Libri i dashur për babain tim Lasgushin: Lasgushi duke lexuar librin e Moikom Zeqos, Pedagogu i Kopernikut*, në: "Koha jonë", -Nr. 233, 24 gusht, 2005, f. 20.

shtysë kryesore ka qenë vetëm poezia e Lasgushit. Falë njohurive të tij për poetikën moderne, Kapurani merret me Lasgushin. Në fillim përkthen poezinë *"Ylli"*. Aty kishte rima akustike, nënvizon Kapurani. Pastaj përkthen gjithë poezitë përfaqësuese të Lasgushit. Kështu hyra në shtëpinë poetike të tij dhe preka me dorë poezinë, - shkruan Kapurani. *"Ai nisej nga përmasa madhore, kozmogonike. Pra nga qielli, kalon te ylli dhe kështu me radhë"*.[264]

Vlerat rreth poetikës lasgushiane shtohen në këtë periudhë të marrë në shqyrttim. *"Dhe po të këndohet Lasgushi me dashurinë, do të vërtetohet thellësia e tij e pashoqe, në mos sot, nga brezat që do të vijnë. Po moskuptimi i lehtë, errësira e disa vjershave të tija, nuk është një e metë përkundrazi, një element i gjithë shkrimeve të thella në botë, që prej poemave indiane e, nëpër Kuranin, gjer më sot. Fundi i fundit, çdo thellësi është e errët. Dhe faji s'është aq i gjeniut sa i publikut mendjeshkurtë"*. Një ditë Shqipëria do t'ia falë njëherë botës këtë talent të madh letrar, nënvizon në këtë shkrim Çabej[265]

Lasgush Poradeci e donte Kosovën, ndërsa vargëzonte se ajo duhet të jetonte në liri dhe e shkëputur nga serbët. Këta të fundit sipas tij, mbeten armiqtë më të betuar të shqiptarëve. Poezitë e tij ishin botuar qyshkur në Kosovë. Lasgushi e dinte këtë të vërtetë të madhe. Kosova përvijohet si një shqetësim i drejtpërdrjetë i poetit.[266]

Shqipëria më në fund është me fat që po feston Krishtlindjet me Lasgushin, *"Krishtin poet"* që sakrifikoi jetën për të ushqyer pasardhësit e tij me vargje, një paralelizëm i devotshëm dhe i adhurueshëm. Në këtë ditëlindje poeti erdhi plot ngjyra dhe jo bardh' e zi si shumësia e viteve që mbartte mbi shpinën e tij.[267]

Shkrimi tjetër, e trajton Lasgush Poradecin si perëndi të prekshme nga ne njerëzit. Ta adhurosh e pastaj ta kthesh në modelin tënd, frymëzimin tënd, do të thotë ta zbresësh poetin mes të gjallëve të kohës sonë. Poeti është më shumë se sa i prekshëm. Një perëndi që ka zbritur nga Olimpi poetik dhe që bëhet frymëzim dhe dëshirë për ta jetuar jetën, me veprën e tij poetike.[268] Shkrimet e kësaj natyre duken në përgjithësi larg një analize të mërfilltë shkencore, por duhet nënvizuar fakti se ato mbushin shtypin dhe revistat e kësaj peruidhe në Shqipëri dhe jashtë saj.

Lexues të rinj dhe forma të reja për të shijuar poezinë e Lasgush Poradecit sjell teatri i poezisë, që përshfaq performanca poetike. Në Teatrin Kombëtar regjisori shkodran Bruno Shllaku, realizon dramatizimin e poezive të Lasgush Poradecit. Ai përgatiti një montazh të përzgjedhur, që erdhi i dramatizuar. Lasgushi së bashku me vashën dhe trimin përcollën te ne ndjenjën e madhërishme të dashurisë.[269]

Ermir Hoxha ndalet te doktoratura e Lasgushit. Për shumë kohë ishte hedhur hije për doktoraturën e shumëpërfolur të Lasgush Poradecit. Për këtë punim Lasgushi punoi mbi pesë vjet. Përmes saj ai bën një prezantim të imët, të figurës së madhe të poetit rumun, i cili vdiq në çmenduri, shkaktuar nga një valë urrejtje dhe abandonimi që iu bë atij në epokën në të cilnë jetoi. *"Eminesku, kjo figurë emblematike e popullit rumun, sipas Lasgushit belbëzonte në tronditje të forta mendore se ishte shqiptar!*

---

[264] A. Kapurani, *Si e bëra anglez... Lasgushin e madh. Intervistë me autorin e librit në anglisht The Myth of Lasgush (Miti i Lasgushit)*, Intervistoi: Ben Andoni, në: "Korrieri", -Nr. 206, 28 gusht, 2005, f. 11.

[265] I. Shema, *Eqrem Çabej për Lasgush Poradecin*, në: "Rilindja demokratike", -Nr. 4173, 20 shtator, 2005, f. 19.

[266] B. Asllani, *Lasgush Poradeci për Kosovën*, në: "Drita", 2 tetor, 2005, f. 14.

[267] Z. Morava, *Krishtlindje me Lasgushin.* Me rastin e 105-vjetorit të lindjes së poetit Lasgush Poradeci, në: "Drita", 30 dhjetor, 2005, f. 3.

[268] N. Buzo, *Meditim për poetin Lasgush Poradeci*, në: "Sot", 6 janar, 2006, f. 20.

[269] E. Kaçi, *Lirikat e Lasgushit në dramatizimin e Shllakut*, në: "Metropol", -Nr. 624, 16 mars, 2006, f. 23.

Ndërsa për punimin e Lasgushit për figurën e tij, rumunët janë shprehur atë botë se "një studiues gjerman (!) ka mbrojtur doktoraturë me një punim kushtuar Emineskut".[270]

Interesat e gjera dhe modestia e poetit bashkohen në një, përmes një shkrimi plot drit'hije shqiptare. Sërish kujtimet mbeten një amalgamë e madhe në subkoshiencën e poetit Lasgush Poradeci. Kujtimet nga takimet me Poradecin vijnë në formën e rrëfimeve të botuara. Mbi të gjitha spikat modestia e Lasgush Poradecit, përballë intersit të gjerë vetjak. Ai kurrë nuk u shit apo u mënjanua nga pazaret sociale dhe politike që koha fabrikonte. Deri në fund liriku më i madh i shqipes, qëndroi modest dhe sfidonjës ndaj kujdo që përpiqej ta përdorte apo injoronte...[271] Letërkëmbimi është kyçi i artë i një monografie që mund të lindë si rezultat i shumësisë në tregun e tyre. Autenciteti i letrave bëhet tregues i fortë i një jete që mund të tregohet me detaje edhe përmes monografisë. Këtë tashmë e ka realizuar fatmirësisht dhe fatalisht Lasgush Poradeci në këtë letërkëmbim që s'vjen aspak i retushuar apo turbulluar nga sisteme të ndryshme.[272]

Sërish merret në dritëparje doktoratura e L. Poradecit përmes një shkrimi nga Ardian Klosi. Studiuesi flet në këtë përqasje rreth doktoraturës së Poradecit, por edhe ngjashmërisë mes poezisë së Eminsekut dhe Poradecit. Topçiu, ndër të jera saktëson në intervistë se Lasgushi vendosi të bëhej poet, kur lexoi poezitë e Emineskut. Ai madje i dinte të gjitha poezitë e Emineskut përmendësh në Rumanisht. Problemi i kësaj doktorature qëndron në faktin se shteti komunist nuk e njohu asnjëherë atë dhe Lasgushin si Doktor të Shkencave Filologjike.[273]

Ardian Klosi sqaron se studimi i Poradecit për Emineskun mbetet interesant edhe në ditët tona. Aty shprehimisht thuhet: *"Me idoelogjinë e tij Emineskun përfshin tërësinë e shpirtit rumun në zgjim e sipër, e megjthatë ideali i tij kulturor nuk arriti të kuptohej tërësisht dhe aty për aty. Përmbajtja artistike e krijimeve të tij ngrihej mbi nivelin e rëndomtë kulturor të bashkëkohësve... Mirëpo analiza më të thella nxorën në pah se kozmosi poetik i Eminescu-t, pat hedhur rrënjë të thella në psikologjinë popullore, edhe atje ku tema e krijimeve të tij i takon lëmit të nocioneve të përgjithshme".*[274]

Eldon Gjika mendon se pesë elementet themelore që Lasgushi i referohet janë: DRITA, AJRI, ERA, ZJARRI, UJI. Paraprakisht, si në përjetësia "VY", ashtu edhe në përjetësia "YZ", autori paraqet në mënyrë të përqendruar vizionin e tij poetiko-filozofik mbi çështje madhore: procesi i njohjes prej njeriut, shkallët e këtij procesi sa racional aq edhe mistik, ku bota tokësore me botën qiellore krijojnë një amalgamë të qenësishme. Lirikat filozofike kanë një tis magjik edhe në lëmin krahasimtar. Teksti poetik lasgushian mbetet i afërt dhe i pashterur me mesazhe prezenca e të cilave i provokon lexuesit të të gjitha kohërave ide, asosacone, kënaqësi estetike meditative për natyrën dhe jo vetëm. *"Leximi me interes edhe sot bëhet për zbërthimin e kodit poetik të tij, duke rritur vlerën poetike të poezive dhe përmbajtjes së tyre".*[275]

Liriku i madh i shqipes glorifikohet. Shkrimi vjen si një përmbledhje honor, për jetën dhe veprën poetike të Lasgush Poradecit. Liriku paraqitet në këtë prezantim si gjithmonë, njerëzor dhe modern. Gëzimi i jetës dhe pasioni i zjarrtë tokësor

---

[270] E. Hoxha, *Lasgushi ishte dhe profesor doktor. Botohet për herë të parë, doktoratura e Lasgush Poradecit, dhënë nga Universiteti i Gracit*, në: "Shqip" -Nr. 67, 18 maj, 2006, f. 47.

[271] S. Adhami, *Interesat e gjëra dhe modestia e poetit*, në: "Drita", 2 korrik, 2006, f. 13.

[272] A. Ymeri, *Jeta e Poradecit përmes autenticitetit të letrave*, në: "Korrieri", -Nr. 142, 25 maj, 2006, f. 19.

[273] L. Topciu, *Emineskut e Poradecit u ra i njëjti short*, në: "Shekulli", -Nr. 144, 26 maj, 2006, f. 18.

[274] A. Klosi, *Llazar Gusho i keqkuptuar*, në: "Shekulli", -Nr. 145, 27 maj, 2006, f. 18.

[275] E. Gjika, *Veçori të lirikave filozofike të Lasgush Poradecit në vështrim krahasues*, në: "Studime filologjike", -Nr. 1-2, 2006, f. 43 -54.

gërshetohet më sublimen dhe qielloren. Lasgushi i dha dashurisë një kuptim më të gjerë vlerësues dhe meditativ njëherazi.[276]

Vijon seria e botimeve me kujtime për poetin. Këtë herë është pogradecari Misto Marko (Mirosh Marko), nipi i Mitrush Kutelit, i cili tregon kujtimet e tij me Lasgushin. Në këtë fokusim, Marko ishte mjeku personal i Lasgush Poradecit ndërsa shkruan letërsi edhe vetë. Bashkë me Lasgushin ata diskutonin për krijimtarinë letrare dhe jo vetëm atë... Nipi i Kutelit rrëfen jetën e tij mes dy gjenive, Lasgushit dhe ungjit të tij, Kutelit madhështor.[277]

Ismail Kadare ndalet te madhështia Lasgushiane. Në këtë kuadër jeta e përditshme mbetet interesante dhe kujtohet e tillë nga personalitete letrare si Kadare. Mozaiku i zymtë i poetit elitar paraqet edhe trandjet e tij shpirtërore. Lasgushi i tregon Kadaresë, se akoma bijës së tij Kostandina nuk i kanë gjetur një vend pune si mësuese e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Pogradec. Lasgushi përgjysmon hallin e tij me Ismail Kadarenë përmes formës epistolare të detajuar. Letrat kanë karakter personal dhe shoqërohen me një nënvizim të Kadaresë në pjesën më të madhe të tyre.[278]

Momente të veçanta nga bashkëjetesa bijë-baba fokusojnë maksima nga epistolari i Lasgushit. Nën këtë vëmendje vizionesh lartësohet vendlindja. Anteu i madhështisë qëndron tek forca për të krijuar vazhdimësinë e veprës së lënë pas... *"Pa rrënjë jeta thahet, po kështu dhe njeriu si bima do të vdesë. Rrënjët mbeten simbolika më e fortë për të mbajtur jetën gjallë..."*[279]

Emocionet e saj, vajza e poetit i ndan përsëri me lexuesin, përmes shtypit pogradecar. Dashuria mbetet ushqimi bazë i jetës. Vetëm nëse dashuria nuk vdes gjërat bëhen mirë, me pasion dhe devotshmëri. Idealizmi i këtij mekanizmi qëndron në faktin dashuri, prej së cilës gjithçka ka kuptim. Gjërat që fillojnë duhet të vazhdojnë a mbarojnë me dashuri, për të përmbushur sa më mirë qëllimin e rrojtjes sonë mbi dhe.[280] Autorja e shkrimit të radhës sjell imitim biblik. Ky version-sipas saj, është rimarrje e zbutur në latim për figurën memoriale të Lasgush Poradecit.

Nën këtë këndvështrim poeti i liqerit shtrohet gju më gju me bashkëqytetarët e vet dhe mbetet jo vetëm një frymëzim i bukur për ta, por dëshirë për të qenë pjesë e rikthimit në jetë si te "*Dhiata e Re"*. Tashmë ai është një perëndi e prekshme me poezinë e tij të pavdekshme.[281]

Përsiatje rreth një monografie për poetin poradecar sjell një tjetër shkrim, përmes të cilit nënvizohet se sistemi poetik i Lasgushit tingëllon si një sistem poetik anglez. Këtë trajtesë e ofron një studiues si Kapurani. Shtysë kryesore ka shërbyer vargëzimi i Lasgushit. Autori duke njohur dhe lexuar fjalën e tij, ka dhënë gjykimin personal për poezinë e Lasgushit. Gjëja më kryesore e studimit është lënda poetike e përkthyer. Kështu autori preku me dorë mitin poetik të Lasgushit të përkthyer.[282]

---

[276] Anonim, *Lasgush Poradeci, Liriku i madh i Shqipes*, në: "Ndryshe", -Nr. 97, 3 - 4 shtator, 2006, f. 16.

[277] A. Bardhylli, *Idilet e këputura të Kutelit*, në: "Shqip", -Nr. 184, 13 shtator, 2006, f. 26-27.

[278] I. Kadare, *Letra intime të Lasgush Poradecit për Kadarenë*, në: "Telegraf", -Nr. 206, 4 shtator, 2006, f. 19.

[279] M. Gusho, *Kush pret rrënjët, nuk mund të rritet*, në "Nositi", -Nr. 398, Pogradec, 22-31 gusht, 2006, f. 5.

[280] M. Gusho, *Kur fillohet një gjë, duhet bërë me dashuri*, në: "Nositi", -Nr. 403, Pogradec, 16-24 nëntor, 2006, f. 8.

[281] N. Buzo, *Perënditë janë të prekshme: meditim biblik mbi Lasgush Poradecin*, në: "Standard". -Nr. 20, 27 dhjetor, 2007, f. 19.

[282] A. Çeta, *Sistemi poetik i Lasgushit në një monografi. Mbi veprën e dr. Anastas Kapuranit The Myth of Lasgush*, në: "Illyria", -Nr. 1646, 11-14 maj, 2007, f. 26-27.

Eldon Gjikaj publikon studimin "Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit". Përmes tij Gjikaj argumenton tezën se Lasgush Poradeci, krijoi një sistem poetik të vetin.[283]

Për Lasgushin e madh ka pasur shume histori me ishte seç na ishte, histori që evidentohen edhe në këtë kapitull. Granit Zela ironizon një pjesë të shkruesve të librave a shkrimeve të tillë për Lasgushin. Sipas tij memuaret për L. Poradecin janë metoda më e fundit për lavdi, që ka kapur ethshëm mjaft nga ata, që i kanë shkëmbyer me poetin ca fjalë sa ishte gjallë. Kështu, duket se po mbulohen një herë e mirë me famën që të japin kujtimet për një poet të shquar mbarëkombëtar.[284]

Në këtë periudhë vitesh kemi botime dhe ribotime të veprës së përkthyer të Poradecit. Ribotohet Eugjen Onegini në vitin 2001. Viti 1999-të shenjon pesë autorë të përkthyer nga L. Poradeci. Viti 2003 sjell tre përkthime të L. Poradecit në gjuhën shqipe. Lista e botimeve dhe ribotimeve të përkthyera ng Lasgushi:

1995

Breht, Bertold. Poezi.[285]

1996

Heine, Henrish. Poezi.[286]

Lenau, Nikola. Poezi.[287]

1998

Mickiewicz, Adam. Poezi.[288]

1999

Goethe, Johann Wolfgang von. Poezi.[289]

Heine, Henrish. Poezi.[290]

Mickiewicz, Adam. Poezi.[291]

Vis, Teofil De. Poezi.[292]

Goethe, Johann Wolfgang. Poezi.[293]

2000

Burns, Robert. Poezi.[294]

2001

Pushkin, Aleksandër Sergeijev. Poemë[295]

---

[283] E Gjikaj, Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit, Naim, Tiranë, 2010, -214f.

[284] G. Zela, *Çuditë e kujtimeve për Lasgushin*, në: "Albania", 31 mars 2008, f. 4.

[285] B. Breht, *Vargu anakronik i njerëzve ose Liri dhe Demokraci*. Poezi. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në: "Zëri i Popullit", -Nr. 239, 17 dhjetor, Tiranë, 1995, f. 7.

[286] H. Heine, *Mbreti dhe poeti*. Poezi. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në: "Zëri i Popullit", -Nr. 39, 18 shkurt, Tiranë, 1996, f. 13.

[287] N. Lenau, *Dritare e hapur*. Poezi. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në: "M M", -Nr. 2, 1996, f. 249-252.

[288] A. Mickiewicz, *Miqve të mij*. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në: "Mehr Licht!", -Nr. 8, 1998, f. 203-210.

[289] J. Wolfgang Goethe, *Kristja*. Poezi. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në: "Drita", 26 dhjetor, 1999, f. 12.

[290] H. Heine, *Sikur të prishej jeta*. Poezi. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në: "Drita", 26 dhjetor, 1999, f. 12.

[291] A. Mickiewicz, *Kënga e Viljas*. Poezi. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në: "Drita", 26 dhjetor, 1999, f. 12.

[292] T. De Vis, *Vetëtima*. Poezi. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në: "Drita", 26 dhjetor, 1999, f. 12.

[293] J. Wolfgang Goethe, *Mignon*. Poezi. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në: "Mehr Licht!", -Nr. 10, 1999, f. 132 – 133.

[294] R. Burns, *Llord Gregor*. Poezi. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në: "Drita", 26 dhjetor, 2000, f. 12.

[295] A. Sergeijev Pushkin, *Eugjen Onjegini*. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në librin: *Eugjen Onjegini*, "Argeta-LMG", Tiranë 2001, -248f.

2002
Burns, Robert. Poezi.[296]
2003
Mickiewicz, Adam. Poezi.[297]
Burns, Robert. [298]
Heine, Henrish. Poezi.[299]
2005
Noailles, Anna de. Poezi.[300]

Përfundime:

Vitet '90 e këtej dëshmojnë një gjeografi të re të mendimit kritik në shqipëri dhe jo vetëm, përshfaqur në libra dhe periodikë të ndryshëm. Prezantohen lirshëm analiza dhe vlerësime sintezë, pikërisht në kohën më të përshatshme, të mundshme. Fundi i sistemit komunist shqiptar dhe ardhja e erës së ndryshimeve, pas vitit 1990 sollën edhe shumësinë e mendimit, të botuar brenda dhe jashtë shtetit shqiptar. Mesatarja shkon 10 deri 13 syresh.

Në krye të klasifikimit qëndron viti 2000, me 56 shkrime e botime shkencore, i pasuar, nga 2003-shi, 2005-sa dhe 2006-ta. Kjo statistikë e përpiktë tregon qartë interesin e pakontestuar për poetin e madh shqiptar.

Pjesë e vlertë e krijimtarisë letrare të Lasgush Poradecit mbetet testamenti i tij poetik, ai më impresionuesi dhe madhështori njëherazi. Poezia lasgushjane në thelbin e vet sendërtues mbetet përherë magji, pikturë dhe muzikë liqeri. Kjo vërehet në ide, mesazhe dhe imazhe, që ajo lë pas duke u vendosur në konektstin e duhur vlerësues të shqipes, përgjithësisht. Vlerësimi i kësaj ane artistike të prekshme, në kuptimin letrar si gjendje apo vizion, luan një rol primar për të fokusuar të gjitha planet e përfaqësimit të autorit, në rastin konkret të Poradecit, poetit të liqerit apo shtërgut të fundit.

Komunikimi i poezisë së Lasgush Poradecit me lexuesin parqitet aspak i vështirë, sepse përceptimi, përjetimi dhe analizimi i saj bëhet nga lexues me nivel të mirë, normalë e plot kulturë. Në të kundërt, skema e komunikimit estetik dhe letrar nuk do të mund të funksiononte. Shqetësimin për komunikim estetik real mes veprës së autorit dhe lexuesit e parashikon edhe bashkëkohësi i Lasgushit, Zef Zorba, i cili artikulon konceptin modern të marrëdhënies mes veprës dhe lexuesit, koncept që përfshin edhe përvojën e lexuesit brenda tekstit letrar.

"Komunikim është ai që s'i drejtohet një lëçitësi të plogët, pasiv, indiferent, që pret çfarë i sjell poeti-dallëndyshe për ta përtypur pa mundim, pa pjesëmarrje. Jo lexuesit të sotëm i kërkohet përgatitje shpirtërore, kulturore dhe artistike për ta bërë veten bashkautor me artistin, jo vetëm për të interpretuar atë që komunikohet, por për ta ndier dhe për ta vuajtur bashkë me poetin, duke kërkuar në vepër përfytyrimin vetjak". [301]

Nën këtë kontekst, përjetimi dhe interpretimi i poezisë së Lasgush Poradecit preket në masë të madhe nga lexuesit. Gjithçka tregon se Lasgush Poradeci vazhdon të mbetet

---

[296] R. Burns, *Meri Morison*. Poezi. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në: "Tema", -Nr. 502, 10-11 shkurt, 2002, f. 19.

[297] A. Mickiewvcz, *Pasiguri*. Poezi. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në: "Spektër", -Nr. 183, 4 tetor, 2003, f. 55.

[298] R. Burns, *Denkan Grej*. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në: "Drita", 28 dhjetor, 2003, f. 11.

[299] H. Heine, *Poezi*. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në: "Drita", 28 dhjetor, 2003, f. 11.

[300] A. de Noailles, *Asnjë ditë s'kam menduar*. Poezi. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, në: "Spektër", -Nr. 204, mars, 2005, f. 21.

[301] Z. Zorba, *Parathënie* në vëllimin poetik *Buzë të ngrira në gaz*, Shtëpia botuese "Dituria", Tiranë, 1994, fq. 99.

kulm rreth të cilit vërtiten në hapësirën e madhe letrare, qindra shkrime kritike apo studime për figurën e tij poetike dhe jo vetëm ato, por edhe mendimi i lexuesit e thjeshtë. Kjo periudhë kohore pra pas, 1992-it deri në ditët tona zë harkun më të madh të botimve rreth jetës dhe veprës së Lasgushit. Saktësisht, numërohen rreth 446 artikuj dhe studime letrare. Spikasin Jorgo Bulo, Ali Xhiku, Emil Lafe, Jani Thomai, Xhevat Lloshi, Emin Kabashi, Sabri Hamiti, Kristaq Jorgo, Sami Krosi, Adem Jakllari, Italo Costante Fortino, Shaban Sinani, Robert Elsie, Mark Marku, Dhurata Shehri, Laura Smaqi, John Hodgson, Eldon Gjikaj, Anastas Kapurani etj.
Konkretisht, në vitin e ndërmjetëm të tranzicionit më 1991, të etiketuar *"Wind of change"* nuk ka asnjë kritikë letrare të publikuar. Në vitin '92 ka dy të tilla, sikurse edhe në vitin pasardhës sërish ka dy gjithsej. Viti 1994 ka tetë botime kritike, pasuar nga viti 1995, që ka pesë botime të kësaj natyre.
Në vitet 1996, 1997 dhe 1998 ka 30 botime të ndryshme kritike, që ekzistojnë veçmas në një llogaritje të ftohtë, ndarë në dhjetëshe të plota. Janë 55 botime që i takojnë vitit 1999-të.
Hyrja e mijëvjeçarit të ri, saktësisht, viti 2000 mbart në vetvete numrin më të madh të botimeve kritike (saktësisht 56). Në vitin 2001 janë 17 gjithsej, në vitin '02 janë 32, në '03-in janë 33, në '04-ën janë 18-të, në '05-ën janë 17-të, në '06-ën janë 21, në '07-tën janë tetë dhe në vitin '08-ën janë vetëm dy të tilla.
Duhet thënë se nga ky vit e në vijim deri në ditët tona mars 2012 janë plot edhe 211 syresh të tjerë, në sinkron me veprën letrare të Lasgush Poradecit, poetit që ende jeton përmes pavdekësisë së artit të tij. Theksojmë se poetë kombëtarë si Lasgush Poradeci, ndikojnë drejtpërsëdrejti te lexuesit ose edhe tek poetët e tjerë, sepse *"shtërgu i fundit"* vazhdon të jetojë e fluturojë në gjuhën e gjallë të popullit shqiptar.
Të bjenë në sy përkthimet dhe ribotimet e L. Poradecit të cilat shtojnë receptuesit e tij. Për Lasgush Poradecin ishte e rëndësishme që poezia të kishte universialitet dhe bashkëkohësi, në mënyrë që ajo të vijojë të komunikojë me të gjitha kohët dhe lexuesit e tyre në perceptim, sepse vetëm kështu ajo bëhet e pavdekshme.

IV. KAPITULLI I TRETË

FILLESAT E KRIJIMIT POETIK

IV.1. Botimi i librit, tirazhi, lexuesit e parë. Poezitë e muzikuara

Suksesi, mbijetesa dhe fama e mëvonëshme e librave të L. Poradecit, si dhe reputacioni i shkrimtarit janë kyesisht më tepër dukuri të sferës shoqërore. Menjëherë kuptohet se, pjesërisht kjo dukuri i përket historisë së letërsisë, meqë fama dhe reputacioni i një shkrimtari maten me ndikimin e tij te shkrimtarët e tjerë, me aftësinë e tij të përgjithshme për të rimodeluar dhe ndryshuar traditën letrare. Pjesërisht, reputacioni është çështje e kritikës letrare. Deri tani kjo çështje është vështruar kryesisht mbi bazën e opinioneve pak a shumë zyrtare, të nënkuptuara sikur përfqësojnë qëndrimin e lexuesit të zakonsëm. Prandaj në qoftë se "rrethi vicioz i shijeve" është çështje shoqërore, ai duhet argumentuar mbi një bazë sociologjike më të gjerë. Një studim i tillë mund të zbulojë sekretin e suksesit të një vepre, në një kategori të caktuar lexuesish. Për këtë mund të ndihmojë grumbullimi i dëshmive për numrin e botimeve dhe të kopjeve të shitura të librave nëpër kohëra.

Për veprën e Lasgushit është shkruar që në gjallje të poetit, por më së shumti pas vdekjes së tij. Ekzistenca e gazetave dhe revistave jo vetëm në gjuhën shqipe është një nga arsyet kryesore pse në këtë periudhë nuk kanë munguar shkrimet kritike, recensionet apo vështrimet dhe informacionet për botimin e dy veprave të veçanta të Lasgush Poradecit. Edhe pse nuk do të ketë shkrime në gazeta dhe revista për çdo poezi apo vargje të poetit, ato sërish do lexohen me interes. *"Kur u ktheva nga Athina më 1920, në Pogradec ishte një mësues, Sheref Zaimi, i thoshin. I pëlqente poezia. Atij ja tregova poezinë Në çetele te kujtimit. E, këtij mësuesit, i pëlqeu shumë poezia dhe më pas se sa shumë kisha punuar unë për ta bërë. Ai shkroi në gazetë pastaj. (Unë e lexova në Rumani, se kisha ikur atëhere) -atë gazetë e kisha po se kam më"*, citon Lasgushin, Petraq Kolevica përmes kujtimesh.[302]

Një rast tjetër dëshmues vjen përsëri nga Petraq Kolevica. *"Në revistën Albania të Faik Konicës kam dërguar vetëm një poezi. Isha shumë i ri atëhere. Kur i dërgova poezinë i shkrojta Faikut*: *Me gjithë respektin dhe përunjësinë e madhe që kam për ju dhe revistën tuaj, kam këtë kërkesë. Poezisë sime, kur të shtypet të mos i ndryshohet asnjë pikë mbi i. Poezinë e dërgova të shkrojtur bukur me atë shkrimin tim, siç e di, por kur u shtyp vargu shpirti im i nxirë krejt, ishte bërë shpirti im i mirë krejt..., ndryshimi i fjalës i nxirë në i mirë, e shkatërroi të tërë poezinë"*.[303]

Lasgushi fillesën e krijimit poetik e ka lajmëruar më herët. Eqrem Çabej i tregon P. Kolevicës se kur ishin në Grac, Lasgushi i recitoi rrobaqepësit të tyre, tetë vargje në frëngjisht dhe i kërkoi të gjente autorin. *"Më në fund rrobaqepësi i dëshpëruar u dorëzua. S'e gjej dot tha. S'ke si ta gjesh -i tha Lasgushi, se këtë e kam bërë unë"*.[304]

Poezitë e Lasgushit nuk janë njohur dhe lexuar vetëm nga lexuesit shqiptarë të atdheut, por edhe nga lexues shqiptarë të Greqisë, Rumanisë apo Austrisë, posaçërisht në Bukuresht, ku edhe janë botuar një syresh i mirë i tyre si dhe dy veprat poetike të Lasgushit *"Vallja e yjve" dhe "Ylli i zemrës"*.

1933. Lasgush Poradeci. *"Vallja e yjve"*.[305]

---

[302] P. Kolevica, *Lasgushi më ka thënë...*, Shtëpia botuese "8 nëntori", Tiranë, 1992, f. 41.
[303] Po aty, fq. 77-78.
[304] Po aty, fq. 213.
[305] L. Poradeci, *Vallja e yjve*. Shtypur në "Albania", Kostancë, 1933, -119f.

Edituar nën kujdesin e Mitrush Kutelit.
Përmbajtja: Shënim i botonjësve, 8; *"Zog i qiejve", 9; "Shpirtit" (Odë), 12; "Ri mbështetur në tryezë", 13; "Kënga pleqërishte", 19; "Poradeci", 21; "Naimit", 22; "Naim Frashërit", 26; "Marshi i Djalërisë" (Himn kombëtar), 32; "E fundit mërzitje", (Marsh Shqiptar), 34; "Mëngjes", 36; "Korrik", 37; "Mbarim Vjeshte", 38; "Dimër", 39; "Gjahtori", 40; "Malli i Vjershëtorit", 45; "Trioleta", 46; "Kroj i fshatit t'onë", 48; "Syt' e lumtur", 50; "Syt' e varfëruar", 51; "Balladë" (Në frymë popullore), 52; "Mbretërija jonë", 55; "Mbretërija jonë" (Trioleta), 55; "Vallja e luleve", 57; "Ah! me-atë mall që më ke ti" (Trioleta), 59; "Ku shtrohet vala" (Romancë), 61; "Syt' e tu vetëtimtarët", 63; "Një yll përjetësije", 64; "Eja, motër", 66; "Mbretërija e zemrës", 70; "Vdekja jonë", 71; "Ri me shëndet", 73; "Mërgim", 75; "Të ritë-e viteve të mi" (Këngë), 76; "Kur të më jesh e zemëruar", 78; "Malli", 79; "Resurrectio", 81; "Letërkëmbim", 83; "Që larg", 84; "Vallja e yjve", 86; "Vallja e përjetësisë", 93; a. "Lënda dhe Jeta", 93; b. "Fryma dhe Qëllimi", 94; c. "Ndenja dhe Njeriu", 95; ç. "Njeriu dhe Zoti", 96; d. "Përjetësia", 97; "Gjeniu i Anijes", 101; "Lundra dhe Flamuri", 103; "Vdekja e Nositit", 105; "Vajtim mi trupin e Shokut", 106; "Ku qajnë motrat të vëllanë" (Vajë në kadencë popullore), 107; "Kur nuk ndjehesh fare mirë", 111;*
1937. Lasgush Poradeci. *"Ylli i zemrës".*[306]
Edituar nën kujdesin e Mitrush Kutelit.
Tryeza e vargjeve: *"Ylli", 7; "Gjumi i shpirtit", 8; "Gjuha e zjarrtë", 9; "Dremit liqeri", 13; "Zemra e liqerit", 14; "Dritë fshehtësije", 15; "Poradeci", 17; "Kënga pleqërishte", 18; "Bjenë telat" (Rapsodi), 20; "Ç'u mbush mali" (Rapsodi), 24; "Dita e njëzetetetës", 27; "Asdrenit" (Porteret), 29; "Vogëlushja", 33; "Malli i largë", 35; "Ti moj shoqe", 37; "Syr' i fshehur", 39; "Vesë dashurije", 41; "Si nus' e re", 43; "Vashë dhemshurije", 45; "Erë trëndelinë", 47; "Dashurija udhëtare", 50; "Je ulur fort", 52; "Oh, vanë fletët" (Fragment), 53; "Ç'dëgjoj me sy të trembur", 54; "Ti po vjen që prej së largu", 55; "Ah! me-atë mall që më ke ti" (Trioleta), 56; "Ku shtrohet vala" (Romancë), 58; "Dora jote ledhatarja", 60; "Posi borbuq' e trëndafilit", 61; "Eja, motër", 62; "Vdekja jonë", 66; "Ëndërr zilitare", 68; "Dëshirave", 70; "Kur në flakë", 71; "Ri me shëndet", 73; "Lamtumirë", 75; "Lamtumirë", (Variantë), 76; "Lamtumirë", (Variantë), 77; "Lamtumirë", (Variantë), 78; "Të ritë e viteve të mi" (Këngë), 79; "Kur të më jesh e zemëruar", 81; "Malli" , 83; "Më zu një mall", 85; "Më zu një mall dhe sot" (Variantë), 86; "Më zu një mall dhe sot" (Variantë), 87; "Që larg", 88; "Vallja e yjve", 91; "Kroj i fshatit t'onë", 95; "Vate prilli", 97; "Kur m'u rite vogëloshe", 98; "Kush të fali bukurinë", 99; "Ne porta nga mulliri", 100; "Del ne porta" (Variantë), 101; "Po qan vasha më shtëpi", 102; "Vallja e luleve", 104; "Balladë" (Në frymë popullore), 106; "Kush po shkon ashtu" (Trimi dhe vasha), 109; "Njeriu dhe Zoti", 113; "Përjetësia", 114; "Zemra e shokut", 121; "Gjeniu i Anijes", 122; "Lundra dhe Flamuri", 124; "Vdekja e Nositit", 126; "Përqafimi" (Rondel), 128; "Vrapojnë Zemërat", 129; "Prej çdo gazi-e hidhërimi", 130; "Kush m'a njohu dhemshurinë", 133; "Naim Frashërit" (Dorëshkrim), 135; "Të ritë-e viteve të mi" (Dorëshkrim), 136;* Fjala e editorit, 137;
Menjëherë pas botimit të dy vëllimeve me poezi, këto tirazhe do të mbërrinin në Shqipëri nga karvanet e tregtarëve, dërguar nga shqiptarët e Kolonisë së Bukureshtit. Lexuesit e parë do të jenë shqiptarët e Rumanisë dhe më pas edhe shqiptarët e

[306] L. Poradeci, *Ylli i zemrës*, Bukuresht, 1937, -184f. Me il. Shtypur në Atelieret e Shtypshkronjës "Albania", Kostancë-Rumani.

Shqipërisë. Letrat e rralla që miqtë, bashkëqytetarët, shkrimtarët e ardhshëm ia dërgojnë njëri-tjetrit në atë kohë, kujtimet që kanë lënë mes nesh janë të mjaftueshme për të provuar se si janë pritur librat me poezi të Poradecit. Në krye të kësaj dëshmie, mund të pohojmë se jo që në fillim vepra poetike është pritur me interes të veçantë.
Përkushtimi i lexuesve shqiptarë ndaj poetit do të rinisë më vonë, pas tre botimeve të para të Lasgushit. Me këto vjersha do të plotësohet kërshëria e lexuesve të grupmoshave të ndryshme edhe atyre që u pëlqejnë vargjet atdhetare, edhe atyre që u pëlqejnë vargjet filozofike apo vargjet e dashurisë. Ndoshta edhe çështje të tipit të bukurisë, llaftarisë apo vetë vdekjes që gjithherë mbetet e shenjtë për njeriun.
Poezia e dashurisë do të jetë ajo që do të lexohet më së shumti. Këto poezi do të qarkullojnë ndër lexues shqiptarë si vargje të ndjera, kurse shumë vargje do të mësohen përmendësh.
Poezitë filozofike *"Naimit"* dhe *"Naim Frashërit"* do të adhurohen veçanërisht nga lexuesit bektashinj, numri i të cilëve në Shqipërinë myslymane, në kohën e botimit të tyre, nuk mund të quhej i vogël. Do të bjerë në sy të poezive përkushtimi atdhetar i Lasgushit, që mbetet qëllim kryesor i tij kur evokon këtë figurë kombëtare. Ndërkaq, numri i lexuesve do të rritet ndjeshëm në këtë periudhë, sepse Naimi ishte figurë iluministe për vetë kombin shqiptar. Popullarizimi lasgushian pohon se jo vetëm poezia filozofike tij, por edhe ajo patriotike dhe mbi të gjitha ajo e dashurisë, tregojnë se në rrethin e të interesuarve në letërsinë shqipe ai do të radhitë shumë e më shumë lexues. Ata do të jenë të shtresimeve të ndryshme, përkatësive morale, politike por edhe fetare. Famën lasgushiane do ta rrisin edhe më, lexuesit e rinj të letërsisë shqipe, në përgjithësi do ta rrisin dukshëm më vonë tekstet shkollore ku poezitë e poetit do të studiohen. Horizonti letrar dhe në përgjithësi ai kulturor i shqiptarëve nis e mësohet me shijet e poetit të ri. Lasgushi do të bëhet shembull për shkrimtarët e rinj shqiptarë të cilët do fillojnë të mendojnë dhe shkruajnë si ai. Mjafton të shohësh botimet e revistave dhe gazetave në shekullin XX, do të kuptosh se sa i gjithanshëm është ndikimi i krijimtarisë së L. Poradecit ndër ta. Miti i Lasgush Poradecit kishte filluar të krijohej në gjallje të poetit.
Mitrush Kuteli është padyshim lexuesi i parë i veprës së Lasgushit. Nëse mbetemi në këtë qasje, punimi i tij për poezinë e Lasgushit ka formë studimore te *"Fjala e e editorit"* në botimin *"Ylli i zemrës"*. Shkrimi ndërtohet me hyrjen, bibliografinë, përballjen metakritike dhe vetë kritikën. Pjesa e parë (Të dhënat hyrëse), janë jo letrare, por na sqarojnë informacion për autorin.
"Gjer në fundin e vjeshtës së tretë të vitit 1933, kur doli nga shtypi "Vallja e yjve", një pjesë e vjershave të Lasgush Poradecit ishin të përhapura nër fletore e të përkohshme, e të ndryshme të mërgimit, kurse pjesa tjetër dergjej në dorëshkrime pa parë edhe dritën e shtypit. Nga vershat e shtypura shumica ishin ngarkuar me gabime shtypi të rënda, të cilat i shëmtonin aq formën dhe përmbajtjen. Këto gabime shtoheshin dhe madhoheshin me rastin e rishtypjes së vjershave, pa lejen e poetit, ne fletoret e revistat e brendshme ose të jashtme. Në të tilla rrethan të vështira, kuptohet kthjelltazi se lëçitësi shqiptar nuk kishte mundësinë të njohë drejtpërdrejt e në mënyrë të plotë artin e vargjeve të Lasgushit".[307]
Kështu, të dhënat nga niveli i informacionit mbi publikimin arrijnë te ai i gjendjes së tekstit. Duke i shoqëruar vargjet e Lasgushit kritika e Kutelit nga ky moment komunikon me lexuesin në funksionin e ndërmjetësuesit. Kompetenca ndërmjetësuese e fjalës së editorit rritet nga një nivel i kritikës te tjetri.

[307] M. Kuteli, *Vepra letrare 5*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1990, fq. 192.

Shënimi bibliografik jep të dhëna për lëvizjen e poezive nga njëri libër i Lasgushit te botimi i radhës. Vështrimi i Kutelit është i pajisur më tituj poezish dhe me numrin e tyre (pra bën një statistikë e poezive të Lasgushit), por edhe i titujve të poezive, që futen për së pari në këto botime. Me një fjalë Kuteli bën rolin e strukturuesit të librit.
"Arsyet për të cilat po i radhosim në "Yllin e zemrës", vjershat e mësipërme janë të ndryshme. Shkaku i parë është se "Vallja e yjve" është shtypur vetëm pesëqind copë të përhapura brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ka arritur sot fort e rrallë. Lexuesit që nuk kanë "Vallen e yjve" do të gjejnë në këtë vëllim disa nga poezitë e atij libri, gjersa "Vallja e yjve" ka për të dalë në një edicion të ri".[308]
Gjysmë shekulli më vonë një autor tjetër, Sabri Hamiti tanimë në Kosovë, do ta strukuronte më pas poezinë e Lasgushit të plotë, atë të dy librave në një të vetëm.
Në vitet '90-të të shekullit XX, një shkrirje të botimeve të poezive bën edhe studiuesja Frida Idrizi.
Nëse Kuteli bëri në botim një përfshirje sa më të plotë të librave të Poradecit, S. Hamiti e strukturoi atë duke iu përmbajtur sistemit poetik të veprës së tij letrare. Edhe F. Idrizi bëri një strukturim të ndryshëm nga dy të parët duke bërë renditjen filologjike, pjesë të burimit të parë.
Në këtë vështrim Kuteli shton nuancën e një polemike. Në nivelin themelor të kritikës së Kutelit, poezia e Lasgushit vështrohet në planin e gjenezës si formë e si kuptim, duke shpallur gjenogjendje të poetit. Kërkimi në formën e tekstit, nis nga fjalori poetik, ecën nga figura, stili, çështjet e metrikës dhe fonologjisë. Ky është aplikimi i një analize konstatuese, e cila shtrihet deri në analizën e motiveve të tekstit letrar. Kuteli ndjek "mënyrën demonstrative" të kërkimit. Këtu mbyllet analiza dhe nis interpretimi. (Analizë formale, analizë funksionale, inerpretim poezish).
"Në këtë mënyrë, ekziston një kapërcim nga kërkimi i formave te dialogu me tekstin, nga kërkimi sistemor, te kërkimi tematik. Nga format tek idetë. Në gjithë këtë format janë një "rrugë" që shtrohet pët të nisur dialogimi me idetë. Tash, nuk e di se si mund të shpëtojë njeriu nga dialogu me tekstin secilën herë, meqë një distancë me të mund të ruhet vetëm gjatë analizës".[309] Në dukje dalin format të cilat të çojnë tek idetë. Kemi kështu dialog me tekstin. Atmosfera e teksitit është e barabartë më atmosferën e lexuesit. Ky tip mishërohet në teksitin kutelian.
"Lasgushi shfaqet e mbetet një kulm vigan, i cili ka për të zotëruar shumë kohë me hijen e vet literaturën dhe mendimin shqiptar".[310] Ky pohim i paradokohshëm i Mitrush Kutelit për poezinë e Lasgush Poradecit, ecën nëpër gjurmët e kësaj poezie dhe sendërtohet. Kuteli njeh mirë sistemin poetik të Lasgushit, por edhe sisitemin e ideve të tij, si një nga dialogjet e kësaj poezie me poezinë e autorit të liqerit.
Ky dalog e shokon poezinë e Lasgushit të lidhur me subjektin e veprës së tij. Mitrush Kuteli njeh Shqipërinë fizike dhe metafizike të poetit. Njeh patriotizmin, erosin dhe temat filozofike të Lasgushit. Thjesht Kuteli njeh poezinë me Jetë-e-me-Vdekje.
Te *"Disa fjalë mbi vjershat e reja të Lasgushit"* dialogu rrudhet në kufirin e një recensioni letrar. Poezitë e reja të Lasgush Poradecit, domethënë ato që poeti i botoi pas Yllit të zemrës, Kuteli i kualifikon kështu: *"Vjershat e reja të Lasgushit ne i ndajmë më dysh: një pjesë e shkruar me tonoin madhor të poezisë dhe pjesa tjetër e një insiprate minore, dekadente"*.[311]
Të parat i sheh në rrjedhën e poezisë së Lasgushit. Të dytat, përfundimisht i kualifikon një lojë fjalësh. Në të dytat fut edhe poezinë e njohur *"Trashëgimi"*,

[308] M. Kuteli, *Vepra letrare 5*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1990, fq. 195-196.
[309] *Dialog me shkrimtarin Sabri Hamiti*, Intervistë te "Jeta e re", Prishtinë, nr. 1, 2001, fq. 12.
[310] M. Kuteli, *Vepra letrare 5*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1990, fq.242.
[311] Po aty, fq.256.

poezinë në të cilën Lasgushi bërtet për moskuptimin e poezisë së tij nga Krist Maloki. Si përfundim duket se moskuptimi këtë herë ka prekur edhe Kutelin, njeriun që e kuptoi Lasgushin i pari në krijimtari.

Le të shohim kronologjinë e kuptimit dhe moskuptimit të veprës letrare lasgushiane.

Ideja për botimin e një libri me poezi të Llazar Gushos zë fill më 19 korrik 1929 dhe çuditërisht është një propozim nga një pogradecar që shkollohej dhe punonte në Bukuresht të Rumanisë. Kuteli do ishte kështu njëherazi edhe lexuesi i parë i lëndës së përzgjedhur për botim. Këtë ide Dhimitër Pasko do ia përcjellë drejtpërdrejt poetit të ardhshëm. *"Ke nër mënt të mbledhësh vjershat në një volum? Unë e dëshëroj nga fellësi' e shpirtit që kjo të bëhet sa më shpejt"*.[312]

Ndërkaq përgjigjja e Llazar Gushos nuk vonon nga Pogradeci më 22 shtator 1929. Ajo bëhet me letrën e radhës duke nënkuptuar vështirësitë sociale që kalontë poeti i ri. *"...më thua t'i mbleth poezit' e përhapura andej-këtej më një volum, po, natyrisht as të vete mendja të më pyesish as ke shkak(sic duket) të mësosh me se rroj dhe a kam ç'të ha për ditën e sotme, për ditën e nesërme"*.[313] Gjithherë duhet t'i dashurosh me shpirt gjërat që ato të bëhen realitet, sikundër thuhet në popull pa dashuri asgjë nuk bëhet. Kjo vihet re edhe nga poeti i liqerit kur kumton: *"Ti i shtrenjtë Dhimitraq, i cili i ke dashuruar aq imtësisht vjershëzat e mija, vjersha LUMTËRONJËSE NË TRAGJEDINË e tyre, nuk do të ketë shpëtuar -mbase-, BESIMI... IDEJA..., FILOZOFIJA... e tyre MALL-plote, JETË-plote, GAS-plote, PËRJETËSI-plote, dyke filluar që në fillim gjer në fund*: *që ne "PARAFJALA" gjer ne "GJENIU I ANIJES" dhe gjer ne "VALLJA E PËRJETËSISË"*.[314]

Në fakt nga letërkëmbimi Lasgush-Mitrush mësojmë se një përpjekje për të realizuar një botim të vjershave të Llazar Gushos kishte bërë në Tiranë edhe një librashitës me emrin Canco bashkë me Skënder Luarasin. *"Poezitë e mia më kot u mundua t'i shtypi Cancua me Luarasin..."*.[315]

Një përpjekje më e hershme ishte bërë për një përmbledhje me poezi të Lasgushit, që vetë ai e quan "volum" imagjinar që më 1924-ën, nga Shoqëria "Albania", në Vjenë. *"...verën e shkuar kur isha ne Zagia erdhi Kryetari i Shoqërisë Leks Buda dhe më lajmëroi se Komiteti ka vendosur të destinojë gjetkë shumën që ndodhet në arkë (700 schiling) për shtypjen e poezive të mija Ish fjala të më dorëzoheshin ato të holla Nëntorin e shkuar, që të përkujdesem unë vetë, i ngarkuar prej Maecenas-ve të mij vienezë, çështjen tipografike*. *Volumi do të mbante shënimin*: *shtypur me përkrahjen lëndore të shoqërisë "Albania", Vjenë"*.[316]

Më 21 janar 1933 Kuteli e pyet Poradecin për volumin e poezive të tij. *"Ç'ndihmë mund të mbledhim këtu për shtypjen e volumit?"*.[317] Ndërkaq që ëndrra e botimit të mos mbetej utopi, sikundër del në këtë letërkëmbim, është Lasgushi që në letrën e 12 nëntorit 1933, i kërkon Kutelit ndihmë për botimin e tij. Më 4 mars, 1933 Mitrushi i tregon se ai dhe Kolonia e Shqiptarëve në Bukuresht kanë nisur të mbledhin shumën e duhur të botimit. *"Shoqëria jonë jep 900 lei*. *Mbesoj që brenda kësaj jave do të përplotësoj 18000 ose 20000 lei (afron 30 napolona)"*.[318]

---

[312] L. Poradeci, *Vepra IV. Korrespondencë Lasgush Poradeci-Mitrush Kuteli*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë, 2010, fq. 18.
[313] Po aty, fq. 19.
[314] Po aty, fq. 44.
[315] Po aty, fq. 45.
[316] Po aty, fq. 81.
[317] Po aty, fq. 81.
[318] Po aty, fq. 85 .

Po në këtë letër, Kuteli tregon se Lasgush Poradeci duhet të vendosë vetë për shtypjen e poezive. *"Të sgjedhish ti vetë editorin, kartën, formatin...Pregatit dorëshkrimin. Dëshiroj të jesh vetë ali, vetë kadi për shtypjen e poezive. Pregatit dorëshkrimin..."*[319] Më 10 mars 1933, sërishmi është Kuteli që e mban në kontakt Lasgushin për shumën e lekëve të mbledhura për botimin e vëllimit të parë me poezi. *"Gjer më sot janë mbledhur 17000 leipër shtypjen e broshurësdhe këto vetëm nga katër veta (Shoqëria 9000, Tërpo 5000, Asdreni 2000 dhe Dogani 1000. Naduhen edhe 3000 për të bërë shumën prej 20000 sa e caktuam në Shoqëri*.[320]

Kuteli i kujton në këtë odise botimi, që libri të botohet në Shqipëri dhe sipas tij, lekët e mbledhura do ia niste përmes Konsullatës Shqiptare në Rumani. Mitrushi i kërkon Lasgushit kopje të këtij botimi, ndërsa i premton shitje ndër shqiptarë të Rumanisë. Përmes letërkëmbimit, poeti poradecar bindet që botimi i librit të tij të parë do të jetë shumë afërt në kohë. Ai nis punën për redaktimin, ndarjen në cikle të poezive dhe renditjen e tyre. *"1. Të kthehet, pas "Kroj i Fshatit t'onë" dhe varianti i vjetër "Kroji i Poradecit" me nëntitullin vriantë. 2. të hiqet poezia "Vjershëtori i marrë" apo "Përtallësve" nuk ka sens. 3. Në vend të " Kuqajnë motrat vëllanë" të vihet titulli i vjetër Logori është më i bukur. 4. Te poezia "Mërgimi" (strofa1) në vend të zemërka është më mirë qamatar dhe në vend të zëmbak: por si ar. Mos harro që fjala zëmbak është përdorur shumë herë. a) "Të rit e viteve të mi"(strofa 6), b) "Logori" (strofa1), c) "Vdekja e Nositit" (strofa 2), d) "Mërgim" (strofa 1) etj. 5. Gjej një titull tjetër në vend të "E fundit mërzitje" 6. Në poezinë "Poradeci" më duket më e bukur strofa (1). Perëndimi vagëlluar mbi liqerin pa kufir/po përhapet dal-nga-dalë një pëhurë si një hije/nëpër fshat e nër lëndina shkrumb i natës që po bije..*.[321]

Mitrush Kuteli e shtyn Lasgushin drejt botimit të librit të parë. *"...shkundu Llazar dhe vështro rrotull. Një njeri vlen sa vepra e tij. Ku e ke veprën?[...]Unë pres formën e parë të volumit t'ënt"*.[322]

Në gjithë këtë qerthull dritëhijesh të letërkëmbimit Rumai-Shqipëri, Mitrush Kuteli vendos përfundimisht që t'ia botojë librin Lasgush Poradecit në Bukuresht. Kuteli i kujton se horizonti pritës andej dhe këtej kufirit është i paduruar.

Më 5 maj 1933 i shkruan nga Bukureshiti: "*Pyetjet e dendura*: *kur dalin poezitë e Lasgushit, sa e sa insceptibilitete... Eshtë detyrë për ty dhe për mua që të dalë volumi. Meqë ti nuk munt dërgo-ma këtë dorëshkrim së bashku me shënimet e tua të fundit... Korrekturat do t'i dërgoj aty. Ti të më tregosh formatin që të pëlqen. Të tjerat ler-i në kujdesin t'im"*.[323]

Për të mbetur të pastër në shoqëri, Lasgushi i kujton mikut të tij altruist së librin ai s'mund ta botojë në Shqipëri për shkak të gjendjes shëndetësore, ndërsa një pjesë të hollash (35 napolona floriri) i kishte prishur për të mos vdekur në dhe të huaj prej flakës së sëmundjes dhe flakës së provimeve.

Në letrën që Lasgushi i dërgon Kutelit më datën 4 gusht, 1933 falënderon miqtë e Bukureshtit për përpjekjet e botimit *"Vallja e yjve"*. Madje nënvizojmë se vetëm përmes kësaj letre merret vesh titulli i vëllimit të parë të Lasgushit. Kjo ide ripërsëritet edhe në letrën e datës 4 nëntor 1933, kur Mitrushi i kërkon t'i sqarojë se *"Qysh mundet edhe titulli edhe nëntitulli i librës të jetë "Vallja e Yjve"*. [324]

[319] Po aty, fq. 85.
[320] Po aty, fq. 86.
[321] Po aty, fq. 90-91.
[322] Po aty, fq. 93.
[323] Po aty, fq. 95.
[324] Po aty, fq. 108.

Lasgushi në këtë letërkëmbim i tregon mikut ofertat që ka marrë nga tri shtypshkronjat e kohës për të shtypshkrimin. *"Më 7 korrik mora një ofertë shtypjeje për 840 fr. ar nga Shtypëshronja "Gutenberg", më 26 korrik një tjetër ofertë për 630 fr. ar, (3000 ekzemplarë) po prej asaj shtypshkronje (kurse ajo e "Arbërisë" ka kërkuar 3000 fr. ar dhe ajo o Kristo Luarasit 1500 fr. ar".*[325]

Mitrush Kuteli është editori dhe njëkohësisht lexuesi i parë i të parës vepër poetike me titullin *"Vallja e yjve"* të Lasgush Poradecit. Gjithçka ka ndodhur më 17 nëntor 1933. Si një nikoqir i mirë, Kuteli liston edhe këshillat e para. Mos fal libra. *"Në asnjë mënyrë nuk lipset t'i shperndash pa të holla".*[326] Madje caktohet edhe çmimi, 3 franga ari copa. *"Do të doja që volumet e tua të para të mos i japësh lirë ose falas. Do të ishte gabim t'i shisje për 3-4 lekë. Sado që të kesh nevojë dhe sado e madhe të jetë kriza, për një libër, një lek kushton vetëm transporti aty".*[327]

Kuteli përcjell edhe një tjetër informacion interesant aktual për kohët. Lexuesi duhet të shkojë te libri dhe jo libri te lexuesi. Gjithkush duhet ta blejë librin në librari ose më saktë të gjejë një burim shitjeje dhe ta sigurojë. Kjo është kulturë mbi të gjitha në respekt të librit dhe shkrimtarit, në rastin konkret poetit të liqerit. *"Cili do ta ketë e gjen pazarin".*[328]

Letra përmban edhe informacion për shpërndarjen e vëllimit poetik nëpër Shqipëri dhe Rumani. *"Gjër tani kam dërguar ne Cancua 142 copë, në Dhori Koti 20, ne Kotzias-Korçë 20 dhe ne Stefan Tati, Durrës 10 copë. Librat do shiten për hesapin t'ënt nga 3 franga ari copa. Dëshëroj të nxjerrish gjësend për harxh".*[329] Një kopje e librit i shkon edhe Lasgushit ne Grac.

Një ndër lexueset e para të *"Vallja e Yjve"* është edhe Lula, e dashura e Lasgushit nga Rumania. Lexues të tjerë që kanë marrë një kopje nga libri janë Mbreti Zog dhe ministri i Arsimit të kohës, libra të dërguar posaçërisht për ta, sërishmi, nga Mitrush Kuteli. Recenzat e botimit i bëjnë Dr. Zoi Xoxa, librashitësi Canco, Bubani dhe Lumo Skëndoja. Një rol të rëndësishëm zë në këtë letërkëmbim edhe shtypi, një tjetër horizont pritës, informues përballë lexuesit të "etur" për poezi në vitet '33. Kuteli veçon: *"Të gjitha gazetavet dhe revistavet ju kam dërguar nga një eksemplar".*[330] Ndërkaq poezitë e Lasgushit dhe përkthimet e tij, plus disa intervista do botoheshin brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Kjo është lista e organeve të periodikut, në të cilin është botuar vepra letrare dhe intervistat e Lasgush Poradecit (1922-2009).

"Dodona"; "Djalëria"; "Mbleta"; "Shqipëria e Re"; "Dielli"; "Gazeta e Re"; "Studenti Shqiptar"; "Ora"; "Arbëria"; "Gazeta Shqiptare", "Vullneti"; "Neo-Shqiptarizma"; "Vullneti i Popullit"; "Shqiptarja", "Demokratia"; "Kosova"; "Gazeta e Tiranë"s; "Minerva"; "Shtypi"; "Illyria"; "Kuvendi Kombëtar"; "Vatra e Rinisë"; "Përpjekja Shqiptare"; "Shkëndija"; "Bota e Re"; "Rinia Fashiste"; "Tomori"; "Tomori i Vogël"; "Njeriu"; "Drita"; "Kombi"; "Letërsia Jonë", "Nëntori"; "Zëri i Popullit"; "Jeta e Re"; "Zëri i Rinisë"; "Studime Filologjike"; "Les Lettres Albanaises"; "Pionieri"; "Zëri i Vlorës"; "Fjala"; "Rilindja"; "Pararoja"; "Puna"; "Filizat"; "Luftëtari"; "Atdheu"; "Shpresa"; "Finoku"; "Kushtrim Brezash"; "Korça"; "Gëzimi"; "Rilindja Demokratike"; "Demokracia"; "Borëbardha"; "Nositi"; "Dardania"; "Teuta"; "Revista Letrare"; "Evropa";

[325] Po aty, fq. 102-103.
[326] Po aty, fq. 109.
[327] Po aty, fq. 118.
[328] Po aty, fq. 109.
[329] Po aty, fq. 108.
[330] Po aty, fq. 108.

"Populli Po"; "Lajmi i Ditës", "Sirena e Vogël"; "Republika"; "Ushtria dhe Koha"; "Mer Licht!"; "Liqeri", "Për Mëmëdhenë"; "Albania"; "Klan"; "Bota Ime"; "55"; "Diaspora Shqiptare"; "Aleph"; "Glossa"; "Stil '97"; "Mokra"; "Përmeti"; "Aks"; "Jehona e Karadakut"; "Tema"; "Diella"; "Panorama"; "Korrieri"; "ABC"; "Shekulli"; "Kalendari Letrar"; "Milosao"; "Poeteka"; "Pena"; "Express"; "Tirana observer", "Ndryshe"; "Gaia"; "Obelisk";

Titujt dokumentojnë gjithçka duke arshivuar me këtë akt, një pjesë me vlerë të veçantë në kulturën mediatike. Botimet ekzistojnë sikur copat e gurit formatojnë një mozaik të vetëm, me të gjitha publikimet që kanë të bëjnë me Lasgushin, duke na përftuar pamjen tërësore të atij informacioni të gjerë, deduksionit, që do të na nevojitej konkretisht për poetin, në mënyrë që të komunikojmë me imazhin letrar, iduksionin e tij.

Librat mësohet gjithashtu që janë shumica botim i thjeshtë dhe pjesa tjetër me kartë të zgjedhur, deseni. Kuteli i kërkon Lasgushit mendim se si është pritur libri ndër shqiptarët e Shqipërisë, një horizont pritës shumë domethenës për një editor. Njëkohësisht edhe test kryesor për pulsin e një poeti. *"Po në Shqipëri si u prit? Librat u shitën?"*.[331]

Një përgjigje që nuk u vërtetua asnjëherë se librarët e asaj kohe s'i dhanë kurrë lekët e shitjes, sikundër pohon vetë Lasgushi në lëtërkëmbimin e botuar. *"Cancua nuk më dërgoj në Pogradec, nuk më dha as në Tiranë 5 napolonat nga llogaritja e librës, sikundër i kishe shkruar dhe (si jo?!) ishe i sigurt"*.[332] Në letrën e 4 dhjetorit 1933 dërguar Mitrushit, nga Graci i Austrisë Lasgushi e falënderon për gjithçka ai bëri për botimin e librit të tij. *"Për dhuratën mundim-madhe të editimit dhe publikimit zemra ime të falënderon. Lasgush. P. "*.[333]

Më 19 shkurt 1934 Kuteli i dërgon me postë 9 kuti që përmbajnë 81 volume. Në këtë datë, bëhet përmes letrës edhe komplimenti i parë i Kutelit, njëkohësisht edhe si lexuesi i parë i vëllimit. *"Mund të them miku im i dashur edhe mendimin tim për vëllimin tënd. Eshtë shumë i mirë"*.[334]

Më tej në letrën e 11 marsit 1935, diskutohet një ribotim i mundshëm i *"Vallja e Yjve"*. Gjithashtu në këtë letër sqarohet s'e nuk do mblidhen ndihma në Bukuresht për ribotimin e librit. Pjesën e librave të mbetur të tirazhit të parë i ble të gjitha Cancua, librashitës në Tiranë me shpirt tregtari. Madje mësojmë se Canco nuk bëri asnjë përpjekja për ta shpërndarë librin në Shkodër, Elbasan dhe Gjirokastër.

Horizonti pritës dhe etja e lexuesit nuk respektohet për ta shpërndarë librin nëpër Shqipëri *"Mik i mirë njihet mik në të keq e në rrezik. Shoku jonë më s'është ç'qe. Kam vendosur t'i-a kthej prapë pendën prej arëgjendi (filigran) që m'a dhuroj sot e pesë vjet kur ish idealist, d.m.th. kur s'qe kapitalist"*.[335]

Më 10 dhjetor 1935 Lasgushi merr nga Kuteli edhe 27 copë të tjera *"Vallja e Yjve"*. Kronologjia datore e 10 nëntorit 1936, shënon nisjen e një bashkëpunimi të frytshëm mes Kutelit dhe Poradecit, për përgatitjen dhe me pas botimin e vëllimit të dytë poetik të Lasgushit *"Ylli i zemrës"*.

Kuteli i kërkon Lasgushit dërgesën e dorëshkrimve poetike, ndërsa i kërkon gjithashtu, që formën e librit t'ia lërë në dorë atij. Lexuesi apo lëçitësi sikurse evidentohet në letëra, përsëri vështrohet si "mbret" nga Kuteli. Për të mos e lodhur as ndikuar, ai i kërkon Lasgushit që shënimi i Kutelit të cilin do ta ketë libri, të qëndrojë

[331] Po aty, fq. 109 .
[332] Po aty, fq. 112.
[333] Po aty, fq. 114.
[334] Po aty, fq. 118.
[335] Po aty, fq. 123.

në fund. *"ky shënim të dalë në funt, për dy arësye*: *që të mos hedhë asnjë fill hije mbi poezitë, të cilat lëcitësi t'i shijojë me intuicionin e tij, me ndjenjat e tij, duke komunikaur drejt-për-drejt me artin t'ënd"*.[336]
Më 15 nëntor 1936 Kuteli i sqaron mikut të tij poradecar, se po përpiqet të nxjerrë një libër me shije estetike. Formati i botimit do të jetë pak më i gjerë se i Valles... Madhështia e shkronjave do të jetë më e dukshme, më të mëdha e më të plota. Ai i thotë që *"Ylli i Zemrës"* do të ketë 160 faqe dhe që do mundohet ta nxjerrë librin po aq të bukur sa *"Vallja e Yjve"*. Lasgushi i shkruan gjithashtu, se kopertina e këtij libri do të përgatitet nga O. Paskali. *"Skulptori O. Paskali po ilustron një mbulesë për "Yllin e Zemërës", po që simbolizon idenë e përbashkët të të dy volumeve, më fliste këto vite disa herë për këtë gjë, dje më tha rrugës se për nja 4-5 ditë e ka të mbaruar"*.[337]
Kuteli betohet se ai ia dashuron vjershat me flakën që i dashuron edhe Lasgushi vetë. Në këtë bashkëbisedë miqsh Kuteli i ngacmon ëndrrën e vjetër poetit, pikturën. Ai i kërkon që kopertinën ta bëjë vetë Lasgushi. *"Cili mbeson se do kuptojë më mirë se ti vetë intuitën e shpirtit tënd? Dhe cili do ta shpjegojë më mirë se ti vetë?"*.[338]
Lasgushi ndërkaq dërgon në Bukuresht herë pas here poezi të reja dhe të ripunuara për t'u bërë pjesë e vëllimit *"Ylli i zemrës"*. Lasgushi lutet që libri i ri të mos ketë gabime dhe i kërkon editorit të tij: botimi të mos mbajë si datë daljeje nga shtypshkronja vitin 1936, por 1937-ën, meqë viti i ri ishte në prag[...] letra e 4 prillit 1937 e lajmëron Llazarin për tirazhin e Yllit. Ai do të jetë 1700 - 2000 copë, jo në edicion popullor, por edicion poezie. *"Libra do dalë në 1700 ose 2000 copë"*.[339]
O. Paskali vonon kopertinën dhe nga letërkëmbimi mësojmë se Kuteli ia beson atë piktorit rumun Ary Murnu, i cili bën dy skica ilustruese për poezinë lasgushiane. Po sipas Kutelit mësojmë se Kolonija e Bukureshtit ka vdekur dhe se shpenzimet e botimit të librit janë personalisht të tijat. Shpenzimet e librit këtë herë shkojnë në 50000 lei (afërsisht 50 napolona). *"Tashi për tashi të lajmëroj me dhembje se Kollonija e Bukureshtit vdiq, më mirë ka vdekur prej kohe"*.[340]
Eshtë ky një aludim i parakohshëm për t'i treguar Lasgushit, që pjesën më të madhe të lekëve të botimeve të librave të tij janë botuar me kursimet e vetë Kutelit. Indirekt, nënkuptohet kjo e vërtetë me lajmërinin për shuarjen e kolonisë në dhe të huaj.
Më 3 maj 1937 Kuteli përmes letrës së radhës lajmëron se *"Ylli i zemrës",* që do të dilte në nëntor ose dhjetor, do të dalë në maj. Lasgushi kërkon që shumicën e librave t'ia dërgojë atij personalisht. Siç duket eksperienca e shpërndarjes së librit të parë, nuk rezultoi e sukseshme. Ndoshta një pjesë librash humbën ose një sasi nuk shkoi në dorën e lexuesit i cili e kërkonte, por përfundoi në depo librashitësish, që i blenë dhe i shitën pak më shtrenjtë. *"Të lutem prapë, librat të m'i dërgosh mua, (dhe vetëm mua), asnjeriu tjetër mos i dërgosh, asnjë copë. të gjitha. Të jap fjalën se nuk do t'i shes më lirë nga çmimi i caktuar prej teje pikërisht-dhe kur ta jep fjalën Llazari, grin veten për ty"*.[341] Në letrën e nisur nga Kostanza më datë 28 maj 1937 Kuteli informon, Lasgushin se vazhdon puna për shtypjen e Yllit. Janë shtypur 96 faqe. *"Së shpejti do të dërgoj të parat volume. Kam disa volume në kartë poroze dhe të tjerat në kartë kinë (Vetëm karta për volumin e parë kushton 12 lek (120 lei)"*. [342] Më 2 qershor, 1937 del

[336] Po aty, fq. 130-131.
[337] Po aty, fq. 133.
[338] Po aty, fq. 138.
[339] Po aty, fq. 143.
[340] Po aty, fq. 144.
[341] Po aty, fq. 148.
[342] Po aty, fq. 151.

boca e parë e vëllimit të dytë poetik *"Ylli i zemrës"*. Kuteli e sqaron poetin se për dytri ditë do shtypet shkrimi i tij kritik dhe kopertina e librit. Sërish aludohet për shitjen e librit, që mbetet një problem i madh edhe në vitet '30-'40 në Shqipëri.
Sipas Kutelit, autori dhuron, nuk di të shesë libra. *"Librat lipsen dërguar (pjesërisht) një agjensie që ka eknikën e marrëdhënieve tregëtare. Dhe që ti nuk do t'ja japësh Cancos, unë të këshilloj të merresh vesh me ndonjë tjetër. Bie fjala me Dhori Kotin ose me ndonjë që mund të rekomandojë Vangjel Treska. Ky të ketë ekskluzivitetin"*.[343]
Kuteli e fton Lasgushin të shkojë në Bukuresht, ku duhet të njohë nga afër rrethin letrar të krijonjësve, atje dhe atmosferën e tyre krijuese. Në ndryshim nga Shqipëria ka më shumë aktivitete. Ndërkaq, e porosit të mos krijojë vetëm vjersha me frymë popullore. Data e saktë e daljes së vëllimit poetik *"Ylli i zemrës"* është 30 shtator 1937. Lajmëruar që në fundvitin e '36-ës, libri del në fundshtator. *"Pas kaqe vonime, më në fund dollli nga shtypi "Ylli i zemrës". Libra peshon 550 gr. Teksti im, -e sqaron Kuteli, ka 40 faqe. Ku të t'i dërgoj me vapor në Durrës ose Selanik, ndryshe, me postë, e pamundur"*.[344]
Mitrush Kuteli me mjaft intuitë sugjeron që botimi i dytë poetik të ketë një shënim botuesi vetëm në fund, me qëllim që mos induktohet "lëçitësi".
Kuteli përmes botimeve të veprës poetike lasgushiane dha shembullin e botuesit në shërbim të kulturës kombëtare dhe jo të botuesit në shërbim të biznesit. Më herët kjo qe provuar edhe me Fan Nolin poet. Vlen të thuhet se *"Ylli i zemrës"*, pasi pa dritën e botimit, njohu edhe sy e duar lexuesish, rumunë. *"Një mik e profesor i njohur këtu, anëtar korrespondent i Akademisë Rumune do prezantojë Yllin e zemrës në Akademinë Rumune. Si të shpëtoj nga dallga e punës që më ka pllakosur, do të shkruaj gjësend në ndonjë revistë rumune, përmbi veprën t'ënde"*.[345]
Profesori është Th. Capidani titullari i kathedrës së filologjisë së krahasuar. Capidani ishte i entuziazmuar për bukurinë e veprës dhe për begatinë e saj nga pikëpamja e gjuhës. Një kopje tjetër e merr zonjusha Megas, profesoreshë për specialitein e higjenës në një shkollë vashash në Buzargic.
Kuteli kërkon të dijë me ngut nga Lasgushi, si e ka pritur lexuesi shqiptar vëzhgimi i tij kritik. Një recension botohet në gazetën *"Drita"*, nga zoti "M". Vërehet xhelozia e mungesës së shkrimeve në Shqipëri për librin e Lasgushit. I premton se do shkruajë në rumanisht për bitimin *"Ylli i zemrës"*. Një lexues tjetër i asokohshëm është edhe xhaxhai i Mitrush Kutelit, doktori Paskua që jeton jashtë Bukureshtit dhe i përcjell fjalë të zgjedhura për librin. Lexuesi i radhës është kompozitori rumun Mihailescu-Toscani. Mësojmë gjithashtu nga letra e 22 prillit 1938 se 1200 libra kanë mbrritur në Shqipëri me vaporin *"Vesta"* nga Kostanca.
Kuteli e informon Lasgushin se një kopje të librit të tij ia ka dërgaur me postë Mbretit Zog të Shqipërisë, i cili mbetet sërish lexues kryesor për veprën e poetit L. Poradeci.
"I dërgova Mbretit një copë nga "Ylli i zemrës" së bashku më një prononcim për themelimin e një "Instituti Mbretëror i Kulturës Kombëtare".[346] Një kopje merr nga vëllimi i dytë i Lasgushit e dashura e tij, Lula, libër që ia dërgoi përmes postës Kuteli si dhe Lumo Skëndua.
Për gjithë mundin e derdhur dhe punën e kryer për botimin e *"Ylli i zemrës"*, Lasgushi i dërgon mirënjohje Mitrush Kutelit, njeriut që me mirëkuptimin e tij të madh dhe altruizmin e vërtetë të një shqiptari të madh, botoi dy librat e Lasgushit në Rumani. Mirënjohja shkon për studimin kritik që ai i bëri poezisë së Lasgushit në një

[343] Po aty, fq. 152.
[344] Po aty, fq. 156.
[345] Po aty, fq. 158.
[346] Po aty, fq. 163.

kohë që shumë shqiptarë të tjerë heshtën. *"I ke vrarë me topuz të tmerrshëm që rëndon shumë sa nuk iau mbajnë eshtrat , të njohurit e tu të njëhershëm, "miqtë" e tu të tanishëm. Prandaj dhe potentatët e redaktorive gazetare, heshtën heshtje morbide[...]Armiqtë e tu kanë nevojë të dridhen pak. Kështu janë mësuar".*[347]

Librat e mëdhenj i nderon koha. Librat, koha i ul dhe i ngre, sipas vlerës së vërtetë që ata mbartin në përjetësi. I tilllë është edhe arti që mban firmën e Lasgush Poradecit. Koha tregoi se ai nuk mund të vdesë, përkundër madhështohet në krahët dhe hapësirën e pamatë. *"Ti shtyp-e bukur Mitrush, me dashuri, asgjë e mirë s'bëhet pa dashuri, as në këtë botë, as në tjerat, vlera e një gjëje von a shpejt imponohet vetvetiu. Për gjërat e mëdha duhet një vleftësim në kohë të madhe. Kohës së madhe i thonë kohë e gjatë, dhe kohë e gjatë i thonë asaj që ngurros, që bën prej guri, monumentet e manifestimit të vlerave shpirtërore, të cilat përbëjnë kulturën e një populli".*[348]

Nga ky letërkëmbim, mësohet se librin *"Ylli i zemrës"* e kanë marrë edhe ministri i Jashtëm, si edhe ministri i Brendshëm shqiptar.

Numri i lexuesve sa vjen edhe rritet, informon Mitrushin vetë Lasgushi, në letrën e datës 26 qershor 1938. *"Nga Ylli i zemrës më kanë marrë mjaft, shpresoj të jap dhe pak(fort pak) të tjera. Armiqt' e tu personalë bënë bojkotimin: Heshtnë. Si ata që heshtin nënë varr. I ke futur ti në varr. Edhe me Vallen e yjve ashtu bënë: Heshtnë. Sepse i ka zënë gjrpri në vend të lig... Ty, të gjithë të lëvdojnë, të lavdurojnë. Vëzhgimi i ka habitur, siç të shkrojta prej kohe, me parashtrimet e tija, editimi monumental i Y. të Z. (i cili ju kujton atë të V së Y.) i ka bindur".*[349]

Në këto rreshta na bën përshtypje armiqësia që gjithherë ekziston në art, madje në çdo kohë. Talenti zhvillohet mes dashamirësh dhe armiqsh, të cilët hedhin baltë dhe shpifje mbi veprën e tyre. *"Pastaj shtypin e përditshëm e mbajnë armiqtë e tu personalë, rrjedhimisht të mijtë, ata vrerojnë përdita, d.m.th. shundojnë, bubanojnë, xoxojnë. Zoti është me ne. Amin".*[350]

Poeti i ironizon këta persona duke emërzuar mbiemrat e tyre. Lasgushi vijon të evidentojë gabimet drejtshkrimore që nuk kanë munguar edhe në vëllimin e dytë poetik. *"Në Y. i Z. Duhet: do t'i puth Për dhembshurije, jo prej dhembshurije, për mua më s'ka sot, jo Për mua s'ka sot".*[351]

Sipas Lasgushit një pjesë e shtypi shqiptar ka vijuar jehonën e botimeve të tij. *"Përveç gazetës Drita, gazetës Shtypi, Përpjekja Shqiptare, (të trija në Tiranë" dhe Kombi-t (të Vlorës), unë nuk kontrolloj asnjë gazetë ose revistë".*[352]

Në letrën e datës 2 korrik 1938, ka një të vërtetë të madhe, e cila duhet të korrigjohet edhe në histrorinë e letërsisë shqipe. Kuteli i tregon se *"Ylli i zemrës"* nuk u shtyp prej shqiptarëve të Bukureshtit. Ai i shkruan se libri u shtyp lëndërisht kësilloj: *"1. Një të pestën të hollat e tua. 2. Afro dy të pestat kontributet e disa miqve të mijtë (dhe të tujtë). 3. Dy të pestat kontributa ime personale".*[353]

Dhe më poshtë Kuteli i bën skanerin imazhit të shqiptarit të Kolonisë së Bukureshtit, për të vërtetuar edhe një herë thënien koniciane se armiku më i madh për Shqipërinë dhe shqiptarët, është vetë shqiptari. *"Kollonija e Bukureshtit duket "e madhe" që së largu. Që së afërmi nuk gjen një njeri me frymë të vërtetë. Kur e ke për t'a gjetur unë po të fal një sy (të m'a nxjerrësh). Kur të gjesh të dytin, po të jap edhe synë tjetër. A,*

---

[347] Po aty, fq. 165.
[348] Po aty, fq. 165.
[349] Po aty, fq. 166-167.
[350] Po aty, fq. 172.
[351] Po aty, fq. 167.
[352] Po aty, fq. 167.
[353] Po aty, fq. 169.

Llazar, Llazar, t'i s'mund të kuptosh se një "ekonomist" si mua-njeri i lëndës pra- u dogj si qiriri për të luftuar kundër lëndës... Më shkoqur: *për të vënë lëndën në shërbim të shpirtit, të idealit... libra jotë nuk u shtyp prej shqiptarëve të Bukureshtit".*[354]

Albumi i Dardhës është një tjetër vlerë edituar në Rumani nën kujdesin e Mitrush Kutelit. Aty veç të tjerash përfshihet një pikturë në tri ngjyra, e Androniqi Zengos (e dashura e Lasgushit ato vite), dhe poezia e Lasgushit *"Dashuri dardhare"*e cila përbën variant të poezisë që i duhet shtuar një ribotimi të poezive lasgushiane.

Lexuesit shqiptarë në Bukuresht nisin e pëlqejnë artin krijues të Poradecit. Jo vetëm ata, edhe një pjesë e banorëve të juglindjes shqiptare, veçanërisht Korçës. Pasi kishin lexuar "*Vallja e Yjve"*, një pjesë shqiptarësh në Rumani dhanë kontribut personal për të botuar vëllimin e dytë të poetit. Ndër ta veçohen zotërinjtë Zografi, Anastasiu, Gjeço e Ktona. Në një tjetër letër e cila daton më 28 qershor 1938, Kuteli replikon me shqiptarin Kristaq Tërpo, që jetonte në Bukuresht.

Sipas Kutelit ai u kujtua shumë vonë për të dhënë të holla për botimin, më saktë bëri muhabet zig-zagu për të mos i dhënë lekët në kohën e duhur për librin e dytë të Lasgushit. Me heshtje i përgjigjet lutjes së të hollave për botin, dhe Komuniteti Ortodoks. *"Unë pagova nga xhepi im një pjesë të shpenzimeve të librës. Nga 65000 lei, pagova 23000. Të tjerat i dhanë Poeti vetë dhe miqtë e tij dhe t'imit... mësova se librat nuk bëhen me para. Me para bëhen shtëpitë. Librat dhe kultura bëhen me shpirt".*[355]

Në letrën e datës 14 shkurt 1939 Lasgushi i shkruan Kutelit se shumica e librit u shit, domethënë, lexuesi i ndërgjegjshëm më dashje ka lexuar poezitë e Lasgushit. Ky intresim tregohet edhe nga blerja e një pjese të mirë e tirazhit të botimit. Nën këtë atmosferë blerjesh, gjithmonë Lasgushi i kërkon Kutelit t'i dërgojë nga Bukureshti edhe dërgesën e dytë të librave. Për botimet personale, por edhe ato të Lasgushit Kuteli ka prishur më shumë se 140 napolona.

Kuteli ndihet i zhgënjyer nga altruizmi i tij. Për të çështja shqiptare është një barrë e rëndë, të cilën s'e çon dot më tej. Ai i rrëfën Lasgushit se nga rrethet pseudoshqiptare nuk pati as përkrahjen më të vogël. Kritikon korrupsionin që asfikson kombin tonë. *"Një librar merr librat e s'denjon të të konfirmojë marrjen e tyre, një deputet merr gjithashtu një torbë tjatër dhe që të falënderojë të kërkon të tjera njëqint, që t'ju përhapë "fukarenjvet", ose të bën nderin të të porositë t'i shtypëshnjë librë të tijnë dyke mbledhur ndihma "ne" dha ata të Kollonisë".*[356]

Sinqeriteti kutelian mbijeton nëpër kohëra dhe bëhet shembull aktual për gjithkënd. Ai i sqaron Lasgushit se borxhin e dy botimeve të tij *"Vallja e Yjve"* dhe *"Ylli i zemrës"* e ka shlyer personalisht në shtypshkronjë. *"Këtë dhuratë s'ta bëra as ty, as kulturës shqip*: *Një dhuratë të bërë vetë-vetes s'ime të cilës i pëlqen Fjala jote e shkruar".*[357]

Ata kërkojnë të mbeten madhështorë deri në fund. I zhgënjyer nga shitja e librave dhe mashtrimet e librarëve të Tiranës, Lasgushi shpërndarjen e librave ua kërkon disa ministrive të kohës. *"Këshilla vendosi të të blerë gjithsë sasinë e "Y. të Z. ". Kjo gjë më gëzon fort. Po, në qoftë se libra është krejt e, ti mund t'i kërkosh të hollat avans dhe me to të shtypësh në Tiranë, nën mbikqyrjen t'ënde drejt-për-drejt, një edicion të dytë. Me këtë rast do të njohësh së afërmi teknikën tipografike më gëzimet e durimet e*

[354] Po aty, fq. 169.
[355] Po aty, fq. 171.
[356] Po aty, fq. 175.
[357] Po aty, fq. 175-176.

saja. Do të kesh edhe rastin të korrektosh gabimet e edicioneve t'ime, edhe do shtosh ndonjë vjershë të re ose ndonjë variantë të re".[358]

Sipas Kutelit, librarët gënjejnë dhe kjo lloj tregtie iu ka hyrë në gjak. *"Djalli të marrë vesh praktikat e librarëve të Shqipërisë".*[359] Më 28 qershor, 1939 Lasgushi i shkruan Mitrushit se ka shtypur një edicion të dytë të Y. të Z. , i cili i është dorëzuar sipas shënimit pardje (pra më më 26 qershor). Tirazhi kap shifrën 2000 copë. Nga ky letërkëmbim gjithashtu mësohet se Lasgushi ka marrë në dorë 1200 copë libra të edicionit të parë të Y. të Z., të edituar në Rumani.

Lasgushi i kërkon llogari Kutelit, se ku janë edhe 800 kopje të tjera ekzemplarësh. Mitrushi duhet t'i dërgojë edhe 800 kopje të librit, që gjenden, në Bukuresht. Po sipas Lasgushit mësohet se *"nj'a 200 vajtnë më kot, ndërsa 800 copë u shitën"*. Madje një pjesë e tyre, sipas poetit të liqerit mbetën të papaguara me ikjen e qeverisë. Adresimi i llogarisë është shumë i qartë.

Lasgushi saktëson se 91 copë nga edicioni i parë janë të pashitura dhe 95 copë gjenden nëpër librari të ndryshme. Dyshimet e Lasgushit për tirazhin e librit të parë sa vijnë e shtohen. Ai s'ka qenë 2000 kopje asnjëherë, por më pak. Lasgushi i kujton Kutelit se botimi i dytë i Yllit..., doli më i keq se ai i Rumanisë. Po sipas Lasgushit, libri kushtoi 740 franga ar. Kushtet teknike te shtypjes ishin të meta.

1939. Lasgush Poradeci. *"Ylli i zemrës".*[360] Botim i 2-të.

Edituar nën kujdesin e Mitrush Kutelit (Bukuresht, 1937), Tiranë, Luarasi, 1939, -185f. Botimi i dytë është rishtypja e botimit të parë, shtypur në shtypshkronjën "Luarasi", Tiranë, 1939 ;

Tryeza e vargjeve: *"Ylli", 7; "Gjumi i shpirtit", 8; "Gjuha e zjarrtë", 9; "Dremit liqeri", 13; "Zemra e liqerit", 14; "Dritë fshehtësije", 15; "Poradeci", 17; "Kënga pleqërishte", 18; "Bjenë telat" (Rapsodi), 20; "Ç'u mbush mali" (Rapsodi), 24; "Dita e njëzetetetës", 27; "Asdrenit" (Porteret), 29; "Vogëlushja", 33; "Malli i largë", 35; "Ti moj shoqe", 37; "Syr' i fshehur", 39; "Vesë dashurije", 41; "Si nus' e re", 43; "Vashë dhemshurije", 45; "Erë trëndelinë", 47; "Dashurija udhëtare", 50; "Je ulur fort", 52; "Oh, vanë fletët" (Fragment), 53; "Ç'dëgjoj me sy të trembur", 54; "Ti po vjen që prej së largu", 55; "Ah! me-atë mall që më ke ti" (Trioleta), 56; "Ku shtrohet vala" (Romancë), 58; "Dora jote ledhatarja", 60; "Posi borbuq' e trëndafilit", 61; "Eja, motër", 62; "Vdekja jonë", 66; "Ëndërr zilitare", 68; "Dëshirave", 70; "Kur në flakë", 71; "Ri me shëndet", 73; "Lamtumirë", 75; "Lamtumirë", (Variantë), 76; "Lamtumirë", (Variantë), 77; "Lamtumirë", (Variantë), 78; "Të ritë e viteve të mi" (Këngë), 79; "Kur të më jesh e zemëruar", 81; "Malli" , 83; "Më zu një mall", 85; "Më zu një mall dhe sot" (Variantë), 86; "Më zu një mall dhe sot" (Variantë), 87; "Që larg", 88; "Vallja e yjve", 91; "Kroj i fshatit t'onë", 95; "Vate prilli", 97; "Kur m'u rite vogëloshe", 98; "Kush të fali bukurinë", 99; "Ne porta nga mulliri", 100; "Del ne porta" (Variantë), 101; "Po qan vasha më shtëpi", 102; "Vallja e luleve", 104; "Balladë" (Në frymë popullore), 106; "Kush po shkon ashtu" (Trimi dhe vasha), 109; "Njeriu dhe Zoti", 113; "Përjetësia", 114; "Zemra e shokut", 121; "Gjeniu i Anijes", 122; "Lundra dhe Flamuri", 124; "Vdekja e Nositit", 126; "Përqafimi" (Rondel), 128; "Vrapojnë Zemërat", 129; "Prej çdo gazi-e hidhërimi", 130; "Kush m'a njohu dhemshurinë", 133; "Naim Frashëri" (Dorëshkrim), 135; "Të ritë-e viteve të mi" (Dorëshkrim), 136;* Fjala e editorit, 137;

---

[358] Po aty, fq. 178...

[359] Po aty, fq. 178

[360] L. Poradeci, *Ylli i zemrës*, Rishtypur në shtypshkronjën "Luarasi", Tiranë, 1939, -185f.

Fakti i tirazhit të dy mijë kopjeve të vëllimit poetik *"Ylli i zemrës"*, përforcohet sërish në kujtimet e Kolevicës si një dëshmi e sinqertë e poetit liqenor. *"Poezitë e Yllit të zemrës i mblodhi Pandeli Martiniani, dashuronjës i poezisë dhe ai ia dërgoi Mitrushit për botim. Dhe tani do të jap një informatë që s'e di njeri*: *Meqenëse "Ylli i zemrës" po shitej shpejt nga të gjitha libraritë, unë u mora vesh me shtypshkronjën e Kristo Luarasit, me djalën e tij Thoma Luarasin dhe shtypa dy mijë kopje, duke e bërë botimin gati ekzakt si ai i bërë në Bukuresht. Edhe vendin e botimit nuk e vura Tiranë, por Bukuresht. Vetëm letra nuk ishte aqë e mirë, po nuk kuptohej".*[361]
Lasgushi dëshmon sërish: *"Poeti mund të shkruajë shumë, po kur boton një libër me poezitë e tij, atje duhet të vejë ato më të mirat. Edhe unë kam shkruar poezi si ato të rilindasve. Nga forma janë doemos më të mira, po s'janë aq të mira sa unë t'i vija në "Ylli i zemrës", prandaj si vura. Kam bërë një poezi, titullin s'ia mbaj mend, për Shoqërinë e Bukureshtit. Mu në mes të Rumanisë/ Në qytet të Bukureshtit/ Leu kjo lule e Shqipërisë/ si zëmbak në mes të sheshit".* [362]
Në këtë pikë nuk mund të flitet për një tirazh të saktë të veprës letrare të L. Poradecit.
Të tjerë lexues të veprës së Lasgushit janë pogradecari Vasil Shuke dhe Naum Kotelic nga Ohëri, (kushëri i Mitrush Kutelit). Gjeografia e leximeve vijon përtej Pogradecit, edhe në Ohër të Maqedonisë, atëherë Jugosllavi. Te çdo shkrimtar që ka një publik botëror, në mënyrë të ndërgjegjshme ose jo, vepron ideja e universilaitetit. Kjo është çështje e njohur për letërsinë, cilëson shkrimtari Ismail Kadare. Madje thuhet se letërsia ka lindur bashkë me të.
Kësaj gjeografie i shtohet edhe një kompozitor rumun, i cili kërkon të kompozojë vargjet e Lasgushit. *"Këngëtori dhe kompozitori Mihailescu-Toscani ka shprehur dëshirën të verë në muzikë disa nga vjershat e tua.*[363]
Kompozitorë shqiptarë kanë bërë muzikë për poezinë e Lasgush Poradecit në festivalet e Radio Televizionit Shqiptar, kryesisht pas vdekjes së poetit: Josif Minga, Rajmond Gusho, Selami Kolonja, Naim Gjoshi, Klement Kole, Valentin Veizi dhe Sajmir Çili. Më herët, në vitet 1936, kompozitori Kristo Kono mbi vargje të Lasgushit kishte kompozuar, për këngëtaren lirike, të madhen Tefta Tashko Koço, këngët *"Kur mu rite vogëloshe"* dhe *"Kroj'i fshatit tonë"*. Poezia *"Kush ta fali bukurinë"* është kompozuar nga Dhimitër Falli.
Në një botim të Radio-Televizionit Shqiptar, Lasgush Poradeci ka gjashtë tekste poezish, të kompozuara këngë, të muzikës së lehtë. *"E mora shoqezën përkrah", muzika Josif Minga, kënduar nga Afërdita Zonja, festivali i i vitit 1989. (Kënga fitoi çmimin e tretë); "Gjarpërushja", muzika Naim Gjoshi, kënduar nga Alma Hyskja, festivali i vitit 1990; "Më zu nja mall", muzika Klement Kole, kënduar nga Foel Grillo, festivali i vitit 1992; "Sot u pamë", muzika Naim Gjoshi, kënduar nga Selami Kolonja dhe Valbona Karaj, festivali i vitit 1992; "Trashëgimi", muzika Valentin Veizi, kënduar nga Rubin Mati, sërish festivali i vitit 1992; dhe "Sa larg", muzika Sajmir Çili, kënduar nga vetë kompozitori në festivalin e vitit 1999"* [364]
Kompozitori Josif Minga në këngën "*Mora shoqezën përkrah"* bashkoi dy poezi në një këngë të vetme. Konkretisht, poezitë "*Mora shoqezën përkrah"* dhe pjesërisht "*Vate prilli"*. Juria e festivalit të dhjetorit për herë të parë vlerësonte tekstet e poetit me një çmim, pas vdekjes. Me sa duket diktatura e proletariatit ishte në grahmat e

[361] P. Kolevica, *Lasgushi më ka thënë...*, Shtëpia botuese "8 nëntori", Tiranë, 1992, fq. 45-46.
[362] Po aty, fq. 97.
[363] L. Poradeci, *Vepra IV. Korrespondencë Lasgush Poradeci-Mitrush Kuteli*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë, 2010, fq. 161.
[364] F. Slatina, *Festivalet e këngës në Radio Televizon 1962-2003*, Botimet Mokra, Tiranë, 2004.

fundit të saj. Minga më parë kishte kompozuar në vitin 1982, "*Vasha me drapër"*, për kor vajzash accapella.
Adhurues të poezisë së Lasgushit, ishin dhjetëra, mijëra shqiptarë brenda dhe jashtë vendit. Ata kishin lexuar poezitë e librave dhe i rishijonin ato edhe duke i dëgjuar dhe ridëgjuar të muzikuara. Një pjesë këngësh rrisnin dëshirën për lexim të veprës së lirikut duke dëgjuar për herë të parë vargjet e tij në këngë. Disa i mësuan përmendësh poezitë e muzikuara nga dëshira për t'i kënduar.
Më 22 prill 1938, Kuteli e lajmëron Lasgushin, se në Akademinë Rumune është prezantuar libri i tij *"Ylli i Zemrës"*. Promovimi është shoqëruar më një fjalë lavdërimi nga profesori Theodor Capidan. Më vonë lexuesit rriten me shpejtësi në numër. Publiku lexues bëhet më i kudogjendur dhe heterogjen. Ndërkaq, kur marrëdhëniet mes autorit e publikut bëhen më të tërthorta dhe të ndërmjetme, atëherë është më e vështirë të hetohen këto marrëdhënie. Rritet kësisoj numri i lexuesve të veprës së poetit në Rumani.
Objekt studimi në ditët tona mund të bëhen: salloni, kafene-libraria, klubi, internet-kafeja, shkolla parauniversitare apo universiteti. Mund të bëhet historia e pasqyrave letrare dhe revistave si edhe shtëpive botuese. Ambientet dhe organizatat letrare ndihmojnë për të krijuar një publik dhe atmosferë të veçantë për shkrimtarët dhe lexuesit e rinj në veçanti.
Më 5 qershor, 1930 Kuteli e lajmëron Lasgushin për nisjen e jehonës lasgushiane në Bukuresht dhe jo vetëm aty. *"Javën e shkuar kuxova të mbaj një fjalim të shkurtër përmi harmoninë lasgushiane në Qendrën e Shoqërisë së Studentëve*.[365] Edhe falendërimi lasgushian është në kohën e duhur. *"Harmonia ime është metafizika ime. Po vleftësimi që më bën, më duket se nuk e meritoj. Me gjith këtë, krijuesit mundim-mëdhenj të një populli, - qoftë dhe asish pa një vepër të përmbledhur dhe të shtypur për të enë sic është vogëlia e shokut t'ënd, - ndjejnë nevojën e ndërmjetkrijonjësve mëndje prehtë për t'u reveluar turmës sado pak... Kështu formohet kultura e një kombi"*.[366]
Po për nder të (S. S. S. R.)-së, Lasgushi shkruan *"Pelegrinata e gjakut"*, studimi dokumentuar mbi aktivitetin heroik të Nikoll N. Naço-Korçës, Burrit të Madh të Kombit, Dekanit të Flamurtarëve të Veteranërisë, krijonjësit dhe Shpirtëzonjësit plot me famë të së parës Shoqëri të mësimit shqip *"Drita"*, në Bukuresht. Kuteli e fton poetin poradecar të vizitojë rrethin krijues të Bukureshtit. Lasgushi, sipas tij duhet të njohë krijuesit rumunë, funksionimin e tyre.
Prezantimi i librit *"Ylli i zemrës"*, në një nga seancat e Akademisë Rumune shndërrohet në ngjarje madhore për shqiptarët. Dorëshkrimet e Lasgushit në Bukuresht, i mbetën Akademisë Rumune. Sipas një amaneti të Lasgush Poradecit mësojmë se në letrën e datës 23 tetor 1939 ai i kërkon Kutelit, që kujdestaria e tyre të jetë Shqipëria. *"Dorëshkrimet e mija mos u nxito t'i japësh në Akademi aty. Kujdestarja e tyre të jetë mëma Shqipëri. Këtë dëshirë kam. Në Rumani mund t'i lesh me kusht të përkohshëm, vetëm në rast urgjent rreziku. Zoti mos e dhëntë ashtu"*.[367]
Lasgushi përmes letërkëmbimit me Kutelin shpjegon domethënien e plagjaturës nëpër kohëra*. "Krijimi i ri prej lëndës së vjetër... Asnjë nga të gjithë veprat artistike e jetë të përbotshme s'është "origjinale". Trupi i tyre është i "huaj", vetëm SHPIRTIN s'ua disputon njeri"*.[368]

[365] L. Poradeci, *Vepra IV. Korrespondencë Lasgush Poradeci-Mitrush Kuteli*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë, 2010, fq. 33.
[366] Po aty, fq. 34-35.
[367] Po aty, fq. 187.
[368] Po aty, fq. 54.

Lasgushit të ri, poezitë do ia mblidhte dhe botonte Kuteli në Rumani, po atëherë do të ishte Lasgushi, që do ta pagëzonte mjeshtrin e rrëfimit shqiptar me emrin Mitrush Kuteli. *"Dhimitër Paskos në shtëpi dhe në Pogradec i thoshin, Dhimitraq, po unë i-a shqipërova emerin dyke i-a bërë "Mitrush". Mbiemrin Kuteli e vuri ay vete dhe i mbeti emëri letrar Mitrush Kuteli"*.[369] Lasgushi krijon një kushtimë për Kutelin më 7 nëntor 1936, me titull Mitrush Kutelit.

[...]Pa m'i prit edhe këtonë/ Iskëra të zemrës s'onë/ Prit-m'i shok n'ato mërgime/ Fjalëzit me rëgëtime/ Nga buçim' i zemrës s'ime/ Zemra ime buçim-shkretë/ Zjen e bren e s'gjen të qetë/ Plaset e përplaset vetë/ Vdes përkohë-e lind përjetë.[370]

Përfundime:

Kapitulli përcjell informacone dhe dëshmi rreth fillesave poetike të Lasgush Poradecit. Së pari nga Eqrem Çabej dhe herën tjetër nga Petraq Kolevica. Saktësohet se poezitë e para të poetit janë: *"Në çetele të kujtimit"* dhe disa vargje në gjuhën frënge pa një titull të saktë.

Përmes një kronologjie mes letërkëmbimit Lasgush-Mitrush, kapitulli përcjell detaje edhe rreth botimeve të para me poezi të Poradecit. Konkretisht të librave poetikë *"Vallja e yjve"*më 1933; *"Ylli i zemrës"*më 1937 dhe ribotimit të *"Ylli i zemrës*" më 1939.

Numrit të lexuesve të veprës së L. Poradecit në Shqipëri, Rumani dhe Austri u shtohen edhe pjesa e besimtarëve bektashinj, të cilët shijojnë poezitë e tij për Naim Frashërin.

Kapitulli hedh dritë mbi drejtshkrimin e poezive shkruar plot gabime, redaktimin e tyre si dhe përgatitjen e kopertinave për shtyp. Editor i botimeve është Mitrush Kuteli i cili bën edhe ndërtimin strukturor të librave të botuar. Lexuesi i parë i poezisë lasgushiane është përsëri Mitrush Kuteli.

Mirëbërja e politikave të botimit nga Kuteli, mundëson që të kemi vendosjen e çmimit të shitjes së librave apo tirazhin e tyre. Tri franga ari copa do të kushtojë një libër, ndërsa tirazhi edhe pse deklarohet në letërkëmbim nga 1700 deri 2000 kopje, asnjëherë nuk del i qartë për numrin e kopjeve të tij.

Jehona e librave të L. Poradecit në shtypin e kohës përcillet nga viti 1922 deri më 2009-ën sipas rendit alfabetik të titujve që mbajnë. Koha dhe lexuesit i japin librit status pavdekësie.

Një pjesë e mirë e shpenzimve për botimin e librave të Lasgush Poradecit, prej Mitrush Kutelit, mbeten kontribut personal i këtij të fundit dhe jo i "Kollonisë së Bukureshtit".

Kapitulli hedh dritë edhe muzikimet e poezive të Poradecit. Nisur nga muzika e bukur lexuesi mëson për ekzistencën poetike të Lasgushit. Shtohen lexues të rinj të veprës së tij letrare. Kompozimet e para realizohen në vitin '36-të nga Kristo Kono dhe Dhimitër Falli, për këngëtaren Tefta Tashko. Më pas kemi edhe shtatë kompozime të tjera këngësh të muzikës së lehtë, duke nisur nga viti 1989 për festivlet e këngës në RTVSh, madje për herë të parë dhe një vend të tretë në to.

[369] Po aty, fq. 203.

[370] L. Poradeci, *Vepra I. Poezia*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë, 2009, fq. 257.

V. KAPITULLI I KATËRT

BOTIME TË TJERA

V.1. Publikime në Rumani, Shqipëri dhe Kosovë

Në vitin **1946**:

Lasgush Poradeci *"Misioni i shqiptarëve të Bukureshtit dhe Naim Frashëri"*.[371]

Fjala e Lasgush Poradecit, ish-sekretar i përgjithshëm i kolonisë me rastin e 100-vjetorit të lindjes së poetit. Botimi është një kujtim i vogël, për Naim Frashërin, një shenjë përkujtimi në njëqindvjetorin e lindjes së tij, që ka qenë gjithnjë një vlerë tradite për popullin shqiptar dhe është një virtut i gjallë për kombin tonë. Në qendër është Lëvizja e Shoqërisë Shqiptare të Stambollit.

Në vitin **1960**:

Lasgush. Poradeci. *"Lirika. Vjersha të zgjedhura"*.[372]

Përmbajtja:

Disa shënime rreth jetës dhe veprës poetike të Lasgush Poradecit nga Muzafer Xhaxhiu, 3;

"Ç'u mbush mali",17; "Bjenë telat", 19; "Kënga pleqërishte", 22; "Naimit", 23; "Naim Frashërit", 26; "Poaradeci", 31; "Mëngjes", 32; "Korrik", 33; "Marim vjeshte", 34; "Dimër", 35; "Gjahtori", 36; "Zemra e liqerit", 38; "Kroj i fshatit tonë", 39; "Vallja e luleve", 41; "Më zu një mall", 42; "Eja motër", 43; "Të ritë e viteve të mi", 46; "Ku shtohet vala", 48; "Balladë", 49; "Ah! Me atë mall që më kë ti", 51; "Malli", 52; "Që larg", 53; "Kur të më jesh e zemëruar", 55; "Vogëlushja", 56; "Ti po vjen që prej së largu", 57; "Vallja e yjve", 58; "Trioleta", 61; "Mbretëria e zemrës", 62; "Syt' e tu vetëtimtarët", 63; "Dora jote ledhatarja", 64; "Kush po shkon ashtu", 65; "Vate prilli", 66; "Po qan vasha në shtëpi", 67; "E mora shoqezën përkrah", 68; "Vdekja jonë", 69; "Vasha me drapër", 70; "Rri me shëndet", 71; "Ku qajnë motrat vëllanë", 72; "Malli i vjershëtorit", 73; "Lundra dhe flamuri", 74; "Gjeniu i anijes", 75; "Vdekja e Nositit", 77;

Në vitin **1974**:

Lasgush Poradeci. *(Poezi)*.[373]

Përmbajtja:

Parathënia nga Razi Brahimi, 6;

"Ç'u mbush mali",7; "Naimit", 10; "E fundit mërzitje", 15; "Kënga pleqërishte", 17; "Malli i vjershëtorit", 19; "Poaradeci", 20; "Kroj i fshatit tonë", 22; "Lundra dhe flamuri", 25; "Gjeniu i anijes", 27; "Vdekja e Nositit", 29;" Zemra e liqerit", 38; "Vasha me drapër", 33; "Gjahtori", 35; "Të ritë e viteve të mi", 38; "Dremit liqeri", 41; "Mëngjes", 43; "Maja e çelur", 45; "Korrik", 48; "Mbarim vjeshte", 49; "Dimër," 51; "E mora shoqezën përkrah", 52; "Kur mu rrite vogëlushe", 53; "Gjarpërushja", 55; "Dhe të kundroj duke kaluar", 57; E"rë trëndelinë", 58; "Vogëlushja", 61; "Vallja e luleve", 63; "Balladë", 65; "Vate prilli", 69; "Kush po shkon ashtu", 70; "Po qan vasha në shtëpi", 72; "Del ne porta", 74; "Ku shtrohet vala", 75; "Eja motër", 77; "Që larg", 82; "Ti po vjen që prej së largu", 85; "Trioleta", 87; "Trashëgimi", 89;

Në vitin **1990**:

Lasgush Poradeci. *"Vepra letrare"*.[374]

---

[371] L. Poradeci, *Misioni i shqiptarëve të Bukureshtit dhe Naim Frashëri*, Bukuresht, 1946, -f.XV.

[372] L. Poradeci, *Lirika. Vjersha të zgjedhura*, Tiranë, "Naim Frashëri", 1960, -83f.

[373] L. Poradeci, *(Poezi)*. Tiranë, "Naim Frashëri", 1974, -91f.

[374] L. Poradeci, *Vepra letrare*, Tiranë, "Naim Frshëri", 1990, -521f.

Përmbajtja:
Parathënia nga Frida Idrizi, 5;
Në fillim përkthen poezinë *"Ylli"*. Aty kishte rima akustike, rrëfen Kapurani. Pastaj përkthen për një muaj gjithë poezitë përfaqësuese të Lasgushit. Kështu hyra në shtëpinë poetike të tij dhe preka me dorë poezinë, vijon ai. *"Lasgushi nisej nga përmasa madhore, kozmogonike... Pra nga qielli, kalon te ylli dhe kështu me radhë..."*.[417] Kapurani ndërkaq, deklaron se do të realizojë të tjera përkthime të veprës poetike të Lasgushit. Kjo vepër mbetet një nga studimet më të rëndësishme për krijimtarinë poetike të Poradecit. *"Ai krijoi me veprën e tij një kozmogoni pa kufi, si*

---

[408] L. Poradeci, *Les lettres albanaises*, 1988, f. 172-174.

[409] L. Poradeci, *Vesë Dashurie*. Biblioteka Valët, 1999, Shkup, Maqedoni.

[410] E. Grassi,-R. Sportelli, *In forma di palore: Poeti della terra d'Albania*: (Poetare e pensare),/. – Bologna, -Nr. Secondo e terzo, aprile-settembre 2002. -446f.

[411] L. Poradeci, *Poemë*. Përkth. Dionis Bubani, Gazeta "Panorama", -Nr. 301, 28 maj, 2003, f.13.

[412] M. Zeqo, *Një poemë e panjohur e Lasgush Poradecit*, Gazeta "Koha Jonë", -Nr. 149, 2 qershor 2003, f. 10.

[413] A. Ch., Kyçyku, *Antologji poetike shqiptare. Një alfabet i poezisë shqipe*. Editura Priviera, Bucuresti 2003, ph. 118-121.

[414] A. Kapurani, *The Myth of Lasgush*, Leicestershire: Upfront, 2004. -306f.
Bibliogr. f.305-306.

[415] A. Kapurani, *Lasgushi ynë ndër poetët më të mëdhenj të kontinentit*, në: "Ballkan", -Nr. 1345, 20 korrik, 2005, f. 19.

[416] A. Kapurani, *Si e bëra anglez... Lasgushin e madh*. Intervistë me autorin e librit në anglisht The Myth of Lasgush (Miti i Lasgushit). Interv. Ben Andoni, në: "Korrieri", -Nr. 206, 28 gusht, 2005, f. 11.

[417] Po aty, –Nr. 207, 29 gusht, 2005, f. 13.

rrallëkush. Lasgushi ka aftësinë t'i përthithë elementet në unitete më të vogla. Për shembull: *tek ylli, tek kroi i fshatit, tek e dashura. Tek këto unitete është një mikrokozmos i tërë. Ky është boshti i parë, i organizuar estetik..."*.[418]
Lasgush Poradeci në vitin 2005 përkthehet në italisht me dy poezi të vetme. "*Pelicano"; "Pogradeci"*. Poezitë janë përkthyer në Italisht nga Shpëtim Doda.[419] I njëjti përkthyes, Shpëtim Doda sjell Lasgush Poradecin edhe në gjuhën spanjolle me poezinë *"Pelicano"*.[420]
Në vitin 2009-të publikohet doktoratura e shumëpërfolur në rrethe të ndryshme intelektualësh, e Lasgush Poradecit. Copëza të saj të përkthyera ishin botuar kohë më parë në shtypin shqiptar të pas viteve 2000. *"Der Verkante Eminescu und seine Volkstumlich – Heimat - Liche Ideologie"*. (Eminesku i ignoruar dhe ideolgjia e tij popullore – vendase) In Universitate Litterarum Graecensi. Në Universitetin e Letrave të Grazit. Graz, Austri, 24 maj, 1933 ; MAII MCM XXXIII ; Me këtë punim Lasgush Poradeci mori në Universitetin e Grazit, Austri, titullin: " Profesor Doktor i Shkencave Filologjike".
Lasgushi sjell një studim të letërsisë së krahasuar, për poetin më të madh rumun të të gjitha kohërave, por edhe një ndër më të mëdhenjtë e kulturës universale, Mihai Emineskun. "Këtu Lasgushi trajton motivin e një ylli të humbur në gjithësi (Emineskut), drita e së cilit, për sa kohë në qiell ish e padukshme për shkak të largësisë së madhe, na mbrin ne vetëm pas mijëra shekujsh, atëherë kur ajo ish shuar prej kohësh. Me ideologjinë e tij përfshin tërësinë e shpirtit rumun në zgjim e sipër, e megjithatë ideli i tij kulturor nuk arriti të kuptohej tërësisht dhe aty për aty.
Përmbajtja artistike e krijimeve ngrihet mbi nivelin e rëndomtë kulturor të bashkëkohësve", thuhet ndër të tjera në përmbledhjen e punimit të doktoraturës së Lasgushit. Doktoratura është e firmosur nga: Rector: Prof. Dr. Joannes Benndorf, Doktor i Filozofisë, Profesor Ordinarus i Fizikës, Rektor Magnifikues i Universitetit të Letrave "Karol Franciskus; Decanus: Prof. Dr. Otto Maull, Doktor i Filozofisë, Profesor Ordinarus i Gjeografisë, Dekan i Urdhrit të Filozofëve; Promotor: Prof. Dr. Franciskus Heritsch; Doktor i Filozofisë, Profesor Ordinarus i Gjeografisë dhe Paleontologjisë, Promotor ligjërisht i emëruar;
Botimi i plotë shqip titullohet: "Eminesku i injoruar dhe ideologjia e tij popullore-atdhetare". (Studim gjenetik duke pasur parasysh lidhjet me kulturën gjermane)".**
Përmbajtja e doktoraturës mbetet e larmishme në këndvështrimin origjinal të shtërgut të fundit të letrave shqipe: Doktoratura e Lasgush Poradecit mbrojtur në Universitetin e Gracit në Austri. Eminesku në faqet e një Monografie-Doktoratë (George Miku), 12; Die Monographie Von Eminesku In Den Seiten Von Einer Doktorarbeit, 13;
Parathënie, 20; Hyrje, 21; I. Eminesku i injoruar: "La Steaoa", 24; II. Origjina e popullit rumun: "Rugăciunea unui Dac", 37; III. Fillesat e atdheut rumun: "Bogdan Dragoş", 43; IV. Idealizmi i Sundimtarit të Moldavisë Stefan Cel Mare "Doina", 52; V. Idealizmi i sundimtarit të Vlahisë Mircea-Vodă cel Bătrân: "Scrisoarea III", 67; VI. Arratisje në të kaluarën e atdheut: "Sărmanul Dionis", 75; Përfundim, 81; Literatura, 84;
Botimi shoqërohet edhe me dorëshkrimin e doktoraturës nga Poradeci në gjuhën gjermane. Dorëshkrimi ka gjithashtu renditjen e tij të faqeve. Ato janë vendosur lart faqes së këtij botimi. Janë gjithsej 91 faqe dorëshkrimi, që në këtë libër korrespondojnë nga f. 89-184 ;

[418] E. Gjika, *Anastas Kapurani, The myth of Lasgush* (Miti i Lasgushit), London 2004, në: "Studime filologjike", -Nr. 3-4, 2005, f. 189 – 191.
[419] L. Poradeci, *Poeteka*, (Revistë), -Nr. 1, prill, 2005, f. 68.
[420] L. Poradeci, "Albania", -Nr. 100, 1 maj, 2005, f. 16.

Vorëort, 92; Einleitung, 95; I. Der verkante Eminescu: "La Steaoa", 100; II. Ursprung des rumänischen Volkes: Rugăciunea unui Dac", 117; III. Anfänge der rumänischen Heimat: "Bogdan Dragoş", 124; IV. Verherrlichung des Moldau-Herrschers Stefan cel Mare: "Doina", 135; V. Verherrlicung des Ëalachei-Herrschers Mircea-Vodă cel Bătrân: "Scrisoarea III", 157; VI. Flucht in die vaterländische Vergangenheit: "Sărmanul Dionis", 165; Schlussbetrachtung, 175; Literatur, 181; Dokumente dhe foto të L. Poradecit. f. 185-216 ;[421]

Megjithëse më sipër u ndalëm realisht në përkthimet e disa poezive të Lasgush Poradecit, duket se nuk ndjanë të njëjtin mendim për to albanologët, gjermani Hans-Joachim Lanksch dhe suedezi Ullmar Qvick. *"Simbas meje, ligjerimi poetik i Lasgushit asht aq specifik saqë përkthimet e teksteve të tij i ngjajnë ritregimit të përmbajtjes së tyne dhe jo poezisë së tij, gja që do me thanë që rezultati asht tejet i vorfun. Nji Zot e din ndoshta ka me lindë dikur-diku edhe përkthyesi i Lasgushit"*[422], - thotë albanologu gjerman, Hans-Joachim Lanksch. Për albanologun suedez Ullmar Qvick, *"Problemi kryesor me poezinë e Lasgush Poradecit është gjetja e një forme të përsosur, sepse Lasgushi ishte mjeshtër i formës dhe do të ishte gabim të bëhej një interpretim formalisht i dobët, një mohim i talentit të këtij poeti të madh!"* [423]

Përfundime:

Përsa i përket botimeve të plota të veprës letrare të L. Poradecit në vite, mund të themi se botimi nën kujdesin e Frida Idrizit është i tillë për Shqipërinë, pasi përmban poezi, fotografi, publicistikë dhe letërkëmbim të autorit. Ndërkaq në Kosovë më i plotë, është botimi që realizohet nën kujdesin e Sabri Hamitit. Mund të themi se botimi i vitit 2009, është një libër i plotësuar me poezi të papërfshira në botimet e mëparëshme. Përmendim tituj si: "Hapja e shkollës"; "Redaktorëve të mij"; "Era e Perëndisë"; "Dr. Bashos" etj. Por konstatojmë se botimi mbetet i cunguar pasi në të nuk janë futur dy baladat e poetit për Muharrem dhe Reshit Çollakun, shkruar më 1974. Saktësisht "Muharrem Çollaku" (Baladë e Kalasë së Poradecit) dhe "Reshit Çollaku" (Baladë poradecare). Këto balada gjenden të botuara në librin e përgatitur nga F. Idrizi.

Horizonti pritës në Kosovë, dikur Federatë e ish-Jugosllavisë, sot shteti më i ri ballkanik, gjithmonë ka dëshmuar simpati e dashuri për veprën e Lasgush Poradecit. Katër botime në harqe kohore të ndryshme janë dëshmia më e plotë e përthithjes së librit nga lexuesi në tregun kosovar. Ndërkohë nuk përjashtohet përsëri mundësia e ribotimit të poezisë së L. Poradecit në shtetin e Kosovës. Pritshmëritë mbeten të mëdha. (L. Poradeci "Vepra letrare", Tiranë, 1990; L. Poradeci "Vdekja e Nositit", Prishtinë, 1986; L. Poradeci "Poezia", Vepra 1, Tiranë, 2009)

Përkthimet e poezisë së L. Poradecit si edhe e vërejmë kanë plotësuar deri diku amanetin Çabejit, që poetin t'ia falim botës. Vepra e Lasgush Poradecit, pjesërisht, është përkthyer në disa gjuhë të huaja, si në anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, spanjisht, rumanisht, maqedonisht, sigurisht që do të vijojë edhe në të ardhmen të përkthehet në të tjera gjuhë të botës. Këto përkthime kanë zgjuar interes të veçantë, madje për disa prej tyre janë shkruar shënime, është bërë recension, vështrim kritik, madje edhe ndonjë studim i mirëfilltë si ai i Anastas Kapuranit. L Poradeci ka lexues të përbotshëm falë përkthimit në gjuhë të huaj, të poezisë së tij.

---

[421] L. Poradeci, *Eminesku i injoruar dhe ideologjia e tij popullore-atdhetare.* (Studim gjenetik duke pasur parasysh lidhjet me kulturën gjermane), Tiranë, "Argeta LMG", 2009, -216f.

** Botohet nën kujdesin e vajzave te poetit Kostandina e Marie Gusho. Përktheu nga origjinali gjermanisht Koço Bendo; Përktheu poezitë nga gjermanishtja dhe rumanishtja Perikli Jorgoni;

[422] Gazeta "Mapo", e hënë 27 shkurt 2012, fq. 14-15.

[423] Po aty, fq. 14-15.

VI. KAPITULLI I PESTË

KRITIKA SOCREALISTE

VI.1. Tematizmi i kritikës rreth veprës së Poradecit

Shkrimet kritike rreth veprës poetike së Lasgush Poradecit në pjesën më të madhe të tyre kanë dalë nga vështrimi Kutelit. Përsa i përket kriterit, orientimit apo qasjes kritike ato gjenden në atë suazë, sado që brenda tyre mund të ketë analiza mbresëlënëse të tipit, srukturës kuptimore apo ndërtimore si janë rastet e herëpashershme të Qoses, Hamitit, Kabashit, Vincës, Idrizit, Plasarit etj.

Në përgjithësi shkrimet i karakterizon shija e kritikës tradicionale pozitiviste me elemente të asaj analitikë dhe me theks të veçantë në trajtimin ideologjik.

Autorë të tjerë qofshin në Shqipëri apo në Kosovë e Diasporë ndriçojnë momente nga jeta e shkrimtarit. Këto shkrime i karakterizon qasja filologjike-pozitiviste dhe analiza e tematikës së krijimeve apo diskutimi i thjeshtë e përmbajtjes së tyre. Në to shumë autorë sjellin të dhëna të reja, sa më të hollësishme, biografike dhe bibliografike. Ata flasin për mënyrën, rrethanat, kushtet në të cilat shkroi poeti, japin shënime nga jeta, që në ndonjë rast nuk janë të rëndësishme në krijimtarinë e tij, pastaj kalojnë në trajtimin e tematikës dhe motiveve krijuese, duke i hedhur një vështrim vargut, metrikës së tij, ritmit, rimës në në fund gjuhës.

Aureolë e gjithë kësaj përvoje është gjykimi dhe vlerësimi i pikëpamjeve, i ideve dhe botëkuptimeve që lindin nga vepra poetike e L. Poradecit. Një gërshetim i metodës biografike me kritikën deskriptive, ndonjëherë analitike, mund të arsyetohet, meqë bëhen hapa për njohjen e plotë të Lasgushit. Sigurisht, shkrirja dhe orientimi i të gjithë aspekteve në rezultatin ideologjik ishte cungim dhe varfërimi i veprës.

Këtë frymë trajtuese ka teksti i Dhimitër Shuteriqit *"Histori e letërsisë për shkollat e mesme"*, 1958. Disa kritikë bien në ngushtësim ideologjik, sepse trajtojnë vetëm anën e jashtme të problemit, planin mimetik, komponentin gnoseologjik dhe jo atë artisitk, poetikë që padyshim do të kishte dimensione më të gjera e më të thella kompozicionale, etike, psikologjike filozofike etj. Ç'është e vërteta, vepra e Lasgushit, nuk kishte nevojë për kurrëfarë mistifikimesh të fryra, sepse vlera e saj ideo-artistike i imponohej vetvetiu publikut lexues me mënyrën e trajtimit dhe formësimit.

Kjo vlerë imanente dominonte në horizontin pritës dhe nuk varej nga ndihma e jashtme, nga parrulla, propaganda apo gjykimi deklarativ. Interesimi dhe entuziazmi në kohë për Lasgushin ka mbetur aq i madh, saqë nga dëshira për të thënë diçka sa më shpejt për këtë poet nuk ngurohet që të huazohen elemente nga ndonjë poezi e tij apo kështu të sajohet plagjiatura mbi Emineskun. Lidhur me të nuk ka munguar asnjëherë polemika dhe ragimi.

Veprës së Lasgushit ishte e rëdësishme t'i bëhej që në krye të herës një kritikë shumështresore, e cila filloi të zbatohet me sukses prej ndonjë autori nga fundi i viteve '90. Katër figurat bazë në veprën e poetit Qielli, Uji, Dheu dhe Zjarri bëhen temat e përhershme të poezisë së tij. Disa prej këtyre autorëve duke analizuar temën, bëjnë një shpjegim simbolik të saj, pra zbatojnë një metodë simbolike, e cila e gjen shpjegimin përfundimtar duke dhënë kuptimin final të mbyllur, duke i dhënë udhë konotacionit, pluralizmit të mendimit, mundësive të hapura dhe kreativitetit me të cilat është mbrojtur vepra e Lasgushi Poradecit.

Në bazë të këtyre shkrimeve qëndron postulati i njohur i cili bën që veprën e Lasgushit ta vështrojmë si shprehje reflektive të rrethanave të caktuara ose kushteve ekzistuese. Faktet letrare lidhen me ato jetësore, disa momente ose përjetime të heroit lirik, merren si qëndrime morale e filozofike të pikëpamjes së shkrimtarit. Vërehet se një pjesë e analizës orientohet në shpalljen e botëkuptimit dhe pikëpamjeve të poetit të liqerit në sytë e lexuesit. Evidentimi është bërë në punimin tonë, kapitulli "Receptim në vite" (1945-1990).

VI.2. Padakortësi në çështje të realizmit socialist

Jo vetëm kur vepra e Lasgush Poradecit është parë në prizmin ideologjik se sa vlen, kur është analizuar aspekti i saj tematik, por edhe atëherë kur është bërë përpjekje të zbërthehet struktura e saj gjuhësore, apo të thuhet diçka në bazë të vështrimeve për vlerën dhe karakteristikat e përgjithshme artistike, kritika letrare ka ngritur këto probleme dhe çështje të disktueshme:

A i takon Lasgushi Realizmit Socialist, apo jo? A është nën ndikimin e Emineskut, lidhur me konceptimin poetik të krijimit të cilin e trajton si apostrof? A ka pesimizën krijimtaria e Lasgushit dhe a justifikohet ajo? Mënyra e receptimit të veprës së tij poetike, respektivisht miti lasgushian dhe arsyet e glorifikimit të tij? Përparësia e vlerës artistike apo vlerës ideore të tij? Tematika dhe motivet e krijimeve të Lasgushit, janë kombëtare apo ndërkombëtare? A ka paqartësi vepra poetike e Lasgushit? Sa është e denjë poezia e tij të hyjë realisht nëpër antologji socrealiste dhe jo vetëm? Skicimit i lirikut të dashuruar në poezinë e tij? Metrika, ritmi, figuracioni, nënteksti, gjuha letrare...? etj.

Padakortësia rreth këtyre çështjeve ka ekzistuar që herët. Lasgushin mund ta konsiderojmë poet të Realizmit Socialist dhe pse heshti gjatë në krijimtarinë poetike të atyre viteve. Mirëpo ky arsyetim bie poshtë kur pohohet se bazat ideo-artistike të realizmit socialist qëndrojnë në bashkimin e teorisë socialiste me lëvizjen e masve, ndërsa në veprën poetike të Lasgushit nuk pasqyrohet ideali i ri estetik apo vetë ideali socialist.

Ç'është e vërteta, tërë diskutimi synon postulatin se krijimatria artistike çmohet përmes pikëpamjeve ideologjike. Edhe ajo palë që pohon përmes pak poezish edhe ata që i mohojnë elementët e realizmit socialist në veprën e Lasgushit, qëndrojnë në të njëjtat pozita, sepse një metodë artistike, një metodë që ka burimin shumë më tepër në ideologji, sesa në estetikë i vishen tipare artistike dhe ashtu ajo bëhet masë për vlerën, respektivisht jovlerësuesin e një krijimatarie.

Nga të njëjtat pozita do të thotë se duke e konsderuar realizmin socialist si metodë të përsosur veçanërisht letrare edhe në këtë vështrim rreth metodës artistike të Lasgushit, mohoen zërat që që do ta inkuadronin poetin në rrjedhën e kësaj poetike, sado që në krijimet e tij u shprehën aspiratat patriotike kombëtare edhe për heronjtë e luftës antifashiste nacionalçlirimtare. Për metodën artistike të Lasgushit, mund të themi se ajo është romantike. Metoda krijuese e Lasgushit mbetet inspirim i kritikës sonë të derivonshme, kur vështrohet nga një këndshikim artistik dhe jo ideologjik. Apostrofi i ndjenjës së mallit, dashurisë, erotizmit personal dhe dëshirës për të jetuar shfaqet te shtërgu i fundit individualisht dhe larg ngjyrës stampë të plagjiaturës.

Çështja e palgjiaturës në veprën Lasgushiane duhet parë në kuadër të strukturës tërësore të krijimeve të poetit dhe jo vetëm në elementë nisës të saj. Kështu janë hedhur dhe ndoshta do të vijojnë të hidhen hipoteza se vepra letrare e Lasgush Poradecit është ndikuar kryekëput nga vepra letrare e Emineskut. Një pjesë kritikësh e konsiderojnë këtë mendim të rezervuar, e quajnë të jashtëm, kalimtar dhe fare të

pjesshëm në krijimtarinë e Lasgush Poradecit. Madje edhe Kuteli e nënvizon këtë gjest në fund të miqësisë me poetin..., por që rezulton fals, sepse ishin përdorur përkthime të Lasgushit në organet e periodiku të asokohshëm. Aurel Plasari dhe më pas Luan Topçiu gjejnë pika të përbashkëta mes poetëve, duke u ndalur te ndjenja e mallit, veçmas te malli lasgushian dhe poezia rumune. Njeriu i Lasgushit sintetizon vullnetin e mirë të njeriut për të jetuar dhe dashuruar.

Pesimizmi i Lasgush Poradecit është kundërshtuar nga kritika jonë dhe pse ndonjëherë ka dëmtuar profilin e tij letrar. Edhe kur ka ndodhur që të jetë pranuar dhe evidentuar gjatë analizës së ndonjë krijimi, është përpjekur që ta arsyetojë duke e gjetur burimin te "sëmundja" e heshtimit të poetit nëpër kohëra, veçanërisht regjimit komunist, te kushtet e vështira të jetës së intelektualit socialist në Shqipëri, të ndikimit të filozofisë së vetësakrifikimit, duke vërejtur se anët e errëta janë krejt të rastit, jo sistem gjithpërfshirës i krijimtarisë së tij.

Sipas kriteresh të tilla ndonjë hulumtues i veprës së Lasgushit, duke dashur ta mohojë dhe zhveshë mitin e tij, i rrënon të gjitha vlerat dhe e sjell veprën letrare drejt një fundi të çuditshëm. Për shembull Krist Maloki apo Muzafer Xhaxhiu.

Rrugën më të drejtë, ndërkaq, mënyrën më të drejtë, mënyrën më objektive të zbërthimit të çështjes fillon e bën Mitrush Kuteli, sadoqë edhe te ky studiues i zellshëm i veprës së Lasgush Poradecit, gjejmë disa teprime e ndonjë lajthitje sikundër ndodh në "vdekje" të letërkëbimit të tyre, moment që duhet kuptuar si irritim dhe distancim qejfmbetjesh personale.

Disa studiues e pranojnë pesimizmin e Lasgushit në vargun e tij, por e çmojnë si një ndjenjë revolte të brendshme të autorit që i hap rrugë optimizmit. Ndodh pra, që të mohosh në emër të optimizmit dhe të konstantosh vlerësime që mbështeten në strukturimin artistik të veprës letrare. Kjo realizohet kur për poetin lirik nuk kemi glorifikim të tij, por tendencë. I nisur nga dëshira që vepra e Lasgushit, të lexohet dhe të çmohet sa më realisht, Mitrush Kuteli në shkrimet e tij e arrin këtë shkallë objektive, por ndodh që duke e qasur shumë pranë vetes me tepëri, t'i mbeten anash dhe të abstragohen disa veçori të veprës lasgushiane.

Ai pohon se kulti lasgushian, zhurma e tij është krijuar me të drejtë, por edhe me arsye të përligjur. Midis të tjerash arrihet në konkluzionin se Lasgushi si poet do të zinte vend në çdo lloj antologjie brenda dhe jashtë vendit, e cila do të përpilohej sipas normave estetike. Zhurma e madhe artistike e poetit të liqerit nuk qëndron në bukurinë artistike të vargut, por në ndjenjën që e përshkron atë, në bindjet dhe në pikëpamjet të asokohshme të poetit për jetën.

Lasgush Poradecit, dy armiq ia afronin vdekjen me ngulm. Pleqëria dhe shteti i diktaturës së proletariatit (Diktatura). Lasgushi kërkon dashurinë e pastër, ideale, me prekje trupore. *"...m'u në fund të zemrës tënde rritet fshehur dashuria"*[424], vijon poeti të deklamojë ndjenjën e pastër që i kap të gjithë për atdheun, vendlinjen, të dashurën. Sepse në jetën e njeriut nuk ka vetëm një dashuri. Autori në vjershat e tij nuk ka parasysh ngurimin dhe turpin për gjininë tjetër, femrën, e cila vjen si profil kombëtar. Ajo rrënjët e saj i ka te mënyra e jetesës, sikundër poezia koloristike *"Kroi i fshatit tonë"*.

Emin Kabashi[425] në monografinë e tij për lirikun, ka parasysh përpos planit semantik, domethënien e funksionit, madje edhe strukturën artistike, poetikën, më pas momentet filozofike dhe psikologjike, të cialt i shikon mjaft gjerë dhe heq paralele me ato të

[424] L.Poradeci, *Poezia, Vepra 1*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2009, fq. 15.
[425] E. Kabashi, *Lasgush Poradeci. Jeta dhe vepra*, Prishtinë, 1997, 252f.

Kierkegorit, Hajdegerit etj. Autori Kabashi është në vazhdën e kritikës integrale, prandaj ai prek dhe çështje të rëndësishme të poetikës lasgushiane.
Mensur Raifi[426] merret me sematikën e Fan Nolit, Migjenit dhe Lasgush Poradecit. Në të vërtetë ai analizon rimën, vargun dhe përmes tyre shqyrton aspektin semantik, formal dhe estetik. Më një fjalë, trajtohet poetika e krijimatrisë dhe tipi letrar që ka realizuar shkrimtari. Në këtë analizë strukturale bëhet orvajtje që të gjendet harmonia midis formës dhe përmbajtjes, të njehsohet sruktura formale dhe ideore, të konstatohet tërësia, tingullore, melodike, kuptimore dhe estetike.
Konceptin estetik dhe qëndrimin ideor të tre autorëve, autori nuk i shikon të ndera, por i sjell në tërësinë stilistike, sidomos përmes strukturës verbale, në këto raste përmes strukturës tingullore, e cila në poezinë e tyre i thyen konvencionet poetike, dhe është shprehje e botëkuptimit të tyre. Titujt *"Vallja e yjve"* dhe *"Ylli i zemrës"*, në rastin lasgushian, sipas kësaj analize kanë të bëjnë sa me aspektin estetik, aq edhe me atë ideor. Aspekti i parë shprehet në manipulimin e lirë të rimës, që i kundërvihet strukturës ritmike klasike, kurse aspekti i dytë përmes kuptimeve që sajojnë strukturat e rimës, motivojnë edhe më mirë idenë.

Përfundime:

E udhëhequr që në shëmbëlltyrën e artit lasgushian mos bjerë asnjë rast i papranueshëm, kritika e kohës ka pohuar dhe mohuar zymtësinë dhe elementët dëshpërues të krijimtarisë së L. Poradecit për x krijim, ku pesimizmi ishte shfaqur apo ndjehej. Në më të shumtën e herës nuk ishte marrë parasysh mënyra e trajtimit apo struktura e brendshme, shtresat e ndryshme kuptimore, domethëniet e shumta apo ndonjë anë sipërfaqësore dhe e përciptë, e cila kishte të bënte me pikëpamjet e poetit apo mendimet e tij të shprehura në varg.
Kjo mënyrë analize i dha më shumë rëndësi vlerës ideologjike të kohës, pikëpamjeve, botëkuptimeve sesa shprehjes dhe realizimit artistik të poezisë së L. Poradecit.
Sipas analizës objektive, konstatojmë se shfaqjet e pikëpamjeve të tilla artistike janë një përfundim i ngushtë estetik për Lasgushin, meqë krijimet e tij mbeten poezi të bukura larg deklaratave të sheqerosura, të angazhuara. Çdo konstatim, çdo gjykim dhe vlerësim, i mbështetur nga fakte konkrete që dalin nga analiza artistiko-gjuhësore, mbeten mitizuese për autorin. Madje edhe demitizimi vërehet si një mit i ri për poetin, njëlloj sikurse ky proces ndodh dhe në kritikën botërore.
Krahasimi më Malarmenë apo Rembonë, elementet filozofike apo pikëpamjet estetike që i ka pikasur dikush, poezitë që si frymëzim kanë pasur jetesën në qytezën e Poradecit, mbeten ndalesa mjaft interesante në perceptimin e lexuesit. Pra, i gjithë receptimi i veprës letrare të Lasgush Poradecit nga ana e kritikëve dhe lexuesve u nënshtrohet shijeve të kohës, që ndonjëherë shkojnë deri në mosdakortësi.
Normat etike të kritikës socrealiste së bashku me kriteret estetike të saj, e bëjnë krijimtarinë e L. Poradecit të paprekshme nga to dhe mjaft të adhurueshme, nga masa e gjerë e lexuesve.

[426] M. Raifi, *Fan S. Noli dhe Migjeni*, "Rilindja", Prishtinë, 1979, fq. 154-156.

VII. KAPITULLI I GJASHTË

POETIKA

VII.1. Poezia e Lasgushit: Vlerësime përgjithësuese receptivo-strukturale

E vështruar në tërësi të saj vepra letrare e Lasgush Poradecit finalizon një hap të ri në republikën e letrave shqipe. Ajo përmbledh dhe asimilon në vetvete tendencat dhe vlerat ideoartistike më interesante të përiudhës dhe formacionit artistik së cilës i përket. Jo vetëm kaq, në të janë mishëruar elemente të ndryshme të letërsive, të drejtimeve dhe formacioneve jashtë rregullave kombëtare të kohës kur jetoi dhe krijoi poeti. Kjo tendencë bëhet realitet falë kontaktit të poetit me letërsinë botërore, leximit të saj, shkollimit jashtë apo gjuhëve të huaja që ai njihte. Gjithçka të bind se vepra e Lasgushit ka risi në planin makrostruktural, ashtu edhe në atë mikrostruktural, në aspektin tekstor dhe atë jashtëtekstor.

Mund të thuhet, kështu se Lasgushi e afroi veprën e tij me shijet e kohës dhe veçoritë artistike të letërsisë në mënyrën më të përshtatshme për lexuesin. Këto ide dhe afrime artistike, të cialt, çështë e vërteta sapo ishin shfaqur, ai i solli në një strukturë vetjake në poezi.

Nga ana tjetër ai, arriti të eleminojë disa skema të vjetëruara, të klishetizuara të periudhës letrare në të cilën krijoi. Thënë shqip vepra letrare e Lasgush Poradecit krijoi një distancë estetike në raport me traditën dhe aktualitetin letrar shqiptar. Kjo e vështruar edhe në paralelizmin historik vertikal, edhe në karhasimin horizontal, na bind se Lasgushi e ngriti traditën poetike në një shkallë më moderne dhe i dha asaj një trajtë të re. Megjithatë vepra e tij letrare nuk është e shkëputur as nga tradita, as nga dukuritë letrare dhe padyshim aristike të kohës.

Duhet nënvizuar se ky artikulim ishte më frytdhënësi në pikëpamje artistike, se përpjektjet e plejadës së viteve ’30 që shprehnin gjendjen dhe aspiratat e kohës. Mënyrat, me të cilën vepra e Lasgushit sillte dhe modelonte botën shqiptare ishin më fatlumet artisitikisht, për shkak të interesit emotiv dhe raportit krijues ndaj gjuhës, vargut dhe stilit që krijoi. Vepra e tij letrare me trajtimin e saj specifik e ndriçonte dhe ngrinte lart vetëdijen shqiptare, iluminonte atë që ishte e turbullt apo fragmentare në ndërgjegjësimin patriotik dhe diturak të receptuesve.

Duhet thënë se Gjergj Fishta e Migjeni apo edhe ndonjë autor tjetër i viteve ’30, i përkisnin orientimeve dhe formacioneve të tjera të kohës. Me modelet e tyre letrare ata formësonin shkaqet mjeruese shoqëroro-ekonomike të atyre viteve, si ngajrje të rëndësishme të një të kaluare jo fort të largët: Lidhja Shqiptare e Prizrenit apo luftrat e ndryshme ballkanike, mjerimi duke u bërë jehonë përmes llojeve të veçanta letrare dhe një stilistike përkatëse.

Fishta dhe Migjeni, krijimtaria e tyre në tërësi ishin pranuar nga rrethet e caktuara të kohës, mjaft të gjera. Vargjet e tyre mësoheshin përmendësh, një model i ri ky, i përdoruar në raste të ndryshme, si kërkesë e receptuesve të kohës. Ndërsa Lasgushi dhe një pjesë tjetër krijuesish të viteve ’30, sollën ëndërrim në realitetin e kohës, ëndërrim plot magji jete për të ardhmen. Vepra e Lasgushit u pranua nga brezi i ri, shtresa më rinore kombëtare, intelektualët që ishin profesorët, mësuesit, nxënësit e tyre etj. Për të dëshmuar të vërtetën e kohës, vepra letrare e Lasgush Poradecit përqafimin e kishte tek këto shtresa që përhapnin të renë dhe ishin shpresë e një ardhmërie ndryshe nga ajo e asokohshme.

Veçmas pëleqhet ose më saktë përpihet më një frymë, poezia e dashurisë së poetit. Kjo ishte arsyeja pse vepra e tij pëlqehet masivisht. Ajo u përhap dhe u bë njohur edhe duke u mësuar përmendësh në kuptimin metonimik të saj. Ajo futej dhe bëhej

melhelm për ndërgjegjen e njërëzve të ndryshëm duke ndriçuar vetëdijen dhe nënvetëdijen e tyre. Receptimi i saj mbështetej sa në veçoritë plot risi artistiko-gjuhësore, aq edhe në ngjyrimin emocional që kishte filluar të ndihej ndër lexues.
Duke bërë krahasime të thjeshta mes Fishtës, Nolit, Migjenit dhe Lasgushit ata qëndronin mes tyre si nata me ditën, ata ishin në përpjestim si ëndrra me zhgjëndrrën, e kaluara me të tashmen, tradita me modernen, retrospektiva me vizionin. Ky konstatim dhe vlerësim nuk mbështetet vetëm në idetë dhe pikëpamjet që ata prezantuan, por në tërë strukturën artistiko-gjuhësore të veprës së tyre letrare, sepse në botën e bukur dhe të vështirë të artit mendimet nuk merren veçmas, si fjala vjen në shkencën e filozofisë, por të gërshetuara si strukturë e përgjithshme.

VII.2. Vdekja dhe testamenti i përjetshëm. Ideja e dhënë përmes strukturës artistike në varg

Po ta vështrojmë poezinë e Lasgush Poradecit, jo vetëm brenda cikleve, por edhe në tërësi dy librat si një të vetëm, do konstatojmë disa parime ideoestetike që e përshkrojnë atë fillim e fund.
Në radhë të parë, prej vetë titujve të disa vjershave si për shembull *"Zog i qiejve"; "Kënga pleqërishte"; "Naimit"; "Naim Frashërit"; "Marshi i djalërisë"; "E fundit mërzitje"; "Vdekja e Nositit"; "Gjeniu i anijes"; "Lundra dhe flamuri"; "Bjenë telat"; "Ç'u mbush mali"; "Dita e njëzetetetës"; "Gjuha e zjarrtë"; "Lavdurim"* etj., prej brendisë dhe strukturës së përgjithshme artistike të tyre, prodhojmë një përpjekje që prezantohet si e re, një botë e lirë poetike, që realizon shkëputjen nga amullia vjershërore e traditës, pushtimin e botës së panjohur, thyerjen e kodeve të vjetra gjykuese, vendosmërinë e poetit për të ecur me hap të sigurt dhe fluturimin e tij në hapësirën e pamatë kozmogonike.
E gjitha kjo mbetet një shprehje artistike personale, një vlerë e formulimit ideor, kulturor dhe intelektual, që gëlonte në Shqipërinë e atyre kohëve. Këto janë parametra të qëndrueshme që depërtojnë në gjithë veprën e Lasgush Poradecit, veçmas në poezinë e tij, madje edhe tek ato krijime që më parë na dukeshin krejtësisht intime.
Nuk është fare rastësi që si poezi nistore e të gjitha ciklave poetike, Lasgushi të vinte *"Zog' i qiejve"* (në vend parafjale), në librin *"Vallja e yjve"* dhe poezinë *"Ylli"*, në librin *"Ylli i zemrës"*. Edhe si formë, si model, pra si kompozicion i jashtëm, si anë vizuale ato lënë përshtypjen e një piramide gjigande, udhrëfyse për botën poetike të poetit nëpër dy librat e tij.
Këto poezi janë një lloj përjetimi lirik e filozofik dhe mbeten një gjetje që simbolizon gjithë preokupimin ideoartistik të Lasgushit poet. Analiza e elementeve strukturale e dëshmon pohimin tonë të mësipërm. Vetë titujt, që jo pa qëllim janë ndërtuar si *këng' e lasht' e vjershërisë* apo si *yll e mall që shëmbëllen*, na prezantojnë një sugjerim, që këto të jenë poezi mbi poezitë e tjera, një Kullë Babeli, në të cilën janë strukturuar në miniature dhe në mënyrë të brishtë disa elemente ideore të poezive, sikurse janë grupuar në mënyrë të programuar preokupimet e poetit që gjenden nëpër poezi të tjera.
Skema metrike e këtyre poezive është e ndryshme, varion nga njëra tek tjetra. E para është e njëtrajtshme, e në strofa. Ai ndjek tendecën e momentit me vargje simetrike dhe të rregullta dhe me rima ose që mungojnë fare ndonjëherë.
Mungesa e disa elementëve estetikë realizohet në përputhje me vetë pritjen e lexuesit, i cili së bashku me idetë dhe brendinë e aplikuar si risi, kërkon akoma më tepër në estetikën krijuese lasgushiane. Kjo formë poetike mbështet në qëndrimin distancues ndaj normave të klisheve estetike që kishin si dukje vargun e lirë në disa raste, i cili

ishte shprehje formale e strukturës së brendshme poetike të atëkohshme. Mosmungesa e elementeve metrike dhe strofike, ndërkaq, reflektohet në aspektin e ritmit, të melodiozitetit dhe të eufemizmit të poezisë në përgjithësi.
Një mendim i tillë është karakteristikë për një varg poezish të tjera në ciklet e ndryshme që Lasgush Poradeci na përcjell në artin e tij poetik. Sistemi i ndërtimit të poezisë vjen normal pa sforco të tepërt dhe përdorimi i figurave letrare është i plotë, veçanërisht ai i metaforës.
Kritiku dhe studiuesi i letërsisë Sabri Hamiti, e vlerëson Lasgush Poradecin mbret të poezisë në letërsinë shqipe.
Poezia *"Zog-' i Qiejve"*, fillon me vargjet:
Këng' e lasht' e vjershërisë më pëlqeu aq fare pak…/ Do t'j-a marr që sot e tutje si bilbil parëverak,/ Që nga fund i vetëvetës do të këndoj një mall të ri:[427]
Që në nisje kjo vjershë portretizon kodin poetik tipik lasgushian, duke sjellë tek lexuesi mesazhin se L. Poradecit nuk i pëlqen më kënga e vjetër, por do që të këndojë këngën e re dhe mallin e ri, duke i nxjerrë ato nga fund i zemrës. Ai kërkon të përhapë poezinë e re, që kaplon tej për tej pengesat në horizont. Poezia "*Zog'i Qiejve"* është një krijim që prezanton mënyrën e lindjes së poezisë, ringritjes së saj, deri në nivelin maksimal të përjetësisë, që bie erë pavdeksie, Shqipërie.
Kështu, që në vargjet e para vërehet se si poeti do të krijojë një këngë të re, një emocion të ri, një projektim të ri, duke e nxjerrë nga fundi i vetvetes. E reja dhe e vjetra ridalin në skenë në këtë poezi. Pa traditë nuk ka të ardhme dhe e kundërta e saj si pëthyerje poetike.
Në këto vargje perifrazohen dy nocione apo figura poetike të Lasgushit: kënga e mendësisë së vjetër dhe malli i ri, të cilat kanë një lidhje mes tyre dhe nuk kundërshtojnë aspak njëra tjetrën, pasi apeli që bën poeti në lirikën shqipe nuk është shkëputje nga ekzistenca e poezisë së mëparshme, por një lidhje të fortë me tokën mëmë, me vetë këngën e lashtësisë, që rrugëton e ndalet tek malli i ri. Pra, kjo është thirrja për të qenë vetvetja dhe vjersha vijon duke shtjelluar testamentin poetik të poetit Lasgush.
Krijimtaria e së shkuarës, me ligjësitë e saj nuk e kënaqte Lasgush Poradecin poet. Për këtë arsye, ai së bashku me Aleks Stavre Drenovën (Asdrenin) do të bëheshin përfaqësuesit e parë të poezisë moderne në Shqipëri.
Kuteli për poezinë *"Zog'i qiejve"* shkruan se i përngjan në artin plastik, një përmendoreje në miniaturë të veprës së Lasgushit në tërësi, ajo i përngjan edhe një harte gjeografike e cila tregon gjithë pamjet fizike e gjithë koncepsionin metafizik të Lasgushit. Me tej mendon se këtu Lasgushi këndon në një dekor stilistik të madhërishëm, qiellin dhe Zotin, dherin e Kombin, dashurinë e Vashën, të lartat e mendimit, jetën metafizike edhe përjetësinë, sikush prej tyre të zhvilluara pastaj në kaptuj të veçantë në *"Vallja e Yjve"* dhe në *"Ylli i Zemrës"*[428], por edhe në krijimet e tjera pas 1937-tës. Kanti pohon se metafizika përcakton njohjen që vjen nga aryeja. Metafizikë poeti quante një kohë të ndërmjetme të njohjes njerëzore. Metafizika është në vetvete kërkimi i shkaqeve.
Lasgushi duke poetizuar kthen sytë në vendlindjen e tij Pogradec, përcjell idetë nga ajo mbretëri piktorike, frymëzohet, flijohet nga akti i krijimit, thurrr vargje brilante, adhuron në kulm shpirtin e tij, iluminimin e tij. Prezanton shkaqe sipas Kutelit...
Brenda tufës së junapit që mbleroj me kaq stoli, /Kur po shoh ndaj ryn bilbili e sakaq ze qan nër fletë, / Këng' e ti më ngjan kulluar posi këng' e Zotit-Vetë. /E prandaj,

[427] L. Poradeci, *Poezia, Vepra 1*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2009, fq. 15.
[428] M. Kuteli, *Vepra letrare 5*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq. 217.

dyke filluar, ay Lart i shpije kryet / Dh' i ngreh sipër-e-më-sipër gjer sa qafa ment i thyet. / Asohere-e ndjej si dridhet më një zë pa shëmbëllim, / Asohere-e ndjej si foli: *Tëjam falë,-o Zoti im! / E pastaj i ulet gusha më- përposh-e-më-përposh, / I venitetme-nga-dale syri-i qarë-e bukurosh. / Ay sheh që nëpër fletë me vështrimin e çuditur / Ndaj çkëlqen nër mijë gjyra Vënd' i ti ku pati zbritur, / E pra ja q'i mbylli sytë, e që gojezën e hapi*: */ Tungjatjeta! Tungjatjeta! Vënd o Vënd ku çel junapi!*[429]

Mëdyshja implicite e gjithëditurisë është njëherazi vetëdije pjesë-pjesë, që shprehet me pyetje eksklamative: *Ti vajton me zë të fshehur, se një zjarr kupton në gji/ Dheut! ah dheut të përtëritur sot i falesh përsëri...*

Kjo poezi është njëra ndër më të mirat e poetit. Për shumë arsye është kod hyrës në poetikën lasgushiane. Në të vërtetë është një këngë e re, një mënyrë e re e të kënduarit të poezisë, sepse ngre në lartësi vet procesin mistik të poetit, që rrugëton me fazat e tij, nga frymëzimi e deri te konkretësia në letër.

Zogu i qiejve është zogu fluturonjës që personifikon poetin, në hapësirën ku ai merr frymëzimin për këngën që do krijojë. Ky frymëzim rritet duke prekur në enumeracion oazin magjik të liqenit, malet, kodrat, fushat, pemët, lulet etj. Kjo këngë bëhet më interesante në ekzistencën e saj dhe rrugëton drejt qiellit e fortë, rrugëton drejt Zotit dhe përjetësisë.

Që nga bota njerëzore, ku këndoj me shpirtin plot, / Prit-e, prit! Se po t'afrohet Zog'i Qiejvet, o Zot! / Fal-i Këngëtor-finoshit Gas të Thjeshtë mun në gji: */ Posi lot në rreze djalli ndrit-e në Përjetësi!*[430]

Vargjet e fundit të poezisë janë lutjet që i drejtohen Zotit krijues për t'u njehsuar me idealin poetik lasgushian. Këtu poeti simbolizohet: zog i qiejve, këngëtar finok që iluminon në pavdeksi.

Lasgushi krijimin e tij e mbështet në katër figura kozmogonike. Ato janë: *Qielli, Dheu, Ajri e Zjarri*, të cilat bëhen tema të përhershme të poezisë së tij.

Nëpërmjet komunikimit krijohet lirika e Lasgushit që ka lëvizje horizontale dhe vertikale, pse jo edhe anasjelltas. Kështu, niveli i ndjenjës është i padukshëm, merr formë fluide a kulmore, përjetuese dhe përcillet si shkallëzim rritës në formë poetike. Në këtë formë realizohet përpjekja për të krijuar artin e përsosur poetik. Fillimisht theksohet vuajtja e poetit. Më pas bëhet kodifikimi i gjuhës së emocionit që e realizon deklamacioni plot zjarr dhe patetikë të shprehur.

Ndër vargje të mbeten në mend figurat stilistike, të cilat të thurrura bukur ndërmjet tyre ngjizin formën dhe përmbajtjen mes tyre:

Apostrofat: Të jam falë, -Zoti im! ; Tungjatjeta! Vënd o Vënd ku çel junapi! ; Ti këndon, o zog i pastër; haj! Bilbil, se vendi jonë ka liqere-e anë detesh; Metonimitë: Ndaj çkëlqen nër mijë gjyra Vënd' i ti ku pati zbritur; Vënd o Vënd ku çel junapi!; Dheut!, ah dheut të përtëritur sot i faleshpërsëri!; Kënga jote-e papandehur q'është fjal' e dashurisë; ngrihet... dhembshurisht e duke qarë; Personifikimet: të jam falë, -o Zoti im!; Haj!bilbil, se Vëndi jonë; Ti këndon, o zog i pastër; Metaforat: do t'ja marr që sot e tutje, do këndoj një mall të ri; zë qan nër fletë; këng' e ti; këng' e Zotit; këng' e kulluar; qafa ment i thyhet; i venitet syri-i; vështrimin e çuditur; t'i ndjen çuditë; të del nga zemra; ti vajton me zë të fshehur; se një zjarr kupton në gji; të fal breng' e përgjëratë; prej mallit që të thyhen; rritet fshehur dashuria, pastaj zbret e parpalitet; kënga jote shuhet; kënga duke psherëtitur; ta rrahish mendjen; dëshirës së zhuritur; të thëthijnë lartësirat qiellore; valon qiejve; me shpirtin plot; fal-i këngëtor-finoshit; gas të thjeshtë; Anaforat: asoherë-e ndjej si dridhet; asoherë -e ndjej si foli; e çdo lis që

[429] Po aty, fq. 15.
[430] Po aty, fq. 15.

mban të gjelbër; e çdo bar i lulëzuar; Shkallëzimet: Dh' i ngreh sipër-e-më-sipër gjer sa qafa ment i thyet; ajo ngrihet... ngrihet... ngrihet... dhemshurisht e duke qarë; zjarri fërfëllon e ngrihet gjer ne djelli, gjer ne Zoti; Aliteracioni: prej qëpallës së përlotur të pikon një pik' e ngritë; Antitezat: Ajo ngrihet... ngrihet... ngrihet dhemshurisht e duke qarë; pastaj zbret e parpalitet si një fluturëz e vrarë; Pasthirrmat: Dheut! ah dheut, të përtëritur sot i falesh përsëri! ; se ç'gëzim përjetësie!; E se ç'mall! E ç'dëshërime; të pat falur dashuria në të qarët e një grime!; Ha! Ç'të zotërovi drita!; Ç'të përshkoi një gaz i ri!; Seç të ndjell një frymë-largë tej nëpër paanësi!; Krahasimet: Do t'j-a marr që sot e tutje si bilbil parëverak; Këng' e ti më ngjan kulluar posi këng' e Zotit-Vetë; pastaj zbret e parpalitet si një fluturëz e vrarë; Përmi lule ku rreh djelli, ndrin me zjarr si pikë loti; si mendim me hov të letë valon qiejve ti vetë; posi lot në rreze djelli ndrit-e në përjetësi!; Hiperbolat: qafa ment i thyhet; me një zë pa shëmbëllim; zjarri fërfëllon e ngrihet gjer ne djelli, gjer ne Zoti; Sinekdokat: Këng' e lasht' e vjershërisë; syri-i qarë e bukurosh; ka liqere- e anë detesh; se një zjarr kupton në gji; prej qëpallës së përlotur; të pikon një pikë e ngritë; sec të ndjell një frymë -e largë; që nga bota njerëzore, shkëlqen nër mujë ngjyra; Perifrazat: Këng' e lasht' e vjershërisë më pëlqeu aq fare pak; E pastaj i ulet gusha më-përposh-më -përposh; Ndaj çkëlqen nër mijë ngjyra Vënd' i ti ku pati zbritur; pa pushim të del nga zemravaj' e tingëllit të mjerë; fal-i këngëtor-finosh gas të thjeshtë mun në gji; Asteizmat: pa pushim të del nga zemra vaj' e tingëllit të mjerë; ti e sheh dh'aq fort të tundet fund 'i zembërës së gjorë; Elipsa: sa, që me t'u ngritur me vetijen më-përpjetë-e-më-përpjetë; Anasjella: ndrit-e në përjetësi posi lot në rreze djelli;

Poezia *"Ylli"* del nga thellësia e zemrës, në formë gjithësie, si transhendencë që mbrrin në kullën krijuese të poetit.

Del nga zemra një yll/ Nuku di nga vjen i shkreti/ Sikur djeg përdhe mi pyll/ Sikur shkon për-së-përpjeti[431]

Te kjo poezi vjen përsëri frymëzimi krijues transhendental, frymëzimi i thellë në shpirtin e poetit, që këtë herë adresohet nga një zonë e largët dijesh të mbretërisë kozmogonike lasgushiane. Jeta pogradecare në poezi mbetet e paperënduar sikurse drita e yllit, që iluminon në vargje. Në strofën tjetër ndjenja djeg përsëri. Fjala është për frymëzimin e dashurisë së parë tokësore. Në këtë rast Lasgushi thërret në ndihmë variantet e poezisë, që plot nerv krijues prangojnë lexuesin. Vijnë mes tyre, përnjëherë yll e mall në dashuri, që stacionohen mes vargjesh, që frymëzohen drejtpërdrejt nga ylli transhendental, i cili qetëson mendjen njerëzore me idetë hyjnore. Lexues të shumtë të veprës poetike të L. Poradecit e mbartin në vetvete këtë eksperiencë jetësore që buron mes strofash.

Sikur digjet përsëri/ Mun në fund në kraharuar/ Sikur sbret nga qjell' i ri/ Ylli i jetës i pashuar[432]

Për shumë poetë qielli ka qenë sinonim i pafundësisë sokratike, i vetë kozmosit. Hapësirës sonë të cilën e dimë që ekziston, por më tej nuk e dimë së çfarë fshihet pas saj. Ylli mbetet figura që duhet zotëruar prej qiellit të pafundmë. Ylli i Lasgushit, si figurë qëndrore e poezisë nuk është vetëm një personifikim dhe simbol njëherazi. Kuptimi i jetës përfshihet branda yllësisë.

Ylli shndërrohet kështu në kryefigurën më përfaqësuese të gjithë vëllimit poetik *"Vallja e Yjve"*. Duke e interpretuar figurën e yllit dhe vallen e tij hapësirës së paanë, mund të themi se poeti kërkon ta zotërojë kozmosin, hapësirën, njeriun. Në fund të

[431] L. Poradeci, *Poezia, Vepra 1*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2009, fq. 149.
[432] Po aty, fq. 149.

fundit ylli është kryefigura njerëzore që lind plot me dashuri, plotë me jetë-e mall të valë në natën ëndërr dhe zhgjëndër të krijimtarisë.
Yll e mall që shëmbëllen/ Drejt pres zemërës së qetë/ Vjen e ndrin e shkon nga vjen/ Rrëzë qjelli, rrëzë jete [433]
Ky yll duke lëvizur në hapësirën e pakufijshme herë është i lumtur e herë është i mjerë, si vetë jeta njerëzore me kontraditat e saj. Nuk ka gjë më të bukur kur ylli rrezaton zjarr dashurie. Mjerimi i yllit vjen nga shuarja e flakës erotike.
Edhe te kjo poezi të mbeten ndër mend figurat artistike që e bëjnë edhe më të thellë mendimin poetik lasgushian për konceptin e gjithësisë.
Metaforat: *Qjell' i ri; sikur sbret; vjen e ndrin; shkon nga vjen;* Asteizma: *Nuku di nga vjen i shkreti;* Perifraza: *Sikur sbret nga qjell' i ri**;*** Antiteza: *Vjen e ndrin e shkon nga vjen;* Simbolet: *Del nga zemra një yll; Yll e mall që shëmbëllen; Drejt pres zemërës së qetë;* Anaforat: *Sikur djeg përdhe mi pyll; sikur shkon për-së-përpjeti**;*** Elipsat: *Yll e mall që shëmbëllen; Drejt pres zemërës së qetë**;***

VII.3. Tendencë meditatovo-kuptimore

Në pikëpamje të përgjithshme poezitë e L. Poradecit, shprehin tendencë meditatovo-kuptimore. Aliteracinet e përdorura në to, pasqyrojnë levizjen përpara, jo qëndrim statik, në vend numëro. Ato shprehin ardhmëri e cila fryn cep më cep në këtë poezi. Nuk duhet harruar që kjo është një karaktëristikë e cila gjendet edhe në poezi të tjera të Lasgushit.
Poezia *"Ylli"* pasqyrohet në formën klasike duke lajmëruar ardhjen e një talenti në poezinë shqipe. Vargu është konçiz dhe jep natyrshmëri meditimi poetik. Tendenca e emancipimit të vetëdijes së lexuesit, konstatohet në poezinë e Lasgushit *"Zog' i qiejve"*, që mbetet e pranishme pothuajse në të gjitha ciklet poetike të lirikut të shqipes. Ky orientim, vërehet, qoftë në poezitë ideore, që shprehin pikëpamjet në mënyrë të përgjithësuar, qoftë në ato lëndore, objektore[434] që shprehin dukurinë në mënyrë konkrete dhe e rimodelojnë botën përmes lirizmit.
Për hir të së vërtetës edhe njëri edhe lloji tjetër kanë të bëjnë me sferën objektive, ku e nisin udhëtimin thëniet e unit lirik të poetit liqerian. Nga kjo sferë objektive, nga gjendja, nga bota, vetë panorama sociale e viteve '30 dhe më tej vitet e socrealizmit nën diktatin e kuq politik, situata ideore dhe kulturore në përgjithsi, kanë sjellë në kahun subjektor dukuritë, pamjet, skenat dashurore, idetë, kuptimet të cilat formësohen estetikisht përmes mjeteve gjuhësore, tingullore, metrike, ritmike dhe figurative në poezi.
Kështu ideja e fshikullimit të personave të cilët prishin gjuhën shqipe, lartësimin apo mendimin e saj duket në poezitë "*Naimit"*; "*Naim Frashërit"; "Gjuha e zjarrtë"; "Kënga pleqërishte";* dhe "*Redaktorëve të mij"*.
Kuteli shkruan: *"Lasgushi ka një fjalor të tijnë, fjalorin lasgushian. Lasgushi ka përtëritur shqipen duke i dhënë ngjyra të reja, ndricim të ri dhe gjallëri të re. Lasgushi është poeti shqiptar, i vetmi poet shqiptar, që mendon, flet dhe shkruan vetëm shqip. Edhe stolitë artistike, Lasgushi i nxjerr vetëm prej gjuhës shqipe, prej realiteteve dhe mundësive shqiptare, prej etikës shqiptare. Edhe në këtë fushë, si në shumë fusha të tjera ai është autarkist"*.[435]

[433] Po aty, fq. 149.
[434] M. Kuteli, *Vepra letrare 5*, Shtëpia botuse "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq. 217.
[435] Po aty, fq. 217.

Sabri Hamiti thekson: *"Një nga pikat e programit reformues poetik të Lasgushit është edhe gjuha. Gjuha e pastër shqipe dhe gjuha poetike. Prandaj poeti sa herë kthen shikimin prapa në trashëgiminë poetike shqipe, shikimi përherë i ndalet në krijimet e Naim Frashërit dhe në meritën e tij të madhe për reformimin e gjuhës së pastër shqipe. Duke e pas* çmuar shume një punë të tillë të paraardhësit, poeti shpesh kur merret me problemin e shqipësisë së shqipes dhe të krijimit të një gjuhe poetike shqipe, të cilën e arrin me sukses të plotë, don të identifikohet me Naimin. Këtë gjë e bën më pashëm dhe me tezë të vënë para vetes në poezinë *"Naim Frashërit", të shkruar në gjashtëmbëdhejtë rrokësh, së cilës i vë moto dy vargje të vjershës së Naimit, "Fjalët e qiririt"*: *E ku shkruhen në kartë fjalët e gjuhës së zjarrtë..."*[436]

Te poezia *"Naimit",* strofa e parë në formë preifraze me dy vargjet e para na sjell ndërmend veprën *"Dëshirat e vërteta të shqiptarëve*" vargu i dytë krijimin*"Qerbelaja",* vargu i tretë veprën *"Histori e Skëndërbeut"* dhe vargu i katërt poemën *"Bagëti e bujqësisa"* të Naim Frashërit. Prangimi i Lasgush Poradecit është i dukshëm.

Ku psherëtin dëshir' e djegur/ Në shesh të kuq të Qerbelasë/ Mes trimërish stërgjyshërishte/ Të shoh ndaj po m'i bje xhurasë[437]

U dogj Naimi-Lasgush, u përvëlua mes njërëzve të paditur, për të lindur një ag të vogël shprese. Talenti naimian ishte në kohën dhe vendin e duhur mes shqiptarësh.

Se ngashërim' e vjershës s'ate/ Ish mall i fellë-e pa të ngjarë/ Posi një krua pastërsije/ Këndimi yt nër ne par rarë[438]

Te poezia *"Naim Frashërit",* Lasgushi evokon me qëllim të kaluarën historike të vendit tonë. Ai revoltohet përnjëmend dhe shpërthen fuqishëm, plot bindje dhe ashpërsi për realitetin në të cilin kishte ngelur ora shqiptare.

Sot po humb' kuvend' i zogut ç*'gjithë bukuri që kishte/ Pa lëngon e nis të shembet folja jonë pleqërishte/ E në breng të kaq rrëmuje psherëtiu dh'u shua fare/ Duke rënë posi pikakëng' e orës shipëtare*[439]

Poezia që bukurtingëllon përmes titullit vetë titullit metaforik është *"Gjuha e zjarrtë"*. Kjo poezi personifikon dhe simbolizon njëherazi gjuhën shqipe saktësisht përmes dhjetë apostrofave që Lasgushi përdor në tërësinë e saj. Përmes tyre jepet ekzistenca e gjuhës shqipe, vetitë dhe forca e saj shprehëse nga ilirët e deri në kohën e poetit. Në një kuadër receptiv më të gjerë shkrihet brenda saj edhe koha e lexuesit të ditëve tona. Dhimbjen për gjuhën shqipe që po prishet, poeti e jep përmes krahasimit të dhimbës së karaharorit, që ndodh në organizmin njerëzor, kur zemra dhemb. Frymëzimi shpirtëror i poetit shfaqet si flaka prometeike, që bëhet edhe më emotive dhe e besueshme përmes përdorimit të onomatopesë.

Posi një kraharuar ti dhemb, o Gjuhë -e zjarrtë/ Posi kullim' i gjakut që rreh në zemër time/ Ti ndrin në thelb të jetës si dritë-e përvëluar,/ O gjuhë-e zemrës s'ime, o mos-e kuvenduar.[440]

Poezia *"Kënga pleqërishte"* konkretzon idenë e moszhbërjes së gjuhës shqipe. Lasgush Poradeci e ndjente se kishte nisur të prishej pastërtia e gjuhës sonë dhe iu bie fort këmbanave "hemingueiane" për zgjim të receptuesve, që orientionin shijet nën këtë magji krijuese.

Ato kohë ndjeheshin ndikimet e huaja në kulturën kombëtare shqiptare, në mënyrën e të jetuarit të shqiptarit, në psikologjinë e të menduarit të tyre, në këngën e Nositit

---

[436] S. Hamiti, *Lasgushi për Naimin*, në "Rilindja", 31, 08. 1985, fq. 14.
[437] Lasgush Poradeci, *Poezia, Vepra 1*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2009, fq. 33.
[438] Po aty, fq. 35.
[439] L. Poradeci, *Poezia, Vepra 1*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2009, fq. 40.
[440] Po aty, fq. 151.

ngadhënjimtar. Nën këtë imazh iluminist Lasgush Poradeci e personifikon këngën pleqërishte.
Poeti e luan vallen shqiptare, herë ëmbël e shtruar. Jehonën e kësaj kënge, dashurinë, dhimbjen dhe trishtimin e saj e meditojmë ne lexuesit e poezisë në vargjet e vijave të ndërprera kur stacionohemi në këtë poezi dhe shijojmë poetikën. "Vendpushimet" mbeten hamendësime ineresante meditimi te *"Kënga pleqërishte"*.
.....
.....
O këngë pleqërishte! O vjersh' e Vëndit t'em!/ O fjalë që më dhimsesh, e që më bën ujem!/ O mall! O psherëtimë! O vajë! –O lot i zi!/ O shpirt i përvëluar që qan nër syt' e mi![441]
Vjersha *"Lavdurim"*[442] është poezia që Lasgushi e ka shkruar me rastin e 40-vjetorit të krijimit të institutit "Kyrias", kjo sipas një letre të gjetur në arkivën personale të Lasgushit drejtuar zotit Kristo Dako, në cilësinë e kryetarit të Komisionit iniciator për organizimin e festës komemorative të 40-vjetorit të institutit "Kyrias", datuar 18.03.1931. Poezia është një kushtimë që i drejtohet Parashqevi Qiriazit, e cila ndoqi me interes dhe mbështeti zhvillimet politike në Shqipëri, pa pushuar së shkruari për çështjen kombëtare. Ndërkohë u bë një nga themelueset dhe drejtueset kryesore të Institutit Femëror "Kyrias" në Tiranë e Kamëz (1922-1933), duke e metamorfozuar institucionin në një nga shkollat e mesme më dinjitoze në Shqipëri.
Kjo poezi ribotohet në vepra poetike 1, të Lasgushit, nga familjarët e tij.[443] Poezia nis me dedikimin *(Vashat shqiptare... Motrës së tyre së Naltë).*
"Rëndësia e grave është shumë e madhe pasi ato edukojnë shoqërinë njerëzore... Gruaja është baza e shoqërisë njerëzore, shtylla e moralit publik, nyja e një lidhje të shenjtë, e familjes, e cila e nxjerr njeriun nga errësira dhe e zbut. Ajo është një lulishte e njerëzimit... T'i japësh arsim një burri do të thotë të mbjellësh një pemë që lëshon vetëm hije, kurse të arsimosh një grua do të thotë të mbjellësh një pemë që përveç hijes, jep edhe pemë".[444] -shkruan Sami Frashëri te kapitulli *"Gratë, Biblioteka e xhepit"*, botimi i parë më 1879 në Stamboll, Turqi.
Bota iluministe mbështjell këtë krijim dhe e bën metaforën e përdorur mjeshtërisht, mjaft kuptimplote. *"Eja Motër, në mes t'onë, Motra jonë-e lumtëruar, ti që sbret nga Bot' e Dritës, e mban hir në kraharuar*".[445]
Poezia shfaq ngjyrim iluminist. "*Le të mburremi, jo vetëm ne burrat, por edhe gjithë zonjat shqiptare se zonjusha Parashqevi Qiriazi, Zhan D'Arka e Shqipërisë na nderoi të gjithëve. As një komb i madh ose i vogël nuk ka sot në Paris një delegat zonjë, po Shqipëria ka këtë zonjushë, e cila me diturin dhe mençurinë e saj dita më ditë po fiton simpatinë e të huajve për fitim të Shqipërisë".*[446]
Midis të tjerash për këtë vjershë, Lasgushi sqaron në shënimet e tij: "*Poezia është një SIMBOL i bukur i procesit shqiptar të ndritjes së vashës shqiptare përmjet kulturës".*[447]
"Redakorëve të mij", përthithet nga një tjetër lloj lexuesi. Këta receptues janë mbase raca e vetë e poetit, të cilët shpërfillshëm nuk gjunjëzohen para censurës partiake të

[441] Po aty, fq. 30.
[442] Poezia është botuar për herë të parë: Në Demokratia, Gjirokastër, 14 nëntor 1931.
[443] L. Poradeci, Poezia, Vepra 1, Shtëpia botuese albPAPER, Tiranë 2009, fq. 233.
[444] S. Frashëri, *Gruaja*, në: Zyber Hasan Bakiu (Kruja). Bibliografi e zgjeruar e veprës të S. Frashërit, Shtëpia botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1982, fq. 165-168.
[445] L. Poradeci, *Poezia, Vepra 1*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë, 2009, fq. 233.
[446] Revista "Ylli i Mëngjesit", Boston, viti 1917, volume. 2, nr. 9, f. 284.
[447] Arkivi familjar i Lasgush Poradecit.

kohës komuniste. Redaktorët janë personat që zezojnë jetën e qetë shqiptare, janë zgjatimet që përhapin frikën e diktaturës përbindësh në katet përdhese të godinës intelektuale shqiptare.

Dirigjimi kuptimor i kësaj poezie, është në sintoni të plotë, me shtresën kuptimore të saj. Poezia është botuar pas viteve '90, me ardhjen e erës së ndryshimeve dhe vendosjes së demokracisë në Shqipëri. Ky krijim në mënyrë vizuale, sqaron qëllimin e poetit dhe pikëpamjen e tij. Fakt dallues që autori është i zemëruar dhe mbartës i emocioneve të mllefosura në këtë poezi, është përsëritja e fjalës redaktor, e cila ruan kuptim të njëjtë. Zanoret dhe bashtingëlloret e fjalës redaktor në vetvete, do të ishin shtresat tingullore që në kontekstin e strukturës e intensifikojnë plotësisht kuptimin dhe domethënien e poezisë. Ky krijim është shembull konkret i shoqërimit mes shtresave tingullore, figurative dhe kuptimore, të cilat bashkë bëjnë strukrurën e plotë të botës poetike.

Ky krijim na shpreh një aspekt shqetësues të poetit, jo vetëm në pikëpamjen personale për këta shërbëtorë të sistemit, sikurse ai i quante redaktorët censorë allaplatonikë.

Redaktorët zemër-pisë/ Fyenjës së poezisë/ Shpirt-katran që më qërtojnë/ Janë qen që s'më kafshojnë[448]

Poezitë e mësipërme përveç kësaj të fundit bëjnë pjesë në ciklet poetike "*Vallja e Dherrit";* dhe *"Zemra e Qiellit"*.

Ndër dilemat kryesore që shfaqen në kuadër të analizës strukturale të poezive *"Vajtim mbi trupin e shokut"* dhe *"Kur qajnë motrat vëllanë"* është ajo, se cilit lloj i takojnë këto krijime: llojit ideor apo atij lëndor. Sado që mund të karakterizohen në llojin e parë të tyre, mënyra e vajtimit për përshkrimin e mungesës së shokut apo vëllait të shuar përgjithmonë nga jeta, të shtyn të mendosh gjithmonë rreth faktit, nëse ekziston këtu lënda subjektive apo lidhja objektive? Asosacioni i parë që të lind në mendje gjatë meditimit, është frymëzimi fillestar i Lasgushit. A thua se ai është element transhendental, rastësor?

Ka shumë mundësi të presupozohet kjo pikënisje krijuese, por motivimi, britma e këtij vajtimi mund të ketë qenë ndonjë kujtim më i hershëm, ose rrëfim i dikujt, ndërsa më pas ka ardhur ndikimi nga veprat letrare të kohës, që është ndikim lidhur me procesin krijues. Gjithçka është e mundshme. Çdo gjë ka filluar nga një kujtimi pastër, së cilit i shtohen elemente nga realiteti dhe përvoja e leximeve të ndryshme. Konkretisht poezia na lidh me kohën ose me vetë psikologjinë e Lasgush Poradecit.

Ndërsa i lexon dhe i rilexon këto poezi, përpara të qëndron lënda poetike e paraqitur me fjalë, ide, nocione dhe koncepte, qëndron vetë struktura e tyre, në të cilën duhet të përqëndrohemi dhe të bëjmë analizën strukturale, konkretizimin estetik të poezive. Kuptimi i thjeshtë, tekstual i dy poezive të mësipërme, konsiderohet përgjërim i poetit për shokun e vdekur apo vëllain që ka ndërruar jetë, dhembje për fytyrën e zbehtë, për dashuritë e pafata në rininë e tyre.

Pjesa më e madhe e kodeve shpjegues të këtyre poezive, në vështrim të parë të imponojnë të tilla mesazhe. Gjithsesi, tërësia e tekstit të përfshin në rrafshe të tjera të domethënies, larg të përditshmes, sipërfaqësores, në rrafshe më të përgjithshme dhe akoma më të rëndësishme. Në një prej strofave të poezisë *"Vajtim për trupin e shokut"*, poeti ngre zërin për humbjen e tij.

Pse më ndrite kaqe fellë/ Mun në shpirt, përhera:/ Vesë, që çkëlqeu në djellë/ Lule, q'e thau era?[449]

---

[448] L. Poradeci, *Poezia, Vepra 1*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2009, fq. 257.

[449] Po aty, fq. 137.

Poezia *"Kur qajnë motrat vëllanë"* është përceptuar e gjitha si prozopope. Lulja e mrekullueshme e zambakut, personifikon vëllain e vdekur i cili përmes eufemizmit të përdorur në poezi, vdes.

Vajto, moj botë/ Vajto me ne/ Se ra zëmbaku/ U shtri përdhe.

...

Të vdiq jot-ëmë:/ *T'u ngjall yt-at*:/ *Prej dhembjes s'ate,*/ *Ah! Shpirt i ngrat*.[450]

Duke mbetur te cikli *Vallja e Vdekjes-Zemra e Vdekjes*, të nguliten në memorie poezitë *"Gjeniu i anijes", "Lundra dhe flamurtari"* dhe *"Vdekja e Nositit"*. Rrafshet e ndryshme te kuptimeve, të porosive dhe mesazheve shkrihen mes tyre dhe sajojnë një të tërë, një nëntekst të njehsuar poetik. Shenjat e strukturuara, tërë kodi dhe nënkodet kësaj tërësie poetike, përmblidhen në një kah fundor. Në këtë stacion të fundit, Lasgushi identifikohet me gjeniun, flamurtarin apo nositin zog. Ata në vetvete janë simbole evokuese, të cilët përpiqen të shpëtojnë njerëzit në udhëkryqe.

Përmes këtyre poezive kuptojmë se nënvizohet mjedisi i një konteksti historiko-shoqëror, të cilin e sugjerojnë si pikërefrimi tekstet poetike të tri poezive të mësipërme. Identifilikimi i poetit mes zogut nosit, flamurtarit apo gjeniut të anijes, nuk ngjan aspak i pazakontë, sepse nuk ka ndryshime apo dallime te dukshme në këto afrime. Paralelizmi është mesazhues: ti vetësakrifikohesh për një jetë më të mirë, pse jo për ideale më të larta njërëzore, për një botë pa halle, më të vetëdijshme.

Poeti i liqerit gjithsesi qëndron më komod në këtë paralelizëm. Me tekstin poetik të tij, është më komunikues, më efikas, njëlloj, real si madhështia e vetsakrifikuarëve, që nuk zhduket në ujin e ftohtë të liqenit të Ohrit.

"Vdekja e Nositit", për shembull është një minidramatizim, shtjellimi i së cilës shkon drejt një lartësie dhe një fundi. Kjo poezi është një performancë në lëvizje, plot shkallëzime rritëse dhe zbritëse. Mesazhi poetik i këtyre poezive mbështet në egon e drejtpërdrejtë lirike të poetit, që do të thotë se në të shprehet përjetimi i tij lidhur me gjendjen. Meqë përjetimi sipas Huserlit është vetë vetëdija, atëhere mund të thuhet se bota e këtyre poezive është shprehje artistike e botëkuptimit të vetë poetit Lasgush Poradeci.

Krijimet janë poezi të vetëmohimit apo vetësakrifikimit të heroit lirik në emër të lirisë, misonit të saj, optimizmit për vazhdimësi. Ato plotësojnë njëra-tjetrën. Kështu në syrin receptiv të lexuesit, gjeniu simbolizon poetin intelektual të kohës, lundra simbolizon jetën e njerëzve, ndërsa anija jetën e poetit intelektual në detin e pafundëm njerëzor.

Flamuri simbolizon ekzistencën, mundin, punën dhe sfidën e çdo njeriu mbi dhe. Metafora e valës së përpjetë dhe antiteza *"në fund e mi kulm"*, tregojnë mundësitë e gjeniut për të mënjanuar rreziqet dhe humnerat e jetës. Gjeniu simbolizon Lasgushin vetë, ndërsa emri i tij jeton në librat poetikë që ai la, por që kanë fituar tashmë një ngjyrim "hyjnor", qiellor. Poezia *"Vdekja e Nositit"*, proteston përmes thirrjes deklamative *"me zjarr ju flas..., me zjarr..."*

Lundra e personifkuar lufton çdo ditë me tollovitë dhe mundimet e vetë jetës. Lundra sfidon mbytjen, duke nënkuptuar faktin se njeriu sfidon vdekjen, mbijeton. Çdo gjë e përjetimeve materiale, lundra, trupi i njeriut, zhduken, ndërsa flamuri i arnuar i fitoreve dhe disfatave, vetë misioni ndjenjë-detyrë, kulmon.

Së fundmi Lasgush Poradeci na tregon se edhe kur direku i anijes fundoset në det, flamuri, misioni, ideali, valojnë në pavdeksi. Duke e personifikaur sërish liqerin te *"Gjeniu i anijes"*, Lasgushi i drejtohet atij në formën e përsëritur. Poeti kërkon heshtje, sepse pranë valës së nxirrë nga rrufeja e kohëve, gjeniu i anijes, poeti vetë do

[450] Po aty, fq. 139-140.

të vazhdojë apelimin e tij. Kjo poezi mbyllet me dy shkallëzime. *Qetohet, ndalohet, mbaron* dhe *hepohet... anohet...valon*. [451] Përjetësohet emri i gjeniut, ndërgjegja e tij, vepra, kujtimi, vargjet, idelet, shpirti i tij. Strofat vijuese kompletojnë këtë përjetësi, japin dimensionin e kuptimit të mesazhit artistik, të vetësakrifikimit për ideale më të larta.

Poezia *"E fundit mërzitje"*, u dedikohet Kosovës dhe kosovarëve që vuanin nën zgjedhën serbe. Poezia në vetvete mbetet marsh shqiptar, sikurse e thekson si nëntitull Lasgushi. Thirrja për sulm ndaj qenit kobë-zi dhe gjakatar merr konotacion krenarie. Rrugëtimi për liri i Kosovës është i qartë. Në zemrën e poetit, gjithsesi, ka një dilemë. Lira apo përgjithmonë gjaku do rrjedhin në rrugën e Kosovës martire?

Lasgushi është emotiv gjithherë për çështjen e Kosovës. Ndërkaq, Lasgushi e dinte që i ishte botuar atje një libër luksoz, me poezi të përzgjedhura prej tij, nën titullin *"Vdekja e Nositit"*. Madje thuhet se autoritetet e kohës nuk e lanë të shkonte në Kosovë, me rastin e këtij botimi. Librin në pranverën e vitit 1979 ia sjell në Tiranë Sabri Hamiti, i cili pati fatin ta takonte poetin. Lexuesit sivëllezër kosovarë kishin përpirë poezitë e tij nëpër librari. Ata shijonin *"E fundit mërzitje"* (Marsh Shqiptar), ndërsa vajtonin fatin e tyre nën pushtetin serb.

Po nuk t'a fal dragoj ty sot:/ Tmerrisht godet me shpirtin plot!/ Të shtyp si djall plot helm e ndot!/ Të flak si qen![452]

Kosova e shoqëronte shpesh në përditshëmrinë e tij të zymtë poetin liqerëror. Në një bisedë me Petraq Kolevicën ai i ka thënë: *"Do të vijë një kohë kur dollia do fillojë*: *Mos e pifshim këtë gotë po të mos u bashkohemi me Kosovën"*. [453]

Duhet të sqarojmë që krye të herës se Lasgush Poradeci ka pasur një dashuri të jashtëzakonshme për Kosovën. Kosova është pjesë e Shqipërisë, ai gjithmonë kështu e mendonte të ardhmen e saj.

L. Poradeci për Kosovën ka shkruar një poemë të madhe. Pikërisht poemën "Mbi ta"[454], e cila është botuar sa ishte poeti gjallë. Vajza e poetit, Maria Gusho deshifron kuptimin e këtij krijimi: "*Atëherë ashtu ishte politika dhe fjala Kosovë atje është zëvendësuar ma fjalën Malësia e Madhe. Faktikisht ajo është Kosova"*.[455]

Poema *"Mbi ta"*, është një krijim epik, në qendër të së cilës poeti pavdekësoi ngjarjet e kryengritjes së Malësisë së Madhe. Ajo është një baladë për poetin dhe pushkatarin rilindas Risto Siliqi. E gjithë poema është një himn i hapur për lirinë, një epope heroike për luftën që bën luftëtari shqiptar në mbrojtje të atdheut të tij. Në këtë krijim mbizotëron atdhedashuria e lexuesit për këtë ndjenjë të madhe. Sulmi mbi armikun serb është një evokim historik për figurat më të ndritura kombëtare, që rrisjell poeti mes vargjeve të tij të ndjera.

Thirrja për çlirim kombëtar i bën bashkë në frontin e luftës plakun njëqindvjeçar dhe çunakun shatëvjeçar. *U zgjua Shkodra se cak më cak lëshoi kushtrimin Malësi e kryengritur*. U nisën shokë e miq prej Shkodrës, për në Malësi të Madhe.

Mbërrijnë të shtatë burrat tok, në kulm të Malësisë, aty ku Drini i Bardhë nën Istok niston drejt Shqipërisë. Mirdita, krejt malësia, të gjithë së toku ishin ngritur për lirinë e atdheut të robëruar.

---

[451] Po aty, fq. 130.

[452] Po aty, fq. 51.

[453] P. Kolevica, *Lasgushi me ka thënë...*, Shtëpia botuese "8 nëntori", Tiranë 1992, fq. 166.

[454] L. Poradeci, *Poezia, Vepra 1*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2009, fq. 365.

[455] M. Gusho, *Kush pret rrënjët, nuk mund të rritet*, në: "Nositi", Nr. 403, Pogradec, 16-24 nëntor, 2006, fq. 8.

M'i pari, thotë, ku rrjedh gjak,/ Sulmon vetëm shqiptari;/ Dhe thotë ajo bën sulm shqiptar,/ Rrjedh varkë e lumë gjak:/ Rrok pushkën plaku qindvjeçar,/ Dhe shtatë vjeçar çunaku.[456]

Kjo poemë na shtyn të bëjmë konstatimin eksplicit se ajo është mishërim artistik i fuqisë, energjisë pozitive që përhap, dëshira për triumf. Ky krijim të kujton poezinë konkrete, e cila edhe me formën e saj vizuale shpreh plot ide dhe e merr informacionin nga realiteti. Këtu provohet më së miri thënia e Lotmanit[457] të famshëm se formalizmi është i njëjtë me semantizmin.

Thëniet e ndryshme figurative e metaforike të kësaj poeme na sugjerojnë diçka të kapshme dhe të detajuar në mënyrë prezantuese. Kjo karakteristikë e kuptimore, është pjesë përbërëse e strukturës artistike të krijimit, që ka elementë të konkretizimit dhe të sugjestives. Ata janë të ngjashëm kudo. Janë njerëz që luftojnë për çlirim kombëtar nga zgjedha e huaj. Subjekti në këtë poemë ndërtohet nga raporti objektor, me një fjalë nga përjetimi dhe përvetësimi ideoratistik i situatave konkrete, i dukurive dhe i ngajrjeve reale historike të kohës.

Një poezi e tillë dhe mbresëlënëse është edhe ajo që mban titullin *"Maja e Çelur"*. Ajo mirëfilli është vjershë simbolike, ndërsa shpreh qëndrimin antifashist të Lasgush Poradecit. Poezia deklaron të parandierë hapur fitoren mbi fashizmin edhe pse është shkruar në vitin 1943. Të duket se çdo fjalë e saj i përgjigjet një fjalëçelësi. Ky krijim është i ndërtuar plot përvojë dhe urtësi mendimi.

Maja e çelur është ëndrra e realizuar, liria e shumëdëshiruar, çlirimi ndërglobal; lulet janë pranvera e fitores; llomi ndyrë janë tradhtarët; era është agimi i lirisë të përhapur ngado, yjtë në qiell janë inetelektualet, vetë poetët që lartësojnë plotësisht atdheun mes vargjesh. Poeti përmes kësaj poezie e parandien fitoren e madhe të popujve mbi fashizmin.

Aq më urtë-e fshehur,/ Dh' aq më me-nga-dalë/ Ritnin pa pandehur/ Sulmin e pandalë./ ...Ja! Se lul' e qetë/ Çeli gjinë-e sajë,/ Përmi degë-e fletë,/ Atje lart në majë![458]

VII.4. Vargjet me sens kritik, që mbartin lëndë jetësore

Le të shohim tani poezitë që ilustrohen me konkretizime artistike më të gjera dhe më të detajizuara. Pra, janë ato poezi lëndësore që prezantojnë jetën dhe që plotësojnë në një farë mënyre edhe poezitë e tjera ideore të shkruara nga Lasgush Poradeci.

Të tilla janë për shembull krijimet e ciklit "*Vallja e Përjetësisë"* si: *"Lënda dhe jeta"; "Fryma dhe qëllimi"; "Ndjenja dhe njeriu"; "Njeriu dhe Zoti"; "Përjetësia"* apo poema *"Ekskursioni teologjik i Sokratit"* etj.

Raporti i objektit lëndor në këto krijime është më i dukshëm dhe thëniet lirike janë më të orientuara nga frymëzimi, i cili luan lojën e pretekstit, si përjetimit emocional. Subjekti deklamativo-lirik është kthyer përkrah materies jetësore, përkrah realitetit të cilin Lasgush Poradeci e këndon dhe e formëson si një lëxim të ri me formë kritike.

Në kritikën letrare studiuesi Henrik Markijeviç[459] këto lloj krijimesh i cilëson si lirika prezantuese. Disa syresh janë shkruar me rimë dhe disa më varg të lirë. Kritika, konkretisht ajo e Mikel Difren[460], përveçon se vargu i lirë është kryengritje kundër një

[456] L. Poradeci, *Poezia, Vepra 1*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2009, fq. 376.
[457] J. Lotman, *Shpërndarje nga struktura poetike*, Shtëpia botuese "Rilindja", Prishtinë 1971, fq 38.
[458] L. Poradeci. *Poezia, Vepra 1*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2009, fq. 300.
[459] H. Markijeviç, *Shkenca e shpërndarjes së librit*, Shtëpia botuese "Rilindja", Prishtinë, 1975, fq. 95.
[460] M. Difren, *Poetika*. Programi i tretë, Shtëpia botuese "Rilindja", Prishtinë, 1971, fq. 88.

forme të vdekur dhe përgatitje për një formë të re. Kjo thënie shndërrohet në një parim estetik, një veçori poetike që përsëritet herë pas here në poezinë e Lasgushit.
Përjashtim bëjnë pjesa tjetër e vjershave të autorit. Sado që vargu poetik, i *shtërgut të fundit*, është i sajuar ndonjëherë më mjete iracionale gjuhësore, siç janë rimat, prapëseprapë kjo i nënshtrohet logjikës dhe unitetit të brendshëm të strukturës kuptimore. Pikërisht për të gjitha këto ky varg del i parregullt, i përzier.
Në më të shumtën e herës në poezinë e tij Lasgush Poradeci përdor rimën klasike për hir të formës vetëm e vetëm që të mos i largohet metrikës klasike. Ky fakt, njëherazi, na dëshmon se distancën estetike nga tradita ai kërkon ta arrijë gradualisht. Tendenca e Lasgushit ndaj një horizonti të ri pritës, një formësimi të ri poetik të ideve apo çështjeve që trajton në krijimtarinë e tij, dalin të natyrshme.
Kjo duket veçmas te *"Ndjenja dhe njeriu"* apo "*Njeriu dhe Zoti"*, poezi që vijnë vërtet plot emocion te lexuesi. Në to, të gjitha planet dhe elementet morfologjike, sintaksore, figurative dhe kuptimore janë në shërbim të formësimit të modelit poetik. Pikërisht ky model prezanton elementin filozofik të jetës, por edhe përjetimin ideoemocional të autorit. Kompozicioni i poezive realizohet përmes një përshkrimi statik.
Këto janë vjersha pa subjekt, të përbëra nga një seri episodesh, të cilat vijnë të lidhura ndër vete, në formë mozaiku vargjesh. Në të dyja krijimet shtrohet tema kryesore, një motiv themelor, ndjenja e njeriut për Zotin krijues e të gjithëpushtetshëm.
Të gjitha motivet e tjera janë në funksion të përcaktimit, të detajit, të fuqisë së Krijuesit. Zemra e njeriut lidhet me atë pjesë të Zotit, që merret me ndjenjat, idetë humaniste, të mirën apo të kundërtat e tyre. Zemra ka të drejtë kur pohon se Zoti është strukur tek ajo. Njeriu i cili i është drejtuar Zotit përmes apostrofit, tërheq vëmendjen e gjithë racës së tij të vdekshme përmes pasthirrmës së përdorur!
Më tej vazhdon duke përçmuar gëzime dhe hidhërime, me sy që shkëlqejnë nga dëshira për t'u arsimuar apo me sy që iluminizmin e shohin më me ngjyra kritike. Duhet thënë se misteri i diturisë ose thellësia e greminës iu shfaqën poetit në kushte tepër të vështira, kur njeriu ishte i lodhur nga pamundësia për studim, nga vështirësitë e tjera të jetës. Përmes personifikimit të Zotit, njeriu i drejtohet atij nëpërmjet apostrofit O Zot!, ndërsa deklarohet ndnjeja e fajit, pendesës, për veprimet e gabuara në përditshmëri ose të bëra jo mirë. Gabimet na bëjnë ndërkaq më të mençur në jetë. Shkaqet na çojnë ndonjëherë në veprime të gabuara.
Spikat në këtë vjershë hiperbola *po "rroj pendesën e jetës më të nxirrë"*, sikundër është fraza e ripërtypur, e Nolit tek *"Israelitë e filistinë"*: *"Pse o Zot na trashëgon mend, që të vijë një ditë dhe të pendohemi"*.[461]
Njeriu është një krijesë e vogël, përballë ekzistencës së Zotit të madh. Sipas Lasgushit, Zoti ndodhet në zemrën e njeriut. Ndjenja dhe Njeriu, karakterizohen nga aftësia për të menduar, nga koshienca dhe subkoshienca etij. Në këtë kuptim mund të themi se sa më i ditur të jesh, aq më shumë njeri i mençur je dhe aq më mirë e kryen misionin tënd në jetë. Njeriu i zgjidh problemet e tij përmes diturisë. Vargu iluminist naimian *"...dhe drita e diturisë përpara do na shpjerë"* merr një tjetër vlerë në këtë aspekt.
Ndjenja e dritës së diturisë të fisnikëron, t'i bën çastet në jetë më të bukura. Sipas poetit, Zoti nuk të dhuron dituri të pakufi, por duhet të sakrifikosh veten për ta kapur vijimësinë e diturisë, transhendencën e tij. Gjithë jeta është sakrificë në emër të diturisë.

[461] I. Shyta, *E vërteta bën keq në zemër*, Shtëpia botuese "D.I.J.A-Poradeci", Pogradec, 2006, fq. 31.

Në këtë kuadër malli është malli kalvar, është ngadhënjimi mbi të keqen. Ky përjetim fitohet në poezi përmes antitezës së përdorur nga autori. Prezena e retiçensës, kuptohet sidomos në vlerën e aspektit ideor.
Dy poezitë e tjera formësohen përmes rimës. *"Lënda dhe jeta"; "Fryma dhe qëllimi"* janë krijime që sjellin përshfaqjen e lëndës, vetë njeriun. Lënda jetësore mbetet figurë e personifikuar në vjershë.
Te *"Fryma dhe qëllimi"*, personifkohet era e Veriut që fryn në Pogradecin e L. Poradecit, era që ndez tallaze fshikullues në jetë. Në këtë poezi kemi përshfaqjen e lëndës në formën e veriut dhe në formën e ujit, aty ku varkëtari dhe varka puthen egërsisht, me një fjalë në triptikun transhendental të ekzistencës përmes nxënies së përhershme.
Në formë më të përgjithshme problemi i kësaj simbioze, trajtohet dukshëm në poezinë *"Përjetësia"*, që arrihet përmes forcës së bashkimit, ekzaktësisht, përmes ndijimit shqisor estetik në varg. Në kuptimn ideor lënda e personifikuar flet drejtpërdrejt përjetësisë "*pata qenë, do të jem!"* Kjo dukuri përkon me mendimin e prof. Ali Xhikut, për prezencën e një Zoti panteist tek poeti: "Zoti i Lasgushit nuk është Zoti teologjik, por Zoti që si në çdo gjë të natyrës, është edhe në vetë njeriun".[462] Zëri i rrëfimit në këtë poezi, në thellësi të liqerit jehon sikurse në një skemë madhështore. Aty njeriu, është i pranishëm vetëm si frymë.
"Interpretimi i intertekstit, interpretim që i bie përsipër lexuesit, mund të ngjajë më një zbërthim aluzionesh dhe referencash të cilat e fshehin kuptimin dhe synimin e tyre, dhe që i përket lexuesit për t'i zbuluar, me qëllim që të kuptojë arysen e tyre të të qenurit. Kështu në (Sytë e Elsës), Aragon përdor intertekstualitetin për të mënjanuar censurën".[463]
Sokrati i poemës *"Ekskursioni teologjik i Sokratit"* identifikon Sokratin e mençur antik dhe Sokratin Lasgush të poemës. Dualiteti Lasgush-Sokrat dhe Sokrat-Lasgush përjetojnë dhe prodhojnë lexime të ndryshme.
Në çdo përgjigje triumfon trajta mohuese kurrsesi. Poema ka shtatë personazhe që janë poeti Lasgush, Sokrati, Kryeshtetasi, kryegjyqtari, kryeprifti, një bujk dhe puntori athiniot.
Poemën në fjalë e përfytyroj si një amfiteatër të madh greko-shqiptar dhe shqiptaro-grek njëherazi, ku interpretohet subjekti kryesor i saj. Në qendër është kërkimi i së vërtetës, nga filozofi i parë i Greqisë historike dhe helmimi i tij nga frika e zbulimit të së vërtetës.
E vërteta bën keq në zemër! Shihet se për poetin Lasgush, Sokrati ishte kryefigurë e pëlqyer, me të cilën madje tenton dhe identifikohet. Ai jo vetëm që do të përdorë fjalët, por edhe shpatën. Bashkë me fjalën duhet edhe fuqia e armëve. Është një poemë e përqendruar rreth temës të së vërtetës.
Në strofat e para na jepet se ai ishte i pari filozof i Greqisë antike, pastaj shohim një lloj glorifikim të madh për vetë filozofin në fjalë. Morali, drejtësia dhe ligjshmëria shtjellohen ne subjektin e poemës lasgushiane
Drejtësinë e Sokratit-Lasgush e shohim kur ai merret me fetë e rrejshme, të cilat me predikuesit e tyre, shfrytëzonin turmat e pashkolluara. Në emër të fesë jetonin me djersën e tyre. Titulli i poemës merr spunto nga bashkëbisedimi me kryepriftin dhe kryegjyqtarin. Kemi, pra një dialog përbrenda poemës i cili shkon çdo herë e më tepër në keqësimin e situatave të kryepriftit dhe kryegjyqtarit me vetë Sokratin. Ndërkaq, Sokrati i pathyeshëm në idetë e tij, nuk u bindet fjalëve të tyre për të heshtur, për të

[462] A. Xhiku, *Nga romantizmi rrjedhave të realizmit*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1989, fq. 131-141.
[463] N. Piègay-Gros, *Poetika e Intertekstualitetit*, Shtëpia botuese "Parnas", Prishtinë, 2011, fq. 143.

qenë derr i kënaqun migjenian dhe për të shërbyer ashtu siç ata kërkonin. Pas insistimit të Sokratit për të zbuluar të vërtetën, kryeprift shprehet në poemë:
Unë nuk besoj aspak/ As në Tempull, as në Zot/ Po qëndroj për sy e faqe/ Mërzitë vetën kot-më-kot/ E mërzit, që besimtarët,/ Të besojnë se besoj-/ Kështu popullin e verbër/ Unë e rrej dhe e mashtroj.[464]
.....
Ndërsa kryegjyqtari pasi zbulohet thotë:/ *E mashtroj, që, me mashtrim,/ Populli të më besojë*:/ *Fronin si kryegjyqtar,/ Besërisht të m'a forcojë*.[465]
Domethënë, mashtrimi prodhohej vetëm sa për të qëndruar në poste të larta dhe më pas, ai, përmes një vargu të vetëm bën përgjithësimin e fenomenit. Kështu bën çdo diktator, deri sa populli ta përmbysë. Ata shfrytëzojnë injorancën e turmave, të cilave Sokrati iu hap sytë.
Kryeprifti dhe kryegjyqtari, thellojnë maskën e mashtrimit në emër të popullit.
Nuk ka Zeus, as nuk ka Zot,/ Ferr, Lugat t' imagjinuar:/ *po ka popull të paditur,/ popull q' ende s`është sgjuar*.[466]
Sokrati kërcënohet me vdekje nëse përhap idenë e tij që është këmbanë për zgjim popullor. Sokrati edhe pas kërcënimit mohon perënditë shtet. Në fund, lexojmë dënimin e Sokratit të pamposhtur dhe idetë e tij. Me aktin e pirjes së gotës së helmit farmaq të hidhur, (lojë kjo e bërë në emër të popullit, parrullë e njohur kjo për regjimet totalitare), "populli", po e kërkonte këtë vdekje. Sokrati vdes, për të mbetur i gjallë në histori.
Poema është një krijim alegorik, që e thurr poeti për diktaurat, diktatorët dhe larot ndjekës të tyre.
Jo: *se vjen dhe prap vjen,/ Vjen pa rreshtur ditë e natë,/ Vjen duke ndriçuar botën/ Jo me fjalë po me shpatë*.[467]
Sabri Hamiti në kritikën e tij për këtë poemë shprehet: *"Heroi moral i Lasgushit, pra Sokrati niset në kërkim të së vërtetës në shoqërinë njerëzore, në këtë kërkim ai do ta shembë idhulltarinë e rrejshme për të krijuar hapsirën e lirisë"*.[468]
Lasgush Poradeci, mbase shfaqet më unikali, si harmoni e përkorë e mjeshtrit që provoi kurorën e lavdisë zulmëmadhe të poezisë dhe karakterit të njeriut, që provoi dhe duroi gjembat e hidhur të indeferencës e pothuaj harrimit. Lasgushi ndikoi si model për kohën dhe pothuaj moskrijimin në këto kohëra të teksteve të reja poetike, një ndikim ky estek dhe moral. Duke mos krijuar ose më saktë duke mos botuar, ai shpallte qartë mosintegrimin e tij në artin e konformuar nëpër kallëpe skematike, duke ruajtur satusin e paravendosur të zogut të lirë të qiejve.[469]
Në poemën *"Ekskursioni teologjik i Sokratit"*, shkruar më 1978, në kohën e "vetmisë me njerëz", Lasgush Poradeci alegorikisht krijoi filozofinë e njerëzore, të atyre personave që, në fakt, nuk e pranonin atë që ekzistonte. Kjo situatë është sprovuar gjithnjë e gjithkund, ku ka një autoritet të imponuar despotik politik. Diktatura komuniste në Shqipëri dukej se fitonte pikë pathyeshmërie në terren, por personazhi i Lasgushit, Sokrati opo vetë Lasgushi, ishin fituesit e pikëve morale të koherencës.

[464] L. Poradeci, *Poezia, Vepra 1*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2009, fq. 345.
[465] Po aty, fq. 349.
[466] Po aty, fq. 354.
[467] Po aty, fq. 364.
[468] S. Hamiti, *Feja e diktaturës: Ekskursioni teologjik i Sokratit.* (poemë dorëshkrim), Gazeta "Rilindja", 2 shtator, 1993, fq. 9.
[469] Y. Çiraku, *Shqyrtime kritike nga Historia e Letërsisë Shqipe*, Shtëpia botuese "Albas", Tiranë, fq. 51; 54.

Filozofia e Sokratit-Lasgush është filozofia e letrarizuar që të mëson përmes mos harrimit në jetë.
Pra, poema sjell retorikë të dyfishtë. Sokrati i Lasgushit ishte humbës i madh real dhe njëherazi fitues akoma më i madh moral i kohëve. Por, ky nuk do të ishte fundi i poetit Lasgush Poradeci. Shoqëritë që e kanë përkrahur demokracinë si formë të qytetërimit kanë rregulla demokratike, të cilat imponojnë edhe mënyrën e sjelljes politike.
Lasgushi e ndërton poetikën e veprave të tij nëpërmjet fjalëve-kyçesh. Më pas jep një gërshetim të sendeve apo tipareve që nuk përputhen me njëra-tjetrën në mënyrë normale. Kështu vetë poeti në gjithë krijimtarinë e tij ka qenë i prirur nga ideali i unitetit, koherencës së universit artistik, duke u konfirmuar si autor i gjetjeve të mëdha lirike.
Në këtë univers ekzistojnë edhe tokësorja, kozmogonikja, dhe hedonistikja, parnasiania dhe folklorikja, romantikja, panteistja, të ndërthurura në botën e lexuesve me përkatësi origjinaliteti shpesh të diskutuar. Poeti ia ka dalë të shprehë artistikisht një sistem të madh me të gjitha hallkat përbërëse të tij. Racional dhe ndjesor, piktor dhe muzikal, ireal dhe real, mjeshtër fin i fjalës shqipe, filozof dhe folklorist, peizazhist dhe fortësisht tragjik, Lasgush Poradeci krijon përmes Sokratit një nga veprat më komplekse të letërsisë shqipe.
Pa frikë mund të thuash se kjo poemë është një galeri shembujsh të cilët përmes forcës artistike na mësojnë të vërtetën njerëzore në vite. Paralelizmat dhe kontrastet tematike e kuptimore përveçohen edhe nga ndërtimet gramatikore të tekstit poetik. Këtë e dëshmon përdorimi i foljeve, trajtave dhe kohëve me të cilat përshkruhen bëmat e personazheve në poemë.
Mirpo, më tepër se me figura gramatikore, përshkrimi, prezantimi, ndonjëherë edhe veprimi në pjesë të ndryshme të ndërtimit strukturor, bëhet përmes enumeracionit të simboleve, apostrofave, metaforave dhe tropeve të tjera gjuhësore. Metafora në poemë ngadonjëherë përdoret në formë shpirtëzimi, sikurse është rasti i gotës ngushëlluese së helmit, thënë ndryshe i gotës satanike.
Përjetësia përcjell mesazhin e mostjetërsimit të vlerave për të përmbushur misionin e tyre. Rimat e bëjnë atë tepër të veçantë. Poezia dallohet në fillim nga një ritëm i brendshëm, që më pas shndërrohet në të jashtëm. Shkallëzimi i ritmit bëhet i fuqishëm deri në fund të poemës. Në këtë krijim lënda përmes njeriut fiton përjetësi. Përjetësia e personifikuar flet me gjuhë njerëzore. Përjetësia i takon panteonit njerëzor. *"Jam sot, si vjet, jam mot si përgjithnjë"*.
Koha nuk është e pandryshueshme, ajo shpeshton ritmin përjetësisht. Njohjen e testamentit poetik Lasgushi e realizon përmes dy çastesh: Në njohjen estetike, (atë shqisore) dhe në njohjen e tejkohësisë (brezat e lexuesve).
E para realizohet përmes shqisave të të shijuarit, të prekurit, të nuhaturit, dëgjuarit ndërsa e dyta të gjitha këto i dorëzon në përjetësi. Poema në fjalë të kujton për një çast njohjen e botës nga poeti i Poradecit, arkitekturën e veçantë të kullës krijuese e vargëzuese, arratisjen e tij në mbretërinë kozmogonike dhe uljen në tokën e vdekëtarëve, si një përpjekje e gjatë pavdeksie sokratike për vetë laboratorn artistik të vargjeve të tij.
Nër shteg-bashkimi, që ti s'di sesi/ Bashkohesh brënda me përjashtësi/ Bashkohesh jashta me përbrëndësi/ Bashkohesh-rritesh-me-përjetësi.[470]
Raporti lëndë-objekt në poezitë *"Dita e njëzetetetës", "Ç'u mbush mali"* dhe "*Bjenë telat"* shpreht përmes thënies së drejtpërdrejtë letrare. Që të tria poezitë janë një

[470] L. Poradeci, *Poezia, Vepra 1*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2009, fq. 216.

deklaratë, një thënie e subjektit mesazh, që mund të identifikohet përmes vargjeve të autorit. Heroi lirik Ismail Qemali është projekt refleksioni i vetë ekzistencës së poetit që shpreh një situatë të konkrete apo një ngjarje objektive të madhe kombëtare, si shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë.

Thonë, është vet-i-tretë/ Thonë, është vet-i-tetë/ Thonë, vet-i-njëstetetë-/ Rrofsh moj Shqipëri përjetë![471]

Mesazhet e tri poezive janë aq të drejtpërdrejta, saqë struktura e poetike i afrohet gjuhës së folur, thënies, bashkëbisedimit real. Kjo lloj shprehje të kujton Sharl Balinë[472], i cili e thekson afrinë e gjuhës poetike me gjuhën e bisedës.

Në këtë fazë të krijimtarisë së tij Lasgushi sillet rreth një tematike të njohur, të artikuluar bukur, në planin patriotik dhe atdhetar. Kjo realizohet përmes mendimit patetik dhe figuracionit thellësisht elegant.

Poezitë e mësipërme mirëpriten nga lexuesi mbarëshqiptar dhe veçanërisht nga kritika letrare. Këto vjersha dëshmojnë një profil letrar origjinal që aplikon forma të reja shprehësish, figuracion të plotë poetik, formë të re prezantimi, sidomos në lëndën objektore me origjinë kulturore, historike dhe vërtetësi shkencore. Në këtë pjesë krijimesh personalja shkrihet me kombëtaren dhe bëhet njësh me universalen, përmes imazhit intelektual të poetit.

"*Për shkrimtarin* (Lasgushin) *e një bote të ngritur mbi izolimin dhe të ndarjes me Përëndimin, ka gjasë që përkitja me këtë univers* (publikun botëror) *të jetë e papërballueshme. Ishte pak a shumë sikur të gjendeshe në një mjedis, në të cilin edhe pse nuk kishe qenë, të dukej i njohur* (qyshkur) *ose i parë në ëndërr"*.[473]

VII.5. Vargje poetike pjesërisht të angazhuar…

Të gjithë aspirojmë për një botë më të mirë, më të denjë. Nën këtë mënyrë meditimi poetik liriku i shqipes sugjeron forma të reja ekzistence. Lasgushi e shpreh këtë në ekzistencë krijimesh si: *"Kënga e Shqipërisë së Re"* apo *"Muharrem Çollaku"* dhe "*Reshit Çollaku"*. Përmes një nënteksti të qartë, grupimin intelektual dhe bërjen e kombit, Lasgushi i përcjell në këngën e tij, për Shqipërinë e re. Ai kapet fort dhe evokon figura emblematike të luftës nacionalçlirimtare për të risjellë një dimension më luftarak apo heroik kombëtar. Këtë vizion poeti e shpërndan fare pak, në kohën e tij. Ai nuk shkroi asnjë varg servil për gjysmë shekulli.

Nganjëherë heshtja flet më shumë se fjala… Kështu L. Poradeci foli përmes heshtjes së tij të gjatë dhe atij pak anagazhimi në dy tre krijimet e pleqërisë së vonë. Të flasësh përmes tyre, konkretisht mes heshtjes, të jesh racional, lakonik, i saktë a i matur, të gjtha këto janë cilësitë e krijuesve të mëdhenj, të poetëve që e njohin rëndësinë dhe peshën e fjalës ose heshtjes.

Konica deklaronte më 1933-shin: *"Ati ynë që je në qiell, jepna fuqi të mbajmë gojën mbyllur kur s'kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthimet e shtypit. Ashtu qoftë!"*.[474]

Raporti i fjalës me heshtjen (atë poetike dhe atë në jetën e përditshme), është një çështje e ndjeshme, që përcakton dhe nivelin estetik dhe atë stilistikor të Lasgush Poradecit. Heshtja dhe fjala janë dy nocionet qëndrore, dy fjalëçelësa të jet'veprës

[471] Po aty, fq. 164.

[472] V. Kajzer, *Pjesë gjuhësoro-letrare*, Shtëpia botuese "Rilindja", Prishtinë, 1971, fq. 101.

[473] I. Kadare, *Dosjet e fshehta duhet të hapen për letrarët*. Intervistë e realizuar nga Dhurata Shehri, Gazeta "Panorama", fq. 18-19, e martë 24 prill, 2012.

[474] F. Konica, *Lutja e shkrimtarit*, në: *Vepra*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1993, fq. 163.

lasgushiane. Megjithatë, duhet thënë se mekanizmi i vjetër suvrejues vepronte në Shqipëri. Ndikimi i shtetit totalitar merr nën mbrojtje, kontrollon dhe mbikqyr letërsinë.
Ndikimi arbitrar i shtetit solli censurën, djegien e librave, kthimin e tirazhit të tyre në karton, apo persekutimin dhe lënien në heshtje të autorëve. Madje dikë e burgos, internon ose e pushkaton si armik të popullit.
Duhet përmendur, s'e antikonformizmin Lasgushi e përshfaq edhe kur e akuzojnë si zog të lirë liqeni, apo si poet të shitur te Mbreti i Shqipërisë, Ahmet Zogu.
I pari që filloi të akuzojë atëherë, ishte ish-ministri i Kulturës dhe kryetari i parë i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, Sejfulla Malëshova. Sulmi e revoltoi poetin dhe e shtyu t`i shkonte në zyrë e ta pyeste: *"Nga e di ti që unë u shita te Zogu?... Lasgushi hyri në pellgun oportunist të intelektualëve dhe u bë poet dallkauk. Dëgjo Sejfulla, çdo gjë tjetër ti mund të ma marrësh, po nderin tim si poet shqiptar ti s'mund të ma marrësh"*.[475]
Në fjalën e redaksisë së revistës së Lidhjes së Shkrimtarëve *"Literatura jonë"* (titull periodiku i kopjuar nga simotra ruse) në nr.1 të vitit 1947, duke aluduar drejtpërsëdrejti mbi Lasgushin shkruhej: *"Ka pasur gjithashtu shkrimtarë të cilët, edhe duke mos bërë krushqi drejt për drejt me armiqtë e betuar të vendit, kanë kënduar si gjinkalla në lëmë, yjtë, hënën, zambakun, etj, duke mos i shërbyer popullit për kauzën e tij, por duke i rënë legenit atëherë kur ky luftonte, vritej e digjej për liri e pavarësi"*.[476]
Në fakt përpos të gjitha këtyre që thuhen e qarkullojnë në shtypin e atyre do vitesh, evidentohet edhe një adhurim për Ahmet Zogun, Mbret. Mbase ka qenë një shenjë adhurimi për Lasgushin, kjo mënyrë, e cila në fakt nuk u përsërit më kurrë gjatë gjithë krijimtarisë së tij letrare. *"Për Zogun e I"*, titullohet krijimi i Poradecit. Megjithatë prej një materiali nuk mund të konkludojmë që Lasgush Poradeci krijoi poezi servile, si ajo që pllakosi në letërsinë shqipe të viteve '50-'60 në Shqipëri.[477]
Lasgushi e kishte kuptuar në thellësinë e tij rendin komunist, ndaj nuk e përshëndeti ekzistencën e tij përmes vargjesh. Edhe pse shkroi dy balada për dy heronj të luftës partizane, ato s'e panë dritën e botimit për shumë kohë. Vetë Lasgushi mendonte se ato as që do botohen për shumë vjet. *"Vjen si gjarpër gjarpëruar/ duke shfryrë e uturuar/ hekurusha e rinisë/ plani i hekurt i Partisë"*.[478]
Përgjigjen e vargjeve të dobët artistikisht, të socrealizmit Lasgushi e jep në librin e Petrq Kolevicës, *"Ç'të bënja bre? Siç deshin u a bëra! Mut deshin dhe unë mut ju dhashë"*.[479] dhe ndërkaq, kjo urrejtje përforcohet te *"Rilindja e Lasgushit"* me autor Petro Priftin, nipin e tij. *"Këta qelbo duan që unë ta bëj Muharremin dhe Rreshitin komunist, siç deshin t'i bënin ata, po dajua nuk i bën nacionalistët, komunistë"*.[480]
Kështu, si rëndom në të gjitha fushat, duhej gjetur gjuha e Ezopit apo nënshkruar "pakti i djallit". Shqipëria atëkohë gjendej në aleancë me bllokun komunist lindor.
Letërsia dhe artet frikonin nën ndikimin e ideologjisë zyrtare. Orët e letërsisë nëpër shkolla bëheshin përgjysmë me iluminizëm dhe përgjysmë me propagandë. Veprat letrare mateshin me metrin e përshtatjes së dogmës marksiste-leniniste. Duhej dëshmuar se me çfarë këto shkrime ilustronin ideologjinë komuniste ose përndryshe, çfarë u mungonte këtyre shkrimeve që ta arrinin këtë objektiv?

---

[475] P. Kolevica, *Lasgushi më ka thënë...*, Shtëpia botuese "8 nëntori", Tiranë, 1992, fq. 45-46.
[476] *"Literatura jonë"*, Tiranë 1947, nr.1, f. 4-5.
[477] L, Poradeci, "Gazeta e re", -Nr. 284, 9 tetor, 1929, f. 2.
[478] P. Kolevica, *Lasgushi më ka thënë...*, Shtëpia botuese "8 nëntori", Tiranë, 1992, fq. 144.
[479] Po aty, fq. 145.
[480] P. Prifti, *Rilindja e Lasgushit*, Shtëpia botuese "Toena", Tiranë, 1997, fq. 126.

Në të dyja rastet në shënjestër ishte shkrimtari. Shumica e bashkëkombasve në Shqipëri, adaptuan në publik pëlqimin e heshtur mbi ideologjinë komuniste. Heshtja e angazhoi Lasgushin në një rrugëtim të tillë të guximshëm për një poet që nuk shihej me sy të mirë nga sistemi totalitar.
Në fakt, Poradeci nuk ishte i vetmi që e kishtë provuar këtë zgjidhje. Ishin formalistët rusë, që në vitet '20 të shekullit të XX, të cilët e kishin projektuar tashmë këtë rrugë, pasuar më vonë edhe nga shumë të tjerë.
Foljet kalimtare në krijimtari zëvendësonin foljet jokalimtare dhe koha e kryer bëhej më e shpeshtë se e pakryera. Me këtë stil dyshimet i iknin, kështu, çdo lloj censurimi. Për të kuptuar natyrën e mbyllur të Lasgushit dhe shpesh herë raportin e tij të vështirë me njerëzit e ambientit që e rrethonte, gjithkujt i vjen në ndihmë, poezia e Franc Ginckait:
Në dyer zemrash trokiti shpesh/ Hyrë!- thoshin dikur/ Një cpoë bukë ai desh/ Porse i jepnin gur/ Kështu i mblodhi gur e gur/ I çoi në shtëpi/ Edhe me ta ndërtoi një mur/ Përreth zemrës së tij.[481]
Duke vepruar në këtë mënyrë Lasgush Poradeci nuk rrezikonte të shkelte hapur tabutë ideologjike të partisë shtet. Çelësi i fjalëkalimit në letërnjoftimin komunist ishte figura e ndritur e partisë shtet. Rrefrenet *bëre foran e Partisë* për Muharrem Çollakun dhe *bëre siç të tha Partia* ishin goma e shpëtimit në detin plot tallaz të kohës diktaturë, që mbyste koka njerëzish.
Beteja e Pojskës në Pogradec është nga më të përgjakshmet në Shqipëri, gjatë luftës antifashiste nacional-çlirimtare. Në leximin metonimik, duhej shpartalluar armiku i madh në numër dhe municion, kurse në leximin metaforik duhej të glorifikohej jehona madhëshore e kesaj beteje të lavdishme. Në poemë spikasin figurat letrare si: epanastrofeja *Hëni shokë, mos më qani, mos më qani e zi mos mbani...,* politononi *digje, bre,* Ç*ollaku, digje... dhe* aliteracioni Ç*'foli trimi i trimëruar?*
Baladat në vetvete mbeten ndër krijimet më interesante të shkruara në moshë të vonë nga autori. Ato himnizojnë Luftën e Pojskës, e cila u zhvillua më 16 korrik 1943, pranë bregut të liqenit të Ohrit, në fshatin Pojskë të Pogradecit.
"Baladë për Muharrem Çollakun" (Baladë e Kalasë së Poradecit) ka një thurrje interesante. Të tërheq vëmendjen si lexues prezenca e veglës muzikore të tamburasë, e pranishme në këtë krijim. Kompozicioni ndërtohet nga thurrima e gjashtë këngëve. *Ç'thotë vallë tamburaja; Ç'thotë teli i tamburasë; Ç'thotë zëri i tamburasë; Tunden telat valë-valë; Ç'thotë ajo vegël e gjorë;* dhe *Thurrja këngën tamburasë.* Elementët realë dhe artistikë bëhen njësh në të. Ngjarjet zhvillohen sikurse në histori, konkretisht në mesnatë, nën një peizazh i cili paralajmëron një betejë madhore, me toponime dhe hidronime. Shkrihen në poemë edhe vargjet popullore të zonës së Pogradecit, taktikë e njohur më herët kjo e Lasgushit, ARTIST. Në fund poema mbyllet me jehonën e heroizmit partizan të Muharrem Çollakut dhe fjalët e nënës plakë. Eufemizmi në pikën kulmore të poemës realizon pavdeksi artistike, sikundër ndodh në histori.
Prej së largu e pa krisur,/ Vjen një plumb i arratisur,/ Vjen pa cak një plumb i rrallë,/ Befas vjen të prek në ballë,/ Të lëmon si për hare,/ Me ngadalë të anon përdhe./ Puth-e, Muharrem, Kalanë/ Me ata shokët partizanë![482]
Metaforat *sikur kap me grusht rrufetë* dhe *i vulos me vulë gjaku* e bëjmë heroizmin e pashoq të Muharrem Çollakut më të pavdekshëm, në artin poetik të Lasgush

[481] P. Kolevica, *Lasgushi më ka thënë...*, Shtëpia botuese "8 nëntori", Tiranë, 1992, fq. 13.
[482] L. Poradeci, *Vepra letrare*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1990, fq. 294.

Poradecit. Këto poema me sa duket autori i kishte shumë përzemër, sepse thuhet në kujtimet e miqve të poetit që ai i dinte ato nga fillimi në fund përmendësh.[483]
Preokupimin e jashtëzakonshëm për tematikën sociale apo atë të luftës çlirimtare për liri kombëtare e gjen në publicistikën e autorit apo letërkëmbimin e tij.
Kuteli e përshkruan kështu këtë moment të poetit. *"Ai (Lasgushi) është sharë shumë dhe është lënë në hije, herë është lëvduar shumë dhe ka dalë në dritë, por më të shumtët e kanë paraqitur "larush" duke e sharë dhe lëvduar njëkohësisht."*[484]
Gjithashtu, Lasgush Poradeci evokon madhështueshëm, pa angazhim, burrërinë shqiptare, kryeshembull i së cilës është burri i vërtetë, Gjergj Kastrioti Skëndërbeu *(siç bënte sulm ngadhërimtar/ Gjergj Kastrioti vetë)*[485] apo Ded Gjo' Luli e të tjerë.
Artisti i madh, krijon për vete, veçonte Lasgushi, edhe pse pati mosmarrëveshje të heshtur me ata njerëz, të cilët e vunë letërsinë shqiptare në shërbim të ideologjisë politike.

VII.6. Pesimizmi në krijimtarinë e Poradecit

Përkundër mendimeve të sjella deri tani, pjesë dërrmuese e kritikës janë edhe poezitë e pesimizmit apo botës së errët. Kritika ka qortuar mes tyre ndjenjën e pesimizmit. Këto poezi rrisin dimensionin e tyre duke i bërë mjaft interesante, jo vetëm në planin artistik por edhe në atë psikologjik poezitë e Lasgushit. Këto krijime shfaqin dilema, dyshime, udhëkryqe hamletiane, frikra për shkatërrim idelaesh, sikurse dëshpërimet e rastit apo momenteve. Por edhe këto poezi jepen me shumë gurë plotësues në mozaikun emblemë të poetit liqenian.
"Çabej, -sipas Sabri Hamitit, *është sivëllau i Lasgushit, i cili për herë të parë hetoi thellësinë e poezisë së Poradecit, duke pohuar se çdo thellësi është e errët.*[486] Ai ka parashkuar moskuptimet dhe keqkuptimet që do të ketë ky sistem poetik në botën kulturore të shqiptarëve.
"Kjo aventurë negative nuk ka prekur vetëm interpretuesit e njëshit ideologjik, por jo njëherë edhe shkrimtarët, bashkëkohës së Lasgushit... nga lavdëruesit e dalldisur me shikim të errësuar, kritikuesit e cekët dhe mendje lehtë... dhe ndoshta më të rrezikshmit heshtakët e organizuar të veprës së tij".[487]
Shqetësimi që shpërthen në këto poezi ka elemente semantike dhe figurative, me intonacion dhe ritëm plot rima. Figurat e çelës të kësaj lloj poezie janë eksklamacioni dhe apostrofi.
"Ku qajnë motrat vëllanë" është një krijim i tillë i mirëfilltë edhe pse poezia është shumë e thjeshtë në tërësinë e saj. Nëntitulli (*Vajë në kadencë popullore)* e fokuson më së mirë këtë rast të shprehur në gjithështrirjen e tij dëshpëruese. Me përjashtim të strofës së parë, gjithë krijimi është ndërtuar mbi bazën e figurës së prozopopesë.
Lulja e zëmbakut është simboli i vëllait që nga eufemizmi *"ra dhe u shtri përdhe"*. *Vajto moj botë* dhe *e fshati i tërë* janë metonimi të pastra për të na dhënë idenë e shumësisë në një varg të vetëm, për këtë gjëmë të pa ndodhur, në familjen Gusho.
Në një interprtim kontekstual, shkëputur atij izolacionist, poezia ka ngjyra autobiografike. Mbresëlënëse janë edhe hiperbolat *të vdiq jot'më*; *t'u ngjall yt-atë*, të

[483] M. Shanaj, Filma dokumentar. Titulli: *L. Poradeci*, (skenari dhe regjia M. Shanaj), Prodhim i Tvsh, Tiranë, 1981.
[484] P. Kolevica, *Lasgushi më ka thënë...*, Shtëpia botuese "8 Nëntori", Tiranë 1992, fq. 215.
[485] L. Poradeci, *Poezia, Vepra 1*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2009, fq. 366.
[486] S. Hamiti, *Poetika Shqiptare*, Shtëpia botuese "55", Tiranë, 2010, fq. 257.
[487] Po aty, fq 257.

cilat artistikisht shumfishojnë dhimbjen e vdekjes dhe shtojnë pesimizmin apo vuajtjen.
"Vdekja jonë" është një tjetër syresh që i shtohet kësaj liste poezish. Hëna lart në qiell nuk ka dritën verdhoshe ar që e rihedh mbi ne, por është bërë pasqyruesese e dritës së diellit.
Heronjtë lirikë lasgushianë vasha dhe trimi, nuk i përballuan dot valët e liqerit, ndaj ata u fundosën frikshëm në thellësi të hapësirës poetike. Dashuria e tyre u shua, vdiq. Bota do të zezojë me veshjen e saj tashmë. Në ndryshim nga subjekti i njohur i fatkeqësisë titanik, heronjtë e vjershës mbyten të dy.
Edhe malli ka vdekur në këtë poezi, ndërsa Lasgushi e përshfaq ftohtësinë mes vargjesh. *Një mall që vdes përjetë...* Simboli i liqenit, pamëshirshmëria e valës fundosëse e bëjmë më të dhimbshme atmosferën e poezisë. Nga shqetësimi dhe nga mendimet plot helm e mbushura me pikëllim, poeti i përputh rimat e vjershës. Ky orkestrim dhe kjo shtresë tingullore mbeten një shprehje e dukshme estetike me vibrimet shpirtërore të poetit.
Në mënyrë edhe më eksplicite, logjika e brendshme e një gjendje të tillë pasqyrohet në rrafshin semantik dhe veçmas përmes disa figurave letrare të goditura nga Lasgushi. Shprehjet dhe fjalët si *vajtimi, dhimbja, pesimizmi, lotët* dhe *trishtimi* janë leksemat dhe semantemat që e pasqyrojnë ngjyrimin shumë pesimist. Nënteksti i ndonjë vargu shpreh kuptime të thella shekspiriane që të përshfaqin edhe elemente të dhimbjes universale. Rexhep Ismajli mendon se Lasgushi është superior ndaj atyre që mendohet se kanë ndikuar mbi të.[488] Madje nënkuptohet qartë vargu hamletian kjo botë u shthur... o prapësi... e dreq...
Që sot, ti botë, do mbash zi/ Një mall që vdes përjetë:/ Tërheq dy veta uj' i zi/ Dh'i tret posi një vetë...[489]
Duke mbetur në këndvështrimin kontekstual kjo poezi është shkruar kur poeti ka qenë i shtruar në spital, në sanatorium më 1918-ën. Datë që dëshmohet në fundin e poezisë. Mbase pesimizmi vjen i shtuar në vargje edhe nga gjendja shëndetësore e rënduar, e Lasgushit. Të njëjtën ndjenjë shpirtërore dëshpërimi të pakufishëm, gjejmë të shprehur me mjete të ngjashme artistike edhe në poezi të tjera të autorit. Gjendja shpirtërore modelohet me shprehje të tipit dhembje, vuajtje, lot, brenga ...
Lasgushi shkruante natën dhe flinte ditën, detaj që faktohet nga dëshmitë e bashkëkohësve apo familjarëve të poetit. Ndoshta natën ndikon errësira (meditimet, ëndërrat, subkoshienca).
Ka shkrimtarë që shkruajnë në orët e para të mëngjesit si për shembull William Wordsworthi. Ai e krahason mëngjesin me fëmijërinë e freskët dhe të pastër. Metafora është kryefigura më e bukur e përdorur në këtë prezantim pesimist. Metaforat që mbulojnë tërësinë e situatave si objekt poetike, karakterizojnë gjendjen subjektive, individuale që është shëmbëlltyrë reflektimi e realitetit.
Mendimi i poetit vjen i ngrysur, ndërsa ne si lexues mendojmë se kjo është edhe njëra anë e realitetit të viteve '30, anë e cila nuk mund të mos reflektohej në vetëdijen e poetit. Përkundër kritikave të ndryshme që vijnë, sikur ai i Krist Malokit, në aspektin artistik, këto elemente jepen të struktuaruar, sa mund të thuhet lirshëm se poezitë e këtij lloji janë ndër më të mirat dhe se ato realizojnë estetikisht dimensionin filozofik të autorit, dyshimin ndaj lumturisë që ndërpritet, që vdes shpejt si gjithë gjërat e bukura në jetë, dyshimin ndaj jetës në përgjithësi.

[488] R. Ismajli, *Poezia e M. Emineskut*, "Hylli i dritës", 1976, fq. 45.
[489] L. Poradeci, *Poezia, Vepra 1*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2009, fq. 97.

Poezia *"Lamtumirë"* në të katërt variantet e saj dhe poezia *"Më zu një mall dhe sot"* në tri variantet e saj përshfaqin nota dhimbje plot pesimizëm. Poezitë trajtojnë apatinë shpirtërore.

Frida Idrizi në parathënien e veprës së Lasgushit shkruan që *"fryma e thellë emancipuese e krijimtarisë së tij në përmbajtje dhe në formë, tipare këto të pezisë së Lasgush Poradecit, e bëjnë atë një nga poetët tanë më të mëdhenj, që do të vazhdojë të lexohet me emocion, jo thjesht për rëndësinë që pati krijimtaria e tij në kohën e vet, por sepse ajo edhe sot është shumë pranë nesh*".[490]

Spikat hiperbola "*ky det i një sumbulle lot*". Në variantet e tjera kjo dashuri do të venitet, do të ndërpritet, *vdes yll' i të rriturit tim*. Arratia edhe atëherë edhe sot e ndan vashën nga trimi. Ajo është një qenie e adhuruar, e pazëvendësueshme, një qenie pa të cilën, trimit në mëmëdhe si hyn vetja në sy, i duket hapësira boshësi, sikurse vetë jeta që është zbrazëti. Ndërkaq ka një lloj shprese të vogël kjo pjesë krijimtrie. Autori sado që e rikrijon shpirtin e plagosur, përsëri vë në qëndër të tij shpresën për shkëlqim, *Ndrin yll' i të rriturit tim*. Antitezat ndrin dhe vdes e realizojnë këtë lojë dritë-hijesh poetike.

...Përndritur mjerimesh pa anë,/ Ndrrin Yll' i të rriturit t'im.

Më pas poeti në variantet e tij përcjell pesimizëm:

...Pa-i mbytur mjerismesh pa anë/ Zbret yll' i të riturit t'im.

Tjetër variant

...I ngrysur mjerimesh pa anë/ Vdes Yll'i të riturit t'im.

Varianti i katërt dhe i fundit

...Pa dridhet liqeri pa anaë/ O vashë-e të riturit t'im.[491]

"Nga optimizmi dhe humanizmi aktiv, që është kaq organik në këto vjersha, mund të kuptojmë se ai fllad trishtimi e melankolie, që fryn në pjesën më të madhe të lirikës lasgushiane nuk është mohimi i jetës. Asketizëm, por dëshira e dështuar e poetit të etuar për jetën. Ndjenja humane këtu rritet gjer në altruizmin revolucionar, gjer në abnegacion".[492]

Mosdorëzimi tek e keqja është për autorin një busull orientimi kah optimizmit që vjen i pakët, në këtë prezantim vargjesh. Variantet duket sikur bëjnë lojë fjalësh, por mbeten të qartë në domethënien që prezantojnë tek opinioni pritës. Në mes të errësirës mbytëse dhe asfiksuese pesimizmi hedh rrënje, por ngjyra e hënës në qiell do të ndriçojë ambientin dhe filli i gjetur i kësaj gjendje merr fund me daljen e dritës, agimit të saj në mëngjes. Duket sikur Camaj i Temalit të Dukagjinit, ka marrë hua pak nga ky ngjyrim lasgushian për ta ritrajtuar atë te poezia famoze *"Fill i gjetun"*.

...në truell/ e gjeta fillin e tretun / në pikën e ndaljes së dritës!"[493]

Heroi i pesimizmit dorëzohet pas hyrjes së simbolit të dritës së diellit që lind dhe largon mendimet e keqija të mesnatës, lodhëse, raskapitëse dhe të mërzitshme. Kërkesa për dritë në të gjitha këto poezi vjen e nënkuptuar si pjesë e palexuar e ajzbergut kryelartë që qëndron mbi sipërfaqen e ujit. Thirrja e nënteksit për dritë është një dualitet antitezë, e gjendjes shpirtërore të errësuar të poetit, kur ai lëngonte në krevatin e spitalit tepër i sëmurë. Melankolia dhe dëshpërimi i poetit, përmbajnë tone të heshtura edhe kur ndonjëherë ai është ajror në mendime. Filozofia e tij nuk është rruga e pashpresë. Poezia e këtij lloji nis nga perceptimi i dejtpërdrejtë, vijon me përjetimin e situatës objektore dhe përfundon në dëshpërim, përzier me fije të vogla

---

[490] L. Poradeci, *Vepra letrare*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1990, fq. 38.

[491] Po aty, fq 198-201.

[492] M. Xhaxhiu, *Disa shënime rreth jetës dhe veprës poetike të Lasgush Poradecit*, në: Lasgush Poradeci. *Lirika*, fq. 13.

[493] M. Camaj, *Gedichte*. Albanisch-Deutsch, "Kyrill&Method Verlag", München, 1991, fq. 40.

shprese. Shqetësimi i poetit e ka shkakun në dyshimin e tij për realizimin e idealeve të kohës. Gjithsesi, gjendja shpirtërore është kalimtare dhe nuk ka të bëjë kurrë me pikëpmajet e ngulitura ose filozofinë e përhershme, sistematike të autorit.

VII.7. Lirika intime, erosi lasgushian. Krijimet për dashurinë!

Pas gërmimit në humnerën e thellë njerëzore, falë përroit të ndërgjegjes, davariten poezitë e intimitetit, që janë ngrohtësi zemre, kënaqësi shpirtërore, dëshirë për ëndërrim erotik... Edhe pse Lasgush Poradeci është adhurues i triumfit njerëzor në dashuri, nuk kalon asnjëherë në ekstrem banal nëpër vargje. Ai gjithëherë mbetet në kufijtë e arsyes kur shkruan për dashurinë. Madje i thyen ata kur merr format fshehtësie. Sistemi i jetës njerëzore nuk degjeneron te Lasgushi deri aty sa të vulgarizohet poezia. Lasgushi e shpjegon më së miri forcën e dashurisë, frymëzimin që i vjen prej saj, jetën që bën dhe që i jep kuptim asaj në tej jetësi.

"Unë besoj në dashurinë. Më shumë më ka tronditur në jetë dashuria, më shumë më ka gëzuar dashuria. Dhe një poet pa femër pranë nuk rron dot, e sidomos, nuk krijon dot".[494] Poradeci lartëson kultin e dashurisë. *Dashuri, heu mall i ri!*

Te ky cikël poezish vërehet qartë ndikimi i ekspresionizmit. *"Mora shoqezën përkrah"; "Vate prilli"; "Lodra e dashurisë"; "Flaka"; "Fluturimi"; "Zemërimi jonë"; "Gjarpërushja"; "Baladë"; "Ylli i jetës"; "Gremina"; "Përse të dua"; "Kroj i fshatit tonë"; "Vallja e luleve"; "Kur shtrohet vala"; "Një yll përjetësije"; "Malli"; "Si vate-e iku dashurija"; "Ku po shkon ashtu"; "Dashuri dardhare"; "Pamja"; "Syt' e tu vetëtimtarët"; "Kjo mbrëmje"; "Balladë"; "Kamadeva";*

Koncepti i Lasgushit për Kamadevën është më i mirë se ai i Dantes. Në pjesën e parë shihen të rinjtë, dashurohen dhe më pas shijojnë këtë dashuri, por demoni i së keqes i ndan. Në pjesën e dytë ai e kërkon të dashurën në qiellin e pafund. *"Kaptoj hapësira pafundësisht të mëdha, duke kaluar me shpejtësira kozmike dhe e gjej. Dashurohemi përsëri, me një dashuri të madhe të shpirtërore dhe unë dua ta afroj të dashurën, ta prek, ta puth, ta përqfoj. Dhe e prek, e puth e përqafoj, por kjo puthje, kjo prekje, ky përqafim s'më ngop, se s'është tokësor. Këtu është kocepti i ndryshimit të dashurisë sime nga jo e Dantes për Beatriçen[...] Prandaj sme ngop kjo dashuri qiellore dhe zbres përsëri në tokë. Dhe kjo dashuri në tokë që s'më ngop dhe e kërkon dh në qiell dhe s'më ngop dhe pres ta gjej në tokë përsëri dhe është vetë natyra e njeriu që kërkon e kërkon dhe s'ngopet kurrë."*[495]

Profesor A. Xhiku vëren se *"ishin romantikët ata, që tek e shihnin këtë jetë si gjallesë të trishtë në një botë të zvetënuar, gjenin te dashuria trajtën më të përsosur të bukurisë dhe një nga mundësitë e pakta për të duruar mundimin e ekzistencës tokësore, madje për ta bërë humane shoqrinë njerëzore. Në këtë gjendje shpirtërore shkonte edhe Lasgushi me lirikën e tij të dashurisë"*.[496]

Imazhi i Lasgushit është kurdoherë imazhi i personit të dashuruar: një njeri i vetmuar, që nuk kishte nevojë për të tjerë dhe ndihej i dashuruar. Me bastun në dorë, qenin Cuci, mikun e tij të ngushtë, me borsalinën mbi kokë, Lasgush Poradeci, një figurë që për një sy të vëmendshëm dukej enigmatik, rrezatonte në gjithë qenien e tij dashuri.

Madje, kur ia lexon vargjet, shikon që brenda vetmisë, ka një tallaz të jashtëzakonshëm dashuror. Ai është vërtet poeti i dashurisë, që i këndon asaj deri në llaftari.

---

[494] P. Kolevica, *Lasgushi më ka thënë*..., Shtëpia botuese "8 Nëntori", Tiranë 1992, fq. 120.
[495] Po aty, fq. 119.
[496] A. Xhiku, *Letërsia shqipe si polifoni,* Dituaria, Tiranë, 2004, fq. 147.

Lasgushi krijon në vjershë, *vashën* e *trimin*, dy protagonistët e erotikës shqiptare. Edhe pse prof. Muzafer Xhaxhiu, poezinë sentimentale të Lasgush Poradecit e quan lëngonjëse, duhet thënë se ajo anonte nga e kundërta. Sentimentalizmi i shtërgut të fundit ishte plot tharm jete dhe dashurie për ta jetuar dhe përjetësuar atë.

Pjesa më e madhe e poezive të Lasgushit mbeten himn për pasionin e dashurisë, që ta mbush jetën me energji dhe gëzim pozitiv. Ndjenja e kësaj poezie lidhet me të bukurën dhe të mirën. Sytë janë tregues shpirtëror në poezinë lasgushiane.

"Syt' e lumtur" është idil poetik i ngjyer në motivin erotik. Poezia është një pikturë në ngjyra vaji ku përcillen misteret e dashurisë. Të bien në sy figurat e epanastrofesë dhe shkallëzimit. Magjia e dashurisë ndërtohet përmes tri fjalëve çelësa: afrim, pushtim, turp. Me një fjalë, poezia e Poradecit rrezaton dozë të madhe sentimentalizmi, gjë që s'mund të mohohet asnjëherë. Ndjenja e dashurisë është ndjenjë e bukur dhe e mistershme, ndërsa godet në zemrën e djalit dhe vajzës.

Poema *"Kamadeva"* hapet dhe mbyllet në formë përsëritjeje. Kjo duket në shtatë strofat e para. Mes figurës së paralelizmit figurativ, vasha e dikurshme, por edhe ajo e viteve të poetit, shfaqet si shoqeza e tij më e mirë, mes përfytyrimit dhe vegimit. Më tej vjen ndarja. Gjërat e bukura janë të destinuar të përfundojnë (vdesin) shpejt. Përmes figurës së metonimisë poeti çuditet e mendon: *si zbrite o dashuri për në greminë!*[497]

Përmes figurës së apostrofit poeti i drejtohet Kamadevës, Zotit që të ndihmon ose jo në dashuri, demonit të frikshëm që s'e shpëtoi dashurinë e autorit. *O kamadeva ime shigjetëhelmuar, o demon që lëshon mbi sytë e mi verbim-magjie,* vargëzon Lasgushi dhe e mban të mbërthyer ndër vargje lexuesin.[498]

Paralelizmi figurativ sjell efektin e fundit apokaliptik, sikurse të vetë ndarjes mes poetit dhe vashës së tij. Lasgushi e krahason si perëndeshë shoqezën e dashurisë, që ka prekur dyert e mbretërisë qiellore. Dashuria e vashës së tij edhe pse nën dhe është dritë që nuk perëndon. *"Dhe po të jem nën tokë,/ që vdiqa ti mos thuaj,/ më shkruaj dhe nën tokë,/ se unë do të të shkruaj..."*,[499] do të vargëzonte në të njëjtën linjë më 1936 edhe spanjolli Migel Ernandes. Krijimet realizojnë një rrugëtim të mbramë, mes tokës dhe qiellit.

Si fshihesh nënë dhe / Në varr mbuluar,/ O drita që nuk ke/ Të perënduar[500]

Njëri ndër lexuesit e parë të Kamadevës është studiuesi kosovar Sabri Hamiti. *"Më 1979 ai më fliste për varantin e plotë të poemës "Mbi ta", dhe për dy poemat e mbaruara, "Kamadeva" dhe "Ekskursioni teologjik i Sokratit", duke ma propozuar si dhuratë dorëshkrimin e poemës "Kamadeva" me një autoportret të vetin"*.[501]

Në ato vite, rrallëkush e dinte nga lexuesit e atij brezi që Lasgushi vazhdonte të shkruante poema të mëdha, ndërsa kritika socrealiste deklaronte ngutshëm se Lasgush Poradeci kishte pushuar së shkruari gjysmë shekulli më parë. Kjo paranojë do vazhdonte të shoqëronte krijuesit, që distancoheshin në mënyrë të heshtur nga metoda krijuese e realizmit socialist. Ndodhte që lexuesit të besonin vërtet që Lasgush Poradeci kishte vdekur qyshkur, duke vënë në dyshim kujhtesën e tyre.

Romanca *"Kur shtrohet vala"*, është një prej poezive më të ndjera poetikisht të autorit. E gjithë poezia prezanton dekorin e dhimbshëm të civilizimit dhe pasionin për të dashuruar. Në kahun tjetër, pasqyron brengosjen prej ndjenjës dashurore, si një

---

[497] L. Poradeci, *Kamadeva, Poezia vepra 1*, Shtëpia botuese albPaper, Tiranë, 2009, fq. 318.

[498] Po aty, fq. 320.

[499] M. Ernandes, *Poezi spanjolle të shekullit të XX*, Shtëpia botuse "Naim Frashëri", Tiranë, 1991, fq. 170.

[500] L. Poradeci, *Kamadeva, Poezia vepra 1*, Shtëpia botuese "albPaper", Tiranë, 2009, fq. 325.

[501] S. Hamiti, *Poetika shqipe. Metafora e Lasgushit*, Shtëpia botuese "55", Tiranë, 2010, fq. 246.

objekt estetik. Metaforat *shtohet vala; pikonin sytë,* anaforat *gjithë përdhe; posi një det,* sinekdota *dashuronte dashuria* mbeten gjatë në kujtesën e lexuesit. Dashuria për Lasgushin është një frymë e madhe mistike. Lasgush Poradeci kultin e femrës së dashuruar e bën realitet në poezinë e tij duke trajtuar këtë temë delikate.
Poeti me këtë poezi u ka paraprirë problemeve kontradiktore të kohës. Vargu *Më s'kishin turp që s'kishte fjalë...,* mbaron me tripikësh (retiçencë) për të dëshmuar provincializmin e viteve zilitare, që përhapnin fjalë për dashurinë e të rinjve.
Edhe malli është shprehje e dashurisë në këtë lirikë të ndjerë lasgushiane. Mesazhi i nënkuptuar i vargjeve të kësaj poezie është bashkimi i të dashuruarve.
Dashuria mbetet një ndjenjë e fshehtë dhe e bukur njëherazi. Me pikëpamje të shprehura artistikisht në këtë poezi, lidhur më faktin se njeriu është pjesë ekzistente e dashurisë së vet, Lasgushi iu afrohet mendimtarëve të mëdhenj, të cilët pohojnë se njeriu dhe ndjenja e dashurisë së pastër nuk vdesin asnjëherë. Ato jetojnë në krijimtari dhe memorien e lexuesit njëherazi.
Nisur nga mosndrojtja e një ndjenje të tillë që nuk pyet ligjësi kur të pushton, poeti u drejtohet bashkëkombasve lexues me poezinë *"Mora shoqezën përkrah"*. Vjersha shpreh botën intime të të dashuruarve, të cilët fusin në funksion kujtesën për të pëjetësuar erotizmin e tyre. Dashuria mund ta ftohë ndonjëherë ndjenjën e saj të fuqishme dhe zjarrmia e ethshme, e sëmurë kohësh tinzare njerëzore, mund ta tjetërsojë atë. Premtimet e rrejshme të përditshmërisë shqiptare mund të sillnin rrezikun e harrimit në dashuri. Lasgushi për herë të parë shpërthen dhe përjetëson çastin seksual, duke shmangur banalizimin e aktit në vargun e tij.
Vendi i përjetësisë së dashurisë nuk është ai i bregliqenit të Ohrit, as qyteza e Poradecit bërë fir, por është organi seksual i femrës që e lë pa mend heroin lirik të dashuruar. Një ekstazë mes jetës dhe vdekjes është shprehur mes antitezës së fuqishme të vargut, për të dëshmuar dashuri trupi.
...E vëndin kur e sjell nërmënd,/ Kur sjell nërmënd ah! atë vënd,/ As rroj, as vdes, po jam pa mënd.[502]
Cikli i poezive të dashurisë sërish fal emocion teksa e lexon atë. *"Ti po vjen që prej së largu"*, është poezia, me të cilën poeti tregon dorëzimin e shoqezës në krahët e pasionit të zjarrtë të dashurisë.
Lasgush Poradeci përdor metafotat *përgëzohet trëndelina;* e *zëmbaku që t'u fal*, për të dhënë idenë dorëzimit të vashës në duart e të djalit. Përmes figurës artistike të shkallëzimit rritës, Lasgushi risjell në vemednjen e lexuesit ndjenjën e nderit te gjinia femërore,e vëtë vashës që bëhet grua dhe krijon familje. Metafora *të të shtroj* bashkon gëzimin me dhimbjen si për të na kujtuar se dhimbja e fisnikëron njeriun dhe e bën atë pjesë të lumturisë së madhe njerëzore. Ndryshe bota do ishte e tharë dhe pa nerv jete.
Ky cikël në vetvete është një relaks shpirtëror për jetën njerëzore, për emocionet e forta që ajo të fal. Cikli poetik për dashurinë, përbën prezantimin e aventurave të shkuara që kanë shoqëruar poetin që i nëdon dashurisë dhe erotizmit të saj.
Është një e vërtetë psikologjike mbarënjerëzore që vërteton, se sa më shumë njeriu të ketë qenë i privuar nga gëzimet që fal dashuria dhe ndjenja e saj, aq më shumë ai shikon rreze dielli për të jetuar, merr ajër dhe bëhet oaz dashurie për jetën e tij.
Ndjenja e dashurisë shndërrohet në ndjenjë gjithëpërfshirëse. Pikërisht ky fenomen vërehet në krijimtarinë lasgushiane të dashurisë dhe të mbetet gjatë në kujtsë për lexuesin.
Elementet e ndërtimit të vagut dhe strofës prezantojnë delikatesë poetike. Këto poezi dallohen qartazi për shtresën e tyre ritmiko-melodike si dhe muzikalitetin e theksuar.

[502] L. Poradeci, *Kamadeva, Poezia vepra 1*, Shtëpia botuese "albPaper", Tiranë, 2009, fq. 242.

Vërehet qartazi se poezitë e ciklit dashuroro-erotik të Lasgushit burojnë nga një vrull i pastër erotik, nga një gëzim i ndritshëm shpirtëror, i cili shprehet në planin eufonik, me rima të kryqëziara dhe herë-herë të puthura, që saktësojnë ndjenjën e të dashuruarve.

E ngjashme për nga motivi, por e ndryshme nga mënyra e receptimit është poezia *"Gremina"*. Ritmi i deklaratës poetike, këtu është i ngadalësuar, kurse tingulli melodioz në përgjithësi, sado që është në varësi nga elemente të bukurtingëllimit të hapur, ka tisin e një jehone me intonacion fluid. Këtë e ka shkaktuar vetë lloji i poezisë që Lasgush Poradeci krijon. Forma dhe parimi estetik në këtë poezi bëhen njësh, përmes një shpërthimi të lirë. Për këtë arsye, kjo poezi është dhe mbetet një konstatim i elementëve, që projektojnë konceptin e dashurisë si shprehje të vetadhurimit të poetit për këtë ndjenjë robëruese. Kalvari i dashurisë është një golgotë e hijshme plot dhimbje e llaftari. Dashuria mbetet një krijesë e brishtë, që me kujdes duhet rritur buzë greminës së jetës. Hiperbola merr trajtën e metaforës për të përjetësuar idenë e shpirtit të dashuruar që nuk vdes.

Për dashurinë-o Zot/ Që shemb një burrë/ Që s'e pat ndjerë dot/ Gruaja kurrë [503]

Përmes kësaj poezie Lasgush Poradeci lartëson gruan përballë ndjenjës së bukur të dashurisë në jetë. Tematika e dashurisë vijon të ndihet e ëmbël dhe kokëfortë në vargjet e Poradecit. "Në to *dashuria*, -shkruan Frida Idrizi, *në krijimtarinë poetike intime të Lasgush Poradecit, e mbush letërsinë tonë plot më drita, gëzim dhe ngrohtësi për ta zbukuruar jetën, jo duke e ilustruar atë, por duke pasuruar shpirtin"*.[504]

Në të gjithë librin "*Vallja e Yjve"* e ndeshim dashurinë si robëri, liri dhe llaftari. *"Në shpirtrat rinorë djeg malli i dashurisë që siç thotë poeti është këngë e pakënduar, vaj i pavajtuar"*.[505] Lum kush bën dashuri, mallkuar kush bie në dashuri. Ndjenja e dashurisë është tepër e fuqishme dhe kur ti kujton se e ke harruar atë. Në të vërtetë, ti jeton përherë me atë ndjenjë.

Poezia "*Balladë"* (Në frymë popullore), cilësojmë se mbetet nga më të bukurat e autorit. Ajo qëndron në një koncept shoqëror dhe moral, i cili buron nga jeta e vendit dhe tradita e mirë popullore kombëtare. Poezia është e afruar me këngën popullore pogradecare *"Fryn veriu në Mal të Thatë"*. Kënga dhe poezia lasgushiane ndërtohen me 8-rrokësh.

Era e shkundërmuar është pranëvënie paralelizmi poetik me afshin e dashurisë. *Mënjolla* është vasha e re e brishte. Edhe këtu dashuria këndohet mes *trimit* dhe *vashës*.

Katër këngët e para sjellin imazhin e katër stinëve të vitit. Dimri mes veriut, malit, dëborës dhe erës. Pranvera me çeljen e luleve të saj, vera me vapë zagushi dhe kallinj gruri të pjekur, ndërsa vjeshta me verdhësi e dallëndyshe, që ikin, shkojnë larg.

Djali, (trimi) në poezi është ndezësi i ndjenjës së dashurisë. Dashuria e tyre vë kurorë në kishë, duke shenjtëruar mëkatin në martesë. Epitetet dhe krahasimet nxjerrin në pah ndjesitë dashurore të të rinjve. *Në të shtënça, moj, në dorë/ do të ngroh si top dëborë*... Dy fjalët e kundërta *ngroh* dhe *top dëbore* mbajnë emcion të madh poetik. Poezia sjell një lidhje të saktë kuptimore mes dëborës së ftohtë dhe topit të dëborës, që përpunohet gjithë art së tepërmi nga mënyra e pazakontë e ngrohjes së ftohtësisë.

Zemra e djalit të dashuruar flakëron nxehtësi, çliron energji pozitive në dashuri, një energji që nuk duhet t'u mungojë çasteve të tilla. Nënteksti i ajzbergut heminguejan është fare i qartë. Të vetmuarit kanë ftohtë, të dashuruarit ngrohin njëri-tjetrin deri në

[503] Po aty, fq. 296.
[504] L. Poradeci, *Vepra letrare*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1990, fq. 30.
[505] Po aty, fq 27.

zjarrmi bashkmi. Perifraza *lele ngriva* është tabuja e aktit seksual gjatë dimrit të ftohtë në Pogradec. Vargu në këtë poezi ndërtohet në mënyrë kushtore, ndërsa foljet i ka vendosur në mënyrën dëshirore. Nisur nga modeli folklorik popullor shqiptar, përparësi në poezi ka mashkulli, i cili e bën për vete të vajzen e tij. *Trim, më more-edhe më shtrove*... Idilikja ndërthuret me emocionin romantik dhe sensual të situatës. Shkallëzimi ngjitës i vjershës shpreh optimizëm maksimal.

"Mbretëria e zemrës" është shtëpia e motrës (motra e ëmbël është e barabartë me fjalën e dashur) në një idil mbresëlënës. Similituda e jetës është shenjuar nga magjia e artit që i jep kupim mëkatit sipas vetë botës së krishterë.

Tek poezia tjetër *"Mbretëria jonë"*, në pjesën e parë dhe të dytë flet miqësia, ndërsa në pjesën e tretë poetizon Lasgush Poradeci. Si në mbretëritë e fuqishme, mbreti dhe mbretëresha do të formojnë mbretërinë e tyre, vatrën familjare. Shpirti dhe ndërgjegja marrin formësimin e njerëzve të dashuruar, që nuk duan t'ia dinë për pjesën jashtë mbretërore.

Poezia erotike, vetë mënyra e modelimit të poezive të dashurisë në përgjithësi shpalosin pjesë të jetës intime të poetit. Përjetimi i lëndës erotike në poezi vjen i drejtpërdrejtë. Meditimi dashuri-shpirt bëhet një raport utilitar, ku erosi si një Ante, fuqizohet nga forca tokësorë, magjia dashurore e njerëzve vdekëtarë. Secila prej vjershave është një kulm erotik, ku evokohen çastet apo orët e bukura nga takimet deri tek puthja. Të gjitha këto përveçohen përmes leximit të tipareve mjaft sensuale, siç janë trupat, buzët, sytë, gjinjtë. Në poezi të tjera të motivit të dashurisë, poeti pozicionohet tek mënyra e rënies në dashuri, në ambiente të ndryshme.

"Dora jote ledhatarja"; "Posi burbuq' e trëndafilit"; "Balladë" etj., mbeten bllok në tërësi vjershash të tilla. Dashuria është jo vetëm një emocion, por edhe fuqi themelore jetësore. Lasgush Poradeci e këndon në vargje këtë ndjenjë si fuqi tokësore e qiellore. Por, thellësia e saj vërehet në botën njerëzore kur e dashura këndohet në nivel të bukurisë trupore e shpirtërore.

Krijimi lasgushian i dashurisë shfaqet sidomos në lirikat personale. Aty dhe vetëm aty, tingullon i veçantë zëri i tij, figuracioni origjinal mes variantesh të ndryshme të cilat lartësojnë ndjenjën e thellë. *"Trioleta"* është robërim kokë e këmbë nga dashuria. Antitezat *gëzon e qan; ëmbëlsi verore*, perifrazat *motërza bujare* apo *zemrën ma more*, janë kryekode zbërthyes të kësaj dashurie. Titujt e lirikave të tjera: *"Syr'i fshehur"*; *"Vesë dashurije"*; *"Erë trëndeline"*; *"Ç'dëgjoj me sy të trembur"* mbeten dëshmi e zgjedhur figurative për dashurinë e poetit. Këtë e dëshmojnë titujt e vjershave të dashurisë, që në më të shumtën e rastve kuptohen si figura të metaforës.

Me një fjalë, të gjitha këto lirika kanë si kryetemë, atë të dashurisë. Në vëllimin *"Vallja e Yjeve"* temë themelore është dashuria, e cila përveç figurës së yllit plotësohet edhe me fjalët (simbolet) si: *zjarr, mall, varr, flakë* etj. *"...tashi në fundin e zemrës së këngëtorit mbin e rritet tinëz, së thelli një ndjesi e re*: *dashuria. E kjo ndjesi e re i fal këngëtorit gaz e dhembje, që të dyja këto të lidhura me fillin e fatit... Lasgushi ka përjashtuar nga rregulla e rimës një pjesë të Balladës edhe një pjesë të Përjetësisë (varianta e Yllit të zemrës). E para fillon kësilloj*:

Fryn veriu në mal të thatë / Thotë vasha lele ngriva. / Duro vashë, të durojmë, / Si duron mali dëborën.

Gjeneza e kësaj vjershe është një këngë popullore tepër e vjetër, e cila këndohet në Poradec. Dyke e stilizuar, Lasgushi i mbajti kësaj vjershe, në fillimin e të gjashtë pjesëve që e përbëjnë, fakturën e saj origjinale. Me përjashtimin e këtyre dy vjershave të gjitha vjershat e Lasgushit i shtrohen regullës së rimës. Këtu hyn edhe vjersha

Përjetësia, "Vallja e Yjve"), e cila më parë na bën përshtypjen e një vjershe të lirë-pa masë e pa rimë).[506]

Poezia *"Fluturimi"* thellon radhën kuptimore të poezive për dashurinë: *Një mall e zjarr që ndrin në zemër prej yllit t'ënd, prej yllit t'im...* Përqafimi realizohet me shkallëzimin e polisedentës *veç mall e zjarr e flakë e dritë, e dehje e prehje që të dy*. Ndarja e dashurisë prodhon ngashërimin e zemrës së dashuruar.

Kështu si në vallen e yjve, Lasgushin e kap mendimi dhe mendimin plot fluturime. Ylli i dashurisë zbret nga mbretëria qiellore si pëllumb i dashuruar, prek ndjenjën e të dashuruarve në tokë dhe e merr e ngre lart, drejt trëndafilit qiellor e hyjnor, shtëpisë së Zotit!. Antiteza *Nuk paske qenë vrer i zi, po qenke vetëm dashuri* ngjason me antitezat ëmbëlsi-dashuri, të cilat në vargjet e vjershës "*Zemërimi jonë"*, bëhen ndjenjë fshehtësie plot bukuri. Kënga e dashurisë është e fuqishme në të gjitha vjershat e këtij cikli.

Në një album turistik për Dardhën, botuar në Bukuresht të Rumanisë nga Kryetarja e Naltë dhe Patronesha e Turizmit në Shqipëri, Princesha, Maxhide Zogu publikohet poezia që mban titullin *"Dashuri dardhare"*. Vargjet e saj mbeten nektar dashurie, sepse dashuria është një kushtetutë për engjëjt që synojnë të jenë njerëz në tokë.

Kjo mbrëmje plot me qetësi/ Kjo pamje plot me bukuri/ Kjo dehje plot me fshehtësi/ Dhe vasha ndjen dhe vasha rri/ Dhe trimi vjen dhe trimi s'rri/ Dhe zemra zjen dhe bren në gji[507]

Poezinë në fjalë, Lasgushi ia ka kushtuar vajzës që ai dashuroi në të ri të tij, piktores Andoniqi Xengo. Atëherë më 1930-ën, në Dardhë të Korçës, ai shkroi poezinë e mësipërme, ndërsa ajo krijoi një cikël pikturash me natyrën e bukur dhe piktoreske të fashatit malor turistik, mahnitës njëherazi. Vetë Lasgushi është shprehur ato kohësh, që ditët me Niqkën, në Dardhë ishin të *mrekulluarëshme* (fjalë tipike lasgushiane). Këto shënime zbardhen në ditarin, (prozën poetike) "Vizitat e zonjushë Anës në kullën time". Aty thuhet: "*Këto shënime janë të sinqerta, këto janë shënimet e Niqkës, shënimet e dashurisë. I kam shkruajtur për veten time, vetëm e vetëm për veten time, që t'i kem për veten time, jo për të tjerët, t'i kem po t'i kem vetëm për veten time". Niqka ishte kështu, krijesa që i rëmbeu atëherë zemrën Lasgushit, që siç shkruan vetë në ditar, "...ishte njeriu që mua ma hëngri kokën, pasi më parë më bëri të ngjëroj ambrozinë e perëndishme dhe të pi nektarin e perënidshëm"*. [508]

Netët në fshatin magjik të Korçës më pas, shoqërohen me këtë shënim, në ditar: "*Këtu është çarçafi me lulet e kuqe të Niqkës, faqja e jastëkut ku kish vënë kryet, shamiçka e mëndafshtë që më parfumovi trupin pas ekstazës s'onë dashurore të asaj nate në Dardhë, dhe cicambajtësja delikatisime prej mëndafshi e Niqkës"*. [509]

Mitrush Kuteli ndërkaq e vë në pah erotizmin dhe prezencën e tij në poezinë e Lasgush Poradecit. *"Erotizmi zotëron pjesën më të madhe të poezisë për dashurinë. Kjo gjë mund të provohet edhe statistikërisht, sepse 23 nga 45 vjershat e "Valles së yjve" edhe 45 nga 67 vjershat të "Yllit të zemrës" janë erotike. Emri i volumit të parë nuk është përveçse emri i poemës erotike e kozmogonike "Vallja e yjve". Për,mbledhja e poezive të këtij volumi të dytë mbante, gjer në vjeshtën e vitit 1936, emrin "Vasha e trimi", protagonistët e dashurisë në etikën shqiptare"*.[510]

---

[506] M. Kuteli, *Vepra letare 5*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1990, fq. 210-211; 219.

[507] L. Poradeci, *Dashuri dardhare*, në albumin turisik: Dardha, Shtypur në atelierët e tipografisë "Albania", Kostancë, Rumani, 9 maj 1938, fq. 14.

[508] L. Poradeci, Vizitat e zonjushë Anës në kullën time, Revista "Klan", nr. 77 (2), 4 tetor 1998, f. 40.

[509] Po aty, fq. 41.

[510] M. Kuteli, *Vepra letare 5*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1990, fq. 227.

Poezia *"Ku vemi shpesh"* shijon më shumë, sepse aty gjen arratinë e ndjenjës që përpiqemi ta fshehim në dashuri.
Në zemër t'ënde vetëm unë/ Në zemër t'ime vetëm ti/ Dhe jashtë bota fjalëtare/ Dhe jashtë syri plot zili.
Duhet të theksojmë se Lasgush Poradeci është poet i lirë vëçnarisht në mendim. Ai shpreh çdo lloj ndjesie shpirtërore. Ky njeri ka parë shumë, ka dashuruar shumë, ka vargëzuar për dashurinë shumë dhe kjo është gjëja më e bukur, që e gjen të thënë plot finesë vargu e mendimi, në brendësi të veprës së tij letrare. Sipas Kutelit *"Këtë ndjesi ai e ka hedhur në varg, e ka thënë troç, e ka thënë pa frikë"*.[511]

VII.8. Filozofia e jetës dhe tragjizmi përmes dhimbjes poetike

Vuajtja dhe vetmia që ndjen Lasgushi, të strukturuara artistikisht në poezi, paraqiten transcendente. Ato nuk shkaktohen nga gjendja konkrete jetësore e poetit. Edhe pse nuk mund të mohohet ndikimi i literaturës së lexuar, meqë faktet e njohura jetësore shenjohen përmes elementesh poetike moderne siç janë zbrazëtia, vuajtja, mërzia, gjendja e brendëshme, parandjenja dhe nervozizmi ndaj vdekjes, trishtimi dhe vetmia nga momentet e pajeta dhe dëshira për t'i personifikuar ato, duhet thënë se poezitë janë krijuar në mënyrë mjaft origjinale. Elementë të tillë shprehin gjendjen e brendshme konkrete subjektive, individuale të lirikut. Ato janë formësuar në një tërësi artisitike dhe prezantojnë një poetikë të veçantë.
Kjo poetikë është moderne, sepse shpreh diçka të re, që haset rallë në letërsnë shqipe. Poeti ka guxim ta artikulojë dhimbjen e tij, vuajtjen personale, pavarësisht nga pikëpamja vetmohuese dhe pavarësisht nga filozofia e shqiptarit, nga krenaria e tij duke shpërfillur dhimbjen, vetminë, tragjizmin e kohës.
"Vesë dashurije"; "Si nus' e re"; "Vashë dhembshurije"; "Je ulur fort"; "Oh, vanë fletët..."; "Ç'dëgjoj me sy të trembur"; "Dëshirave"; "Kur në flakë"; "Lamtumirë";
Të ëndërrosh apo përfytyrosh dorën e shoqezës së fëmijërisë mbi supin tënd, të luash me vajzat e asaj kohe, kur u bie mbi fytyrë i kuqi, i dashurisë, humbja nëpër kohë e kësaj shoqërie, janë pikat e takimit të lexuesit në poezinë *"Vesë dashurije"*. Përmes saj autori sjell këto eksperienca që njeriu ka dëshirë sërish t'i përjetojë në jetën e tij. Loja me vajzat, tani që ato janë rritur është e ëndërrt. Janë ritur vajzat!
Malli i dashurisë së parë dhe forca e harrimit të saj endet në poezinë e tij *"Si nus' e re"*. Takimi i vashës me trimin, rindarja e tyre dhe shpirti mërgimtar i kujtimeve e bëjnë jetën të mbështillet me vellon e pluhurtë të harrimit në kohëra. Poezia përcjell këtë gjendje trishtimi që ta fal malli i harrimit.
Ndalesë tjetër në këtë rrugëtim jetësor tragjik është edhe poezia *"Vashë dhembshurije"*. Largësia sjell metamorfozën e harrimit. Besa e shpallur në dashuri bëhet fije-fijë dhe lëngon. Vasha e dhembshur ka përfunduar në motër. Tragjizmi i kësaj ndjenje është i papërshkrueshëm në dualitetin e saj teatral. Në këto lloj poezish Lasgushit më shumë i takojnë fjalët *llaftari, fshehtësi, dhembshuri, varfanjak* apo *lotë*, sikurse vëren Muzafer Xhaxhiu.[512] Gjithsesi, këto fjalë janë përdorur me mjeshtëri nga Lasgush Poradeci. Kompozimi i përgjithshëm artistik i poezive vjen në mënyrë simbolike të arrirë. Shkolla poetike lasgushiane, mbetet arritje edhe në këtë aspekt mistik të saj.
Kujtimi i një dashurie që nuk është më, është thelbi e poezisë *"Je ulur fort"*. Vitet e dashurisë së artë u shuan, dogjën, përvëluan...Vetëm kujtimi ka mbetur tani, madje ai

[511] E. Demo, *Nje burrë që flet pa frikë për dashurinë*, Gazeta "Shekulli", 23 shkurt, 2012, fq. 8.
[512] M. Xhaxhiu, *Kritikë dhe studime letrare*, Tiranë, 1975, fq 91-104.

dhemb. Kujtimet ndonjëherë nuk kanë diell! Moti dhe zemra paralelisht janë nxirë e sterrosur tashmë në këto kujtime.
"Oh, vanë fletët..." (fragment) është një tjetër poezi e kësaj linje trajtuse, në makinerinë poetike prodhuese të Lasgush Poradecit. Rrënia e fletëve, në zi të kohës është vdekje e figurshme e dashurisë. Rënia e gjetheve nga lartësia e tyre tregon që ka një fund të jetuar. Ato sheshtojnë të vetmuara. Ky proces tragjik është i pashmangshëm në jetën e jetuar. Me sy prej vetëtime, buçimheshturi durim ka mbledhur fletë-fletë këtë aspekt ekzistencial jetësor.
"Ç'dëgjoj me sy të trembur" ka në fokus të saj përpjekjen e madhe të njeriut për ta mbajtur gjallë me çdo kusht dashurinë e tij me thonj në zgrip të jetës a vatrës së zemrës flakë. Propozimi frik portretin e djalit, shprish fytyrën e tij. Kjo këngë e llaftaruar godet në imazhin portret të djalit dhe harrohet dhe zhvillohet e gjitha më ton ekzistencial. Është kënga, që gjen shteg te kënga, në kërkim të mbijetesës së dashurisë. Zërit të vashës i shtohet kënga e dashurisë për të dëshmuar arenën e njeriut të guximshëm gladiator. *"Dëshirave"* është poezia e fatit të pashpresë të njeriut. Dëshirave të tanishme, nga mosbesimi u është mpakur lumturia, pa të cilën vdes edhe shpresa fundore. Poeti kërkon gjetjen e faktorëve pengues të realizimit të dëshirave jetësore.
"Kur në flakë" është një tjetër poezi e cila qëndron e fuqishme në këtë linjë këndvështrimi. Endrra e bukur e atdheut duhet ta prekë në përshkrim edhe vashën e poetit. Paralelizmi i poetit për dashurinë dhe gjendjen e mjeruar ekonomike të Shqipërisë e bëjnë këtë krijim mjaft të bukur. Kjo pranëvënie e bën poetin ta shohë atdheun si prespektivë ëndërrimi. Për Lasgushin nuk ka as Shqipëri të begatë, madje as vashë të përqafuar. Në këtë poezi antiteza shenjtëron shumë bukur misonin e saj. Mesa duket fati i intelektualit në atdheun e tij vijon të jetë thelbësor në udhëkryqin e jetës. Intelektuali i viteve '30 si fat letrar trajtohet jo vetëm nga Poradeci. Në prozë bashkëkohësit e tij si Koliqi, Konica, Kuteli e gjenin veten artistikisht mes gjurmëve autobiografike.
Poezia *"Lamtumirë"* na vizaton përsëri fuqinë mistike që projekton njeriun në përditshëmrinë e tij aktive. *"Lamtumirë"* vjen në katër variante dhe i kushtohet tragjedisë së mërgimit shpirtëror të njeriut. Kjo poezi është fort mirë e krahasueshme me ato krijime të shkruara nga poetë botërorë. Dashuria në fluturimin e saj mërgues të saj do të mbijetojë ose do të vdesë. Kjo poezi ka figuracion të goditur shprehës sikundër metafora *dridhet liqeri pa anë*, figurë që në vargje i adresohet vashës së djalërisë lasgushiane.
Vuajtja në krijimet e Poradecit është momenti tragjik i vetë jetës së tij. Poeti shpesh e më shpesh është i vetmuar dhe atë e shpalos në mënyrë të trishtueshme brenda vargut të tij. Ai, në gjithë strukturën poetike të krijuar, e nënkupton këtë vetmi. Gjithsesi, mund të thuhet se Lasgush Poradeci ishte prijës i përpjekjes intelektuale dhe emotive për një jetë më të mirë. Intensiteti i kësaj përpjekjeje padyshim ka dhenë kontributin e vet në vargjet e tjera që pasojnë labirinthin e mëtejshëm krijues të Llazar Gushos, poet. Si përfundim kësaj analize mund të theksojmë se Lasgushi nuk shkon deri në finalen e filozofisë së tragjedisë së jetës, në pajtim të plotë me të keqen, humbjen, sikurse bëjnë Niçe, Dostojevski apo Hajdegeri. Lasgush Poradeci proteston veçanërisht kundër fatkeqësisë njerëzore dhe kjo vërehet qartë në të gjithë strukturën e këtyre poezive.

VII.9. Copëza shpirti e jete si modele poetike. Poeti piktor dhe piktori poet.

Poezitë e këtij modelimi shprehin dhe imitojnë në mënyrë artistike copëza nga jeta e përditshme, episode, skena dhe situata shpirtërore të asokohshme. Modelimi artistik i këtyrë krijimeve më tepër mbulohet nga nocionet plot përshkrime e prezantime të ndryshme. Rezultat i një rimodelimi të tillë janë titujt e poezive: "*Poradeci"; "Dremit liqeri"; "Zemra e liqerit"; "Mbarim vjeshte"; "Dimër"; "Korrik"; "Gjahtori"* etj.

Disa nga këto vjersha janë pa frikë kërkime antropologjike, sespse përshkruajnë mënyrën e jetës apo prekin psikologjinë individuale duke shfaqur ndjesitë e vetëdijes kombëtare. Me ndihmën e konteksitit letrar, si aspekt i domethënies, zgjerohet dimensioni kuptimor i tyre. Kjo strukturë poetike e ndërtimit të poezive ka një ritëm dhe energji të atillë sa përfshin edhe elemente jashtëtekstorë, sikurse është konteksti i përgjithshëm dhe procesi i përjetimit të pastekstit me mendie. Koha letrare në këto poezi është më e gjatë se sa zgjat vetëm teksti letrar.

Nga poezia *"Poradeci"* pozicionohet gjeografikisht Pogradeci, si qytezë me përmasa katundi, i cili ka përreth një krahinë më të gjerë, ka liqenin e Ohrit, ka Malin e Thatë, ka lëndina, kodra dhe fusha, ka manastirin e Shëndaumit në breg të të cilit buron e rrugëton Drini i Zi.

Dyke nisur udhëtimin mes-per-mes nër Shqipëri/ Drini plak e i përrallshëm po mburon prej Shëndaumi...[513]

Me këto dy vargje Lasgushi krijon fytyrën e atdheut, ashtu si e përfytyronte ai Shqipërinë. Pra, Lasgushi jep mesazhin, që atdheu ynë është këtej dhe andej kufirit. Drini i shkon mes për mes, që do të thotë se ai lumë i famshëm që e shohim si kufi të shtetit shqiptar me vendet fqinjë, në fakt është mesvija e Shqipërisë. Atdheu ynë është i madh. Drini plak na ndan në mes. Lasgush Poradeci mbetet shumë shqiptar dhe bashkimi i trojeve tona ishte një projekt i tij, sikurse i gjithë atdhetarëve të mëdhenj.

Poeti i liqerit përthithet bashkë me vargjet që shkruan nga sivëllezërit shqiptarë në Kosovë. Perëndim i vagëlluar *(çasti i hyrjes së diellit)* personifikim i metaforizuar i perëndisë së verdhë *(diellit që humbet në ujërat e liqenit të Ohrit)* është më së tepërmi imazh vegimtar i liqenit të Poradecit që çdo natë përfshihet nga magjia hyjnore. Imazhi përhumbjes në natën e thellë ngjyhet me të zezën e pluhurit si hije. Metamorfoza e perëndimit është pushteti i errësirës që po bie nga qielli. Nën këtë mbretërim që s'pipëtin, në katund kërcet një portë dhe gjithëçka merret në zotërim nga nata e gjumtë. Edhe në liqen hesht lopata e varkëtarit dhe varkës që çdo ditë puthen egërsisht. Një shqiponjë e arratisur fluturon për në Mal të Thatë. Zemra djaloshare futet thellësi shpirti dhe prangohet nga kjo madhështi prangosëse. Më tej tërë fisi, tërë jeta, dergjet e zë gjumi nga dashuria e një dite të re. Në këtë finale të ritualit gjigand të natyrës, kur zotëroi më katër anët errësira, vazhdon jeta, Drini plak dhe i përrallshëm, vazhdon rrjedhën e tij mespërmes Shqipërisë fill nga burimi i Shën Naumit. Nuk ka si të përshkruhet më bukur një vend plot magji si Pogradeci dhe liqeni i tij.

"Dremti liqeri" është vjersha që i kushtohet natyrës të Pogradecit. Eshtë natyra që e ka frymëzuar poetin, së cilës ai i këndon mes vargjesh. Ai e dashuron dhe e mbron këtë peizazh mbresëlënës. Lasgushi lufton me frymëzim dhe mall të ri vjershëtori për të përjetësuar vendlindjen. Hiperbola *dremit liqeri pa kufi* vijon më krahasimet: *aty ndaj fundesh u përflak posi me zjarr e me flori* apo *posi me flak u ndez dhe kroi*.[514]

---

[513] L. Poradeci, *Poezia. Vepra I*, Tiranë, "alb PAPER", 2009, fq. 31-32 (varinti i parë dhe i dytë i poezisë).

[514] Po aty, fq. 155.

"Zemra e liqerit" është një tjetër krijim që shtysën e saj e merr nga meditimi. Rreziku për jetën, ankthi i vdekjes, e kanë kthyer bregun në zall të shkretë. Metaforat e goditura si: *Zemra e liqerit; dirgjet liqeri-i kaltër; sipër ti buçet prej fundesh, me rrëmbim të zemëruar; valë e urtë; që prej zallit të shkretuar*.[515]
"Mbarrim vjeshte" në qendër të saj ka zogun çoçërr, zogun e rrallë që fluturon shumë shpejt në peizazhin poradecar. Shkathtësia e tij është krejt e paimagjinueshme për Lasgushin poet. Ky lajmës i trokiti m'u në portë poetit të liqerit. Zogu i rrallë është emblema e kudogjendur e vjershës: *nëpër gardh-e nëpër ferra dërdëllet gazmor një çoçërr!*[516]
Poezia *"Dimër"* mbetet e ngjyer në të bardhën e ftohtësisë që krijon magjia e akullt në Pogradec. Gjithëçka fle në katundin e Poradecit. Shpirti i poetit fle letargjisht si tërë fisi e jeta bashkë. Në këtë peizazh qetësie, melankolie e bukurie të bardhësisht të ftohtë, dëgjohet vajtimi i një zogu, që alarmon me zërin e tij për të dëshmuar frikën e vdjekjes, një rrugëtim i gjatë për mbijetesë që kuptohet përmes retiçensës në fund të poezisë. Vjersha është e ngjyer e gjitha me ftohtësi. Në të vërtetë ky peizazh i ngrirë është bota e jashtme përmes së cilës shprehet ftohtësia rrënqethëse e së brendshmes, gjendjes së vetë zogut qiellor të Pogradecit.
Psherëtin me zë të ti / jet' e trembur se mos vdesi[517]
Nga fohtësia marramendëse kalojmë në nxehtësi të thellë te poezia *"Korrik"*. Si në realitet poezia djeg së nxehti. Në korrik ambienti digjet nga nxehtësia e diellit. Korriku vjen në poetikën e Lasgushit, me zogun që rri fatlum në shullër, me shqerrat që çlodhen, shtrihen, dirgjen dhe flenë. Çinçëron gjinkalla, një gjetje onomatopeike, kjo!
Në vjershën *"Korrik"*[518], konkretisht në fund të saj kemi përsëri një retiçensë, që dëshmon se jeta vazhdon edhe në këtë muaj të nxhetë të vitit. Por prezenca e natyrës së bukur shqiptare vijon prezantimin e saj mes për mes veprës poetike.
Ajo rimerr jetë pavdekësie në vjershën *"Gjahtori"*[519]. Ky lloj himni i bukurisë në natyrë huazohet nga proza e rrjedhshme e Kristoforidhit, Gramenos, e vetë Mid'had Frashërit. Këtu shpaloset një përshkrim të qartë, apo më mirë një pikturim i natyrës poradecare. Kjo strukturë vargjesh ka një ritëm intensiv dhe një energji pozitive të tillë, sa tërësia e poezive në këtë bllok, përfshin edhe elementët jashtekstorë, në kontekstin e përgjthshëm të të shijuarit të poezisë si magji natyrore. Vetë poezia është një apostrof që thërret pranë atdheun kur vetë je larg.
Poezia është shkruar në Athinë më 1918. Me ndihmë e kontekstit si aspekt i domethënies, zgjerohet dimensioni kuptimor i kësaj lloj poezie, saktësisht i asaj me objekt natyrën. Secili prej këtyre elementëve jashtekstorë të meditуar është në vetvete edhe një lloj simboli dhe çfarë është me më shumë rëndësi, secila prej poezive paraqet një forcë figurative.
Përmes materies së trajtuar e të prezantuar në tekst shohim përetej vargut në modelin lasgushian. Ky vështrim përtej është vetë poezia, arti i saj, magjia që rikrijon, është vetë realititeti i ngritur në art, natyra e bukur e Pogradecit dhe pogradecarëve. Këto poezi, veçse të natyrës mund të quhen pa frikë edhe piktura në bojëra vaji.
Në këtë cikël shpjegohet më së miri poezia e pikturës dhe piktura e poezisë së poetit piktor. Funksionimi i gjuhës së figurshme letrare është i dukshëm në varg. Fjalë pas fjale dhe detaji pas detaji bëhet zbërthimi i strukturës poetike. Poezitë kanë jehona

[515] Po aty, fq. 156.
[516] L. Poradeci, *Poezia. Vepra I*, Tiranë, "alb PAPER", 2009, fq. 54.
[517] Po aty, fq. 56.
[518] Po aty, fq. 53.
[519] Po aty, fq. 57-59.

zërash, drita, ngjyra, tinguj, aroma, të cilat bashkarishtjanë vetë jeta nën kala e Pogradecit. Natyra përsëritet sipas stinëve të vitit edhe në poezi.
Kemi të bëjmë me një rreth ciklik të vzhdimësisë së jetës që nuk vdes. Paralelizmi pranëvë shpirtin njerëzor me atë të natyrës. Dimër në natyrë, dimër në zemrën time, korrik në natyrë, korrik në zemrën time, do perifrazoheshin gjendjet e zbërthyera në poezinë peizazh të Lasgush Poradecit, nisur nga titujt e tyre. Këto poezi, një pjesë prej së cilave janë përmendur në këtë cikël, sjellin një përshkrim të natyrës si dashuri për të jetuar, gjendjeve dhe situatave që krijohen në gjirin e saj, të cilat jepen nga prespektiva e gjithëdijëshme e poetit piktor dhe piktorit poet.

Përfundime mbi poetikën lasgushiane:
Llazar Gusho, alias Lasgush Poradeci, që me krijimet e para goditi në shenjë. Ai zgjoi interes të posaçëm ndër shtresa të ndryshme lexuesish. Vepra e tij letrare u bë objekt receptimi aktiv pas botimit sporadik të poezive të tij të para në shtypin e kohës gjatë viteve ’30. Botimi i vjershave ishte një faktor që ndikoi dukshëm në kërshërinë e lexuesve. Duhet të themi se atij i paspriu jehona e vlerës artistike të poezive dhe përjetimi i thellë estetik që krijohej prej tyre, në horizontin pritës.
Në këtë skemë padurimi kishin dhënë kontibutin e tyre edhe shumë autorë të tjerë të viteve ’30, por duhet thënë se vepra poetike e Lasgushit me strukturën e saj letrare befasoi shijet e lexuesve, duke ju shkaktuar atyre një prangim të fortë artistik. Këto risi të pranuara qenë sa në aspektin tematik aq edhe në atë struktural poetik. Idetë, temat, motivet, mesazhet ishin në përgjithësi si ato të autorëve të tjerë bashkëkohës të Lasgushit, mirëpo trajtimi i tyre, veçmas ai i dashurisë, kishte fatin e tërheqjes artistike.
Brezi të cilit i përkiste Llazar Gusho ishte i shoqëruar nga dy faktorë themelorë, shkollimi jashtë vendit dhe rikthimi i tyre në atdhe për t’u bërë pjesë e rrethanave politoko-shoqërore. Autorët e këtij brezi i shprehën pikëpamjet mes krijimeve poetike, por edhe manifestimeve të ndryshme letrare. Këto krijime u bënë më pas, zëdhënëse estetike të idealeve dhe synimeve të kohës.
Me cilësinë e krijuesit të ndjeshëm dhe modern njëherazi, Lasgushi kishte kuptuar herët, se poetika dhe arti në përgjithsësi duhet të mbështeteshin fort, në aspektin social. Vepra letrare e Lasgushit mbeti e pavaruar si një strukturë e hapur artistike që mposhti tallazet që i vinin nga drejtime të ndryshme intelektuale dhe politike të kohëve. Kjo sulmnajë, bëri që poezia mos prekej a bëhej plagëshumë. Përkundër më gurët që i hodhën sipër, vepra poetike e Poradecit ndërtoi themele më të forta qëndrese në vitrinën e viteve. Në këtë kuadër vetë kjo esteikë e pasqyruar poetikisht e artistikisht si edhe gjerësia e saj ndikuan në përvetësimin e receptimin e madh në vite, nga ana e publikut lexues. Vlerat e mirëfillta artistike, në artin poetik lasgushian i kuptoi në vitet e para të saj edhe kritika letrare. Në fillim ajo dha gjykime të përgjithësuara, deklarative dhe sentimentale që i karakterizonte toni romantik.
Çabej thotë: “*Ç’e ndryshon nga të parët është thellësia… Është vjershëtori më i thellë që ka shkruar në shqipet; në qoftë se kjo nuk është vënë re gjer tani, shkaku është se më të shumtët nuk e kuptojnë poezinë e tij, e cila me fjalë e mënyra foljesh fare të thjeshta, e shumë herë popullore, arrin të koncentrohet aq sa mundet të nxjerrë në dritë mendimet më të thella, ndjenjat më labirintike, idetë më të larta. Dhe po të këndohet Lasgushi me dashurinë, do të vërtetohet thellësia e tij e pashoqe, në mos sot, nga brezat që do të vijnë”*.[520]

[520] E. Çabej, *Mbi poezinë e Lasgush Poradecit*. “Gazeta e Re”, -Nr. 94, Tiranë, 22 shkurt, 1929, fq. 3.

Pati edhe ndonjë kritik sulmues dhe aspak dashamirës si Krist Maloki. "*Nër nja 90 vjersha që ka botue deri më sot Lasgush Poradeci gjinden vetem nand a dhjet me një përmbajtje të përgjithëshme kombëtare shqiptare shif*: *"Vallja e Yjve", Nr. 6,7,8,9; "Ylli i Zemrës", Nr. 9,10,11,12!), porse mu ato jan nga ma të dobëtat e vjershnimeve të tija (d.m.th. s'jan kurrsesi kristalizime!), dhe edhe në qoftë se flasin aty e këtu për ndonjë ngjarje a personë shqiptare, nuk përmbajn në vetvehte asnjë frymë poetike t'atillë që mund t'u thonte se*: *kështu e vetëm kështu mund të flasi shpirti shqiptar! Në këtë pikëpamje asht ma karakteristike nga të gjithat njajo vjershë e vogël – një vjershë mjatt e çuditshme dhe problematike - që iu kushtue me rasen e 60-vjetorit*: *ASDRENIT"*.[521]

Megjithatë, Dhimitër Pasko (Kuteli) arriti përmes përpjekjesh të bëjë një analizë të qartë të veprës letrare të Lasgushit, madje zbërtheu elementë të strukturës poetike të vjershërimit në krijime të ndryshme. Sa për ilustrim të këtij orientimi kritik po përcjellim në pasazh nga studimi i Mitrush Kutelit rreth vlerës së veprës së Poradecit poet: *"Në këtë kaptinë të fjalorit është e udhës të shtojmë disa fjalë përmbi përfytyrimet, përmbi metaforat ose përmbi stolitë stilistike të Lasgushit. Një shënim të parë që lypet të bëjmë me këtë çështje është konstatimi se Lasgushi është këtu si edhe në shumë fusha të tjera të veprimit, i cili nxjerr të gjitha metaforat e simbolet vetëm e vetëm prej gjuhës shqipe, prej realiteteve e mundësive shqipëtare, prej etikës shqiptare. As mitologjia greke dhe as mitologjia romake, të cilat zotërojnë kaq breza artistësh të të gjitha cepeve të botës, nuk e shtyjnë Lasgushin të përdorë ndonjë motiv ose simbol të huaj në vjershëri. Lasgushi është i vetëmi poet shqiptar, që mendon, flet e shkruan vetëm shqip. Ay përpiqet të vlerësojë e të zhvillojë potencialin shqiptar në art e në gjithë fletët e jetës"*.[522]

Mirëpo, në përgjithësi, shkrimet kritike të paraqitura para çlirimit të vendit rreth veprës poetike të Lasgushit, mbetën në planin impresionist dhe përshkrues. Në përgjithësi Kritika letrare nuk dha një vlerësim të saktë ose të krijonte një sistem gjykimesh objektive për të.

Një afirmim disi gjysmak vepra e Lasgushit e arriti pas luftës nacionalçlirimtare, si në publikun e thjeshtë lexues të saj ashtu edhe në qarqet e kririkës letare. Ky afirmim së pari, qëndronte në tematikën e krijimve dhe vetë ideve që trajtonte poezia.

Kritika u përqëndrua në strukturën ideo-tematike të poezive, duke shfaqur preferencën e saj me pikatore përballë poetit. Kjo kritikë dha rezultate sporadike, por të mira, sepse duke analizuar strukturën ideo-tematike, ajo preku edhe elementët artistikë të saj. Duhet theksuar se një pjesë e madhe artikujve kritikë me rastin e receptimit të veprës së Lasgush Poradecit ndiqte një lloj ecurie tradicionale. Këto aspekte ajo i vlerësonte dhe analizonte veç e veç dhe nuk i vështronte në dinamikën e tyre strukturale të plotë.

Vetëm më vonë me shfaqjen e metodës integrale dhe orientimeve te specializura të kritikës sonë, që përfaqësohej nga kritikë të afirmuar për kohën, vepra e Lasgushit nisi të studiohet me kritere të vërteta shkencore, duke zbuluar elementë të veçantë të saj, duke shprehur tërësinë strukturorë të ekzistencës historiko-shoqërore.

Në Kosovë, Sabri Hamiti përmes fusinotës solli një vlerësim të specializuar të veprës lasgushiane. Ai bën përpjekjë gjigande për të depërtuar në shtresat strukturore të ndërtimit të saj: *"Përderisa Bodëleri hyn në librin e vet "Lulët e ligësisë"me një vjershë kushtuar lexuesit, Lasgushi hyn në vallet e veta poetike me një vjershë kushtuar krijuesit. Kjo na e thotë edhe njëherë në fillim natyrën krijuese dhe*

[521] K. Maloki, *Kritikë letrare: A asht poet Lasgush Poradeci?*, në: "Shqipnija", -Nr. 4, 27mars, 1944, fq. 4.

[522] M. Kuteli, *Vepra letare 5*. Shtëpia botuese Naim Frashëri, Tiranë, 1990, fq. 207-208.

programin poetik të Lasgushit, i cili edhe kur në fiksionin e vet poetik kërkon një dialog me lexuesin, edhe kur don të krijojë një vijë komunikimi me tjetrin, gjithëherë niset nga krijuesi, nga vetja. Sepse do të jetë vetëm poet, kudo e gjithëherë. Poezia e tij është para së gjithash një shqiptim i thellë i krijuesit të saj. Pikërisht ky tip i shkrimit letrar dhe ky tip i krijuesit kushtëzon edhe një mënyrë specifike të interpretimit, të cilën do ta ndjekim më vonë".[523]

Tri parimet kryesore të Lasgushit të madh qenë: kërkimi i vazhdueshëm, liria e shprehjes dhe bukurtingëllimi i poezisë. Në raport me elementët e përgjithshëm të strukturës së veprës letrare vlerësimi kritik bëhet i ndryshëm. Ndonjëherë këtyre qendrimeve u parapriu tendenca utilitare socrealiste me pikëpamje ideologjike, kështu që, vetvvetiu u bënë shtrembërime në vlerësimin e saj.

Rrjedhimisht, Lasgushi u qortua, u mbrojt që nuk shkruan apo që ka vdekur qyshkur, në harresë të viteve totalitare. Ai është pesimist, fluid, i pakapshëm, madje dhe i rëndomtë, u tha në ndonjë rast. Të gjitha këto u panë jashtë strukturimit artistik dhe veçorive estetike të veprës së Lasgush Poradecit. Nëse do të ishte marrë parasysh kualiteti në prizmin e strukturimit artistik, atëherë çështjet e trajtuara do të merrnin një karakter tjetër. Pesimizmi për shembull do të trajtohej si i tillë plot qortime dhe do të përveçohej si poetikë me vlera estetike të dobëta, duke përfshirë edhe motivet, shkaqet dhe filozofinë e pasqyruar në krijimtari.

Vepra e Lasgush Poradecit në poezi, por edhe shënimet e ndryshme apo ditarët, japin mundësi të një shqyrtimi edhe më të gjithanshëm se kaq. Struktura e krijimeve të tij poetike mbetet e vlefshme për një analizë më të thellë në rrafshin fonologjik, morfologjik, sinatksor apo semantik.

Tematikën e tij, veçanërisht motivin e dashurisë ai e trajtoi me një poetikë të re. Konkretisht, ajo në poezi qëndron më së shumti në thyerjen e konvencionit letrar tradicional dhe në inaugurimin e elementëve të rinj, në aspekt të metrikës, fjalëformimit dhe veçanërisht figuracionit. Raporti krijues, gjuhësor i përdorur në poezi është ligjërimi qytetas, duke ndryshuar fund e krye nga një pjesë autorësh të tjerë të kohës lasgushiane. Figuracioni poetik çdo herë tenton të arrijë në strukturën e poezive, jo vetëm figura të qëndrushme, të trashëguara nga ngjashmëri letrare, por edhe kuptimin kontekstual. Lasgush Poradeci thelloi me poezinë e tij distancën e arsyeshme estetike ndaj traditës. Kur është fjala për motivet, për tematikën dhe në përgjithësi për lëndën letrare autori mbështet deri diku në traditën e kohës, pastaj në letërsinë bashkëkohore e veçmas në orientimin e autorëve të viteve '30.

Lasgushi është i prekshëm ndaj elementëve kombëtare, qoftë në aspektin tematik, qoftë në aspketin artistik. Ky është një faktor që veprën e tij e bën më të begatshme në aspektin e elementit semantik.

Brenda motivit të dashurisë, Lasgushi realizon shoqërime përmes figuracionit të pasur, trajtimit filozofik, meditimit. Ai zgjeron tematikën që nuk mbetet brenda stitlit bardh' e zi të viteve '30. Këtë stil Lasgush Poradeci e realizon me prezencën e sintezës së rrymave të ndryshme të kohës si simbolizmi, ekspresionizmi apo impresionizmi.

Simbolistë, si Sharl Bodler, Artur Rembo, Pol Verlen dhe Stefan Malarme, ishin të suksesshëm. Poezia e tyre kërkonte që poeti të mos mbetej në sipërfaqen e dukshme të gjërave, por të depërtonte në thellësi të tyre, te domethëniet e fshehta. Poeti simbolist e fton lexuesin që të bëhet bashkëudhëtar i aventurës drejt atdheut të fjalës poetike. Simbolizmi kishte mbrritur kështu dy dekada më vonë në Shqipëri, për t'u shfaqur në

[523] S. Hamiti, *Vdekja e Nositit. Shqiptimi i poezisë. Hyrje për interpretim*, në librin L. Poradeci, *Vdekja e Nositit*. Shtëpia botuese Rilindja, Prishtinë, 1978, fq. 9.

trajta mirëfilli në veprën poetike të Lasgush Poradecit, por edhe në disa krijime te mëvonshme të Asdrenit.
Në këtë kuadër, romantizmi lasgushian është romantizëm i hapur dhe idilik. Në qendër të poezisë lasgushiane qëndron prania e motivit patriotik, e temës filozofike, lirika intime e dashuroro-erotike, krijimi që trajton agoninë shpirtërore, gjendjn e përditshme jetësore e poezinë mistike. Këtyre konstatimeve ju shtojmë edhe faktin se Lasgushi shkroi ditarin e shënimeve të jetës së tij, ose të një pjese të saj, krijim, sikundër cilësohet nga kritika si proza poetike e poetit. Mund të themi se Lasgushi e lëvroi atë me sukses duke përfshirë deri diku një analizë psikologjike të nënkuptuar, apo meditim përmes prezencës së monologut. Ndërkaq, mund të thuhet se ky autor në jetën e tij të gjatë u përpoq ta modelonte dhe ta kompletonte artistikisht energjinë krijuese që zotëronte.
Nëse bazohemi në llojshëmrinë e tematikës, të motiveve dhe formave si dhe në sintezën strukturale artistike të veprës së tij letrare, pohojmë se Lasgush Poradeci, përmes saj, ka mundur ta afirmojë një masë të madhe potencialit të tij krijues.
Duhet thënë se pas viteve, ’90, kritika letrare dha një mendim më të specializuar për veprën e Poradecit, duke thënë pa frikë mendimin e saj, atë që ndoshta nuk e kishtë bërë mendimi i specializuar socrealist. Ky mendim vijon të rritet potencialisht edhe sot e kësaj dite. Mjafton t’i hedhësh një sy bibliografisë dhe zërave të saj në rritje me shënime, artikuj apo studime letarare e gjuhësore për veprën letrare të madhështorit Lasgush Poradeci.
Si përfundim, theksojmë se tekstet letrare janë receptuar në periudha të ndryshme kohore katër herë nga lexuesi. Leximi i parë i përket periudhës 1928-1939, kohë kur autori shkruan, boton dhe përcillet nga lexuesi në mënyrë legale. Ky ishte një lexim normal, me një nivel po normal receptimi dhe interpretimi. Leximi i dytë, vendoset në periudhën 1940-1944, kohë kur autori sërish preferohej ndër shqiptarë, me vargjet e tij. Procesi honorizues u zbeh disi për shkak të luftës, por gjithsesi ai ekzistoi. Leximi i tretë i përket Shqipërisë së udhëhequr zyrtarisht nga komunistët. Në atë periudhë autori dhe vepra e tij do të ribotoheshin. Më tepër se një lexim rigoroz, ishte një oshëtimë leximi. Lexuesi dhe kritikët e privilegjuan Lasgushin, duke i dhënë jehonë më të madhe veprës së lexuar, por të lënë në hije nga sistemi totalitar. Leximi i katërt nisi pas viteve ’90 e vijon ende. Ky është leximi dhe interpretimi më i sigurtë se tre të parët. Skema e komunikimit estetik është e plotë dhe shumë e pranueshme.
Sërish funksionojnë vepra e autorit, kritika dhe lexuesi. Tre leximet e para argumentojnë majftueshëm se figuracioni, stili, ndjeshmëria ideore, emocionale dhe vizioni letrar i Lasgush Poradecit nuk janë vjetëruar dhe nuk rrezikojnë të vjetërohen. Studiuesit dhe lexuesit e sotëm, të çliruar nga socrealizmi i vjetëruar, rikonfirmojnë modernitetin lirik të shtërgut të fundit.
Aurel Plasari këtë e vë në dukje edhe kur thotë thotë: *“Dhe është fakt i vërtetë që një pjesë e madhe e skemave dhe motiveve që ka trajtuar poeti ynë janë universale, pra, sa të të tjerëve, aq edhe të Lasgushit. I nënshtrohen ato atij ligji që quhet “Ligji i qarkullimit”, i cili nuk pyet për “kufij gjuhësorë ose kombëtarë”. Në poezi ky ligj është veçanërisht i fuqishëm.”*[524]

[524] A. Plasari, *Pric përballë princërve*, në: *Don Kishoti zbret në Shqipëri*, Shtëpia botuese Naim Frashëri, Tiranë, 1990, fq. 259.

VIII. KAPITULLI I SHTATË

FAQE DITARËSH DHE SHKRIME TË TJERA

VIII.1. Karakteristika të zhanrit ditar te Lasgush Poradeci. Ditari për dashurinë. Proza poetike e Lasgushit dhe struktura narrative e saj

Për kohën kur u shkrua ditari, ose siç emërtohet nga kritika letrare, proza poetike e Lasgushit dikur nuk zgjonte interes, as në planin makrostruktural as në atë mikrostruktural të analizës. Ajo zgjoi interes në mijëvjeçarin e ri, pas viteve 1990. Aspektet makro dhe mikrostrukturale imponoheshin nga formacionet e ndryshme të lexuesve, që mplekseshin me këto lloj krijimesh, që gjenin vetveten përmes elementëve ekzistencialistë që pasqyronte kjo lloj mënyre të shprehuri.

Sado që autorët e viteve ’30 kishin orientime të caktuara dhe qëndrime ideore unike në krijimtarinë e tyre artistike, vërehen dallime të ndryshme lidhur me funksionimin e formacionit stilistik dhe specifikës së zhanrit që ata përzgjidhnin për krijim. Lasgushi përsa i përket trajtimit artistik është mbështetur në tipe letrare të kohës, modele që ai e aplikonte tashmë edhe në poezinë e tij. Në këtë linjë kjo poetikë vjen e tillë edhe në prozën e tij, në formë ditari. Lasgushi i përshtatet pikëpamjes së Rene Wellek dhe Ostin Woren se: *“Në këtë aspekt, shkrimtar i mirë është ai që pjesërisht i përshtatet zhanërit të tij ashtu siç është, por edhe e zgjeron, e plotëson atë”*.[525]

Kollrixhi kishte të drejtë kur deklaronte se, jeta e cilitdo qoftë ai, edhe kur nuk bie shumë në sy, po të rrëfehet me vërtetësi meriton vëmendje. Lexuesi pasi i ka përpirë këto shkrimësi ditari e ka më të lehtë të perceptojë poezinë dashuroro-erotike lasgushiane, e ka më të lehtë të përfytyrojë aromën që përhap vargu i tij. Pas kësaj përvoje informacioni, lexuesi i fundshekullit të XX dhe i mijëvjeçarit të ri do ta kishte më të lehtë të përfytyronte portretin e të dashurës së Lasgushit, apo shoqezës së tij. Këto përqasje mbeten modelime plot fantazi që do i rrinin plotësisht për shtat prerjes femërore në poezinë e tij dashuroro-erotike.

Kështu, një lexues i tillë do të përfytyronte imazhe femërorë, ndryshe nga një lexues që e shijon veprën poetike pa e lexuar këtë lloj ditari. Ai që rilexon veprën poetike mbi një emocion që të fal fleta e një ditari personal është më i mirëinformuar dhe gjen më drejt vetveten, në shijen që ta fal poezia, herë-herë bashkë me variantet e saj.

Përsa i përket publikut lexues, ditarët dhe proza poetike e Lasgushit mund të renditen dhe grupohen njësh me ato të një serie të autorëve të kohës së tij, të cilat ndryshojnë e përdallohen nga organizimi i brendshëm, strukturimi artistik, toni emocional i tyre, por edhe nga elementë të fjalorit, gjuhës, temës dhe kompozicionit.

Në vitet ’30 prozat satiriko-humoristike apo ditarët personalë të Nonda Bulkës dhe të Migjenit ishin plot ndikim ironiko-tragjik, ndryshe nga ato me ngjyrim erotiko-dashuror që prezantonte Lasgushi. Madje, lexuesi ndonjëherë ndërthurur e bën njësh paralelizmin mes poezisë edhe formës së përfytyryar që ta dhuron si mirazh ditari personal. Në ato vite, shkrimet e Nonda Bulkës janë reportazhe publicistike dhe gazetareske. Shkrimet e Millosh Gjergj Nikollës (Migjenit) trajtojnë probleme kritike të kohës, shkrirë mes elementëve artistikë të pasqyruara nëpër faqe botimesh. Autorët letrarë të viteve ’30, ndryshe nga Lasgushi, bënë në shkrimësinë e tyre kritikën e realitetit të dhimbshëm shoqëror. Ky brez krijuesish trajtoi kryesisht prozën e shkurtër si përshembull tregimin, skicën, esenë, fejtonin, pamfletin etj.

---

[525] R. Wellek dhe O. Woren, *Teoria e Letërsisë*, Shtëpia botuese “Enciklopedike”, Tiranë, 1993, fq, 271.

Lasgush Poradeci nuk i lëvroi të gjitha këto, por pjesërisht u mor me ndonjë shkrim publicistik dhe vijoi të shkruante rregullisht në fletore ditarin e tij. Lasgushi në gjithë këtë mori shkrimesh në vitet '30, përshfaqi specifikën e tij letrare. Tek ai ishte ngjizur një kulturë e epërme nga vitet e shkollimit jashtë Shqipërisë dhe literatura botërore, pasi lexonte në gjuhë të huaja. Manastiri, Selaniku, Bukureshti, Austria dhe Graci i saj do të linin gjurmë të pashlyeshme në formimin e djaloshit poradecar, i cili më tej bëhet pjesë e vlerës intelektuale kombëtare.

Lasgushit do t'i binte në dorë për të lexuar, letërsi gjithfarësh, por më i preferuari do të ishte Eminesku e më tej plot të tjerë, si: Gëtja, Pushkini, Hajnia, Lermontovi, Miçkeviçi, Hygoi, Brehti dhe Bërnsi pa haruarr edhe folklorin e pasur rumun. Pothuajse, pjesa më e madhe e tyre kishin mbajtur në jetë ditarë mjaft të rëndësishëm jo vetëm për dashurinë. Sado që analogjia në mbajtjen e shënimeve mund të jetë e njëjtë, motivi dashuror mbetet i përveçuar si në ditarët edhe korrespondencat e Lasgushit. Kjo analogji kthehet në një lloj mode për poetin pogradecar. Trajtimi i formës ditar shpesh mbështet në kushte dhe gjendje analogjie personalitetesh jo vetëm letrare.

Në radhë të parë, është tërheqës realiteti i asaj kohe, për autorin pogradecar, shprehitë poetike që e karakterizojnë, intonacioni veçantë, simbolika dhe struktura klasike e këtij lloj shkrimi, trajtimi lëndës rrethuese, për të vijuar me përqasjen karahsuese, të kohëve apo ndjenjës së dashurisë në diakroni. Të bie në sy fjalëformimi me rrënjë treshe, fjalët e reja që Lasgushi krijon, nga syresh të tjerë të shqipes.

Të gjitha këto Poradeci i ka strukturuar mes ditarësh, të cilët nga familjarët e poetit, pjesërisht po shohin dritën e botimit. Mes radhëve të shkruara në ditar shpesh ndeshim edhe komente të herëpashershme të Lasgushit. Ato dëshmojnë se ditarët e poetit, apo një pjesë e tyre siç janë pagëzuar nga kritika, proza poetike, mbeten të rëndësishme në llojin e tyre, për të hedhur dritë edhe mbi shumë anë të panjohura, të cilat shoqërojnë misterin e poetit.

Libri *"Shkolla shqipe e Poradecit"*,[526] sjell jehonën e shkollës së parë shqipe të Pogradecit **, që u çel vetëm një javë më vonë pas shkollës së parë shqipe të Korçës, pra më 14 mars, 1887. Libri fakton edhe ngjarje dhe data historike të asaj kohe në Pogradec dhe rrethinat e tij, si pjesë e kujtimeve të djalërisë së poetit mbi lëvizjet e çështjes kombëtare.

Shënimet janë mbajtur me shumë pasion dhe ndjesi krenarie nga Lasgush Poradeci. Kjo shije përjetohet në tekste nga gjithëkush kur i lexon. Ky lloj ditari dhe shënimet për ngjarje të mëdha historike të vendit, shkruar nga Lasgush Poradeci lexohen me një frymë nga lexuesit. Bazuar në veçoritë e mënyrës së trajtimit të tyre, veçanërisht në tematikë dhe shkrimin dokumentaro-artistik të përdorur, këta ditarë apo shënime të ndryshme i mund t'i grupojmë në:

-Ditarë personalë që trajtojnë përditshmërinë e poetit, problematikën e saj.

-Ditarë personalë dhe korrespondencat intime që trajtojnë ndjenjën dashurore të poetit, fragmente nga jeta, ambienti dhe hapësira kulturore e kohës.

-Shënime personale që trajtojnë ngjarje realiste historike të cilat prekin jetën e kombit shqiptar.

Origjinaliteti i ditarëve apo i epistolarit të poetit me bashkëshorten e tij divine Naifie Mema-Gusho evidentohen lehtësisht nga kopjet origjinale që gjenden në shtëpinë e poetit në Tiranë. Aty paraqiten ditarë dhe copëza letërkëmbimi të vetë Lasgushit me shkrimin e tij origjinal, për të dëshmuar se ato janë origjinale dhe të paprekura nga

[526] L. Poradeci, *Shkolla shqipe e Poradecit*. Tiranë, "albPAPER", 2002, f. 12.

** Përgatitur nga vajza e poetit, Marie Gusho

botues të ndryshëm. Të drejtën e botimit të ditarëve të Llazar Gushos e kanë vetëm familjarët e poetit.

VIII.2. Ditari personal i përditshmërisë së poetit, problematika e tij.

Lloji shkurtër i ditarit të Lasgushit, që trajton dukuritë e përditshme shqiptare, probleme dhe çështje të ndryshme të realitetit të kohës, përmes ideve të hedhura, shqetësimeve, përgjithësimeve dhe mendimeve filozofike të përshfaqura, kritika letrare i ka lënë përsëri me emërtimin e tyre klasik, ditarë.

Parë në tërësi ky nocion është i përshtashëm dhe motivon strukturën e shkrimit të tyre. Ato janë shënime intelektuali, të cilat shfaqen më së shumti edhe me elementë simbolikë, ironikë apo ndonjëherë alegorikë. Në to të bie në sy komenti që autori shpreh si qëndrim personal apo shprehësia e tij inetelektuale në përgjithësi për këto probleme. Mjetet artistike përveçojnë më së miri praninë e simbolit. Teksti i tyre gjithësesi na lidh me vetë kontekstin e kohës, me probleme të përditshmërisë, ndaj për këtë arsye këto shënime janë më të gjera se sa shfaqen në nisje të tyre. Çështje të përditshmrisë gjenden në lëtërkëmbime të njëpasnjëshme me miq si Asdreni dhe Kuteli, qoftë kur është në shtrat i sëmurë apo kur ka ngelur pa asnjë lek nëpër botë.

Ndërkohë ka edhe shkrime të një problematike të tillë, e cila ndërtohet me pikënisje nga copëza ditarësh. Përmendim ato me titull: *"Përzënia e profesor Jokl-it nga Shqipëria"*; *"Ekspozita Androniqi Zengo"* apo *"Shënime rreth literaturës shqipe"*.[527] Këto gjerësi, vetërrezatimi problematik, vijnë si rezultat i nëntekstit të pasur.

Lasgushi shfaq gjykime për jetën në tërësinë e përgjithësinë e saj. Për njeriun, për gjithsinë, botën, universin dhe kohën që do vijë. Të gjitha këto, Lasgushi na i koncepton përmes ndjesisë intelektuale, meditimeve filozofiko-figurave apo ngjarjeve të jetës së përditshme. Është plotësisht e arsyeshme që problemet e shkruara në ditar, ia kanë imponuar Lasgushit, mënyrën e gjykimit dhe lirshmërinë e thjeshtë të shprehjes.

Mund të thuhet qartë se këto ditarë kanë estetikë utilitare. Kjo mënyrë trajtimi është rezultat i pikëpamjeve të tij, i qëndrimit ndaj kushteve ekzistuese, parimeve sipas së cilave ekziston bota jonë njerëzore. Lasgushi, në këto shënime nuk vë askënd në dyshim apo dilema.

Këto mendime dhe pikëpamje, tregojnë natyrën e tij prej poeti, i cili nuk parapëlqen lumturinë finale dhe kënaqësinë e njëtrajtshme që ajo të fal. Kurioziteti i tij theksin e vë tek liria e vërtetë njerëzore, që ta imponon filozofia e dyshimit dhe lumturia e vërtetë në jetë. Lasgushi ndër to vë në qendër njeriun, përpjekjet dhe sakrificat e shumta për mbijetesë. Natyrisht ky është vetë bota jonë, në të cilën njeriu qan, qeshet, lumturohet dhe vdes.

Një rëndësi të veçantë në formimin artistik të këtyre ditarëve ka rrëfimi. Në pjesën më të madhe të tyre shkrimi zhvillohet nga prespektiva e së gjithëdijshmes si parandjenjë. Ndonjëherë Lasgushi fut mes tyre edhe vetëdijen individuale, si përjetim i miqësisë në kohë. Pra, ai bëhet i prekshëm herë me përjetime dhe herë me fakte që i sjell në ditarin e tij përtej të zakonshmes. Ndonjëherë shënimet e poetit marrin formën e monologut të brendshëm.

[527] L. Poradeci, *Publicistikë, krtikë letrare, antologji shqipe e kësikohëshme*, Vepra 2, Shtëpia botuese "albPaper", Tiranë, 2009, fq. 13; 28; 326.

VIII.3. Ditari personal dhe korrespondenca intime e poetit, fragmente nga jeta, mjedisi dhe hapësira kulturore e kohës

Ditari personal i dashurisë rallë herë bëhet publik në gjallje të jetës së autorit. Më së shumti dritën e botimit ai e shikon pas vdekjes së tij. Ditari për Ana Jovanin e dëshmon më së miri këtë fakt në *"Vizitat e zonjush Anës në kullën time"*. Është një dashuri e poetit, diku në moshën 70-vjeçare, e përjetuar në pleqëri të thellë.

Poradec, e hënë 26 qershor 1978.

"Në orën 3.30 dyke ngrënë drekën me gurnecka të thekura erdhi Ana në dhomën poshtë ku hanja, i fshiva shpejt buzët me dorë se i kisha me vaj dhe e ngrita shpejt lloskën me që e mbaj me lloskë..., hyri e qeshur e lëvizur si një gjarpërushkë Ana, sapo hyri i-a putha shumë faqet, i-a putha edhe gojën me rëmbim në atë sekondë, po më ardhi pastaj si turp, turp për veten time, që e putha në gojë me buzët e mija gjysmë të vajosura..."[528]

Poradec, e hënë 17 korrik 1978

Dhe më tej:

"[...] pa hyrë ajo në autobuz shtërnguam duart, ajo më puthi (përpara aq shumë njerëzve) në të dy faqet mbi qoshet e buzëve të mia, unë s'e putha se kisha turp (të mos e kompromentoj përpara aq shumë njerëzve, se njerëzit janë shumë të liq".[529]

Androniqi Xengo mbetet piktorja që trazoi asokohshëm zemrën e poetit liqerëror. Më 17 prill të vitit 1972, ditën e hënë, në Tiranë, Lasgush Poradeci kujton në ditarin e tij, se festohej 100 vjetori i lindjes së Asdrenit, në sallën e Lidhjes se Shkrimtarëve.

"Në sallë ish dhe Niqi[...] Nuk ishte prishur, e ndryshuar, ballin dhe pjesën e pshtme të faqes së mëngjër që shikonja unë dhe hundën dhe vetullën s'i kish fare të prishura, i kish të freskëta si më parë, po vetëm pjesa e faqes së poshtme, midis faqes dhe gushës kur e puthnja unë me aq ëndje m'u duk se i qe prishur dhe më ardhi keq për këtë prishje. Edhe vetullën e kish të bukur si më parë, të pa prishur, të pandryshuar, ashtu siç e ka ajo vetullën të bukur siç është ajo vetullushe, me vetullën krejt horizontale pranë syrit, që u jep aq bukuri dhe hije të bukur syve. Niqi ish një sërë më pranë se unë, në fronat më të djathtën t'ime".[530]

Ndërkaq, po kaq interesante mbetet korrespondenca intime që Lasgushi mban me bashkëshorten e tij divine, Nafije Mema. Ajo e thërret -*"Lasgushi i em", "Shpirti i em",* ndërsa ai *"Nafija ime e dashur*" e më vonë edhe me emrin e përkëdhelisë *"Shqipe".* Letrat mbyllen me dedikime të tipit: ai -*Të puth me mall Lasgushi yt; Të pushton ëmbël nër kraha Lasgushi yt; T'i puth faqkat e kuqura Lasgushi yt; T'i puth flokët e gjata prej floriri;* ajo -*Shumë të puthura o shpirti i em, Nafia jote; Shumë të puthura kilometrike të çon jotja Nafije; Ëmbël të shtërngon ndër kraha Nafija jote...*

Letrat e tyre përshkruajnë takimin e parë, puthjen, prekjet e "turpshme" në dashuri, 1000 përkëdheljet mes tyre. Të gjithë ia kemi lexuar Lasgushit në vargje mendimet për dashurinë. Ndërkaq, rrjedhimisht shtohen pyetjet: Sa i dashuruar ishte Lasgush Poradeci? Si ia tregonte ai dashurinë vajzës durrsake me të cilën lidhi jetën, Nafije Memës? Si ndihej ai në këtë dashuri mistike dhe reale njëherazi?

Poeti Lasgush dhe Nafija, nxënëse në Institutin "Nana Mbretëreshë", shkëmbenin letra plot pasion në vitin 1939. Ato publikohen në ditarët dhe korrespondencën intime për t'i ndarë me lexuesit e poetit.**

---

[528] L. Poradeci, Vizitat e zonjushë Anës në kullën time, Revista shkencore filologjike "Glossa", nr. 1, Tetovë, Maqedoni, Tetor 1999, f. 88.

[529] Po aty, fq. f. 94.

[530] L. Poradeci, *Vepra V. Korrespondencë Lasgush Poradeci-Asdren,* Shtëpia botuese "albPaper", Tiranë 2012, fq. 59.

** Publikuar nga vajzat e poetit, Kostandina dhe Marie Gusho.

Me këtë lloj krijimtarie ndodh ajo që Umberto Eco thekson se budallallëku i të tjerëve na indinjon, por mënyra e vetme për të mos reaguar me të nëjtën mënyrë është ta përshkruajmë duke shijuar finesën e rrallë të fabulës, të së përditshmes.
Nga ky letërkëmbim lexojmë poetin e ëmbël të dashurisë që e kishin ëndërruar dhe dashuruar në largësi, pse jo edhe nga afër, shumë nga vajzat e institutit "Nëna Mbretëreshë". Dikush kish pasur një korrespondencë shpresëdhënëse, e dikush tjetër kish guxuar të shkonte në dhomën e tij duke dalë fshehurazi nga konvikti. Siç lexojmë dhe kuptohet më pas, fati përkëdhel vetëm Nafije Memën, vajzën e hijshme nga Durrësi detkaltër, me lëkurën e bardhë, me flokët e mrekullueshme të verdhë dhe me onde. Ja një nga letrat që ata i drejtonin njëri-tjetrit në vitet e para të njohjes, konkretisht më 13 Qershor 1939.
"Zonjushës Nafije Mema,
Durrës
E dashur Nafije,
Sot kur po t'i shkruaj për të parën herë këto radhë, ndjej se jam i pafuqishmë të të them atë që kam në zemër. Një dobësi më zotëron. Sa i dobët paskam qënë për të çfaqur ato që dua. Ku është them tashi mjeshtëria e pendës. Ajo sot ka zbritur fellë në shpirt, më ka lënë prej gazit pa fjalë, dhe prandaj dyke t'i shkruar këto rradhë dua vetëm që dhe ti të ndjesh atë lumturi të heshtur, të mbushur me dritë, që ka zënë vendin e fjalëve në fund të zemrës s'ime. E sjell ndërmënd pjekjen t'onë të parë të 25-vjetorit, që ashtu e kish vendosur Zoti, ëndërrimet e mija pas vashës shqiptare të vërtetë, përpjekjet e durimshume pas saj-dhe ja, Nafije, Nafija ime, tashi them se Zoti që është Dashuri nuk shpjetohet kurrë të na ç'përblejë më në fund. Jam i lumtur që të poqa dhe të njoha më të vogël atëhere, që të kërkova dhe të gjeta si pëllumbeshë të ritur tashi, që piva prej gojës t'ënde dhe t'i putha syçkat e ëmbëla. Në këtë letër po mbyll sot me kujdes vetëm lumtërinë t'ime, që t'a ndjesh edhe ti, dyke qënë unë i pafuqishmë sot për tjetër gjë.
Shumë të fala të dërgon Lasgushi yt".[531]
Ndjenja e madhe e dashurisë së të rinjve përjetësohet në ditarët që për kohën ishin shndërruar në letërsi epistolare, e cila si gjini letrare ka në qendër të objektivit të saj letërkëmbimin. Romani me karakteristika ditari në formë letrash nuk ndodhi me Lasgushin e madh, sikundër me Gëten dhe Verterin, Robert Musil-in dhe Tërlesin e tij, Haki Stërmillin me Dijen e Shpendin, apo Gjon Zaverin e Paolën e Sterio Spasses.
Kjo lloj gjinie karakterizohet nga një lloj përzierje e realizuar me ndjenjën e masës, përmes intimitetit dhe një farë kontrolli mbi stilin, i cili ndonjëherë shkon deri në një shkrim mjaft të kultivuar. *"Epistolari shkruhet në vetën e dytë dhe merr parasysh personalitetin e të adresuarit dhe jo lexuesin e papërcaktuar anonim, që do ta lexojë atë kur të publikohet".*[532]

VIII.4. Shënime për ngjarje reale historike të prekshme për realitetin shqiptar.

"Shkolla shqipe e Poradecit"[533], shkruar nga Lasgushi është një botim plot shënime mbi fakte historike që kalonte vendi dhe kujtime të poetit mbi lëvizjet e çështjes kombëtare. Libri shoqërohet me fotografi të kohës dhe faksimile.

[531] L. Poradeci, *Vepra 3* (Ditar dhe korrespondencë intime), Shtëpia botuese "albPaper", Tiranë 2010, fq. 10.
[532] T. Çaushi, *Fjalori i Estetikës*, Shtëpia botuese "Ombra GVG", Tiranë 2005, fq. 115.
[533] L. Poradeci, *Shkolla shqipe e Poradecit*, Tiranë, "albPAPER", 2002, f. 156.

Prezantimi dhe përshkrimi i ngjarjes së madhe iluministe të Pogradecit jepet në mënyrë objektive, moment që tregon se pozicionimi i narratorit është sinkronik. Ky narrator në të shumtën e herës së tij përshfaqet i nënkuptuar. Herë-herë prania e tij është e padukshme, e fshehur nga gjykimet, vëzhgimet dhe konstatimet interesante. Mirëpo shpesh ndodh që zëri i narratorit autorial të vërehet qartë kur ai ndërhyn me komentin e tij përfundues. Ndonjëherë ky lloj narratori eklipson parimin estetik në qëndrimin filozofik të Lasgush Poradecit.

Kjo lloj proze dokumentare apo shënimet personale për ngjarje dhe data të mëdha të jetës së autorit realizojnë mënyrën e veçantë të strukturimit kompozicional të saj apo strategjisë narrative të përdorur. Prezantimi i rrëfimit dokumentar bëhet nga prespektiva e gjithëdijshme në vetën e parë ose të tretë.

Shembulli më i mirë i trajtimit dhe i përjetimit artistik të një problematike dokumentare që mbështet në elemente intelektuale është botimi "*Shkolla shqipe e Poradecit"*. Në strukturën e shënimeve nuk hasim në figuracion letrar. Çdo gjë është dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga prespektiva e psikologjisë historike, në dukje naive, por befasisht e zgjuar, e nxitur nga gjendja faktike dokumentare e ngjarjes.

Vendi pikëtakues është ambienti inetelektual, shkolla shqipe e Poradecit, në përballje me pushtuesit e huaj. Profilizmi intelektual i kësaj kohe të madhe historike plot vlerë iluminuese, jepet nga këndivështrimi i poetit. Gjithashtu, në këtë lloj përshkrimi një vend të veçantë zë rrëfimi në vetën e tretë, i zhveshur nga shtresa e emocionit figrativ. Këtë e realizon figura autentike e qytezës së Pogradecit dhe përpjekjet e njerëzve të saj për të përhapur gjuhën shqipe përmes shkollës shqipe, të hapur vetëm një javë pas asaj të Korçës, më 14 mars 1887.

Në shkrimin *"Himni Kombëtar "flamurit pranë të bashkuar" dhe gjeneza e tij"*, Lasgush Poradeci sjell për herë të parë historinë e krijimit të Himnit të Flamurit Kombëtar. Sipas shkrimit, kori kishtar shqiptar i Bukureshtit filloi të gjallërohej në fillim të viteve 1900. Bukureshti në atë kohë ishte kryeqyteti shqiptar i mërgimit. Kori udhëhiqej nga profesori rumun Kiriak, i cili më pas, duke pasur shumë punë me korin e tij të shoqërisë *"Karmen"*, ia la në dorë drejtimin 25-vjeçarit Ionesku. Ky i fundit, përveç këngëve shqipe, i mësonte korit edhe këngë popullore a marshe patriotike, si dhe himnin kombëtar të Rumanisë "*Mbi flamurin tonë"*.

Himni i Rumanisë ishte shkruar nga poeti Ioan Barsan me muzikë të Çiprian Porumbeskut në vitin 1907. *"Të entuziazmuar nga ky himn, koristët shqiptarë ju lutën Asdrenit të thurrte disa vargje të përshtatura me atë melodi, që të këndohej prej tyre. Kori kërkonte një himn shqip. Vetëm pas disa ditëve Asdreni solli tekstin e himnit "Rreth flamurit të përbashkuar", titulli origjinal "Betimi mbi flamur"[...]"Përpara se të ish kënga, ish ndjenja e mëmëdhetarëve dhe ish nevoja e tyre për organizim, për çdo mjet që mund ta shtynte një hap më përpara veprën e filluar. Ajo ndjenjë shqiptare përmblodhi atë kolloni, ajo kolloni bëri atë shoqëri shqiptare, ajo shoqëri atë shkypshkronjë shqiptare, atë fletore shqiptare, atë shkollë shqiptare, atë kishë dhe xhami shqiptare, atë Kor Kishëtar shqiptar, dhe ky kor desh tashi, midis himneve dhe përlavdurimeve të Zotit në gjuhën shqipe, edhe këngën e tij kombëtare, Himnin e Shqipërisë, Himnin e Flamurit Shqiptar". Dhe himni arrin të bëhet kësisoj Himni Kombëtar i Kollonisë së Bukureshtit, që përfaqësonte Shqipërinë në atë vend mërgimi aq të djegur për atdhe, dyke u bërë zakon të këndohet rregullisht përpara dhe pas çdo ushtërimi të korit. Fjalët e Asdrenit u shkrinë në melodinë e himnit kombëtar rumun.*

Më 1912, me ngritjen e flamurit në Vlorë, himni i shqiptarëve të Bukureshtit, tashmë i kënduar dhe në Shqipëri, u njoh si himni ynë kombëtar".[534] shkruan Poradeci.

Fakti që Lasgushi nuk rreshti së shkruari as në këtë formë dëshmon se autori i tyre ishtë në rrugë të mbarë përsa i përket krijimtarisë letrare realisht të paktë, vetëm në dy vëllime poetike. Vepra jo letrare e Lasgushit ekziston. Ndoshta dëshmi të tjera presin dritën e botimit, presin të shkundin pluhurin e viteve për të prekur duar dhe sy lexuesish.

Vepra e Lasgushit do të na ofrojë në çdo kohë mundësi studimi dhe interpretimi. Çdo qasje rreth saj do të kontrubuojë në lartësimin e poetit kombëtar, L. Poradecit.

Shkrime të tjera të kësaj natyre janë kryesisisht ato të përmbledhura në veprën 2 të Poradecit: *"Shqipërija, Vënd i Ri"*; *"Asdreni një manifestim kombëtar"; "Rrëfimet e Mitrush Kutelit"; "Musine Kokalari. Siç më thotë nënua plakë"; "Mbi shfaqjen e dramës Besa prej Grupit të Shoqërisë Dragoj të Poradecit"; "Gjergj Fishta Lirik, Shkëmb i Tokës dhe Shkëmb i Shpirtit Shqiptar"; "At Gjergj Fishta, Vazhdimtar në Mendimin e Kombit"; "Misioni i Shqiptarëve të Bukureshtit dhe Naim Frashëri"; "Naim Frashëri, Vjershëtor i Bukureshtit"; "Lirika e Naim Frashërit"; "Himni Kombëtar "flamurit pranë të bashkuar" dhe gjeneza e tij"; "Një fatos i vetëranërisë shqiptare";* apo *"Vepërimi Kombëtar i Shqiptarëve të Rumanisë me Kryeqëndër Kolloninë e Bukureshtit";*[535]

Përfundime:

Në këtë kapitull bëhen përpjekje drejt hulumtimit të të dhënave biografike dhe shkallë-shkallë prej tyre, më pas të kalohet në shqyrtimin e krijimtarisë së Lasgush Poradecit. Hulumtuesit pas viteve '90 vihen në kërkim të prozave poetike apo ditarëve të ndryshëm të autorit, që mund të ndihmojnë lexuesit në interpretimin e lirikave të tij. Shënime të tilla kanë dhënë dhe do të vijojnë të japin edhe më tepër receptues grupmoshash të ndryshme ndër vite. Kësisoj hulumtimi dhe studimi do ishte mirë të përqëndrohej edhe në këtë pjesë të veprës së Lasgush Poradecit.

Konkretisht ditarët apo shënimet e ndryshme ne mund t'i grupojmë në:

-Ditarë personalë që trajtojnë përditshmërinë e poetit, problematikën e saj.

-Ditarë personalë dhe korrespondencat intime që trajtojnë ndjenjën dashurore të poetit, fragmente nga jeta, ambienti dhe hapësira kulturore e kohës.

-Shënime personale që trajtojnë ngjarje realiste historike të cilat prekin jetën e kombit shqiptar. ("Shkolla shqipe e Poradecit"; "Himni Kombëtar "flamurit pranë të bashkuar" dhe gjeneza e tij" etj.)

Prej shkrimesh të tilla, lexuesi i poezisë së L. Poradecit, i shikon këto publikime si mundësi për interpretime të plotësuara të krijimtarisë poetike të autorit, apo për të rritur kreativitetin rreth heronjëve lirikë të poezive.

Karakterstika e llojit të shkurtër të ditarit apo prozës poetike gjithashtu të shkurtër që Poradeci lëvron, mbetet interesante, në aspektin e të gjithë elementëve që përbëjnë tërësinë strukturale të punimit tonë. Interesantja përshfaqet edhe në kuadër të tematikës së trajtuar në ditar apo shkrimeve të tjera. Gjithashtu, kapitulli dëshmon se ka lexues të ditarit lasgushian apo shënimeve të tjera të L. Poradecit, të cilët pasi i lexojnë ato, u rikthehen poezive për lexim ose bëjnë të kundërtën.

[534]L. Poradeci, *Vepra V*, Korrespondencë Lasgush Poradeci-Asdreni. Përgatiti për shtyp Kostandina Gusho & Maria Gusho, Tiranë, "albPAPER", 2012, -f. 82-88.

[535]L. Poradeci, *Vepra II, Publicistikë; Kritikë letrare; Antologji shqipe e kësikohëshme*, Tiranë, "albPAPER", 2010, f. 456.

IX.KAPITULLI I TETË

VARIANTËT, TEKSTI I PARË

IX.1. Variantet poetike lasgushiane dhe receptimi filologjik

Analiza filologjike është hapi i parë i studimit të një vepre letrare që kërkon një angazhim të ndërgjegjshëm profesional dhe shpirtëror. Ajo nis me leximin e kujdesshëm të materialit, hap i cili ndihmon në njohjen më të mirë të tekstit. Analiza filologjike çon në gjetjen e tekstit të parë (botimin e parë), studion autorësinë e veprës, kohën në të cilën ndodhin ngjarjet, kohën e shkrimit dhe botimit të saj apo komentin gjuhësor. Kërkimi i tekstit të parë ka rëndësi në studimin e një vepre letrare, sepse gjurmohet radha e botimeve të saj, nga i pari deri tek i fundit, pasi dimë se veprat gjatë këtij procesi pësojnë ndryshime, ndonjëherë nga botuesit, ndonjëherë nga vetë autori. Studiuesi francez Eric Faye saktëson se skelat ndërtuese të një vepre shkrimtari nuk i heq, por gjatë gjithë kohës korrigjon diçka ose shton diçka tjetër.

Përmes analizës filologjike ne na intereson t'i afrohemi sa më shumë tekstit të parë, mbresave dhe përjetimeve spontane të shkrimtarit, pastaj të ndjekim evoluimin e tij në variantet e tjera të veprës, botimet e mëvonshme, nëse ato janë të ndryshuara nga botimi i parë. Tashmë është katërcipërisht i njohur fakti që Lasgushi nga rishkrimi i poezive, thënë ndryshe nga përpunimi i varianteve të tyre, arrinte cilësinë e poezisë, vargut, përsosmërinë e saj. Në më të shumtën e herëve L. Poradeci u është kthyer dhe rikthyer disa prej poezive të tij, deri kur ka menduar se ato janë të gatshme për botime dhe sy lexuesish: *"Edhe unë mundohem, me fuqitë e mija, t'ia nxjerr në shesh toskërishtes potencialitetin e saj shpirtëror, bekimin e harmonive të saj, dyke bërë vargje të përsosur në harmoni. Harmoni nuk është forma (forma e përsosur s'është kurrë art, mund të jetë zejtari, po jo art). Harmonija ime është manifestimi (me anë të vargut) i vetë jetës dhe i vetë botës shqiptare, së kristalizuar në forma të dukshme shpirtërore, të cilat janë simbole të jetës dhe të botës. Prandaj rima ime identifikohet me fondin, prandaj formë e fond janë një: janë realiteti shpirtëror i shfaqur identikërisht me anën e poezisë. Prandaj rima ime nuk kuptohet kurrë që është rimë, po tretet në simbolin e jetës të cilin ajo e shpreh me atë simbol të përsosur. Ky është arti im, një art shqiptar. Kur them rimë, e bashkuar me fondin, nuk kuptoj vetëm rimën, por dhe ritmin dhe masën me stilin e jetës, të jetës shqiptare".*[536]

Përmes kërij shkrimi sërish L. Poradeci aludon për madhështinë e poezisë dhe poetencialin e saj ndër ne lexuesit e saj. *"Është jeta shqiptare, morali ethik shqiptar që çfaqet me atë simbol poetik, sepse vetëm gjuha shqipe (e derdhur në poezi) me tingujt frymorë dhe lëndorë të saj ka mundësi të shprehë harmoninë specifike së poezisë s'ime. Sa më e përsosur është një poezi, ajo është (njëkohësisht) dhe aq më e fuqishme, domethënë aq më shumë përmban potencialin e moralit frymor shqiptar. Që dua të dali poezia ime (e cila është "harmonija" ime në kuptimin e rrëfyer më sipër) sa më potenciale, kjo nuk shkaktohet prej volles t'ime individore, po prej vet potencialit të jetës dhe botës, i cili me vitalitetin e tij të plotë e shtyn vetveten që t'a çfaqi, t'a shprehi më plotërisht. Shprehjen ky vitalitet e di (nga vet natyra e tij) e do të jetë njëjt me potencialitetin e vet të tij. Nuk ka potencial më të madh ose më të vogël në poezinë e përsosur, po ka vetëm potencial të plotë, domethënë vetëm gradën supreme të potencialitetit vital të jetës së racës. Jeta (p.sh në manifestimin e saj si*

[536] L. Poradeci, *Vepra 1, Poezia*, (Pse shkruaj), Shtëpia botuese "albPaper", Tiranë, 2009, fq. 6-7.

"dashuri") ka vetëm një potencial, domethënë ajo është e përsosur, domethënë e fortë absolutisht".[537]
Ndërkaq, sot, lexuesi i specializuar, kritiku letrar u rikthehet varianteve, madje i lexon të gjitha dhe shijon më së miri poezinë në tërësi. Lexuesi i sotëm në ndryshim nga lexuesit e viteve të dikurshme lexon me sy të lirë në një botim të vetëm të gjitha variantet e poezive, të cilat gjenden të përmbledhura në ribotimet e bëra rishtas nga familjarët e Lasgush Poradecit. Lexuesi i atëhershëm nuk e kishte këtë lehtësi botimi. Ai ka lexuar dhe shijuar vetëm atë poezi që përfshihej në ato botime më së shumti pa prezencën e varianteve, veç ndonjë rasti që i risillte ato.
Lasgushi e huazoi stilin *(variantë)* nga mjeshtri i vjershërimit, mësuesi i tij, rumuni Mihai Eminsku, i cili gjithashtu e krijoi në disa variante poezinë që shkroi. Madje në ribotimin e fundit të veprës letrare të Poradecit, fjala variantë me *-ë* fundore sikurse në gjuhën rumune, shkruhet e tillë, jo me e- fundore (variante), si në librat e dikurshëm.
Këtë lexim variantesh dhe analizën mes tyre mund ta bëjnë veçanërisht studentët universitarë apo nxënësit e sistemit parauniversitar shqiptar, sepse poezitë e lirikut të shqipes studiohen në orë të veçanta mësimore.
Le të shohim disa poezi të Lasgush Poradecit së bashku më variantet e tyre. Poezi me dy variante janë: *"Poradeci"; "Marsh i djalërisë"*; *"Syt' e lumtur*"; *"Syt' e varfëruar"*; *"Vallja e luleve"*; *"Vdekja e Nositit"*; *"Trashëgimi"dhe "Dashuri dardhare"*. Vijnë me dy variante dhe disa poezi që kanë tituj të ndryshëm si: *"Mëngjes" -"Mëngjezi"*; *"Ylli i jetës"-"Ylli"* dhe *"Del ne porta"-"Ne porta nga mulliri"*.
Të vetmet poezi që ekzitojnë me katër variante janë ato me titull *"Lamtumirë"* dhe *"Durimi i dashurisë"*. Kjo e fundit dy herë vjen me titullin *"Durimi"* dhe dy herë me *"Durimi i dashurisë"*. Poezia*"Valimi i dashurisë"* ka tre variante. Dy herë me titullin *"Valimi i dashurisë"* dhe një herë më titullin *"Gëzimi"*. Ajo me titull *"Zotit Gjikam"*, ka vetëm një variant. Edhe poezia *"Fluturimi"* vjen me një variant. Poezia *"Më zu një mall"* ka tre variante, ku vetëm dy prej tyre vijnë me titullin *"Më zu një mall dhe sot"*. Sqarojmë se këto poezi janë marrë të gjitha nga botimi i *"Veprës 1"*, të poezive të autorit, botimi i vitit 2009.
Poezitë në vija të përgjithshme kanë shumë pak ndryshime në formë dhe në përmbajtjen e tyre. Vlen të sqarohet këtu koha e shkrimit të tyre, sepse ajo ndihmon në interpretimin e poezive. Disa variante vijnë me data të sakta, një pjesë tjetër nuk e kanë të shënuar atë në fund të poezive të publikuara.
Komenti gjuhësor dhe analiza strukturore e poezive janë të tjera ndalesa në krijimtarinë e varianteve të Lasgush Poradecit. Gjatë komentit gjuhësor të poezive shohim se ato kanë pësuar ndryshime nga varianti në variant. Ndryshimet vijnë në nivelin makrostrukturor dhe atë strukturor, në nivelin fonetik, leksikor, sintaksor dhe ortografik.[538] Brenda poezive, disa fjalë e humbasin kuptimin fillestar. *"Autori heq vargje, duke e shkarkuar tekstin nga një ngarkesë e panevojshme dhe nga ana tjetër, shton vargje me synim plotësimin e semantikës"*.[539] Analiza e strukturës së poezive, të krijon njdesinë e detyrueshme të kuptimit të tyre përmes vargjesh.
Poezia *"Dashuri dardhare"* është ndër ato poezi që ka të ndryshuar vetëm strofën e fundit. Së pari ajo botohet me titullin *"Kjo mbrëmje"*[540] dhe së dyti në Albumin

[537] Po aty, f. 7.
[538] E. Gjika, Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit. (Variante, burime, poetikë), Shtëpia botuese dhe studio letrare "Naimi", Tiranë, 2010, fq. 92-107.
[539] Po aty, fq. 97.
[540] L. Poradeci, *Vepra 1, Poezia*, Shtëpia botuese "albPaper", Tiranë, 2009, fq. 253.

turistik të Dardhës, vjen nën titullin *"Dashuri dardhare" (Trimi dhe vasha)*. Vargu i fundit *o mall e zjarr e yll* përjetë[541], bëhet *si ndrin e shkrin e plas përjetë*.[542]
Lexuesi implicit dhe ai eksplicit vrojtojnë praktikisht ndryshimet që vetë autori ka bërë në poezinë e tij. Leximi i poezive ku mungon data e kohës së shkruar duhet bërë më i kujdesshëm. Kjo punë kërkon përqëndrim më të madh, sepse do t'i duhet lexuesit të lexojë mes vargjeve për të gjetur kohën të cilën përjeton autori, ndjesitë e përcjella, reflektimet e shprehura heshturazi apo me zë të lartë.
Në kuadër të nivelit strukturor kjo tufë poezish, në disa variante ndryshon vetëm titullin. Ky ndryshim bëhet domino në rrjedhën e tij. Të tilla janë poezitë me variantet e tyre: *"Poradeci"; "Marsh i djalërisë", "Syt' e lumtur"*; *"Syt' varfëruar"*; *"Vdekja e Nositit"; "Lamtumirë"; "Më zu një mall"; "Trashëgimi"*; *"Ylli i jetës"; "Gëzimi"; "Durimi";* Në këtë fokus duhen parë edhe ato poezi që publokohen vetëm me një variant të mirfilltë, pasi nga poeti nuk është parë e udhës të vijnë edhe variantet e tjera si për shembull poezia për Koliqin.
Poezia *"Mëngjes"* duhet parë e pranëvënë me poezinë *"Mëngjezi"*. Ato janë variante dhe duhet të qëndrojnë pranë njëra-tjetrës në ribotime të tjera të poezive të Lasgushit. *"Mëngjes"*[543] gjendet në faqen 52 dhe poezia me titull *"Mëngjezi"*[544] në faqen 281. Në variantin e dytë të saj, fjala *nosit* është zëvendësuar me sinonimin *nori*.[545] Nuk dihet se për çfarë arësye në të gjitha botimet e bëra pas çlirimit të vendit variantet botohen në largësi faqesh të konsiderueshme nga njëra-tjetra. Varianti i parë e përshfaq mëngjesin në trajtën e pashquar dhe varianti i dytë në trajtën e shquar. Ajo mban për datë botimi 11 gushtin 1929. Strofa e fundit e poezisë, në dy variantet e saj ndryshon totalisht. Lexuesi kërkon të jetë më i konkretizuar nga ky afrim për të bërë përceptimin e poezisë në fjalë në të dy variantet e saj. Duhet bërë korrigjimi i pranëvënies së tyre, që tashmë rezulton i tillë në të gjitha përmbledhjet poetike, të publikuara në vazhdimësi. Në këtë sens sqarojmë se kemi marrë në shqyrtim, në këtë kapitull, vetëm ato poezi që variantet e tyre i kanë brenda tekstit letrar të botuar më 2009.
Përsa i përket kompozicionit të jashtëm të veprës letrare këto poezi kanë ndryshimet e tyre që kapen edhe nga syri i një lexuesi të zakonshëm. Organizimi në strofa ndryshon nga njëri variant në tjetrin.
Poezia *"Marsh i djalërisë"*, në dy variantet e saj në faqet 47 dhe 49, ndryshon vetëm strofën e fundit.[546] Mendojmë se varianti i parë është më i arrirë se i dyti edhe pse i dyti shkruhet për të qenë më i arrirë artistikisht në shumë raste nga krijuesit. Vërejmë se mungon në publikim data e saktë e shkrimit. Varianti i parë, zakonisht ndiqet nga varianti tjetër për të realizuar përsosmërinë e poezisë. Në këtë rast, në vlerësimin tonë vlen të theksohet mesazhi, që përcillet më i qartë në variantin e parë.
Poezia *"Syt' e lumtur"* vjen në dy variante.[547] Edhe këtu nuk ka data të shkrimit të varianteve. I pari është më i shkurtër, më konciz, i shkruar me distik. Poezia nuk ka një emër të përveçëm, që i adresohet dashurisë së lirikut. Varianti i dytë është më i

[541] L. Poradeci, *Dashuri dardhare; Trimi dhe vasha*, në librin: *Dardha, Album Turistik*, Botim i Shoqërive dardhare Bashkimi, Bukuresht dhe Shpresa, Dardhë. Nën patronazhin e Entit Kombëtar të Turizmit. Kryetarja e Naltë dhe Patronesha e Turizmit, Princesha Maxhide Zogu. Ky album u shtyp në Atelierët e Tipografisë "Albania", Kostancë, Rumani, nën kujdesin e Mitrush Kutelit. Viti i botimit: 9 maj 1938, Bukuresht, Rumani, f. 14.
[542] L. Poradeci, *Vepra 1, Poezia*, Shtëpia botuese "albPaper", Tiranë, 2009, fq. 253.
[543] Po aty, fq. 52.
[544] Po aty, fq. 281.
[545] Ka shpjegimin pelikan.
[546] Po aty, fq. 47; 49.
[547] Po aty, fq. 68; 69.

gjatë dhe vjen i shkruar me tercinë. Në këtë variant kemi një emër të përveçëm në dashurinë e poetit, emrin Tome, që nuk del në asnjë poezi tjetër të Poradecit të shkruar më vonë. Varianti i shkurtër është më i miri, pasi nën gjykimin tonë, vjen më emotiv dhe më i ngrohtë për lexuesin përmes mospërdorimit të emrit real ose ireal të vajzës. Kjo hapësirë rrit kreativitetin e lexuesve për të bërë një përfytyrim personal të pandikuar lidhur me vajzën e dashuruar.

Poezia *"Syt' e varfëruar"*[548] ka dy variante që kanë ndryshime të mëdha mes tyre në ndërtimin e poezisë. Njëri është shkruar me distik dhe tjetri me tercinë.

Poezia *"Vallja e luleve"*[549] variantin e parë ka me vit botimi 1924-ën dhe ka dhjetë strofa. Varianti i dytë ka shtatë strofa. Edhe pse vjen më i shkurtër, varianti i dytë ka sintezë mendimi, ka koncizitet poetik. Pasthirrmat zëvendësohen nga përemra pronorë.

"Vdekja e Nositit"[550], shfaqet me dy variante. Poezia pothuajse është e njëjtë në të gjithë gjatësinë e saj të strofave. Ndryshon vetëm leksema *gjit* në *vir*, që kanë në sinonimi kuptimin e vendit më të thellë të liqenit të Ohrit, fundin e masivit ujor. Sërish do të thoshim, se përpunimi mbetet varianti më i mirë, por edhe në këtë rast mendojmë se varianti i parë mbetet më i mirë se i dyti. Variantet në vetvete janë një gjetje që rritin emocioanalitetin e lexuesit përballë këtyre lloj poezish. Receptuesi, përballet vetë në fund të fundit me poezinë që ai pëlqen më së shumti, si variant të përzgjedhur prej tij.

Poezia *"Lamtumirë"*[551] ekziston me katër varinte. Poezitë përballë receptuesit të tyre pothuajse kanë të njëjtën përmbajtje. Varianti i parë me tri strofa, varianti i dytë me tri strofa, varianti i tretë përsëri me tri strofa dhe vetëm varianti i katërt, ka katër strofa. Tek ky i fundit, strofa e katërt rrit emocionalitetin poetik të poezisë, duke shërbyer njëherazi edhe si një mesazh përfundimtar në vjershë. Poezia në tërësinë e saj vjen ndryshe nëpër variantet e publikuar. Vetëm strofa e parë e varianteve nuk asnjë ndryshim. Leksiku jo i njëllojshëm përbën risi në prezantimin e strofave të tjera. Të bie në sy fjala *yll*, që shoqërohet nga foljet *ndrin*, *zbret* dhe *vdes* në tri variantet poetike. Në variantin e fundit (të katërtin) kemi risi, konkretisht vargun *o vashë-e të rriturit t'im*. Për receptuesin mendojmë se varianti i katërt është më i miri, pasi vjen si sintezë e dy të parëve. Poezitë nga njëra-tjetra përshfaqin një përmirësim formal të tekstit të tyre, ç'ka e bën variantin e katërt më të plotë në përcjelljen e kuptimit poetik.

Poezia *"Më zu një mall"*[552] publikohet përmes tri varintesh. Të parin Lasgushi e titullon thjesht "*Më zu një mall"*. Në dy varianet e tjera, konkretisht, në të dytin dhe të tretin, poezia ndryshon titull. Shtohet kështu lidhëza bashkërenditëse *dhe*, por edhe ndajfolja *sot*, duke e bërë *"Më zu një mall dhe sot"*. Për receptuesit variantet vijnë me katër strofa që tek-tuk ndryshojnë leksemat e tyre. Në variantin e tretë *vasha* zëvendësohet me fjalën *motër*, duke i dhënë poezisë konotacionin e afërsisë për figurën e gruas. Gjithsesi, duhet thënë se varianti i parë mbetet ndër më të arrirët, sepse sjell më shumë përjetim të atmosferës për lexuesin, duke e bërë mungesën e vashës më bindëse.

Poezia *"Ne porta nga mulliri"*[553] vjen me dy varintë, i fundit me titull më konciz: *"Del ne porta"*. Varianti i parë është shkruar me tercinë, varianti i dytë në distik. Në kuadër të kompozicionit të jashtëm për syrin receptiv poezia vjen respektivisht në

[548] Po aty, fq. 71; 72-73.
[549] Po aty, fq. 79-80; 81-82.
[550] Po aty, fq. 133-134; 136-137.
[551] Po aty, fq. 198; 199; 200; 201.
[552] Po aty, 202; 203; 204.
[553] Po aty, 208; 209.

pesë strofa, varianti i parë dhe në gjashtë varianti i dytë. Veprimi në variantin e dytë është më konkret dhe parandjenjës.
Kritika e specializuar e ka quajtur poezinë *"Trashëgimi"*[554], testament të poetit, me të cilën Lasgush Poradeci vijon t'u flasë në kohë receptuesve të vjershave të tij. Edhe kjo poezi ka dy variantë të saj. Variantet ndryshojnë totalisht në semantikën e publikuar për botim. Varianti i parë vjen më i ndjerë dhe më i arrirë në përfeksionimin krijues të poetit pogradecar të liqerit të Ohrit. Varianti i dytë prezanton edhe detaje si vendin, ditën e javës, datën e saktë, shekullin dhe orën e krijimit deri në minuta, (Tiranë, dita e premte, 27 shkurt 1942-XX, ora 12. 25'). Në leximim vertikal të poezisë leksemat e saj, *vjershërije*, *bukurije*, *iskër* dhe *copë* janë më të mbajturat mend nga lexuesi dhe njëherazi fjalëçelsa në variante. E gjithë jeta e Poradecit krijues, ka kaluar në bunacë e furtunë, duke i falur dinjitet personal dhe artistik poetit. Testamenti i tij letrar vijon të mbajë erë Shqipërie.
"Valimi i dashurisë"[555] është poezia në radhën e varianteve, e cila vjen e botuar në tre të tilla. Në fillim të librit është vendosur varianti i tretë, i vitit 1973, që korespondon me faqen 284 (me katër strofa). Në fund të poezisë poeti vendos edhe kohën e përfundimit të saj mesnatë. Pastaj vjen varianti i dytë me titull të ndryshuar *"Gëzimi"*, që në shënimet origjinale të poetit ka titullin *"Shkëmbi"*, faqe 285 i cili nuk ka datë dhe vit krijimi (me tri strofa). Me tej vjen varianti i parë i poezisë, ai i vitit 1941, që gjendet në faqen 286 (me katër strofa). Mendojmë që varianti i parë, ai i vitit 1941, mbetet varianti më i arrirë artistikisht. Në strofat e katërta të dy varianteve me vitshkrime, fjala *thërrime* zëvendësohet me fjalën tjetër *kujtime*. E gjithë poezia pothujase mbetet e njëjtë nga fillimi i saj deri në fund. Ndjenja e dashurisë përthith në vetvete pasionin dhe dëshirën për ta jetuar jetën çdo çast. Dashuria në zemër mbetet një valim i përjetshëm në përditshmërinë e gjithkujt, mashkull apo femër.
Poezia *"Durimi"*,[556] vjen me ka katër variante. Në pikëpamje të ndryshimeve strukturore kemi ndryshimin e titujve të varianteve vetëm në dy raste, në atë të dytin dhe të tretin "*Durimi i dashurisë"*. Në këtë kuadër, varianti i katërt në botim, mbetet i pari se i përket datës 17 korrik, 1941, shoqëruar me shënimin e datës së përfundimit të poezisë: (Pogradec, në shtëpi nga lumi). Varianti i tretë mbetet, realisht i dyti dhe mban datën e botimit real të poezisë (Revista *"Tomori i vogël"*, Tiranë 1 shkurt 1942). Varianti i dytë nuk shoqërohet me datë krijimi të poezisë. Ndërkaq, varianti i parë që realisht është i katërti, i menduar për shkak të datës së botimit të tij, shënon vitin 1972.
Theksojmë se në këtë botim, mungon viti, por i parë në raport me publikimet e kësaj poezie në ribotime të tjera, i përket 1972-shit. Të gjithë variantet kanë nga tetë strofa, vetëm varianti i tretë, ka shtatë të tilla, sepse mungon strofa e pestë e poezisë. Kjo poezi në të gjitha variantët vjen pothuaj e njëjtë, por me pak ndryshime të vogla në leksikun e përdorur. Varianti më i mirë mbetet ai i vitit 1942 me titull *"Durimi i dashurisë"*. Në botim mungon sqarimi variantë poshtë titujve të poezive edhe pse ato qëndrojnë pranë njëra-tjetrës. Në një botim të ardhshëm duhet bërë edhe ky korrigjim.
Antiteza *i lumtur-i palumtur* mbizotëron në këtë poezi lasgushiane. Në këtë dualitet dritë-hijesh gëlon jeta njerëzore. Durimi dhe përpjekja sizifiane merr konotacion ajzbergian në vijimësinë e jetës njerëzore. Lasgushi nënvizon përmes figurës së apostrofit brengën që e mban me vete prej kohësh.
Hon-dashuri! Yll Perëndi

[554] Po aty, 237, 238.
[555] Po aty, fq. 284; 285; 286.
[556] Po aty, 287-288; 289-290; 291-292; 293-294.

Që mbaj në zemër![557]

Metafora e kujtimit që *përplaset përmi dhe*[558] mbetet ndër më të bukurat e kësaj poezie. Harmonia dhe muzikaliteti e bëjnë atë dhe variantet e saj ndër më të bukurat në krijimtarinë lasgushiane.

Tashmë, te Lasgush Poradeci, ndryshimi i titujve të varianteve në poezi, kthehet stilemë. Sqarojmë gjithashtu, se poezia "*Yll i jetës"*, faqe 269 përveçohet si vjershë që ka dy variante. Saktësisht poezinë *"Ylli"*, f. 149. Si rregull botimi ato mund të pranëvihen si variante poetike. Po kështu ndodh edhe me poezi të tjera, si *"Fluturimi"*, f. 271-272 dhe *"Zotit Gjikam"*, f. 303. Për dy të fundit e kuptojmë se poezitë janë variante, vetëm nga sqarimet e bëra. Poezia *"Fluturimi"* në fund të saj mban shënimin: *"Varianti që po botojmë është ai i ripunuar nga poeti më 1973"*[559] dhe poezia *"Zotit Gjikam"*, që Lasgushi ia kushton Ernest Koliqit, poshtë titullit ka shënimin variantë. Sqarojmë se ato kanë të botuar vetëm njërin variant[560]. Në një botim më të kuruar të veprës letrare, pranë tyre mund të publikohen nga familjarët edhe variantet e munguara deri tani.

Përfundime:

Ndryshimet e poezive me variante ndodhin më së shumti, në aspektin strukturor të tyre. Lasgush Poradeci vendos tituj poezish dhe i ndryshon ato nëpër varinte (në varësi të tyre I; II, III, dhe IV). Ai shton dhe heq vargje nëpër to. Ndryshim titujsh nuk kanë të gjitha poezitë e këtij procesi. Poradeci pakëson dhe shton vargje kur atij i duket normale, në kuadër të semantikës së përgjithshme të krijimeve të tij. Madje në to shton edhe datën dhe vitin e botimit tek-tuk, duke sjellë si risi edhe vendosjen e orës së mbarimit të krijimit poetik, (në ndonjë rast edhe shekullin).

Ky dimension kohor na lejon të arrijmë në konkluzione të ndryshme apo të përsiatim për probleme të sfondit krijues të autorit. Konkretisht për njohjen e kohës në të cilën u shkrua dhe u botua vepra, njohjen me mjedisin ideo-kulturor, shkollën apo drejtimin letrar të cilit Lasgushi i përket, njohjen me kushtet historiko-shoqërore, kohën e shkrimit dhe botimit të poezisë.

Janë këto njohje, ato që na çojnë në konkluzionin përfundimtar të përcaktimit të tekstit të parë poetik të Lasgushit dhe më tej të radhitjes së varianteve të tij. Varianti më i mirë letrar dhe artistik, mbetet gjithsesi subjektiv. Në varësi të shijeve dhe teknikave të leximeve në kohë fitohet nga lexuesi poezia më e mirë e poetit perfeksionist.

Sqarojmë gjithashtu se mund të emërtojmë variant të parë ato poezi që dëshmojnë me shkrim një datë të hershme krijimi dhe të rendisim varinte të dyta, të treta, të katërta gjithë ato poezi, që për data kanë vijimësi vitesh. Në këtë kuadër kemi bërë një ndarje variantesh dhe interpretimi mbi bazën e këtij arsyetimi logjik. Lasgushi i krijon variantet si rezultat i arsyetimit përfundimtar të tij, arritjen e përsosmërisë në poezi. Kjo nuk duhet thënë për të gjitha. Sipas mendimt tonë, në shumësinë e tyre preferohen variantet e para si qasje poetike më të mira. Lexuesi ndërkaq, për poezitë e tjera është i lirë ta bëjë receptimin e tyre në bazë të dëshirës personale ose më saktë duke u nisur nga ndryshimet e përshkallëzuara që ato fitojnë.

Lexuesi filologjik, që vjen si rezultat i analizës filologjike të poezive lasgushiane e ka më të lehtë të arrijë në këtë përfundim, pasi përcakton tekstin e parë poetik. Me radhë vijnë variantet e tjera të poezive. Lasgush Poradeci e arrin përsosmërinë e vargut të tij poetik në formë dhe përmbajtje me durim vetflijues.

---

[557] Po aty, fq 292.
[558] Po aty, fq. 287.
[559] Po aty, fq. 271.
[560] Po aty, fq 303.

Vetë ai thotë: *"Poezija duhet të shprehi jetën-me simbolin poetik-në maksimumin e saj, në potencialin absolut të saj. Atëherë poezija është e përsosur, perfekte. Kur s'është e përsosur: kur s'ka fuqinë supreme, poezija nuk se ësht' e metë, po s'i përshtatet, s'i përputhet potencialit moral të jetës, pra s'është poezi, nuk përfaqëson vitalitetin integral të jetës dhe të botës, poetncialin absolut"*.[561]
Nën këtë mendim prej mjeshtri krijues, Lasgush Poardeci arriti përsosmërinë e vargut, vetë magjinë e poezisë brilante. Jo të gjithë poetët e letrave shqipe e kanë pasur këtë mani krijuese, që për një pjesë ishte kthyer në manjakëri. Pjesa tjetër krijonin më lehtësisht vargjet e tyre. Herë me vlera dhe herë pa vlera artistike dhe ideore, ata krijonin. Përkundër, shtërgu i fundit, në vitet '30, mbolli ndër lexues lëndën e tij poetike me materie nga jeta, e përjetësoi atë në koherencë. Më pas ai heshti gjatë, duke folur vetëm përmes veprës që shkroi.
Lasgush Poradecit më së miri mund t'i bësh pa problem analizë filologjike të poezive të tij, veçmas të atyre që vijnë në formë variantesh, prej të cilave, mund të ndërtosh një skemë përfundimtare të këtij rrugëtimi, që përmbyllet sukseshëm në veprën poetike, si pjesa më e mirë e saj.
Variantet lexohen dhe interpretohen nga shijimi personal dhe i lirë në gjykim i çdo lexuesi, qoftë ky implicit apo eksplicit. Hapi lasgushian është i ngjashëm pikë për pikë në këtë drejtim me mikun e tij shpirtëror, udhëheqësin letrar, Mihai Emineskun. Sikundër ai, edhe Lasgushi pëdor variantet për poezinë e tij, duke shenjuar kështu pika takimi mes tyre, njëherazi adhurim dhe respekt për vetë artin që poetët krijojnë.
Aspak plagjaturist, Lasgush Poradeci sjell në vëmendjen tonë përpjekjen titanike prej mjeshtëri krijues, në të bërit poezi shumë të mirë. Studioja prej shkrimtari kalit durimin dhe krijon iskra bukurie që mbajnë erë Shqipërie.
Të bësh art veçon Kuteli është punë e vështirë: *"Profesionizmi në letërsi, në vëndin tonë, është, hë për hë, një rrugë vuajtjesh, buka e tij është e hidhur. E hidhur, them, për atë që s'di marifete dhe hipokrizira. Terreni i letërsisë është një tokë tek gëlojnë gjarprinjtë. Të vrasin shokët, se ju bën hije. Dhe kur nuk u bën hije do të thotë se nuk je i zoti për letërsi"*.[562]
Me Lasgush Poradecin me sa duket funksionoi kjo e para. Heshtja poetike për të kuptuar se artisti nuk shkruan poezi të dobët dhe pa vlera të mirëfillta artistike. Koha e rrezikut kishte trokitur edhe në portën e kullës së tij krijuese. Mes miqsh prej kohësh ishte kuptuar kodi i heshtjes së poetit *fin* të fjalës shqipe.

[561] Po aty, fq. 7.
[562] M. Kuteli, *Testamenti i Mitrush Kutelit*, Gazetën "Shqip", Tiranë, 30 prill 2009, fq 20.

X. KAPITULLI I NËNTË

KUTELI, INTERTEKSTUALITETI I POETIT, LËQERI I KRISTOFORIDHIT

X.1. Dy qëndrimet e Kutelit për poezinë lasgushiane dhe intertekstualiteti i poetit

Mitrush Kuteli prezanton dy qëndrime kundërshtuese përballë artit poetik të Lasgush Poradecit. Në fillim ai nxit, boton, inkurajon dhe e mbron veprën letrare të poetit, ndërsa më pas e kritikon krijimtarinë e tij. Janë dy qëndrime të kundërta, që marrin kuptime në situata konkrete kohore. Le t'i shohim me radhë.

Kuteli së pari, lavdëron poezinë e Lasgush Poradecit me apologjinë, që i bën poetit poradecar, në fillimet e krijimtarisë së tij. Studimi i M. Kutelit mbi poezinë e Lasgushit, edhe sot e kësaj dite, mbetet shkollë më vete përsa i përket idesë së shkrimit të një punimi shkencor, të mirëfilltë kritik. Madje, ai e mbron nga Krist Maloki dhe akuza e tij, a është poet Lasgush Poradeci? *"Lasgushi nuk mund të quhet Poet në kuptimin e nalt të fjalës Dichter."*[563]

Kuteli reagon kundër kritikës së Malokit që kishte bërë për Lasgushin më 1937 e, si duket u nxit më shumë, kur këtë e ribotoi te gazeta "Shqipnija" më 1944. Këtu, Kuteli e vë në pah dallimin midis koncepteve të tij dhe të Malokit për kriterin kombëtar të vlerësimit të veprës letrare. Kështu, ai thekson se: *"Maloki ka një koncept etnografik për karakterin kombëtar të letërsisë, që dallohet prej tij, që merret me shpirtin kombëtar. Këtë e jep në formë tejet ironike"*.[564]

Për Malokin, studimi i Kutelit është i tejmbushur me gabime të natyrave të ndryshme: është shkruar me qëllime e mjete fare të papranueshme; janë shtrembëruar fakte; ka plot gabime dhe "përdhunime metodash shkencore".

Në vjershat e Lasgushit, sipas Kutelit *"nuk ka prodhime kulmesh, por si trajtë në to Poradeci punon bukur baltën e shqipes. Si përmbajtje ai tregon se di të dëgjojë, e di të na bëjë të ndjejmë dhe ne, së bashku me të, tingëllimat dhe bubullimat e brendëshme, të shpirtit*".[565] Vjershat, pre e këtij shkrimi, janë: *"Gremina"; "Engjëjt e parë"; "Durimi"; "Dh'u patmë nisur"; "Vasha me drapër"; "Trashëgimi"; "Tërë ditën në shtëpi"; "Faqet e dashurisë"*, apo *"O sytë e vashës sime";*

Mbrojtja kuteliane nuk mungon në asnjë rast për veprën letrare të poetit për shumë vjet, aq sa do të rezistojë edhe miqësia e pastër e tyre. Sipas Lasgushit, zënka, bëhet për arsye banale, për një muhabet mblesëror për motrën e Kutelit. *"Kur më la Dhimitraqi (Dhim Paskua) që më doli i pabesë (pa patur ay faj, se i futi intrigat e-motra Lirija-Jago femërore)"*.[566]

Fill me këtë zënkë, nge krye qëndrimi i dytë i Kutelit përballë poezisë lasgushiane. Ai nis dhe e qorton krijimtarinë e njeriut, të cilin e kishte promovuar dhe mbrojtur në fillesat e shkrimësisë. Në këtë pikë personale nis dyzimi i vlerësimit të Kutelit për poezinë lasgushiane. Që nga ky moment e quan Lasgushin "dekadent", ai që e kishte ngritur Lasgushin lart si poet (i pari që e krijoi për Lasgushin këtë epitet të famshëm). Madje, një shkodran, Zef Çezari, lidhur me disa poezi që Poradeci i botoi si përkthime, e quan në këtë kohë Lasgushin plagjiaturist të Gëtes dhe Novalisit. Paskua

---

[563] K. Maloki, *A asht poet Lasgush Poradeci?*, "Përpjekja Shqiptare", Nr. 18-26, Tiranë, 1938, fq. 31.
[564] M. Kuteli, *Poetë e detraktorë*, në: "Revista letrare", -Nr. 9, 1944, f. 1-4.
[565] M. Kuteli, *Shënime letrare, Vëllimi I*, Tiranë, 1944, f . 22-32.
[566] L. Poradeci, *Vepra IV, Korrespondencë Lasgush Poradeci-Mitrush Kuteli*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2010, fq. 200.

"zuri t'i shajë poezitë e mija të mëpastajme. Unë, si përgjigje, me që s'përgjigjem kurrë, as për lëvdatat as për sharjet, përdora një strategji, një mistifikim letrar. Përktheva poezi të Goethes dhe të Novalisi-it dhe i botova me nënëshkrimin "Lasgush Poradeci", pa mencionuar se janë përkthim. Paskua i shau edhe këto poezi të Goethes dhe Novalis-it. Domethënë ra në grackë, në grackën t'ime".[567]

Në këtë përballje ka dhe do të ketë zëra, se poezia e Lasgushit deri diku mbetet plagjiaturë e poezisë së idhullit të tij, rumunit Emenisku. *"Lidhjet e poezisë së L. Poradecit me poezinë e M. Emineskut in ka prekur i pari M. Kuteli. Ai tërheq vëmendjen edhe se kemi filluar të bëjmë një studim përmbi lidhjet e poetit tonë më kulturën rumune dhe kontigjentet e saja në veprën e Lasgushit... Nuk e dimë fatin e këtij studimi. I ka hulumtuar me hollësi këto lidhje edhe Vehbi Bala, në studimin e tij, në kapitullin "Lasgush Poradeci dhe poezia rumune.",* nënvizon Aurel Plasari.[568]

Akademik Kopi Kyçyku përmes shkrimeve të tij nënvizon prezencën e kësaj ngjashmërie në veprën poetike të L. Poradecit: *"Emenesku dhe Poradeci janë poetë të natyrës e të dashurisë. Në këto "treva letrare" bie në sy fare qartë se liriku shqiptar është ndikuar thellësisht nga ai rumun. Në një numur të madh poezish, Poradeci e merr si model Emineskun, me të cilin ishte lidhur shpirtërisht. Kështu, "Ku shtrohet vala", "Mërgim" , "Malli" , "Që larg" etj. janë shkruar në lidhje të drejtpërdrejtë me "De-a[avea" (Sikur të kisha), "Din str`in`tate" (Që jashtë vendit), "Speran]a" (Shpresa), "Dorin]a" (Dëshira)".*[569]

Ndërkaq, ideja e plagjiaturës në këtë rast zbehet përmes formës së intertekstualitetit. Vetë Lasgush Poradeci i shkruan në një letër Mitrush Kutelit, që është njëherazi edhe përgjigje për të: *"artisti i vërtetë s'pyet, QË KU e nxjerr lëndën brute të krijimeve të tija; ay pyet*: *A ka realizuar, prej kësaj lënde, një vepër ORIGJINALE, TË RE , TË FUQISHME, PLOT EKSPRESIVITET VETJAK? Imitim -relevojnë eruditët!; krijim i ri –relevon poeti! Krijim i ri prej lëndës së vjetër... Asnjë, nga gjithë veprat artsitike me jëtë të përbotshme, s'është origjinale; trupi i tyre është i huaj; vetëm SHPIRTIN s'ua disputon dot njeri".*[570]

Pra ndodh ajo që bën mjeshtri i madh murator gjatë ndërtimit të një objekti. Materialin e vjetër e ripërdor bashkë me lëndën e re. Brenda këtij konteksti, Lasgush Poradeci ndërton artin e tij magjik. Kuteli në këtë situatë shmang Emineskun dhe kupton gafën me kolosët e mëdhenj të artit botëror.

Ndërkaq Lasgushi e ka ditur dhe e ka realizuar me vetëdije të plotë ndikimin e tij nga Emenesku dashurinë e përjetshme poetike. Roland Bart, në interpertimin që i bënte tregimit *"Sarrazini"* të Balzakut, ngriti tezën e intertekstualitetit letrar. Sipas tij, *"të gjitha tekstet letrare janë të endura me fije të teksteve të tjera, jo në kuptimin konvencional. Teoria e intertekstualitetit e mohon pikëpamjen tradicionale për ndikimin si diçka e palejueshme ose si diçka që duhet fshehur nga lexuesi. Për botkuptimin postmodern, nuk ekziston "origjinaliteti" në letërsi; e gjithë letërsia është intertekstuale"*. Duke iu referuar edhe njëherë Bartit themi se *"nuk ka tekst të virgjer"* dhe se *"çdo tekst është thurrje e re e citateve nga e kaluara"*.[571]

Në kuadër të intertekstualizmit, në poezinë e Lasgush Poradecit gjithçka tingëllon e bukur dhe e magjishme. Pa pikë dyshimi themi, se ndikimi i Emineskut është i madh, madje edhe deri në krijimin pikë për pikë të termit *"variantë"*.

---

[567] Po aty, fq. 200-201.
[568] A. Plasari, *Letërsia dhe muret*, Enti botues "Zëri i Rinisë", Tiranë 1993, fq. 83.
[569] K. Kyçyku, Nga poezia rumune moderne, http://kkycyku.blogspot.com/2010_01_01_archive.html
[570] L. Poradeci , *Poezi et coetera…, Vepra 2*, "Onufri" Tiranë 1999, f. 13.
[571] A. Vinca, *Teori Letrare*, Shtëpia Botuese e librit Shkollor, Prishtinë 2012, fq 360-361.

"Krijimi i ri prej lëndës së vjetër" kjo është kredoja artistike e Lasgushit, vepra poetike e të cilit është një dialog i përhershëm me artin oral, me poezinë e Naimit, me Vedat indase, me idetë filozofike të Sokratit, me poezinë e Emineskut dhe poetëve të tjerë romantikë e paromantikë rumunë dhe europianë. Poemat e vona *"Kamadeva"* dhe *"Ekskursioni teologjik i Sokratit"* janë modele të teksteve poetike të krijuara mbi bazën e një "lënde të vjetër", praktikë që i karakterizon pothuajse të gjitha veprat artistike me *"jetë të përbotshme"*.[572]

Kuteli përmes vëzhgimit kritik, në fund të fundit e lartëson krijimtarinë letrare të Poradecit. Sipas tij *"përsa i përket stilit, Lasgushi largohet prej formës popullore shqipëtare duke tretur ndjesitë e tij në kallëpe të reja. Sendi i përbashkët i të dy pjesëve është freskëtija e ndjenjave që i këndon dhe qëndrimi thellësiht moral"*.[573]

Akademik Kyçyku nënvizon, se edhe Asdreni ngjyen në vargjet e Emineskut. *"Ndër poetët ballkanas, mbi të cilët Eminesku pati ndikimin më të prekshëm, përmendim në radhë të parë Asdrenin. Te ky i fundit ndjehet fuqishëm toni i poezisë sociale të Emineskut. Asdreni mbante në vend nderi, në bibliotekën vetjake veprat e plota të Emineskut. Poezia e tij ka qënë për mua libër jastëku shprehej Asdreni. Modeli emineskian i huazuar nga Asdreni është njëherazi social dhe etik"*.[574]

Nën ndikimin e Emineskut, Lasgush Poradeci e pasuroi fondin leksikor të gjuhës letrare shqipe, me terma e kuptime të reja sikurse vë në dukje studiuesja Luçia Xhamo-Diakonicë. *"Të tilla janë, bie fjala, mall, magji, dhemkë etj, për të cilat ka pasur një dobësi të veçantë, si të ishin fjalëçelësa edhe për rastin e Asdrenit, me domethënien dor, durere, farmec etc. Në poezinë e Lasgush Poradecit fjala mall nuk mbart vetëm kuptimin e dëshirës së fuqishme për të parë dikë apo diçka, por, si në gjuhën rumune, ka edhe kuptimin "të dashurosh, të vuash nga dashuria", por sidomos kumton edhe dëshirën, aspiratën, shpresën (kuptime polisemantike, që i ka të vetat gjuha poetike e Emineskut). Po nën ndikimin e poezisë emineskiane në krijimtarinë e Lasgush Poradecit termi magji e ka zgjeruar frymëmarrjen tematike duke nënkuptuar edhe çmësyshje, lidhje intime, ngazëllim, mrekullim, shkrehje çlodhëse, shijë qiellore, tundim, ngasje, cytje, bukuri, harmoni, kënaqësi"*.[575]

Një tjetër mendim që na vjen ndërmend jo në mënyrë naive, teksa arsyeton në kuadër të ndikimve të letërsisë botërore tek shkrimtari, është edhe fakti tjetër se Kuteli e Poradeci, ndërsa u pranguan nga personalitetet letrare rumune në shkrimet e tyre, nuk e dinin se një ditë globalizmi do e bënte të stërnjohur veprën e panteonit letrar rumun. Autorët e letërsisë rumune do vinte një ditë që të përktheheshin kudo. Disa tregime të Mitrush Kutelit kanë ngjashmëri të madhe në stil, me tekstet letrare të shkrimtarëve rumunë Mihail SADOVEANU apo Ion CREANGĂ, ky i fundit bashkëkohës i Emineskut. Atëherë nuk ishte e lehtë të identifikohej intertekstualiteti, ndërsa sot atmosfera globale e ka më të lehtë ta pasqyrojë këtë ngjashmëri, të mbajë qëndrim dhe të thotë të vërtetat që kohët i kishin lënë pezull për këta krijues.

Lasgush Poradeci ka njohur në detaje poezinë e Emineskut, Gëtes dhe Novalisit, nga të cilët ka marrë frymëzim në poezinë e tij. Ai, në lirikë merr edhe struktura të gatshme nga poezia popullore. (p.sh *"do të shtrydh si top dëbore"* e bën *"do të ngroh si top dëbore")*. Kemi të bëjmë me një strukturë krejt të re edhe pse në pikëpamje matematikore ruan më shumë elementë të së vjetrës. *"Strukturalistët gjurmojnë gjithashtu poetë që përparojnë në mënyrë drejtvizore, sipas një ideali të veçantë*

[572] A. Vinca, (po aty) fq. 357.
[573] M. Kuteli, *Shënime letrare*. Shtëpia Botuese "Grand Prind", Tiranë 2007, fq. 217.
[574] K. Kyçyku, *Nga poezia rumune moderne*. http://kkycyku.blogspot.com/2010_01_01_archive.html
[575] Po aty.

gjuhësor, e që kërkojnë çdo herë lidhjen më të mirë të elementëve të marrë nga një repertor statik e shumë të njohur".[576]
Brenda këtij ndikimi funksionon edhe njohja e mirë që Lasgush Poradeci kishte për veprën e Kostandin Kristoforidhit dhe përkthimet e tij.
Liqeni i Ohrit në Pogradec, i përjetësuar në poezinë lasgushiane, pasqyrohet në trajtën më të butë të tij, *liqer*. Këtë fjalë Lasgush Poradeci e ka marrë nga *"Dhiata e Re"*, përkthim i Kristoforidhit në dialektin toskërisht më 1879. I njëjti teksti ishte rishtypur nga Shoqëria Biblike, në Korçë më 1930, posaçërisht për Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. I jemi referuar, ribotimit të tij më 1995-së për të shpjeguar hershmërinë e fjalës *liqer*. Teksti shoqërohet me një parathënie nga Anastasi, Kryepeshkopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë.
Sinjalin e parë për këtë fjalë e jep Mitrush Kuteli te *"Vëzhgimi kritik"* kur thotë: *"Sa i përket mburimit disa nga fjalët e lashta të mësipërme të përdorura në glosarin poetik të Lasgushit janë marrë prej këngëve popullore dhe të tjerat prej shkrimve të vjetra të shqipes (Kupitori, Kristoforidhi etj.)."*[577] Llazar Gusho e njihte mirë veprën e Kostandin Kristoforidhit. Sqarojmë, se L. Poradeci i përkiste një familjeje të njohur poradecare, asaj të gushollarëve që përqafonte besimin ortodoks. Fryma dhe besimi fetar nuk do të mungojnë në rrugëtimin e afirmimit të Llazar Gushos, i cili jo vetëm që e ka lexuar *"Biblën"* përkthim të Kristoforidhit, por edhe e zotëron atë deri në detaje.

X.2. Interpretim filologjik mbi disa fjalë mbizotëruese në poezinë e L. Poradecit

Liqeni i Ohrit, pikturohet magjishëm përmes vargut poetik të L. Poradecit dhe ngulitet njëherë e përgjithmonë, si ngjyrë a gjendje, në memorien e lexuesve. Eshtë fjala për liqenin e Pogradecit apo liqenin e dritës, i cili mes lexuesve, përftohet në vargjet e Poradecit si hidronimi. Pothuaj në të gjithë poezinë e Lasgush Poradecit ai gjendet në trajtën *liqer*, trajtë tipike e toskërishtes.
Në tekstin biblik *"Dhiata e Re"* të përkthyer nga Kristoforidhi, fjala *lëqer*, saktësisht ekziston e shkruar shtatë herë. Sqarojmë se nuk është fjala për një gabim drejtshkrimor të përdorur në këtë tekst, sepse lëqer nuk gjendet vetëm një herë në të, por përsëritet disa herë. Del në format: *përanë lëqerit; së lëqerit; të lëqerit; dhe ndë lëqert* (katër herë) dhe tri herë e përsëritur, vetëm forma e fundit.[578] Ato janë të shkruara te *"Ungjilli pas Markut"* dhe *"Ungjilli pas Llukajt"*.
Liqeni është kryefjalë e poezisë lasgushiane apo thënë ndryshe emblema e artit letrar të tij. Në një farë mënyre, lexuesi kupton se Lasgushi e njeh mirë tekstin biblik të përkthyer të Kristoforidhit. Edhe në këtë rast Lasgushi e merr fjalën nga Kristoforidhi dhe zbaton artin e mjeshtrit ndërtues. Lëqer>liqer, shndërohet në fjalën më identifikuese të poezisë së tij. Lëqer>liqer është trajtë e asimiluar e ndikuar nga q (qiellzore). Në poezinë e L. Poradecit, gjuhësisht, kjo fjalë del rotacizuar, duke mbetur me afër formës poetike arkaike. Të bie më së shumti në sy ngjashmëria e *-n*-së së rotacizuar në *-r-*.
"Për ruajtjen e trajtës fonetike liqer, parapëlqimin e saj për arsye eufonike, mund të marrim në konsideratë dhe një fakt tjetër. Në tekstin lasgushian hasim dhe fjalë të tjera me -r- ndër zanore, psh. "ku ke rarë" për "ku ke rënë". Marrim shkas prej këtij

[576] S. Çapaliku, *Letërsia e interpretuar*, Shtëpia Botuese "ARBRI", Tiranë 1998, fq. 64.
[577] M. Kuteli, *Shënime letrare*, Shtëpia Botuese "Grand Prind", Tiranë 2007, fq. 82.
[578] *Dhiata e Re e Zotit dhe Shpëtimtarit t'ënë Jusu Krisht Kthyerë prej Elinishtesë Shqip ndë të folë Toskërisht.* Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, Tiranë, 1994, fq. 177; 193-194; 759.

rasti se poeti e ka shijuar së tepërmi tingëllimin e bashktingullores dridhëse -r- në pozicion ndërzanor".[579]
Ndërkaq, trajta liqer përdoret në të folmen e Arbëreshëve të Italisë si dhe në të folmen e malësisë së Mokrës, në rrethin e Pogradecit. Edhe këtu ka vepruar rotacizmi**, sikurse në fjalët e fondit të trashëguar apo në huazimet e vjetra të shqipes. Këto janë trajta tipike toske që i përshtaten tekstit. Sipas Kolec Topallit ky rotacizëm ka vepruar në fazën e zhvillimit historik të shqipes për shkak të vendosjes së fjalës në trajtën e shquar (shfaqet rregullisht në trajtën e shquar të këtyre fjalëve).
A mund të aludojmë për një shfrytëzim të fjalorit të Kristoforidhit nga Poradeci?
E mbështesim këtë bindje edhe në fjalë të tjera që Lasgushi poet ka marrë nga *"Dhiata e Re"* si: *Zot; Perëndi; yj-yjtë; lundra; bubullimat; shqiponja; ay; ravvi; bunacë; kënkë e pleqvet; dyke; pëlhurë*[580] etj.
Konkretisht *ay, kënkë, pleqvet, dyke, pëlhurë* janë dukuri dialektore tipike toske. Interesant është edhe fakti i shkrimit të fjalëve me vizë ndarëse, i rimarrë nga teksti i Kostandin Kristoforidhit: *i-cili; të-dukurit'; së-vdekurish, i-dashurisë;* etj.[581]
Në këtë kuadër pohojmë se Lasgush Poradeci, e ka njohur mirë tekstin e përkthyer, teknikën e përkthimit të Kristoforidhit dhe leksikun e përdorur, veçori të cilat, i ndërthur në poezitë e tij dhe i vulos me firmën e pavdeksisë. Gjithçka sendërtohet më së miri në vargje. Sipas Kutelit, Lasgushi është poeti shqiptar që mendon, flet dhe shkruan vetëm shqip.

Përfundime:

Pyetja që çdo kush shtron është, nëse ka të drejtë Kuteli apo Lasgushi?
Më saktë është dekadente dhe plagjiaturiste poezia e Lasgushit?
Në fillim është mburur fort për poezinë e tij nga M. Kuteli dhe më pas është akuzuar si plagjiaturë e Emineskut, Gëtes dhe Novalisit.
Populli thotë se asgjë nuk merr jetë nga asgjëja ose më saktë, asgjë nuk lind prej hiçit. Konkretisht, teoria e intertekstualitetit nxjerr nga loja nocionin e ndikimit letrar si kategori të kompromentuar, nga shkenaca tradicionale pozitiviste dhe relativizon konceptin e origjinalitetit ose thënë shkurt e ripërkufizon atë. Mishel Montenji, eseist frëng, thotë se ne nuk bëjmë tjetër, veçse interpretojmë njëri-tjetrin.
Nisur nga këto dy qëndrime të Kutelit, pikë së pari të përforcohet ideja se poezitë e Lasgushit mbeten madhështore, mbetet e merituar mbrojtja, që Kuteli u bën fillesave të krijimtarisë së poetit, ndërsa nuk do komentim ndryshimi mëvonshëm i vlerësimit poetik. Nisur nga një inat i çastit M. Kuteli prodhoi dy qëndrime për poezinë lirike të Poradecit, ku i dyti del bllof. Automatikisht mbetet vetëm mendimi i parë dhe i patjetërsueshëm i Mitrush Kutelit për L. Poradecin dhe poezinë e tij.
Ky kapitull bën edhe një interpretim filologjik mbi disa fjalë mbizotëruese në poezinë e L. Poradecit, ku përveçojmë lëqerin e përdorur nga Kristoforidhi, plot shtatë herë në "Dhiatën e Vjetër", fjalë të cilën L. Poradeci e huazon duke e shndërruar në liqer.

---

[579] L. Topçiu, *Tekstualizëm dhe stil*, "Getic", Bukuresht, 2000, fq. 171.
** Rotacizmi është kthimi i bashtingullores */n/* në */r/* në pozicion ndërzanor, një dukuri e rregullt kjo e toskërishtes, që ka funksionuar në një periudhë të hershme. (Kolec Topalli. Fonetika historike e gjuhës shqipe. Shtëpia botuese Dituria, Tiranë, 2007).
[580] Dhiata e Re e Zotit dhe Shpëtimtarit t'ënë Jusu Krisht Kthyerë prej Elinishtesë Shqip ndë të folë Toskërisht. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, Tiranë, 1994, fq.159; 193; 266; 446; 684; 717; 717-718; 724; 732; 736; 693; 743; 753.
[581] Po aty, fq. 126-127.

XI. KAPITULLI I DHJETË

LASGUSHI DHE LEXUESI I "DETYRUAR"

XI.1. Poezia e Lasgush Poradecit në sistemin parauniversitar, atë universitar shqiptar dhe çështje të tjera sqaruese

Duke filluar nga viti 1941, e më pas në sistemin parauniversitar dhe atë universitar shqiptar, Lasgush Poradeci ka pasur lexuesin e tij të "detyruar", lexues që e ka mësuar veprën e tij letrare në shkolla të kohës.

Kanoni është thelbësisht problem skolastik, çështje që lidhet me planet edukative, arsimore të çdo niveli. *"Libri klasik-libri kanonik-posejdon të drejtën supreme të gjenerojë në mënyrë reciproke një dialog pyetje-përgjigje. Me të shkuarën e të ardhmen me lexuesit e çdo kohe. Mësimi i letërsisë nuk është thjesht transmetimi i njohurive, po një mundësi e mirë për të vendosur një dialog mes gjinive të së kaluarës dhe atyre të së sotmes".*[582] Harold Bloom sqaron se *"formimi i kanonit nuk është proces arbitrar, poetët mbijetojnë jo për hir të përzgjedhjes së kritikëve ose të profesorëve, por prej forcës së tyre të brendshme, në aftësinë e tyre për ti transmetuar lexuesit e brezave emocione intensive. Forca e kanonikes* -thotë Bloom, *manifestohet në atë heshtjen këmbëngulëse (të vazhdueshme) të shkrimtarëve të fuqishëm. Ata janë të pakontestueshëm".*[583]

(Për këtë le të shohim më poshtë bibliografinë e jetës dhe veprës së Lasgush Poradecit në tekste shkollore dhe universitare, entet botuese dhe vitet e botimit).

Së pari, ky lexues është prezantuar me një botim për shkrimtarët shqiptarë, i cili përfshinte edhe Lasgushin, tekst që përmblidhte kursin e lartë, klasa e tretë dhe e katërt, një botimi i Ministrisë së Arsimit, Tiranë, 1941. Botimi i dytë, përmban një shënim autobiografik të Poradecit. Të dhënat plotësuese shënojnë vitin e lindjes së Lasgush Poradecit. Në trajtimin që i bëhet jetës dhe veprës letrare të poetit informacioni është i plotë dhe i paanshëm. Ky tekst publikohet që në gjallje të lirikut pogradecar. Nëpër shkollat e vendit ai mësohej përmes këtij teksti ku lexuesit informoheshin edhe për ekzistencën e poetit.

Një trajtesë më të kuruar për jetën dhe veprën letrare të L. Poradecit bën teksti *"Historia e Letërsisë Shqipe"*, për shkolla të mesme. Aty, ndër të tjera, tregohet për rrethanat jetësore nëpër të cilat u përshkrua edukimi ideoartistik që poeti mori nga mjedisi pogradecar dhe më pas prej shkollash të ndryshme, nga poezia e popullore folklorike e trevës si edhe nga letërsitë e huaja, sidomos ajo rumune dhe gjermane, vende ku ai studioi.

Tekstet teorike dhe antologjike mbartin në vetvete një ndërdyzje: elementin promovues të autorit si poet kombëtar shqiptar dhe rritjen e vlerës së shkollës shqiptare. Këto tekste e udhëheqin lexuesin drejt përfundimit se letërsia shqipe tashmë vështrohet si letërsi tradicionale, padyshim plot me vlera antologjike, por edhe me vlera të mëdha artistike, veçmas duke përmendur këtë autor edhe si një vlerë mbarëkombëtare.

Prej vitit 1941 deri në vitin 2011, kemi ndërfutjen e jetës dhe veprës letrare të L. Poradecit mes kapitujsh të ndryshëm tekstesh të botuar nga Ministria e Arsimit dhe më pas nga Instituti i Lartë Pedagogjik, Akademia e Shkencave të Republikës

[582] U. Motta, *Il canone letterario e il ruolo della scuola*, Linea Tempo, Rivista online di ricerca storica letteratura e arte - n. 10/2009

[583] Po aty.

Popullore Socialiste të Shqipërisë, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë së Universitetit Shtetëror të Tiranës, Instituti i Historisë e Gjuhësisë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë së Universitetit Shtetëror të Tiranës, Drejtoria e Botimeve Shkollore, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor dhe së fundmi edhe nga shtëpi botuese private.
Saktësisht, në fillim janë botuar 4 tekste shkollore që përmbajnë poezi të Lasgushit dhe japin të dhëna për jetën dhe veprën letrare të poetit, prej tyre vetëm një antologji poetike, ndërsa po të shtyhemi në kohë, në edicionin e teksteve alternative, veç shtëpisë botuese të librit shkollor dhe shtëpive botuese private konkurrente në treg, në periudhën mes viteve 1997-2011, u botuan 35 tekste shkollore që përmbajnë ndër vete poezi të ndryshme të publikuara në programet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
Në periudhën e viteve 1941-1990 janë botuar dhjetëra tekste shkollore për arsimim 8-vjeçar dhe të mesëm, që përmbanin poezi të Lasgush Poradecit. Vitet '41 pasohen me ato të 1955-ës, 1956-ës, 1959-ës dhe 1968-ës. Më pas kemi edhe disa poezi të botuara në leximin letrar të klasave të teta të ciklit 8-vjeçar. Prej vitit 1992 deri në vitin 2011 botohen edhe mjaft tekste të tjera shkollore. Duhen përmendur këtu gjithashtu dy botime të bëra në atë kohë, në Prishtinë nga Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK. Përmes tyre vjen e ribotuar ajo pjesë që flet për jetën dhe veprën letrare të Lasgushit.
Më 1991-in, në Shkup të Maqedonisë kemi një botim të ilustruar për shkollarë. Tirazhi i këtyre botimeve ka qenë i ndryshëm për çdo vit kalendarik. Këtë e dëshmojnë shënimet në fund të teksteve mësimore.
Në vitin 1941 broshurat e para shkollore u botuan në tirazh 2000 ekzemplarë, ndërsa botimet e mëvonshme me një tirazh më të madh i cili realizohej në varësi të poltikave që ndiqte shteti shqiptar diktatorial. Tirazhi i veprave të pas 1990-s vjen në rritje të dukshme, por që në mjaft raste nuk publikohen në CIP (katalogimi i Bibliotekës Kombëtare) Tiranë, për arsye të ndryshme taksash tatimore, që shtëpi botuese private ndjekin, për të shmangur pagesën në shtet. Përmendim antologjinë e vitit 1996, tirazhi i së cilës shkonë në 26 mijë kopje.
Tekste të tjera shkollore kapin tirazh edhe më të madh, duke shkuar në 65 mijë kopje në një vit të vetëm shkollor. Ato janë të miratuara nga MASH (shënim që gjendet në faqen 3 të tyre) dhe prezantojnë përmbajtje shkencore si edhe një mënyrë interesante grafike dhe ilustruese, jo të lodhshme për nxënësit e nivelit parauniversitar dhe atij universitar në vend. Të bie në sy integrimi konceptual, i cili lidhet me dosmosdoshmërinë për të realizuar një njehsim të gjithë teksteve në mënyrë të natyrshme, logjike, shkencore dhe didaktike. Tekstet kanë gjithashtu fotografi bardhë e zi të Lasgush Poradecit, herë në moshë të re dhe herë në moshën e tij të thyer, pleqërinë e vonë. Ndërkaq, aparati pedagogjik përbëhet nga kërkesa të tipit: Kuptimi dhe motivimi i poezisë; Interpretimi dhe vlerësimi i saj; Gjuha dhe stili; Detyra shtëpie; Ato jepen zakonisht për nxënësit e sistemit parauniversitar shqiptar.
Duhet theksuar se botimet e viteve të fundit kanë ardhur duke përmirësuar teknikat e shtypshkrimit të teksteve te shkollore. Ato realizohen më saktë, më këndshëm estetikisht për syrin, përmes ilustrimesh me ngjyra (vetëm botimet shkollore "Albas" arrijnë në 34 syresh gjatë kësaj kohe).
Nga viti 1945 deri në vitin 1990 pushteti diktatorial aplikon masa shpërfillëse për një pjesë të mirë autorësh shqiptarë, të cilët ishin anatemuar nga sistemi. Veprës së tyre letrare u mohohej e drejta e leximit dhe studimit nga lexuesi shqiptar apo përfshirja në tekste shkollore të kohës. Pra, bëhet fjalë për autorë si: Martin Camaj, Sejfulla Malëshova, Arshi Pipa, Kasëm Trebeshina etj., që e rifituan lexuesin e tyre vetëm pas viteve 90-të të shekullit XX.

Kjo, kurrsesi nuk ndodhi me Lasgush Poradecin. Emri dhe poezia e tij kanë dritë-hije ndër vite. Në këto tekste mësimore, në periudhën e administrimit monist të librave shkollore janë publikuar duke shtuar të dhëna për autorë të tjerë më pak të rëndësishëm, por shumë të angazhuar në artin e tyre propagandistik. Krijimtaria e tyre parrullë u brohorit atëherë, por në ditët tona mbeti në harrim. Arti i angazhuar atëkohë, është shpërfilluar në mijëvjeçarin e ri.

Kështu ka ndodhur edhe me kujtesën e lexuesit të "detyruar", e cila preku përmes teksteve shkollore autorët më të dashur, njëherazi të urryer nga sistemit komunist. Ata kanë munguar në këto botime. Fishta, Koliqi, Konica, Harapi e Pëllumi e dëshmojnë këtë fakt. Në përgjithësi, tematika e poezisë së viteve, '50 të shekullit XX, është e dobët emocionalisht. Ajo sillet rreth disa temave që më tepër ishin direktiva partie, sesa ndiqnin rritmin dhe thelbin e jetës, të individit dhe të vetë shoqërisë së asaj kohe. Temat e mëdha të revolucionit, të partisë dhe shndërrimeve socialiste në fshat dhe qytet zbërtheheshin në motive të kohës socrealiste.

Në vitet 1980 të shekullit XX, kur Letërsia e Realizmit Socialist zhvillonte një praktikë të konsiderueshme dhe ishte shpallur letërsi zyrtare, studiuesit e saj mendonin se pjesë e pandarë e procesit të përgjithshëm të ngritjes së rendit socialist ishte edhe formimi i një letërsie të re. Kjo detyrë që shtronte Partia e Punës së Shqipërisë përcaktoi gjithë rrugën e zhvillimit të letërsisë shqiptare të pasçlirimit, e cila pasqyroi shndërrimet e realizuara në jetën e vendit komunist, ndërsa ndihmoi me mjetet e veta në luftën për ndërtimin të "shoqërisë së re". *"Për arsye politike dhe ideologjike, poezia e L. Poradecit mbeti e pastudiuar, e injoruar dhe e keqinterpretuar, e veshur me mister dhe me rrezik, në ribotimet e kësaj poezie u hoqën një numër i madh poezish, strofash, vargjesh, redaktorët ndërhynin deri aty sa ta kthenin gjuhën në normë letrare* (shohim për këtë shembullin yjve-yjeve) *sipas rregullave të drejtshkrimit, duke maskuar kështu përmbajtjen, formën muzikalitetin, magjinë, sugjestivitetin, unitetin e veprës, karakterin sistematik të saj".* [584]

"Historia e Letërsisë Shqiptare", për shkollat e mesme, një botim i vitit 1985 dhe ribotim i vitit 1987, emrin e Lasgush Poradecit në kapitullin "*Hyrje në Letërsinë Shqiptare të Pavarësisë"*, e përmend vetëm tri herë. Ka edhe një vështrim mbi jetën dhe veprën letrare të Poradecit, gjithashtu nga faqja 191 deri 195.

Ismail Kadare vëren se në këto tekste pasqyrohej një krizë e ndjeshme morale, pavarësisht nga optimizmi i tyre i jashtëm. Sipas tij, *"në emër të një liberalizimi të tepëruar janë futur në tekstet tona shkollore, madje të reklamuar ndonjëherë si disidentë, bashkëpuntorë të sugurimit, e që kanë qenë vrasës të pështirë, nga ata me plumb pas koke".*[585]

Në "*Antologjinë e Letërsisë Shqiptare 2"*, botim i vitit 1979 dhe një ribotim i vitit 1988, emri i poetit Lasgush Poradeci nuk përmendet asnjëherë. Madje vërejmë se nuk përmendet as emri i Dhimitër Paskos (Mitrush Kuteli). Ndër shumë përfaqësues të brezit të tij të viteve '30, përfshihen Dionis Bubani, Llazar Siliqi, Spiro Çomora, Vehbi Bala, Zihni Sako etj. Poradeci e Kuteli nuk ekzistojnë as në kapitullin e poemave, ku spikasin Vehbi Bala, Zihni Sako, Aleks Çaçi, Kolë Jakova, Llazar Siliqi etj.

Ndër ta nuk përfshihet Lasgush Poradeci. Ai qëllimshën nuk është futur në antologji nga autorët përzgjedhës. Me sa duket u rujat fryma politike në gjithë hallkat përbërse të botimit, duke e cilësuar atë botim që në faqen 5, *"Letërsi e Realizmit Socialist"*. Mesa duket poeti i liqerit të Pogradecit, nuk ishte i njëllojtë me pjesën tjetër të

[584] L. Topçiu, *Tekstualizëm dhe stil*, "Getic", Bukuresht, 2000, f. 10.

[585] I. Kadare, *Në tekstet e letërsisë, njerëz të sigurimit*, Gazeta "Panorama", 10 tetor 2013, f. 21.

sivëllezërve poetë. Si një emër që lëshon hije ndër ta, enkas Lasgushi nuk përmendet asnjëherë në të gjithë botimin. Kapitujt e emërtuar *Letërsi e periudhës së Rindërtimit dhe të Ndërtimit Socialist të Vendit 1. Poezi dhe 2. Poema (fragmente)*, nuk e përfshijnë lexim të detyruar, poezinë e Lasgush Poradecit.

Në këtë antologji poetike nuk mungojnë emrat politizuar të diktaturës, si: Shefqet Peçi, Shevqet Musaraj, Fatmir Gjata, Spiro Dede, Anastas Kondo e Dalan Shapllo. Këtyre vitesh poezia e Lasgushit cilësohet e vështirë për kritikët e vendit, herë moderniste, herë hermetiko-fetare etj., në të cilën nuk ekzistonte socrealizmi.

Lasgush Poradeci dhe prezenca e tij ka ulje-ngritje në historinë e teksteve të shkollore apo antologjitë poetike të atyre viteve si në arsimin 8-vjeçar dhe në atë të mesëm. Gjithsesi ekziston kujtesa e lexuesit (nxënës) nëpër kohë dhe hapësira të caktuara (brenda dhe jashtë vendit tonë), kujtesë e cila na dëshmon se tekstet shkollore të shtypura, librat e dikurshëm kanë rëndësi të madhe në ndriçimin e jetëshkrimit të shkrimtarit si pjesë e vlerave kombëtare.

Në këtë vështrim, historia e prezencës së jetës dhe veprës letrare të Lasgushit përmes teksteve shkollore në Shqipëri dhe Kosovë, është zhvilluar përbrenda konteksteve të ndryshme shoqërore e politike, jo rrallë, është fshirë fare. Heshtja dhe indiferenca u zgjodhën atëherë si mjete për asgjësimin e vlerës poetike të Poradecit. Nga ana tjetër thënia popullore *"Dielli nuk mund të mbulohet me shoshë"*, i rri shumë mirë veshje kostumit poetik të Lasgush Poradecit.

Lexuesit u rritën me poezinë e tij, edhe kur ajo në tekstet shkollore vetëm sa shenjohej pak ose aspak. Atëherë shfaqej shumë pak, ndërsa sot, shumë përmasore. Trajtimi që i bëhet Lasgushit në tekstet shkollore të programuara nga MAS, sërish, sipas një plani kalendarik vjetor botimesh mbetet në këtë aspekt emblema më e përfolur e kohëve nën diktaturë, por edhe pas diktature. Dikur i mbështjellë me mjergull harrimi, ndërsa sot është ngritur në piedestalin vlerë të kohës sonë. Shteti dhe shoqëria vrapojnë të korrigjojë gabimet e së shkuarës më shpejtësi për të korrigjuar pseudovlerat letrare. *"Qesharake, koha e humbur dhe e pikëlluar, tallet përpara e pas nesh"*.[586]

Me një mirëllogaritje, teksti mësimor i vitit 1950 sjell pesë poezi të Lasgushit, ai i 1958-ës sjell katër, 1964-ës sjell po katër, i viteve 1965-1973 sjell një, i vitit 1974 sjell dhjetë poezi, teksti i viteve 1984-1987 sjell një, edhe ai i 1986-ës ka gjithashtu një, tekstet e 1987, 1988, 1989 sjellin vetëm dy poezi, teksti i viteve 1990-1994 një poezi, ato të viteve 1995-1996 vetëm nëntë. Viti 1999 sjell 15 poezi. Vitet 2000-2002, prezantojnë pesë poezi, 2003-shi sjell katër, 2004-tra dy, 2005-2010 publikojnë vetëm një poezi të botuar, ndonjëhre edhe dy të tilla. 2011-ta sjell gjashtë, 2012-ta, tri poezi. Të gjitha këto botime ndër vite, janë tekste shkollore të arsimit 8-vjeçar, 9-vjeçar dhe atij të mesëm (gjimnaz). Në vitin 2009 botohet doktoratura, tekst që vazhdon të përdoret i plotë si literaturë në orët akademike universitare. "*Eminesku i ignoruar dhe ideologjia e tij popullore-vendase*", botimi i shtëpisë botuese Argeta LMG.

Jeta dhe vepra letrare e Lasgush Poradecit deri tani nuk është përfshirë në letërsinë e avancuar që aplikohet për të tretin vit pranë gjimnazeve tona. Nxënësit në këtë program mësimor studiojnë vetëm dy autorë gjatë gjithë vitit shkollor. Mbase në klasën e 12-të hartuesit e këtij programi shkollor mund ta përfshijnë plotësisht studimin e Lasgush Poradecit.

Lexuesit e detyruar të shkollave të arsimit parauniversitar studiojnë krijimtarinë letrare të Poradecit, ndërsa shijojnë vlerat artistike dhe estetike të saj. Informacioni i detyruar arrin të përcillet më së miri te nxënësit, të cilët e pëlqejnë magjinë poetike të

[586] T. Eliot, *Katër kuartetet, Kënga e V* (Ajri dhe pranvera), në librin: *Letërsia Botërore 4*, Tiranë, "Shblsh" 2000, fq. 141.

krijuar nga Lasgush Poradeci. Gjithsesi, duhet ritheksuar që autori i cili e përjetësoi liqenin e Ohrit në letërsinë shqiptare, mbetet emblema më e lexuar nga breza e breza të tërë, të cilët dinë pafundësi vargjesh nga krijimtaria letrare e Lasgush Poradecit. (shohim përgjigjet e pyetësorit në kapitullin e fundit të punimit tonë).

Lexuesit e sotëm të sistemit parauniversitar në Shqipëri, janë me fat që e studiojnë të plotë krijimtarinë e Poradecit në shkollat e tyre. Lexuesi i "detyruar" nëpër shkolla mëson zellshëm mbi jetën dhe veprën letrare të shtërgut fundor, i cili i fton të gjithë lexuesit në gjoksin e hapur të tij, në gjirin e vetë veprës poetike. "Çelësi i letërsisë" ka qenë një botim pothuajse i përvitshëm për nxënësit e cilklit 9-vjeçar dhe atij gjimnaz. Botuesit kujdesshëm, trajtojnë të gjithë autorët që përfshihen në pyetjet e provimit i cili relizohet me shkrim, në kuadër të provimeve të lirimit dhe maturës shtetërore.

Botimet e shtëpisë botuese "Albas" janë më të përzgjedhurat ndër altertekstet e hedhura në treg për përdorim të nxënësve, që në rastin konkret mbeten edhe më cilësorët. Në më të shumtën e rasteve poezia e Lasgush Poradecit, është e futur në antologjitë poetike dhe kërkohet nga hartuesit e tyre të mësohet përmendësh nga nxënësit. Vetëm në pesë raste, poezitë shoqërohen me fotografi të Lasgush Poradecit. Në dy raste, janë foto të Lasgushit të ri dhe në tre të tillë, të Poradecit poet në pleqërinë e thellë. Janë përdorur edhe ilustrime me ngjyra, skica të portretit bardh e zi apo tablo, që i ka realizuar piktori i merituar pogradecar, Anastas Kostandini. Ilustrimet janë përzgjedhur veçanërisht nga shtëpia botuese "Albas" pas viteve 2000 e këtej. Ndërkaq, duhet të kujtojmë që lexuesi vazhdon të preferojë, të prekë dhe të kërkojë veprën poetike të Lasgushit. Të bie në sy fakti, që në shumicën e rasteve të botimeve antologjike, vepra poetike e Lasgush Poradecit para viteve '90 është botuar përmes një ose dy poezish. Vetëm pas viteve '90 vepra letrare e Lasgushit shfaqet e botuar nën më shumë se dy poezi, madje deri në nëntë dhe pesëmbëdhjetë të tilla. Të dhënat statistikore tregojnë se poezia e L. Poradecit është përzgjedhur nga hartuesit e teksteve shkollore, përmes dy librave të dikurshëm të tij me poezi, *"Vallja e yjve"* dhe *"Ylli i zemrës"*.

Në fakt, të bën përshtypje se si në të gjitha tekstet shkollore të pas viteve '70 ka një dukuri ose me saktë një "lapsus" në prezantimin e poezisë "*Vallja e Yjve"*. Në të gjitha tekstet mësimore poezia vjen në normën letrare. Ajo shkruhet "*Vallja e Yjeve"*. Paraqitja e kësaj poezie në këtë formë botimi është një "shtrembërim" nga të gjitha entet botuese në Shqipëri.

Deformimi është i dukshëm për lexuesin, sepse mendia e tij e ka të ngulitur versionin jo letrar, nga vetë titulli i vëllimit të parë poetik i poetit liqerian. T'i mësosh gabim lexuesit të çdo kohe titullin origjinal të kësaj poezie, do të thotë që me dashje t'i mësosh atij të tjetërsuar edhe titullin e librit të parë poetik të Lasgush Poradecit. "*Vallja e yjve",* sikurse në origjinal, duhet shkruar i tillë e nuk duhet mësuar aspak gabim. Në gjë nëse mësohet e gabuar, e tillë rrënjoset përjetësisht në kujtesën e brezave dhe në mënyrë mekanike bëjnë formim të gabuar.

Le të dalemi te dukuria e ndryshimit të titullit ose fjalëve të tjera në poezitë e Lasgushi Poradecit. Ana letrare nga pikëpamja e origjinalitetit të poetit në këto tekste mësimore është shkelur, madje duhet thënë edhe origjinaliteti i formës poetike. Forma origjinale e titullit të poezisë "*Vallja e Yjve"*, por edhe e vetë titullit të njëjtë, të vëllimit poetik të Lasgushit vjen e ndryshme. Kjo bën që lexuesit e poezisë dhe gjithë veprës poetike në tërësi të mos gjejnë afërsinë e formës së parë poetike të botimit të parë të vëllimit.

Kjo bën gjithashtu të mos gjejnë më ndjeshmërinë, familjarizimin dhe estetikën e origjinalit. Këto të gjitha përcillen përmes leximit të parë, të poezisë, e cila të jep po asosacionin e parë mbresëlënës. Ndërkaq, nga ana gjuhësore ndryshimet lidhen me

standardizimin e gjuhës shqipe, e cila përkundrejt dy formave të shumësit të shqipes *yj* dhe *yje*, ngre në normë letrare të dytën.

***

Në të folme dialektore, forma e të shquarës shumës **yjet**, ndeshet në formën **yjtë**.

Arsyet e kësaj forme përdorimi mund të lidhen me disa elementë:

- Prapashtesën ***-të***. Kjo prapashtesë mund ta ketë origjinën në nyjën ***/-të /*** të shumësit në rasat emërore e kallëzore, por nga një formë e hershme **-të** e cila përdorej edhe si nyjë e përparme edhe si nyjë e prapme me të njëjtën formë.[587] (Sot / **të /** nyjë e përparme dhe **/ t /** nyjë e prapme: male**të** > male**t**). Sipas zhvillimit historik fonetik kjo nyjë e ka origjinën nga përemri dëftor **ta** (**ata, këta**) shndërruar në **të** si nyjë. Pra forma **yjtë** mund të jetë formuar duke i prapavendosur formës **yj** (njëra nga format e shumësit të fjalës **yll)**, nyjën e numrit shumës **-të.** Pra **yj + të > yjtë.**
- Asnjëanësin me **-të** në fund të fjalës në faza të hershme të shqipes së dokumentuar. Përdorime të tilla në gjuhën shqipe kanë qenë deri vonë, madje deri në ditët tona në të folme të caktuara. Që në kohën e Buzukut asnjëanësit e tipave të ndryshëm ndeshen me këtë prapashtesë (te Buzuku: *ujëtë, drithëtë, barkëtë;* te Budi: *anëtë, mishtë, mjaltëtë, plehëtë*... -të kaluar sot në gjininë mashkullore.) etj.[588]
- Prapashtesa trajtëformuese **-të,** e shumësit ndeshet edhe tek emra të tjerë të cilët nga gjinia asnjëanëse kanë kaluar në gjininë mashkullore, p.sh. të tipit: *sy-sytë; veshë-veshët*ë (veshët); *gji-gjitë; krahë-krahët*ë (krahët).

Mbështetur në këto përdorime, prapashtesa trajtëformuese **-të,** e cila në fakt edhe në këto raste, në origjinë i përket nyjës së prapme, mund të ketë mbetur si formë rudimentare në të folme të ndryshme, *për arsye të ligjërimit bisedor* edhe tek emra të tjerë, pavarësisht se nuk kanë qenë asnjëanës nga kuptimi, por ndoshta nga forma (siç është rasti i fjalës *yll*, konkretisht formës së shumësit **yj + të – yjtë**).

Nyja e prapme *-të*, e cila ka pasur një rol konservues, ka dhënë prapashtesën ***/ -të /*** të shumësit, e cila mund të jetë shtrirë edhe në fjalë të tjera, për analogji, të cilat nuk i përkisnin këtij grupi (emrave asnjëanës). (Bëjmë një vërejtje në këtë pikë që asnjëanësit, në këtë formë, kryesisht janë huazime më së shumti të latinishtes. Fjala **yll**, është fjalë e fondit autokton të trashëguar në gjuhën shqipe).

Duhet përveçuar njëherazi se shqipja standarde i pranon të dyja format e shumësit të emrit *yll*, megjithëse kjo poezi është shkruar para vendosjes përfundimtare të rregullave të drejtshkrimt të gjuhës shqipe të vitit 1972. Redaktimi dhe korrektimi i saj mbeten tjetër gjë në tekstet shkollore, pasi janë bërë të shtyra në kohë. Këtu shtrohet pyetja përse te Lasgushi kemi ndryshim të fjalës a fjalëve origjinale dhe te Gjergj Fishta, rasti e thekson se është ruajtur forma dialektore e krijimeve të tij? Mbase ka ardhur koha që në një ribotim të veprës letrare të Lasgush Poradecit nëpër shkolla, gjithçka të ndreqet në kuadrin origjinal të librave të parë poetikë të autorit.

Meqenëse fjala ***yll*** është fjalë e fondit të trashëguar, mund të bëjmë edhe një vërejtje tjetër. Dihet se ashtu si në shumë gjuhë të tjera edhe në shqipe, fillimisht nuk ka pasur formante të veçantë për numrin shumës. Kuptimin e numrit e shprehnin mbaresat rasore të veçanta. Kështu për analogji me emrat asnjëanës, ku në paradigmën e lakimit të këtyre emrave, në trajtën e shquar nyja e dikurshme e rrjedhores -së, është njehsuar me trajtën e përgjithshme -të / -t të kallëzores, për analogji mund të jetë shtrirë edhe tek emra të tjerë jo asnjëanës.[589]

---

[587] K. Topalli, *Bazat e gramatikës historike të gjuhës shqipe. Format e nyjave dhe burimet e tyre*, "ShBLU", Tiranë 2011, f. 89-94.

[588] Sh. Demiraj, *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972, f.176-177.

[589] Sh. Demiraj, *Fonologjia e gjuhës shqipe*, 1996, fq.172.

Në këtë rast vështirësia që krijohet nga ndeshja e bashtingëlloreve në eptimin e fjalëve, mund të shmanget me ndërhyrjen e një zanoreje, që është quajtur nga greqishtja anaptiks. Zanorja *e* shtuar në këtë rast luan të njëjtin rol si bashtingëlloret që zhdukin hiatin. Fonemat që përdoren për këtë qëllim, janë zanoret -ë- dhe -i-, kështu mund të jetë përftuar yjve[590]

Por forma yjve vjen edhe në ligjërimin bisedor. Këtë e shpjegon sinkopa me të cilën kuptojmë, rënien e një tingulli ose një grupi tingujsh në trup të fjalës. Edhe sinkopa është karakteristikë e ligjërimit bisedor. Por disa fjalë të përbëra, që përdoren në gjuhën letrare janë formuar, duke shkurtuar në mënyrë të ndërgjegjshme pjesën e parë të tyre si p.sh. yjve-yjeve.[591]

Gjithsesi, pavarësisht hipotezave të mundshme mbi rrugët e krijimit, arsyet mbeten thjesht dialektore, meqenëse nuk hasen përdorime të tilla në të folme dhe areale të tjera dhe për faktin se ende në këtë areal folës gjenden përdorime të kësaj natyre madje edhe në fjalë të tjera.

Kronologji bibliografike e jetës dhe veprës së Lasgush Poradecit në tekstet parauniversitare dhe ato univesristare

Krijimtaria e L. Poardecit në tekste mësimore:

-Lasgush Poradeci (1899). Shënin autobiografik. Në librin: Shkrimtarët shqiptarë, Pjesa e II. Prej lidhjes së Prizërendit e deri sot. Për klasën e tretë e të katërt të kursit të naltë.[592]

-Lasgush Poradeci. Në librin: Letërsia Shqipe e periudhës 1912-1939.[593]

-Lasgush Poradeci (1899). Në librin: Historia e Letërsisë Shqipe.[594]

-Lasgush Poradeci. Në librin: Historia e Letërsisë Shqipe. (Shkrimtarë të tjerë të kohës së indipendencës, Kapitulli XXII, Lasgush Poradeci).[595]

-Lasgush Poradeci (1899). Në librin: Historia e Letërsisë Shqipe.[596]

-Lasgush Poradeci. Në librin: Letërsia Shqipe e Periudhës 1912-1939. [597]

-Lasgush Poradeci (1899). Në librin: Historia e Letërsisë Shqipe.[598]

- Lasgush Poradeci. Histori e Letërsisë Shqipe.[599]

-Asdreni. (Aleks Stavre Drenova). *"Excelsior!"* Lasgush Poradecit. Poezia i kushtohet mikut të dashur, mesa duket edhe të adhuruar prej tij. Ai bën portretin e

---

[590] K. Topalli, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Shtëpia botuese Dituria, Tiranë, 2007, f. 220.

[591] A. Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë; Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2004, f 151.

[592] *E. Koliqit nga K. Gurakuqi, Shkrimtarët shqiptarë, Pjesa e II*. Prej lidhjes së Prizërendit e deri sot. Për klasën e tretë e të katërt të kursit të naltë, Botim i Ministris' s' Arsimit, Tiranë, 1941, -f.554.

[593] V. Bala, *Letërsia Shqipe e periudhës 1912-1939* (konspekt-leksione), Botim i Institutit të Lartë Pedagogjik, Tiranë, 1956, f. 120-121.

[594] Dh. Shuteriqi, *Historia e Letërsisë Shqipe, Vëll. II*, Botim i Institutit të Historisë e të Gjuhësisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës, Tiranë 1959.

[595] *Historia e Letërsisë Shqipe*. Tekst për shkolla të mesme, Botimi i katërt, 1962, Drejtoria e Botimeve Shkollore, f. 197-199.

[596] Dh. Shuteriqi, *Historia e Letërsisë Shqipe*. Për shkolla të mesme, Prishtinë, 1968, f. 262-264.

[597] *Letërsia Shqipe e Periudhës 1912-1939* (Maket). Botim i Institutit të Historisë e të Gjuhësisë dhe i Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës, Tiranë. 1968, f. 155.

[598] Dh. Shuteriqi, *Historia e Letërsisë Shqipe*. Për shkolla të mesme, Prishtinë, 1968, f. 262-264.

[599] Dh. Shuteriqi, *Histori e Letërsisë Shqipe*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK, Prishtinë, 1969, f. 262-264.

poetitit të liqerit mes vargjesh. Titulli vetë është një superlativë, shkallë sipërore latine, i shkëlqimit dhe ndriçimit, që i jep nderim poetit.[600]
-Lasgush Poradeci dhe lirika e tij. Në librin: Historia e Letërsisë Shqiptare që nga fillimet deri te Lëvizja Antifashiste Naciaonalçlirimtare. (Lasgush Poardeci dhe poetët e tjerë të viteve '20-'30, është një vështrim i shkurtër që shërben si hyrje, ndërsa në ndarjen Lasgush Poradeci dhe lirika e tij, flitet për veprën letare të poetit, duke analizuar disa poezi shkurt, vetëm në nivel strofash për të theksuar disa veçori të përmbajtjes, apo figuarve letare, të marra nga vëllimet e tij poetike *"Vallja e yjve"* dhe *"Ylli i zemrës"*).[601]
-Lasgush Poradeci. Në librin: Historia e Letërsisë Shqiptare.[602]
-Lasgush Poradeci. Në librin: Historia e Letërsisë Shqiptare.[603]
-Lasgush Poradeci. Në librin: Histori e Letërsisë Shqiptare Mendime të personaliteteve, foto, bibliografi e veprave të Lasgush Poradecit. Elsie sjell mendime për veprën e Lasgushit nga Çabej, Kuteli, Maloki dhe Hamiti. Jepet në libër një bibliografi e shkurtër e veprave të Poradecit. Fotot e Lasgushit një pjesë e tyre janë të kohës së rinisë së poetit, pjesa tjetër e mëvonshme nga jeta e tij në Tiranë dhe në Pogradec).[604]
-Lasgush Poradeci: *"Ekskursoni teologjik i Sokratit"*, poemë në dorëshkrim. Në librin: Letërsia Moderne Shqiptare. (Bëhet një analizë e plotë e kësaj poeme në dorëshkrim. Autori, gjithë tekstit të vet poetik i krijon një status të ri, atë satirik. Poeti bëhet një me vetëdijën e zgjuar të Sokratit dhe duke ecur me të në udhën e kërkimit të rëndë në mesin e njerëzve dhe të pushtetit, nga një anë nuk ka si i ndjen dhimbjet për humbjet dhe mashtrimet, e në anën tjetër nuk mund të refuzojë dhe të përjashtojë protagonistët e mashtrimit dhe manipulimit të njerëzve).[605]
-Lasgush Poradeci (1899 - 1987). Në librin: Letërsia Moderne Shqiptare. (Në këtë tekst shkollor bëhet një përmbledhje e detajuar e jetës dhe veprës së Lasgushit. Një vend të rëndësishëm zënë dy veprat e tij letrare dhe aparati pedagogjik për zbërthimin e poezive të ndryshme dhe poemave të tij të njohura. Jepen detaje poetike edhe përmes vargjesh të konkretizuar nëpër veshtrime letrare).[606]
-Lasgush Poradeci. Poeti modern i shqipes. Në librin: Letërsia Moderne Shqiptare. (Poeti cilësohet si pjesë e modernitetit të letërsisë shqipe. Për tetë dekada të jetës së tij, ai ishte vetëm poet. Poradeci është shembull i krijuesit modern shqiptar. Lasgushi krijoi poetikën e tij origjinale, që shfaqet me bukurinë llaftare të vetënjohjes për të arritur përsosmërinë dhe përjetësinë. Tema themelore e krijimeve të tij është dashuria që ai e ndjen dhe e kupton si një fuqi të pashtershme).[607]
-Lasgush Poradeci. Motivet kryesore të poezisë lasgushiane. Tiparet e lirikës së tij: Lirika e natyrës dhe e dashurisë. Në librin: Letërsia për Maturantët. (Pasqyrohet fryma e re që solli poezia e Lasgush Poradecit, në vitet '30. Poradeci është në letërsinë shqiptare poeti lirik që solli një ndjeshmëri të veçantë të fjalës, poezisë. Poezia e tij

---

[600] Përg. Grup autorësh, në librin: *Antologjia e Letërsisë Shqipe për Shkollat e Mesme*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1974, f. 178.
[601] *Historia e Letërsisë Shqiptare që nga fillimet deri te Lëvizja Antifashiste Naciaonalçlirimtare*. Hartuar nga Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1983, f. 521-530.
[602] J. Bulo, K. Kodra, N. Jorgaqi, R. Marku, S. Bulo, Zh. Nova, *Historia e Letërsisë Shqiptare 1*. Për shkollat e mesme, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë 1987, f. 191.
[603] Po aty, f. 191.
[604] R. Elsie, *Histori e Letërsisë Shqiptare*, Tiranë-Pejë, 1997, f.266, 336, 361, 363, 380, 424, 456, 625.
[605] S. Hamiti, *Letërsia Moderne Shqiptare*, Prishtinë, 1998, f. 247-250.
[606] Po aty, f. 95-116.
[607] S. Hamiti, *Letërsia Moderne Shqiptare*, Shtëpia botuese "Alb-ass", Tiranë 2000, f. 79-96.

dallohet në tre aspekte kryesore: në poezinë filozofike, patriotike dhe erotike. Ai ushqente pikpamje idealiste për artin. Sipas tij misioni i poetit është i përcaktuar nga "hyjnia". Veten e krahasonte me zogun e qiejve).[608]

-Lasgush Poradeci. Motivet kryesore të poezisë lasgushiane. Tiparet e lirikës së tij: Lirika e natyrës dhe e dashurisë. Në librin: Çelësi i letërsisë. (Lasgush Poradeci është i pari poet modern shqiptar dhe një nga lirikët më të mëdhenj shqiptarë të shekullit të XX. Poezitë e tij kanë një strukturë të ndërlikuar poetike, prej së cilës varet edhe muzikaliteti dhe ritmi i brendshëm i tyre. Lasgushi i këndon dashurisë jo si emocion, por si fuqi themelore jetësore, si fuqi tokësore e qiellore).[609]

-Lasgush Poradeci. Një histori e shkurtër. 5.4-Lajmëtarë të modernizimit, Migjeni dhe Lasgush Poradeci. Në librin: Letërsia Shqipe. (Në këtë treshe të rrallë dhe madhështore spikat figura e poetit Lasgush Poradeci. Më tej ka një informacion rreth jetës dhe veprës letrare të Poradecit, ndërsa ky poet solli një frymë të re në krijimtarinë e viteve '30. Prezantoi mendime të thella, ndjenja labirintike dhe ide universale. U largua prej poezive romantike të rilindasve tanë).[610]

-*"Excelsior!"* Lasgush Poradecit. Në librin: Letërsia dhe Gjuha Shqipe 4.[611]

-Lasgush Poradeci. Jeta dhe vepra letrare e Lasgush Poradecit; Në librin: Letërsia dhe Gjuha Shqipe 4.[612]

-Lasgush Poradeci. Jeta dhe vepra letrare e Lasgush Poradecit; Në librin: Letërsia dhe Gjuha Shqipe 12.[613]

Krijimtaria e L. Poardecit në tekste antologjike:

-*"Vallja e luleve"; "Poradeci"; "Kroj i fshatit tonë"; "Mbarim vjeshte"; "E fundit mërzitje"*;[614]

-*"Lundra dhe flamuri"*;[615]

-*"Vallja e luleve"; "Poradeci"; "Mbarim vjeshte"; "Kroj i fshatit tonë";* [616]

-*"Ç'u mbush mali"*;[617]

-"*Dremit liqeri"; "Dimrit"* (vjershë)*; "Korrik"*;[618]

-*"Ç'u mbush mali"*;[619]

-*"Poradeci"*.[620]

-"Poradeci".[621]

---

[608] Orhanasi H. Afërdita, *Letërsia për Maturantët*, Erik botime, Tiranë 2003, f. 39-41.

[609] R. Petro., N. Malaj, *Çelësi i letërsisë*, "Albas", 2003, Tiranë, f. 37-40.

[610] R. Elsie, *Letërsia Shqipe*, Tiranë, "Skandërbeg books", 2005, f. 131-142.

[611] Përg. Grup autorësh, *Letërsia dhe Gjuha Shqipe 4*, Profili shoqëror, Botimet Shkollore Albas, Tiranë, 2007, f. 36-37.

[612] Po aty, f. 81-85.

[613] Grup autorësh, *Letërsia dhe Gjuha Shqipe 12*, Botime Shkollore Albas, Tiranë, 2011; 2012; f. 160-173.

[614] Dh. S. Shuteriqi, *Historia e Letërsisë Shqipe, për shkollat e mesme*. *Letërsia e re shqipe, Antologji e komentuar për shkollat e mesme*, Tiranë 1950, Botim i Ministrisë s'arsimit. Tiranë 1955, f. 160.

[615] Dh. S. Shuteriqi, *Historia e Letërsisë Shqipe, për shkollat e mesme*, Tiranë 1955, f. 160.

[616] *Antologji e letërsisë shqipe për shkollat e mesme*, Botimi i tretë 1958, Botim i Ministrisë s'arësimit dhe kulturës, Tiranë, f. 302; 303; 304; 305.

[617] Përg. A. Naçe; S. Vigani; T. Gjata, në librin*: Leximi letrar* (Antologji për klasën e 5 të shkollës 8-vjeçare, 1964, Drejtoria e Botimeve Shkollore, Tiranë, f. 123.

[618] Përg. Gj. Zheji, në librin: *Leximi letrar* (Antologji për klasën e 6 të shkollës 8-vjeçare, 1964, Drejtoria e Botimeve Shkollore, Tiranë, f. 48; 50; 116.

[619] *Leximi letrar* (Antologji për klasën e 5 të shkollës 8-vjeçare), 1965, Instituti i Studimeve dhe Botimeve Shkollore, Tiranë, f. 141.

[620] Q. Xhomo, Dh. Qirirazi, në librin: *Antologjia e Letërsisë Shqipe 1*. Për shkollat e mesme. Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë 1971, 1972, 1973, 1974, f. 178.

[621] Në librin: *Antologjia e Letërsisë Shqipe për Shkollat e Mesme*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1974, f. 178.

- *“Poradeci”; “Kroj i fshtit tonë”; “Vdekja e Nositit”; “Gjuha e zjarrtë”; “Vallja e luleve”; “Ç’u mbush mali”; “Mbarim vjeshte”; “Mall”; “Vate prilli”;* [622]
-*“Poradeci”*[623]
“Kroj i fshatit tonë”; [624]
-*“Poradeci”; “Ç’u mbush mali”*.[625]
-*“Kroj i fshatit tonë”;* [626]
-*“Vallja e luleve”*;[627]
-*“Dimër”*;[628]
-*“Maja e çelur”*[629]
-*“Dremit liqeri”*;[630]
-*“Poradeci”; “Kroj i fshtit tonë”; “Vdekja e Nositit”; “Gjuha e zjarrtë”; “Vallja e luleve”; “Ç’u mbush mali”; “Mbarim vjeshte”; “Mall”; “Vate prilli”*;[631]
-*“Poradeci”; “Kroj i fshatit tonë”; “Vdekja e Nositit”; “Gjuha e zjarrtë”; “Vallja e luleve”; “Ç’u mbush mali”; “Mbarim vjeshte”; “Malli”; “Vate prilli*”;[632]
-*“Poradeci”; “Kur shtrohet vala”; “Baladë”; “Trioleta”; “Dimër”; “Gjeniu i anijes”; “Dora jote ledhatarja”; “Lundra dhe flamuri”; “Kur qajnë motrat vëllanë”; “E mora shoqezën përkrah”; “Sytë e tu vetëtimtarët”; “Rri me shëndet”; “Malli i vjershëtorit”; “Vdekja e Nositit”; “Mbarim vjeshte”*.[633]
-*“Kënga pleqërishte”; “Poradeci”; “Mbarim vjeshte”; “Vdekja e Nositit”; “Ekskursioni teologjik i Sokratit”*.[634]
-*“Kënga pleqërishte”; “Poradeci”* (variant ripunuar i vitit 1929); *“Mbarim vjeshte”; “Vdekja e Nositit”; “Ekskursioni teologjik i Sokratit”* (fragment).[635]
-*“Vallja e yjeve”; “Ekskursioni teologjik i Sokratit”; “Vdekja e Nositit”; “Zemra e liqerit”;* [636]
-*“Vdekja e Nositit”*[637]
“Poradeci” [638]
“Kroj i fshatit tonë”[639]

---

[622] Në librin: *Antologji e Letërsisë Shqiptare për shkollat e mesme*. Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë 1977, f. 200-211.
[623] *Leximi letrar për klasën e 8 të shkollës 8-vjeçare*, 1984, 1987, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, f. 95.
[624] *Leximi letrar për klasën e 7 të shkollës 8-vjeçare*, 1986, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, f. 132.
[625] *Antologjia e Letërsisë Shqiptare 1*. Për shkollat e mesme. Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë 1987, 1988, 1989. f. 244-247.
[626] *Leximi letrar, kl.5*, 1990, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, f. 72.
[627] *Leximi letrar, kl.8*, 1993, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, f. 69.
[628] “Gëzimi”, (Revistë mujore e ilustruar për shkollarë), -Nr. 5-6, Shkup, janar-shkurt 1993, f. 3.
[629] *Maja e Çelur. Antologji e Letërsisë Bashkëkohore Shqiptare*. Për shkollën e mesme (III-IV), Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1994, f. 5-6.
[630] *Leximi letrar, kl.7*, 1995, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, f. 47.
[631] J. Bulo, K. Kodra, N. Jorgaqi, F. Idrizi, S. Bulo, S. Buçpapaj, *Antologji e Letërsisë Shqiptare për shkollat e mesme 1*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë 1996, f.317-326.
[632] *Antologji e Letërsisë Shqiptare 1*, 1996, f. 317-326.
[633] *Antologji për nxënësit e shkollës së mesme. Poetë shqiptarë nga shek. XII deri në shek. XIX;* Përg. Anton Papleka, “Mësonjëtorja e parë”, 1999, f. 368 -383.
[634] S. Hamiti, *Letërsia Moderne Shqiptare*, Shtëpia Botuese “Alb-ass”, Tiranë 2000, f. 264; 265; 267; 268; 268.
[635] S. Hamiti, *Letërsia Moderne Shqiptare*, “Albas” 2002, f. 170; 172; 174; 176; 178-179.
[636] *Letrësia Shqiptare 3*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë 2003, f.108; 111; 117; 119.
[637] *Çelësi i letërsisë*, “Albas”, 2003, f. 152-153.
[638] Po aty, f. 233-234.
[639] *Leximi letrar, kl.5*, 2003, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, f. 72.

-*"Vdekja e Nositit"; "Kënga pleqërishte";*[640]
-*"Poradeci"; "Gjuha e zjarrtë";*[641]
-*"Mëngjes"*[642]
-*"Poradeci"*[643]
-*"Vdekja e Nositit"; "Kënga pleqërishte";*[644]
-*"Poradeci"* (variant i vitit 1929); *"Ekskursioni teologjik i Sokratit"* (fragment); *"Mbarim vjeshte"; "Trioleta";*[645]
-*"Poradeci"; "Mbarim vjeshte";*[646]
-*"Vallja e yjeve"*[647]
-*"Vallja e yjeve"*[648]
-*"Vdekja e Nositit"*[649]
-*"Lamtumirë"*. (Të dy varientet e poezisë); Tekstet shkollore në vitet 2010 dhe 2011 kanë vetëm një variant të poezisë së botuar.[650]
-*"Vdekja e Nositit"; "Kënga pleqërishte"; "Gjuha e zjarrtë"; "Poradeci";*[651]
-*"Vallja e yjeve"; "Kënga pleqërishte"; "Kroj i fshatit tonë"; "Baladë"; "Gjuha e zjarrtë"; "Mbarim vjeshte";*[652]
-*"Gjeniu i anijes"*[653]
-*"Kënga pleqërishte"; "Mbarim vjeshte"; "Lundra dhe flamuri";*[654]
-*"Vallja e yjeve"; "Kënga pleqërishte"; "Vdekja e Nositit", "Poradeci";*[655]

Përfundime:

Na bie në sy se vetëm disa prej poezive të L. Poradecit, studiohen në sistemin parauniversitar shqiptar. Ende nuk janë bërë përpjekje të mjaftueshme për të sjellë në programet shkollore poezi të tjera të shkruara të Poradecit. Nga viti në vit ato pothuajse kanë mbetur të njëjta për lexuesin e "detyruar" të programeve shkollore.

Konkretisht, poezitë maratonë për më shumë se gjysmë shekulli që përdoren në tekstet shkollore parauniversitare janë: *"Poradeci"; "Kroj i fshatit tonë"; "Dimër"; "Maja e çelur"; "Vdekja e Nositit"; "Gjuha e zjarrtë"; "Vallja e luleve"; "Ç'u mbush mali"; "Mbarim vjeshte"; "Malli"; "Vate prilli"; "Kur shtrohet vala"; "Balladë"; "Trioleta"; "Gjeniu i anijes"; "Dora jote ledhatarja"; "Lundra dhe flamuri"; "Kur qajnë motrat vëllanë"; "E mora shoqezën përkrah"; "Sytë e tu vetëtimtarët"; "Rri me shëndet"; "Malli i vjershëtorit"; "Zemra e liqerit"; "Këngë*

---

[640] *Letërsia dhe Gjuha Shqipe 10*. Drejtimi shoqëror, Tiranë, 2004, Botime Shkollore Albas, f. 103; 105.
[641] *Letërsia dhe Gjuha Shqipe 2*. Drejtimi shoqëror, Tiranë, 2004, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor e Re, f. 66; 67.
[642] *Gjuhë Amtare, kl. 6*, Tiranë, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, Botime Shkollore Albas, f. 91 dhe 84.
[643] Po aty, f. 91 dhe 84.
[644] *Letërsia dhe Gjuha Shqipe 2*. Profili shoqëror, Tiranë, 2006, Botimet Shkollore Albas, f. 76; 78.
[645] *Letërsia dhe Gjuha Shqipe 4*. Profili shoqëror, Tiranë, 2007, Botimet Shkollore Albas, f. 86; 88; 89; 91.
[646] *Letërsia dhe Gjuha Shqipe 4*. Profili natyror, Tiranë, 2007, Botimet Shkollore Albas, f. 66; 68.
[647] *Matura Shtetërore; Letërsi dhe Gjuhë Shqipe 3.* Drejtimi natyror, Tiranë, 2008, f. 29-30.
[648] *Letërsi dhe Gjuhë Shqipe 4.* Drejtimi shoqëror, Tiranë, 2008, f. 117.
[649] *Letërsi dhe Gjuhë Shqipe 10.* Tiranë, 2009; 2010; 2011, f. 285.
[650] *Gjuhë Amtare, kl. 8*, Tiranë, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, Botime Shkollore Albas, f. 100.
[651] *Çelësi i letërsisë*. Për shkollat e mesme profili natyror dhe shoqëror, "Albas", 2009, f. 151-158.
[652] *Çelësi i letërsisë*, Për shkollat e mesme profili natyror dhe shoqëror, "Albas", 2010, f. 139-151.
[653] *Gjuhë Amtare, kl. 9*, Tiranë, 2010, 2011, Botime Shkollore Albas, f. 130.
[654] *Letërsia dhe Gjuha Shqipe 12*, Tiranë, 2011; 2012; Botime Shkollore Albas, f. 160-173.
[655] *Çelësi i letërsisë dhe i gjuhës shqipe*. Për maturën shtetërore, Botimet Shkollore Albas, 2012, f. 118; 121; 124; 125.

pleqërishte", "Gjuha e zjarrtë"; "Lamtumirë" (në dy variante) si dhe poema *"Ekskursioni teologjik i Sokratit"*.
Dy poezi rezultojnë si më shumë të botuarat, ato janë: *"Vdekja e Nositit"* dhe *"Poradeci"*. Pjesa tjetër e magazinës poetike lasgushiane nuk kontaktohet fare nga lexuesi i "detyruar" i saj ndër vite. Gjithë kjo lëndë e pashfrytëzuar duhet risjellë në vëmendjen e nxënësit-lexues të shkollës sonë, gradualisht.
Të gjitha tekstet shkollore përmbajnë jetën dhe veprën letrare të Lasgushit dhe pothuajse të gjitha poezitë e cituara më sipër bëhen lëndë e programit mësimor. Aparati pedagogjik në fund të temës mësimore ka një sërë pyetje dhe detyrash rreth X poezie, ka pjesë poezish nga Lasgush Poradeci, skemën e analizës dhe pikat çelës të komentit letrar. Pyetjet dhe përgjigjet jepen të tipit quitz dhe mbartin një vlerë të madhe didaktiko-pedagogjike në zbërthimin e situatave komentare. Këto tekste shkollore shpërndahen nga vetë MAS, në Shqipëri, Kosovë dhe një pjesë e mirë e tyre edhe në Maqedoni.
Gjithashtu këto tekste përdoren edhe në diasporë nga bashkëatdhetarët tanë në Europës apo Shtetet të Bashkuara të Amerikës. Lexuesi i këtyre vendeve, sikurse lexuesi-nxënës i arsimit parauniversitar e merr njëlloj informacionin e publikuar dhe hedhur në treg për shitje. Të njëjtin mendim ndajmë edhe për tekstet universitare të cilët trajtojnë jetën dhe veprën letrare të poetit. Para viteve '90, gjithçka përmblidhej në pak faqe, ndërsa pas viteve '90 trajtimi i autorit bëhet përmes kapitujsh të plotë shkencorë.

XII. KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

NJË RECEPTIM NDRYSHE

XII.1. Receptime poezish që veçohen nga të tjerat

Disa poezi të Lasgushit, sigurisht që mund të hapin polemikë, me interpretimin e tyre ndër lexues. Por, nëse i hedhim një vështrim paralel poezisë "*Një lule vjeshtet"* të At Gjergj Fishtës, shohim, që edhe ajo është ndër krijimet letrare *që ta bën me sy*[656]. Eshtë ndjenja e një frati për një frat.[657]

Duke qenë bashkëkohës dhe miq, Fishta dhe Lasgushi, mund të kenë notuar në të njëjtat ujëra krijimtarie për një dashuri të ndaluar ose paragjykuar. Të tilla "miqësi", më herët vijnë të arratisura edhe nga "*Epi i Kreshnikëve"*.

"Duke e flakur "të folmen e përditshme", "shprehjet gjysmë të gatshme", gjithë sa "na vijnë nga të tjerët" dhe nga të tjerë më të këqinj se ne, "na japin për realitet vetëm një njohje konvencionale", ku shkrimtari vërtet synon të zbresë në atë "qetësi të thellë ku mendimi përzgjedh fjalët në të cilat do të mishërohet. Duke u larguar nga gjuha e zakonshme, të shkruarit lejon të rrokësh atë që deri dje nuk qe rrokur ende prej të menduarit. Edhe për këtë arsye vepra nuk është as "produkti" as "pasqyrimi" i një realiteti paraekzistues, por është një "zanafillë", "një ndodhi e re. [...] Kritika tradicionale, madje edhe degë të reja, si psikokritika apo sociologjia e letërsisë, për interpretimin e veprës të degdisin te një "gjetiu", te një gjësend jashtë saj (veprës): te jeta e shkrimtarit apo historia dhe shoqëria e kohës, ndërkohë që ky konceptim i ri i letërsisë, përkundrazi, të shtyn kah një "kritikë e brendshme.

Për atë që di të lexojë, marrëdhëniet e shkrimtarit me botën e me njerëz të tjerë, si dhe me vetveten, gjenden në plotësinë e tyre aty, në vepër. Aty është sheshi, tek shkrimtari e zbulon veten, madje e shpik. Do të ishte e kotë ta kërkoje një shkrimtar në dokumente arkivore. Të shkruarit përfytyrohet si një "fshehje", një "strukje", një "bishtnim" prej realitetit ekzistues për t'u ngujuar në hapësirën e gjuhës dhe të letërsisë".[658]

E pashprehshmja nuk shfaqet në thurrimën e veprës e analizuar, por vepra e analizuar afrohet ndaj nesh si një mekanizëm që përfton të pashprehshmen. Përkufizimi i këtij mekanizmi do të ishte *përkufizimi i emocionit estetik*.[659]

Një libër i cili do që të të mbajë, të vazhdojë, është një libër që duhet të na japë mundësi ta lexojmë në shumë mënyra, d.m.th. *"mundësi për lexime të ndryshme, të ndryshueshme, të ndërrueshme"*.[660]

Echo thotë se një vepër arti, edhe kur ajo është formë e kryer dhe e "mbyllur" në përkryerjen e vet si organizëm përpikshmërisht i kalibruar, është "e hapur" së paku për aq sa mund të interpretohet në mënyra të ndryshme pa iu tjetërsuar veçanësia e saj e pacënueshme.[661]

Veprat e mëdha jetojnë nëpër kohë. Ato nuk vdesin, por përjetësohen. Organizimi i domethënësit në tekstin letrar sjell një mugullim të vijueshëm marrëdhëniesh të

---

[656] Term i përdorur nga A. Plasari, në librin: *Fishta i dashuruari*, Shtëpia botuese "Marin Barleti", Tiranë 1996.

[657] A. Plasari, *Fishta i dashuruari*, Shtëpia botuese "Marin Barleti", Tiranë 1996, 107f.

[658] U. Echo, *Necessitan e possibilita nelle strutture musicali*. "La difinizione dell'arte", Milano, 1968, f. 173.

[659] Po aty, f. 173.

[660] G. Lanson, *Essais de methode, de critique et d'historie litteraire*, Paris 1991, f. 18.

[661] U. Echo, *Opera aperta*, Milano, 1962, f. 84.

brendshme, që i mbeten çdo lexuesi t'i zbulojë gjatë leximit të tij. Shpjegimi tradicional i tekstit, që brengoset vetëm për "letrarësinë", nuk i pranon "kuptimet e figurëshme". Ndërkohë, metodat e reja kritike priren t'i shumëfishojnë këto kuptime; vetë sprovat e bëra gjatë një aventure japin shembuj të këtyre ndryshimeve në mënyrën e të lexuarit. Edhe estetika e receptimit e ka pranuar "papërcaktueshmërinë" e tekstit letrar, "ambiguitetin" që qëndron në thelbin e tij.[662] Jauss-i është i mendimit se interpretimet e reja të një vepre të së shkuarës mbrohen ndaj tepërive arbitrare nëpërmjet caqeve dhe kushteve të horizontit historik dhe shoqëror. Për të kuptuar çështjet që një vepër parashtron, duhet ta lidhim atë me "horizontin e pritjes" së "lexuesve të parë".

Nga ana tjetër, vargu i njëpasnjëshëm i kuptimeve që tashmë i janë dhënë të njejtit tekst përgjatë historisë, ka logjikën e vet. Ai krijon një traditë interpretimi, ndaj së cilës, një interpretim i ri duhet të vendosë një qëndrim të ri, si në rastin e poezive të veçanta nga të tjerat. Një poezi është krijuar për t'u marrë e rimarrë, për t'u lexuar e rilexuar në pafundësi herësh dhe kuptimesh.

Zemra e shokut

Të kam shok nga koh' e vjetër
Shok prej zemre-edhe prej gjaku...
Shok të ri me besë plaku
Nuku kam, nuku ke tjetër.

Se ç'do gas e mall të shkretë
M'i ke thënë-emër më emër
Unë-i mbylla mun në zemër
Gjer sa zemra të mos jetë.

Se ti mban në kraharuar
Shenjtërine-e një dhurate:
Mban në fund të zemrës s'ate
Ç'të kam thënë-i llaftaruar.

Ish e bardhë-e nuku kishte
Dredhëri zemra bujare:
Bënte botën zilitare
Zemr' e bukur shokërishte.[663]

Një ndër poezitë që futet në këtë grupim, është ajo me titull *"Zemra e shokut*", e përfshirë në ciklin e pestë, *"Zemra e vdekjes"*. Titulli i poezisë mbetet një metonimi e pastër për të shprehur idenë se zemra mban në thellësi të saj sekrete. Poezia ndërtohet nga katër strofa. Tek strofa e parë Lasgush Poradeci sjell dashurinë mes një burri të moshuar dhe një djali të ri, por në anën tjetër duket e çuditshme, sepse që në fillim i kumton: *të kam shok nga kohë e vjetër* (metaforë), domethënë shok të qëmotshëm, një shok që e lidh zemra apo diçka shumë e afërt. Prezenca e së vetmes retiçensë në këtë poezi bën që mendimi i lexuesit të jetë më i thellë në interpretimin e saj. Retiçensa na bën të hamendësojmë më thellë në poezi. Me shok prej *gjaku*, ke të bësh me një lidhje gati gjenetike, por me *shok të ri me besë plaku*, duket sikur qasim një antitezë, sepse për poetin të rinjtë mund të jenë çuna pa besë, ndërsa të vjetrit janë ata që e mbajnë fjalën e dhënë. Mes tyre nuk ka një shok tjetër, ata kanë një lidhje të veçantë mes

[662] A. Plasari, *Fishta i dashuruari*, Shtëpia botuese "Marlin Barleti", Tiranë 1996, fq. 102-104.
[663] L. Poradeci, *Zemra e shokut*, *Vepra 1*, *Poezia*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2009, fq.221.

vetes. Vargu *nuku kam, nuku ke tjetër…* sqaron se nuk ka shok tjetër mes tyre. Poezia përforcon idenë se ata ja kanë zbuluar misterin njëri-tjetrit. Në jetë nuk mund të kesh shumë shokë të cilët t'i kesh shokë zemre. Të tillë ke vetëm një. Nuk mund të kesh dhjetë shokë të zemrës…, sepse shokut të zemrës i hapesh, jo gjithkush futet brenda saj. Mund t'i ketë thënë të dua, mund t'i ketë thënë... Ne, lexuesit, vetëm mund të hamendësojmë, sepse i ka thënë diçka të pazakonshme, përpos faktit që të gjitha këto i ka mbyllur në zemër, deri sa ajo të mos jetë, të vdesë, një pohim tronditës ky!

Strofa e dytë, e poezisë prezanton çdo gjë që ka pasur shoku i vet në shpirtin e tij. Gjithçka që ka pasur të bëjë me gjëra të bukura apo jo, djaloshi ia paska besuar në fshehtësi shokut të tij. Ndërkaq, ky i vjetri i ka mbyllur ato në zemër, brenda një kutie të çuditshme, çelësin e së cilës e ka vetëm ky. Eshtë një arkë shpirtërore. Të dy i kanë thënë gjëra njëri-tjetrit. Vetë akti seksual konsiderohet në aspketin religjioz i shenjtë. Kur ai bëhet me dashuri, mbetet një akt i shenjtëruar, por nëse nuk bëhet me dashuri, mbetet marrëdhënie tradhëtie e zakonshme dhe konsiderohet mëkat. Antiteza *gas e mall të shkretë,* bën që shokët t'ia besojnë zemrës të fshehtat e tyre.

Në strofën e tretë poezia nuk dihet nëse mbron pozitën e njërit apo të tjetrit. Në pamje të parë dhurata e shenjtë është dashuria që i lidh ata me njëri-tjetrin. Në fund të zemrës ka një mister. Duhet t'i ketë thënë *të dua*, fjalë që nuk shkruhet në poezi, por që gjithsesi është thënë. Ajo është e shenjtë, sepse nuk i besohet gjithkujt një marrëdhënie e tillë. Shtrohet pyetja, çmund t'i ketë thënë në strofën e tretë, *i llaftaruar, i tronditur*? Fakti që e mban në fund të zemrës, në fshehtësi, përbën një sekret, sepse e mbajtur në fillim të zemrës do ishte e dukshme *(m'u në fund të zemrës sate rritet fshehur dashuria)*, thellësi që e ndeshim edhe në poezi të tjera te Lasgushi i dashuruar. Çfarë mund t'i ketë thënë, ne nuk e dimë, vetëm hamendësojmë në receptimin e kësaj poezie. Është fjala për diçka që nuk i thuhet zakonisht një njeriu.

Në strofën e fundit vjen përfundimi se ajo zemër në të cilën ata kanë mbyllur misterin, fshehtësitë e njëri-tjetrit, ka qenë një zemër e pastër, e dlirë, fisnike. Brenda kësaj lidhje, sikurse duket në poezi, ishin miqësia, shoqëria dhe dashuria e tyre për njëri-tjetrin të cilat e bënin botën të kishte zili, t'i vështronin ata po me zili sepse, gjithmonë kur dy njerëz duhen së tepërmi me njëri-tjetrin, ndjenja e tyre ngjall zili.

Në këtë poezi kemi shenja të një biseksualizemi të pastër, sepse nuk duket dashuri e zakonshme, sepse poeti nuk flet per zemrën e shoqes së tij, por të shokut. Poezia duket së tepërmi intime dhe ka një tis mjegulle. Poezia e parë lartazi saj, fsheh diçka që nuk është e tejdukshme, nuk është transparente për lexuesin. Ajo flet për gjëra të fshehta, që nuk duhet t'i dinë të tjerët. Një shoqe nuk përmendet askund në këtë poezi. Gjithkush e lexon vetë tekstin çfarë thotë, aty nuk përmendet gjinia tjetër. E gjitha është sekret mes dy shokësh të cilët janë më shumë se shokë.

Mall të shkretë ndjej dhe gjëra të gëzueshme kujtoj, dhe gjërat më të vështira ti m'i ke thënë emër për emër, na kumton poeti. Mbase malli shkretë mund të jetë një lakmi e parealizuar asnjëherë. Ndjenja e llaftaruar bën që shoqëria e tyre të kalojë në një çast tjetër. Më në fund ia ka thënë atë që nuk ka pasur guxim t'ia thoshte.

Receptimi i parë bën që poezia të lexohet si çdo poezi tjetër. Ajo të duket ndryshe në leximin e dytë, të tretë, sepse në poezitë e tjera më së shumti, Lasgush Poradeci i këndon dashurisë së femrës. Tani ai vjen ndryshe! Zemra e shokut është një zemër që ta bën me sy!

Në vëllimin poetik të Lasgush Poradecit të botuar më 1937, në vargjet poezisë *"Vallja e Yjve"* receptimi biseksual përforcohet edhe më tepër. Simbolika e poezisë është ajo e njerëzve të dashuruar. Antiteza *kudo janë-kudo s'janë* përforcon idenë, se yjet ekzistojnë edhe pse nuk i sheh gjithmonë në përditshmërinë tënde.

Ylli i dashuruar, dashurohet me një tjetër yll. Simbolikë e kësaj vjershe është vetë dashuria, bota dhe marrëdhënia që krijohet mes saj. *Yll i mjerë e yll i lum,* një tjetër antitezë përfaqësuese e idesë së ndjenjës gjithëpërfshirëse që të fal dashuria për një qenie si ajo e të të njëjtit seks. Kushdo dashurohet sipas ndjenjës së vet shprehëse ose jo shprehëse. Nisur pikërisht nga kjo poezi, poezive lasgushiane mund t'ju bësh një tjetër receptim.

Vallja e yjve

Yjtë-e ndezur si fingjill, Që vërtiten palë-palë, Prej mosgjëje zunë fill Plot me jetë-e mall të valë.
Zunë fill me dashuri Që kur bota zu të ngjizet, Pa sikush për shok të ti Përvëlohet edhe ndizet.
Ndizet ças edhe për ças, E si kurrë s'ka të shuar, Pa pushim i vete pas Me një sulm të llaftaruar.
E si kurrë nuku mund Ylli yllin që t'a kapë Rrotull qiejve pa fund Venë-e-vinë-e-venë prapë...
....
Do të venë fluturim Kudo janë-e kudo s'janë, Nëpër qjell që s'ka mbarim, As fillim, as fund, as anë.
Kur mi të, kur nënë të, Kur me hire-e kur pa hire, Do përëajnë gjithënjë Hapësirë...shkretëtire...
Ata ikin varg-e-varg Me një etje të pashuar: *Sesà fellë-e sesà larg Shoq me shoq u pat larguar!...*
Kùsh j-u fali-aq dëshërim, Dh'aqë zjarr e aqë flakë, Dh'i gatoj me aq durim Yjtë-e lum e varfanjakë?
Se do një, si për çudi, Ku prej syresh rreh të ftohet, Shoq i vet, nga mall'i ti, Më me zjarr zë përvëlohet...
Dh'i vjen qark më me vërtik E me dhembje më të nxehtë, E si ik...si gjithë ik... E pushton me zjarr të vetë:
Sa më pak e shmbëllen: *Aq më shumë-e ndjek dëshira... Pa nga malli që s'e gjen, Dridhet gjithë hapësira.*
...Kur po ja! Se që përtej Ndriten erërat nga pakë: *Yll-i çdukur nëpër qiej Vetëtiu e mori flakë*:
J-a pat shtënë me një ças, Mun në mes në kraharuar, Shoq' i vet q'i sillej pàs Me një sulm të llaftaruar;
Q'e kish flakën mun në gji, Q'e zhuritte dashurija, që çkëlqente me zili Rrotull rrezeve të tija.
Yll i mjerë e yll i lum! Yll i lum e yll i mjerë! Sapo drita t'u përgjum, Sheh një shoq nëpër skëterë;
Ay vin... e gjith vin..., Gjith më pranë... -e gjith më pranë...- Sesà ndrin e vetëtin!... Sesà ndjen një gas pa anë!...
Sesa ndritesh përsëri! Sesì ndizesh përsëpari! Sesì djek me dashuri Posi yll margaritari!...
Dashuri! Heu! Mall i ri! Dashuri! këng' e durimit! Ti liri! Ti robëri! Ti valim i shkrepëtimit!
....

Zunë fill me dashuri/ Që kur bota zu të ngjizet,/ Pa sikush për shok të ti/ Përvëlohet edhe ndizet.[664]

Mjafton të lexosh vetëm këto vargje në trup të poezisë dhe nga leximi vertikal, jo varg pas vargu, arrin të marrësh një tjetër konotacion poetik. Komenti mbase do të ishte i tepërt. Poeti e justifikon mendimin e tij në mënyrë të hapur dhe fare thjesht të yjve të dashuruar. *"Yjtë-e ndezur aqë larg. Lozin vallen e dëshirës Dyke ndritur varg-e-varg Nëpër terr të errësirës. /Zunë fill me dashuri Që kur bota zu të ngjizet, Pa sikush për shok të ti Përvëlohet edhe ndizet. /Ata ikin varg-e-varg Me një etje të pashuar*: *Sesà fellë-e sesà larg Shoq me shoq u pat larguar!... /Se do një, si për çudi, Ku prej syresh rreh të ftohet, Shoq i vet, nga mall'i ti, Më me zjarr zë përvëlohet... /J-a pat shtënë me një ças, Mun në mes në kraharuar, Shoq' i vet q'i sillej pàs Me një sulm të llaftaruar; /Yll i mjerë e yll i lum! Yll i lum e yll i mjerë! Sapo drita t'u përgjum, Sheh një shoq nëpër skëterë;*

Dashuria e zbukuron jetën edhe pse ajo mund të të japë vështirësi. Përmes durimit, zgjohet dëshira për të bërë kompromisin e vazhdimit. Pikësimi i mesvargshëm, ose vijat e ndërprera në këtë poezi janë stacione pushimi a meditimi, të cilat duhen zëvendësuar në receptimin tonë me dashurinë e njëllojtë.

Ndërkaq, njerëzit i thonë ende *shoq* njëri-tjetrit në gjininë mashkullore në zonat veriore të Pogradecit dhe më tej edhe në Republikën e Kosovës. Këtu vepron rotacizmi, sikurse në fjalët e fondit të trashëguar apo në huazimet e vjetra të shqipes. Sipas Kolec Topallit përdorimi i */q-së/* në fjalën *shoq* e ka burimin nga gjuhët latino-romane *socius*. Prania e një zanoreje */i/* në rrokje të patheksuar fundore ka shndërruar grykoret e dikurshme të këtyre gjuhëve në qiellzoret e sotme. Trajta *shok*, (është një trajtë më e vonëshme shënimi ynë) është formuar me rrugë analogjike.[665]

Poezia *"E mora shoqezën përkrah"*është poezia erotike, e shënjtërimit të aktit seksual të të dashuruarve. Këtë herë jo e të njëjtit seks, por e erosit femër-mashkull.

E MORA SHOQEZËN PËRKRAH

E mora shoqezën përkrah,
E matmë rrugën ca-nga-ca,
Sikur na ndillte larg diçka.

Pa zuri dita perëndoj,
Pa zuri nata na mbuloj,
Pa zura shoqen ta pushtoj.

Perse buçet, liqer i qet!
Liqer, ti ç'thua ndaj buçet!
Ç'far' pe, liqer, mi zall te shkret?

E çasin kur e sjell nër mend,
Kur sjell nër mend, ah! atë vend,
As rroj as vdes, po jam pa mend.[666]

Edhe kjo poezi bëhet pjesë e këtij leximi ndryshe, atij të ajsbergtë. Poezia *"E mora shoqezën përkrah"*, mbetet ndër lirikat më të bukura të dashurisë lasgushiane. Të shprehesh ndryshe për këtë poezi mbase nuk thua më shumë se ç'mund të kenë thënë të tjerët për forcën e dashurisë së dy të rinjëve, në një çast idilik. Vargjet: *e çasin kur e sjell nër mend,/ Kur sjell nër mend, ah! atë vend,/ As rroj as vdes, po jam pa mend,*

---

[664] Po aty, fq. 112.
[665] K. Topalli, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, "Dituria", Tiranë, 2007; f. 296.
[666] L. Poradeci, *Poezia. Vepra 1*, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë 2009, fq. 242.

nuk janë vargje toponimike të Pogradecit, të vjetër lasgushian. Nuk është fjala për një vend të caktuar gjeografik, as për një zall, as për hark kohor.
Sipas disa gojëdhënave që janë trashëguar ndër njerëz në Pogradec, tregohet se vetë poeti i liqerit, ka sqaruar që ai vend në poezinë e tij, nuk është toponimi e qytetit të Pogradecit, por është organi seksual i femrës, pas përjetimit të aktit seksual. Nëse e lexon poezinë me këtë sqarim ajo receptohet ndryshe në kohën tonë, kohë kur edhe qarkullon e botuar kjo gojëdhënë urbane.
Lasgushi ishte një nga zëdhënësit virtuozë jo vetëm të shpirtit poetiko-lirik të shqiptarëve, por edhe i filozofisë së përgjegjësisë së tyre në dashuri. Kjo rrëfenjë qarkullonte natyrisht nën zë dikur, e më dendur në ditët tona.[667] Nën këtë sqarim poezia fiton dimension tjetër receptues. Poeti i Pogradecit, kurrsesi nuk mund të linte jashtë kësaj ndjesie këtë poezi e cila bëhet edhe më e bukur në këndvështrimin receptues. Nën tisin e kësaj qasjeje analizuese, lexuesi mbetet më i drejtpërdrejtë me një realitet që nuk është vështirë ta riprodhosh, si dikur në ditët tona.

Përfundime:

Objekt i këtij kapitulli janë tre krijime të L. Poradecit: "Zemra e shokut"; "Vallja e yjve" dhe "E mora shoqezën përkrah".
Në fund të qasjes sonë themi që poezia e parë dhe e dytë janë ndryshe nga lirikat e tjera të Lasgushit. Ato thyejnë tabu për kohën. Në një lexim tjetër, të ndryshëm nga ai i deritanishmi, ato kanë të trajtuar ndjenjën biseksuale. Në ditët tona njerëzit i shprehin afeksionet e tyre përmes risisë së internetit, dhe hapin zemrën ndonjëherë përmes virtualitetit. Në ato vite ndjenja ishte poetike, ndërsa sot është ndjenjë eterike e cila ka ndryshuar tepër.
Dashuria poetike mbetet e jetësuar në vargje, ndërsa dashuria virtuale ikën e vjen. "Zemra e shokut" është ishulli i thesarit, të cilin nuk e plaçkit askush. Një ishull i tillë dihet që eksizton, por s'mund të preket nga gjithkush në realitet.
Duhet thënë se deri më tani nuk ka pasur një interpretim ndryshe të poezisë për shkak të mendësisë së kritikës letrare që nuk guxonte të bënte një interpretim të tillë, temës tabu që ka trajtuar Lasgush Poradeci, por edhe ndoshta për shkak të shumësisë së poezive të tjera shumë të bukura që ka shkruar ai për dashurinë femërore, poezi të cilat e kanë lënë në hije zemrën e shokut.
Poezia "Vallja e yjve" na adreson se duke u nisur prej saj në receptim, disa krijimeve poetike të L. Poradecit, mund t'ju bësh një qasje tjetër kuptimore, atë të ndjenjës për seksin e njëjtë.
Poezia e tretë lajmëron që në titull se trajton dashurinë për femrën. Vihen përballë njëri-tjetrit mashkulli i dashuruar dhe femra e dashuruar, duke zbuluar fshehtësi trupore mes tyre dhe jo toponimi.
Ky receptim i ndryshëm, sjell konotacion të pafundëm për lexuesin e poezisë lasgushiane. Kapitulli në fjalë na përforcon idenë se një poezi mund të lexohet shumë herë dhe në mënyra të ndryshme interpretuese.
Marrëdhëniet që shkrimtari vendos me gjuhën e bëjnë veprën letrare, gjithnjë sipas Proust-it, vendin e "të shpikurit" më shumë, se vendin e "të shprehurit" të vetvetes. Kështu ndodh me disa poezi të veçanta të Lasgush Poradecit gjatë receptimit të tyre.

[667] Në: Gazeta "Nositi", Pogradec, nr. 401, qershor, 2004, fq. 8.

XIII. KAPITULLI I DYMBËDHJETË

RECEPTIMI PËRMES LEXIMIT ELEKTRONIK

XIII.1. Leximi on-line i poezisë së Lasgush Poradecit

Vitet i fundit, faqet letrare elektronike kanë marrë një zhvillim të madh, çka ka ndikuar në shtimin e interesit të përdoruesve të internetit. Kryesisht moshat e reja në Shqipëri dhe jo vetëm po bëhen pjesë e leximit të faqeve të ndryshme. Dihet që kjo po dëmton metodën tradicionale të leximit të librit për shkak të lehtësirave të shumta që interneti ofron në gjetjen, blerjen dhe leximin e tij. Ky lloj shërbimi bën që libri t'u shkarkohet me shpejtësi lexuesve në çdo kohë dhe vend, risi që do të ndikojë edhe në të ardhmen e afërt në shtimin e numrit të lexuesve, të librave apo faqeve on-line.

Interneti si një mjet i rëndësishëm komunikimi, aktualisht konsiderohet si lehtësia e mijëvjeçarit të ri që po luan dhe do të luajë një rol të rëndësishëm në rritjen e nivelit të iluminizmit publik. Nën këtë kërshëri, zhvillimi i internetit është shoqëruar edhe me shtimin e interesimit të publikut për librin apo faqeve (web-et) on-line të cilat publikojnë fragmente librash letrarë dhe jo letrarë.

Në këtë kuadër shkrihet koha e humbur dhe një vend të veçantë zënë faqet që të ofrohen në internet, faqe të cilat mund të posedohen lehtësisht nga lexuesit në mbarë botën në mënyrë të rrufeshme. *"Nga studimet që janë kryer lidhur me këtë çështje, ka rezultuar se për momentin dhe nuk dihet se për sa kohë do të jetë kështu, interneti dhe libri këto dy forma të ndryshme të transmetimit të informacionit janë më tepër ndihmuese dhe plotësuese të njëra-tjetrës, pra ato thjesht shtojnë njohuritë e përdoruesve të tyre, dhe ende nuk bëhet fjalë për një konflikt që mund të krijohet me përdorues dhe lexues, të cilët janë të ndarë në dy kategori; përdorues të internetit dhe lexues të librave"*.[668]

Gjithsecili prej nesh, për të plotësuar nevojat e tij, preferon t'i alternojë të dyja, për të qenë kështu sa më i informuar, lidhur me një çështje apo një tjetër. Saktësisht, me vendin që zë në internet përmes faqeve on-line Lasgush Poradeci, mjafton të shkruash në *"Google"* emrin e tij dhe hapen dhjetëra faqe të tilla për poetin. Jeta dhe vepra e lirikut poradecar tani ekziston edhe përmes tyre. Përpos kemi edhe *fotografi (imazhe)*[669] të poetit.

Së pari, është *"Wikipedia"*[670] që të jep informacion të përgjithshëm për lirikun. Ndërkohë pas saj ka edhe shumë syresh të tillë, që të ofrojnë poezi të Lasgushit. *"Forumi shqiptar"* zë një rol të veçantë në këto faqe on-line, ku njerëz të ndryshëm diskutojnë, komentojnë, analizojnë apo shkëmbejnë mendime për poezinë e Lasgush Poradecit.[671] Lexuesit janë anonim ose shkruajnë me pseudonime.

Janë 23 faqe kërkimi në Google për jetën dhe veprën letrare të Lasgush Poradecit. Në njërën prej tyre, vetëm poezia *"Dremit liqeri"* [672] rezulton e lexuar nga nga 2237 lexues. Kjo poezi është hedhur në internet më 19 korrik të vitit 2013. Duhet thënë se kur ende nuk është mbushur ende një vit nga publikimi i saj on-line ajo rrit çdo ditë numrin e lexuesve të saj.

---

[668] O. Tavani, *http://www.gazeta-agon.al/mat.php?idm=19284&l=a*

[669] *https://www.google.al/images?hl=sq&biw=&bih=&q=Lasgush+poradeci&gbv=2&sa=X&oi=image_result_group&ei=YLIhU66eGcf-ygOGzILACg&ved=0CCQQsAQ*

[670] *http://sq.wikipedia.org/wiki/Lasgush_Poradeci*

[671] *http://www.forumishqiptar.com/threads/1337-Lasgush-Poradeci/page2*

[672] *http://www.kilikos.com/publ/letersi/lasgush_poradeci/lasgush_poradeci_dremit_liqeri/6-1-0-8*

Nga kontakti me këtë faqe, deri më datën 17 mars, 2014, ora 13:58', rezulton se lexuesit e saj ishin 2237 persona. Forumi *"Horizont"*[673] në faqen e tij on-line ka të postuara nga lexues të ndryshëm 21 poezi të poetit deri më 17 mars, 2014. Vetëm biblioteka on-line *"Kritika Letërsi"* ka të publikuara në faqen e saj dy poezi, *"Kush ta fali bukurinë"* dhe *"Zemra"*[674]. Ato rezultojnë të lexuara nga 16. 506 lexues deri në orën 14:21' datë 17 mars, 2014.

Ky informacion jepet në fund të faqes. Poezitë janë publikuar më 10 nëntor 2007. Po deri në këtë datë vetëm vargjet: *Për Dashurinë O Zot, që shemb një burrë,/ që s'e pat ndjerë dot gruaja kurrë!*,[675] publikuar në faqen on-line të revistës *"Poezia shqiptare"* numërojnë si lexues të tyre 610 të tillë.

Poezia *"Vallja e luleve"*[676] në faqen elektronike *"Rapitful"* numëronte deri në orën14:36' të datës së mësipërme të hartimit të këtij kapitulli, 29. 255 lexues. Revista on-line *"Bukureza"*[677] ka të publikuara *poezitë "Kroi i fshatit tonë"; "Maja e çelur"; "Dimër"; "Vallja e yjve"; "Gjarpërushja"; "Kush ta fali bukurinë"* dhe një biografi të shkurtër të Lasgushit. Ajo mban si datë të ngarkimit së saj 18 gushtin, 2013. Numri i lexuesve të poezive të Lasgushit në këtë revistë elektronike, deri në datën 17 mars, 2014, ora 14:45' shkon në 1100.

Biblioteka Kombëtare Tiranë, në një nga faqet elektronike të saj përmban vetëm për Lasgushin 390 regjistrime të gjetura. Ato jepen të detajuara me shkrim në ngjyrën e kuqe dhe janë paraqitje e shkurtër regjistrimesh.[678] Kësaj faqeje i mungon numri i vizitorëve ose lexuesve, por sigurisht llogariten me mijëra, pasi dihet fluksi i madh i lexuesve në bibliotekën kombëtare, Tiranë.

Nëse do të ndaleshim në shumë faqe të tjera on-line që kanë të publikuara poezinë e Lasgush Poradecit, apo pjesë të bigrafisë së tij shoqëruar edhe me foto personale të poetit, pa llogaritur shkrime të ndryshme për veprën letrare të tij, numri i vizitorëve lexues shkon në miliona, numër që rritet nga ora në orë dhe nga dita në ditë.

Aktualisht nuk mund të japim një numër të saktë të lexuesit elektronik të poezisë së Lasgush Poradecit, konkretisht një satistikë të qartë, sepse një pjesë faqesh elektronike nuk e kishin të publikuar rubrikën e vizitorëve që i klikojnë apo i lexojnë ato. Brenda kësaj statistike elektronike, do të ishte normale që të ekzistonte edhe ky numër lexuesish, i cili mungon për neglizhencë të personave që i menaxhojnë këto faqe on-line në internet. Përfundimisht, duhet të theksojmë se lexuesit on-line të jetës dhe veprës letrare të Lasgush Poradecit sa vjen dhe rriten. Kjo vlen edhe për shkrimet jo on-line, për veprën letrare të poetit të të gjithë shqiptarëve.

Përkufizimi për njeriun e lindur poet L. Poradecin, vjen edhe përmes një titulli të përzgjedhur nga shumësia e shkrimeve për të on-line nga A. Vataj, ku ndër të tjera po citojmë: *"Vetëm një titull honorifik i dhanë, kur ai mbushi 100 vjet nga dita e lindjes së tij, i vetmi titull në jetën e tij... i ulur vetëm në fronin e poezisë, krijonte dhe do të krijojë lexues me sekretin e mosdhënies së ideve të zakonshme. Për t'i dhënë poezisë së tij, gëzimin e kuptimit dhe të jetëgjatësisë ndaj shekujve indiferentë. Ai ka ikur fizikisht... më parë, ndërsa ende shumë të tjerë rrotullohen rreth emrit të tij nën shiun e fjalëve dhe mjegullën e dendur të veprave të tyre. Iku dhe la pas një liqen të kaltër,*

---

[673] *http://forumihorizont.com/printthread.php3?s=547fbc5edddb7c204c83284e42e6b97b&threadid=2311&perpage=34*

[674] *http://www.gazetakritika.net/Forumi/index.php?itemid=474*

[675] *http://www.poeziaime.com/index.php/poezi/entry/lasgush-poradeci-.html*

[676] *http://rapitful.blogspot.com/2012/03/vallja-e-luleve-lasgush-poradeci.html*

[677] *http://bukureza.blogspot.com/2013/08/lasgush-poradeci-poezi-dhe-biografia.html*

[678] *http://www.bksh.al/adlib/scripts/wwwopac.exe?&DATABASE=catalo&OPAC_URL=/adlib/expert/index_al.html&LANGUAGE=1&lp=Poradeci,+Lasgush&LIMIT=50*

vargjet për të cilin diti t'i thurrte vetëm ai. Iku duke mbetur përgjithnjë aty, mes dallgëve të kaltëra, për të fluturuar së bashku me erën e liqenit nëpërmjet poezive që shkroi vetë ai".[679]

Përfundime:

Në internet, në faqe të ndryshme on-line (23 të tilla) gjen 35 poezi të L. Poradecit (numër, i cili mund të rritet nga dita në ditë, orët, apo minutat). Ato herë-herë janë fragmente poezish ose një strofë e vetme, por në të shumtën e rasteve janë poezi të plota apo pjesë jetëshkrimi të vetë poetit.

Ka faqe që i qëndrojnë besnike origjinalit të poezisë, janë korrekte dhe pa gabime drejtshkrimore, ndërkohë që ekzistojnë faqe të cilat, poezive lasgushiane u heqin lidhëza, parafjalë ose u shtojnë të tilla. Mbaresat dhe prapashtesat vijnë sipas kulturës gjuhësore të gjithkujt, që i ka postuar poezitë në to. Madje, ka faqe on-line, në të cilat mungon përdorimi i zanores -ë-. Poezitë janë shkruar duke përdorur zanoren -*e*-, në vend të zanores -*ë*-, gjë e cila vështirëson leximin e tyre...

[679] *http://alsiva.wordpress.com/2012/06/05/lasgush-poradeci-liriku-qe-vallezon-me-yjet/*

XIV.KAPITULLI I TREMBËDHJETË

Pyetësori

XIV.1. Receptim përmes një pyetësori

Bart thekson se lexuesi është gjyqtari bazë i domethënies së një teksti. Ndërkohë, mund të supozojmë, padyshuar se mund të gabojmë ose jo, që letërsia ndikon mbi njerëzit, veçanësisht mbi të rinjtë më drejtpërdrejt, më fuqishëm, sesa mbi brezin e vjetër. Brezi i ri mund ta lexojë krejt ndryshe Lagsush Poradecin dhe mund ta receptojë poezinë e tij të dashurisë po ndryshe, por sado ndryshe ta përjetojë atë, prapë se prapë robërohet nga magjia e artit lasgushian. Në qoftë se dashuria së jashtmi është bërë në ditët tona më praktike, thelbin i saj romantik të brendshëm nuk mund të ndryshojë asnjëherë. Njerëzit, kur dashurojnë, edhe pse mund ta "zbulojnë" veten apo jo, ata gjithsesi dashurojnë në formatin e tyre. Në çdo pamje gjithçka është dhe mbetet pjesë e jetës në dashuri. Sigurisht edhe në poezinë e Lasgush Poradecit dashuria është një pjesë jashtëzakonisht e rëndësishme, që receptohet ndryshe në çdo kohë.

Brenda këtij argumenti mund të themi, se lexuesit pa përvojë e marrin letërsinë në mënyrën më naive të tyre, e kuptojnë si kalk të jetës e jo si interpretim të saj. Ndërkaq, ata lexues që kanë lexuar më pak libra, e marrin leximin me më seriozitet, se sa lexuesit që e kanë bërë leximin profesion dhe ritual të përditshëmrisë së tyre.

A mund të shkohet përtej këtyre hamendjeve? A mund të përdorim mbi këtë pyetsor mënyra të tjera "hetimi" mbi lexuesit e çdo grupmoshe? Nuk mund të japim ndonjë situatë objektive, sepse çdo rast i veçantë varet tërësisht nga kujtesa dhe aftësitë analitike të atyre që u pyetën, kurse përgjigjet e tyre u kodifikuan dhe u vlerësuan më tej në materialin e mëposhtëm të përpunuar dhe argumentuar mbi to. Duhet të theksojmë se në përpunimin e çdo pyetje të këtij pyetsori, u përfshinë dhe u shtjelluan informacione aktuale, të cilat sigurisht përfshin ose jo marrëdhënien e lexuesit në një kontekst të caktuar të ngjarjes së përfshirë në të.

Pyetja e shumëdiskutuar se sa ndikon letërsia te publiku, është një pyetje empirike e, nëse do të gjejë përgjigje, ajo gjen terrenin e saj duke ju drejtuar përvojës dhe meqë për letërsinë, si dhe për elementin sociologjik brenda saj, (në kuptimin e tyre të gjerë), atëherë duhet t'i drejtohemi jo përvojës së njohësit të "djallëzuar", por përvojës së racës njerëzore. Kur vjen fjala te raportet mbi lexueshmërinë e gjigandëve të poezisë shqipe, që kanë epërsi me tekstet letrare, Lasgush Poradeci (1899-1987) krahas Naim Frashërit dhe Çajupit, mbetet më i preferuari dhe nga më të lexuarit, po aq sa poetët botërorë si Esenin, Neruda, Pushkini etj.

Vitet e fundit vepra e Lasgush Poradecit është ribotuar e plotë nga familjarët e tij, me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës Turizmit Rinisë dhe Sporteve. Konkretisht, botimi i veprës poetike është bazuar në botimet e dy librave poetikë që u shtypën së pari në Bukuresht, duke mbajtur parasysh shënimet dhe korrigjimet që Poradeci ka bërë në anë të faqeve të tyre përfshirë dhe shpjegimet e fjalëve në fund të poezive të cilat i bën gjithashtu vetë ai, poeti. Me këto dy libra që i shkroi sa në Pogradec e Athinë, aq edhe në Bukuresht, deri në vitet tridhjetë, Lasgushi mbeti i parapëlqyer te lexuesi i tij i preferuar, në grupmosha të ndryshme. Poezia është një dimension që në moment të jep një emocion të madh, të jep gjithë botën brenda vargjeve. Lasgushi mund të konsiderohet prijësi i poezisë së dashurisë. Poezitë e tij, pa asnjë frikë të ndërtojnë mes vargjesh biografinë e poetit edhe, madje pa e njohur atë më parë.

"Ti po vjen që prej së largu" është poezia që i bën të themi autobiografinë vetë poetit. *"Prandaj"* është një tjetër poezi që përfshin dhe bën njësh brenda saj gjithë mentalitetin njerëzor. Brenda vargjesh, ai flet fillimisht për një vashë, pastaj për një

grua, të cilat, autori i do të dyja, edhe vajzë, edhe grua, por në ndonjë rast edhe duke guxuar më tej. Kjo tregon që Lasgushi mbetet poet i guximshëm në letërsinë shqipe. Gjoli (liqeri) ka qenë frymëzimi i tij, natyra ka qenë dashuria e tij, vasha kanë qenë fshehtësia e tij, ambienti në përgjithësi ka qenë qyteza e dashuruar. Dhe kjo e bën atë poet të veçantë dhe të dhembshur, por edhe tepër të dashur për lexuesin. Rileximi i poezisë së Lasgush Poradecit nëpër kohë fiton dimensione më të plota.

Vetë poeti Lasgush thekson se *"Kur shkruan poezi duhet ta kesh shpirtin e shenjtëruar. Çdo poezi duhet të jetë një xhevahir dhe xhevahir duhet të jetë çdo varg i saj dhe çdo fjalë e saj duhet të jetë xhevahir. Prandaj poezi mund të shkruash vetëm pak, se ku t'i gjesh gjithë ata xhevahirë? Poezia duhet të jetë cilësi jo shumësi. Mos ki frikë se ke shkrojtur gjatë jetës tënde vetëm dhjetë poezi"* .

Në këtë kapitull do të japim rezultatet e një studimi në të cilin parashtruam 22 pyetje, lidhur me jetën dhe veprën letrare të poetit Lasgush Poradeci, bazuar në përgjigjet themeltare të shprehura nga të anketuarit, të krahasuara me interpretimin e përgjithshëm dhe raportin që del po prej analizës së tyre. Në fakt ky rezultat nuk ishte i papritur për ne. Disa nga pyetjet kishin kuptim të drejtpërdrejtë për të anketuarit tanë. Nga 200 të anketuar, të ftuar për t'iu përgjigjur pyetsorit në mënyrë anonime me shkrim, na erdhën po 200 përgjigje. Për arsye që të përfshinim grupmosha të ndryshme në mbushjen e pyetësorit, e shtymë kohën, nga një muaj që e kishim vendosur më parë edhe për tri javë të tjera, deri në mes korrikun 2010. Nga një masë përgjigjesh pak më e lartë se 52%, mund të konstatojmë se këto opinione përfaqësojnë një shumicë të grupmoshave të ndryshme popullsisë shqiptare.

Kërkesat e dërguara: 200; Kërkesat e mbledhura: 200; Totali i përgjigjeve të marra me shkrim 200;

Kampioni mbetet përfaqësues dhe është bërë në mënyrë rastësore. Në të janë përfshirë jo vetëm studentë por edhe njerëz me shkollë dhe pa arsimim. Kategoritë e përfshira në këtë pyetësor ishin: Pensionistë 10%, punonjës në administratë 20%, studentë 25%, nxënës me arsim 9-vjeçar dhe të mesëm 20%, popullsi e zonave rurale 15% dhe popullsi në zonat urbane e paarsimuar (analfabetë ose vetëm me arsim fillor) 10%. Vërejmë se të gjithë janë dakord (100 %) që Lasgush Poradeci është poet pogradecar. Ndonjëherë të duket sikur të njëjtat pyetje dhe të njëjtat përgjigje krijojnë një rreth të mbyllur raportesh të ndryshme. Për një seri pyetjesh opininionet e të anketuarëve ishin të përziara.

Zona e anketimit u shtri në pyetësor pothuajse të gjithë vendin tonë. U përfshinë studentë nga jugu dhe veriu i Shqipërisë bashkë me familjet e tyre. Në këtë kuadër pyetësori përfshiu në vetvete grupmosha të ndryshme të anketuarish.Vlen të theksohet se prindrit e studentëve veriorë të anketuar nga ne, që studionin në Universitetin e Korçës e dinin që Lasgushi ishte poet pogradecar, mbase duke u nisur nga mbiemri i personalizuar i qytetit turistik të Pogradecit, që në këtë rast është pjesë e pseudonimit letrar të tij.

Në gjithë përiudhën e viteve '30, në Shqipëri shkrimtarët të cilët krijuan dhe jetuan brenda dhe jashtë vendit stisën pseudonimet e tyre letrare. Llazar Sotir Gusho alias Lasgush Poradeci do të përjetësohet i tillë, jo vetëm atëherë, por edhe pas vdekjes së tij, madje edhe në ditët tona. Shumë shkrime të viteve 1930 vijnë mes nesh të nënshkruara me pasudonime letrare. Disa autorë përdorën dy apo tre pseudonime letrare.

Llazar Gusho përdori vetëm një, atë të Lasgush Poradecit, ndryshe nga kumbari i tij i poezisë Dhimitër Pasko, që krijoi tre të tillë. Për shembull Dhimitër Pasko na prezantohet me (Mitrush Kuteli, Izedin Jashar Kutrulia dhe Dr. Pas). Me sa duket poetit të liqerit i mjaftoi një i tillë, i cili jo vetëm i ngjiti, por edhe i solli shumë fat,

ndërsa e futi atë në pavdekësi.[680;681] Dua të sqaroj se në të gjithë grafikët e pyetësorit, vlerat e rezultateve paraqiten me ngjyrë vjollcë, ndërsa përqindjet respektive të tyre me ngjyrë vishnjë.

Pyetja 1

Mosha juaj ?	Nr. i personave	%
8-12 vjeç	0	0
13-17 vjeç	15	7.5
18-24 vjeç	25	12.5
25-29 vjeç	100	50
30-34 vjeç	10	5
35-39 vjeç	10	5
40-44 vjeç	10	5
45-49 vjeç	0	0
50-54 vjeç	10	5
55-59 vjeç	0	0
60-64 vjeç	0	0
65-69 vjeç	10	5
70-74 vjeç	0	0
75-79 vjeç	10	5
80...vjeç e në vazhdim	0	0



Në hartimin paraprak të pyetësorit u përfshinë grupmosha të ndryshme të cilët u testuan për përgjigjet e pyetjeve që ata do të na jepnin. Konkretisht: 8-12 vjeç; 13-17 vjeç; 18-24 vjeç; 25-29 vjeç; 30-34 vjeç; 35-39 vjeç; 40-44 vjeç; 45-49 vjeç; 50-54 vjeç; 55-59 vjeç; 60-64 vjeç; 65-69 vjeç; 70-74 vjeç; 75-79 vjeç; 80 vjeç e në vazhdim…; Duke pasur të tilla mosha në përgjigjet e pyetësorit ai do të ishte për ne më i vërtetë dhe më bindës.

Në këtë kuadër u porositën studentët në shpërndarjen e tij të ishin sa më gjithëpërfshirës me njerëzit e afërm të tyre. Pjesën më të madhe të të anketuarëvë e përbënte mosha 25-29 vjeç, të cilët ishin 100 vetë, pra saktësisht 50%. Moshës 18-24 vjeçare i përkisnin 25 vetë ose 12,5% dhe moshës 13-17 vjeçare i përkisnin 15 vetë ose 7,5%. Brenda këtij përpunimi të dhënash duhet të themi se anketues të moshave 8-

[680]P. Daka, *Fjalor pseudonimesh (1743-1944)*, Botim i Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shtëpia botuese "Shkenca", Tiranë, 1998, fq. 100.

[681]P. Daka, *Fjalor pseudonimesh, anagramesh dhe siglash të përdoruara në shtypin shqiptar dhe në botime të tjera*, në "Studime filologjike", nr. 4, Tiranë, 1967, fq. 198.

12 vjeçare; 45-49 vjeçare; 55-59 vjeçare; 60-64 vjeçare; 70-74 vjeçare dhe 80 vjeç e në vazhdim, nuk u përfshinë fare në plotësimin e pyetësorit.
Ndërkohë katëgoritë e grupmoshave të tjera përfshinë 60 vetë, saktësisht 30% e tyre, të cilët u bënë pjesë e mbushjes së tij. Për shkrimin e pyetësorit u kërkua të përdorej stilolaps me ngjyrë blu. Të anketuarit u porositën paraprakisht t'i vendosnin përgjigjet e tyre brenda kuadrateve përkatës, që gjendeshin bri pyetjeve në fletën e pyetësorit. Qëllimi i këtij pyetësori ishte të mbledhte të dhëna në lidhje me perceptimin e jetës dhe veprës së Lasgush Poradecit ndër lexues. Informacioni që do të jepej, do të ishte i gjithi anonim. U sqarua që pyetësori do përdorej vetëm për arsye studimi në përpilimin dhe analizimin e të dhënave përfundimtare.
Gjithëkush duhet të vendoste shenjat +; –; apo X; brenda kuadratit përkatës të alternativës së përzgjedhur.

Pyetja 2

Cili është niveli juaj arsimor ?	Nr. i personave	%
Analfabet	20	10
8-vjeçar	15	7.5
I mesëm	35	17.5
I lartë	110	55
Pasuniversitar	20	10



Në pyetësor u pa e udhës që studentëve të largët që vinin kryesisht nga veriu i Shqipërisë, madje nga zona të thella si Hasi, Kukësi dhe Puka t'ju jepej edhe një pyetsor tjetër, i cili do të mbushej nga të afërmit, miqtë dhe shokët e tyre. Ideja ishte që të përfshiheshin në pyetësor grupmosha të ndryshme njërëzish, por edhe të kishte një shpërndarje gjeografike sa më të gjerë, duke përdorur kampionin empirik "top-dëborë".[682]
Zgjedhja e shumëfishtë "top-dëborë" përfshin përdorimin e metodave probabilitare për një përzgjedhje fillestare të elementëve të kampionit dhe pastaj shtimin e shumëfishtë të njësive të zgjedhjes nëpërmjet përdorimit të informacionit të siguruar nga elementët fillestarë. Reduktimi i madhësisë së zgjedhjes dhe kostot e ulëta janë përparësitë e kësaj metode zgjedhjeje të referuar nga ne.

[682] *http://www.slideshare.net/luzisokol/metoda-krkimi-kapitulli-4-zgjedhja*

Pyetja 3

Gjinia që i përkisni ?	Nr. i personave	%
Femra lexuese	120	60
Meshkuj lexues	80	40



Femrat janë më të tërhequra pas poezisë lirike, pasi e receptojë atë në mënyrë mjaft të brishtë. Mbase lirizmi i poezisë ju fal konotacion pozitiv më tepër receptueseve femra, sesa receptuesve meshkuj. Grupmosha të ndryshme, të tilla, janë ndjerë mirë nën emocionin që të fal leximi i poezive të Lasgushit.

Roli i femrave si publik dhe lexues në shekullin e XXI, dhe roli i meshkujve po si publik dhe lexonjës së poezisë së Lasgushit, në këtë mijëvjeçar të ri, tregojnë se prezenca e përqindjes anon më tepër nga seksi i bukur, që është vetë femra, të cilat mesa duket janë të namuruara pas poezisë së Lasgush Poradecit, sesa burrat.

Ky rraport me një fjalë nuk është i njëjtë mes femrës lexuese dhe mashkullit po lexues. Gjithçka statistikisht është shprehur me një njëzet për qindësh më shumë për gjininë femërore. Femra duke qenë nga natyra e saj edhe më e hedhur apo më çapkëne, në këtë lloj poezie më së shumti ndjehet më mirë se meshkujt. Lexuese femra kemi 120 ose (60%) dhe lexues meshkuj kemi 80 ose (40%). Vargu soft i Lasgushit, i përshtati figurës femërore një fjalor tipik personal. Ai shpesh vinte imponues në tërësinë e poezive. Studentet e degës gjuhë-letërsi shqipe në Universitetin e Korçës kishin njohje më të hershme me fjalën dhe poezinë e Lasgush Poradecit, ndaj mund të themi që mes poetit dhe lexuesit femëror-krijohet një lidhje shpirtërore e brendshme më e fortë. Pa e kuptuar vjen një ditë, që ai, Lasgush Poradeci të udhëheq në shijet e tua poetike dhe kështu ndodh më këtë gjini delikate. Nën këtë vështrim, Lasgushi e ka mbajtur pranë lexuesin femëror me fjalën e tij të zgjedhur, vargun muzikal dhe ritmin e saj. Duke e lexuar dhe duke e njohur peshën e fjalës lasgushiane, ato e pëlqejnë këtë poezi.

Vasha e Lasgushit është një krijim i imagjinatës së tij, që më së miri i përket realitetit të kohës kur poeti vargëzoi. Janë thjesht koncepti i femrës, objektit të adhurimit dhe dashurisë së skajshme për të në poezi, momente që prangojnë gjininë femërore. Kjo duket prej tipareve të saj të kudogjendura në poezi.

Veç bukurisë, pastërtisë, përskuqjes, s'ka asnjë të dhënë në poezi për emrin, profesionin, intelektin, interesat e saj... Prezenca e grave mbetet në vetvete një tjetër studim i imët për rolin e familjes dhe të femrës, si publik dhe si lexues në shekullin e XXI, në letërsinë shqiptare. Gjithsesi, në këtë pikë femrat na rezultuan si lexueset më të zellëshme të poezisë së Lasgush Poradecit, duke përbërë 60% të të anketuarëve.

Pyetja 4

Cili është vendbanimi juaj ?

Personat e përfshirë në pyetsor ishin studentë kryesisht nga Qarku i Korçës. Ndërkaq, duhet të theksojmë se dhjetë ishin studentë nga zonat e thella të Veriut shqiptar që studiojnë në universitetin "Fan S. Noli" të Korçës, të cilët morën më shumë se një pyetësor me vete, për ta plotësuar edhe prindërrit apo të afërmit e tyre (konkretisht nga Kukësi, Puka dhe Hasi i Veriut shqiptar).

Jo rastësisht ata kanë zgjedhur Universitetin e Koçës për t'u diplomuar në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, Dega: Gjuhë-Letërsi Shqipe, pasi shpërndarja e preferencave të tyre bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Gjashtë ishin vajza dhe katër djem. (Rreth 20%). Njëqind e dhjetë ishin studentë nga qyteti i Korçës dhe fshatrat përreth (55%). Një pjesë studentësh ishin të grupmoshave të ndryshme pasi u përfshinë edhe nga studimi me kohë të pjesshme të këtij universiteti. Njëzet e pesë nga Pogradeci dhe fshatrat (13%), njëzet e katër nga Bilishti e fshatrat (12%) si edhe njëzet e një nga Erseka dhe fshatrat përreth (11%).

Pyetësorët e shpërndarë kërkonin kohën e mjaftueshme për t'u menduar dhe më tej për t'u mbushur drejt, kohë e cila supozohet se nuk ju ka munguar, që përgjigjet e tyre të ishin sa më të personalizuara dhe të sakta. Në një pyetësor vendbanimi është kusht kryesor, sepse të adreson më saktë dhe më drejt në hapësirën gjeografike që gjithkush kërkon ta sjellësh në analizë, si pjesë e një interpretimi gjithëpërfshirës të punimit të tij shkencor. Në këtë kuadër ky "mision" quhet i përfunduar me sukses... pasi prezenca e tyre e dëshmon angazhim në mbushjen e tij.

Pyetja 5

Ju mund të thoni se Lasgush Poradeci është...?	Nr. i personave	%
Piktor	50	25
Shkrimtar	150	75
Aktor	20	10
Arkitekt	0	0
Këngëtar	6	3
Politikan	5	2.5
Më shumë se një alternativë	180	90



Shumica e të anketuarve lidhur me pyetjen e pestë, u shprehën të sigurtë se Lasgush Poradeci është shkrimtar 150 (75%), madje një pjesë e mirë e tyre ishin të informuar që Lasgushi ishte edhe piktor 50 (25%). Shumica e opinioneve të tyre jepen me më tepër se një alternativë të qarkuar, ç'ka të linte të kuptoje që krahas poetit kombëtar Poradeci ishte për ta edhe piktor. Zhurma piktorike ndërkohë vijon të trandë mediat shqiptare.

"Një poet është vetvetiu piktor, aq më tepër kur poezia e tij mbetet një pikturë e ngrirë në bojëra vaji. Lasgushi mori kulturën e duhur përmes studimeve në Akademinë e Arteve të Bukaura në Rumani. Kështu, Poradeci do të do të pikturojë portretin nudo, të një vajze rumune. Fakte e kujtime të tilla e lidhin poetin tonë me pikturën, madje edhe punët e pikturuara të Androniqi Xengos. Piktura dhe vizatimet e realizuara nga Lasgushi janë plot 54. Ndër to përmendim: "Dy cicat që tronditën botën", telajo, përmasa 70x50cm; "Portret i Stanisllavës" me mbishkrimin "Stanisllava kur e putha në llërë", me laps, përmasa 54x64cm; Eqrem Çabej duke pirë cigare" me laps, përmasa 14.5x10cm; "Mitrush Kuteli ulur mbi arkë", me laps, përmasa 38x14cm etj.

Pra, më 1 tetor 1922 Lasgushi është anëtar i Shoqërisë së Studentëve të Shkollës së Arteve të Bukura në Rumani. Pikturat me ngjyra vaji Lasgushi i ka në këtë periudhë të jetës së tij. Në konkursin e provës, vizatoi skulpturën e perëndeshës Afërdita. Madje, kur u dhanë rezultatet Lasgushi doli i pari. Më 1 dhjetor 1934, Lasgushi emërohet profesor vizatimit dhe bukurshkrimit në Liceun Shtetëror të Tiranës. Tërë poezitë e tij kanë fjalë të pavdekshme që ftillëzojnë imazhe të pabesueshme. Një poet është vetvetiu edhe piktor edhe nëse nuk bën kurrë pikturë. Punimet te Lasgushi shpalosin mrekullitë fabuleske te liqerit, lëvizjen në shtërngatë, urinë botiçeliane të të dashurave, sakrificat biblike të pelikanëve, që poeti i mbiquan peliaknë".[683]

Vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve kishin shënuar që ai ishte politikan, 5 vetë ose 2,5%, kishin bindjen e tyre se Lasgush Poradeci ka qenë pjesë politikëbërjes në vitet '30 të shekullit të kaluar në Shqipërinë e Mbretit Zog. Një pjesë kishin mendimin që Lasgushi ka qenë pjesë përbërëse e deputetëve shqiptarë, pasi veç shenjimit të bërë te fjala poet, ata kishin shenjuar edhe fjalën politikan.

Mesa duket klima politike e viteve '30 prekte për ta edhe intelektualin e rikthyer në atdhe për të jetuar dhe kontribuar për Shqipërinë si shumë të rinj të atyre viteve, të cilët gjendeshin mes alternativës, të qëndronin larg atdheut apo të riktheheshin e t'i shërbenin atdheut.

Gabimi i anketuesve është fare i vogël në kontekst të pyetjes së gjashtë. Gjithashtu, duhet thënë se opinionet e tyre janë të bashkuara në dualitetin e përgjigjeve që ata japin se Lasgushi ishte edhe aktor, edhe këngëtar.

180 (90%) e tyre justifikojnë përgjigjen e saktë. Të anketuarit kanë menduar se poeti poradecar ka qenë edhe artist i filmit dhe këngës, duke u nisur nga shumë figura të asaj kohe, të cilët u angazhuan me këto gjini brenda dhe jashtë Shqipërisë. Mbase të menduarit gabim vjen edhe prej faktit që mjaft poezi të Lasgushit, janë muzikuar në vite, nga kompozitorë të ndryshëm shqiptarë...

Shkrimtari dhe piktori u gërshetuan më së miri në alternativat e atë anketuarve, duke justifikuar njohuritë e tyre të fituara apo të mësuara përmes leximit apo orës së mësimit, qoftë kjo akademike apo edhe në nivele të të tjera të arsimit parauniversitar shqiptar. Theksojmë se piktura mbetet njëra anë e medalies së shkrimtarit që realisht ka pikturuar me ngjyra dhe "fjalë" apo ka vargëzuar me fjalë dhe "ngjyra", që sigurisht të anketuarit e kanë pasur parasysh në pjesën më të madhe të tyre në përgjigjet që dhanë për këtë pyetje.

Pyetja 6

Në cilin ambient, ju keni dëgjuar për emrin ose veprën e tij …?	Nr. i personave	%
Në shkollë	155	77
Në familje	50	25
Në bibliotekë	22	11
Nga shokët	0	0
Në tv	150	75
Në radio	16	8
Më shumë se një alternativë	170	85

[683]M. Zeqo, *Lasgushi dhe engjëjt e pikturës*. Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë 2003, fq. 5.
Të ritë e viteve të mi. Koleksion i pikturave të Lasgush Poradecit, Shtëpia botuese "albPAPER", Tiranë, -64f.



Të dëgjosh për një poet ndodh shpesh në jetë. Ai, një ditë të bëhet prangim i kënaqësisë shpirtërore që të fal vepra e tij. Është interesante të shohësh sesi të anketuarit vetë, e perceptojnë idenë që për Lasgushin kanë dëgjuar për herë të parë në shkollë, konkretish në vitet e sistemit mësimor parauniversitar.
Ata janë 155 të anketuar, ose 77%. Poezia lasgushiane ka tërhequr vëmendjen e lexuesve më tepër mbase me ndonjë varg erotik. Ndjeshmëria e publikut drejt këtij parapëlqimi mbetet e pritshme. Pjesa e madhe e të anketuarve kanë dëgjuar për veprën letrare dhe jetën e poetit veçanërisht në masmedia. Janë 150 të tillë ose 75% që kanë dëgjuar përmes mjeteve të informimit ekzistencën e poetit poradecar.
Më së shumti rolin kryesor e zënë televizioni dhe radio, që e kanë trajtuar figurën e poetit mes kronikash dhe emisionesh të ndryshme. Mbase në familjen shqiptare flitet pak ose aspak për një poet. Familja shqiptare mund ta ketë ose jo një libër artistik në bibliotekën personale. Shkak për mungesën e një libri poetik të Lasgush Poradecit, në bibliotekën personale është edhe tirazhi i vogël i veprës letrare të poetit ndër vite. Receptuesit e kanë kërkuar nëpër librari dhe nuk e kanë gjetur.
Një shkak më vete ka qenë edhe çmimi i lartë i veprës poetike nr. 1 (poezia) edhe pse ajo mbetej një financim i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Vetëm 50 vetë ose 25 për qind e të anketuarve kishin dëgjuar të flitej në familjen e tyre për veprën letrare të poetit, apo të kishin një libër poetik të Poradecit. Dihet që biblioteka kudo dhe gjithëkund mbetet një oaz dijesh të padiskutuara për rëndësinë e madhe që ajo mbart ndër njerëz, të cilët kërkojnë të afirmojnë vetëveten në koherencën tonë. Por çuditërisht 22 të anketuar ose 11% kishin dhënë një përgjigje e cila do të ishte mirë të ishte alternativa 100% e të gjithë të anketuarëve.
Fakti mbetet kokëfortë, ç'ka nënkupton se bibliotekat frekuntohen pak ose aspak nga lexuesi. Kjo vatër infromimi për shkrimtarët dhe veprën e tyre letrare zë shumë pak vend në shoqërinë tonë. Mbase mungesa e një tirazhi gjithpërfishirës për gjithë masën e lexuesve të etur për poezinë lasgushiane, bën që informacioni për poetin të jetë i vakët në ambientet e bibliotekës shqiptare.
Pjesa më e madhe e numrit në total të anketuesve me 0 përqind kishin shmangur opsionin shokët. Askush nuk e kishte marrë informacionin për krijimtarinë lasgushiane nga shokët apo shoqet e tij. Kjo të bën të besosh se libri zë shumë pak vend, në jetën e përditshmërisë së të të anketuarëve. Mbase këngët, hite botërore apo filmat zënë një vend më të rëndësishmëm ndër ta për diskutime. Eshtë për të ardhur

keq, që libri nuk zë vend në këto diskutime, që ata bëjnë në përditshmëri. 170 vetë ose 85% e tyre kishin dhënë më shumë se një alternativë në përgjigje.
Kjo shkallë e lartë përgjigjesh tregon se ata në një farë mënyre kanë informacion për jetën dhe veprën letrare të Lasgush Poradecit. Madje dinë edhe vargje të ndryshme të poezive të poetit. (shih vijimin e pyetësorit).
"Poetët në teatër" është një serial që sjell poezinë shqipe të interpretuar në skenën "Shekspir" të Teatrit të Metropolit, Tiranë. Një episod i është kushtuar poezisë së Lasgush Poradecit. Ka lexues që kjo klimë u duket e ngrohtë për poezinë, ka të tjerë dhe këta nuk janë vetëm nostalgjikët, që janë kundër poezisë vizuale.
Disa e shohin me kënaqësi një spektakël të tillë në sallë, apo në radiotelevizon të shfaqur. Mjafton të kujtojmë këtu ritransmetin e herë pas hershëm të ciklit, apo dokumentarët që janë realizuar për poetin e dashurisë, nga kineastë adhurues të poezisë së Poradecit.

Pyetja 7

Cili nga vargjet e mëposhtme i takon Lasgushit ?	Nr. i personave	%
Gush-e-gji-stolisura	160	80
Mbi varrin tim do të rrijë i heshtur	20	10
Do vajtoj pa fund, pa shpresë	10	5
Nuk e di	10	5



Në këtë pyetje ishin përfshirë vargje të Lasgushit, Dritëro Agollit dhe të Fan Nolit. Vargjet nuk kishin identitet të autorësisë. Vargu Gush-e-gji-stolisura ishte shkëputur nga poezia *"Vallja e luleve"* të Lasgush Poradecit. Vetëm 160 studentë ose 80% kishin dhënë përgjigjen e saktë në pyetësor. Njëzet prej tyre ose 10%, kishin vendosur përgjigjen e gabuar duke shenjuar vargun e poezisë "Kur të jesh mërzitur shumë..." të Dritëro Agollit. Dhjetë ose 5% kishin dhënë sërish përgjigje të gabuar, duke cilësuar si vargje të Lasgushit, ato të Fan S. Nolit.
Ndërkaq, përqindja më e madhe e të anketuarve, kanë dhënë përgjigjen e saktë të pyetjes numër tetë, duke qarkuar alternativën e saktë. Mbajtja mend e vargjeve të Lasgushit, nga personat e anketuar ka ardhur si rezultat i rubrikës mësoni vjershën përmendësh që gjendet në fund të teksteve shkollare. Sot nëpër kurikula të ndryshme mësimore, si *"Gjuha amtare"* (ekziston letërsia shqiptare e ndërthurrur brenda saj).
Për ciklin parauniversitar, sërisht ekziston kërkesa mësoni përmendësh vjershën, kërkesë që të rrit kreativitetin e të menduarit dhe të arsyetuarit në jetë, rrit shprehësinë e gjithkujt për të qenë i sukseshëm në shoqëri. Ky "minikonkurs" i formës me shkrim,

tregoi se të anketuarit kishin dijeni për ekzistencën e vargut lasgushian. Këtë e provon dhënia e përgjigjes së saktë në anketim, për gjetjen e vargut të Lasgushit. Dhjetë prej tyre ose 5% kishin shenjuar alternativën nuk e di.
Ndoshta vërtet ata nuk kanë ditur vargje përmendësh të poetit. Mbase nuk kanë dashur të "dokumentojnë" mos njohjen e poezisë së "shtërgut të fundit". Ky fakt ka treguar se ata nuk kanë ditur as vargje të Dritëro Agollit apo Fan Nolit. Mungesa e një informacioni të gjithëdijshëm prej tyre na tregoi se ata nuk kanë ditur se kujt poeti i përkisnin vargjet e përzgjedhura.

Pyetja 8

Cila është vepra e parë poetike e Lasgush Poradecit ?	Nr. i personave	%
Vallja e yjve	140	70
Ylli i zemrës	55	27
Nuk e di	5	2.5



Pyetjes 8 të pyetësorit i janë përgjigjur saktë 140 persona ose 70%. Libri i parë poetik i Lasgush Poradecit *"Vallja e yjve"* përmban 51 poezi. Duhet të theksohet këtu gabimi që bëhet në shkrimin e titullit të këtij vëllimi poetik apo vetë titullit të poezisë në fjalë, nëpër tekste shkollore të sistemit parauniversitar shqiptar dhe atyre universitare.
Pra, shkruhet *"Vallja e yjeve"* dhe jo *"Vallja e yjve"* si në origjinal. Aq më tepër kur bëhet fjalë për një vëllim poetik, të një autori të rëndësishëm në letërsinë shqiptare. Pesëdhejtë e pesë ose 27%, kishin listuar vëllim e dytë poetik të Lasgushit, si vëllim të parë poetik të autorit. Për ta vëllimi i dytë, ishte libri i parë i Lasgush Poradecit, libër që ka ka në përmbajtjen e tij 70 poezi. Ndërkohë 5 veta ose 2,5% e tyre nuk e dinin fare titullin e librave poetikë të Lasgushit.
Kjo mungesë infromative krijohet për ta, nga mosfrekuentimi në shkollë apo boshllëqe në lëndën e letërsisë.

Pyetja 9

Në strofat e mëposhtme, vendos fjalën e munguar ?	Nr. i personave	%
Strofa e parë	100	50
Strofa e dytë	90	45
Nuk e di	10	5



Njëqind e nëntëdhjetë pjesëmarrës ose 95% e tyre në pyetësor, kishin plotësuar fjalët e munguara në vargjet e mëposhtme. Një pjesë e mirë kishin gjetur drejt fjalët e munguara në të dyja strofat e poezive të përzgjedhura nga krijimtaria lasgushiane. Strofa e parë dhe strofa e poezisë së dytë e patën mundësinë më të madhe, të plotësoheshin me fjalët e munguara, pasi ato mbeten poezi shumë të njohura për lexuesin.

Strofa e parë i përkiste poezisë *"Ku shtrohet vala..."*, ndërsa strofa e dytë ishte pjesë e poezisë *"Testamenti"* . Në poezinë e parë, në vargun e dytë fjala e munguar ishte *dashuria*, dhe në vargun e katërt, fjala e munguar ishte *fshehtësia*. Ky varg mbahet lehtësisht përmendësh nga lexuesit, pasi rezulton si i shumë përdorur në tekste mësimore apo emisione mediatike.

Në poezinë e dytë, fjala e munguar ishte punë, fjalë e cila përsëritet në vargun origjinal të poetit, tri herë. Njëqind të anketuar kishin gjetur drejt fjalët e munguara të vjershës së parë. Ndërkohë 90 persona ose 45% e të anketuarëve kishin plotësuar drejt fjalët e munguara në poezinë e dytë. Përgjigjen nuk e di e kishin përzgjedhur 10 ose 5%, studentë, ç'ka lë për të nënkuptuar se ata nuk ishin në gjendje të dallonin vargjet e shkruara nga Lasgush Poradeci. Ky antikap vjen për shkak të boshllëqeve të mbartura të vetë studentëve, nga koha kur ata ishin pjesë e sistemit parauniveristar shqiptar.

Shumica e të anketuarëve kishin një orientim të drejtë për të zëvendësuar me shkrim teksitin e munguar. Pra, në përqindje më të madhe kishin dhënë përgjigje të sakta, ata njerëz që njihin mirë poezinë lasgushiane, mbase ata që kishin mësuar përmendësh vargje të poetit liqenor. Për hir të së vërtetës, duhet të merret në konsideratë ideja së të dyja poezitë e krijuara nga Poradeci, janë shumë të njohura në opinionin publik.

Andaj, poezitë justifikojnë përpjekjen e madhe të njeriut për të përvetsuar shprehi në vargje poetësh të ndryshëm në përgjithsi, konkretisht, në veçanti të Lasgush Poradecit. Të binte në sy fakti jo normal, që pjesa më e madhe e të anketuarve nuk e kishin idenë fare se çfarë titulli kishin poezitë që ishin përzgjedhur për t'u përdorur në pyetësor. Poezitë janë të ndjera dhe adhurohen vazhdimisht nga lexuesit e poetit.

Hija ime nuk di dhunë/ Di veç frymëzim lirije/ Dhe di ....., ..., .../ Mund pa fund për art magjije

Se s'dashuronja-as un' as ti/ Por dashuronte ..... :/ Një dashuri-një fshehtësi/ M'e fshehur sesa .....

Pyetja 10

Cili është mendimi juaj për moshën e Lasgushit ?	Nr. i personave	%
60 vjecar	0	0
70 vjecar	15	7.5
80 vjecar	20	10
Ka vdekur	145	72
Nuk e di	10	5
Rron akoma	10	5



Një pjesë e mirë lexuesish dhe adhuruesish të poezisë lasgushiane nuk e kanë ditur saktë vitin e lindjes së poetit. Rrjedhimisht ata kanë gabuar në përcaktimin e moshës së tij. Nuk është antikap i madh të mos ta dish ditëlindjen e Lasgush Poradecit. Një pjesë e tyre duke dhenë shumë alternativa mbi pyetjen e 10-të kanë thelluar edhe më tepër idenë që çelet nga debati për moshën e vërtetë të Lasgushit.

Lidhur me pyetjen: është gjallë apo ka vdekur Lasgushi, 145 ose 72 % e tyre mendonin që poeti kishte vdekur dhe vetëm një pakicë e vogël njerëzish e dinin që ai frymonte akoma nëpër rrugët e lagjes së vjetër të Pogradecit, qytetin e lindjes së Lasgushit. Pse jo edhe në Tiranë. Ai endej në dualitetin Pogradec-Tiranë dhe anasjelltas. Muajt e verës së nxehtë Lasgushi jetonte në qytetin e tij bregliqenor dhe në muajt e dimërt, tepër të ftohtë, kur frynte veriu dhe murlani, poeti i kalonte ditënetët e tij në kryeqytet.

Ditëlindja e Lasgushit, më saktë mossaktësia e saj ka bërë që edhe studiuesit e veprës së tij të ngatërronin moshën e vërtetë të poetit. Pjesa e më e madhe e lexuesve e dinin të vdekur qyshkur dhe jo të gjallë poetin liqeror. Heshtnaja e tij nën diktaturë, mesa duket e thelloi edhe më tepër misterin rreth rrojtjes apo mosrrojtjes, rrjedhimisht edhe mossaktësinë e moshës.

Një pjesë e vogël anketuesish janë përgjigjur nuk e di. Saktësisht 10 prej 200 të anketuarve ose 5% e tyre, ndërsa pjesa tjetër prej 10 vetësh (5%) mëndojnë se ai rron ende. Pesëmbëdhdhjetë persona të anketuar në pyetsor, (7,5%) kanë dhënë përgjigjen se Lasgushi është 70 vjeçar. 20 persona ose 10%, shprehen përmes shënjimit të tyre që Lasgushi është 80 vjeç. Nuk ka asnjë shenjim te alternativa Lasgushi 60 vjeçar. Sipas datëlindjes së tij më 1899, më 27 dhjetor 1979, Lasgushi mbush 80 vjeç. Po sipas kësaj datëlindjeje, më 27 dhjetor 1999, Shqipëria festoi 100 vjetorin e lindjes së tij.

Te pllaka e varrit të poetit, që ndodhet në Pogradec, në varrezat e publike, shkruhet vitlindja dhe vitvdekja e Lasgushit (1899-1987). Lasgushi vdiq më 12 nënëtor 1987. Gjithashtu ka hamendësime që liriku i shqipes ka lindur më 27 dhjetor të vitit 1900

në Pogradec. Me çfarë duket vitlindja e poetit lëviz me një vit. Në shënime të kohës del edhe kjo pasaktësi e vitlindjes së poetit.
Shënimi mbi varrin e tij në Pogradec, mbetet një dëshmi e saktë dhe publike e lindjes dhe vdekjes së Lasgush Poradecit. Përllogaritja e të cilit jep edhe moshën e rrojtjes së Lasgushit, 88 vjeç.
Duhet thënë se shumë pak të anketuar se dinin që Lasgush Poradeci nuk kishte vdekur ende. Pjesa tjetër, 72% e dinin që shtërgu i fundëm kishte mbyllur sytë përgjithmonë me vdekjen e tij një ditë të ftohtë nëntori në moshën 88-vjeçare në Pogradec.

Pyetja 11

"Shqiponjë-e arratisur" është frazë e bukur, e shkëputur nga një poezi e autorit... Ju mendoni se ajo i takon asaj me titull?	Nr. i personave	%
Vdekja e shtërgut	10	5
Poradeci	175	87
Bjenë telat	0	0
Kamadeva	15	7.5



Të anketuarit, pyetjes 12-të i janë përgjigjur saktë. 175 ose (87%) e dinin që fraza ishte shkëputur nga poezia antologjike *"Poradeci"*. Shtatëdhjetë prej tyre kanë dhënë përgjigjen e duhur për vargun e marrë nga poezia *"Poradeci"*. Madje duhet theksuar se ishte marrë nga të dy-ja variantet e kësaj poezie. 10 veta ose 5% janë shprehur gabim se fraza i përket poezisë *"Vdekja e shtërgut"* dhe 15 persona (7,5%) mendojnë se fraza është shkëputur nga poema e dashurisë *"Kamadeva"*). Nuk ka asnjë shënim që fraza i përket poezisë *"Kamadeva"*
Një ndihmë e madhe në formimin e nxënësve tanë është aparati pedagogjik i librave shkollorë të gjuhës amtare apo mirëfilli teksteve shkollore të letërsisë (sikurse lënda emërtohej dikur) ku kërkohej të mësuarit përmendësh i poezisë.
Kjo ka bërë që ata t'i përgjigjen pa problemin më të vogël, versionit të drejtë të pyetjes. Kanë dhënë përgjigjet e tyre të gabuara 70 studentë duke përfshirë mes tyre poezitë *"Vdekja e Shtërgut"*, *"Bjenë telat"* dhe poemën *"Kamadeva"* . Përgjigja e saktë ishte që ky varg i përket dy varianteve të poezisë *"Poradeci"*.
Duhet theksuar se poezia në fjalë është ndër poezitë e përzgjedhura nga hartuesit e teksteve mësimorë në arsimin parauniversitar shqiptar, qoftë edhe në altertekstet e mëvonëshme. Madje edhe në botimet antologjike.
Duke fituar këtë "popullaritet", si një ndër poezitë e përzgjedhura në programin mësimor, poezia ka mbetuar sigurisht ndër më të lexuarat, komentuarat dhe

analizuarat nga lexuesi i “detyruar” i saj nëpër shkollat tona. Mbase një pjesë e mirë e të anketuarave mund ta kenë ditur përmendësh poezinë *“Poradeci”*. Atgumentet e mësipërme e justifikojnë faktin që 87% e të anketuarëve e kanë ditur që *“shqiponja e arratisur”* ishte shkëputur nga kjo poezi që shijon mrekullisht në dy variantet e saj.

Pyetja 12

Sa botime të Lasgush Poradecit gjenden në bibliotekën tënde ?	Nr. i personave	%
1	27	13.5
2	15	7.5
3	0	0
Më shumë	0	0
Asnjë	158	79



Pjesa më e madhe e të anketuarve nuk e kishin një vepër letrare të Lasgush Poradecit në bibliotekat e tyre familjare apo personale. Konkretisht, 158 prej tyre ose 79% nuk kishin në biblioteka asnjë botim të veprës letrare të Lasgushit. Asnjëri prej tyre nuk kishte tre botimet e edituarara ndër vite.

Mungesa e veprës së Poradecit në tregun shqiptar pas çlirimit të vendit, shpjegohet me tirazhin e vogël por edhe të paribotuar të saj. Diktatura e boton veprën e poetit në vitet 1960, 1974 dhe 1990. Në Kosovë Lasgushi botohet më ’68-ën, ’78-ën, ’86-ën dhe ’90-ën. Më 1999, shtëpia botuese “Onufri”, boton tri veprat e Lasgushit (poezia, poemat; publicistika; ditarë personalë). Dy botime modeste me poezi të zgjedhura kemi në 2002-in dhe 2005-ën.

Ndërkaq, më 2009 edhe në vijim shtëpia botuese private “albPAPER” bën ribotimin e veprës së poetit. Deri tani botimi i saj ka shkuar te *“Vepra nr. 5”, (Korrespondencë Lasgush Poradeci-Asdren)* si dhe botimi i librit me piktura të poetit. (*“Të ritë e viteve të mi”* është koleksioni i pikturave të Lasgush Poradecit).

Horizonti pritës për veprën e Lasgushit ka qenë gjithmonë në interes për veprën letrare, por për hir të së vërtetës ajo mungon në treg ende, madje edhe në panairet e librit brenda dhe jashtë vendit tonë. 15 veta ose 7,5% kishin vetëm dy vepra, më shumë se tre botime nuk kishte asnjë i anketuar.

Duhet theksuar që vitet e fundit, edhe pse gjendet në treg vepra letrare e Poradecit, ajo është shitur shumë pak për shkak të çmimit të lartë të tregëtimit të saj ndonëse është me financim të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në Tiranë. Njerëzit duan ta kenë të paktën në bibliotekat e tyre, ribotimin me poezi të Lasgushit, por ata stepen për shkak të çmimit të lartë të saj. *“Vepra letrare, nr.1”*, që ka poezinë dhe poemat e Lasgushit kushton 1500 lekë.

Gjithësesi duhet thënë që poezitë e Poradecit sërishmi lexohen dhe mësohen përmendësh, pasi vepra e tij qarkullon në biblioteka shtetërore dhe private, apo dorë më dorë, pasi e ka blerë njëherë atë, dikush ose nëpërmjet internetit. Ky numër është jo i pakët. Janë 27 të anketuar që e kanë veprën e Lasgushit. Ata, të shprehur në përqindje, saktësisht sipas këtij anketimi janë 13,5%.

Pyetja 13

Ju mendoni që Lasgush Poradeci ka mbiemrin e tillë se...?	Nr. i personave	%
Ai ka lindur në Pogradec	190	95
Babai i tij ka lindur në Pogradec	10	5
Nëna e tij ka lindur në Pogradec	0	0



Për këtë pyetje, 190 persona ose 95% kanë dhënë opinionin se Lasgush Poradeci, ka lindur në Pogradec. Të gjithë pothuajëse kanë dhënë këtë përgjigje, po të shtojmë edhe 10 të anketuar ose 5%, që kanë qarkuar obsionin se poeti lindi në Pogradec, meqe babai i tij ka lindur në Pogradec. Pra, të gjithë e dinë që Lasgushi ka lindur në Pogradec.

Dihet nga të gjithë që emri i poetit është Llazar Gusho dhe pseudonimi letrar Lasgush është formuar nga bashkimi shkurt i tyre plus emrin e qytetit në trajtën e tij të vjetër Poradec. Asnjë person i anketuar nuk ka mbështetur opsionin që Lasgushi ka mbiemrin e tillë meqë nëna e tij ka lindur në Pogradec. Emri i qytetit Pogradec, gjithkënd e sqaron, adreson dhe e informon se poeti i liqerit është nga qyteti i Pogradecit. Sipas përgjigjeve të mbledhura nga anketimi ata mendojnë se Lasgushi nuk ka lindur në një tjetër qytet të Shqipërisë, veçse Pogradecit të tij frymëzues për vargjet e tij.

Kështu vendlindja bëhet për Lasgushin një lloj pasaporte, a emblemë që e identifikon poetin më qytetin, në të cilin jetoi, krijoi vargje poetike dhe u shua për t'u përjetësuar.

Pyetja 14

Kritika letrare ka bërë një cilësim të qartë për Lasgushin si: ? (vendosni më shumë se një alternativë)	Nr. i personave	%
Novelist	0	0
Lirik	110	55
Piktor	20	10
Botues	0	0
Përkthyes	90	45
Autor tekste këngësh	20	10
Asnjë prej tyre	10	5
Tjetër	0	0
Më shumë se një alternativë	155	77



Duke u nisur nga vlerësimet që i janë bërë figurës së Lasgushit, ai mbetet një figurë shumë dimensionshe. Të anketuarir duke dhënë më shumë se një alternativë pothuajse kanë prekur të gjitha cilësimet që portreti i tij mbart.

Poeti lirik, piktori, përkthyesi me normë i shëpisë botuese Naim Frashëri, autori i teksteve këngë në gjallje dhe pas vdekjes... Lasgushi, tashmë arrin të perceptohet ndër lexues si një vlerë disafishëse. Theksoj këtu se përkthimet e Lasgushit në vetvete janë shqipërime të rikrijuara në variantin e tyre të botimit allalasgush. Pushkini, Hajnia, Hygoi, Lermontovi, Miçkeviçi, Gëtja, Brehti, tingëllojnë lasgushianë. Edhe sot e kësaj dite përkthimet e Poradecit mbeten shembuj të arrirë të përkthimit shqip.

Këtë e dëshmojnë me përgjigjet e tyre shenjuese 90 vetë ose 45%. Në alternativat e tjera të pyetësorit 155 anketuesit ose 77%, janë ndalur dhe kanë shenjuar më shumë se një të tillë. Përgjigja e munguar 0%, Lasgushi novelist, tregon se të anketuarit e dinë që L. Poradeci nuk është i tillë. 110 prej tyre ose 55% e dinë që Lasgushi është poet lirik. 20 të anketuar (10%) e dinë që poeti liqeror është piktor jo vetëm me vargje, por me ngjyra konkrete vaji. 20 anketues apo 10% japin përgjigjen se Poradeci është autor tekstesh këngësh të muzikës së lehtë shqiptare. Nuk kanë shenjuar asnjë nga alternativat e mësipërme 10 vetë ose 5%. Asnjë përgjigje nuk ka pasur për alternativën Lasgushi editor. Dorës së lirë të anketimit, në këtë pyetje i kanë thënë jo

pothuajse të 200 personat e anketuar. Askush nuk kishte dhënë një obsion për të shtuar diçka që e kishte dëgjuar nga jeta dhe vepra letrare e L. Poradecit.
Duhet thënë se poeti i dashurisë njihet nga pjesa më e madhe e të anketuarve edhe si shumë dimensional, duke mbrujtur me mençuri cilësimin real që i ka bërë kritika shqiptare. Autori i lirikave me sa duket është ngulitur thellë në mendjet e tyre dhe nuk mund të harrohet as si përkthyes, piktor, ose autor tekste këngësh të muzikës së lehtë shqiptare. Novelisti dhe botuesi nuk kanë marrë asnjë shenjim në fletët e anketave të shpërndara.

Pyetja 15

Lasgush Poradeci ka marrë çmime të llojit ? (vendosni më shumë se një alternativë)	Nr. i personave	%
"Nobel" në letërsi	0	0
"Nderi i Kombit"	50	25
Mësues i merituar	10	5
"Naim Frashëri i Klasit të Parë"	40	20
Më shumë se një alternativë	62	31



Çështja e informimit ka rëndësi të madhe në jetën e gjithësecilit nga ne. Duhet theksuar së Poradeci nuk ka fituar asnjëherë Nobel në letërsi edhe pse do ishte nder dhe krenari kombëtare për ne shqiptarët. Madje një çmim i tillë, për të, nuk është dhënë asnjëherë. Anketuesit në këtë pikë janë të mirëinformuar. Që Lasgushi është nder i kombit, ky fakt dihet nga 50 vetë ose 25% e të anketuarëve.
Konkretisht, me rastin e 100-vjetorit të lindjes në 27 dhjetor 1999, presidenti i atëherëshëm i Republikës, z. Rexhep Mejdani i jep L. Poradecit, titullin "Nderi i Kombit" dhe Pogradeci, qyteti i lindjes i akordon titullin "Qytetar Nderi i Pogradecit". Titulli qytetar nderi mbetet një vlerë më tepër për mjeshtrin e letrave shqipe.
Dhjetë veta ose 5% e panë të udhës të shenjonin Lasgushin si mësues të merituar. Mbase ata niseshin nga fakti që Lasgushi dha lëndën e vizatimit në gjimnazin e Tiranës.
Medalja "Naim Frashëri" i klasit të parë, grupoi në shënjimin e tyre 40 persona (20%). Duhet thënë se Lasgush Poradeci ka marrë çmimin më të madh, atë të lexuesit, që vjen nga pëlqimi i poezive të tij nëpër kohë, madje edhe nga tekstet e muzikuara për këngë në festivalet e këngës së lehtë në RTSh dhe jo vetëm.

Anonimati i anketimit ka motivuar një numër të madh përgjigjesh nga studentë dhe të afërm të tyre, të cilët kanë shprehur mendimin personal dhe të sinqertë. Edhe këtu duhet theksuar se të anketuarit kanë dhënë më shumë se një alternativë të vetme si përgjigje. Një gjë të tillë e kanë bërë 62 persona ose 31% e tyre.
Çmimet mbeten vlerësim në përjetësi edhe pse Lasgushi i fitoi ato me pavdekësinë e veprës. Ndodh, që vlerat e mëdha, njërëzve tanë të realizuar në fusha të ndryshme të jetës, veçanërisht artit dhe letërsisë ua japim apo ua njohim pas vdekjes. Kështu ka ndodhur edhe me Lasgush Poradecin. Ndërsa madhështia e poetit ekziston ndër breza lexuesish, heshtimi personal përballë diktaturës, "harrimi" me dashje prej saj, nuk ulën dëshirën e leximit të poezive të tij.
Madje ndonjëherë edhe e shtuan më shumë kërshërinë e lexuesve për receptimin e saj në mënyrë individuale, sipas shijes preferenciale të gjithësecilit. Duhet thënë se me pikatore, pak vlerësim erdhi për poetin, në fund të viteve '90 nga diktatura, por madhështia e tij mbrriti pas viteve '90, kur diktatura komuniste bie në Shqipëri.
Njerëzit duhet të jenë edhe më të informuar në këtë pikë, duhet të këtë më shumë informacion në masmedia e tekste shkollore parauniversitare dhe universitare për poetin që është vlerësuar me të drejtë, "Nder i Kombit".

Pyetja 16

Librin e Lasgush Poradecit e keni blerë...? (vendosni më shumë se një alternativë)	Nr. i personave	%
Në qytetin tuaj	20	10
Në një qytet tjetër	10	5
Panair libri	5	2.5
Kosovë	1	0.5
Maqedoni	1	0.5
Shtet tjetër	0	0
Ta dhuroi dikush	5	2.5
Bukinist	0	0
Në internet	0	0
Nuk kam blerë asnjë	158	79
Më shumë se një alternativë	42	21



Të blesh libra gjithëherë është ushqim shpirtëror ose investim kulturor personal. Vlera e librit mbetet një vlerë e çmuar dhe e pazëvendësueshme. 10% e të anketuarve nuk

kanë asnjë dyshim që librin e Lasgushit, e kanë blerë në qytetin e tyre. Në qytete të tjera e kanë blerë veprën e poetit 10 vetë ose 5%.
Në Kosovë e ka blerë librin 1 person i vetëm, 0,05%. Në Maqedoni e ka blerë gjithashtu librin e Lasgush Poradecit përsëri 1 person 0,01%. Në shtete të tjera nuk e ka blerë librin askush nga të anketuarit e mi. Pesë persona të anketuar e kanë blerë librin në një nga panairet e librit të mbajtura në kryeqytetin shqiptar, Tiranë, në vitin 2000 (i vetmi panair ku është tregëtuar vepra e Lasgushit). Pranë stendës së poetit, librat janë dhënë me autografë nga dy bijat e tij.
Duhet të sqarojmë se dikur, një libër të Lasgushit nuk e gjeje në librari pasi tirazhi i tregëtimit ishte shumë i vogël. Sot libri i Lasgushit nuk mungon në librarit e Shqipërisë, madje as në zonat e thella malore të vendit tonë.
Botime të Lasgushit gjenden edhe në rajonin tonë shqipfolës Kosovë dhe Maqedoni falë një distribuimi të mirë të tirazhit të veprës letrare. Në librari të veçanta bëhet tregëtimi i serisë së veprës të L. Poradecit. Poezia e L. Poradecit është e parapëlqyer për çdo grupmoshë, ndaj libri i tij përzgjidhet për t'u dhuruar në raste festash personale familjare. Pesë persona ose 2,5% janë ndjerë mirë me këtë dhuratë. Personat që e tregëtojnë librin në rrugë apo bukinistët sikurse kanë emrin e tyre "zyrtar", në këtë pyetësor nuk janë pjesë e tregëtimit të librit të Lasgushit, (botime të hershme këto, të realizuara ndër vite). Sjellim ndërmend përshembull botime të shtëpisë botuese "Naim Frashëri".
Ndërkaq, interneti mbetet një botë lundrimi pa kufij, madje edhe blerjet mund t'i bëjë gjithkush përmes shërbimit on line. Janë shtëpi të ndryshme botuse ato që ofrojnë shitjen e veprës së Lasgushit, përmes blerjeve live, por sqaroj s'e përmes internetit askush nga të anketuarit tanë nuk e ka blerë atë. Dikur nuk gjendej në raftet e librarive asnjë vepër letrare të Poradecit, ndërsa sot falë botimeve të ndryshme të poezisë, vepra e lirikut gjendet nëpër librari.
Ka edhe të anketuar, që nuk kanë pasur mundësi të blejnë një libër të Lasgush Poradecit. 158 persona ose 79% nuk kanë blerë asnjë libër të poetit, ndërsa e kanë gjetur atë në ambientet e bibliotekës së qytetit apo shkollave të mesme. Përgjigjet e kësaj pyetje kanë qenë të larmishme sikurse vërehet edhe nga ky anketim. Më shumë se një alternativë kanë dhënë 42 të anketuar ose 21% e tyre.
Në ditët tona mundësitë për ta blerë një vepër të lirikut është më e mëdhe, pasi edhe gjeografia e shpërndarjes së tirazhit të librit, por edhe shitja e tij bëhet në të gjitha trojet shqipfolëse.

Pyetja 17

Në sa prej gjuhëve të botës janë përkthyer poezitë e Lasgushit ...? (vendosni më shumë se një alternativë)	Nr. i personave	%
Gjermanisht	10	5
Anglisht	60	30
Rusisht	0	0
Frëngjisht	35	17.5
Spanjisht	15	7.5
Tjetër	0	0
Më shumë se një alternativë	145	72



Opinionet e qytetarëve nëpër Shqipëri, lidhur me përkthimin e poezive të Lasgushit në gjuhë të huaja është i dyzuar, sepse një pjesë mendojnë që Lasgushi flet edhe në gjuhë të huaja me artin poetik. Një pjesë pohojnë se Lasgushi ende nuk ka filluar të komunikojë në gjuhët kryesore të globit.

Nëse ju pranëvëmë këtyre mednimeve edhe thënien e Çabejit, "...kur Lasgushin do ia falim botës", mund të themi që ky rrugëtim është në rrugë të mbarë. Lasgushi është përkthyer në të gjitha gjuhët e huaja të renditura si alternativa në pyetësor. Në gjermanisht, anglisht, rusisht, frëngjisht, spanjisht dhe më gjerë vijon të përkthehet në gjuhë të tjera të huaja.

Ka kohë që lexuesi i huaj shijon poezinë e Lasgush Poradecit në disa gjuhë. Numërin më të madh të të anketuarëve të cilët e dinin se poeti liqenor ishte përkthyer në gjuhë të huaja, e zinte gjuha angleze. Ishin 60 të tillë ose 30% që ishin pozicionuar tek alternativa anglisht. Alternativa poezi në gjuhën frënge ishte përzgjedhur në pyetësor nga 35 anketues ose 17,5% dhe pasohej nga 15 anketues ose 7,5% e tyre që kishin përzgjedhur spanjishten si gjuhë të huaj, ku ishin përkthyer poezitë lasgushiane.

10 persona ose 5% mendonin që poezia e Lasgushit është përkthyer edhe në gjuhën gjermane. Alternativat poezi të përkthyera në rusisht apo në gjuhë të tjera të huaja nuk kishin asnjë përzgjedhje nga anketuesit. Mungesa e informacionit se poezitë e Lasgush Poradecit janë përkthyer në gjuhën ruse, ka bërë që mos kishte asnjë shenjim në pyetësor. Po kështu mungesa e informacionit për të anketuarit shpjegonte se ata nuk e dinin se poezia lasgushiane bënte jetën e saj në gjuhë të tjera të huaja.

Në këtë pyetje, të anketuarit kanë dhënë më shumë se një alternativë, çfarë tregon se poezia e Lasgush Poradecit për ta shijohet jo vetëm në shqip. Janë 145 të anketuar ose 72%, të cilët e kanë ditur se në gjuhët e mësipërme Lasgushi e kishte krijuar lexuesin e tij me kohë. Do ishte e udhës që të ketë herë pas here një botim në gjuhën shqipe, i cili të publikonte poezitë e botuara në gjuhët e huaja, të poetëve shqiptarë.

Duke qenë se ky numër shtetesh rritet çdo vit, do ishte akoma më mirë që në një botim të veçantë të publikoheshin të gjitha poezitë e Lasgushit të përkthyera në gjuhë të huaja. Një poet kombëtar rrit vlerën nacionale në botë kur përkthimet e poezive të tij shijohen nga shumë shtetas të huaj, posaçërisht në gjuhët e tyre respektive. Një fat të tillë mesa duket e ka edhe krijimtaria e Lasgushit, poetit që shpesh e më shpesh është thënë se mbetet ndër më të vështirët për t'u përkthyer prej të vetmit shkak, leksikut tipik lasgushian.

Pyetja 18

Motivi mbizotërues i poezive te Lasgushit është ai ...? (vendosni më shumë se një alternativë)	Nr. i personave	%
Patriotik	20	10
I natyrës	30	15
Erotik	140	70
I dashurisë	140	70
Tjetër	20	10
Më shumë se një alternativë	160	80



Tema dhe motivet në një vëllim poetik janë të rëndësishme për çdo grupmoshë lexuesish. Motivet e poezisë lasgushiane mbeten gjithmonë interesante për larminë që sjellin. Rreth 140 të anketuar ose 70 për qind thonë se motivet me të dashura në poezinë e Lasgush Poradecit janë ato të erosit dhe dashurisë, megjithatë, një pjesë tjetër mendojnë se motivet, ai patriotik dhe ai i natyrës, zënë një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e Poradecit.

Kjo përllogaritje qëndron për të dya motivet, në numër dhe përqindje të barabartë (140 ose 70%). Motivi patriotik shenjohej nga 20 veta ose 10%, ndërsa motivi i natyrës përzgjidhej nga 30 veta ose 15% e tyre. Motivet e tjera janë përmbledhur në pikën e fundit të tabelës së kësaj pyetje në pyetësor. Rreth 20 persona ose 10% kishin shtuar motive të tjera si ai patriotik, filozofik por edhe atdhetar tek alternativa tjetër.

Në krijimtarinë e Poradecit, të gjitha këto motive ndeshen në poezi të ndryshme dhe i bëjnë ato të veçanta dhe mbresëlënëse për lexuesit e veprës letrare të Lasgush Poradecit. Ndërkaq, kanë dhënë më shumë se një alternativë 160 të anketuar ose 80%, që kanë ditur më së miri motivet mbizotëruese të poezive të *"zogut të qiejve"*.

Motivi erotik dhe motivi i dashurisë mbeten më të parapëlqyer nga lexuesit anketues. Në këtë aletrenativë, aspak emotivë, ata kanë bërë siç duket një përapëlqim dallues të vetë poezisë lasgushiane. Motivet për ta mbeten një lloj treguesi përfaqësues për kategori të ndryshme leximi.

Pyetja 19

Cili nga autorët e mëposhtëm ka bërë studim mbi veprën letrare të Lasgushit ? (vendosni më shumë se një alternativë)	Nr. i personave	%
Fan S. Noli	5	2.5
Mitrush Kuteli	80	40
Millosh Gjergj Nikolla	0	0
Ismail Kadare	115	57.5
Krist Maloki	30	15
Anastas Kapurani	45	22.5
Më shumë se një alternativë	110	55



Të anketuarit në këtë pyeteje, kanë dhënë alternativa të mirëmenduara. Ata e kanë ditur saktësisht, se cilët autorë kanë bërë një studim mbi veprën letrare të Lasgush Poradecit. Të anketuarit, konkretisht 80 prej tyre ose 40%, kanë realizuar shenjimin e duhur, duke perveçuar studimin e Mitrush Kutelit, si të vetmin studim më të mirë dhe më të rëndësishmin nëpër kohë, për poetikën e Lasgushit, lirikut të madh të letrave shqipe.

Kjo përgjigje masive, vjen edhe si rezultat i faktit se ata janë njohur dhe mbase kanë punuar në orët mësimore me studimin kritik të Dhimitër Paskos. Jo vetëm botimi, por edhe promovimi dhe mbrojtja e shkëlqyer e veprës së Lasgush Poradecit është bërë plot gjykim dhe talent nga Kuteli.

Duke dhënë më shumë se një alternativë, një numër i madh pohimesh janë bërë edhe për Ismail Kadarenë, i cili herë pas herë në shënime, prek jetën dhe veprën letrare të Lasgushit. Janë 115 anketues ose 57, 5%, të cilët e dinin që Ismail Kadare ka shkruar për jetën dhe veprën e Poradecit.

Nuk ka mundur të marrë nga të anketuarit, asnjë përgjigje Migjeni. Sipas tyre Migjeni nuk ka bërë një studim letrar për Lasgushin.

Fan Noli pozicioninte rreth vetes 5 shenjues ose 2,5%. Në fakt kjo përzgjedhje rezulton e gabuar, sepse as Noli nuk ka një studim për poezinë e Lasgush Poradecit. Edhe pse (2,5%), ato mbeten pozicionim i gabuar për anketuesit.

Krist Maloki dhe Anastas Kapurani janë shënjuar nga të anketuarit, me shenjën përkatëse si studiues të veprës letrare të Poradecit. Njëri e qorton artin krijues të Poradecit, tjetri e madhështon atë. 30 të anketuar ose 15% pozicionohen te emri i Krist Malokit dhe 45 veta ose 22,5% pozicionohen te emri i Anastas Kapuranit. Ky fakt rezulton i dijshëm prej tyre. Edhe në këtë pyetje 110 të anketuar saktësisht 55%, zotëronin informacion të saktë rreth studiuesve të veprës së Lasgushit. Ata kishin dhënë më shumë se një alternativë të mundshme për emrat e studiuesve që kishin shkruar për bardin shqiptar.

Pyetja 20

Autorin, autorët që zgjodhët i keni?	Nr. i personave	%
Lexuar	40	20
Dëgjuar	10	5
Përdorur	130	65
Cituar	20	10



Pyetja njëzet e pyetësorit duhet parë në lidhje me atë paraardhëse. Autorët, studiues të veprës së Lasgushit janë përdorur nga të anketuarit në orët akademike të mësimit, konkretisht të diskutimit të jetës dhe veprës së poetit. Kjo gjë ndodh edhe gjatë orëve të mësimit në sistemin parauniversitar shqiptar.

Dhjetë prej tyre ose 5% i kanë lexuar këto studime, ndërsa 130 ose 65% të anketuar i kanë përdorur këto punime shkencore, në procesin mësimor. Kanë cituar studimin e veprës letrare të Lasgushit, studentë dhe jo vetëm, pra, 20 të anketuar ose 10%. Ky citim mund të jetë realizuar në shkollë, universitet, në projekte dhe detyra shtëpie, në radio dhe televizion, gazeta, revsita apo rrjete sociale elektronike.

Duhet theksuar që 65% e të anketuarve kanë qenë në kontakt me studimet e ndryshme për verpën letrare të poetit poradecar. Sigurisht, leximi i pavaruar mbetet shije individuale, por ai i deturuar e bën përdorimin e studimeve të ndryshme mjaft efikas në rritjen e dijes individuale. Përdorimi i tyre mund të ketë qëne i pjesshëm, jo i plotë, çfarë ka nxjerrë në pah leximin tërësor.

Por mund të ketë qenë edhe lexim i plotë, i detajuar gjë që mund ta ketë bërë përdorimin e tyre një sukses më vete, në realizimin e çdo njërit prej të anketuarëve. Prakticiteti i çdokujt në gjetjen e librit të duhur, si pjesë e literaturës së dhënë apo informacionit të kërkuar, e çon përdorimin e tyre në një domosdoshmëri për të gjithë.

Pyetja 21

Për nder të Lasgush Poradecit shteti shqiptar ka vendosur apo ka ndërtuar... ? (vendosni më shumë se një alternativë)	Nr. i personave	%
Një emër shkolle	50	25
Një emër rruge	0	0
Një emër qëndre kulturore	70	35
Një monument	180	90
Një shtëpi muze në Pogradec	40	20
Një shtëpi muze në Tiranë	30	15
Më shumë se një alternativë	186	93



Lidhur me këtë pyetje, e cila në renditjen e të gjithë pyetësorit mban numrin 21, të anketuarit, kanë dhënë përgjigje të alternuara, pra duke mos u përgjigjur vetëm për një alterantivë. Pesëdhjetë të anketuar ose 25% e tyre mendojnë se për Lasgushin ka një emër shkolle në qytetin e Tiranës, saktësisht, ajo është shkollë e sistemit 9-vjeçar dhe ndodhet në lagjen Kombinat.

Një tjetër shkollë që mban emrin e lirikut të shqipes L. Poradecit ndodhet në Pogradec. Ajo është shkolla jopublike Lasgush Poradeci (shkolla është e sistemit 9-vjeçar dhe atij të mesëm).

Nuk ka pasur asnjë prononcim në alternativën nëse ka një emër rruge me emrin e lirikut të madh të letrave shqipe. Një rrugë e tillë nuk ekziston as në vendlindjen e tij në Pogradec, por realisht ka një emër rruge në kryeqytet. Ajo është te Diga pranë liqenit artificial të Tiranës, rrugë e cila mban emrin Lasgush Poradeci.

Duke qenë se të anketuarit i përkasin një universiteti që ndodhet në qarkun e Korçës, madje ka edhe një filial në qytetin e Pogradecit, mesa duket kanë informacion se Qëndra Kulturore në Pogradec, mban emrin Lasgush Poradeci. Këtë e pohojnë 70 të anketuar, ose 35% e tyre. Emri i saj është vendosur në ceremoninë e mbajtur më 19 dhjetor, 1988.

Një monument i Lasgushit, vepër e skulptorit të popullit Mumtaz Dhrami ka jetësuar në pavdeksi veprën e Lasgushit në Pogradec. Një qind e tetëdhjetë të anketuar ose 90% e tyre japin përgjigjen se për nder të tij është ndërtuar një monument në Pogradec, një monument i shumëpritur vite më parë, që u bë realitet falë kryebashkiakut të Pogradecit, Artan Shkëmbi. Në Pogradec në 27 dhjetor 2006 vendoset shtatorja e tij në breg të liqenit të Ohrit, në qëndër të qytetit. Monumenti i Lasgush Poradecit është i lartë 3 m e 40 cm. (Në Pogradec është vendosur vitet e fundit edhe një tjetër monument, ai i Mitrush Kutelit).

Dyzet të anketuar ose 20%, e dinë që në Pogradec ekziston shtëpia muze e Lasgushit, falë altruizmit të pronarit të saj Koço Krëste, i cili e ringriti nga themelet dhe e mirëmban atë. Ndërkaq 30 të anketuar ose 15% kanë votuar se në Tiranë ka një shtëpi muze të poetit. Përgjigja e kësaj pyetje është dhënë e gabuar, pasi shtëpia muze në Tiranë u prish nga familjarët, për të ndërtuar aty më pas një pallat banimi.

Theksojmë se informacioni i 15% të anketuarëve për këtë pyetje nuk është i saktë. Në Tiranë nuk ka një shtëpi muze për poetin. Pranë pallatit ndodhet vetëm një pllakë përkujtimore, që sqaron se aty ka qenë shtëpia në të cilën ka banuar poeti Lasgush Poradeci. Kështu, rreth 186 anketues kanë dhënë më shumë se një përgjigje për alternativat e pyetjes 21 të pyetësorit.

93% e të anketuarve kanë pasur informacion të saktë për përjetësimin e emrit të Lasgush Poradecit nga shteti shqiptar. Informacion që sigurisht merret i shpejtë nga masmediat apo interneti. Në interpretimin e të dhënave të pyetjes 21 të pyetësorit

mbetet fakt domethënës që, 93% e të anketuarve kanë pasur informacione për përjetësimin e lirikut.
Panteoni letrar ka vend për talentet rrezatues nëpër kohëra, sikurse me meritë qëndron në të Lasgushi, tashmë poet jo vetëm i Pogradecit, por i gjithë Shqipërisë.

Pyetja 22

Nëse takoni Lasgushin cilat ishin vargjet e poezisë së tij, që do t'i drejtoheshit për t'i shprehur nderimin si lexues? (Shkruani vargjet që mbani mend...)



Në pyetjen e fundit të pyetësorit njëqind, pra (50%) të anketuar nuk kanë shkruar asnjë varg të Lasgushit. Mesa duket ata nuk kanë ditur përmendësh vargje të tij. Ose më saktë nuk u janë kujtuar ato për momentin, ose vërtet nuk kanë ditur vargje të lirikut. Mbase nuk e kanë kujtuar saktë, komplet strofën dhe kanë preferuar të mos i shkruajnë vargjet, sesa t'i hedhin gabim.
Një hentikap më vete mbetet edhe prezenca e ulët e nivelit të nxënësve gjatë këtyre viteve në shkollën shqiptare. Një pjesë e tyre nuk i kanë zbatuar si duket rregullat mësimore që vendoste mësuesi në klasë, sipas një standardi të të mësuarit për gjithë jetën, standardi të drejtuar nga mësuesi i lëndës në klasë.
Kjo ka bërë që një pjesë të jenë moskokëçarës gjatë orës së mësimit, aq më tepër të mësonin vargje përmendësh nga autorë të ndryshëm të letërsisë shqipe. Mund të thuhet se një pjesë e të anketuarve janë treguar të papërgjegjeshëm në pikën e fundit të pyetësorit, duke e anashkaluar të shkruarit e vargjeve përmendësh, duke mos shkruar asnjë varg të autorit të pavdekshëm të poezisë së dashurisë.
Ky fakt shpjegohet ndoshta edhe me përtesën e tyre në çastin e mbushjes së këtij pyetësori. Të mësuarit e vargjeve përmendësh është aftësim praktik për të artikuluar sa më drejt dhe bukur në gjuhën e vendit tënd, por mesa duket nuk është kuptuar kështu nga të gjithë nxënësit detyra e të mësuarit të vargjeve përmendësh, që duhet theksuar se në një pjesë tekstesh shkollore është hequr fare. Treguesi mbetet mjeran kur është fjala për një kolos të letrave shqipe si Lasgush Poradeci. Ndërsa, njëqind të tjerë, (50%) të anketuar kishin përzgjedhur strofën e poezisë romancë *"Ku shtrohet vala..."*:
...Se s'dashuronja-as un' as ti/ Por dashuronte dashurija:/ Një dashuri-një fshehtësi/ M'e fshehur sesa fshehtësija.
Duhet theksuar se kjo strofë e përzgjedhur në mënyrë masive nga të anketuarit, në njëqind herët e saj të shkruara në fletët e pyetësorit asnjëherë nuk ishte e shkruar saktësisht në trajtën që e ka botuar poeti. Njëjësi i poezisë, ishte bërë shumës, ndërsa ishin shtuar lidhëza, nyje, mbaresa dhe prapashtesa sipas dëshirës të të anketuarve.
Madje vërehet se ata, nuk dinin të përdornin as shenjat e pikësimit në poezi. (shih pyetësorët). Me përjashtim të disa syreshëve që kanë përdorur apostrofin për të theksuar formën mohore të vargut, pjesa tjetër nuk dinin të përdornin fare apostrofin,

sikundër në rastin e zëvendësimit të ë-së fundore. Nuk dinin të saktesonin përdorimin e vizës ndarëse në një varg të vetëm apo në total brenda strofës së përmendur.
Theksoj që ky varg mbahet mend, mbase është përdorur më shpesh në shkollë apo gjatë orës së mësimit. Ndoshta e kanë të dëgjuar më së shumti në radio-televizion ose të deklamuar në shoqëri apo rrethe familjare. Mbase është lehtësia e vargut për ta mbajtur mend atë ose bukurtingëllimi i tij, që e bën gjithkënd, të madh e të vogël, të prangohet pas shprehësisë së tij. Gjatë orëve të mësimit nxënësit e çdo niveli të arsimit parauniversitar shqiptar e kanë të lehtë të mësojnë vargje përmendësh.
Brenda aparatit pedagogjik të disa alterteksteve shkollore ekziston detyra mësoni poezinë përmendësh ose mësoni njëzet vargje përmendësh. Ky pyetësor ka sigurisht shkallën e caktuar të saktësisë ose të gabimit. Duhet theksuar se gabimi varet edhe nga çiltërsia e përgjigjeve të dhëna nga të anketuarit. Nuk duhet harruar, s'e gjithçka varet me klimën që vendoset mes studiuesit dhe të anketuarëve, sikurse edhe me vetë natyrën e pyetjeve që përmban pyetësori ynë.
Formën e saktë të pyetësorit e gjeni në rubrikën *Apendiks* të këtij punimi.

Përfundime rreth pyetësorit:
Për të marrë një informacion sa më të detajuar rreth jetës dhe veprës letrare të poetit Lasgush Poradeci, u anketuan 200 persona, të cilët u përgjigjën për 22 pyetje, të pyetësorit të përgatitur. Në kampion u përfshinë grupmosha të ndryshme njerëzish, veçanërisht studentë në universitetin "Fan Noli" të Korçës. Në mbushjen e tij pati gjithpërfshirje personash, ndërsa ra në sy numri i madh i vajzave. Dihet që numri i femrave mbetet më i madh se ai i djemve, (si preferencë) për të ndjekur studimet e larta në degën Gjuhë-Letërsi Shqipe. Nën këtë këndvështrim, numri i tyre si pjesëmarrëse në pyetësor, rezultoi të ishte më i madh sesa ai i djemve.
Shërndarja e të drejtave të sudimit nga MASH bëri që pozicionimi Jug-Veri të rezltonte efikas edhe në mbushjen e pyetësorit. U motivua një rreze gjeografike sa më e gjerë. Konkretisht, Jugu (Qarku i Korçës) dhe Veriu me (Kukësin, Pukën dhe Hasin).
Pyetja numër pesë e pyetësorit tregoi se në masën 75% Lasgushi njihet që është shkrimtar dhe nga 25% e tyre njihet edhe si piktor. Poradecari Llazar Gusho, njihet si artist i fjalës por edhe si mjeshtër i ngjyrës në telajo. Ambientet shoqërore vuajnë për diskutime librash, veçanërisht për takime poetësh. Shkolla, saktësojnë 77% e të anketuarëve i ka informuar plotësisht me njohuri, për jetën dhe veprën letrare të Lashush Poradecit. Televizioni sipas tyre zë vendin e dytë të informimit dhe të tretin familja.
Biblioteka si vatra e rrezatimit të librit zë një përqindje të vogël, çka do të thotë se sot ajo frekuentohet shumë pak ose aspak dhe se fondi i saj nuk përdoret si duhet nga të anketuarit. Rreth 80% e të anketuarëve e dinë vargun që mban autorësinë e Poradecit, pjesa tjetër e ngatërrojnë ose nuk e dinë saktësisht atë. Edhe kjo pyetje vërteton idenë se sot lexohet shumë herë më pak, se dikur. Mosditja e saktë e vargut thellon hendekun e mosinteresimit të njerëzve lidhur me persona të rënësishëm të jetës së tyre. Iluminizmi me ç'duket po zëvendësohet nga botëkuptime të tjera, mbase më pak të vlejtshme në jetë. Pyetja tetë tregon se janë anketues të paktë, ata që e dinin titullin e librit të parë poetik të Lasgushit.
27% prej tyre e kanë ngatërrur titullin e vëllimit të parë të poetit. Mbase lexuesit e kanë vështirë të mbajnë mend titujt e veprave letrare të një shkrimtari. Edhe pyetja nëntë përcjell informacion zinxhir, te të anketuarit. 95% e kanë gjetur saktë fjalën e munguar ndër vargje.

Kjo, sepse të dyja poezitë janë kërkuar nga mësuesit të mësohen përmendësh, në lëndën e gjuhës amtare. Mister ka mbetur përherë mosha e poetëve të mëdhështorë, atyre që vepra letrare i bën të pamoshë. Sa i ri, aq edhe vjetër, të duket shpesh e më shpesh Lasgushi. Ndonjëherë të vjen si prej kohësh të herëshme, e ndonjëherë të duket si mik fare i afërt me ty. Heshtja në diktaturë bëri që ai harrohej, ose të shpallej si i vdekur. 72% e dinin që poeti lirik kishte ndërruar jetë qushkur. Mund të quhet atikap, fakti se 5 përqind e të anketuarëve se dinin ende që poeti kishte ndërruar jetë.
Pyetja 11 mbetet dëshmi e fortë e idesë, se poezitë e trajtuara përgjithësisht në shkollë, njihen dhe mbahen mend mirë nga të anketuarit. E tillë rezultoi poezia që mban titullin e vendlindjes së autorit. Receptimi veprës letrare fillon nga të ekzistuarit e librit, në bibliotekën e shtëpisë. Rreth 20% e kanë veprën e lirikut në shtëpi. Të tjerët, rezultoi se nuk e kanë një vepër të Lasgushit në bibliotekat e shtëpisë. Të mos e kesh një libër me poezi, në ditët tona shpjegohet me disa arësye, që mund të jenë: tirazhi i vogël i librave apo çmimi i lartë i tregëtimit të tyre. Në botë çmimi i një libri të ribotuar ulet, nga sasia e madhe e shitjve. Në Shqipëri ndodh e kundërta. Çmimi i librit nuk ulet prej ribotimit të tij, ndoshta nga shumë syresh rritet.
Kështu ndodhi edhe me botimin e veprës së fundit të L. Poradecit. Çmimi i tregëtimit të saj është 1500 lekë ose 15 euro. Botuesit dhe familjarët e shkrimtarëve duhet të gjejnë politikaka të përbashkëta, të cilat do të bënin, që vepra letrare në treg, në ribotimin e saj, të shijohej nga një masë sa më e madhe njerëzish. Njohja e poetit pogradecar vjen pak a shumë edhe nga personalizimi i emrit të qytetit me pseudonimin letrar të tij. 95% e të anketuarëve dhanë përgjigje të saktë duke u nisur nga vendlindja e autorit, ose toponimia e Pogradecit e shumëgjendur në vargjet e poetit.
Shumë pak lexues e kanë blerë veprën letrare në Pogradec. Në përgjigje spikat qyteti nga vijnë vetë lexuesit. Ç'ka do të thotë se distribuimi i librit është bërë i saktë në të gjithë vendin tonë, ku një lirik si Lasgush Poradeci ka më mijëra adhurues. Edhe në rajon, Kosovë e Maqedoni tregëtohet vepra letrare e Lasgushit. Lirik e ka bërë Lasgushin, vepra letrare e mrekullueshme, piktor e bëjnë ato pak piktura, që edhe sot e kësaj dite trondisin me artin e brendashkrirë dhe përkthyes e ka bërë puna e palodhshme e tij, e përkthimit me normë në shtëpitë botuese nën diktaturë.
Të tria cilësitë kanë funksionuar më së miri ndër lexues në vite. Njohuritë e të anketuarëve nuk kanë qenë as të gabuara, as të nxituara. Ata që kanë qenë nxënës sistematikë në mësim, e kanë justifikuar më së mirë organizmin e njohurive. Leximi mbetet kulturë gjithpërfshirëse. 25% e të anketuarëve e dinin që Presidenca e Republikës i ka akorduar Lasgushit, pas vdekjes titullin honorifik "Nder i Kombit".
Përkthimi i poezisë mbetet art më vete. Poradeci rezulton i vështirë për t'u përkthyer në gjuhë të huaja. 30% e të anketuarëve janë të bindur që L. Poradeci ekziston i përkthyer në gjuhën angleze. Pak e nga pak profecia e Çabejit do bëhet realitet. Lasgushin dhe artin e tij letrar e njeh edhe bota.
Nënvizoj, që motivi i dashurisë dhe ai erotik parapëlqehen në poezi nga lexuesi. Janë këto dy motive, që prangojnë 140% të të anketuarëve, të cilët me sa duket këto motive i kanë të preferuara në veprën letrare.
Mitrush Kuteli dhe Ismail Kadare janë ndërkaq dy personat të cilët janë marrë më fort më veprën e Lasgushit. I pari si promovues dhe mbrojtës i saj dhe i dyti si adhurues. Emrat e tyre njihen nga lexuesit, sepse ata zënë 97,5% të pohimeve. Kjo, edhe sepse studimet e tyre letrare mirëpërdoren gjatë orëve të mesimit. 65% e kanë përdorur një studim të tillë gjatë mësimit në klasë.
Pavdekësia e një personi të rëndësishëm, sikundër rezulton Lasgush Poradeci, shenjohet me mirënjohje në jetën publike të një vendi, si emrat e shkollave, rrugëve

apo institucioneve të ndryshme. Ngrihen monumente dhe shtëpi muze. Lasgush Poradeci e ka prekur këtë mirënjohje brezash. Pavdekësia e poetit, veçanërisht është lartësuar nga vepra letrare. 90% e të anketuarëve e dinin se në qytetin e lindjes së poetit ngrihet një monument që përjetëson poetitn. Mirënjohja i vjen një poeti edhe nga të mësuarit përmendësh të vargjeve të tij.

Pyetja e supozuar se me çfarë vargu do i shprehnit Lasgushit respektin tuaj, është trajtuar në masën 50% me poezinë *"Kur shtrohet vala"*. Strofa e fundit e së cilës, me sa duket rezulton e mirëmësuar përmendësh, nga një pjesë e madhe shqiptarësh.

...*Se s'dashuronja-as un' as ti/ Por dashuronte dashurija:/ Një dashuri-një fshehtësi/ M'e fshehur sesa fshehtësija*. Vargje që të mrekullojnë në çdo lexim apo deklamim.

Duhet theksuar se një pjesë e mirë e të anketuarëve, kanë dhënë më shumë se një alternativë, në përgjigjet e tyre me shkrim të pyetësorit. Jo vetëm se kjo gjë ju është kërkuar në pyetësor, por edhe sepse ata janë ndjerë mirë, duke dhënë më shumë se një përgjigje. Kjo formë ka rezultaur për ta efikase duke ju dhënë më shumë mundësi në të mosgabuarit e tyre.

Pyetësori ynë lartëson idenë se të anketuarit përgjithësisht e njohin jetën dhe veprën letrare të Lasgush Poradecit. Në përqindje të vogla të papërfillshme disa syresh ngatërrojnë gjithçka, por pjesa më e e shumtë e të të anketuarëve kanë informacion saktë. Një problematikë më vete mbetet vepra në treg, etja për t'u lexuar Lasgushi, numri i pakët i tirazhit apo edhe çmimi i lartë që ajo ka, lënë për të dëshiruar ndër lexues. Mungesa dhe kërkesa e një libri të Lasgushit në familjen shqiptare, tregon, që edhe pas vdekjes poeti, vijon të robërojë lexues me vargjet e tij. Kanë rëndësi studimet që realizohen për jetën dhe veprën letrare të Poradecit. Ato duhet të përfshihen në realizimin e orëve të mësimit. Një rol të madh luajnë bibliotekat universitare, pranë të cilave këto botime nuk duhet të mungojnë. Duhet siguruar një fond i veçantë për blerje kopjesh të tyre.

Në universitetin e Korçës "Fan S. Noli", konkretisht në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, pjesë e të cilit ishin të anketuarit, botime të tilla nuk mungojnë, por sasia e kopjeve mbetet e vogël, çka përmbën problem për gjetjen në mënyrë masive e literaturës nga studentët. Gjithsesi, një vlerë të madhe mbartin në këtë aspekt edhe biblioteka të tjera jashtë ambientve universitare, që janë burim i rëndësishëm për përthithjen e informacioneve. Kjo, jo vetëm për një figurë embelmatike si Lasgush Poradeci, në letërsinë shqipe, por edhe për shumë shkrimtarë të tjerë që mbeten po kaq të rëndësishëm në letërsinë tonë.

Përgjithësisht jeta dhe vepra letrare poetit liqenor të Pogradecit njihet nga receptuesi i saj, çka nënvizon se Ai (Lasgush Poradeci) mbetet prangues, ndër lexues të grupmoshave të ndryshme, në vendin tonë.

XV. BIBLIOGRAFIA *:*

Referenca:

-Vepra të Lasgush Poradecit
PORADECI, L. Një fatos i veteranerisë shqiptare. Fytyra urdhëronjëse dhe aktiviteti heroik i kryeveteranit Nikoll N. Naço Korça. Botim i veçantë i fletores Shqipëria e re, Kostancë. Shtyp, "Albania", 1932.
PORADECI, L. Vallja e yjve. Shtypur në "Albania", Kostancë, 1933, -119f.
PORADECI, L. Ylli i zemrës. Bukuresht, 1937, -184f. Me il. Shtypur në Atelieret e Shtypshkronjës "Albania", Kostancë-Rumani.
PORADECI, L. Ylli i zemrës. Botim i 2-të. Tiranë, Luarasi, 1939, -185f.
PORADECI, L. Misioni i shqiptarëve të Bukureshtit dhe Naim Frashëri. Fjala e Lasgush Poradecit, ish - sekretar i përgjithshëm i kolonisë. Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së poetit. (Bukuresht 1946) -XVf. Të kseroksuara.
PORADECI, L. Lirika e Naim Frashërit. (dorëshkrim), Tiranë, 1946; (arkivi familjar i poetit).
PORADECI, L. Vjersha lirike. Nën redaktimin e Lasgush Poradecit. (Dorëshkrimi përmban 25 lirika të Poradecit). Një ksombël ruhet në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë, Tiranë 1950.
PORADECI, L. Lirika. Vjersha të zgjedhura. Tiranë, "Naim Frashëri", (1960), -83f.
PORADECI, L. Poezia. Prishtinë, Enti i Botimeve Shkollore i Rep. Soc. të Serbisë, 1968, -150f. Me il.
PORADECI, L. (Poezi). Tiranë, "Naim Frashëri", 1974, -91f.
PORADECI, L. Vdekja e Nositit. Prishtinë, Rilindja, 1978, -227f.
PORADECI, L. Vdekja e Nositit. Botim i dytë i plotësuar, Prishtinë, Rilindja, 1986, -278f.
PORADECI, L. Vepra letrare. Tiranë, "Naim Frshëri", 1990, -521f.
PORADECI, L. Ylli i zemrës. Poezi. Prishtinë, Rilindja, 1990, -180f.
PORADECI, L. Vepra. Poezia. Volumi 1. Tiranë, Onufri, 1999, -372f.
PORADECI, L. Vepra. Publicistika. Volumi II. Tiranë, Onufri, 1999, -381f.
PORADECI, L. Vepra. Shqipja: Ditar, korrespondencë intime e dashurisë në vitet'39-'40. Volumi III. Tiranë, Onufri, 1999, -235f. ; 10 faqe me il.
PORADECI, L. Shkolla shqipe e Poradecit. Tiranë, "albPAPER", 2002, -156f.
PORADECI, L. Përse të dua. (Poezi dashurie). Tiranë, "Lilo", 2005, -92f.
PORADECI, L. Eminesku i injoruar dhe ideologjia e tij popullore-atdhetare. Tiranë, Argeta LMG, 2009, -216f.
PORADECI, L. Vepra I, Poezia. Tiranë, alb PAPER, 2009, -383f.
PORADECI, L. Vepra II, Publicistikë; Kritikë letrare; Antologji shqipe e kësikohëshme. Tiranë, alb PAPER, 2010, -456f.
PORADECI, L. Vepra III, Ditar dhe korrespondencë intime. Tiranë, alb PAPER, 2010, -159f.
PORADECI, L. Vepra IV, Korrespondencë Lasgush Poradeci-Mitrush Kuteli. Tiranë, alb PAPER, 2010, -206f.
PORADECI, L. Vepra V, Korrespondencë Lasgush Poradeci-Asdreni. Tiranë, alb PAPER, 2012, -130f.
PORADECI, L. Lasgushi dhe engjëjt e pikturës. Muzeu Historik Kombëtar. Tiranë, 2003, - 24f.
PORADECI, L. Të ritë e viteve të mi. Koleksion i pikturave të Lasgush Poradecit. Tiranë, alb PAPER, 2012, -64f.

Litereturë teorike:

1. **BARTHES, R. Writing degree zero**, First published in Tel Quel 47, fall 1971, reprinted in Polylogue, -125ph.
2. **BAYLON, Ch., Mignot X. Komunikimi,** Shtëpia botuese, Logosa, Shkup, 2004, 335f.
3. **CHEVREL, Y. Letërsia e Krahasuar,** Shtëpia botuese Albin, Tiranë, 2012, -160f.
4. **CULLER, J. Teori letrare. Një hyrje shumë e shkurtë,** Era, Prshtinë, 2001, -150f.
5. **ECO, U. The Reader,** Indiana University Press, Londër, 1984, -210ph.
6. **GROS-Piėgay, N. Poetika e Intertekstualitetit,** Shtëpia botuese Parnas, Prishtinë, 2011, -264f.
7. **GJIKAJ, E. Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit,** Shtëpia botuese dhe studio letrare Naim, Tiranë, 2010, -214f.
8**. HAMITI S. Poetika Shqipe,** Shtëpia botuese 55, Tiranë, 2010, 631f.
9. **ISMAJLI, R. Shumësia e tekstit,** Rilindja, Prishtinë, 1980, -261f.
10. **JAUSS, R., H. Esperienza estetica ed ermeneutica letteraria,** volume I, Il Mulino, Bologna, 1987, -420p.
11. **JAUSS, R., H. Esperienza estetica ed ermeneutica letteraria,** volume II, Il Mulino, Bologna, 1987, -391p.
12. **KRISTEVA, J. Desire in language. A semiotic Approach to Literature and Art**, Columbia University Press, 1980, -305ph.
13. **MISAK, Ch. The cambridge Companion to Peirce,** Cambridge university Pres, 2004, -320ph.
14. **PENDAVINJI, Gj. Nga mbledhja tek analizat statistike e të dhënave,** Shtëpia botuese Plejad, Tiranë, 2008, -166f.
15. **PENDAVINJI, Gj. Metodat e kërkimit,** Shtëpia botuese Koti, Korçë, 2010, -243f.
16. **SHAUMJAN, S., K., A semiotic Theory of Language,** Bloomington-Indianapolis, Indiana Univ. Press, 1987, -301ph.
17. **The Kristeva reader. Blackwell Publishers,** Oxford, UK, 2002, -327ph.
18. **UÇI, A. Universi estetik. Bota moderne,** Vëllimi i III, Shtypur në shtypshkronjën Nënë Tereza, Tiranë, 1997, -602f.
19. **UELLEK, R., UOREN, O. Teoria e Letërsisë,** Shtëpia botuese Enciklopedike, Tiranë, 1993, -270f.
20. **WELLEK, R., WARREN, A. Theory of Literature,** New York, 1956, -275ph.

Tregues i autorëve të shqipëruar dhe redaktuar nga Lasgush Poradeci:

21. **PUSHKIN, A., S. Puscinit (4maj); I. I. Puscinit. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Pushkin A. S. Lirika, Tiranë, 1949, f. 21-23.
22. **HYGO, Viktor. Arti dhe populli.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Hygo, Viktor. Pjesë të zgjedhura. Tiranë, "Naim Frashëri", 1952, f. 29-30.
23.**VAPCAROV, N., I. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Vapcarov, Nikolla. Vjersha të zgjedhura. Tiranë, 1952, f. 69-70.
24. **MAJAKOVSKI, V. Mirë e bukur. Poema e tetorit (1927).** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Majakovski Vladimir. Mirë e bukur. Tiranë, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, 1954, -103 f.

25. **PUSHKIN, A., S. Eugjen Onjegini.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Pushkin, Aleksandër Sergeijev. Eugjen Onjegini. Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, 1956, -208 f.
26. **HEINE, H. Poezi. Në tri pjesë.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Heine, Henrish. Në tri pjesë. Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, 1957, -199 f.
27. **LERMONTOV, M. Lirika të zgjedhura.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Lermontov, Mihail. Lirika të zgjedhura. Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, 1957, -71 f.
28. **MAKAROCKINA, N. Trëndafili i kuq. Vjersha.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Makarockina, Nina. Trëndafili i kuq. Tiranë, "Naim Frashëri", 1958, -34 f.
29. **HEINE, H. Atta Troll. Gjermania. (Poema).** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Hajne, Henrih. Atta Troll. Gjermania. Tiranë, "Naim Frashëri", 1958, -34 f.
30. **MICKIEWICZ, A. Vjersha dhe poema.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci, Emil Plumbi, Qevqep Kambo. Në librin: Mickiewicz, Adam. Vjersha dhe poema. Tiranë, "Naim Frashëri", 1960, -234 f.
31. **BERNS, R. Vjersha dhe ballada.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Berns, Robert. Vjersha dhe ballada. Tiranë, "Naim Frashëri", 1961, -199 f.
32. **GOETHE, J. W. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Goethe, Johann Wolfgang von. Poezi. Tiranë, "Naim Frashëri", 1962, -192 f.
33. **BREHT, B. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Breht, Bertold. Poezi. Tiranë, "Naim Frashëri", 1973, -131f.
34. **HYGO, V. Ndëshkimet.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci dhe Sotir Caci. Në librin: Hygo, Viktor. Ndëshkimet. Tiranë, "Naim Frashëri", 1975; -264 f.
35. **Këngë popullore rumune. Mjer si ti, obe, obe!; Syth o sythi vocërak; Toma 59. Alimosh. Poezi.** Shqipëruara nga Lasgush Poradeci. Në librin: Këngë të popujve: Poezi popullore të vendeve të ndryshme. Tiranë, "Naim Frashëri", 1978; f. 38; 76; 77.
36. **HEINE, H. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Hajne, Henrih. Poezi. Prishtinë, Rilindja 1981; -403f.
37. **FOR, P. Duhet të duhemi. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Poezi franceze. Tiranë, 1984, f. 453.
38. **HYGO, V. Nënshtrimit pasiv. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Poezi franceze. Tiranë, 1984, f. 272-274.
39. **KOPE, F. Lotët. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Poezi franceze. Tiranë, 1984, f. 384-385.
40. **LABE, L. Sonete. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Poezi franceze. Tiranë, 1984, f. 115-116.
41. **NOAILLES, D., A. Asnjë ditë s'kam menduar. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Poezi franceze. Tiranë, 1984, f. 456.
42. **D'OBINJE, A. Stanca. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Poezi franceze. Tiranë, 1984, f. 117-118.
43. **SHARL LE KONT, D., L. Mesditë. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Poezi franceze. Tiranë, 1984, f. 361-362.
44. **VERAREN, E. Mulliri. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Poezi franceze. Tiranë, 1984, f. 398-399.
45. **VIS, D., T. Vetëtima. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Poezi franceze. Tiranë, 1984, f. 141.
46. **GOETHE, J., W. Poezi.** Kushtim; Nata e parë; Kristja; Atërsia e të dashurit; Mbanë lumit; Mall; Lamtumirë; Së zgjedhurës; Tryezë e shtruar; Me një gjerdan të artë; Si i vdekur; Dhëndërri; Surprizë e fuqishme; I vetëgënjyer; Shoqëri; Gjëja më e

mirë; Vanitas; Vanitatum, Vanitas!; Këngë ciganësh; Perëndia dhe Bajadera; Këngë vajtimi e gruas fisnike të Hasan Agait; Perëndesha ime; Vizita; Gota; Praku i Lilit; Prabola; Detyra. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Goethe, Johann Wolvgang von. Vepra të zgjedhura II, Tiranë, 1988, f. 25; 33-36; 47-50; 56; 59-62; 78-81; 88-89; 92-95; 137-138; 206-210; 339-342; 363-366; 369-373; 400-405; 450-455.

47. **BREHT, B. Vargu anakronik i njerëzve ose Liri dhe Demokraci. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: Zëri i Popullit. -Nr. 239, 17 dhjetor, Tiranë, 1995, f. 7.

48. **HEINE, H. Mbreti dhe poeti. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: Zëri i Popullit. -Nr. 39, 18 shkurt, Tiranë, 1996, f. 13.

49. **LENAU, N. Dritare e hapur. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: M M. -Nr. 2, 1996, f. 249-252.

50. **MICKIEWICZ, A. Miqve të mij.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: Mehr Licht!. -Nr. 8, 1998, f. 203 – 210.

51. **GOETHE, J., W. Kristja. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: Drita, 26 dhjetor, 1999, f. 12.

52. **HEINE, H. Sikur të prishej jeta. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: Drita, 26 dhjetor, 1999, f. 12.

53. **MICKIEWICZ, A. Kënga e Viljas. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: Drita, 26 dhjetor, 1999, f. 12.

54. **VIS, D., T. Vetëtima. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: Drita, 26 dhjetor, 1999, f. 12.

55. **GOETHE, J., W. Mignon. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: Mehr Licht!. -Nr. 10, 1999, f. 132 – 133.

56. **BURNS, R. Llord Gregor. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: Drita, 26 dhjetor, 2000, f. 12.

57. **PUSHKIN, A., S. Eugjen Onjegini.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Pushkin, Aleksandër Sergeijev. Eugjen Onjegini. Argeta-LMG, Tiranë 2001, -248f.

58. **BURNS, R. Meri Morison. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: Tema. -Nr. 502, 10 - 11 shkurt, 2002, f. 19.

59. **MICKIEWICZ, A. Pasiguri. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: Spektër. -Nr. 183, 4 tetor, 2003, f. 55.

60. **BURNS, R. Denkan Grej.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: Drita, 28 dhjetor, 2003, f. 11.

61. **HEINE, H. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: Drita, 28 dhjetor, 2003, f. 11.

62. **NOAILLES, D., A. Asnjë ditë s'kam menduar. Poezi.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: Spektër. -Nr. 204, mars, 2005, f. 21.

63. **GOETHE, J., W. Poezi. Këngë ciganësh.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: Spektër. -Nr. 205, prill, 2005, f. 20.

64. **GOETHE, J., W. Poezi. Nata e parë.** Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në: Liqeri. 5 janar, 2005, f. 4.

Literaturë kritike:

-Studime, artikuj, krijime letrare të autorëve të tjerë për Lasgush Poradecin botuar në vëllime dhe periodikë të ndryshëm shqiptarë dhe të huaj, sipas kronologjisë së viteve.

1928

65.**ANONIM. Dy fjalë mbi vjershëtorin Lasgush Poradeci.** "Shqipëria e Re". -Nr. 347, Kostancë, 28 nëntor 1928, f. 3.
1929
66. **ÇABEJ, Eqrem. Mbi poezinë e Lasgush Poradecit.** Gazeta e Re. -Nr. 94, Tiranë, 22 shkurt, 1929, f. 3.
